

ENVER HOXHA

VEPRA

9

PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNII

ENVER HOXHA

VEPRA

**BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE
SHQIPERISE**



ENVER HOXHA

**INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE - LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH**

ENVER HOXHA

VELLIMI

9

JANAR 1952 – GUSHT 1952

**SHTËPIA BOTUËSE «NAIM FRASHËRI»
TIRANË, 1972**

PARATHËNJE PËR VËLLIMIN 9

Vëllimi i 9-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përfshin shkrime të periudhës janar-gusht 1952. Midis këtyre shkrimeve janë Raporti në Kongresin II të PPSH «Mbi aktivitetin e KQ të PPSH», raporte e diskutime në mbledhje të plenumit, të Byrosë Politike dhe të Sekretariatit të KQ të PPSH, Fjala në Kongresin e dytë të BRPSH, Fjala në Kongresin e tretë të BPSH. Një numër materialesh botohen për herë të parë.

Në veprat e këtij vëllimi një vend të veçantë zënë problemet e planit të parë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës popullore, të ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit, të zhvillimit të forcave prodhuase, të rritjes së mirëqenjes së masave punonjëse. Në këto vepra është përpunuar politika e Partisë për industrializimin socialist të vendit në bazë të parimeve themelore të marksizëm-leninizmit dhe të kushteve konkrete kombëtare e ndërkombëtare. Njëkohësisht janë trajtuar një numër çeshtjesh të rëndësishme të nxjerrjes nga prapambetja dhe të zhvillimit të bujqësisë, si edhe të shndërrimit socialist të fshatit.

Edhe pse në prak të planit të parë pesëvjeçar niveli i forcave prodhuase, i teknikës dhe i arësimit në vendin tonë ishte ende shumë i ulët, Partia e Punës e Shqipërisë

në zhvillimin e ekonomisë e të kulturës populllore udhëhiqej nga parimi revolucionar i mbështetjes në forcat e veta, në burimet e brendshme, në aftësitë e punonjësve dhe të kuadrove tanë. Mbështetej gjithashtu edhe në ndihmën e vendeve të tjera socialiste, në radhë të parë të Bashkimit Sovjetik. Këtë ndihmë ajo e kërkonte dhe e përdorte kryesisht në dobi të zhvillimit të forcave prodhuase me qëllim që Shqipëria socialistë siguronte ecjen përpara me këmbët e veta.

Rëndësi të madhe historike e njëkohësisht aktuale ka përpunimi shkencor që i bën shoku Enver Hoxha në Raportin e Kongresit II të PPSH dhe në shkrimet e tjera të kësaj periudhe, metodës së udhëheqjes politike të Partisë mbi bazën e përvojës së fituar sidomos pas çlirimit të vendit. Ai në mënyrë të veçantë tërheq vëmendjen për demokratizimin dhe forcimin e mëtejshëm të pushtetit popullor. Ai vë theksin në përsosjen e udhëheqjes kolegiale, në dhënjen rregullisht llogari të organeve drejtuese të Partisë përpara masës së komunistëve, në forcimin e kritikës e të autokritikës, në rritjen e rolit të masave punonjëse si ndërtuese të socializmit.

Në të njëjtën kohë shoku Enver Hoxha i mësonte komunistët të qëndronin syhapur, të mos harronin për asnjë çast kanosjet që i vinin Partisë nga presioni i fortë që ushtronin imperialistët e ndryshëm dhe revisionistët jugosllavë nga jashtë, kulakët dhe armiqtë e tjerë të klasës nga brenda. Përpara një presioni të tillë Partisë i duhej të rritte vazhdimesht vigjilencën dhe të luftonte me një forcë edhe më të madhe oportinizmin e djathtë, si rrezik kryesor.

Veprimitaria e dendur armiqësore kundër Republi-

kës Popullore të Shqipërisë që zhvillonin pareshtur imperialistët dhe shërbëtorët e tyre në kufitë e vendit tonë, nxirrte shumë pengesa dhe vështirësi në rrugën e plotësimit të detyrave të planit të parë pesëvjeçar. Për shkatërrimin e pengesave dhe për kapërcimin e vështirësive, porositte shoku Enver Hoxha, ishte e nevojshme të rritej gatishmëria moralo-politike dhe ushtarake, të forcohej organizimi dhe disiplina në punë, të fuqizohej mbrojtja e atdheut, tërë punonjësit në veprimtarinë e tyre praktike të udhëhiqeshin nga parulla kryesore e Partisë: «Të ndërtojmë socializmin duke mbajtur në njëren dorë kazmën dhe në dorën tjetër pushkën».

Vëprat e këtij vëllimi flasin për lidhjen e ngushtë të punës e të luftës për ndërtimin e socializmit në Shqipëri me luftën e forcave revolucionare socialistë dhe antiimperialiste në gjithë botën.

MBI VËRTETIMIN E DOKUMENTAVE

Konkluzione në Plenumin XII të KQ të PPSH¹

8 janar 1952

Natyrisht, Byroja Politike e studjoi raportin, ajo ishte dakord me të, si dhe me konkluzionet që dilnin prej tij. Në raportin që i është paraqitur këtij plenumi janë përfshirë edhe vërejtjet e Byrosë Politike dhe siç shihet në projektrezolucion çështjet janë përcaktuar më mirë. Ashtu siç u theksua edhe nga të gjithë shokët dhe ky është edhe mendimi i Byrosë Politike, vërtetimi i dokumentave ka qenë një gjë e domosdoshme që ka dhënë frut të mirë pér Partinë tonë, pse e ka forcuar atë. Kjo ka qenë gjëja kryesore dhe këtu ishte synimi i gjithë kësaj pune të rëndësishme. Veç kësaj vërtetimi i dokumentave na dha edhe një pasqyrë të qartë në lidhje me shtresat shoqërore në Parti. Njëkohësisht me vërtetimin e tyre dolën në shesh edhe gabimet që janë vërtetuar në Parti gjatë dhjetë vjetëve dhe sidomos.

¹ Plnumi diskutoi rrëth raportit përfundimtar të Byrosë Politike «Mbi vërtetimin e dokumentave në Parti», që kishte filluar që në janar 1950.

mos gjatë periudhës së mungesës të Statutit të saj, nga mungesa e të cilit ka përfituar armiku. Elementët e dobët, të futur në Parti, kërkonin ta dobësonin atë nga brenda dhe të pengonin zbatimin e drejtë të vendimeve të Komitetit Qendror dhe të Partisë. Gjithashtu vërtetimi i dokumentave na dha edhe një pasqyrë ekzakte të qëndrimit të komunistëve ndaj të metave dhe gabiimeve, po kështu edhe të qëndrimit të elementit armik në Parti. Në këtë punë kaq të madhe është vërtetuar se në Parti gjatë dhjetë vjetëve ka ekzistuar çështja e oportinizmit, bile, në një shkallë shumë më të madhe se sa ajo e sektarizmit. Fakti që me rastin e revizionimit janë hedhur jashtë Partisë një numër elementësh armiq dhe të padëshirueshëm, tregon se vigjilanca e Partisë nuk ka qenë në lartësinë e duhur për ta ruajtur Partinë nga elementë të tillë. Këto lëshime dhe kjo mungesë vigjilence kanë qenë më tepër rezultati i punës së pamjaftueshme që është bërë pas çlirimt se sa i kohës së luftës, kur Partia nuk ishte shumë e zhvilluar. Kjo tregon njëkohësisht edhe dobësinë tonë organizative gjatë kësaj kohe, mënyrën dhe metodën jo të mirë të drejtimit në lidhje me kuadrin, mosndjekjen e zhvillimit të kuadrit në luftë, që ishte shosha më e sigurtë etj., të cilat nuk kanë qenë të shëndosha. Për këto arësy Partia nuk u zhvillua në masën e duhur. Pas çlirimt, kur kërkohej që Partia të zhvillohej në masën e duhur, duhej që ata që futeshin në Parti, të kontrolloheshin mirë që të mos hynin në radhët e saja elementë armiq ose të dobët. Kjo ka qenë edhe koha e veprimtarisë armiqësore e trockistëve jugosllavë dhe e Koçi Xoxes me shokë që influencuan shumë në futjen

në Parti të elementit armik. Këtë e tregon fakti që një pjesë e mirë e të përjashtuarve rezulton të jenë futur në këto momente. Me gjithë punën armiqësore dhe goditjen e rëndë që ju dha trockizmit në vendin tonë, Partinë nuk e zuri asnjëherë gjumi, por qëndroi gjithmönë vigjilente. Ajo i ka analizuar e dënuar edhe më vonë qëndrimet armiqësore dhe antiparti si dhe oportunitzmin e theksuar në radhët e Partisë e të disa üdhëheqësve të saj, duke e pasur të qartë që puna ë armikut është një luftë e vazhdueshme që ai i bën Partisë. Mirëpo gjatë kësaj lufte vigjilanca, kombativiteti dhe ashpërsia e komunistëve nuk duhej të qëndronin në mënyrë të njëjtë dhe të palëvizshme, por duhej të bëheshin më të mëdha dhe me forma të ndryshme. Në këtë drejtim Partia ka pasur suksese dhe këtë e tregon zbulimi i dobësive dhe puna armiqësore e disa elementeve që dolën në Plenumin V dhe IX të Komitetit Qendror. Por, që të evitoheshin dëmet që ju bënë Partisë nga këta elementë, duhej bërë një punë më e organizuar që këta të ishin goditur më përpara. Këto gabime që janë vërtetuar në Parti dhe që ajo i ka analizuar e goditur, janë në vijën e djathtë, në vijën oportuniste, d.m.th. elementë të lëkundshëm e të gatshëm për t'u bërë gjahu i armikut kanë mundur të hyjnë në gjirin e Partisë sonë.

Vërtetimi i dokumentave tregoi se në Partinë tonë ka kombativitet dhe është bërë luftë në organizatë kundër elementeve armiq oportunistë, të lëkundshëm, gjenjeshtarë, por në rast se Komiteti Qendror e organet e tij do t'i kishin evituar që në fillim gabimet që u

ndreqën më vonë¹, kjo punë do të kishte dalë me rezultate edhe më të shkëlqyeshme. Çështja e mbrojtjes së Partisë është një problem i përditshëm. Këtë e tregon edhe eksperienca e Partisë sonë, prandaj asnjëherë të mos shkojmë me mendimin se meqë u bë verifikimi, të biem në plogshti dhe ta dobësojmë luftën kundër armikut të jashtëm ose të brendshëm.

Problemi i sektarizmit duhet shikuar mirë, pse ka rrezik që në punë të vigjilencës në disa raste të kapërcet në anën tjetër. Prandaj me të drejtë Byroja Politike tërheq vëmendjen e Partisë që ajo të ketë parasysh çështjen e elementeve të përjashtuar, pse elementët që janë hedhur jashtë Partisë, jo për punë armiqësore, Partia duhet t'i ketë në sytë dhe në kujdesin e saj, t'i futë në punë e në luftë këta njerëz dhe të shohë si punojnë e si qëndrojnë ndaj vijës së Partisë. Gjithashtu elementëve që janë përjashtuar jo si armiq, të mos u vëmë damkën dhe t'i bëjmë pre të armikut, i cili do të përpinqet që t'i kapë e t'i bëjë të tijtë. Kjo duhet pasur parasysh jo vetëm në Parti, po edhe në punën me Frontin, që është një organizatë politike shumë e gjerë e ku vihen re shkarje në këtë çështje.

Një çështje tjetër që ngriti Byroja Politike në këtë raport është forcimi i vigjilencës për mbrojtjen e pastërtisë së radhëve të Partisë, kjo të mbahet vazhdimisht parasysh në rrugën e drejtë të Partisë. Lufta dhe për-

¹ Një nga këto gabime ishte dhe ideja e përkrahur nga Tuk Jakova, sipas së cilës vërtetimi i dokumentave duhej të bëhej jashtë kontrollit të masës së komunistëve dhe pa pjesëmarrjen e drejtëpërdrejtë të organizatave bazë.

pjekjet i sjellin Partisë elementë të rinj, të dhëna të reja, prandaj ata që sot i fshehin akoma gjëra Partisë, do t'u dalin patjetër në shesh në të ardhshmen. Kjo është e natyrshme. Presioni i armikut, i borgjezisë do të lëkundë shumë elementë, jo vetëm nga ata që kanë qenë me armikun, po edhe nga ata që nuk kanë pasur gjëra të dyshimita, por që nuk mund t'i qëndrojnë këtij presioni. Në rast se Partia nuk ua lufton me mjetet e saj këto dobësi, do të vijë dita që edhe këta të hidhen jashtë Partisë. Këtu ka rëndësi që këto çështje duhen mbajtur vazhdimesht gjallë. Përveç kësaj edhe njerëzit duhet të shihen në punë, d.m.th. të gjykojen me çfarë i japin ata Partisë, të çmohen me besnikërinë ndaj Partisë në terrenin praktik, ideologjik dhe politik. Komunistët e mirë, besnikë duhet të kenë parasysh se lufta e tyre duhet të vazhdojë deri në fund, derisa ata të mbyllin sytë. Për ata komunistë që u janë zbuluar gabime, Partia duhet të ketë parasysh parimin se këta, me gjithë të metat që kanë, do të ndreqen me anë të punës e të aktivitetit të tyre, d.m.th. gabimet që janë vërtetuar ndër ta, të mos bëhen pengesë në rast se ata ecin përpara dhe i lajnë ato duke ja shpërblyer Partisë dhe popullit me vepra prej komunisti. Prandaj edhe këtë duhet ta ketë parasysh Partia.

Përsa u përket masave që janë marrë ndaj disa komunistëve përfaje që kanë bërë në të kaluarën dhe që Partia ka marrë masa ndaj tyre një herë, këto janë gjëra që korrighojen. Ndërsa në lidhje me vërejtjet që u janë bërë mjaft elementëve, pse nuk kanë treguar të vërtetën, mendoj se të tilla vërejtje janë të drejta pse ata nuk kanë qenë në rregull me Partinë dhe kjo

megjithatë nuk i hedh poshtë ata. Ai që nuk ka mbajtur qëndrim të drejtë ndaj Partisë e meriton që të merret një masë e tillë ndaj tij.

Në lidhje me përjashtimet, mendimi i Byrosë Politike është se këto përjashtime, po t'i analizojmë, del se janë bërë në drejtim të armiqve që janë futur në Parti nga lëshimet e bëra dhe numri i tyre është mjaft i madh. Por, po ta marrim të lidhur me situatën e vështirë që ka kaluar Partia jonë gjatë kësaj kohe, nuk mund të dalim me konkluzionin se ka munguar vigjilenca dhe lufta e Partisë për të goditur elementin armik. Më e rëndë për ne është se në të përjashtuarit ka shumë fshatarë të varfër. Këtu është një gabim e faj i punës sonë në lidhje me anëtarët e Partisë duke marrë para-sysh se Partia jonë është e re dhe niveli i anëtarëve të saj është mjaft i ulët. Ne nuk kemi luftuar dhe nuk luftojmë dita-ditës për ngritjen e komunistëve. Kjo është një e metë e punës sonë. Prandaj ne duhet të kemi një program rigoroz për ngritjen ideologjike të komunistëve. Kjo gjë përpara na ka munguar plotësisht, kurse tani është diçka më në rregull, po akoma jo e mjaftë. Në rast se ngritjen ideologjike të komunistëve nuk e marrim me seriozitetin e duhur, do të bëjmë gabim të rëndë, pse ose do të shkojmë në vijë sektare në çështjen e pranimeve, d.m.th. do ta ngushtojmë Partinë duke mos bërë pranime të elementeve të rinj, ose do të ecim me hope në këtë çështje dhe do të na vijnë në Parti njerëz të papregatitur. Prandaj çështja e ngritjes ideologjike të komunistëve i vihet si detyrë e parë Partisë.

Ne kemi analizuar dhe do të analizojmë qëndrimet

e secilit ndaj detyrave dhe rregullave të Partisë, pse kemi raste që komunistët nuk i kryejnë si duhet detyrat që u ngarkon Partia dhe nuk janë vigjilentë sa duhet. Shohim gjithashtu se kritika e autokritika nuk janë në lartësinë e duhur. Po qe se kritika dhe autokritika janë të dobëta tani, dhe po qe se do të vazhdohet kështu, ato do të dobësohen edhe më në të ardhshmen. Edhe qëndrimi i disave nderaj detyrave që na vë Partia nuk është i drejtë. Kjo e metë zhduket nëpërmjet luftës e kritikave të gabimeve, kështu puna jonë do të përparojë dhe do të japë rezultatë. Qëndrimi jo i drejtë ndaj detyrave dhe vështirësive shihet qartë në faktin që shumë komunistë punojnë në administrata. Po të bëhej një shpërndarje më e drejtë e tyre, do t'i jepej një hov më i madh çështjes së realizimit të planit. Ne konstatojmë se ka komunistë që kanë filluar të marrin tiparet e një burokrati dhe po shkëputen nga masat e popullit. Në disa komunistë ndjehet një drojtje e pajustifikueshme për të shpurë lirisht vijën e Partisë në masat e popullit. Ka komunistë të vjetër që druhen të flasin përpara masave të popullit, të shtrojnë probleme dhe të diskutojnë, bile disa herë masat e popullit janë shumë më përpara në këtë drejtim dhe kjo vihet re në mbledhjet e konferencat që bëhen me popullin. Kjo gjë vjen se disa komunistë po burokratizohen. Një gjendje e tillë i sjell shumë dëme Partisë, pse masave nuk u vete fjala e Partisë nëpërmjet shokëve për problemet e përditshme që e preokupojnë jashtëzakonisht popullin; komunistët duhet me ua sqarue këto gjëra masave. Por shumë anëtarë të Partisë rrallë mbajnë kontakte me masat. Le të marrim çështjen e detyrave që Partia u

ngarkon komunistëve jashtë punës zyrtare. Këto detyra neglizhohen. Një nënë më tha një ditë: «Mëhallë bën qytetin e qytetet bëjnë gjithë Republikën». Prandaj, po të mos kujdesohen anëtarët e Partisë për mëhallën, atje nuk do të venë mirë punët. Po kjo nënë më tha: «Po hyri një pikë në shtëpi dhe nuk u ndreq, do të kalojë tavanin dhe do të bëjë që të rrëzohet e tërë shtëpia». Shikoni ç'filozofi! Këto çështje i neglizhojnë anëtarët e Partisë. Mos harroni se lidhja me masat është një parim themelor leninist. Prandaj kjo gjë të mbahet kurdoherë parasysh. Anëtarët e Partisë duhet të kontrollojnë vazhdimisht jetën dhe aktivitetin e tyre, t'i bëjnë analizë vetes dhe të mos kenë frikë për të njobur gabimet, pse në punë e sipër bëhen edhe gabime. Të kritikosh gabimet e të tjerëve është e mirë, por mos harro se dhe ti vetë bën gabime. Partia ne na mëson të luftojmë për vijën e saj, pse kjo është gjëja themelore. Mirëpo ka shokë që bëjnë gjëra që nuk pajtohen me vijën e Partisë, kjo është e rëndë. Si këto që më tha ajo nëna ka shumë probleme dhe zgjidhja e këtyre do të na lidhë më ngushtë me masat e popullit dhe këtu është çështja e ngritjes së prestigjit të Partisë, e autoritetit të saj. Këtë gjë ne duhet ta mbrojmë me këmbëngulje, pse ka lidhje me forcimin e pozitave të Partisë sonë me masat. Prandaj në zbatimin e vijës së Partisë ne nuk duhet të bëjmë lëshime.

... Përsa u përket anëtarëve të Partisë në prodhim, kemi menduar të bëjmë një studim dhe këtë gjë do ta shohë me kujdes Byroja Politike.

Sa për pranimin e të rinjve në Parti, vërejtja që bëri shoqja Nexhmije, është e drejtë, pse mund të

ngjasë që elementë të rinj dhe të mirë të qëndrojnë në rini deri në 24 vjeç, kurse shumë prej tyre mund t'i kenë konditat të vijnë me kohë në Parti. Prandaj edhe kjo çështje duhet të shihet.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Plenumat XII të KQ të PPSH që gjendet në AQP

FJALIM I MBAJTUR ME RASTIN E INAUGURIMIT TË PUNIMEVE TË HIDROCENTRALIT MBI LUMIN E MATIT¹

11 janar 1952

Popull i krahinave të Veriut,
Popull i krahinës së Matit,

E ndjej veten të lumtur që t'ju sjell përshëndetjet më të zjarrta të qeverisë dhe të Komitetit Qendror të Partisë së Punës me rastin e 6-vjetorit të themelimit të Republikës sonë Popullore dhe me rastin e hapjes së punimeve të veprës më të madhe të deritanishme të pushtetit tonë popullor, hidrocentralit elektrik mbi lumin e Matit. E ndjej veten shumë të lumtur që të takohem sot me ju, shokë malësorë, sepse populli i këtyre malësive ka qenë kurdoherë i papërkulshëm kundrejt zgjedhës së huaj dhe tradhëtarëve të vendit, sepse ai dha nga gjaku i tij në Luftën nacional-çlirimtare të popullit tonë dhe sot është mbështetje e fortë e pushtetit popullor dhe e Partisë sonë të Punës.

Më 11 Janar 1946 u shpall Republika Popullore e

¹ Sot Hidrocentrali «Karl Marks».

Shqipërisë. Kjo ishte fruti i luftës heroike të popullit tonë trim, që bëri nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Shqipërisë kundër fashistëve italianë dhe gjermanë, që na kishin pushtuar vendin dhe kundër tradhëtarëve të vendit, ballistë e zogistë, reaksionarë dhe fashistë, që ishin vënë në shërbim të pushtuesve të huaj. Kjo ishte fruti i luftës heroike të Ushtrisë së lavdishme Sovjetike, të ushtrisë së Stalinit, e cila shkatërrroi ushtritë e fashizmit kudo që ishin dhe i dha mundësinë popullit tonë që të çlironte vendin e tij, të vendoste pushtetin popullor dhe të bëhej një herë e përgjithnjë zot i fateve të tij. Republika Popullore e Shqipërisë u ngrit si kështjellë paqeje dhe lirie mbi gërmadhat e regjimit skllavërues dhe tradhëtar të Ahmet Zogut, mbi gërmadhat e regjimit fashist dhe pushtuesve të Musolinit dhe të Hitlerit që u mbajt prej tyre në vendin tonë me gjak e terror, duke u mbështetur vetëm në disa shërbëtorë dhe spiunë të tyre si Abaz Kupi, Hysni Dema, Fiqri Dine, Mithat Frashëri, Mehdi Frashëri, Mustafa Merlika, Gjon Marka Gjoni, Ernest Koliqi e të tjera si këta. Republika Popullore e Shqipërisë u ngrit me përpjekje, me luftë, me luftën më heroike të popullit tonë; i udhëhequr nga Partia jonë trime. Lufta neve na kushtoi shumë shtrenjtë, dhjetëra mijëra shqiptarë dhe shqiptarka heroike ranë në fushën e luftës për çlirimin e atdheut. Fashistët e huaj dhe të vendit na shkatërruan të gjithë ekonominë, fshatra dhe krahina të tëra të vendit tonë i bënë shkrumb e hi.

Populli i këtyre krahinave luftoi heroikisht në radhët e brigadave të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve. Qindra bij heroikë

të këtyre krahinave luftuan me trimëri të madhe dhe shumë u vranë në luftë për lirinë e popullit tonë. Të tillë kanë qenë: Nazmi Rushiti, Mustafa Kaçaçi, Ndoc Deda, Bardhok Biba, Haki Fejzo, Haxhi Zhgjuni, Gani Bozhiqi, Ali Metra, Dyleman Çela, Bajram Lika, Ali Hoxha, Abdi Kryekurti, Isuf Koleci, Mark Bib Marku, Mark Gjet Macaj, Demir Gashi, Riza Doda, Jashar Kola, Sabri Caka, Rexhep Zuna etj. etj.

Lufta nacional-çlirimtare e udhëhequr nga Partia Komuniste forcoi bashkimin e të gjithë popullit tonë, ajo zhduku një herë e përgjithmonë intrigat e dallavëret e Ahmet Zogut dhe të fashistëve për të përçarë popullin tonë në gegë e toskë, në katolikë e muslimanë. Lufta nacional-çlirimtare dhe pushteti popullor kanë bërë që të zhduken një herë e përgjithmonë këto intriga të poshtra dhe sot populli ynë, që nga Vermoshi e deri në Konispol, që nga Bregdeti e deri në Korab, është i bashkuar si një trup i vetëm në Frontin Demokratik rreth Partisë së Punës dhe qeverisë së tij. Ky bashkim ka bërë që Shqipëria ta mbajë lart flamurin e lirisë, të pavarësisë, të paqes dhe të socializmit në këtë qoshe të Ballkanit, sado e rrethuar gjeografikisht nga armiq të egër dhe me qëllime të këqia kundër saj. Ky bashkim u bë i mundur, sepse në krye të masave punonjëse të vendit tonë qëndron Partia e Punës, Partia e dashur e popullit, që udhëhiqet nga mësimet e marksizëm-leninizmit e të shokut Stalin.

Ahmet Zogolli erdhi në fuqi me ndihmën e mercenarëve të Jugosllavisë monarkiste dhe të shteteve imperialiste. Ai qëndroi 15 vjet në fuqi. Ç'i dha Shqipërisë Ahmet Zogu gjatë 15 vjetëve të regjimit të tij monarkist

dhe fashist? Asgjë të mirë, përvèç së keqes. Regjimi i Ahmet Zogut ishte regjimi i feudalëve, ishte regjimi i skllavërisë, i tradhëtisë. Ai i shërbente jo popullit, jo vegjëlisë, por një grushti gjakpirësish dhe maskarenjsh, bejlerë dhe agallarë, si Abdurraman Krosi, Abaz Kupi, Hysni Dema, Hysen Selmani, Musa Juka e të tjerë. Ahmet Zogolli i solli popullit tonë mjerimin, zinë, papunësinë, skllavërinë. Ai pregetiti pushtimin e Shqipërisë nga fashizmi italian dhe kur erdhi puna për mbrojtjen e atdheut, Ahmet Zogolli mbushi valixhet me floririn e popullit dhe iku natën si kusar, fshehur nga populli e u arratis jashtë shtetit. Sot ai është katandisur në një sahanlëpirës i thjeshtë, si një mace e zgjebosur, në shërbim të anglezëve dhe të amerikanëve. Regjimi i Zogollit u varros një herë e përgjithmonë. Atë e shkatërrroi për vdekje lufta heroike e popullit tonë, i cili ngriti në Shqipëri flamurin e lirisë dhe të demokracisë.

Regjimi ynë popullor ka vetëm shtatë vjet qysh nga dita që është themeluar. Ç'është bërë gjatë këtyre shtatë vjetëve? Ne kemi bërë gjatë këtyre shtatë vjetëve atë që regjimi i Ahmet Zogut nuk do të ishte në gjendje ta bënte as në 70 vjet. Fshatari dhe malësori u çliruan përjetë politikisht dhe ekonomikisht nga prangat e beut dhe të bajraktarit. Reforma agrare e bëri fshatarin zot të tokës. Ndërsa më 1938 në të gjithë vendin tonë kishte vetëm 634 shkolla fillore, tanë kemi më shumë se 2 000 shkolla fillore, ku mësojnë tri herë më shumë nxënës se sa më 1938. Prodhimi industrial sot është gati katër herë e gjysmë më tepër se në vitin 1938, sipërfaqja e tokave të mbjella një herë e gjysmë më

tepër, prodhimi i pambukut 55 herë më tepër, numri i spitaleve 7 herë më tepër, numri i traktorëve 18 herë më tepër e kështu me radhë. Përveç kësaj ajo që ka rëndësi të madhe është se sot industria, bujqësia, arësimi, çdo gjë është në shërbim të popullit dhe jo në shërbim të një grushti të pasurish si mjet i tyre për ta skillavëruar popullin. Ne kemi ngritur fabrika të mëdha, hidrocentrale, kemi ndërtuar hekurudha e rrugë të reja. Marrim për shembull, Kombinatin e tekstileve «Stalin». Siç dihet ky kombinat u ndërtua me ndihmën e Bashkimit Sovjetik brenda dy vjet e gjysmë dhe sot po prodhon beze për popullin. Më 1955 ky kombinat do të mund të prodhojë njëzet milion metra linear beze në vit, domethënë aq beze saqë të mund të ketë rreth 18 metra për çdo frysëm në Republikën tonë. Kjo sasi do të jetë e mjaftueshme për nevojat e popullit tonë në beze. Le të marrim për shembull Fabrikën e madhe të sheqerit «8 Nëntori» në Maliq, e cila do të prodhojë për çdo vit (nga viti 1955) nëntë milion kilogram sheqer, që do të jetë i mjaftueshëm për popullin shqiptar, ose le të marrim kanalin vaditës Peqin-Kavajë: ky kanal është 45 kilometra i gjatë dhe do të ujitet të gjithë fushën e Kavajës, midis lumit të Shkumbinit dhe detit, me një sipërfaqe prej shtatë mijë hektarësh. Këtë kanal ne e filluam vitin që kaloi dhe e bëmë brenda tetë muajsh. Edhe Ahmet Zogu u mëndua tâ bënte këtë kanal, por pasi u punua atje tre vjet, pasi vodhën sa deshën ministrat bashkë me Ahmet Zogollin, më në fund e mbyllën hesapin duke e braktisur kanalin me këto fjalë: «Ujët nuk ecën nalt». Duhet kujtuar se ne jo vëtëm që e ndërtuam kanalin për një kohë kaq të

shkurtër dhe tri herë më të madh se ai që mendonte të hapte Ahmet Zogu, por edhe atë pak punë që ishte bërë atëhere, nuk e shfrytëzuam fare, pasi projekti i atëhershëm s'ishte real, por për të gënjer popullin.

Plani pesëvjeçar do ta zhvillojë edhe më tej ekonomjinë tonë dhe mirëqenjen e popullit tonë. Plani pesëvjeçar kërkon punë nga ne. Realizimi i tij është plotësisht i mundshëm, sepse populli ynë ka dhënë prova që tregojnë se ai është po aq ndërtues i mirë sa ç'është edhe luftëtar trim, sepse ne ndihmohemi dhe nga Bashkimi i madh Sovjetik dhe vendet e demokracisë popullore.

Me mijëra janë heronjtë e punës në vendin tonë ku ndërtohen me sukses bazat e socializmit. Për të lavdëruar janë rrethi i Peshkopisë, i cili është shembull pune të frutshme dhe organizimi për të gjitha rrethet e tjera të Shqipërisë; të tillë janë lokaliteti i Buzhqit dhe i Martaneshit të rrethit Burrel, që mbajnë flamurin tranzitor të rrethit përfushatën bujqësore, për t'u uruar dhe përfshiruar janë katundarët e dalluar dhe të dekoruar përsuksese në prodhime bujqësore, për zbatimin e udhëzimeve agroteknike dhe të metodave sovjetike në punë që japid prodhime të shumta. Këta katundarë janë me qindra në Shqipëri. Më lejoni të përgëzoj këta bujqësore: Ibrahim Bajramini nga rrethi i Burrelit; Shefki Toçin, Cen Pucën nga rrethi i Peshkopisë; Kasëm Ramën dhe Pjetër Petrashin nga rrethi i Krujës dhe t'u uroj atyre dhe të gjithë katundarëve që të punojnë mirë tokën e tyre dhe të korrin prodhime të bollshme që jetesa e tyre të bëhet e begatshme.

Ne sot festojmë hapjen e punimeve për ndërtimin e hidrocentralit mbi lumin e Matit. Kjo është një nga veprat e mëdha të ndërtimit të bazave të socializmit që përfshin plani pesëvjeçar. Ky hidrocentral që do të ndërtohet në fshatin Kakërdhok, është një vepër shumë e madhe. Punimet për ndërtimin e hidrocentralit do të fillojnë sot dhe do të mbarojnë brenda vitit 1955. Brenda katër vjetëve, lumi i Matit, që sot është një nga armiqjtë tanë natyrorë, pse na mbyt e na dëmton tokat, do të bëhet një nga miqtë tanë me vlerë se do të na japë dritë e fuqi. Hidrocentrali i Matit në fillim do të jetë katër herë më i madh se Hidrocentrali «Lenin», që u vu në përdorim dy muaj më parë dhe, më vonë, kur të ndërtohet aty afër edhe hidrocentrali i dytë¹, do të jetë gjashtë herë më i madh se Hidrocentrali «Lenin». Me ndërtimin e hidrocentralit të Matit ne do të krijojmë sistemin e energjisë elektrike për industrinë tonë, i cili sistem neve na mungon. Që nga hidrocentrali i Matit do të shtrihet një linjë elektrike e tensionit të lartë, me një gjatësi 150 kilometra, duke shkuar nëpër Tiranë, Elbasan dhe Qytetin «Stalin». Në këtë mënyrë do të mund të furnizohen me energji elektrike nga ky sistem: Tirana, Elbasani, rafineria e naftës, që do të ndërtohet gjatë këtij pesëvjeçari afër Elbasanit, Qyteti «Stalin», Patosi si dhe Rubiku, Bulqiza, Durrësi, miniera e Krrabës, miniera e Selenicës dhe do të krijohen mundësítë për të siguruar plotësisht me energji elektrike edhe Shkodrën, Lezhën, Rrëshenin, Burrelin,

¹ Hidrocentrali «Frederik Engels».

Shëngjinin, Milotin, Mamurrasin, Krujën, Shijakun, Kavajën, Rrogozhinën, Lushnjën etj.

Për të ndërtuar hidrocentralin e Matit do të punojnë rreth 4 000 punëtorë. Mbi lumin e Matit do të ndërtohet një digë e madhe. Vetëm për ndërtimin e kësaj digë, të këtij barrazhi kolosal, do të nevojiten 500 000 metra kub gurë. Kjo do të thotë që vetëm diga mbi lumin e Matit kërkon aq gurë sa do të ishin të mjaftë për të ndërtuar një mur një metër të gjerë dhe pesë metra të lartë në një gjatësi prej njëqind kilometrash, d.m.th. në një gjatësi që do të shkonte përmbi rrugën automobilistike që nga Burreli dhe deri në Shkodër. Brenda këtij viti do të ndërtohet gjithashtu një rrugë e asfaltuar prej rreth 25 kilometra që nga Ura e Milotit dhe deri në Kakërdhok e pastaj kjo rrugë do të lidhet edhe me Burrelin. Ngritja e barrazhit mbi lumin e Matit do të shkaktojë formimin e një lijeni që do të jetë 12 kilometra i gjatë, me një sipërfaqe prej rreth 2 000 hektarë dhe me një thellësi maksimale prej 55 metrash. Lijeni që do të formohet, do të mbulojë tërësisht ose pjesërisht 6 katunde me rreth 100 shtëpi. Natyrisht, familjet e atyre katundeve që do të mbulohen nga lijeni, do të shpërblehen tërësisht. Qeveria do t'u japë atyre tokë të mirë diku gjatkë, në të njëjtën masë që ata do të humbasin nga përmbytja e lijenit, do t'u ndërtojë shtëpi të reja dhe të mira dhe do t'u paguajë në të holla vleftën e mallit tjetër që do të përmbytet si pemë, mullinj e të tjera.

Më datën 7 të këtij muaji Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë dhe qeveria morën vendimin për ndërtimin e hidrocentralit mbi lumin e Matit. E

gjithë maqineria dhe ndihma teknike e domosdoshme për ndërtimin e këtij hidrocentrali do të merret nga Bashkimi Sovjetik. Neve na bie detyra që të vëmë tërë forcat tona për ta ndërtuar hidrocentralin dhe ne jemi të sigurtë se do t'ja dalim në krye punës. Ne jemi të sigurtë, sepse mbështetemi në tri gjëra kryesore: në patriotizmin e shkëlqyer të popullit tonë, në udhëheqjen e Partisë së Punës si dhe në ndihmën e pakursyer të Bashkimit Sovjetik dhe të shokut Stalin. Bashkimi i këtyre tre faktorëve është garancia e plotë e ndërtimit jo vetëm të këtij hidrocentrali, por edhe e të gjitha fitoreve tona si për të kaluarën ashtu edhe për të ardhshmen. As regjimi i Ahmet Zogut dhe as ndonjë regjim tjetër borgjez nuk do të mund të ndërtonte për popullin një hidrocentral të tillë. Këto vepra mund t'i bëjë vetëm Partia e Punës, pushteti popullor, populli i lirë. Ndërtimi i këtij hidrocentrali ka rëndësi shumë të madhe për të gjithë Republikën tonë e në radhë të parë për krahinat e Veriut. Krahinat e Veriut, më tepër se çdo krahinë tjetër e Shqipërisë, duhet ta bëjnë çështjen e ndërtimit të këtij hidrocentrali çështje të tyre. Ndërtimi i këtij hidrocentrali do të thotë dritë, fuqi, përmirësim i jetesës, qytetërim. Hidrocentrali do të jetë një shkollë e madhe për të gjithë vendin tonë, atje do të preqatiten kuadro të rëndësishëm, atje bariu i sotëm do të bëhet teknik dhe punëtori, inxhinier. Atje do të lindin heronj të rinj të punës së ndërtimit të bazave të socializmit. Atje do të forcohet Partia me anëtarë të rinj, që do të vijnë nga të gjitha anët e Shqipërisë dhe sidomos nga malësitë e krahinave të Veriut. Në ndërtimin e Hidrocentralit elektrik të Selitës punuan me mijëra e

me mijëra punëtorë; me qindra prej tyre janë bërë specialistë të mbaruar, të cilët tani do të marrin përsipër të ngrenë hidrocentralin mbi lumin e Matit. Veçanërisht nga gjiri i këtyre krahinave kanë dalë njerëz të dalluar dhe me vlerë të madhe. Kush e njinte më parë Sali Vatën nga një fshat i humbur i Kukësit, fshatar i varfër, i mbuluar në mjerime dhe në hidhërimë? Asnjieri. Por tani Sali Vatën e njeh dhe e do gjithë Shqipëria. Populli punonjës atë e thërret «luani i tuneleve» që çau malin e Dajtit, për atë flasin të gjitha gazetat e Shqipërisë. Ai është një njeri i lumtur dhe i nderuar. Si Sali Vata nga Kukësi ka me dhjetëra në Shqipëri dhe me qindra do të dalin nesër. Nga kjo masë e madhe, që është mbledhur sot këtu për të inauguruar këtë vepër të madhe, do të dalin heronj të punës, njerëz të zot që do të bëjnë të lulëzojë Shqipëria. Partia do t'u hapë sytë, do t'i mësojë, do t'i bëjë njerëz të lumtur. Kur kam pasë vizituar njëherë punimet e Hidrocentralit elektrik «Lenin», në Selitë, nga masa e punëtorëve doli një grup minatorësh nga Mati dhe më porositi t'i thoshja Partisë kështu:

«Ne duam të vendoset sa më parë ndërtimi i hidrocentralit elektrik mbi lumin e Matit. Ne kemi vuajtur shumë, ne kemi qenë pa bukë nën regjimin e gjakpirësit Ahmet Zog dhe të fashizmit që na mbanin në errësirë e na vrissnin. Tani ne jemi të lirë, të lumtur dhe këto ja detyrojmë Partisë sonë dhe Stalinit. I thuaj, pra, Partisë se ne jemi gati, se atje në ato vende, ku më parë mbretëronte uria dhe terrori i Ahmet Zogut dhe i bajraktarëve, sot populli i lirë do të ndërtojë hidrocentralin elektrik më të madh të vendit, që t'i japë dritë

Shqipërisë dhe kjo është drita e Partisë, drita e Leninit dhe e Stalinit». Dëshirat e popullit po i realizon Partia.

Unë ju bëj thirrje të zjarrtë, juve malësorëve trima të krahinave të Veriut, në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe të qeverisë që, si kurdoherë të tregoheni patriotë të flaktë dhe ta mbështetni këtë ndërmarrje të madhe të pushtetit popullor, të hidheni në sulm dhe në gara krahinë me krahinë dhe fshat me fshat për të shkuar në punë për ndërtimin e hidrocentralit të madh mbi lumin e Matit. Ky hidrocentral ndërtohet për ju në radhë të parë. Ndërtimi i tij duhet të bëhet për ju çështje patriotike, çështje nderi dhe lavdie. Partia dhe qeveria kanë besim të plotë se ju do ta kryeni këtë detyrë me nder, siç i keni kryer të gjitha detyrat patriotike deri më sot. Pra, për popullin, për Partinë, për Stalinin, në sulm përpara për ndërtimin e hidrocentralit të Matit.

Armiqtë tanë të brendshëm dhe të jashtëm, po mundohen me çdo mënyrë që ta pengojnë popullin tonë në punën e tij krijuese. Ata tmerrohen dhe bëhen si të çmendur, kur dëgjojnë se pushteti popullor në Shqipëri çon dritë atje ku ka qenë shkretëtirë, ngrë hidrocentrale në grykat e egra të lumit të Matit, ndërton rrugë atje ku mezi shkelte këmba e njeriut. Dhe ata aq më tepër do të përpiken që të na pengojnë në punën tonë. Por ata e kanë të kotë. Lehjet e këtyre qenërve, klithmat e këtyre çakejve, nuk e trembin popullin tonë. Reaksionarët e brendshëm më kot e kanë që shpresojnë në përblysjen e pushtetit popullor. Pushteti ynë popullor është më i fortë se kurrë. Republika jonë Popullore qëndron si kështjellë e pamposhtur, sepse ajo ka aleatë të fortë. Ne jemi të fortë, sepse jemi pjesë e pandarë e

kampit të socializmit dhe të paqes, që udhëhiqet nga Bashkimi i lavdishëm Sovjetik dhe i madhi Stalin. Ne jemi të fortë, sepse populli ynë është patriot, punëtor, paqedashës dhe interesat e tij ai di si t'i mbrojë nga çfarëdo armik është po qe nevoja edhe me pushkë. Le të dërgojë tradhëtari Tito diversantë dhe spiunë në Shqipëri. Le të hedhin luftënxitësit imperialistë amerikanë dhe anglezë, parashutistë. Le të provokojnë monarko-fashistët grekë dhe neofashistët italianë kundër vendit tonë. Populli ynë nuk frikësohet nga këto akte banditizmi, por i patrembur dhe i sigurtë ecën përpara. Të lehurat e qenërve, rrëth e përqark, nuk mund ta ndalojnë karvanin tonë që të ecë përpåra. Spiunët dhe diversantët i pret pushka e popullit, i pret pushka e Hasan Ramës nga Kacnija, që s'e la as t'i zinte këmba tokë parashutistit të Trumanit dhe e shumë të tjerëve që nuk kur-syen as jetën për të mbrojtur pushtetin popullor nga diversantët. Spiunët dhe diversantët duhen gjurmuar ku-do që të jenë dhe t'u jepet ajo që meritojnë: plumbi ballit. Reaksionarët e brendshëm, që janë struktur si miu në vrimë, të mos shpresojnë se do të ngjallet i vdekuri dhe një lëvizje e bishtit të tyre do të jetë e mjaftë për t'u prerë atyre kokën. Populli ynë ka mjaft eksperiencë për të mos lejuar që të përsëritet e kaluara. Ne e duam paqen dhe njëkohësisht dimë edhe si ta mbrojmë atë. Rruga jonë është rruga e paqes, është rruga e luftës për mbrojtjen e paqes:

Shokë fshatarë,

Punoni pa u kursyer për të prodhuar sa më shumë; rregulloni punët tua ja familjare, në mënyrë që t'ju tep-

rojnë krahë pune dhe të mund të shkoni për të ndërtuar hidrocentralin e madh mbi lumin e Matit; ruajeni push-tetin tuaj si gjënë më të shtrenjtë, duke mos lënë asnje këmbë armiku në vendin tonë; realizoni planin e shtetit, sepse kështu do të përparojë vendi ynë dhe do të dësh-tojnë planet e armiqve!

Shokë punëtorë dhe teknikë, punoni pa u kursyer për të organizuar më mirë punën dhe për të realizuar me sukses planin e ndërtimit të hidrocentralit mbi lumin e Matit!

Shokë komunistë dhe komuniste, qëndroni si kurdoherë në ballë të luftës për realizimin e planit të shtetit, tregohuni të gatshëm si kurdoherë për të përmbushur këto detyra të rëndësishme që ju vë përparrë Partia! Te ju, fshatari dhe punëtori, që s'janë në Parti, duhet të shohin shembullin e shkëlqyer të vetëmohimit dhe të heroizmit në luftën për ndërtimin e bazave të socializmit dhe për mbrojtjen e atdheut.

Rroftë përvjetori i gjashtë i Republikës Popullore të Shqipërisë!

Rroftë populli ynë trim e paqedashës!

Rroftë Partia jonë e lavdishme!

Rroftë populli trim e besnik i krahinës së Matit!

Rroftë Bashkimi i lavdishëm Sovjetik dhe Stalini i madh!

Rrofshin ndërtuesit e hidrocentralit të Matit!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i Popullit»,
Nr. 10 (1018), 12 janar 1952*

*Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 10 (1018),
12 janar 1952*

TE FORCOJMË VAZHDIMISHT PARTINË NË PROCESIN E LUFTËS PËR NDËRTIMIN E SOCIALIZMIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

15 janar 1952

Unë jam dakord me vërejtjet që bënë shokët në lidhje me forcimin e mëtejshëm të Partisë sonë pas Kongresit I të saj. Në këtë drejtim ka përparime si nga ana e organizatave të Partisë, ashtu dhe nga forumet udhëheqëse të saj. Partia jonë i ka kryer detyrat kryesore që i ngarkoi kongresi: Megjithatë në punën tonë ka akoma mjaft gabime dhe të meta, të cilat mendoj se konsistonjë më shumë në mungesën e një drejtimi më të mirë nga ana jonë se sa në mungesën e shpirtit luf-

¹ Në prak të Kongresit II të Partisë, Byroja Politike e KQ të PPSH, i bëri një analizë të thellë punës së Partisë qysh nga Kongresi I i saj. Gjatë dy ditëve u diskutua rreth raporteve të paraqitura mbi punën organizative, propagandistike të Partisë dhe punën për realizimin e planit ekonomik të shtetit. Lidhur me këto çështje, shoku Enver foli tri herë, duke dhënë orientime të rëndësishme.

tarak të Partisë dhe të popullit tonë. Me këtë dua të them se sikur drejtimi ynë të ishte forcuar edhe më tepër, do të kishim rezultate akoma më të mëdha. Prandaj duhet të bëjmë një luftë të madhe që të mësojmë të udhëheqim më mirë dhe t'i japim shembullin gjithë Partisë, sepse dobësitë më të mëdha i kemi pikërisht në punën drejtuese.

Me këtë analizë që i bëjmë punës organizative të Partisë, natyrisht duhet të kuptojmë se ne shohim të gjithë punën tonë, për arësy se këtu diskutojmë jo vetëm si ka punuar Partia për forcimin e saj në vetëvete, por për ta bërë atë më në gjendje që të drejtojë çësh-tjet ekonomike. Kjo është në vijën e drejtë të Partisë, pse Lenini dhe Stalini na mësojnë që partinë ta forcojmë vazhdimit duke luftuar për të arritur një objektiv të caktuar, për ndërtimin e socializmit, për përmirësimin e jetës së masave punonjëse. Forcimi organizativ i Partisë dhe mobilizimi i saj për zbatimin e detyrave që analizojmë, janë dy çështje të pazgjidhshme nga njëra-tjetra. Në rast se Partia forcohet në luftë duke zbatuar detyrat që shtrohen para saj, rezultatet do të janë të mëdha. Prandaj forcimi organizativ i Partisë të mos ndahet nga puna e saj për të përmirësuar drejtimin e ekonomisë.

Pse e them këtë? Sepse siç vunë në dukje edhe gjithë shokët kur diskutuan, në punët tona kemi mjaft të meta e mungesa, që vihen re në zbatimin e centralizmit demokratik, në disiplinën e Partisë, në zhvillimin e kritikës e të autokritikës. Në Parti ka shfaqje të sektarizmit dhe të oportunizmit. Të gjitha këto të meta manifestohen në jetën dhe në luftën e përditshme të Partisë dhe ato nuk mund t'i marrim të shkëputua nga njëra-tjetra.

Në qoftë se njëri është oportunist ose sektar, këtë gjë patjetër ai do ta shfaqë edhe në luftën e në punën e tij. Duke qenë anëtar partie, ai bën jetën e Partisë në një organizatë bazë, ku i ngarkohen dhe detyra. Po në qoftë se ai e ka fë shpirt oportunizmin ose mungesën e disiplinës, kjo do të konstatohet patjetër gjatë punës për zbatimin e detyrave. Mundet që në organizatën bazë të Partisë për një kohë të gjatë të mos duket kjo dobësi, por po të ngarkohet me punë, kjo do të dalë patjetër në shesh gjatë realizimit të vijës së Partisë.

Në luftë kundër të metave dhe gabimeve, ne duhet të përdorim akoma më mirë kritikën dhe autokritikën. Kjo armë e shëndoshë në duart e Partisë nuk duhet të mbetet vetëm në organizatën bazë, atje sigurisht është themeli i Partisë dhe, po të mos luftohet me këtë armë, nuk mund ta forcojmë atë, por kjo armë duhet të vihet në praktikë edhe në punët shtetërore duke filluar që nga qeveria dhe deri në bazë. Pra, edhe nga ana e push-tetit duhet që vendimet dhe direktivat e Partisë të zbatohen me rigorozitetin më të madh. Si të merret vendim për një çështje, është e domosdoshme që kjo të bëhet objekt i diskutimeve të ashpra kundër të metave që pengojnë zbatimin e tij.

Përsa i përket çështjes së aparatit të Komitetit Qendror, më duket se në punën e tij ka akoma formalizëm. Më përpara nuk e kemi pasur dhe aq të qartë çështjen e rregullave, tanj ato i kemi vendosur. Por nuk mjafton me kaq. Format e punës organizative nuk duhet të qëndrojnë në vend dhe të kontrollohen në mënyrë burokratike e të shkëputura ngajeta, nga lufta e Partisë dhe e çdo sektori veçanërisht. Pse e them këtë gjë? E

them sepse ne kemi shumë shembuj, sidomos nga ekipet që kanë vajtur në rrethe. Jo se puna e këtyre ekipeve nuk ka qenë e frutshme, por nuk është ndjekur sa duhet procesi i ndryshimit të gjendjes së mëparshme të asaj organizate ku është bërë kontrolli. Në Shkodër për shembull kanë vajtur plot ekipe e megjithatë edhe tani na raportojnë se atje vazhdojnë të ekzistojnë akoma pothuaj të njëjtat të meta dhe gabime. Me një fjalë nuk janë bërë sa duhet ndryshime. Mos vallë organizata e Partisë në Shkodër është përtokë? Jo. Atje ka komunistë që kanë luftuar, që kanë një të kaluar të mirë. Po pse ndodh kjo gjendje atëhere? Kjo ndodh se kur shkohet në bazë, organizatave të Partisë u shtrohen një sërë çështjesh, duke u futur në hollësi, në vend që t'u shtohen atyre dy ose tri nga problemet më të rëndësishme të rrethit.

Le të marrim një shembull tjeter: lidhur me format e arësimit politik që kemi vendosur, Bedriu nuk na ka thënë ndonjëherë nëse janë apo jo të aplikueshme njësoj si në fshatrat e malësive të Dukagjinit ose të Mirditës, që i kanë shtëpitë shumë larg njëra-tjetrës, ashtu dhe në një uzinë ose fabrikë, ku të gjithë komunistët janë të grumbulluar në një vend. Në kushtet e fshatrave të disa zonave ose rretheve, më duket se është shumë e zorshme të kontrollohet se si zhvillohet puna në format e edukimit. Format, pra, duhet t'i studojmë dhe t'ua adaptojmë konditave tona, situatës konkrete, ndryshe biem në shablonizëm që nuk është marksiste-leniniste dhe me një mënyrë pune të tillë natyrisht nuk mund të arrijmë rezultatet e dëshiruara. Prandaj, ne duhet të gjejmë e të aplikojmë në fillim ato forma edukimi që i

përshtaten kohës dhe vendit tonë. Më vonë, me kohë, do të arrijmë progresivisht në forma më të përsosura. Kështu edhe për çështjet e tjera.

Ne kemi disa metoda apo mënyra pune që janë të drejta, që i kemi vendosur dhe i praktikojmë me qëllim që udhëheqja të jetë në korrent të problemeve kryesore të Partisë. Por mua më duket se sekretarët e Komitetit Qendror duhet të bëjnë më shumë përpjekje për t'u themi në problemet e rëndësishme që Byroja Politike vazhdimisht shtron në praninë e tyre. Në rast se neglizohen si këto metoda pune, ashtu edhe ato të kontrollit, detyrat që cakton Komiteti Qendror e Byroja Politike, nuk do të zbatohen plotësisht dhe ne nuk do të kemi këtu asnjë pasqyrë reale të gjendjes së problemeve dhe të luftës që bën Partia për zgjidhjen e tyre. Këto ndodhin se ju nuk i zotëroni si duhet problemet dhe, natyrisht, kjo bën që shpeshherë drejtorët e drejtorive të aparatit të KQ, nëndrejtorët dhe inspektorët të mos janë në gjendje të ndihmojnë si duhet bazën. Ata, duke pasur disa receta të thjeshta në mendje, venë në bazë e hiqen si njerëz me kompetenca të mëdha, por në fakt ndihma e tyre për komitetet e Partisë nuk është në lartësinë që kërkohet. Ne e dimë se punonjësit e aparatit të KQ nuk janë në nivelin e sekretarit të parë të rrëthit, por në qoftë se ata do ta dinë mirë problemin, pavarësisht se nuk janë në nivelin e sekretarëve, atëhere do të janë më kompetentë për punën e tyre. Kështu, në rast se një instruktor është për financën ose për tregëtinë, problemet e këtyre sektorëve ai duhet t'i njohë mirë dhe këtë zanat ta lidhë me problemet e Partisë që ta bëjë këtë

të mobilizohet mbi këto vendime që ka marrë Komiteti Qendror.

Njohja e problemieve ekonomike nga ana e shokëve të aparatit është një formë e ngritjes së kuadrit, e aftësimit të tij. Po për kuadrin e Partisë nuk mjafton vetëm kjo. Më e rëndësishmja është studimi i teorisë marksiste-leniniste, pa të cilën nuk mund të kuptohen drejt dhe problemet ekonomike. Te ne, drejtoret, nën-drejtoret dhe inspektorët pothuajse nuk kanë shkolla të larta dhe ne nuk do të jemi në gjendje t'i kemi të tillë edhe për një kohë të gjatë, po duhet të ecim në këtë rrugë, natyrisht në bazë të mundësive tonë. Punonjësit e aparateve të Partisë duhet të ngrihen më lart nga ana e teorisë marksiste-leniniste, po njëkohësisht duhet të bëjnë përpjekje të ngrihen edhe nga ana profesionale, të kualifikohen vazhdimi. Kështu, shokët e aparatit të KQ kur shkojnë në bazë, do të janë më tepër në gjendje të kontrollojnë e të ndihmojnë organizatën e Partisë, të mësojnë prej saj e ta mësojnë atë. Por kjo gjë kërkon që ata vetë të janë në çdo drejtim më përpara nga ai që kontrollojnë, ndryshe do të venë të shesin mend kot. Kjo duhet të jetë një detyrë me rëndësi për njerëzit që punojnë në aparatet e Partisë. Prandaj, ngritjen e niveli ideo-teorik e profesional organet e Partisë duhet ta shohin dhe ta zgjidhin drejt, duke mbajtur parasysh se Partia nuk merret vetëm me çështje specifike të saja, por ajo drejton të gjithë sektorët dhe në rast se nuk e bën këtë, punët do të çalojnë e nuk do të ecin si duhet përpara. Që punët të drejtohen mirë, duhet të zbatohen jo vetëm këto masa, po nga ana tjetër të kemi kujdes që të mos marrim forma nga të tjerët në mënyrë

automatike pa i lidhur ato me luftën që bën Partia, me detyrat e saja konkrete.

Cështja e aktivizimit të levave të Partisë ka një rëndësi të madhe. Përse nuk përdoren si duhet këto leva? A e ndjen nevojën e tyre Partia? Mua më duket se nuk është kuptuar si duhet rëndësia e tyre dhe në radhë të parë çështja e pushtetit. Është thënë e përsëritur shumë herë se në rrethe, ka raste që pushtetit nuk i lihen kompetencat që i takojnë. Pse ja merr Partia këto kompetenca? Përse ajo ngatérrohet disa herë në punët e pushtetit? Ka edhe konfondim të detyrave. Po kështu, me gjithë përparrimet që janë bërë, edhe në Komitetin Qendror, përveç shokëve që janë ngarkuar të merren direkt me punën e pushtetit, nga të tjerët nuk bëhen sa duhet përpjekje dhe nuk tregohet interesim për këtë problem me rëndësi. Me këtë dua të them që detyrat specifike të Partisë të mos merren e zbatohen në mënyrë formale. Shokët merren shumë pak me problemet ekonomike rrëth të cilave duhet të shihet se si punon e mobilizohet Partia, si reagon ajo në zbatimin e detyrave ekonomike. Shokët e Partisë nuk i mësojnë si duhet këto gjëra në organizatën bazë. Aty komunistët duhet të mësojnë parimet e ndërtimit të Partisë, centralizmin demokratik, si të bëjnë kritikën e autokritikën etj., por do të mësojnë edhe orientimet e Partisë e direktivat e saja për sektorët e tjera, për problemet dhe detyrat e tyre e, në këtë drejtim, edhe për rolin që luan pushteti, kompetencat e tija dhe çështjet që duhet të zgjidhë ai. Këto gjëra janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Ne duhet të vëmë re me kujdes se në ato komitete partie

ku koordinohen mirë këto çështje, kenii rezultate konkrete. Në dy rrethet, Tiranë e Peshkopi, udhëheqja ka arritur deri në një farë shkalle t'i lidhë mirë këto probleme, prandaj nga metoda e tyre e drejtimit mund të mësojnë edhe të tjerët. Po kështu edhe dy komitetet e Partisë në Ministrinë e Mbrojtjes Popullore e në Ministri-në e Punëve të Brendshme kanë përmirësuar më tej metodën e punës duke forcuar edhe disiplinën për zbatimin e detyrate. Neve na bie barra që të përmirësojmë punën e Partisë dhe të pushtetit dhe, duke qenë në udhëheqje, të zbatojmë deri në fund vijën e Partisë në detyrat që na ka ngarkuar ajo. Nga të gjitha këto del e nevojshme që t'ua mësojmë mirë shokëve të rretheve si rolin udhëheqës të Partisë, ashtu dhe kompetencat e pushtetit e të organizatave të masave. Partia i udhëheq levat e saja dhe në rast se nuk do të dijë t'i përdorë drejt ato, nuk do t'i organizojë e drejtojë mirë, puna e tyre nuk do të shkojë si duhet përpara dhe ne do të dëmtohemi.

Të marrim organizatën e bashkimeve profesionale. Si shpjegohet fakti që në këtë raport me rëndësi, flitet kaq pak për këtë organizatë, që është leva kryesore e Partisë? Në raport flitet fare në vija të përgjithshme, nuk bëhet fjalë si është gjendja organizative e bashkimeve profesionale, si është ndihmuar ajo nga Partia, cilat janë të metat, ç'duhet bërë etj.

Ose të marrim organizatën e bashkimit të rinisë. Puna me rininë është me rëndësi shumë të madhe. Është e domosdoshme që të thellohem më shumë në çështjet e kësaj organizate. Sektarizmi, për shembull, nuk është në natyrën e rinisë, pse ajo s'ka prirje të jetë e tillë.

Mua më duket se sektarizmi në rini vjen nga vetë format e organizimit të punës që janë vendosur në këtë organizatë, jo vetëm nga emri që kanë organizatat e rinisë si «organizata bazë», por edhe nga metodat e punës që përdoren shpeshherë. Ju, të Drejtorisë së organizimit posaçërisht kur i shtroni problemet duhet të thelloheni më tepër në këto forma, nëse ato i përshtaten ose jo rinisë dhe t'i thoni Byrosë Politike shkaqet e vërteta të sektarizmit dhe ç'duhet bërë kundër tij. Mos vallë ka shablonizëm në format organizative që zbatohen me rininë? Më duket se edhe me unifikimin e të dy organizatave të rinisë në një të vetme, përsëri ka sektarizëm. Mund të themi se radhët e Bashkimit të Rinisë së Punës janë zgjeruar pak më shumë se ç'ka qenë më parë efektivi i rinisë komuniste. Pra nuk janë mbajtur si duhet parasysh orientimet e Partisë për shtimin e radhëve të rinisë. Ndryshe si shpjegohet që mblidhen organizatat e rinisë në fshat, por pjesën më të madhe të të rinxje e lënë mënjanë, kurse duhet që të gjithë të rinxjtë e fshatit të mblidhen, të edukohen, të mobilizohen për detyrat që shtron Partia dhe të zgjerohen kështu radhët e bashkimit të rinisë. Prandaj Drejtoria e organizimit duhet të nxjerrë konkluzione nga një gjendje e tillë dhe të forcohet më shumë puna me rininë. Partia lufton vazhdimisht, por ne duhet të mbajmë kurdoherë ngritur disa probleme kryesore. Nuk duhet të harrojmë për asnjë çast se Partia s'ka si t'i bëjë të gjitha punët vetëm me anëtarët e saj. Në rast se nuk aktivizohen organizatat e masave, nuk mund të zgjidhen si duhet të gjitha problemet. Kjo është një nga arësyet e të gjitha dobësive që vihen re në realizimin e detyrave. Prandaj

aktivizimi i organizatave të masave ka rëndësi të madhe për Partinë.

Lufta e përditshme i forcon komunistët, i bën ata që të përvetësojnë parimet e Partisë, të zbatojnë në praktikë detyrat e saja, pa bërë lëshime, pa qenë liberalë. Pra, Partia u mëson njerëzve parimin, por ajo është kudo, i ka sytë hapët dhe në qoftë se një komunist në praktikë nuk e bën detyrën, atëhere ai kritikohet dhe ndihmohet për të luftuar gabimet e të metat dhe për të punuar më mirë. Por kritika dhe autokritika nuk duhet të mbetet një armë vetëm në dorën e komunistëve, por të përvetësohet e të përdoret edhe nga njerëzit pa parti, që të bëhen edhe ata bolshevikë. Prandaj nga ana e drejtorive të aparatit të KQ duhet të shihet më me kujdes çështja e levave të Partisë, po kështu edhe nga ana jonë, pse edhe ne kemi të meta si në çështjen e drejtimit të Partisë, ashtu edhe në atë të aparatit shtetëror dhe të organizatave të masave.

Përsa u përket lidhjeve me bazën, jam dakord me vërejtjet e shokëve. Po të mos i kemi të forta organizatat bazë të Partisë, nuk do të mundim t'i arrijmë objektivat tonë, sidomos në fshat ku organizatat janë më të dobëta. Prandaj t'i kushtohet një rëndësi më e madhe punës në fshat, formave të organizimit, të edukimit dhe lidhjet që kemi vendosur t'i vëmë në rrugë të drejtë, ashtu siç janë në rrugë të drejtë për shembull në Tiranë, ku shokët drejtues të Partisë kanë një eksperiencë të mirë në çështjet organizative të Partisë, pse sidomos Fiqreti, si sekretare e parë e komitetit, interesohet drejt-përdrejt edhe për forcimin e Partisë nga pikëpamja organizative. Ndërsa disa rrethe të tjera nuk kujdesen sa

duhet si për forcimin gjithnjë e më shumë të organizatave të Partisë ashtu dhe për edukimin e komunistëve. Format e punës organizative dhe edukative më duket se janë në rregull, po nuk duhet të kënaqemi me këtë, këto forma të përpinqemi t'i konkretizojmë e t'i zbatojmë si duhet në jetë, të insistojmë jo vetëm nga ana sasiore, po edhe nga ana cilësore. Prandaj një rëndësi e posaçme duhet t'u kushtohet seminareve që zhvillohen, rendeve të ditës që caktohen, problemeve që shtrohen për t'u zgjidhur etj. Në fshatës shtëpiajuese që shtrihen përmes këtyre fshatrave, përfundimisht përfundimisht duhet të peshojnë mirë çdo gjë që bëjnë. Por ka edhe raste që ata jo vetëm nuk i peshojnë si duhet këto gjëra po bien vetë në gabime të mëdha, bëjnë hatëre, padrejtësi, siç ndodh me shpërndarjen e kartërave të Frontit, në lidhje me luftën kundër kulakëve etj. Gabime të tillë i kush-tojnë Partisë dhe shkaktojnë që edhe njerëz të pafaj-shëm të pëshpëritin dhe të bëhen të pakënaqur.

Shpeshherë na thonë se nga lart ujët vjen i kulluar, po poshtë turbullohet. Kjo nuk është e mirë dhe tregon se njerëzit nuk kanë besim të shokët e bazës; nuk janë pesë vetë këtu lart që e bëjnë Partinë. Kjo ndodh jo se shokët tanë poshtë nuk janë të mirë, po ngaqë ata kanë nivel të ulët dhë bëjnë gabime. Prandaj në fshat duhet të kemi shumë kujdes, të mbajmë parasysh që fshatari ynë e do Partinë, por këto gabime të disa komunistëve të veçantë i pezmatojnë njerëzit e popullit, kur atyre nuk u zgjidhen drejt problemet që kanë. Një fjalë

e mirë e anëtarëve të Partisë e kënaq popullin, ndryshe ai bëhet i pakënaqur. Pra, lidhjet me bazën dhe zbatimi dialektik i të gjitha formave e metodave të punës, janë çështje që duhet të na preokupojnë më shumë për të forcuar akoma më tepër Partinë dhe lidhjet e saja me masat.

Edhe në lidhje me punën kolegjiale në Parti ka përparime, po akoma kemi shumë të meta. Nga informata që na jepen dhe nga konstatimet tona del, për shembull, se në Korçë nuk kërkohet sa duhet llogari për zbatimin e detyrave që i janë ngarkuar secilit. Prandaj dobësi të tilla duhet të korrigohen. Format organizative në Parti nuk shkojnë mirë dhe nuk ka si të jetë ndryshe kur mobilizimi i Partisë në këtë drejtim, demokracia e Partisë, kritika e autokritika etj., nuk janë në lartësinë e duhur. Në disa raste janë shfaqur tendenca komandimi, gjë që është e rrezikshme, pse nga kjo lind megalomania, arbitrariteti e sëmundje të tjera në shokët drejtues të Partisë. Është vënë re tendenca e komandimit sidomos në disa shokë drejtues të komiteteve të Partisë në rrethe, është vënë re mungesa e kritikës për ta nga poshtë dhe e autokritikës nga ana e tyre. Çështja e mungesës së dhënjes llogari duhet të kihet parasysh vazhdimisht, pse njerëzit i shmangen kësaj detyre që është një nga konditat e domosdoshme për forcimin e Partisë. Shokët drejtues në rrethe duhet të shkojnë në mbledhjet e organizatave me kritikë dhe autokritikë. Një e metë tjetër është se edhe në mbledhjet e plenumeve të komiteteve të Partisë shokët e forumit nuk shkojnë dhe aq të preqatitur për të bërë kritikë e për të dhënë llogari. Ne nuk duhet të lejojmë në asnje

mbledhje plenumi që të mungojë fryma e kritikës dhe e autokritikës, prandaj ta çmojmë drejt këtë armë dhe ta përdorim për të forcuar punën e forumeve tonë, demokracinë e Partisë, kolegjalitetin në udhëheqje.

Për Drejtorinë e organizimit kisha vërejtjen që organizimi i punës në këtë drejtori duhet të ishte më i mirë. Shokët kryesorë të kësaj drejtorie duhet të mësojnë të drejtojnë më mirë. Nga pyetjet që u bëmë shokëve të kësaj drejtorie pamë se disa sektorë kryesorë nuk janë ndihmuar sa duhet ose janë ndihmuar fare pak dhe në mënyrë të cekët. Kjo ka ndodhur se vetë shokët drejtues të kësaj drejtorie nuk u janë futur thellë problemeve. Sikur ta pyesim shokun Mihallaq Gjinikasin që të na shpjegojë më me hollësi për çështjen e bashkimeve profesionale nëse organizimi që kemi vendosur i është përgjegjur kësaj ose asaj detyre, nuk do të jetë në gjendje të na përgjigjet, pse ky është një problem shumë i gjerë dhe duhet ndjekur vazhdimisht, gjë që ai nuk e ka bërë si duhet. Kështu mund të na ndodhë edhe me shokë të tjerë. Megjithatë kam përshtypjen që si shoku Pirro Bita, që është drejtor, ashtu dhe Mihallaqi, si zëvendës i tij, janë munduar të punojnë dhe kanë punuar mirë, porse në disa çështje të rëndësishme të Partisë, me gjithë punën që kanë bërë, puna e tyre duhet të ishte e një cilësie më të lartë.

Përsa u përket instruktorëve të Komitetit Qendror, ata duhet të lidhen të paktën me drejtorin dhe jo me një nga nëndrejtorët ose me ndonjë shef seksioni, sepse çështja e jetës së Partisë kë rëndësi jashtëzakonisht të madhe. Edhe seksioni i informacionit nuk duhet lidhur me një nga nëndrejtorët, po direkt me drejtorin, i cili

duhet të dijë të gjithë situatën e Partisë, sukseset dhe të metat e saja. Drejtori duhet të dijë mirë edhe çështjet e çdo seksioni.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQF*

**TË PËRMIRËSOJMË MË TEJ DREJTIMIT
E PROPAGANDËS DHE TË AGJITACIONIT
TË PARTISË**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH*

15 janar 1952

Vërejtjet e shokëve janë plotësisht të drejta dhe unë jam dakord me to. Këto vërejtje duhet t'u bëhen mësime të rëndësishme jo vetëm shokëve që drejtojnë sektorin e agjit-propit, por edhe neve të gjithëve, pse çështja e propagandës dhe e agjitionit është me shumë rëndësi për Partinë tonë, ashtu siç e theksuan mjaft mirë edhe shokët e tjerë.

Partia jonë është e re dhe relativisht e ulët nga pikëpamja ideologjike e kulturale. Kjo e rrit edhe më tepër rëndësinë që ka sektori i agjit-propit. Ne duhet të nisemi nga parimi që veçanërisht shokët, të cilët udhëheqin këtë sektor; duhet të jenë nga më kryesorët që ta zotërojnë mirë ideologjinë dhe kulturën marksiste-leniniste. Këtë gjë ata duhet ta bëjnë medoemos, pse Partia u beson drejtimin e një sektori jashtëzakonisht të rëndësishëm.

Është shumë e zorshme që të gjithë ne të bëhem

profesorë të marksizëm-leninizmit, por studimi i vazhdueshëm dhe në mënyrë individuale nga ana jonë i marksizëm-leninizmit lidhur me problemet që na dalin gjithmonë përpala, të hap perspektiva, të sqaron shumë çështje e detyra dhe të bën që ato të të mbeten në kokë. Domethënë mbi atë çka ke lexuar, problemin e ke pak a shumë të qartë. Këtë duhet ta bëjë në radhë të parë Bedriu, si sekretar i Komitetit Qendror që drejton sektorin e agjit-propit dhe me shembullin e tij të mësojë edhe të tjerët që merren direkt me sektorin e propagandës dhe të agjizacionit të Partisë. Mësimi dhe përvetësimi i marksizëm-leninizmit nga ana e kuadrove të agjit-propit është armë kryesore për të drejtuar me sukses sektorin e agjizacionit e të propagandës dhe të kryejnë kështu si duhet punën që u ka ngarkuar Partia në këtë fushë. Bedriu duhet të përpiqet ashtu sikurse bën Koleka, që vret mendjen dhe mëson vazhdimisht mbi teknikën. Kështu, pra, duhen bërë shumë përpjekje për ngritjen e nivelit ideologjik, pse ne duhet të luftojmë për ta rritur e për ta kalitur kurdoherë ideologjikisht Partinë, gjë që sigurisht nuk mund të arrihet, kur udhëheqja s'bën përpjekje në këtë drejtim.

Përveç kësaj, është edhe çështja e kulturës së gjithanshme me të cilën duhet të pajisen njerëzit që drejtojnë sektorin e agjit-propit. Kultura jonë është e paktë. Ka disa nga ne me një kulturë më të gjerë, disa të tjerë me një kulturë më të kufizuar, kurse ka disa me një nivel akoma më të ulët kultural. Përsa i përket Bedriut, ai ka një farë kulture, por ajo nuk është e mjaftueshme. Këtë mund ta themi edhe për

Nexhmijen, si drejtoreshë e Drejtorisë së agjit-propit. Nga ana tjetër, të mos harrojmë se ka nga ne që, duke mësuar në shkollën e vjetër, kanë nevojë që të luftojnë kundër asaj që s'përputhet me frymën revolucionare të shkollës së re. E shoh këtë edhe në veten time. Unë kam një farë kulture, pastaj kam lexuar dhe lexoj mjaft. Duke lexua çdo ditë unë e revizionoj kulturën që kam si në lëmin e sociologjisë, ashtu edhe në literaturë, histori etj. Disa çështje unë i di ashtu siç i kam mësuar, por natyrisht, marksizëm-leninizmi më bën që t'i shoh më qartë ato që kam në kokë. Prandaj përpinqem të gjej në të katër anët literaturë marksiste. Kur bie rasti të shoh si vlerësohet vepra e një shkrimitari ose një epokë historike, ose një çështje në politikë, unë mbështetem në veprat dhe librat marksiste-leniniste që botohen. Kështu e revizionoj unë dita-ditës kulturën time. Pse duhet bërë kjo nga të gjithë e sidomos nga shokët që drejtojnë agitacionin e propagandën?

Ne flasim për pikëpamje të gabuara ideologjike, por kur vjen puna të luftojmë me të vërtetë kundër tyre në terrenin praktik dhe të përdorim për këtë qëllim armët marksiste-leniniste derisa të zhdukim lakrat që kanë disa në kokë duke u thënë konkretisht se cilat pikëpamje janë pozitive dhe cilat janë negative e pastaj të tregohet rruga e drejtë në baza të shëndoشا marksiste-leniniste, këtë gjë shokët tanë nuk e bëjnë mirë, pse nuk dinë sa duhet. Prandaj duhet në radhë të parë që kuadrot e ngarkuar, që drejtojnë sektorin e agitacionit e të propagandës, t'i përvishen kryerjes së këtyre detyrave, ndryshe rrahim ujë në havan

për presionin borgjez që i turret Partisë nga ana ideologjike. Në këtë prizëm ne duhet ta shikojmë pak më thellë edhe çështjen e intelektualëve. Ata duhet t'i afrojmë, po për të bërrë këtë gjë, duhet që shokët që merren me intelektualët, jo vetëm të pajisen me kulturë të re, por t'u sqarojnë edhe kulturën e vjetër. Unë nuk jam dakord me pikëpamjen aq kategorike të Bedriut se «inteligjencia e vjetër është rezervuari i ideo-logjisë borgjeze dhe distributori i koncepteve të huaja në të gjitha fushat». Të shprehesh në mënyrë kaq absolute dhe t'i futësh të gjithë intelektualët në një thes, nuk është aspak e drejtë. Në radhët e intelektualëve ka shumë që e kanë treguar me prova se janë patriotë dhe luftojnë për zbatimin e vijës së Partisë dhe nuk është aspak e vërtetë se «shumica e tyre nuk janë të dispozuar që të ndihmojnë në çështjet e kulturës». Ata mund të aktivizohen dhe kjo varet nga puna e Partisë për t'i tërhequr në punë dhe për t'i ndihmuar. Përsa i përket aktivizimit të tyre në çështje të teatrit, kjo ka ndodhur se ky është një sektor më i lchtë dhe atje ne kemi edhe talentin popullor. Pra, duhet një organizim i mirë dhe një kujdes i veçantë për njerëzit e kulturës, pse një punë e tillë mund të na japë frute dhe të mos themi se është e zorshme t'i aktivizojmë intelektualët. Ata duhet t'i aktivizojmë dhe t'i ndihmojmë në punë.

Bedriu, merret jashtëzakonisht me çështje të vogla, praktike, formale. Unë nuk mund të pranoj se ai nuk ka kohë të merret me studime të thelluara, po ka frikë t'u futet problemeve të mëdha, sepse ato janë të komplikuara, kurse çështjet praktike të përditshme mund

të zgjidhen më lehtë. Problemet kryesore sigurisht duan më shumë kohë, por atyre u duhet kushtuar vëmendja e merituar, ndryshe punët e agjit-propit nuk mund të shkojnë mirë. Më duket se Nexhmija kishte të drejtë në kritikën që i bëri Bedriut në Plenumin XII, se ai i druhet përgjegjësisë dhe nuk vendos bile edhe për gjëra që janë fare të vogla dhe brenda kompetencave të tija. Fakti është se Bedriu edhe mua më pyet për gjëra fare të vogla. Po të jetë që të pyesë për ndonjë çështje me rëndësi të madhe politike, kjo është e mirë, po për çështje të tjera të zakonshme ai ka plotësisht të drejtë të vendosë dhe të veprojë vetë dhe të jetë i sigurtë në atë që bën. Edhe sikur të bëjë gabim do ta korrigojmë. Bedriu duhet të ketë parasysh se është anëtar i Byrosë Politike dhe duhet të marrë më shumë përgjegjësi. Këtu nuk e kam çështjen që të mos vihem unë në korrent të problemeve. Unë duhet të jem i informuar, kjo është e domosdoshme të bëhet jo vetëm nga Bedriu, por edhe nga të gjithë shokët e tjerë. Mehmeti është ai që më informon rregullisht, ai është plot iniciativë kur ka çështje për të raportuar, di e zgjedh edhe kohën, edhe çështjet për të bashkëbiseduar. Por Mehmeti kur nuk ka mundësi të më takojë vepron edhe ndryshe, ai merr vetë masa dhe kur më takon, më njofton. Ne marrim shumë vendime në qeveri. Shumë gjëra ndodhin, disa nga ju, shpeshherë nuk më vënë në korrent se ç'po bëhet. Ne kemi vendosur edhe mënyrën e punës si në Byronë Politike, ashtu edhe në qeveri duke bërë mbledhje nga një herë në javë. Po ç'ndodh me vendimet që marrim? Është e vërtetë se secili nga ne ka kompetencat e tija, po kjo

nuk do të thotë që të mos konsultohet e të mos informojë. Po të mos bëhet kjo gjë, natyrisht për ato që duhet, ka rrezik që unë të shkëputem dhe një gjë e tillë nuk është e lejueshme, pse edhe unë kam vendin dhe përgjegjësinë time. Pra duhet që edhe unë të informohem. Bie zjarri në një pus të Kuçovës dhe unë nuk di asgjë. Sa kushton një pus? Disa milion lekë. Nuk duhet të di unë për një gjë kaq me rëndësi?

Po e kemi çështjen te Bedriu. Ai duhet të ketë më tepër iniciativë në punë, të marrë përgjegjësi, të ketë besim në vendimet që merr dhe të mos ketë frikë. Kur i del përpara ndonjë çështje që ka nevojë për ndihmën tonë, le të vijë kur të dojë që t'i jap edhe unë mendimin dhe ndihmën time.

Ju të Drejtorisë së agjit-propit duhet të shkundeni dhe jo vetëm të ndihmoni shoqi-shoqin, po edhe vetë-veten dhe të keni më shumë besim në shokët. Nexhmijes i kam thënë edhe herë të tjera se nuk është e mjaftueshme që ajo të rrijë të kontrollojë vetë materialët e shumta propagandistike që preqatiten. Vërejtjet që bën ajo shumë herë nuk janë të këqia, pse Nexhmija ka një sens të drcjtë, të qartë mbi vijën politike të Partisë, por kjo nuk është e tërë puna. Ajo duhet t'i ndihmojë më tepër zëvendësit e vartësit e saj. Këtë e them se te Nexhmija konstatoj që nuk ka sa duhet besim në disa shokë, në çështje të tilla si «jo nuk i formulojnë mirë raportet, leksionet» etj. Edhe çështja e formulimit ka rëndësinë e vet, luan një farë roli, po çështja është më shumë te bindja, te vija. Prandaj duhet edhe atyre me u dhënë më shumë liri e kompetenca, sigurisht duke i kontrolluar e ndihmuar

dhe të kemi parasysh problemet kryesore që u shtruan këtu, domethënë shokëve që ka secili nën vartësinë e tij, t'u bëjë kritika, po gjithashtu të mos harrojë askush se duhet të bëjë edhe vetë autokritikë.

Punët në sektorët e agjit-propit janë një kompleks i koklavitur. Duhet të bëhen përpjekje serioze për të dalë nga një metodë e ngushtë pune. Bedriu na thotë se nuk po shkëputet dot nga gjërat e vogla, po ka shumë shokë që janë shkëputur nga gjërat e vogla dhe, duke u kapur nga më të mëdhatë, luftojnë për t'i zgjidhur ato sa më mirë. Prandaj Bedriu duhet të përpiqet të vendosë një metodë më të drejtë pune dhe të mos mbërthehet vetëm me punë zyre, por të shkojë shumë më tepër në.bazë.

Shpeshherë drejtuesit e sektorit të agjit-propit na thonë se duhen marrë këto dhe ato masa. Po pse nuk i merrni kur ato i keni të qarta, pse i keni lënë çështjet zvarrë derisa të trashen? Kush e ka ndaluar Bedriun dhe Drejtorinë e agjit-propit të vënë në vend çështjen e edukimit ideo-politik në Parti, organizimin e studimit marksist-leninist, dhe të formave, frekuentimin e tyre, disiplinën etj? Të gjitha masat edukative i ka parashikuar Partia, po ato duhet të vihen në jetë dhe udhëheqësit të nxjerrin konkluzione. Atje ku mundësitet janë të pakta, të gjenden forma të tjera, të mos biem në shablonizëm. Në qoftë se komunistët nuk venë në rrethet politike, faji nuk është vetëm i tyre. Ashtu siç vihen përpara përgjegjësisë shokët nën kryeministra që janë anëtarë të Byrosë Politike për çështje ekonomike në shtet, ashtu është përgjegjës për çështje të agjit-propit, edhe sekretari i Komitetit Qendror, i

ngarkuar nga Byroja Politike ta drejtojë këtë sektor. Ai duhet të bëjë që komitetet e Partisë të merren si duhet me këto probleme. Prandaj, kur shkohet në bazë dhe konstatohet se në atë rreth, ta zëmë ka dobësi në sektorin e arësimit, ju duhet ta ngrini me forcë të madhe këtë problem në komitetin e Partisë.

Sic u tha këtu nga disa shokë edhe unë për veten time nuk jam dakord me propozimin për riorganizimin e Drejtorisë së agjit-propit¹. Vetëm them se Drejtorinë e agjit-propit duhet ta ndihmojmë me disa kuadro. Në këtë sektor duhet të kemi kuadro të shëndoshë, me kulturë, që të kenë haber, pse jemi në një fazë të tillë që duhet të përballohen problemet e agjACIONIT e të propagandës. Pastaj kjo duhet të na shërbejë që edhe ne ta shohim më mirë punën e agjACIONIT e të propagandës. Duhet t'i rritim kuadrot dhe kjo detyrë duhet t'i bëjë këta shokë që të dalin nga kjo situatë. Po duhet të ruhemë edhe nga formalizmi. Ashtu sikurse thanë edhe shokët, format që kemi organizuar sic janë kabinetet e Partisë e format e tjera, të gjitha duhet të luajnë rolin e tyre. Prandaj në këtë sektor duhet të çojmë njerëzit më të preqatitur. Për një kohë ne duhet të sakrifikojmë disa kuadro të shëndoshë dhe të përqëndrohemë në këtë problem për preqatitjen e kuadrit udhëheqës. Pa bërë këtë gjë nuk do të arrijmë të kemi një situatë të mirë. Të mos marrim një kuadër të mirë dhe ta dërgojmë si agjITATOR të thjeshtë për shem-

¹ Në raportin që i paraqitej Byrosë Politike bëhej propozimi që Drejtoria e agjit-propit të ndahej në dy drejtori: njëra të merrej me propagandën, agjACIONIN e shtypin dhe tjetra me kulturën, artin e arësimin.

bull, në Rrëshen, pse me një lule nuk vjen behari, por këtë filiz të dimë ta përdorim mirë që të sigurojjmë edhe filiza të tjerë, pra një shok më të kualifikuar ta vëmë në një kabinet, ku të punojë për të pregetit kuadro të rinj.

Gjithashtu unë nuk jam dakord tani për tani me masat që propozohen për të nxjerrë gazeta lokale. Ne nuk kemi përmirësuar akoma shtypin qendror, nuk kemi arritur që masat ta lexojnë atë sa duhet, sidomos në fshat, bile, siç u tha, ka raste që edhe në rreth nuk lexohet as nga disa kuadro të Partisë. Kur ne nuk kemi arritur akoma që një kuadër drejtues në rreth të bëhet i ndërgjegjshëm për rolin e shtypit, pse kërkojmë t'i nxjerrim probleme të tjera vetes duke botuar gazeta lokale dhe të rrimë e të flasim jo kështu ndodhi në kooperativën e Lumalasit, jo kështu po bëhet në Fikas etj? Duke shkruar vetëm për gjëra të tillë se ç'po ndodh në rreth, ajo nuk mund të jetë gazetë. Për problemet lokale në një gazetë rrethi mund të shkruhet vetëm një faqe. Atëhere ç'do të bëhet me tri faqet e tjera? Domethënë duhet të rrahësh çështje politike ose çështje të tjera të rëndësishme. Për këtë do të detyrohem i të dërgojmë në bazë kuadro nga të qendrës dhe kështu të ndajmë forcat që kemi. Pastaj për fshatin jo se nuk kemi material të mjaftë për të botuar në gazetat qendrore dhe të ndihmohen kështu kuadrot dhe populli, por çështja është që të ngremë më lart nivelin e shtypit ekzistues, që ai të tërheqë sa më shumë lexues. Përveç kësaj janë dhe mungesat e çregullimet në shpërndarjen e shtypit. Atëhere përsë ta bëjmë këtë ndarje forcash? Unë jam i mendimit që të mos i nxjerrim këto gazeta, po të marrim masa që shty-

pi qendror të dalë mirë, të përmirësojë cilësinë, të bëhet më interesant për masat e gjera të popullit dhe këto ta lexojnë me dëshirë e të shpërndahet në rregull. Po të bëjmë këtë, atëhere kemi korrur një sukses të madh. Përsa i përket çështjes së revistave, më duket se nuk janë të tepërtë. Revistat si ato të ushtrisë, të shëndetësisë, arësimit etj., nuk janë pér masat, po përkatësisht pér oficerët, mjekët, arësimtarët etj. Edhe pér të tilla revista ne kemi nevojë, pse ato ndihmojnë në kualifikimin e kuadrove të secilit sektor, vetëm se duhet që nga ana e dikastereve përkatëse të shfrytëzojen sa më shumë. Sa pér revistën «Ylli», ajo me të vërtetë është një revistë pér masat. Edhe revista që nxjerr Ministria e Bujqësisë është një revistë pér masat. Prandaj të mos kërkojmë të përhapemi shumë dhe pastaj të mos kemi rezultate.

Vërejtjet e tjera që bënë shokët në diskutimet e tyre, nuk duhet t'i marrë era. Jo vetëm që shumicën e tyre ne duhet t'i kemi parasysh pér raportin që do të bëjmë pér Kongresin II të Partisë, ku t'i trajtojmë si çështje të rëndësishme, por edhe çështjet e tjera që u ngritën prej tyre dhe që kanë rëndësi të madhe duhet të bëhen objekt i një studimi dhe të merren masa konkrete pér t'i vënë në zbatim. Lidhur me këto çështje që u ngritën duhet që herë pas here t'i bëhet nga një raport Byrosë Politike pér masat që janë marrë, duke treguar konkretisht gjendjen, ndryshimet dhe deri ku kanë shkuar punët. E them këtë se këtu flasim shumë herë, marrim dhe vendime, por shpeshherë mjaft çështje mbeten si punë muhabeti. Pastaj kur i marrim në shqyrtim na thuhen gjëra të përgjithshme.

Ndihma që u dha në këtë mbledhje është që madhe. Ndihmë të veçantë për zgjidhjen konkrete të problemeve dhe sidomos të atyre që kërkohet ndërhyrje nga lart do t'u jepet. Këtu ka edhe çështje për të cilat duhet ndihmuar në rrugë shtetërore. Nuk është e drejtë që ne, që jemi në qeveri, megjithëse i kemi parë të drejta kërkcesat e bëra nga Drejtoria e agjit-propit, ju kemi rënë me gërvshërë të madhe, ca më shumë nga të gjithë Koleka. Kjo tregon se ne vetë jo se nuk kemi kuptuar rëndësinë e sektorit të agjit-propit, po ngaqë na janë dashur maqineri e gjëra të tjera, kemi lënë pa plotësuar disa nevoja të agjit-propit. Me një fjalë edhe ne kemi gabim në këtë drejtim. Prandaj edhe nga ana shtetërore duhet të marrim masa rigorozë për plotësimin e nevojave që ka propaganda dhe agjizacioni pse është e vërtetë që Partia duhet të luftojë, po ajo ka vënë edhe rregulla shtetërore, ku ka plot lëshime. Shokët që janë përgjegjës nga ana shtetërore nuk e kanë ndihmuar sa duhet Partinë që vendimet e Byrosë Politike të marrin një rrugë më të mirë zbatimi. Prandaj çështjeve të Partisë duhet t'u jepet zgjidhje nga tō dy anët, domethënë nga ana shtetërore dhe nga ana e Partisë, siç janë p.sh. çështja e shkollave, kurseve, etj., pse të tëra konditat janë që të zgjidhen.

Përsa i përket çështjes së «prosovjetizmit antisovjetik», edhe unë jam dakord me Mehmetin dhe them se Bedriu gabon që e ngre problemin sikur te ne armiku po punon nën maskën e «prosovjetizmit». Një antisovjetizëm që fshihet prapa prosovjetizmit nuk ekziston te ne. Ta shtrosh çështjen se antisovjetizmin duhet ta kërkojmë prapa prosovjetizmit, aq më tepër ta alar-

mosh këtë, do të thotë ta orientosh shtrembër Partinë, të krijosh një problem që nuk ekziston, të mos vigjilosh e zbulosh armiqëtë e vërtetë të Bashkimit Sovjetik, të Partisë e të popullit tonë. Prandaj, teza e Bedriut mbi «prosovjetizmin antisovjetik» duhet hedhur poshtë¹.

Unë jam dakord gjithashtu edhe me vërejtjet që bëri Hysniu për pikëpamjet e gabuara të Bedriut në lidhje me trockizmin dhe katolicizmin te ne. Edhe në këtë drejtim Bedriu gabon.

Të marrim çështjen e trockizmit. Bedriu thotë se «trockizmi është demaskuar plotësisht». Kjo shprehje nuk është ekzakte. E vërteta është se Kongresi I i Partisë demaskoi grupin trockist të Koçi Xoxes, por kjo s'do të thotë se me kaq mori fund lufta e Partisë kundër trockizmit. Rruja jonë është e gjatë dhe aspak e shtruar me trëndafila. Fakti është se edhe pas Kongresit I armiqëtë e brendshëm dhe të jashtëm s'kanë ndënjur papunuar kundër Partisë sonë. Si mund të garanto hemi ne se edhe në të ardhshmen s'do të kemi më të bëjmë me punë armiqësore, trockiste, oportuniste? Ne nuk mund të ecim përpara me sy mbyllur, përkundrazi sytë duhet t'i bëjmë katër. Kur u pyete ti, Bedri, se e kujt është shprehja që «trockizmi është demaskuar plotësisht», e the vetë që s'është e tjetërkujt, por është shprehja jote. Unë dua të të them që të kesh kujdes në përcaktimet dhe përkufizimet e prera që

¹ Siç u vërtetua më vonë, Bedri Spahiu e çorientonte propagandën e drejtë të Partisë sonë për Bashkimin Sovjetik dhe nën etiketën që ai trilloi për «prosovjetizmin antisovjetik» ai kërkonte të pengonte propagandën që bëhej për realizimet në B.S.

bën e që ti i ke aq shumë qejf, por që nuk janë të drejtë dhe e orientojnë shtrembër Partinë.

Të vijmë tanë edhe në çështjen tjetër. Ti Bedri ke mendimin që me klerin katolik të mirret sidomos shteti dhe bën propozimin që të thirren disa priftërinj në Komitetin për çështje klerike pranë Kryeministrisë e të bisedohet me ta që «kisha katolike të punojë përmirëqenjen shpirtërore dhe materiale të popullit» siç thotë statuti i saj! Unë jam me mendimin që shprehu Hysniu që katolicizmi nuk luftohet me anë të masave shtetërore, kryesorja është puna ideologjike e shkençore e Partisë. Helmi i fesë nuk luftohet me urdhëra nga shteti, por më punë të palodhur, me durim e vazhdimisht nga ana e Partisë. Prandaj shokët tanë të kenë më shumë kujdes që propagandën e kishës ta rrethojnë me vijën e drejtë të Partisë dhe jo të shihet ngushtë problemi duke thënë, pse foli filan prift për shpirtërat. Një mendim i tillë do të thotë me shtrembëruue vijën e Partisë, pse ligjet tona u kanë dhënë të drejtë klerikëve të kryejnë shërbimet e tyre fetare. Ne duhet të bëjmë që prifti, kur meshon në kishë, përveç ceremonisë fetare, të flasë që në Républikën Popullore të Shqipërisë po luftohet varfëria, po luftohet për paqen. Sa përfenë, atë ta luftojmë me forma të tjera dhe të bëjmë që njerëzit t'ja heqim kishës nga prehri dhe t'i mobilizojmë ata rreth vijës së Partisë.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP

TE PERMIRESOJMË ORGANIZIMIN DHE DREJTIMIN E PUNËS PËR REALIZIMIN E DETYRAVE EKONOMIKE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH*

16 janar 1952

Shokët këtu i ngritën të gjitha problemet dhe unë jam dakord me vërejtjet e tyre si dhe me raportin që na është paraqitur. Në Byronë Politike dhe në Komitetin Qendror ne i kemi parë direktivat dhe shifrat orientuese të planit pesëvjeçar, por ato po i rishikojmë edhe një herë pse çështjet tani po shqyrtohen në bazë. Me analizën që po bëjmë në këtë mbledhje të Byrosë Politike, kemi për qëllim që të shohim si ka punuar e drejtar Partia, Byroja Politike, Sekretariati dhe aparatet e Komitetit Qendror për realizimin e planit të shtetit. Në lidhje me këtë, më duket se çështjet u ngritën mjaft mirë.

Rëndësia e planit pesëvjeçar është e padiskutueshme. Realizimet e vitit të parë të këtij plani, sipas shifrave dhe në krahasim me planin dyvjeçar, natyrisht janë më të larta. Por plani i vitit 1951 në shumë

sektorë nuk është realizuar. Kjo është një gjë shumë e rëndë për ne. Del pyetja: mos vallë nuk i kemi pasur mundësitë ta realizonim planin në mos plotësisht, të paktën asërsisht? Apo në disa sektorë ka ndonjë faktor që pengon realizimin e planit siç janë konditat e natyrës etj.? Mundësi për ta realizuar planin e vitit 1951 unë them se kemi pasur. Po pse atëherë nuk është realizuar? Kjo gjë u theksua nga të gjithë, shkaku është mungesa e drejtimit dhe e organizimit të mirë të punës.

Me gjithë përmirësimet që kemi një punën organizuese e drejtuese të Partisë, jemi akoma mjaft mbrapa. Kur ne kemi treguar kujdesin e duhur për një organizim të mirë të punës dhe për një ndihmë më të përqëndruar e një bashkëpunim më të ngushtë si këtu në Komitetin Qendror e në aparatin e tij, ashtu dhe në dikastere, janë realizuar suksese kolosale dhe në një kohë rekord. Pra, në rast se do të ishte bërë që në fillim të vitit në të gjithë sektorët një punë e tillë e organizuar dhe do të kishte një drejtim më të shëndoshë edhe rezultatet do të ishin shumë më të mëdha e, në prakun e vitit të dytë të pesëvjeçarit, nuk do të dilnim me deficite, nuk do të kishim gjëra të prapambetura e të parealizuara nga viti i parë, të cilat tan po na bëhen pengesë për realizimin e planit të vitit të dytë. Vihet pyetja përpara të gjithë Partisë: Do të vazhdojmë ne me këto dqbësi në çështje të drejtimit, të organizimit dhe të kontrollit në punë? Jo, nuk duhet të vazhdojmë. Atëherë çfarë duhet bërë? Është e domosdoshme që të gjitha të metat që njohim dhe që sot po i kritikojmë, t'i luftojmë. Ne bëjmë autokritikë, po nuk

i zbatojmë si duhet ato që themi. Prandaj dua të theksoj edhe një herë që të përmirësojmë organizimin dhe drejtimin e punës për realizimin e detyrave ekonomike. Natyrisht, kjo kërkon edhe zbatimin e disa formave e metodave më të mira në punë duke filluar që nga lart, nga udhëheqja e deri në bazë. Të metat që vërehen në punën e Partisë, të jemi të ndërgjegjshëm se janë edhe pasqyrim i dobësive tona këtu lart, me gjithë përmirësimet e bëra si në Byronë Politike e në Sekretariat, ashtu edhe në organet shtetërore.

Unë mund të them se udhëheqja e Partisë, Byroja Politike dhe Sekretariati mbahen më mirë në korrent të problemeve, pavarësisht se në këtë çështje ka dhe të meta. Këtu ka një dobësi të përgjithshme që, problemët që diskutohen në Byronë Politike sipas planit, nuk janë aq të koordinuara me problemet kryesore që ajo u ka shtruar si organeve shtetërore, ashtu dhe atyre të Partisë, me qëllim që të shohë më mirë se si zbatohen vendimet e saj. Këtu duhet të përpinqemi, sa të jetë e mundur, që kur Byrosë Politike i vihet një problem për ta shqyrtuar, t'i vijë nga të dy anët dhe, kur merret vendimi përkatës nga ajo ose nga Sekretariati, këto të bëhen probleme të Partisë, por njëkohësisht edhe të shtetit, pse kështu rezultatet do të jenë më të mira.

Mua më duket se i kemi vendosur mirë mënyrat e punës për organet e pushtetit, po kjo nuk është e mjaftë, sepse duhet të shohim si zbatohen ato në praktikë. Le të marrim mbledhjet e qeverisë. Me përjashtim të atyre që zhvillohen për të shqyrtuar buxhetin, planin dhe analizat tre ose gjashtëmuajore, mbledhjet e tjera

bëhen pothuajse vetëm për të nxjerrë vendime dhe urdhëresa. Natyrisht qeveria nuk mund të mblidhet çdo ditë, por në mbledhjet e saja duhet të ngrihen më shumë probleme të nivelit qeveritar dhe të merren vendime të rëndësishme në lidhje me realizimin e planit për këtë ose atë sektor. Nga ana tjetër, në mbledhjet e qeverisë nuk bëhet sa duhet kritikë e fortë për një sektor që nuk shkon mirë, ose për ata drejtues që nuk zbatojnë si duhet vendimet dhe detyrat e ngarkuara. Këtë gjë ne nuk duhet ta nënveftësojmë, pse qeveria është organi ekzekutiv dhe urdhërdhënës më i lartë i Republikës Popullore të Shqipërisë dhe si e tillë ajo duhet të luajë rolin drejtues që i takon. Rolli drejtues i qeverisë kërkon që ajo të merret si duhet edhe me zgjidhjen e problemeve ekonomike.

Në Byronë Politike dhe në Sekretariatin e Komitetit Qendror shtrohen probleme themelore të politikës ekonomike të Partisë, të cilat ne si qeveri duhet t'i zbërthejmë e prej tyre të nxjerrim më mirë detyrat tona. Por këtë gjë nuk e kemi bërë si duhet. Ne si Kryesi e Këshillit të Ministrave, unë si Kryeministër, shokët zëvendëskryeministra dhe ministra nuk duhet të lejojmë që të na vijnë në qeveri një numër i madh problemesh, por të kërkojmë nga vetja dhe shokët e aparatit shtetëror një punë më të kujdeshshme për të studjuar e për të përpunuuar sidomos problemet më të rëndësishme ekonomike që ngre jeta e që shqyrtohen edhe në Byronë Politike. Kryesia e Këshillit të Ministrave, natyrisht, do të nxjerrë urdhëra dhe udhëzime, pse këto janë në kompetencën e saj, por ne duhet të vëmë më mirë në rrugë çështjen që, si kryesi, të merre-

mi më mirë me problemet dhe vendimet që dalin nga Byroja Politike dhe nga qeveria për çështje të planit, të kontrollojmë e të kërkojmë llogari si u zgjidh ky ose ai problem, çfarë rezultatesh dha etj.

Le të marrim si shembull një çështje konkrete, atë të ullirit, megjithëse kemi shumë probleme të tilla. Këtë çështje ne e diskutuam kur pamë urdhëresën. Tani ky proces po vazhdon. Çfarë dimë ne si kryesi e qeverisë për ullinjtë, që përbëjnë një problem me rëndësi të madhe ekonomike për vendin tonë? Ne po e ngremë me forcë vazhdimisht që të kemi ullinj, por në mbledhjet e qeverisë rrallë na ngrihet problemi i ullinjve, grumbullimi i tyre, fabrikimi i vajit etj., të raportohet se si shkon puna dhe të propozohet se si të ecë më mirë. Kështu mund të numëroj edhe shumë probleme të tjera. Ne nuk duhet të shtrojmë në Kryesinë e Këshillit të Ministrave probleme të tilla vetëm me raste, kur ndonjë nga ne do të konstatojë se vaji nuk është i mirë ose nuk kemi vaj etj., por këtë ta bëjmë metodë pune e t'u referojmë kryesisë dhe qeverisë probleme që na preokupojnë e që kërkojnë zgjidhje. Ullirit, sidomos shërbimeve të tij, duhet t'i kushtojmë rëndësi të veçantë. Vitin tjetër nuk duhet të na bjerë rendimenti, përkundrazi të shtohet, me përjashtim të ndonjë katastrofe. Puna, kontrolli dhe ndihma e Ministrisë së Bujqësisë dhe e Partisë edhe për këtë kulturë duhet të matet me rezultate konkrete.

Kryesia e Këshillit të Ministrave duhet ta mbajë qeverinë në korrent të vazdueshëm, pse ajo është një organ operativ i saj. Si mund të mbahet në korrent qeveria? Në kemi aparate, kemi nënkyeministrat përgjegjës

për çdo sektor, kemi ministrat, kemi takimet kolegjiale, me mua mund të bëhen edhe më shumë takime individuale etj. Megjithkëtë, a janë vallë shokët sa duhet në korrent të problemeve ekonomike me të cilat janë ngarkuar? Mendoj se jo sa duhet, pse shokët kapen shpeshherë pas problemeve të ditës dhe nuk kanë parasysh si duhet të ndjekin sidomos problemet kyçe dhe ato të perspektivës e të përcaktojnë në këtë mënyrë kur dhe përse do t'i shtroj detyrë vartësit, përse do t'i kërkoj llogari dhe ai të vrasë mendjen për ta kryer plotësisht detyrën, për të cilën është përgjegjës. Po kështu duhet thënë edhe kur ndonjë shok shkon për këshilla dhe ndihmë te përgjegjësi i vet, nuk është e drejtë që ai të kërkojë takime për çështje që janë në kompetencën e tij dhe që duhet t'i zgjidhë vetë. Në këtë drejtim nuk duhen pranuar justifikime, po secili të mendojë e të veprojë me përgjegjësi të plotë për detyrat që i janë besuar.

Përpara Byrosë Politike njerëzit duhet të vijnë me plan të realizuar, të sjellin eksperiencën e tyre pozitive, të thonë se përse nuk u krye kjo ose ajo detyrë dhe ç'masa janë marrë.

Të mos harrojmë çështjen e drejimit kolegjial, kjo përveç të tjerave ndihmon edhe për zgjidhjen e problemeve të secilit dhe nxjerr në shesh përgjegjësitë personale. Bisedova një ditë, me Gogon, për fabrikën e sheqerit, ai vajti atje dy-tri herë me radhë dhe kur u kthyena tha se gjithshka ishte në rregull, kurse kryeinxhini pas dy-tri ditësh më dërgoi telegram urgjent ku më informonte se për mungesë lënde të parë dhe qomyri, fabrika rrezikohej të ndalonte punën. Koleka në këtë-

drejtim, një javë më parë më tha se çdo gjë ishte në rregull kurse del e kundërta. Do të ecim ne me këtë mënyrë pune? Për këtë çështje ata shkuan prapë dhe morën masa për rregullimin e gjendjes. Po përse të mos merreshin këto masa kur vajtën herën e parë? Në këtë drejtim që të gjithë kemi shumë të meta, prandaj na bie detyra t'i vëmë në rrugë më të drejtë çështjet dhe lidhjet e marrëdhënjet me ministrat të bëhen më të shëndosha, më të forta, më rigoroze. Ndryshe nuk mund të ecim përpara, prandaj duke u mbështetur edhe në eksperiencën që kemi, të luftojmë më tepër që të arrijmë në forma më të përsosura të drejtimit kolegjial dhe të forcimit të përgjegjësisë personale.

Përsa i përket disiplinës së planit ka disa rregulla dhe ligje, të cilat në rast se nuk i zbatojmë, mund të bëjmë sa të duam «vaz pa qitap». Ne duhet të jemi të pamëshirshëm për thyerjen e disiplinës. Foli edhe Koleka për harmonizimin e punëve shtetërore dhe të Partisë, domethënë për bashkëpunimin e aparateve e të funksionarëve të Partisë me ato të shtetit. Sekretarët e Komitetit Qendror që drejtojnë punën e aparatit më duket se nuk kanë një bashkëpunim të ngushtë e të vazhdueshëm me shokët nënkyryeministra dhe me ministrat. Ata që drejtojnë Partinë e kanë për detyrë të forcojnë organizatat e Partisë në rrethe e në bazë edhe në drejtimin që ato të japid një ndihmë më të madhe për realizimin e planit. Në rast se sekretarët e Komitetit Qendror nuk janë mirë në korrent të problemeve ekonomike, natyrisht jo në detaje, po në thelb, atëherë nuk mund të udhëzojnë e të drejtojnë mirë aparatet dhe Partinë në luftë për realizimin e planit. Nuk duhet të mjaftohemi me pjesë-

marrjen e tyre në mbledhjet e Byrosë Politike për një çështje, ose për një tjetër. Në mbledhje merret orientimi, por gjatë zbatimit të vendimit çështja është më e kocklavitur dhe këtë gjë e di Gogo Nushi më mirë pse ai është kompetent, prandaj Rita Marko që drejton disa sektorë ekonomikë nga ana e Partisë, duhet të ketë bashkëpunim me Gogon dhe me Kolekën. Ata duhet të shohin jo vetëm si shkon zbatimi i një vendimi, po në ndjekje e sipër të problemit, t'i sinjalizojnë shoku-shokut se si po ecën puna nga ana e Partisë ose nga ana shtetërore. Shokët që punojnë në aparatin e Partisë t'u thonë atyre që drejtojnë organet shtetërore se nuk po merren akoma këto ose ato masa dhe kjo shkakton këtë gjendje. Po kështu edhe ai shok që punon në aparatin e shtetit, t'i thotë aparatit të Partisë se ku çalon puna e saj etj. Kështu, kur të vijë për shqyrtim në Byronë Politike një problem i tillë që duhet të ndiqet si nga ana e Partisë dhe nga ajo e shtetit, të jemi të armatosur të dy palët dhe të mos ketë raste që ndonjëri të thotë se nuk është në korrent të problemeve.

Çështjet në Byronë Politike duhet të na vijnë të qarta, të metat e gabimet duhet të arsyetohen dhe të merret përgjegjësia e plotë pa i hedhur ujë verës. Nëse praktikojmë një metodë të tillë, do të kemi një punë më të shëndoshë. Kjo pastaj duhet të pasqyrohet dhe në shokët e drejtorive ekonomike, drejtorët e të cilave duhet të janë në kontakt më të ngushtë me shokët e tjerë dhe me ministrat. Këto gjëra Komiteti Qendror i ka caktuar dhe bëhen, po duhet të janë më të gjalla. Që nga sekretari i Komitetit Qendror e deri te drejtori duhet të njihet mirë thelbi i problemit për të cilin ka

marrë vendim Byroja Politike, pse kështu do të mobili-zohen më mirë Partia, komitetet e Partisë dhe organi-zatat bazë. Pra edhe aparati i KQ duhet të ketë kontakte të gjalla, jo vetëm për të kuptuar mirë problemet, por edhe për t'i koordinuar e për t'i zgjidhur drejt ato. Pastaj për çështjen e mobilizimit të Partisë nuk ka diskutim. Po të jetë Partia në udhëheqje dhe të drejtojë mirë, çdo gjë do të ecë si duhet. Po të ketë neglizhencë në Parti, do të ketë patjetër të meta në çdo fushë aktiviteti. Unë çështjen e kuptoj kështu: Partinë duhet ta shohim në organizatën bazë dhe në gjithë akti-vitetin shtetëror ku çdo komunisti i janë ngarkuar fun-kione dhe detyra. Një ministër duke zbatuar disiplinën, rregullat dhe vendimet e Komitetit Qendror dhe të qeverisë duhet të ketë njëkohësisht paraçysh që të sillet me kuadrot si një njeri i Partisë dhe të vëré komunistët në radhë të parë përpara përgjegjësisë së Partisë; por dhe përpara përgjegjësisë shtetërore. Mble-dhja e organizatës është baza e Partisë ku ngrihen problemet dhe, kur nuk ecin ato, bëhet kritikë e auto-kritikë dhe armatosen komunistët për të shkuar puna përpara.

Të marrim si shembull çështjen e zbatimit të meto-dave të përparuara. Kjo është një detyrë partie dhe shtetërore. Ne nuk mund të themi se për këtë gjë u interesua Partia, ndërsa pushteti nuk tregoi interesim ose e kundërta. Interesimi duhet nga të dy anët. Pikë-riشت se nuk bëhet si duhet kështu prandaj ka metoda të përparuara që përhapen ngadalë. Kështu për shembull ndodh në sektorin e ndërtimit. Pse Rrapo Dervishi nuk e sheh si duhet këtë çështje nië sektorin që drej-

ton¹? Pse atje komunistët nuk mobilizohen si duhet për të zbatuar më mirë metodat e reja përparimtare? Të mos e kuptojmë organizatën bazë vetëm për të bërë kritikë dhe autokritikë, po kjo të lidhet mirë me punën, me problemet dhe aty të gjejnë zgjidhje detyrat. Kështu shëndoshet Partia, mbledhjet e saja kanë autoritet dhe lënë përshtypjen se në atë qendër drejton me të vërtetë Partia. Në një organizatë bazë punohet mirë, kur ajo në mbledhjen e saj vë në rendin e ditës sot çështjen e emulacionit, nesër garat socialiste, pasnesër jetën e punëtorëve, një herë tjetër diskuton mbi disiplinën, më vonë për shkollat e mbrëmjes, pra, jo gjithnjë shqyrton të njëjtën çështje. Partia në bazë ka shumë çështje, në supet e saj ajo i ka të gjitha problemet dhe po të interesohet seriozisht për zgjidhjen e tyre, jo vetëm do të bëhet kompakte, por do të ndihet akoma më shumë edhe përgjegjësia e drejtimit. Duhet të kemi kujdes se po t'i caktojmë mirë detyrat dhe të jemi rigorozë në zbatimin e tyre, do të forcohet më shumë ndërgjegjja e shëndo-shë. Ndër komunistë, do të rritet ndjenja e përgjegjësisë së tyre dhe e drejtimit në punë, do të ngrihen njerëzit më tepër nga ana profesionale, rregullat, disciplina do të futen nga komunistët në një rrugë të sigurtë dhe secili do të bëhet më i zoti për punën që i është ngarkuar. Ndryshe do të lëvizet andej e këtej.

Jam dakord me problemet që u ngritën për sektorin e bujqësisë. Ne duhet të kemi parasysh se në këtë sektor ka vështirësi për arësyet që u thanë, por të jemi të ndërgjegjshëm se edhe shumë detyra nuk janë plotësuar

¹ Shoku Rrapo Dervishi atëhere ishte ministër i ndërtimit.

për mungesa organizimi e drejtimi. Po të mos e shohim në këtë mënyrë çështjen, atëhere detyrat e mëdha që kemi përpara, nuk do të kryhen mirë dhe në kohë, rendimentet nuk do të arrijmë t'i realizojmë si duhet dhe lënda e parë për fabrikat që kemi ngritur nuk do të na mjaftojë.

Të marrim për shembull pambukun. Ne kemi marrë mjaft vendime për këtë çështje, po nuk jemi shumë në dijeni se ç'bëhet për zbatimin e tyre. Kemi vendosur për rajonizimin e kulturave bujqësore dhe kemi thënë që ta bindim konkretisht fshatarin që ai në disa zona ta braktisë mbjelljen e misrit dhe nevojat e tija t'i përballojë me stimulacion që do të marrë nga mbjellja e bimëve të tjera sipas orientimit të shtetit. Edhe çështja e ujitjes duhet të merret më me seriozitet. Që kur ishte Iljaz Reka në Ministrinë e Bujqësisë ne kemi shtruar çështjen e kanaleve të dyta, kurse tani na thuhet se planin për këtë qëllim do ta kemi në marsin e ardhshëm. Ne kemi vendosur të mos i shtojmë sipërfaqet e tokave për mbjelljen e pambukut se nuk kemi mundësi për arësyet që dihen, po duhet të marrim të gjitha masat e tjera që të ngrihet rendimenti për hektar. Pra, duhet të merren masa efikase për ujitjen duke administruar ujët e kanaleve në mënyrën më racionale. Po të marrim të gjitha masat që thamë më lart dhe të mos lejojmë që në SMT-në e Lushnjës traktori të bëjë 187 hektar, po më se 300 hektarë njësi hamullore në vit, siç bën SMT-ja e Korçës, po të administrojmë mirë ujët e kanaleve ujitëse, po të kemi kujdes për çështjen e plehrave etj., etj., atëhere shifra prej 7 kv. pambuk për hektar jo vetëm do të arrihet, po edhe do të tejkalohet. Prandaj

çështjes së pambukut t'i vëmë rëndësi të madhe dhe detyrat që kemi caktuar për këtë bimë duhet të kryhen. Në rast se merren të gjitha masat në kohë, ne mund të kemi në bujqësi rendimente më të larta. Po kështu edhe për sektorët e tjera. Përsa i përket rajonizimit, për ne është e zorshme që të bëjmë qysh tanë një studim për të gjitha kulturat, po kemi mundësi që të bëjmë rajonizimin e kulturave kryesore si atë të duhanit, pambukut, panxharit etj., dhe, pasi të hedhim baza të forta për rajonizimin e këtyre bimëve të rëndësishme, të shtrojmë çështjen për zgjerimin e rajonizimit.

Edhe duhanit, që është një kulturë me rëndësi, më duket së Ministria e Industrisë nuk i ka vënë rëndësinë e duhur, prandaj ky problem duhet të studjohet mirë që nga përfitimet që duhet të kenë kultivuesit e duhanit e deri te manipulimi i kësaj bime. Me sa di unë në Shkodër në radhët e fshatarëve ka disa pakënaqësi për çështje të duhanit. Prandaj kjo çështje duhet parë dhe në këtë drejtim të tregohet më tepër kujdes për mbjelljen, rritjen dhe mirëmbajtjen e duhanit. Ministria e Industrisë dhe ajo e Bujqësisë duhet të marrin masat e duhura për mbjelljen e duhanit dhe inkurajimin e kësaj kulture duke dhënë edhe kredi dhe të sigurohen për fshatarët që merren me këtë bimë mjete moderne, të cilat janë fare të thjeshta. Të merren masa gjithashtu dhe t'u dilet çështjeve përpara, të mos varemi vetëm nga stimacionet, por të shikohet se si punon fshatari për duhanin, që nga mbjellja e deri në manipulin e tij dhe të ndihmohet ai me të gjitha mënyrat. Ndryshe nuk e kemi bërë si duhet punën tonë. Këto gjëra i ka marrë përsipër Ministria e Industrisë, e cila, me gjithë

përpjekjet që po bën, nuk i ka shkuar problemit deri në fund. Çështja e cilësisë së duhanit sidomos ka rëndësi të madhe, prandaj edhe për këtë sektor duhet të pregatitim kuadro të ndërgjegjshëm që të specializohen për këtë kulturë dhe të shohin se çfarë interes i ka shtetit dhe cilat e qysh janë interesat e fshatarëve që mbjellin duhan.

Në këtë fryshtë duhen parë edhe problemet e tjera që ka në bujqësi, siç janë çështja e lënjes së tokave. Këto probleme, si e thanë shokët e Byrosë Politike, duhet të na vijnë të studjuara dhe të na propozohen edhe masat që duhen marrë. Ky fenomen mund të ngjasë në malësi dhe jo në Myzeqe dhe që të mos na ndodhë në fushë, duhet të shohim një çikë më mirë edhe çështjen e ndihmës dhe e krediteve. Dhe kur them kredi, kam parasysh jo vetëm lekë, por të ndihmohet fshatari me fuqi tërheqëse, me plugje më të mira, me farë të zgjedhur etj. Mua më duket se pa e ndihmuar fshatarin edhe me këto të fundit, jo vetëm me kredi në të holla, ai nuk do të jetë në gjendje të punojë mirë tokat dhe të shtojë prodhimin. Natyrisht, një gjë të tillë ne nuk kemi mundësi ta zgjidhim në këtë mbledhje, por çështja është që të kemi një plan dhe të kërkohet zbatimi i tij.

Në kongres problemet kryesore ekonomike si ato të bujqësisë, të industrisë, të minierave etj., duhet t'i ngremë me forcë dhe drejt, që ta orientojmë e ta mobilizojmë Partinë. Ne duhet të bëjmë kthesë në miniera dhe përkëtë sektor kemi të tërë përgjegjësinë duke filluar që nga Byroja Politike, nga aparati i KQ dhe gjithë Partia, pse atje nuk ecet mirë.

Përsa u përket drejtorive ekonomike u tha se ato kanë pasur mjaft të meta. Shokët që i drejtojnë ato kanë punuar, po nuk kanë ditur të organizojnë mirë punën, t'i trajtojnë si duhet problemet dhe pastaj t'ja shtrojnë mirë Partisë. Shumë nga ju, shokë të drejtorive ekonomike, nuk jeni të rinj dhe pa eksperiençë. Prandaj t'i luftoni më mirë të metat që u thanë, të merrni më tepër kontakt me bazën dhe problemet e saj. Veç kësaj të njiheni më shumë me kuadrot dhe të ndihmoni më efektivisht sekretarët e Komitetit Qendror për problemet që dalin përpara. Ju keni mundësi dhe duhet t'i bëni këto gjëra.

Për Ritën, si sekretar që merret me sektorët ekonomikë, kisha të thoshja se ai interesohet mjaft për zgjidhjen e problemeve që i ngarkohen. Ai përpinqet, lufton dhe kjo është një gjë shumë e mirë dhe pozitive. Edhe për studim, besoj se nuk i mungon vullneti për t'ju futur më shumë zgjidhjes së problemeve dhe për zgjerimin e horizontit. Përsa u përket kontakteve më të ngushta me ne, jo vetëm për çështje kuadri ose për një çështje të caktuar, por edhe për çfarëdo problemi që ai nuk e ka të qartë, le të vijë kur të dojë dhe unë, me sa di vetë, me sa do ta kem të qartë atë problem dhe me sa mundësi të kem, do të jem gati që ta ndihmoj në punë dhe të ndihmojmë kështu shoqi-shoqin.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TË ZBATOJMË DREJT POLITIKËN E PARTISË NË CILËSIMIN E KULAKËVE NË FSHAT

21 janar 1952

LETËR DËRGUAR KOMITETIT TË PARTISË TË RRETHIT
D U R R E S

DHE GJITHË KOMITETEVE TË PARTISË NË RRETJE
DREJTORISË POLITIKE TË USHTRISË POPULLORE
DEGËS POLITIKE TË MP TË BRENDSHME

Në lidhje me luftën e klasave në fshat, konstatojmë se ju nuk i vini rëndësinë e duhur këtij problemi ashtu si ju ka udhëzuar Komiteti Qendor. Konstatojmë se në këtë drejtim, ju bëni gabime qoftë nga e djathta, qoftë nga e majta dhe këtë problem kaq të rëndësishëm nuk e keni studjuar dhe vazhdoni të mos e studjoni me seriozitetin e duhur. Nga kjo rrjedhin shumë padrejtësi dhe vija e Partisë në përcaktimin e kulakut dhe në kufizimin e tij ekonomik nuk zbatohet si duhet.

Ju e dini se komiteti i Partisë i rrethit është instanca e fundit që vendos për përcaktimin e kulakëve në bazë të të dhënave dhe të propozimeve të organizatave bazë të Partisë të fshatit. Një e drejtë e tillë sjell me vete edhe

përgjegjësi të mëdha mbi ju dhe kjo lë të kuptohet që jeni përgjegjës për zbatimin e drejtë të vijës së Partisë. Që vija e drejtë e Partisë të zbatohet dhe të kontrollohet nëse zbatohet drejt, nuk mjafton që komiteti i Partisë i rrethit të aprovojë në mënyrë burokratike dhe pa i studjuar thellë propozimet që i vijnë nga poshtë. Faktet tregojnë se komiteti i rrethit tuaj, në përgjithësi kështu vepron, nuk bën gjë tjetër veç aprovon pa studim dhe pa diskutim propozimet që i vijnë nga poshtë. Këtë gjë e faktojnë gabimet që po vërtetojmë në caktimin dhe kufizimin e kulakut ku ka oportunizëm të theksuar, dobësim të luftës së klasave, që do të thotë se shumë kulakë të vërtetë nuk janë zbuluar dhe nuk luftohen, por vazhdohet të konsiderohen si katundarë të mesëm dhe nga ana tjetër, katundarë të mesëm janë cilësuar ķulakë, janë dënuar si të tillë dhe ndaj tyre zbatohet politika që ka caktuar Partia vetëm për kulakët.

Por, veç kësaj, nuk merrni të paktën mundimin që të rishqyrtoni lutjet e kërkesat që vijnë nga katundarët e cilësuar si kulakë për t'i verifikuar të thënati e tyre dhe kjo t'ju shërbejë sado pak për verifikimin e vendimeve që ju keni marrë në lidhje me përcaktimin e kulakëve. Lutjet e njerëzve për ju kanë pak rëndësi, pse shkonin nga parimi i gabuar që çdo gjë, që keni vendosur, është e pagabueshme dhe përjashton bërijen e gabimeve, megjithëse në organizatat e Partisë në fshatrat e rrethit tuaj, nga pakujdesia juaj, nga mungesa e një pune organizative dhe édukative të shëndoshë në bazë të direktivave të Partisë, ekzistojnë shumë dobësi. Këto dobësi duhet që t'ju bëjnë më realistë për të ndihmuar dhe për të kontrolluar organizatat bazë në fshat dhe veç-

nërisht përsa i përket problemit të luftës së klasave. Është një gabim shumë i rëndë të lejoni dobësimin e ashpërsimit të luftës së klasave në fshat, por është një gabim tjetër, po aq i madh, të cilësoni si kulakë, katundarë të mesëm, të cilët duhet të jenë aletat e fshatarëve të varfër në luftën kundër kulakëve.

Shumë fakte vërtetojnë sa thamë më lart, veçanërisht ngjarja e Ishmit, e cila ishte bërë e rrezikshme dhe komiteti juaj nuk kishte mundur, jo vetëm ta shëronte këtë plagë, por as ta diktonte.

Një fakt tjetër, në mes të shumë të tjerave që ekzistojnë, është çështja e fshatit Luz të Kavajës, nga ku ju keni mjaft letra katundarësh, qofshin këto me përbajtje të drejtë ose jo, me të cilat qahen për padrejtësitë që u janë bërë, në lidhje me cilësimin e tyre si kulakë. Një nga këta katundarë, i quajtur H.B., duke mos marrë asnje përgjegje nga komiteti i Partisë i ka drejtuar një lutje drejtpërdrejt Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, ku i shpjegon se është cilësuar padrejtësisht si kulak nga organizata bazë e Partisë e fshatit Luz dhe nga Komiteti i Partisë i rrethit të Durrësit. Duhet të dini se Komiteti Qendror i Partisë i studjon me kujdes lutjet dhe propozimet e popullit, pse kështu na mëson Partia. Vetëm kështu Partia do të lidhet me masat dhe do të mësojë nga masat. Lutja e këtij katundari u verifikua nëpërmjet instruktorit të Drejtorisë së bujqësisë të Komitetit Qendror në organizatën bazë të fshatit Luz të Kavajës dhe pretendimet e tij ishin plotësisht të drejta. Ai është cilësuar padrejtësisht si kulak, pse në fakt ai është një katundar i mesëm. Nga mbledhja e kësaj organizate bazë u vërtetua gjithashtu se atje po

bëheshin gjëra të turpshme dhe padrejtësi flagrante, të cilat i kishin shpëtar vigjilencës së organizatës bazë të fshatit dhe Komitetit të Partisë të rrethit të Durrësit. Jo vetëm kaq, por shokë të Komitetit të Partisë e kishin inkurajuar fajtorin. Në organizatën bazë të fshatit Luz ekziston një farë Q.Ç. kandidat partie, që në realitet ja ka hipur në qafë organizatës bazë dhe bën ligjin atje. Në pozitat e këtij kanë qenë edhe sekretari i organizatës bazë dhe disa shokë të tjerë. Ky person, që ka qenë trim beu, me të kaluar të dyshimtë, immoral, i dënuar nga gjyqet, arrogant dhe që ka rrahur katundarë, dallaveraxhi dhe çfarë të duash ka influencuar që katundari H.B. të cilësohet kulak për arësy se nuk i ka dhënë çupën e tij 14-vjeçare për grua këtij bukuroshi 45-vjeçar. Sigurisht ju keni një përgjegjësi të rëndë për një situatë të tillë, pse merret me mend që padrejtësia që i është bërë katundarit H.B. nuk duhet të jetë e vëtmja. Duhet të ketë edhe katundarë të tjerë në këtë fshat në pozitat e H.B. dhe kulakë të tjerë në fshat, të cilët jo vetëm nuk luftohen, por edhe mbrohen. Natyrisht, pas këtij verifikimi, organizata bazë e Partisë e fshatit Luz e inkurajuar në rrugën e drejtë nga ndërhyrja e organeve të Komitetit Qendror të Partisë, u bë më luftarake për mbrojtjen e vijës së Partisë. Ajo zbuloi kalbësirën që ekzistonte në gjirin e saj, spastroi nga radhët e saja Q.Ç. dhe mori masa ndëshkimore ndaj sekretarit të organizatës bazë dhe disa shokëve të tjerë.

Nga një çështjë e tillë juve ju dalin detyra të rëndësishme:

1. — Të rishikoni sa më parë dhe drejt zbatimin e politikës së Partisë në lidhje me luftën e klasave në

fshat. Të vini në vend padrejtësitë ndaj katundarëve të mesëm dhe të ashpërsoni luftën kundër kulakëve të vërtetë. Udhëhiquni vazhdimisht në këtë çështje të rëndësishme nga mësimet e Leninit dhe të Stalinit, që na i kanë bërë të qarta këto probleme si dhe nga direktivat e Komitetit Qendror, të cilat bazohen plotësisht në mësimet e marksizëm-leninizmit, të zbatuara në rrethanat e katundit tonë. Ky rishikim t'ju shërbëjë jo vetëm juve, por të gjitha organizatave të Partisë të rrethit tuaj, duke pasur kurdoherë parasysh që ky problem të ngrihet drejt, d.m.th. të mos shikohen vetëm padrejtësitë dhe mbasandaj, duke u ruajtur nga sektarizmi, të kalohet në oportunizëm duke lënë kulakët të qetë ose të mbrohen nën pretekstin se «mos gabojmë». Rishikimi i vijës së Partisë në këtë drejtim nuk duhet të bëhet vetëm duke rishqyrtuar lutjet e katundarëve të cilësuar si kulakë, të cilat flenë në raftet tuaja, por duhet të kuptohet më gjerë, duke u lidhur mirë udhëheqja me bazën, duke e ndihmuar bazën për këtë problem dhe duke e kontrolluar.

2. — Mjaft gjëra ju shpëtojnë juve në këtë drejtim, të cilat sjellin konsekuenca të rënda, prandaj duhet të luftoni burokracinë që ekziston te ju dhe në aparatet e komitetit të Partisë, të forconi punën kolegiale në udhëhcqje dhe t'u vini rëndësi të jashtzakonshme mbledhjeve të organizatave bazë të Partisë, të aktiveve, të komitetit të Partisë të rrethit dhe të byrosë. Problemet që i shtrohen Partisë dhe forumeve, të jenë të studjuara dhe të preqatitura mirë. Të luftohet ashpër formalizmi në punë dhe mungesa e përgjegjësisë. Të zhvillohet kritika dhe autokritika bolshevikë kudo dhe sidomos

nga poshtë-lart. T'i vini rëndësi të madhe zërit të popullit dhe bazës së Partisë. Të mos neglizhon i as gjënë më të vogël, pse kjo ju bën ju që të harroni edhe gjërat e mëdha. Shihni se si shoku Stalin interesohet edhe për gjëra familjare që i kërkon populli. Në një kolkoz të vogël të Ukrainës, nipi i një kolkoziani plak ishte shumë i sëmurë. Doktori që e mjekonte i kishte humbur shpresat dhe i thotë kolkozianit plak se nuk ka shpëtim. Kolkoziani plak mendon dhe thotë: «Nipi im i vetëm do të vdesë. Kush mund të ma shpëtojë atë?» Atëherë ai i drejtoi një telegram shokut Stalin ku i thotë: «Nipi im i vetëm po vdes, shpëtoma». Pas tri orëve kolkoziani plak mori një telegram nga Stalini me këtë përgjegje: «U nis për atje aeroplani me doktorë specialistë». Dhe nipi i kolkozianit plak shpëtoi. Shihni sa kujdeset shoku Stalin për çështje të popullit. Pra, nuk duhet në asnë mënyrë të veprohet ashtu si konstatohet te ju dhe në shumë rrethe të tjera qoftë nga Partia, qoftë nga organet e pushtetit. Të luftohen ashpër neglizhencat e theksuara në shqyrtimin e kërkesave të popullit, në pritjen e popullit, në zgjidhjen e problemeve të tij, në zgjidhjen e problemeve shtetërore dhe të Partisë, qofshin ato shumë të mëdha, qofshin edhe fare të vogla.

3. — Përsa i përket çështjes së katundarit H. B., ai duhet të thërritet nga ju, t'i thuhet se u shqyrtua çështja e tij dhe se rezultoi që kishte të drejtë. T'i thuhet se komiteti i Partisë i rrëthit dhe organizata bazë e fshatit të tij, kanë gabuar. T'i hiqet menjëherë cilësimi i tij si kulak dhe t'i tregohen masat që janë marrë ndaj QÇ. Në të njëjtën mënyrë duhet të veproni edhe përrastet e tjera.

4. — Rishikimi i çështjes së luftës së klasave në fshat, i gabimeve që do të vërtetohen pas këtij rishikimi, duhet të bëjë thelbin e një mbledhjeje të plenumit të komitetit të Partisë të rrethit, ku të analizohet mirë kjo çështje dhe të mësohet Partia nga gabimet që janë vërtetuar për të zhdukur oportunizmin ndaj kulakëve dhe sektarizmin ndaj elementit katundar të mesëm.

Me autorizim të Byrosë Politike të KQ
të PPSH

Sekretari i Përgjithshëm

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

**SI TË PARAQITEN MATERIALET PËR MBLEDHJET
E BYROSE POLITIKE E TË SEKRETARIATIT
TË KQ TË PPSH**

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

25 janar 1952

Kisha për të bërë disa vërejtje në lidhje me paraqitjen e materialeve për në mbledhjet tona. Këtë çësh-tje e kemi thënë ngahera, por megjithatë vazhdojmë akoma në rrugën e mëparshme. Relacionet e projekt-vendimet na vijnë shumë të gjata; një gjë të tillë nuk mund ta lejojmë më. Projektvendimet e Sekretariatit ose të Byrosë Politike nuk duhet të kenë karakter agjitativ, ato të kenë trajtën e ligjeve, të përcaktojnë detyrat qartë e të prera. S'ka nevojë që medoemos materialet të kenë hyrje. Sigurisht, do të ketë edhe disa projekt-vendime, të cilat duhet edhe të arësyetohen, për ato do të bëjmë përjashtime, por si rregull, të jenë të shkurtëra.

Një anë tjetër e këtij problemi është se na vijnë

¹ Diskutim para fillimit të mbledhjes së Sekretariatit.

projektvendime në një numër jashtëzakonisht të madh, gjë që na pengon të kontrollojmë zbatimin e vendimeve. Na vijnë edhe mjaft projektvendime për çështje që janë në kompetencat e sekretarëve të Komitetit Qendror, të cilët duhet t'i zgjidhin vetë ato probleme dhe të mos na i sjellin në mbledhjet e Sekretariatit. Një çështje që zgjidhet brenda vendimit dhe vijës së Partisë, në të mirë të saj, nuk është nevoja që të paraqitet edhe këtu, po të merret masë dhe të mbahet përgjegjësi nga vetë shokët. Prandaj, kësaj duhet t'i vëmë fre dhe këtë do ta arrijmë duke i caktuar drejt çështjet në plan e duke i gjykuar më mirë. E them këtë, pse kam vënë re që plani i aprovuar, shumë herë nuk respektohet nga shokët që punojnë në aparatin e Komitetit Qendror. Le të marrim si shembull mbledhjen e sotme të Sekretariatit:

Në plan është vendosur që gjatë tërë muajit të shqyrtohen 17 çështje, kurse vetëm në mbledhjen e sotme kemi një rend dite prej 24 pikash! Përse janë shtuar probleme mbi ato që ne kemi diskutuar dhe vendosur në plan pa u marrë vesh? Më e keqja është se këtu nuk figurojnë një sërë çështjesh të rëndësishme nga ato që janë studjuar dhe aprovuar që t'i shqyrtojmë, po në vend të tyre na janë paraqitur të tjera. Për shembull, relacioni mbi zhvillimin e plenumeve dhe të aktiveve, ai mbi Frontin, raporti mbi bashkimet profesionale etj., nuk na kanë ardhur fare, megjithëse kanë qenë në plan. Gjëra të tillë në asnjë mënyrë nuk mund t'i lejojmë. Ja, në këtë mbledhje ka shumë probleme të rëndësishme, për të cilat mund të merret një vendim për të dhënë një vijë të tërë, siç është ai i Institutit të shkencave, që

mendoj ta marrim në Byro ose për çështjet e kooperativave, që kanë një rëndësi të madhe etj., që vetëm një ose dy prej këtyre problemeve duan një mbledhje të veçantë, nëse duam që ato të studjohen si duhet. Po kur paraqitet një pyll i tillë materialesh të shumta si sot, sigurisht, problemet nuk kanë si diskutohen thellësisht.

Kurdoherë që do të vijnë materiale jashtë kufive që vëmë, ne do t'i kthejmë menjëherë. Gjithashtu, do të kthehen menjëherë, kur vijnë, edhe çështje të parashikuara, për të cilat nuk është biseduar më parë nëse është nevoja që të shtohen. Të kemi parasysh që të mos bombardohemi me shumë çështje për të marrë në shqyrtim, duke thënë se «duhet edhe kjo, duhet ajo». Kështu nuk mund të ecet. Prandaj duhet bërë një shoshitje e problemeve dhe këtu të na vijnë çështje me të vërtetë të rëndësishme. Në qoftë se kthehet një material, pasi s'është në rregull, vonesa e tij për në mbledhjen e parashikuar, do të ngarkojë me përgjegjësi atë që është në krye të atij sektori dhe që ka firmuar relacionin ose projektvendimin.

Të bëhet edukatë në njerëzit e Partisë sonë që kur njërit i kthehet një material një ose dy herë, duhet të mendohet dhe ta ndjejë si një gjë të madhe.

Për shumë nga këto çështje që diskutojmë nuk bëhen përpjekjet e duhura nga ana e sekretarëve të Komitetit Qendror që punojnë dhe drejtojnë në aparat. Këta duhet të kontrollojnë më thellë preqatitjen e materialeve që bën një degë ose sesion dhe, në qoftë se kanë shumë ujë, të mos ja paraqitin Sekretariatit ose Byrosë Politike. Këtu duhet të na vijë esenca e çështjeve.

Çështja e shkurtimit të materialeve që na vijnë në Byronë Politike ose në Sekretariat nuk është një gjë e lehtë, përkundrazi, po sidoqoftë duhet të bëhen përpjekje nga shokët derisa të mësohen me një punë të tillë. Sigurisht, në fillim mund të na vijnë edhe materiale që nuk do të kenë shpjegime të plota, po në punë e sipër gjërat do të perfektionohen.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

SHTYPI NUK MUND TË JETË I PAVARUR NGA PARTIA

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH*

25 janar 1952

Redaksia e gazetës «Zëri i Popullit» duhet të kuptojë drejt çështjen e pavarësisë së saj dhe të të gjithë bashkëpunëtorëve e korrespondentëve, pse ndryshe mund të rrëshqasë dhe të bjerë në gabime që kanë rrjedhime të mëdha. Çdo mendim se «nc jemi të pavarur, se mund të shkruajmë pa u influencuar nga komitetet e Partisë», është i gabuar. Kryeredaktori, redaktorët dhe gazetarët kanë kompetencat e tyre, po njëkohësisht kanë edhe përgjegjësi përpara Partisë pér punën që u është ngarkuar. Asnjë gazetar nuk mund të jetë i shkëputur nga Partia e sidomos organi i Komitetit Qendror, «Zëri i Popullit». Përkundrazi, ai duhet të jetë i lidhur ngushtësisht me Partinë.

Çështja e pavarësisë duhet të kuptohet mirë në radhë të parë nga kryeredaktori i gazetës «Zëri i Popullit» dhe gjithë korrespondentët. Kur aparati i Komitetit

Qendror dhe korrespondentët i sinjalizojnë kryeredaktorit një sërë problemesh, ai duhet t'i studjojë ato me kujdes, t'i klasifikojë dhe t'i shohë në kolegjum. Midis tyre mund të gjenden probleme të një rëndësie të përgjithshme të cilat kërkojnë një vëmendje të posaçme, po mund të ketë edhe gjëra më pak të rëndësishme. Këto të fundit mund të jepen për botim me kompetencë të kryeredaktorit. Por kur ka një problem të rëndësishëm që duhet të vlejë si një mësim për gjithë Partinë dhe që është mjaft delikat, është i domosdoshëm konsultimi me sekretarin përkatës të Komitetit Qendror të Partisë. Me këtë duhet të diskutohet edhe problemi kur një korrespondent pengohet ose nuk lejohet nga komitetet e Partisë të rretheve ose dikush tjetër të kryejë si duhet detyrën që i është ngarkuar, kryeredaktori mund të propozojë që të shkruhet edhe ndonjë artikull ku të kritikohet ky fenomen. Si të diskutohet e të rrihet problemi, në qoftë se gjykohet dhe gjendet e arësyeshme botimi i shkrimit përgjithësues, atëhere veprohet. Pra, për një çështje që atakon komitetet e Partisë dhe përgjithëson një fenomen, të mos bazohemi vetëm te korrespondanca e një gazetari, që mund të jetë dhe e drejtë, por çështja të bëhet objekt studimi e diskutimi edhe me sekretarin e Komitetit Qendror dhe aty të vendoset nëse duhet botuar ose jo, ky shkrim i rëndësishëm.

Duhet të shkohet nga parimi se sekretari i Komitetit Qendror që drejton sektorin e agjizacionit e të propagandës di se si zhvillohetjeta e Partisë, pse ai është në kontakt të ngushtë me sekretarët e tjerë të Komitetit Qendror, pse ai merr pjesë në mbledhjet e Byrosë

Politike, pra është edhe në gjendje të thotë se ku duhet të godasë shtypi ynë. Prandaj duhet medoemos që kryeredaktori i gazetës të këshillohet me të. Nuk mund të shkëputet çështja e gazetës nga udhëheqja e Partisë, nuk mund të thuhet se «korrespondentët janë të pavarur prandaj ata s'kanë nevojë të pyesin e të këshillohen me Partinë».

Mundet që shokët e një komiteti partie në rreth të mos jenë dakord me korrespondentin që ka bërë shkrimin për botim, prandaj ky, kur ja dërgon materialin qendrës duhet të njoftojë se ku janë kundërshtimet e tij me komitetin e Partisë. Kjo do ta orientojë kryeredaktorin ta diskutojë çështjen me shokët e Komitetit Qendror. Gazetari është i pavarur, ka kompetenca të plota, por ato duhet t'i zbatojë në vijën e Partisë. Natyrisht, kjo do kuptuar drejt dhe të mos shpjerë në censurë, e cila është e dënueshme dhe nuk lejohet.

Kritika dhe autokritika në shtyp përbëjnë një problem të madh. «Zëri i Popullit» duhet të pasqyrojë vijën e Partisë, ta ngrejë me forcë dhe drejt këtë çështje. Kjo kërkon që korrespondentët të shkruajnë dhe të mbahen afër. Ata të rretheve të mbahen afër nga komitetet e Partisë, ashtu sikurse shokët e gazetës «Zëri i Popullit» në qendër të mbahen afër nga Drejtoria e agitacionit dhe e propagandës e Komitetit Qendror. Korrespondentit duhet t'i sqarohen mirë kompetencat. Ai nuk duhet të jetë mendjemadh e të mendojë se «unë kam aftësira e kompetenca të veçanta, prandaj mund të shkruaj edhe pa u konsultuar me Partinë», përkundrazi, ai duhet të jetë njeri i thjeshtë, të ketë kontakte shumë të ngushta me Partinë e organet

e saj dhe këtë ta quajë ndihmë e jo të mendojë se «po më censuron komiteti i Partisë». Nga ana e saj Partia duhet ta shohë më mirë ndihmën që nevojitet t'u japë korrespondentëve, të cilët në asnjë mënyrë nuk duhet t'i lërë të mënjanuar.

Përsa i përket rubrikës «Jeta e Partisë» ajo duhet të shërbejë për edukimin e gjithë Partisë. Por meqenëse shokët që drejtojnë këtë rubrikë nuk janë shumë të pregetitur, shkrimet e saj dalin mjaft tregimtare dhe nuk ngrenë problemet kyçë që rrihen, për shembull, në një mbledhje partie dhe rrëth tyre të shkruhet cila është eksperiencia e mirë, cilat janë të metat, si u zgjidhën dhe si u vendos. Prandaj shokëve të rubrikës «Jeta e Partisë» një ndihmë të madhe duhet t'u japë sekretari për agjizacionin e propagandën dhe aparati i Komitetit Qendror. Por ata të ndihmohen edhe nga sekretarët e tjera të Komitetit Qendror, që e njohin jetën e Partisë, t'i ndihmojnë edhe komitetet e Partisë në rrëth ku punojnë nga shokët më të zot. Kjo do të bëjë që të evitohen gabimet në shtyp dhe shkrimet e kësaj rubrike të jenë më objektivë, më instruktivë. Të zgjidhen njerëz të mirë që e njohin jetën e Partisë, të cilët të jenë afër bazës dhe afër udhëheqjes e të ndihmohen që të shkruajnë për probleme të rëndësishme të jetës së Partisë. Kësaj çështje duhet t'i kushtojmë vëmendje shumë të madhe.

Kryeredaktori i «Zërit të Popullit» duhet të vlerësojë më tepër rëndësinë që ka konsultimi me shokët e aparatit të Komitetit Qendror e veçanërisht me shokët e Drejtorisë së agjizacionit e të propagandës. Vërejtjet që bëjnë dhe këshillat që jasin shokët e aparatit

të Komitetit Qendror duhet të mbahen më mirë parasysh. Në këtë proces nuk përjashtohen edhe vërejtje jo të thelluara, por këto sqarohen në rrugën e diskutimeve.

Përsa i përket artikullit që u botua¹, ai ka të metat dhe të mirat e tija. Duke e lexuar këtë artikull, të krijohet përshtypja sikur korrespondentëve u bëhet censurë nga komiteti i Partisë. Kjo frymë është e gabuar. Por në këtë shkrim ka edhe gjëra të drejta, të cilat po të diskutoheshin para se të botohej e të ndihmohej korrespondenti nga ana e komitetit të Partisë, në kuptimin e drejtë të bashkëpunimit, përfitimet dhe mësimet do të ishin akoma më të mira për të gjithë Partinë. Përsa i përket asaj që tha dikush këtu se nuk i duhet bërë kritikë një rrethi që ato ditë i jepet një flamur, kjo nuk është me vend. Flamuri i jepet një rrethi për sukseset që ka pasur, po nëse atje ndodh një gabim dhe gjykohet se duhet kritikuar, atëhere kritika mund t'i bëhet, pra nga kjo anë kritika është e drejtë.

Bedriu thotë që çështja e kritikës në shtyp nuk është kryesorja. Përkundrazi, unë them se kjo është kryesorja, pse kritikën në shtyp nuk e kemi të zhvilluar në shkallën e duhur. Po kështu është e gabuar edhe teza tjetër e Bedriut se «Partia në rreth i persekuton korrespondentët». Unë jam i mendimit që Partia në rreth nuk i persekuton korrespondentët, vaj halli po të mos kuptojnë njerëzit e Partisë rëndësinë e kritikës

¹ Është fjala për një artikull kritik, botuar në gazeten «Zëri i Popullit», Nr. 273, datë 14 nëntor 1951, që mban titullin «Qëndrim i padrejtë ndaj korrespondentëve të gazetës» dhe i referohet rrethit të Korçës.

e të autokritikës. Sidomos udhëheqja e Partisë në rrith nuk mund të ketë si qëllim të persekutojë një korrespondent, pse ajo e kupton rëndësinë e punës së tij. Ndoshëta mund të ketë ndonjë njeri të paformuar si duhet që e bën këtë gjë, por kjo s'duhet përgjithësuar. Shtypi nuk mund të jetë i pavarur nga Partia, pse kjo shpie në shkëputjen e tij dhe në mospasqyrimin si duhet të vijës së drejtë të saj. Direktivat që jep Komiteti Qendror, redaksia e gazetës «Zëri i Popullit», duhet t'i marrë si urdhëra.

Vërejtjet që u bënë në këtë mbledhje, me siguri do ta forcojnë akoma më shumë punën e shtypit të Partisë, sidomos në organin kryesor të saj, «Zëri i Popullit». Ne jemi të bindur se Fadili, si një shok i vjetër i Partisë dhe si kryeredaktor i organit të Komitetit Qendror të Partisë, «Zërit të Popullit», do t'i kuptojë e vlerësojë si duhet këto vërejtje dhe do të mobilizohet me të gjitha forcat për t'i vënë ato në jetë.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TË GJALLEROHEN MË SHUMË ASAMBLETË E KOOPERATIVAVE TË SHITBLERJES DHE TË KONSUMIT

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

25 janar 1952

Përpara se shokët e Drejtorisë së tregëti-financës të Komitetit Qendror të venë në bazë, ta zëmë në Peshkopi, është mirë të pyesin se kur ka ndonjë mbledhje asambleje të kooperativave me qëllim që të marrin pjesë në punimet e saj. Bashkë me ta, të shkojnë edhe sekretari i parë e shefi i seksionit ekonomik të komitetit të Partisë të atij rrithi. Atje të shikohet si zbatohen parimet dhe direktivat e Partisë lidhur me rolin e asambleve, sa flasin njerëzit dhe a vihen përpara përgjegjësisë ata që nuk zbatojnë detyrat. Pasi të ndihmohet konkretisht një asamble, atëherë t'u thuhet shokëve të komitetit të

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth një raporti mbi çështjet organizative të kooperativave të shitblerjes dhe ato të konsumit. Shoku Enver Hoxha u ndal në çështjen thelbësore të problemit — në domosdoshmërinë e gjallërimit të asambleve si organe më të larta të këtyre kooperativave.

Partisë të rrithet: ja, kështu të bëhen edhe asambletë e tjera të kooperativave të shitblerjes dhe ato të konsumit. Të mos bien komitetet e Partisë në atë që, në vend të punës konkrete që duhet të zhvillojnë për këtë çështje, të bëjnë vetëm në fund një autokritikë.

Edhe ju, shokë të Bashkimit Qendror të Kooperativave të Konsumit që veproni nga ana shtetërore, mos harroni parimin e Partisë, se kooperativat e shitblerjes e të konsumit janë organizata masash, prandaj nuk duhen neglizhuar mbledhjet e asamblesë dhe roli i komisioneve të kontrollit. Mbledhja e asamblesë nuk është një veprim formal, atje materializohet dhe konkretizohet vija e Partisë, e cila shprehet edhe në vendimet e qeverisë. Në këto mbledhje duhet të bëhet kritikë dhe autokritikë, të arrihet që njerëzit të diskutojnë dhe këshillat administrative¹ të venë e të flasin në popull si i shërbehet atij. Në qoftë se një nëpunës nuk punon mirë, mbledhja e asamblesë mund të vendosë edhe ta pushojë e ta zëvendësojë me një tjetër. Po të veprohet kështu për gjallërimin e asambleve, njerëzit nuk do të mungojnë, por do të vijnë me dëshirë në këto mbledhje dhe do të mbajnë qëndrim për problemet që shtrohen. Pra, funksionimit të mirë të asambleve dhe furnizimit të dyqaneve me mallra duhet t'u jepet shumë rëndësi. Këto probleme të vlerësohen drejt si nga ana e Partisë, ashtu dhe nga ana shtetërore dhe vija e Partisë do të zbatohet mirë, në qoftë se problemet do të kuptohen edhe nga ana parimore. Çështjet do të zgjidhen si

¹ Organe që zgjidheshin dhe kontrolloheshin nga asambletë.

duhet, kur të kryhen mirë detyrat edhe nga ana shtetërore.

Ne duhet t'i vëmë një rëndësi shumë të madhe demokratizimit të organizmave tonë, qofshin këto të pushtetit ose të organizatave të masave. Këto nuk i kemi në lartësinë e duhur. Një nga dobësitë e tyre është puna e pamjaftueshme për mobilizimin e masave për zbatimin e vendimeve të Partisë, pse ato nuk mund të zbatohen pa mobilizuar masat e gjera të popullit. Një gjë e tillë ndodh edhe me vendimet e pushtetit, për moszbatimin e të cilave përgjigjen këshillat popullore që kanë edhe këto mungesa të ndieshme. Ka ndodhur që përpara tyre komitetet ekzekutive mbajnë raporte të thata. Kjo s'duhet të ndodhë dhe duhet kuptuar mirë funksioni i këshilltarëve, kompetencat e tyre, detyrat e tyre për të dëgjuar ankesat dhe kërkosat e popullit dhe problemet që dalin t'i transmetohen këshillit popullor. Ne konstatojmë se ligjet nuk zbatohen si duhet, ka raste që në kundërshtim me ligjet hiqen këshilltarët. Atëhere, si mundet një këshilltar të luajë rolin dhe të përdorë kompetencat që i ka dhënë populli? Fakti është se ka kryetarë komitetesh ekzekutive të këshillave popullore që nuk dinë cilët janë anëtarët e këshillit popullor të qytetit a të rrethit. Anëtarët e këshillit nuk shkojnë sa duhet te populli, ndërsa komisionet që janë ngritur pranë këtij këshilli popullor, nuk funksionojnë mirë.

Këto probleme që ngrita, të studjohen mirë dhe të vihen në zbatim me qëllim që edhe kooperativat e shitblerjes e të konsumit të përparojnë më tepër. Prandaj, të organizohet mirë puna nga ana shtetërore, të

forcohet kontrolli nga ana e popullit dhe e Partisë. Një dyqan në fshat për ne nuk kushton shumë, por për fshatarët është një gjë e madhe. Ne duhet të përpinqemi me të gjitha mundësitë që rrjeti i tregëtisë të shtrihet kudo, pse tani ne kemi forca në çdo fshat për ta bërë një dyqan të mirë; gjithashtu tani kemi më shumë mundësi për t'i plotësuar ato me mallra, për të cilat ka nevojë fshatari¹.

Në krye të kooperativave të shitblerjes të mos janë të gjithë komunistë që kanë shumë barrë në kurriz, po të ketë më shumë njerëz pa parti, të cilët të ndihmohen vazhdimit në punën e tyre.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Byroës Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP

¹ Në atë kohë, për vetë kushtet tona ekonomike, shtrirja e rrjetit të tregëtisë në fshatra ishte shumë e vogël. Në Berat, për shembull, çdo 15 fshatrave u takonte mesatarisht një dyqan, i cili duhej të furnizonte rrëth pesë mijë banorë.

MBI DISA GABIME NË PUNËN E KOMITETIT TË PARTISË TË RRETHIT TË PUKËS

*Letër udhëzuese dërguar komiteteve të Partisë
në rrethe*

26 janar 1952

GJITHË KOMITETEVE TË PARTISË

Kohët e fundit Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH mori në shqyrtim situatën e vështirë, të krijuar në Komitetin e Partisë të rrethit të Pukës. Shkaktari kryesor i kësaj situate të rëndë në udhëheqjen e këtij komiteti ka qenë kryesisht sekretari i dytë shoku Z.G.

Shoku Z.G., element ambicioz, mendjemandh, karrivist, nuk i kryente mirë detyrat që i kishte ngarkuar Partia dhe ishin konstatuar shumë lëshime dhe dobësi në punën e tij. Përveç kësaj, shoku Z.G., duke kërkuar të ngjitej edhe më lart pa e merituar, me metoda trockiste dhe në rrugë krejtësisht antimarksiste, organizoi një intrigë shumë të rrezikshme. Kjo intrigë kishte për qëllim dobësimin e organizatës së Partisë të rrethit të Pukës, krijimin në këtë organizatë të dy tarafeve:

komunistë të rinj dhe të vjetër, krijimin e pikëpamjes se «komunistët e vjetër janë më të besueshëm dhe të pagabueshëm dhe të rintjtë më pak besnikë, bile dhe të dyshimtë». Përveç kësaj Z.G., i mbështetur në të dhëna jo të besueshme, por të grumbulluara prej tij nga elementë armiq dhe spiunë në shërbim të okupatorëve dhe të kuislingëve, akuzonte padrejtësish sekretarin e parë të Komitetit të Partisë të rrethit të Pukës dhe disa shokë të tjerë, si spiunë të okupatorëve dhe të kuislingëve në kohën e okupimit. Z.G., në kurdisjen e kësaj intrige, kishte krijuar një rreth të tij në udhëheqjen e komitetit dhe jashtë rregullave të Partisë, pa vënë në dijeni më parë Komitetin Qendror të Partisë, kishte filluar përpunimin e sekretarit të parë dhe të shokëve të tjerë. Shoku Z.G. të gjitha këto veprime i bënte prapa krahëve të komitetit të Partisë dhe të Komitetit Qendror të Partisë, të cilin e vuri në korrent vetëm kur u zbulua një situatë e tillë e sëmurë. Kjo intrigë dhe kjo punë trockiste dhe antiparti i kishte tronditur drejtuesit e Partisë në Pukë.

Përpara akuzave dhe veprimeve të shokut Z.G., ishin tronditur edhe vetë sekretari i parë i Partisë e disa shokë të tjerë të rinisë, të cilët gjetën rrugën e mbrojtjes, jo duke e shtruar këtë çështje në komitet për ta sqaruar ose të vinin në dijeni sa më parë Komitetin Qendror të Partisë, por edhe ata u grumbulluan me njëri-tjetrin për t'u mbrojtur jo me metodat dhe rregullat e Partisë.

Kuptohet, pra, që në udhëheqjen e Partisë në Pukë, ekzistonin dy tarafe dhe, natyrisht, puna nuk e cte mirë. Atje ekzistonte frika dhe kërcënimi, atje

zhvillohej një familjaritet i dënueshëm, atje u zhduk kritika dhe autokritika në rrugën e drejtë, atje u dobësua uniteti në udhëheqjen e Partisë, atje nuk kishte udhëheqje kolegjiale dhe vigjilencia revolucionare. jo vetëm që ishte dobësuar, por zhvillohej në rrugë të shtrembër.

Këtë situatë të vështirë në udhëheqjen e Partisë në Pukë, e shëndoshi plenumi i Komitetit të Partisë të rrethit të Pukës me ndihmën e Komitetit Qendror të PPSH. Nga analiza që bëri ky plenum u vërtetua se akuzat e shokut Z.G. ndaj sekretarit të parë të Partisë dhe disa shokëve të tjerë të rinisë, ishin pa baza, pra ishin shpifje. U vërtetua gjithashtu qëllimi karrierist, ambicioz dhe antimarksist i Z.G. si dhe dobësitë e tjera të tija në punë. U vërtetua familjariteti i tepruar, mungesa e kritikës dhe e autokritikës, mungesa e kërkimit të llogarisë në punë nga ana e sekretarit të parë si dhe nga shokët e tjerë të byrosë dhe të komitetit të Partisë të rrethit.

Mbledhja e plenumit në Pukë i vuri në dukje të gjitha këto të meta, dënoi fajet e rënda të Z.G. dhe gabimet e shokëve të tjerë, kritikoi ashpër metodën e punës të byrosë dhe të vetë komitetit duke vënë në dukje luftën që duhet bërë për të zhdukur familjaritetin e theksuar, mungesën e kritikës dhe të autokritikës, punën e dobët kolegjiale dhe mungesën e vigjilencës revolucionare në komitet dhe në byro. Punimet e këtij plenumi vunë në dukje se byroja dhe komiteti ishin kritikuar shumë rrallë për punën e tyre të dobët,

ndërsa sekretarët nuk ishin kritikuar fare. Gjithashtu plenumi vuri në dukje kritikën e dobët nga poshtë-lart, gjë që ka dëmtuar rëndë punën e Partisë në këtë rreth.

Byroja Politike e Komitetit Qendror e studjoi këtë gjendje dhe mori të gjitha masat për t'i dhënë fund kësaj pune të sëmurë dhe antiparti. Ajo vendosi shkarkimin nga detyra të sekretarit të dytë të komitetit të Partisë, shokut Z.G. dhe transferimin e tij nga Puka. Konferenca e Partisë për rrethin që u mblohd më vonë, e dënoi ashpër këtë punë të dobët dhe vendosi që Z.G. të dënohet edhe me vërejtje me shënim në kartën e regjistrimit dhe njëkohësisht t'i hiqet e drejta të zgjidhet në organet drejtuese të Partisë për 3 vjet rresht. Konferenca vendosi që sekretarit të parë t'i bëhet një vërejtje me shënim në kartën e regjistrimit dhe të shkarkohet nga detyra e sekretarit të parë, duke e ngarkuar atë me detyrën e sekretarit të dytë. Gjithashtu, konferenca mori masa të ndryshme për disa shokë të tjera të Komitetit të Partisë të Pukës për gabimet e tyre lidhur me këtë çështje.

Nga kjo punë e dobët e udhëheqjes së Partisë të rrethit të Pukës duhet të nxjerrim disa mësime që t'i shërbejnë gjithë Partisë:

1. — Të forcohet uniteti në Parti dhe në udhëheqje dhe të çmohet ashtu si duhet udhëheqja kolegiale, si në plenumin e komitetit, ashtu edhe në byro. Të mos harrohet për asnjë çast nga ana e byrosë si dhe nga vetë anëtarët e komitetit roli kryesor i udhë-

heqjes së komitetit. Për këtë arësyen duhet që plenumi i komitetit të Partisë të mblidhet rregullisht ku byroja të raportojë për problemet kryesore dhe t'i marrë në shqyrtim e të vendosë mbi këto probleme. Pra, byroja e komitetit duhet t'i japë plenumit, në kohë të caktuar, llogari për zbatimin e detyrave. Raportet e byrosë përpjaka plenumit duhet të jenë seriozisht të studjuara d.m.th. ato të jenë të frymëzuara nga qartësia bolshevik, nga kritika dhe autokritika individuale dhe kolektive, nga propozime të qarta të problemeve e të masave që duhen marrë për forcimin e gjithanshëm të punës së Partisë e të shtetit.

2. — Të forcohet vazhdimit kritika dhe autokritika në gjithë Partinë. Të inkurajohet vëcanërisht kritika nga poshtë-lart. Të goditen ashpër të gjithë ata drejtues ose forume, që për të fshehur gabimet dhe mungesat e tyre në punë, mbytin kritikën e Partisë dhe sidomos ata njerëz, që, duke pasur qëllime të këqia dhe antiparti, bëjnë provokime dhe akuzojnë pa të drejtë dhe pa argumenta njerëz të shëndoshë të Partisë, si bëri shoku Z.G. Çdo gjë që bie erë dobësi ose shtrembërim në vijën e Partisë dhe kundër kujtdo qoftë, duhet të shtrohet në organizatë ose në forumin e Partisë, pa druajtje dhe me kurajë bolshevik. Për mbrojtjen e Partisë dhe të vijës së saj nuk lejohet familjaritet as mbytje e kritikës -dhe e autokritikës as mungesë e vigjilencës revolucionare. Nuk duhet të lejohet për asnjë moment shkelja e Statutit dhe e rregullave organizative që ka caktuar Partia. Çdo gjë duhet të zhvillohet në bazë të Statutit dhe të rregullave në fuqi. Rrugë tjetër nuk duhet të lejojnë komunistët as në

organizatën bazë as në forumet udhëheqëse, sikundër është lejuar në forumet udhëheqëse të Komitetit të Partisë të rrethit të Pukës.

3. — Janë të rrezikshme e të dënueshme dhe në rrugë antiparti krijimi i tarafeve, të cilat fillojnë me disa pakënaqësi të vogla për njëri-tjetrin dhe konkretizohen më vonë në vijë të shtrembër kundër Partisë. Këto rrjedhia nga dobësitë e atyre komunistëve që nuk e kuptojnë dhe nuk e zbatojnë si duhet armën e kritikës dhe të autokritikës dhe s'kanë kurajën bolshevikë të luftojnë për zhdukjen e këtyre të metave mikroborgjeze në veten e tyre dhe në udhëheqje. Armiku pa dyshim përfiton nga këto dobësi dhe, me anë të këtyre komunistëve që paraqiten me këto dobësi, ndërhyn në çështjet e brendshme të Partisë. Qëllimi i armikut është të shkatërrojë Partinë tonë. Faji i rëndë i Z.G. duhet të na mësojë se si armiku i Partisë dhe i popullit tonë, duke i njojur dobësitë e Z.G. e ka përdorur këtë plotësisht për të dobësuar Partinë dhe udhëheqjen e saj në rrethin e Pukës. Z.G. në punën e tij antimarksiste është mbështetur kryesisht në të dhënat e armikut të klasës dhe të Partisë. Kundër armikut të jashtëm dhe të brendshëm të Partisë, duhet të jemi vigjilentë dhe të ashpër, duhet të njohim metodat e tija dhe t'i luftojmë ashpërsisht. Çdo gjë ta shikojmë në prizmin e Partisë, me sy kritik dhe bolshevik, të jemi të matur dhe të drejtë në gjykimet tona dhe, në vendimet për mbrojtjen e Partisë, të mos dezorientohemi as nga e kaluara e mirë e ndonjë shoku që gabon rëndë dhe as nga dobësitë e theksuara në punë të ndonjë shoku tjetër, që nuk ka një stazh të

gjatë në Parti. Çdo gjë duhet të peshohet mirë dhe të zbulohet gishti i armikut, në rast se ekziston dhe atëhere masat të jenë të pamëshirshme. Z.G. dhe shokët e tij në zhvillimin e kësaj intrige nënveftësonin dhe përbuznin shokët e rinj të Partisë dhe mbivlerësonin veten se gjoja ata kishin dhënë prova më shumë ndaj Partisë dhe vendit. Kjo i kishte çuar ata të mburreshin më tepër se q'duhej për të kaluarën e tyre dhe kjo u shërbente për t'i fshehur gabimet dhe fajet që ata bënin. Përveç kësaj i dënueshëm ka qenë faji i Z.G. dhe i shefit të sigurimit në Pukë, të cilët pa vënë në dijeni Komitetin Qendror të Partisë dhe pa marrë autorizimin e tij, vunë në përpunim sekretarin e parë të Partisë. Të gjitha këto shfaqje të huaja dhe shtrembeime të rregullave dhe të vijës së Partisë duhet të luftohen me ashpërsinë më të madhe.

4. — Të kritikohen dhe të goditen drejt shfaqjet e nënveftësimit të kuadrit të ri. Duke marrë parasysh se dhe në disa rrethe të tjera ka shfaqje të nënveftësimit të kuadrove të rinj si për shembull në Vlorë, është e nevojshme dhe e domosdoshme që komitetet e Partisë ta kenë mirë parasysh këtë çështje. Kuadrin duhet ta vlerësojmë mirë dhe drejt në punë, si kuadrot e vjetër ashtu edhe kuadrot e rinj. Ne duhet të ndjekim kurdoherë me besnikëri mësimet e Stalinit mbi këtë çështje dhe të kemi parasysh kûr thotë:

«...nuk është puna që të orientohemi nga kuadrot e vjetër apo nga kuadrot e rinj, por të ndjekim vijën e kombinimit, të bashkimit të kuadrove të vjetër dhe të rinj në orkestrën e

vetme e të përbashkët të punës drejtuese të partisë dhe të shtetit»¹.

Me autorizim të Byrosë Politike të KQ
të PPSH

Sekretari i Përgjithshëm

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë si-
pas originalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 244-245.

**TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR KQ TE
PPB TE POLONISË ME RASTIN E 10-VJETORIT TE
THEMELIMIT TE SAJ**

29 janar 1952

**KOMITETIT QENDROR TE PARTISE PUNETOKE TE
BASHKUAR TE POLONISE**

Varshavë

Në emrin e Komitetit Qendror dhe në emrin tim personal, ju përshëndes përzemërsisht me rastin e 10-vjetorit të themelimit të Partisë Punëtore të Bashkuar të Polonisë.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe mbarë populli punonjës i Shqipërisë njojin dhe çmojnë luftën dhe përpjekjet e vazhdueshme që ka bërë Partia Punëtore e Bashkuar e Polonisë për çlirimin e klasës punëtore dhe të popullit vëlla polak nga zgjedha naziste dhe nga borgjezia reaksionare e vendit, si dhe luftën e përpjekjet që po bën sot Partia Punëtore e Bashkuar e Polonisë për ndërtimin e socializmit në Republikën motër të Polonisë.

Partia dhe populli ynë i urojnë nga zemra Partisë

Punëtore të Bashkuar të Polonisë suksese të reja në luftën e saj të lavdishme për triumfin e kauzës së pagues e të socializmit që udhëhiqet nga Bashkimi i lavdishëm Sovjetik dhe nga shoku i madh Stalin.

Për Komitetin Qendror të PPSH
Sekretari i Përgjithshëm

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 24 (1032), 29 janar 1952*

*Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 24 (1032).
29 janar 1952*

**TELEGRAM NGUSHULLIMI DËRGUAR QEVERISË
SË RP TË MONGOLISË ME RASTIN E VDEKJES
SË MARESHALIT ÇOIBALSAN**

29 janar 1952

**QEVERISË SË REPUBLIKËS POPULLORE
TË MONGOLISË**

Ulan-Bator

Në emër të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë, të popullit shqiptar dhe në emrin tim personal i drejtoj Qeverisë së Republikës Popullore të Mongolisë dhe nëpërmjet saj gjithë popullit mongol ngushullimet më të thella për humbjen shumë të dhimbshme të udhëheqësit dhe të birit të shquar mongol, Mareshalit Çoibalsan.

Populli shqiptar merr pjesë në hidhërimin e popullit mik e paqedashës mongol për humbjen e Mareshalit Çoibalsan, një nga themeluesit e shtetit popullor mongol, luftëtarit të pamposhtur kundër imperializmit, farkëtarit të miqësisë së pathyeshme e të përjetshme

midis popujve të Mongolisë dhe të Bashkimit Sovjetik
dhe bashkëpunëtorit më të afërt të Suhe Batorit¹.

Kryetari i Këshillit të Ministrave
të RP të Shqipërisë
Gjeneral-Armate

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i Popullit»,
Nr. 24 (1032), 29 janar 1952*

*Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 24 (1032),
29 janar 1952*

¹ Suhe Bator (1893-1923) — një nga krijuesit e Partisë Revolucionare Popullore të Mongolisë, Hero Kombëtar i popullit mongol.

ME SHUMË INTERESIM PËR PROBLEMET JETIKE TË POPULLIT

*Takim me sekretarin e parë të Komitetit të Partisë
të rrethit të Durrësit¹*

2 shkurt 1952

SHOKU ENVER: Të kam thirrur në lidhje me mungesën e interesimit që po duket nga ju për çështjet e popullit. Ju nuk interesoheni për strehimin e popullit. Fshatra të tëra nuk kanë bukë dhe ju nuk e bëni çështje. Ju helmohen njerëz² dhe disa rrojnë me rrepa e barishte — interesim është ky? Nga ana tjetër bëhen gjithë ato gjëra brenda në Parti, siç ishte edhe çështja

¹ Shoku Enver Hoxha në këtë takim ka thirrur në raport sekretarin e parë të Komitetit të Partisë të rrethit të Durrësit, shokun N.B. për tu informuar rreth disa çështjeve të ngutshme lidhur me gjendjen e vështirë për bukë në fshatrat e këtij rrethi, për të nxjerrë shkaqet dhe masat për përmirësimin e kësaj gjendjeje.

² Disa persona duke përdorur për bukë miell nga fara e dezinfektuar, helmohen.

për të cilën Komiteti Qendoror ju dërgoi edhe letrën e e fundit¹ dhe shumë gjëra të tjera.

Të kam thirrur gjithashtu për çështjen e bukës në zonën e Kavajës dhe këtë problem kaq preokupant as që e merrni në studim. Kur vijnë, rastësisht, shokë nga qendra, atëhere i diskutoni këto gjëra, po nuk i bëni çështje me kohë në Komitetin Qendoror. Mua më vijnë letra nga populli ku më thonë se ka njerëz që vuajnë për bukë. Si ndodhin këto, pa na thuaj pak si është situata e bukës në Kavajë, çfarë masash keni marrë dhe përsë nuk është bërë bereqeti këtë vit në ato fshatra?

SEKRETARI I PARE: Situata e bukës si në Kavajë, ashtu edhe në të gjithë zonën e fushës të rrethit tonë, duke filluar që nga Rrogozhina, në fshatrat e Kavajës, të qendrës së Durrësit, të Shijakut dhe deri në ato të Ishmit nuk është e mirë. Të gjitha këto fshatra janë shtërnguar për bukë. Sa për malësitë, ato nuk kanë bukë, po janë bërë mirë ullinjtë dhe më ndryshtë është situata e tyre, sepse këmbejnë ullinj me misër në tregun reciprok. Si masë e marrur nga ana jonë ka qenë kjo: të futim në punë ata fshatarë që janë shtërnguar shumë për bukë. Në këtë mënyrë ne kemi sistemuar në punë 3 000 e ca familje për muajin janar, ndërsa për shkurtin ky numër na rritet në 3 631. Zona e Kavajës përbëhet nga 934 ekonomi individuale, nga të cilat 448 sot furnizohen nga shteti, d.m.th. gati gjysma e tyre. Numri i atyre që janë shtërnguar për bukë vjen duke u shtuar, d.m.th. po shtohet kërkesa për bukë nga

¹ Shih në këtë vëllim, f. 64.

fshatarësia. Në 13 fshatra të kësaj zone na del se duhen furnizuar dhe 154 familje të tjera. Ato që mbeten, besoj se do ta përballojnë gjendjen, sepse një pjesë kanë bagëti dhe inventar tjetër bujqësor. E tillë është gjendja në Kavajë. Në të njëjtën situatë jemi edhe në fshatrat e Shifikut, të qendrës së Durrësit dhe në lokalitetin e Lekajt. Përsa u përket fshatarëve që kanë hyrë në punë të shtetit, ata i furnizojmë me nga 6 kg. në muaj, po edhe kjo nuk u është dhënë në kohë, sepse nuk na ka ardhur i törë kontingjenti që kemi kërkuar në bazë të nevojave. Ministria e Tregëtisë për të verifikuar kërkuesat tonë dërgoi një njeri dhe pa se ato ishin të drejta. Po ne tani kemi edhe një pjesë të fshatarësisë që e kanë kaluar me çikrra dhe tani nuk u ka mbetur asnjë rezervë, prandaj gjendja e tyre është e vështirë. Ka, si thashë, edhe një pjesë tjetër që nuk kanë bukë, po realizojnë të ardhura nga shitja e prodhimeve të tjera. Në këtë pjesë hyn edhe malësia jonë që prodhon ullinj e vaj. Për të lehtësuar gjendjen e rrethit tonë mendojmë të lihet e lirë shitja e bereqetit në rrethet kufitare me Durrësin si Kruja, Tirana, Elbasani dhe Lushnja. Përveç kësaj të hiqet dispozita e Ministrisë së Tregëtisë që ndalon furnizimin e atyre fshatarëve që futen në punët e shtetit po që nuk i kanë larë detyrimet. Pastaj, për muajin shkurt, propozojmë që të na jepet edhe një sasi për të furnizuar edhe 700 familje më shumë. Nga këto masa ne besojmë se, me rastin e uljes së detyrimeve për shkak të thatësirës, një pjesë e fshatarësisë do të përfitojnë se do t'u kthehet drithi. Gjatë shkurtit ne mendojmë të mbarojmë studimin për nevojat që do të ketë rrethi ynë për

marsin, prillin dhe majin, prandaj të na jepen 250 kv. shtesë vetëm për këtë muaj.

SHOKU ENVER: Po organizatat e Partisë q'thonë për këtë gjendje, i keni mbledhur ato?

SEKRETARI: Kemi biseduar personalisht me anëtarë partie dhe me sekretarë organizatash bazë.

SHOKU ENVER: Pse s'keni mbledhur sekretarët e Partisë, po vetëm kryetarët e këshillave?

SEKRETARI: Sot e bëmë këtë gjë.

SHOKU ENVER: Ky është një problem i madh që preokupon rrëthin tuaj dhe s'duhet bërë kur ju kujtojnë. Përse nuk të ka vajtur në mend të mbledhësh sekretarët e organizatave të të gjitha atyre fshatrave që kanë vështirësi në sigurimin e bukës dhe t'u kërkosh se si është situata realisht? Kjo tregon se ju pak mbështeteni në Partinë, ose edhe kur mbështeteni, shikoni në ata elementë që nuk janë të shëndoshë, që janë futur kontrabandë në Parti. Kush mund të na e japë drejt situatën në këtë rast më mirë se Partia? Ne kemi besim në kryetarët e këshillave, po më parë kemi Partinë. Çfarë thotë Partia për këtë gjendje? Si mund të bazohem unë vetëm në mbledhjen e kryetarëve të këshillave, kur nuk kemi më parë zërin e Partisë? Unë mund të jepja urdhër t'ju vinte kjo sasi bereqeti që tani, po nuk mund, mbasi këtu nuk është fjala e Partisë. Po planet, pse nuk i realizoni ju, cilat kanë qenë shkaqet që nuk u bënë misri dhe gruri sivjet te ju?

SEKRETARI: Nga analiza që i kemi bërë kësaj çështjeje na rezulton që për drejtimin e mirë të fushatës së mbjelljeve nuk kemi ditur të kapim çështjet

më kryesore. Bie fjala në mbjelljet ne u kapëm nga çështja e pambukut dhe arritëm që ta realizonim si mbjellje. Po ne nuk ditëm të realizonim në kohën e duhur mbjelljen e misrit, megjithëse kishte edhe mungesë të fuqisë tërheqëse. Kjo është një e metë në drejtim që unë e gjej në veten time, pse nuk dita ta kap. Si rrjedhim, misrin na e zuri thatësira, ai u mbuall, por në një sipërfaqe të madhe nuk mbiu. Një tjetër arësy ka qenë se fara që na u dha, nuk ishte e vendit, por ishte farë e Peshkopisë që ishte mësuar me ujë. Një faktor tjetër që s'u bë misri është edhe ai i thatësirës gjatë gjithë verës.

SHOKU ENVER: Kush ka influencuar më shumë nga të gjitha këto?

SEKRETARI: Thatësira, në radhë të parë.

SHOKU ENVER: Po a e provuat ju çështjen e thatësirës me matje etj.?

SEKRETARI: Po, kjo gjë është bërë.

SHOKU ENVER: Kur ja keni paraqitur ju qeverisë këtë gjendje?

SEKRETARI: Ne nuk e kemi paraqitur këtë gjë në qeveri, pse e vërteta është që na ka munguar guximi, mendonim se do ta zgjidhnim vetë.

SHOKU ENVER: Por qeveria nuk do t'ju hante.

SEKRETARI: E kuptoj dhe tanë e kam realizuar këtë gjë.

SHOKU ENVER: Po tjetri nuk pret kur të të vijë ty guximi, ai do bukë të hajë. Kë provuar ti të mos hash për tri-katër ditë bukë? Nëse ju nuk keni guxim, ç'faj kanë ata që helmohen duke përdorur për bukë farë gruri të dezinfektuar? Pastaj në fund nuk zgjidhen

çështjet, përkundrazi ato komplikohen, bëhen më të rënda, sikundër është bërë tani. Dihet se shteti ka edhe një plan që për kaq bukë ka nevojë dhe kaq kërkon të vijë edhe nga jashtë. Ku ta gjejë tani shteti gjithë këtë sasi? Përse t'ju mungojë guximi, derisa është provuar se shkaku kryesor, që nuk u bë bereqeti, ka qenë thatësira? Kur ta thoshte Partia një gjë të tillë, edhe sikur të mos marrë vesh Ministria e Tregëtisë ose qeveria, drejtore Byrosë Politike ose Komitetit Qendror dhe kërkon që të vihen drejt çështjet. Ti je sekretar partie, po unë nuk të kam parë asnjëherë të vish te unë, kur shikon se ministri i grumbullimeve dhe ministri i tregëtisë për shembull nuk pranojnë kërkesat tuaja; këto janë probleme të rëndësishme, janë çështje politike, është buka e popullit. Ti thua se është vërtetuar se bereqeti nuk është bërë nga thatësira, por ne dimë që në Durrës ka edhe vende ku nuk ka dëmtuar thatësira. Këto zona mund t'u vijnë në ndihmë atyre që janë dëmtuar.

SEKRETARI: Ne kemi vetëm zonën e Maminasit ku është bërë bereqeti.

SHOKU ENVER: E keni realizuar grurin, sa dhe përse jo plotësisht?

SEKRETARI: Nuk e kemi realizuar plotësisht, po vetëm 78 për qind. Shkaku kryesor ka qenë lagështia në dimër, gjë që shkaktoi rënjen e rendimentit.

SHOKU ENVER: Duhet me u interesue mirë për çështjet e bujqësisë dhe jo me formula që ju japid një ose dy njerëz. Po të jetë lagështia e dimrit, atëherë duhet ta heqim grurin nga rrathi juaj, pse sipas jush nuk mund ta ngremë kurrë rendimentin, veçse duke

mbushur të gjithë fushën e Durrësit me kanale kulluese.

SEKRETARI: Lidhur me këtë ka edhe një sërë gjërash të tjera, siç thashë edhe për thatësirën.

SHOKU ENVER: Sa është realizuar pambuku te ju si sipërfaqe dhe si rendiment?

SEKRETARI: Si mbjellje 102 për qind, kurse si rendiment shumë dobët.

SHOKU ENVER: Kjo na intereson ne, rendimenti, pse, sa mbollët ju, nuk na intereson shumë. Pastaj ne e dimë se sa të sakta janë këto shifra. Ne i dimë dobësitë e pushtetit tonë në çështjen e statistikave; dimë gjithashtu edhe dobësitë e Partisë në fshat. Se sa është mbjellë e prashitur, ne në këto gjëra bëjmë skonto të mëdha, por të shohim më shumë rezultatin në mobilizimin e Partisë, këtu tregohet puna. Përsa u përket shkaqeve atmosferike, edhe ato merren parasysh në mos qind për qind, po aty afër, duke dëmtuar fare pak qoftë'shtetin ose fshatarin. Puna kryesore është te interesimi i madh që duhet të tregojë Partia në çështjet bujqësore. Nga Partia nuk ka interesim sa duhet në fshat dhe kjo gjë duhet të na shqetësojë. Tani të vijmë konkretisht në problemin: Sa fshatra kanë vështirësi në sigurimin e bukës në Durrës?

SEKRETARI: 70.

SHOKU ENVER: Ku janë më të shumtata?

SEKRETARI: Në Ishëm janë 25.

SHOKU ENVER: Ç'bëhet me detyrimet e atyre që nuk i kanë shlyer — merren gjë masa për ata që nuk e kanë shlyer grurin dhe a vazhdon grumbullimi?

SEKRETARI: Vazhdon, po grumbullimi i misrit

ecën shumë ngadalë, kurse grumbullimi i grurit është ndaluar.

SHOKU ENVER: Sa ka arritur grumbullimi i misrit?

SEKRETARI: 59 për qind.

SHOKU ENVER: Kush ka dhënë më shumë?

SEKRETARI: Malësitë i kanë shlyer pothuaj qind për qind.

SHOKU ENVER: Sa fshatra janë këto?

SEKRETARI: Janë 50 e ca fshatra.

SHOKU ENVER: Kanë nevojë për bukë këto fshatra?

SEKRETARI: Edhe ato kanë nevojë, po ne mëndojmë se ato duke pasur vaj e ullinj, i shkëmbujnë këto prodhime me misër. Përveç këtyre kanë edhe të ardhura të tjera në të holla dhe po të ketë misër në shitje të lirë, ata mund ta blejnë edhe me para.

SHOKU ENVER: Po 100 fshatrat e tjera sa bereqet duan dhe në sa kategori ndahen për çështje të furnizimit?

SEKRETARI: Ato nuk do të marrin të tëra, sepse një pjesë e vogël e ka bukën dhe në çdo fshat ka nga 2-3 familje të tilla. Pastaj është pjesa tjetër që ka inventar bujqësor, megjithëse nuk ka bërë bereqet. Kjo pjesë përbën 25-30 për qind të fshatarësisë sonë e cila edhe kjo mund ta sigurojë bukën.

SHOKU ENVER: Sa njerëz janë që furnizohen nga shteti për punën që bëjnë?

SEKRETARI: 3 061 që marrin nga 6 kg. për frymë, po dhe këtë nuk e kanë marrë në rregull, pse kontingjentet që kërkojmë ne, na vijnë të shkurtuara.

SHOKU ENVER: Nga këta që punojnë, ka ndër ta që nuk i kanë shlyer detyrimet?

SEKRETARI: Ka, por ka edhe një pjesë nga ata që janë punëtorë dhe nuk përfshihen në listë.

SHOKU ENVER: Pra, një pjesë janë nga ata që marrin nga 6 kg. në muaj sepse kanë dërguar njerëzit e tyre në punë, po një pjesë tjetër mbeten. Kanë me se ta blejnë ata?

SEKRETARI: Një pjesë, prej 30 për qind, janë në gjendje.

SHOKU ENVER: Po të tjerët si bëjnë?

SEKRETARI: Duhet me i furnizue. Nëse do t'u japim hua në formën që u dha vitin e kaluar, do të duhen nja 800 kv.

SHOKU ENVER: Sa familje u furnizuan vjet me hua nga shteti?

SEKRETARI: Mbi 1 000 familje.

SHOKU ENVER: Po në Tiranë nuk është lënë e lirë shitja e misrit?

SEKRETARI: Jo, as në Krujë e as në Elbasan, sidomos, ku mund të blejnë bereqet fshatarët tanë.

SHOKU ENVER: Po a u mjafton atyre 6 kg. në muaj që marrin nga shteti?

SEKRETARI: Me zor të madh.

SHOKU ENVER: Po farën e kanë këto familje?

SEKRETARI: Edhe fara u mungon.

SHOKU ENVER: Po ju ua keni ndarë farën fshatarëve — u keni dhënë farë misri?

SEKRETARI: Nuk u kemi dhënë.

SHOKU ENVER: Po si do të bëjnë ata për mbjelljet e pranverës?

SEKRETARI: Mund të bisedojmë edhe pak në përgjithësi, shoku Komandant, për çështje të mbjell-

jeve. Në çështjet bujqësore ne kemi një deficit të madh në pendë, pse numri i tyre ka ardhur duke u zvogëluar nga 1949 në 1951. Edhe kuaj kemi shumë pak. Gjithsejt ne kemi 1 517 kafshë.

SHOKU ENVER: E pamundur.

SEKRETARI: Këto shifra janë në bazë të regjistrimit të sivjetëm të bagëtive. Mushka kemi vetëm 30 dhe më se 3 000 gomarë. Në këtë situatë është e vështirë për rrethin tonë të lërohen rreth 31 000 ha. Mesatarja për një pendë që është 3 ha., pse ato të malësive nuk bëjnë më shumë se 2 ha., për mungesë toke.

SHOKU ENVER: Pse të mos organizohet puna që ata të malësive, sa të mbarojnë tokat e tyre së lëruari, t'u venë në ndihmë me qira atyre të fushave?

SEKRETARI: E kemi organizuar edhe këtë.

SHOKU ENVER: Sa hektarë punoni ju me traktorë?

SEKRETARI: 7 498 ha.

SHOKU ENVER: Ju po të përpinqeni që të vini për të lëruar edhe kafshët e tjera të trasha, patjetër që do t'ja dilni mbanë çështjes.

SEKRETARI: Po, ne kemi disa kuaj në Kryevidh që i mbajnë hergjele. Sivjet ne i kemi detyruar t'i kapin. Nëpër malësitë i përdorin kuajt për të lëruar, po gomarët nuk i përdorin. Kuajt i përdorin sidomos familjet kosovare të vendosura në këto fshatra.

SHOKU ENVER: Sa i keni realizuar punimet e vjeshtës?

SEKRETARI: Ato i kemi realizuar të tëra, se janë më të kollajta.

SHOKU ENVER: SMT-ja juaj nuk ecën mirë. Përse

nuk i vini në rrugë të mirë këto gjëra ju, përgjegjësia për këto bie e gjitha te organizata e Partisë, te udhëheqja e saj. Sa e ka realizuar SMT-ja planin?

SEKRETARI: Vjet në pranverë ajo ka shkuar keq.

SHOKU ENVER: Juve kafshët tërheqëse ju mungojnë dhe kuajt nuk i futni në punime. SMT-në e keni përtokë dhe masa për të rregulluar situatën nuk po merrni që të ndreqen shpejt e sidomos të mos prishen. Atëherë si do t'ua dalim ne gjithë këtyre problemeve? Cila është zgjidhja e tyre? Ju po thoni ngaherë se po merrni masa, po puna është se çfarë rezultati po jasin. Këto që na thoni janë të hidhura dhe nuk kemi dëgjuar asnjë rrëth që të mos thotë se nuk kemi marrë masa, po puna është se çfarë po bëhet. Po për çështjen e mbjelljeve, ç'bëhet?

SEKRETARI: Për grurin ne vjet kemi dalë 1 155 ha. deficit dhe kjo na i ka rënduar shumë mbjelljet e pranverës.

SHOKU ENVER: Po unë di që ju keni kërkuar farë dhe kur nuk ju dha, prapë përqindja e mbjelljeve u ngrit. Si ndodh kjo, d.m.th. se ju kishit farë.

SEKRETARI: Po të shihet mirë, kërkesa jonë ka qenë e drejtë. Ne kemi kërkuar 1 500 kv. farë, kur nuk na u dha, e pakësuam normën për ha. dhe kështu duke bërë ekonomi të madhe në hedhjen e farës, realizuam sipërfaqe më të mëdha në mbjellje.

SHOKU ENVER: Sa janë realizuar mbjelljet e vjeshtës?

SEKRETARI: 87 për qind në grurë, kurse kulturat e tjera janë realizuar plotësisht.

SHOKU ENVER: Ç'ju mungon për mbjelljet e pranverës?

SEKRETARI: Ne kemi nevojë për fuqi tërheqëse. se pendët po na theren.

SHOKU ENVER: Therjen ne e kemi të ndaluar për qetë.

SEKRETARI: Ne kemi kërkuar të na japë grumbullimi qé nga të rretheve të tjera ku grumbullohen të tillë.

SHOKU ENVER: Sikur të kishim qé të grumbulluar, do t'ua kishim dhënë fshatarëve.

SEKRETARI: Ne akoma nuk dimë si rreth sa farë do të na duhet.

SHOKU ENVER: D.m.th. ti nuk di sa farë do t'ju duhet, atëhere kur do ta paraqitni kërkesën?

SEKRETARI: Studimin për 2 500 kv. farë ne e kemi bërë një herë, por është puna të dimë tani në lidhje me kthimin që do t'u bëjë shteti fshatarëve që janë dëmtuar nga thatësira. Kështu besoj se do të na duhet farë më pak se 2 500 kv.

SHOKU ENVER: Sa bukë mendoni t'u jepni atyre që nuk kanë, qoftë duke punuar për llogari të shtetit ose si hua deri në muajin qershori? Këtë gjë ne duhet ta bëjmë se s'mund ta lëmë popullin të vuajë për bukë.

SEKRETARI: Pak më shumë se 4 600 kv.

SHOKU ENVER: Si i ndani ju këto sasi?

SEKRETARI: Bëhet studimi nga këshilli i fshatit dhe i lokalitetit dhe aprovohet nga një shok i rrethit dhe më në fund jepet nga organet e grumbullimit. Mërrret dëftesa e dörözimit të bereqetit dhe si ta marrë, ashtu do ta japë, d.m.th. po e mori grurë, do ta kthejë grurë.

SHOKU ENVER: Si është situata e bukës në ato fshatra dhe kush ka vajtur atje?

SEKRETARI: Unë kam shkuar vetë në Luz, Synej, Beden e Rrogozhinë, po situata është më e keqe në fshatrat e lokalitetit të Lekajt se sa në ato të Kavajës, ku fshatarët kanë përfituar më mirë nga ana e shtetit. Në fshatin Synej p.sh. në 123 familje që ka, 78 përfitojnë nga furnizimi, kurse në fshatrat e lokalitetit të Lekajt janë furnizuar më pák. Edhe në lokalitetin e Ishmit furnizimi ka qenë i paktë, gjithësejt 74 familje; atje zgjidhet problemi po të furnizohen edhe 123 familje.

SHOKU ENVER: Po përse do t'ua ndani me kaq vonesë bereqetin që do t'u kthehet fshatarëve nga ana e shtetit për efekt të thatësirës?

SEKRETARI: Se tani do të bëhet llogaria për këtë çështje dhe do të përfundojë ditët e para të shkurtit. Sa për ndarjen, ajo varet nga disponibilitetet e tre-gëtisë. Tanë në vend të misrit fshatarëve që punojnë në qendrat e punës, u jepet thekër për ushqimin e familjeve të tyre, pse nuk ka tjetër bereqet.

SHOKU ENVER: Po ajo që do t'u kthehet nga ulja për efekt të thatësirës, thekër do të jetë?

SEKRETARI: Nuk e di, po thekra njësoj është me misrin, vetëm se ka një gjë që fshatari ynë nuk është mësuar të hajë bukë thekre.

SHOKU ENVER: Po organizimin e ndarjes së bereqetit si e bëni, të gjithë në Durrës vijnë e marrin apo prisni sa t'u sigurohen kamiona?

SEKRETARI: Nuk e marrin vetëm në Durrës, se përveç depove që kemi në Durrës, kemi edhe në Kavajë e Shijak. Veç kësaj, ne e organizojmë punën në

atë mënyrë që ndarja të bëhet shpejt, brenda një javë në të gjithë rrrethin.

SHOKU ENVER: Duhen bërë më shpejt akoma këto gjëra, bile po të ketë mundësi brenda ditës, ose shumë-shumë brenda dy-tri ditëve duhet të përfundojë, se do bukë ai tjetri, nuk rrighet pa ngrënë. Po, për farë kur e keni lënë që të bëni kërkesën?

SEKRETARI: Ne kemi bërë një kërkesë që në fillim kur paraqitëm planin. Po tani duhet të bëjmë një kërkesë tjetër pas zbritjes nga thatësira dhe do të njoftojmë Ministrinë e Tregëtisë.

SHOKU ENVER: Ju duhet të interesoheni më shumë për çështjet e Partisë në fshat, pse atje atë e kemi shumë të dobët dhe na ngjasin gjithë ato gjëra që janë të palejueshme. Si është e mundur që gjëra të tilla kaq të rëndësishme t'ju shkojnë në këtë mënyrë pa i kapur?

SEKRETARI: Kjo vjen nga sistemi i dobët i punës sonë në udhëheqje, sidomos përsa i përket ndjekjes së çështjeve.

SHOKU ENVER: Duhet ta luftoni këtë sistem që të mos na ngjasin gjëra të tilla më. Patjetër forcimi i pushtetit nuk bëhet në një ditë, pse duhen vite që ai të forcohet si duhet, prandaj këtë gjë ne duhet ta kemi parasysh, se jemi jashtëzakonisht të dobët në këtë drejtim. Pushteti nuk mund të forcohet me këtë skure që ka zënë kokën e disa shokëve, me këto dobësi që tre-gojnë në çështje të organizimit të punëve të pushtetit. Ne i marrim çështjet e pushtetit sikur ato zgjidhen vetëm me kurajë, me ligje. Këto përbëjnë një anë, po nuk e forcojnë pushtetin. Pushteti forcohet duke mësuar

dhe duke përfituar nga eksperiencia e përditshme e Partisë. Çdo ditë Partia duhet të vërë një gur në forcimin e pushtetit që nga lart e deri në këshillat e fshatit, të cilat kanë një rëndësi të jashtzakonshme. Ligjet e urdhëresat, që përbëjnë masat për edukimin e njerëzve që punojnë në pushtet për ta forcuar organizativisht këtë, nuk studjohen mirë dhe nuk kontrollohet zbatimi i tyre i përpiktë. Nuk mbahen qëndrime të ashpra kundrejt atyre që abuzojnë e vjedhin e që nuk presin mirë popullin. Po të mos i nxitë Partia njerëzit të kryejnë punën e tyre, pushteti nuk mund të ecë përpara, nuk forcohet dhe na sjellin gjithë këto çështje. Duhet të pyeten kryetarët e pushtetit, që janë njerëz të mirë e që e duan Partinë dhe pushtetin e tyre, mirëpo vihet re se disa nuk e njohin sa duhet se ç'është pushteti, nuk i njohin mirë kompetencat, të drejtat, nuk studjojnë kërkesat e popullit dhe ndonjë këshilltari i hiqet mandati si pa gjë të keq. Me dobësi të tilla këta patjetër nuk do ta bëjnë detyrën e tyre dhe kur ti i kërkon gjithë ato gjëra, ata të bëjnë skonto. Ne nuk kemi arritur në Parti akoma të kemi gjëra plotësisht të sakta. Prandaj në radhë të parë duhet të forcohet Partia, të ndihmohet dhe, kur vjen çështja që fshati nuk ka bukë, t'i kërkohet organizatës së Partisë të na thotë si është situata, ndryshe nuk jemi aq të sigurtë në njohjen e gjendjes. Ato që thotë Partia, janë të sigurta dhe nuk ka më llafe. Këto gjëra të bëhen mësimë për herët e tjera dhe këto fatkeqësi të na shërbijnë që të mos na ngjasin më vitin e ardhshëm. Të shikohen me kujdes të madh çështjet e fshatit dhe të Partisë në fshat.

SEKRETARI: Të gjitha këto vërejtje janë të drejta. Është e vërtetë që ne nuk i kapim me kohë e nuk i vlerësojmë sa duhet këto gjëra që kanë karakter të rëndësishëm parimor dhe na shkasin, ashtu si na ngjau me çështjen e Ishmit.

SHOKU ENVER: Nuk ka si ju shkasin gjëra të tilla po ta bëni Partinë luftarake, të ndërgjegjshme për të kryer detyrat që i vihen përpara, që janë në interesin e çdo komunisti dhe të të gjithë popullit. Duhet me i dhënë Partisë kurajë, iniciativë që të luftojë dhe kritika e autokritika të bëhet e hapët, e fortë dhe e drejtë, jo bajate. Pastaj kritika e autokritika të bëhet lidhur me problemet që ka fshati dhe punën në fshat e udhëheq Partia. Komunistët atje duhet të janë në ballë të të gjithë situatës. Ata duhet të mendojnë për mbjelljet, korrjet, kanalizimet, për arësimin; duhet të mendojnë cilët janë armiqtë dhe si duhen luftuar; kështu ata do të janë të qartë se ku çalon e ku nuk çalon puna, pse udhëheqja e gjithë jetës në fshat është celula dhe pa të nuk mund të kryhen punët në fshat. Po të ishte ndihmuar organizata e Ishmit që të ishte luftarake dhe të pastronte me kohë maskarenjtë, do të ishte më e mirë gjendja atje. Po nuk mjafton me shkue vetëm një herë dhe me dhënë një orientim në via të përgjithshme, po duhet ngulur këmbë në vend dhe, kur shtrohet çështja e realizimit të mbjelljeve të vjeshtës, të kërkohet arësyja përsë nuk janë realizuar, t'u jepet kurajë komunistëve që të kritikojnë njëri-tjetrin për dobësitë që kanë dhe nëse njëri ka gabuar, të kritikohet dhe të ndihmohet të ndreqë gabimet dhe nëse nuk i bën këto dhe i përsërit një ose dy herë, atëhere — edhe jashtë

nga Partia. Dhe po qe se nuk është i mirë e nuk mund t'i durojë dot kritikat, të goditet bile dhe jashtë Partisë. Dobësitë të goditen nga vetë organizata se kështu ajo do të kalitet. Por në organizatat bazë shpesh nuk bëhet kështu, por shihet vetëm rendi i ditës, bësedohet në përgjithësi, u thuhen disa gjëra të thjeshta atje dhe me kaq mbaron mbledhja. Celula në fshat është koka drejtuese e jetës së fshatit dhe po ta kemi të fortë celulën, do të kemi të fortë edhe pushtetin. Po ta çmojë se të gjitha punët e fshatit nuk mundet t'i bëjnë vetëm pesë komunistë, atëhere ajo do të aktivizojë patjetër edhe aktivin pa parti, këshillin e pushtetit, njerëzit e Frontit, të organizatës së gruas etj. dhe të gjithë këtë aktiv duhet ta drejtojë Partia. Këshillat duhet të respektohen, të bëjnë mbledhje serioze, të mobilizojnë rininë, të kuptojnë dëshirat e saja, t'ja bëjnë më të mirë jetën rinasë dhe kur të vijnë të rinjtë në qytet, të kenë ndërmend që të marrin material propagandistik për fshatin, për zbukurimin e tij. Po punët nuk bëhen kështu, ato bëhen në mënyrë burokratike. Kështu nuk mund të bëhet Partia sa më luftarake, përkundrazi mbytet dhe vihet në gjumë. Partia jonë është luftarake, po disa kuadro nuk dinë të punojnë dhe të komandojnë ushtrinë e Partisë dhe në qoftë se do të vazhdojmë kështu, e humbëm luftën, pse Partia nuk do të shkojë e pregetitur në luftë. Prandaj Partia duhet të pregetitet mirë për realizimin e planit të mbjelljeve, të korrijeve, të arësimit në fshat, të forcimit të pushtetit. Dhe, që t'i bëjë të gjitha këto Partia, duhet organizimi i mirë i saj dhe këto gjëra t'i bëjë në praktikë dhe t'ua futë në shpirt komunistëve. Duhet të futen në punë njerëzit,

sigurisht ata do të bëjnë edhe gabime, po do të korrigjohen. Po puna është se disa nuk kanë besim në fshatarët, në punëtorët, nuk kanë besim të vënë një punëtor në krye të këshillit të bashkimeve profesionale, pse ai është pa parti dhe, sipas tyre, në këto forume duhet të vihen njerëz që janë anëtarë partie, që mund të kenë edhe 20 detyra të tjera dhe që nuk mund të bëjnë dot asnjë.

Një gjë tjetër që duhet rregulluar, pse është çështje që ka rëndësi, është ajo e udhëheqjes kolegjiale dhe e përgjegjësisë personale. Gjithsecili në Parti ka funksionet e veta të caktuara dhe është përgjegjës për atë që është ngarkuar. Prandaj ai duhet të vejë në komitetin e Partisë me konkluzionet e duhura dhe jo me shfajësimë, pse nuk e ka kryer këtë ose atë punë që i është ngarkuar. Në komitet të Partisë do t'i kërkohet llogari deri në një për kryerjen e detyrave. Nuk duhet të pranoni që ndonjëri të vijë me detyra të parealizuara në mbledhje të komitetit të Partisë dhe të thotë që kjo dhe kjo nuk u bë për këtë dhe për atë arësy. Nësc u muar një vendim nga Partia për një gjë, ai duhet të kryhet dhe përgjegjësi duhet të vijë dhe të thotë që e kreva. Gjatë punës e sidomos kur gjen vështirësi, ai mund të vijë dhe të kërkojë ndihmë nga udhëheqja, po kur të vijë fundi, duhet të thotë se e kreva punën. Partia ka kudo organizatat dhe aparatet e saj dhe me ndihmën e tyre ajo duhet të realizojë çdo gjë. Njëri do të thotë kështu dhe tjetri ashtu, do të ketë vështirësi të ndryshme, por të gjitha ato duhet të kapërcehen me luftë dhe kur të vijë koha, të gjithë të thonë që detyrat u realizuan. Në qoftë se ndonjëri vjen

e thotë në Parti se nuk e realizoi detyrën që i ishte ngarkuar, ai duhet të paraqitë arësy shumë të forta duke analizuar mirë shkaqet e vështirësitë e pakapercyeshme, me gjithë masat e marrura dhe përpjekjet që janë bërë. Dhe në qoftë se realizimi i asaj çështje varej jo vetëm nga ky shok, po edhe nga ndonjë shok tjetër, dhe ky shok nuk ka bërë përpjekje për të dhënë ndihmën e tij, atëherë duhet të merren menjëherë masa për atë shok. Mundet që gjatë mbledhjes, kur jepen rezultatet e detyrave dhe kur shqyrtohen shkaqet e moskryerjes së detyrave, osc edhe më parë, shokëve duhet t'u hiqet vërejtja me qëllim që gjatë punës të mobilizohen për ta kryer detyrën. Por në qoftë se shokët prapë nuk veprojnë, atëherë komiteti i Partisë merr edhe masa dhe, po qe se me gjithë këto masa nuk ecën përpara, atëherë mund të përjashtohet edhe nga Partia. Prandaj në këtë drejtim duhet t'i vihet rëndësi e madhe çështjes së përgjegjësisë personale. Pastaj ti, si sekretar i parë, duhet me qenë shumë rigoroz në kërkimin e llogarisë. Po kështu edhe si komitet i Partisë e si byro, që të bëhet puna e të ndjehen përgjegjësitë që ka secili, duhet që detyrat të kryhen në mënyrë kolegjiale. Mirëpo në këtë rast të mos humbasë edhe përgjegjësia personale, pse ndryshe humbet edhe ajo kolegjiale. Po nuk u punua kështu, nuk mund të ketë as kritikë e as autokritikë; po ashtu edhe ti, po të mos e kryesh mirë detyrën, nuk ke kurajë të kritikosh edhe të tjerët që nuk e kanë kryer atë. Pra, kur njëri është mbi dhogë të kalbur, nuk mund të kritikojë dot të tjerët. Prandaj shokët e sidomos ata të udhëheqjes, duhet të bëjnë sa më pak gabime, po nëse vazhdojnë të bëjnë gabime,

atëhere këta janë fals dhe detyrohen të mos kritikojnë të tjerët. Pra, gabimet që bën njëri ose tjetri shok, të dëgjohen në byro dhe të kritikohen, sepse kritika i shkund njerëzit e nuk lejon që punët të shkojnë keq. Prandaj njerëzit të vihen përpara përgjegjësisë, t'u japoim kompetenca, t'i ndihmojmë, t'i kontrollojmë dhe të marrin edhe vetë përgjegjësi, pse kështu, siç ka ndodhur disa herë, nuk mund të ecet. Të kontrollohen detyrat e secilit dhe të ndiqet zbatimi i tyre dhe ndjekja bëhet në qoftë se detyrat caktohen qartë. Kur ti për shembull ngarkon disa shokë për të studjuar dhe për të sqaruar situatën e bukës në disa fshatra, ti duhet të japësh edhe udhëzime si duhet të punojnë dhe në çmënyrë duhet t'i zgjidhin problemet duke u caktuar edhe kohën. Mirëpo gjatë punës ti duhet ta kontrollosh e ta ndihmosh kuadrin. Në rast se shokët kanë shkuar në fshat dhe kanë biseduar me komunistët, ashtu siç i ka këshilluar Partia, ata nuk do të gabojnë, po do të sjellin rezultate dhe Partia do të jetë dakord me çështjet e zgjidhura. Ndryshe do të ndodhë në rast se misri, kur do të vijë, do të shpërndahet keq. Pra, po të mos jetë bërë mirë kjo punë, Partisë do t'i vijnë patjetër letra nga populli ose nga vetë komunistët, të cilët do të thonë se ai që u ngarkua, nuk e ka bërë mirë punën. Kështu do të zbulohet edhe ai që nuk ka punuar në bazë të udhëzimeve të Partisë.

Tani për çështjen që të thirra, ne do ta shohim me shokët dhe do të vendosim sa më parë.

SEKRETARI: Ne kishim edhe disa gjëra në lidhje me furnizimin e qytetit. Përsa i përket mishit, e siguruan, sepse ka filluar grumbullimi. Po ne nuk jemi

furnizuar akoma as me fasule as me oriz, sheqer, sapun etj.

SHOKU ENVER: Sheqer ka dhe do t'ju dërgohet.

SEKRETARI: Kisha edhe çështjen e furnizimit të qytetit me zarzavate. Gjatë dimrit në plazh ka një numër të madh kursesh. Prodhimet e fshatarësisë të rrethit nuk janë të mjaftueshme, kështu që kemi deficite. Tani ne kemi ngritur nja tri bahçe me 55 hektarë tokë, po megjithkëtë, nevojat e qytetit nuk mund të plotësohen në qoftë se nuk do të na jepet një sasi nga fermat e rrethit tonë.

SHOKU ENVER: Me zárzavate jemi shumë të shtëranguar, po do ta shikojmë.

SEKRETARI: Do të ishte mirë të na jepeshin dy maqina për të përballuar nevojat e qytetit duke blerë në tregjet e rretheve të tjera. Kështu mund të sigurojmë shumë gjëra p.sh. patatet në Korçë.

SHOKU ENVER: Po të marrim patate për Tirana, do t'ju japim dhe juve.

SEKRETARI: Po të kishim mjete, do të bënim diçka siç bëjmë ditët e festave, kur u kërkojmë maqinat drejtoreve të ndërmarrjeve dhe vemë e blejmë ushqime në rrethet e tjera.

SHOKU ENVER: Po djathë keni?

SEKRETARI: Jo, nuk kemi; vaj na ka ardhur dhe peshk kemi pak.

SHOKU ENVER: Për peshkun e keni vetë fajin. Partia duhet të bëjë një punë të veçantë politike me peshkatarët, pse ky prodhim ka mjaft rëndësi.

SEKRETARI: Ne kemi një dobësi që nuk kemi komunistë në radhët e peshkatarëve. Ne kishim propo-

zuar të kishim një punëtor politik në grupin e peshkatarëve, po nuk u aprovua. Peshkatarët shkojnë e gjuajnë me barka në Vlorë e gjetkë.

SHOKU ENVER: Këtë gjë do ta shohim, po ku do të rrijë ai më shumë?

SEKRETARI: Në Vlorë, sepse në Durrës rrinë vetëm ata të transportit. Ky të rrijë atje ku janë barkat dhe të lidhet me komitetin e Partisë të territorit ku gjuhet peshku. Çështjen e strehimit nuk mund ta zgjedhim dot shpejt dhe në këtë sektor janë bërë plot dallavere, megjithëse janë goditur mjaft njerëz. Tani na u bënë disa shtesa në buxhet për ndërtim shtëpish të reja.

SHOKU ENVER: Tirana tani do të marrë disa masa për çështje të strehimit, prandaj të keni kujdes të fitoni edhe ju nga kjo eksperiencë. Kini kujdes edhe për familjet e marinarëve, të strehohen.

SEKRETARI: Ata i kanë në fshat familjet e tyre, prandaj nuk u kemi dhënë shtëpi.

SHOKU ENVER: Në strehim duhet të vini njerëz të ndershëm dhe të pakorruptueshëm që të zbatojnë drejt vijën e Partisë. Sigurisht të tërë nuk mund t'i kënaqim, po duhet të evitojmë padrejtësitë dhe sa kemi mundësi, aq do të bëjmë. Nuk duhet të lejohet që ata të strehimit të përkrahin miqtë e tyre duke bërë që disa të rrinë lirë, ndërsa të tjerët t'i lënë pa strehuar.

*Botohet për herë të parë sipas
procesverbalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

LETËR FALENDERIMI DËRGUAR PIONIERËVE TË SHKOLËS SË LUKOVËS¹

17 shkurt 1952

ÇETËS SË PIONIERËVE TË LUKOVËS

Ju falenderoj nga zemra të gjithë ju pionierë të fshatit Lukovë për dhuratën e bukur që më dërguat.

Uroj që për familjet tuaja, viti i ardhshëm të jetë edhe shumë më i frutshëm në zhvillimin dhe prodhimin e portokallave, limonave etj., që kështu jeta juaj të bëhet më e begatshme, që të zhduken përgjithmonë nga zemrat tuaja të pastra e të njoma çdo brengë e çdo mërzi, që të keni ç'të dëshironi, që të rroni të lirë, të lumtur, në paqe, në atdheun tonë të lirë, të bukur e të shtrenjtë.

Të doni me gjithë shpirt Partinë që udhëheq popullin tonë në rrugën e jetës së lumtur, në socializëm, t'i doni Partinë e Stalinin e madh me gjithë shpirt, pse ata janë çdo gjë për njerëzit, ata janë socializmi, komunizmi, rinia e njerëzimit.

Partia dhe qeveria, që udhëheqin popullin tonë, lutojnë me këmbëngulje për të ardhshmen tuaj të begat-

¹ Fshat në rrëthin e Sarandës.

shme dhe për paqen. Ne do të fitojmë. Populli me Partinë kurdoherë do të korrin fitore. Dhe ju, si bij të denjë të popullit tonë trim dhe të Partisë sonë heroike, duhet të mësoni, kurdoherë të mësoni dhe vazhdimisht të mësoni, pse vendi ynë ka shumë nevojë për njerëz të mësuar dhe dituria në djemtë e popullit është arma e fortë, me të cilën do të ndërtojmë më shpejt socializmin.

Ju përqafoj

Miku juaj besnik

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë si
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

**TELEGRAM URIMI DËRGUAR SHOKUT
MATIAS RAKOSHI ME RASTIN E 60-VJETORIT
TË DITËLINDJES**

9 mars 1952

**SHOKUT MATIAS RAKOSHI
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I PARTISË SË PUNONJËSVE
HUNGAREZE**

Budapest

Me rastin e 60-vjetorit të ditëlindjes Suaj, më lejoni t'Ju drejtoj përshëndetjet më të singerta të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, të popullit shqiptar dhe të miat personalisht. Populli shqiptar njeh te Ju, shoku Rakoshi, drejtuesin e madh të klasës punëtore hungareze, udhëheqësin e sprovuar të partisë dhe të popullit vëlla hungarez si dhe mikun e shtrenjtë dhe të singertë pér forcimin e vazhdueshëm të miqësisë dhe të bashkëpunimit në mes të dy popujve tanë vëllezër. Partia dhe të gjithë punonjësit tanë Ju urojnë shëndet të mirë dhe jetë të gjatë pér të mirën e popullit hungarez, i cili nën udhëheqjen Tuaj lufton me vetë-

mohim për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e paqes i ndihmuar nga Bashkimi i lavdishëm Sovjetik dhe Stalini i madh.

Sekretari i Përgjithshëm i Partisë
së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 59 (1067), 9 mars 1952*

*Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 59 (1067),
9 mars 1952*

RAPORT NË KONGRESIN II TË PPSH
«MBI AKTIVITETIN E KOMITETIT QENDROR
TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË»

31 mars 1952

Shokë,

Tre vjet e disa muaj na ndajnë nga Kongresi I i Partisë, kohë mjaft e shkurtër për veprimtarinë e një partie dhe sidomos të një populli. Por gjatë kësaj kohe të shkurtër, populli shqiptar i udhëhequr nga Partia e tij heroike, ka korrur suksese të rëndësishme në ekonomi, në lëmin shoqëror dhe kultural. Vendi ynë, me hapa të mëdhenj dhe të sigurtë, ka ecur përpara drejt përparimt, ka ndërtuar një jetë çdo ditë e më të mirë, ka forcuar çdo ditë e më shumë fuqinë ekonomike dhe atë të mbrojtjes së atdheut të tij. Çdo gjë ka treguar qartë gjallërinë e madhe të popullit tonë dhe vijën e drejtë të Partisë së Punës të Shqipërisë që, duke ndjekur me besnikëri mësimet e Leninit dhe të Stalinit, udhëheq me sukses popullin tonë në rrugën e socializmit.

Gjatë kësaj periudhe të shkurtër janë zhvilluar, si jashtë dhe brenda vendit tonë, ngjarje me rëndësi që populli dhe Partia jonë i kanë jetuar me intensitet të madh.

I

SITUATA NDËRKOMBËTARE

Detyra të rëndësishme i vihen popullit dhe Partisë sonë përpara situatave ndërkombëtare që po zhvillohen, për arësy se këto situata ndërkombëtare influencojnë shumë mbi konditat e brendshme politike, ekonomike dhe shoqërore, për arësy se agresorët imperialistë amerikanë dhe anglezë, me satelitet e tyre, turbullojnë jetën paqësore të popujve, sulmojnë dhe gjakosin popujt e botës dhe preqatitin një kasaphanë të tretë botërore për njerëzimin.

Përpara situatave të tilla të rënda popujt liridashës nuk mund të qëndrojnë duarlidhur dhe të mos mbrojnë interesat e tyre, nuk mund të mos veprojnë me gjallërinë më të madhe për të mbrojtur interesat e paqes dhe të pengojnë krimet e shëmtuara të imperialistëve gjakatarë.

Është e natyrshme dhe legjitime që populli ynë, i cili bën pjesë në kampin e madh e të pamposhtur të paqes, të mbrojë me heroizëm ndërtimin paqësor dhe socialist të vendit të tij. Për këtë arësy ne duhet të ndjekim me kujdesin dhe vigjilencën më të madhe zhvilimin e situatave ndërkombëtare, të sqarojmë vazhdimi shësht masat e gjera të popullit mbi çka po ngjet në botë, mbi tendencat e forcave që përcaktojnë situatat

ndërkombëtare dhe t'u tregojmë njëkohësisht rrugën dhe masat që duhet të marrin për të mposhtur rrezikun e madh që kërcënon botën nga një gjakderdhje tjetër e tmerrshme që preqatitin imperialistët amerikanë dhe shërbëtorët e tyre.

Është e qartë për të gjithë se politika aventuriere dhe kriminale e qeverisë së Shteteve të Bashkuara dhe e të gjitha shteteve që janë nën zapin e fashistëve amerikanë, e ndërlikon çdo ditë e më shumë situatën ndërkombëtare, e bën këtë më të rëndë. Cilat janë arësyet e këtij tensioni të vazhdueshëm? Arësyet qëndrojnë vetëm në agresivitetin e egër të imperializmit amerikan, i cili dëshiron të dominojë botën, të skullavë-rojë popujt dhe t'i shfrytëzojë ata deri në palcë. Imperializmi amerikan është mahur me gjakun e popujve, është mahur me luftërat e ndryshme imperialiste që janë zhvilluar, jo në strofkën e tij, por në vendet e tjera të botës. Këto luftëra të padrejta dhe shfarosëse për njerëzimin, janë preqatitur prej imperialistëve dhe imperializmi amerikan ka fituar pjesën e luanit. Imperializmi amerikan është bërë furnizuesi, spekuluesi, «tre-gëtari i vdekjes» dhc i mjerimit në botë. Imperializmi amerikan për të arritur synimet e tij të pasurimit dhe të dominimit të botës është përpjekur dhe vazhdimisht përpjekur ta bëjë luftën me duart dhe me gjakun e të tjerëve. Shoku Stalin ka thënë:

«...provokatarët e luftës janë mësuar t'i nxjerrin gështenjat nga zjarri me duart e të tjerëve...»¹.

¹ J. V. Stalin, Veprat, vell. 14, f. 211;

Kjo politikë e luftës agresive dhe këto principe barbare frymëzojnë për veprim imperialistët amerikanë me Herri Trumanin¹ në krye. Manjatët e Uoll Strit-it² përpiken të hedhin në duart e tyre të gjitha burimet e lëndëve të para, të pushtojnë të gjitha tregjet botërore dhe të bëjnë ligjin e tyre në to. Kjo i shtyn këta miliarderë të organizojnë luftëra të reja agresive, jo vetëm me anën e konkurencës politike dhe ekonomike, por sidomos me metodën e dominimit, me anë të armëve dhe të zjarrit. Metoda të tilla të luftës, jo vetëm që nuk i zhdukin kontradiktat e mëdha që ekzistojnë në gjirin e kapitalizmit, por i thellojnë akoma më shumë se zhvillimi i vendeve kapitaliste, në epokën e sotme — sikundër e ka shpjeguar Lenini në librin e tij të famshëm «Mbi imperializmin» — zhvillohet në mënyrë të pabarabartë, nëpërmjet krizash dhe konfliktesh ndërkombëtare dhe vende të ndryshme luftojnë për të zhdukur konkurentët e tyre, për të siguruar një ndarje të re të kolonive, tregjet botërore dhe lëndët e para.

Në Luftën e parë botërore, që u shkaktua nga kontradiktat midis shteteve imperialiste, u shkatërruan shtete imperialiste si Austro-Hungaria dhe Rusia cariste. Për

¹ President i SHBA-së që nga viti 1945—1953. Nën qeverimin e tij SHBA organizuan paktin agresiv të Atlantikut Vëtor dhe në vitin 1950—1953 organizuan intervencionin ushtarak kundër RDP të Koresë.

² Rrugë në Nju-Jork (SHBA) ku janë vendosur bankat e mëdha, bursa etj. Emri Uoll Strit është bërë sinonimi i kapitalit financiar amerikan, oligarkisë financiare amerikane që përcakton politikën e jashtme agresive dhe politikën e brendshme reaksionare në SHBA.

një kohë Italia dhe Gjermania u dobësuan, Amerika dhe Japonia u pasuruan për së tepërmi. Lufta e dobësoi tepër gjithashtu Anglinë dhe Francën. Por sidomos pësroi një disfatë të madhe, të pariparueshme sistemi imperialist në tërësi, për arësyse se Revolucioni i madh i Tectorit, krijoj shtetin e parë proletar në botë, Bashkimin e lavdishëm Sovjetik, çlroi nga thonjtë e imperializmit një të gjashtën e botës. Intervencioni i armatosur i 14 shteteve imperialiste kundër shtetit të parë socialist në botë dështoi dhe Bashkimi Sovjetik triumfoi mbi të gjitha rreziqet. Që në atë kohë ekonomia botërore u nda në dy sisteme: sistemi kapitalist dhe sistemi socialist. Sistemi socialist shkoi duke u forcuar çdo ditë nga ana politike, ekonomike dhe kulturale dhe i tregoi botës, në mënyrë të pakundërshtueshme, superioritetin e tij mbi sistemin kapitalist, në gjirin e të cilit vazhdimisht dhe periodikisht shpërthejnë kriza të mëdha ekonomike.

Lufta e dytë botërore tregoi edhe një herë tjetër forcën e pamposhtur të Bashkimit Sovjetik, vitalitetin dhe superioritetin e sistemit socialist triumfues, në saje të të cilit u shkatërruan dhe u mundën tmerrësisht Gjermania hitleriane dhe Japonia militariste. Bashkimi Sovjetik doli nga Lufta e dytë botërore më i fortë se kurrë. Bashkimi Sovjetik ndihmoi vendet e demokracisë popullore që të çliroheshin nga thundra e fashizmit dhe e kapitalit. Në saje të luftës heroike që bëri populli i madh kinez i udhëhequr nga PK e Kinës dhe të ndihmës së Bashkimit Sovjetik u çlirua Kina heroike. Kurse nga ana tjetër sistemi kapitalist shkoi duke u dobësuar dhe duke u zhytur në kriza dhe në kontradikta të mëdha në gjirin e tij. Pas Luftës së dytë botërore, ne konsta-

tojmë dobësimin akoma më të madh të imperializmit anglez, të atij francez, japonez, italian etj.

Në këtë dobësim të përgjithshëm të imperializmit, si ka thënë shoku Stalin:

«Tani qendër e shfrytëzimit financiar të botës janë, kryesisht, Shtetet e Bashkuara të Amerikës së Veriut»¹.

Për arësyen e zhvillimit të pabarabartë të vendeve kapitaliste, Shtetet e Bashkuara u bënë bankieri më i fuqishëm i botës kapitaliste. Lenini thoshte: *«Në çdo dollar ka gjurmë gjaku»²*.

Në rast se ushtarët amerikanë nuk morën pjesë në këto dy luftëra të mëdha botërore, ose morën pjesë vetëm kur davaja po merrte fund, dollari amerikan ka marrë pjesë në luftë vazhdimi. Amerikanët kanë furnizuar me armë e me municion të gjithë imperialistët e tjerë që përlesheshin në luftëra të përgjakshme. Politika djallëzore e dollarit amerikan, si në kohën e Luftës së dytë botërore, ashtu edhe në atë të Luftës së parë, është e qartë. Megjithëse Amerika hyri në Luftën e parë botërore nga fundi, si kundërshtar i Gjermanisë së Kaizerit³, ajo në periudhën pas Luftës së parë financoi pa pushim potencialin ushtarak të Rajhut

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 7, f. 268.

² V. I. Lenin. Veprat, vëll. 28, f. 54.

³ Kështu quhej perandori në Gjermani që nga viti 1870 deri në vitin 1918.

të tretë¹, ajo financoi Hitlerin dhe manjatët e Ruhrit², ajo militarizoi Gjermaninë. Gjithashtu edhe në Luftën e dytë botërore Amerika hyri në luftë gati në fund kundër Gjermanisë. Tani në periudhën pas Luftës së dytë botërore, ajo është bërë furnizuesja e Gjermanisë së Bonit, ajo po e armatos këtë pjesë të Gjermanisë, ajo po mëkëmb fashizmin dhe po rikrijon Vermahtin gjerman³ për një luftë tjeter kundër Bashkimit Sovjetik dhc demokrative popullore.

Kampi imperialist, luftënxitës, me imperializmin amerikan në krye, po intensifikon preqatitjen e një lufte të re botërore kundër kampit të socializmit dhe të paqes, kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore. Nuk është aspak e habitshme që imperialistët amerikano-anglezë filluan në ethe këto preqatitje lufte në një kohë kur Lufta e dytë botërore akoma nuk kishte mbaruar dhe plagët e tmerrshme të luftës akoma nuk ishin mbyllur. Ndërsa Bashkimi Sovjetik, që çlroi botën nga zgjedha fashiste, pësoi aq humbje të mëdha në njerëz dhe në material dhe kur vendet e demokracisë popullore me ndihmën e tij rindërtonin gërmadhat që u kishte shkaktuar lufta, imperialistët amerikano-anglezë, mendonin dhe punonin për preqatitjen e shpejtë

¹ «Perandoria e tretë» — kështu e quanin fashistët gjermanë, Gjermaninë hitleriane.

² Zonë industriale në Gjermaninë Perëndimore ku ishte dhe është përqëndruar industria e rëndë dhe sidomos ajo e prodhimit të armatimeve.

³ Vermaht (gjermanisht) — forcat e armatosura, që u shtria gjermano-fashiste në periudhën e diktaturës hitleriane.

të një lufte të re botërore, mendonin për skllavërimin e popujve, për grabitjen e lirisë dhe të pasurive të tyre.

Pas Luftës së dytë botërore, të gjithë konkurrentët kapitalistë të Shteteve të Bashkuara pësuan disfata dhe ata u detyruan t'i nënshtrohen si në pikëpamje ekonomike, financiare, ashtu edhe në pikëpamje politike kapitalit amerikan, i cili është bërë një fuqi dominuese në blokun imperialist. Ky raport forcash në kampin imperialist, ku dominon kapitali amerikan, ka ashpërsuar edhe ca më tepër kontradiktat në gjirin e sistemit kapitalist si dhe ato në mes të kampit të socializmit dhe atij të kapitalizmit në përgjithësi.

Imperialistët e kanë halë në sy Bashkimin Sovjetik, prandaj ata preqiten dhe armatosen për një luftë të re kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore. Pra rreziku i një lufte të re botërore kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore po shtohet.

Por fakti se imperializmi amerikan është bërë forca dominuese dhe drejtuese e kampit imperialist a tregon forcimin e sistemit kapitalist? Jo, aspak. Ai tregon të kundërtën: dobësimin e sistemit kapitalist dhe shtimin e kontradiktave në gjirin e tij. Vetëm klika e Titos dhe gangsterët e tjerë të Uoll Strit-it, monarko-fashistët e Athinës dhe fashistët e Romës, me gjithë kriminelët shqiptarë të luftës pretendojnë gjepura të tillë. Ndjekja me kujdes e zhvillimit të ngjarjeve ndërkombëtare na tregon haptas se me gjithë terrorin amerikan në të gjitha vendet e marshallizuara dhe në vendet koloniale, me gjithë kërcënimet dhe presionet politike, financiare

etj., të amerikanëve, kontradiktat në mes ujqërve imperialistë janë të mëdha.

Teoritë e kalemxhinjve dhe të duaxhinjve të amerikanëve, që pretendojnë se kapitalizmi ka arritur një farë stabiliteti, për arësyse se një shtet imperialist ka fituar superioritet në rivalitetin e shteteve të tjera imperialiste, duke hedhur në dorë burimet e lëndëve të para dhe të tregjeve botërore, janë gënjeshra dhe pa baza. Këto teori të imperializmit predikojnë se gjoja sistemi kapitalist në përgjithësi ka hyrë në një fazë të re ku ekonomia kapitaliste do të rregullohet këtej e tutje pa luftëra për ndarjen e botës në mes bloqeve kundërshtare të shteteve kapitaliste. Në këtë mënyrë, sipas këtyre teorive fashiste amerikane, «janë zhdukur kontradiktat që e minonin botën kapitaliste nga brenda». Këto teori skllavëruese amerikane shoqëruan planin famëkeq Marshall që futi nën kthetra popujt e vendeve të Evropës Perëndimore dhe shumë vende të tjera në kontinentet e ndryshme dhe i siguroi oligarkisë financiare të Amerikës një nënshtrim të madh të këtyre shteteve, duke shkaktuar varfërimin e tmerrshëm të klasës punëtore dhe të masave punonjëse të këtyre vendeve, shndërrroi industrinë dhe gjithë ekonominë e këtyre vendeve në një industri dhe ekonomi lufte. Plani Marshall, që vuri nën thundrën e miliarderëve amerikanë, si finansiarisht dhe ekonomikisht, të gjithë ekonominë e këtyre vendeve, gjë që qeveritarët tradhëtarë ua imponuan popujve të tyre, nuk mund të këtë zhdukur kontradiktat që ekzistojnë në mes partnerit amerikan nga një anë dhe satellitëve të tij të kolonizuar nga ana tjetër. Jo, kontradiktat nuk janë shuar, por janë shtuar shumë dhe provat

janë të gjalla si në Angli, në Francë, në Itali, ashtu dhe në vendet e varura koloniale e gjysmëkoloniale. Plani Marshall ishte preqatitja në hyrjen e Paktit agresiv të Atlantikut, domethënë i blokut luftënxitës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye.

Imperialistët amerikanë dhe anglezë, duke ndjekur shembullin e agresorëve hitlerianë, u imponojnë popujve të Shteteve të Bashkuara, Anglisë, Francës, Gjermanisë Perëndimore, Italisë, Greqisë, Jugosllavisë dhe shumë popujve të tjerë të Perëndimit, politikën e preqatitjes së luftës dhe e futin ekonominë e këtyre vendeve në ekonominë e tyre të luftës. Në këto vende janë shtuar jashtëzakonisht taksat, janë ngritur çmimet e çdo gjëje të nevojshme për jetesën e masave punonjëse, të cilat rrojnë në mjerim e varfëri të tmerrshme. Në këto vende, ku sundojnë amerikanët si dhe në vetë Shtetet e Bashkuara, papunësia ka arritur në një shkallë të padëgjuar ndonjëherë. Kjo politikë lufte, natyrisht, shoqërohet me masa policore nga më fashistet, nga më të egrat, që ua kalojnë veprimeve të Gestapos. Njerëzit përparimtarë, njerëzit që mbrojnë paqen, persekuohen në mënyrën më barbare në Shtetet e Bashkuara dhe në të gjitha vendet e marshallizuara.

Bota kapitaliste shkon duke u zvogëluar, fusha e ekspluatimit kapitalist po ngushtohet, sidomos në Evropë dhe në Azi, ku pas Luftës së dytë botërore u çliruan vendet e demokracisë populllore dhe Kina e madhe e Mao Ce Dunit. Nga ana tjetër, lëvizja nacional-çlirimtare ka shpërthyer në të katër anët e kontinentit aziatik dhe afrikan kundër sunduesve kolonialistë dhe lufta për çlirim është forcuar dhe shtohet çdo ditë në vendet kapi-

taliste, ku masat e popullit te udhëhequra nga partite komuniste, ndjekin luftën e tyre te çlirimit me forca te shumëfishuara kundër pushtuesve amerikanë dhe qeveritarëve te tyre te shitur. Këto janë arësyet që i shtyjnë imperialistët amerikanë te preqatiten në ethe për luftë, te ndërtojnë buxhete kolosale për luftë dhe për armatime, te urdhërojnë satelitët e tyre te armatosen dhe te ndjekin një politikë te luftës që i çon në varfërinë më te madhe popujt e tyre. Kjo është arësyja që, si dhe herët e tjera, imperialistët amerikano-anglezë po rikrijojnë Vermahtin, po lirojnë nga burgjet te gjithë gjeneralët fashistë te Hitlerit, te gjithë industrialistët e mëdhenj te Ruhrit dhe i futin në shërbimin e tyre, krijojnë «Ushtrinë Evropjane»¹, paktet e ndryshme, te hapëta dhe te fshehta, anekse te Paktit agresiv te Atlantikut Verior. Kjo është arësyja që imperialistët amerikanë dhe satelitët e tyre, nënshkruan paqen e veçuar me Japoninë, për të pasur në këtë vend një bazë te tyre agresioni, për të ringjallur ushtrinë fashiste japo-neze dhe për ta hedhur këtë në luftë kundër kampit te paqes dhe te socializmit.

Forcat e botës socialiste u shtuan dhe u forcuan dhe për këtë arësyje imperializmi dëshiron dhe bën çdo përpjekje që këtë zhvillim te fuqishëm te socializ-

¹ Kështu do te quheshin forcat e armatosura te «Komunitetit evropjan te mbrojtjes» që u krijuar sipas marrëveshjes që arriti më 27 maj 1952 përfaqësuesit e Francës, Italisë, Gjermanisë Perëndimore, Belgjikës, Hollandës dhe Luksemburgut. Sipas kësaj marrëveshjeje këto forca kalonin nën drejtimin e Komandës Supreme te Paktit agresiv te Atlantikut Verior (NATO).

mit ta pengojë dhe ta ndalojë me anë të forcës dhe të zjarrit. Duke parë humbjen e tyre të sigurtë, imperialistët kërkojnë të zgjatin jetën e sistemit të tyre të kalbëzuar në kulm dhe këtë, natyrisht, ata duan ta bëjnë duke e hedhur botën në një luftë të re. Dhe ata e kanë filluar këtë luftë kundër popullit heroik dhe të lavdishëm të Koresë. Ka gati dy vjet që barbarët fashistë amerikanë nën flamurin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, sulmuan popullin heroik dhe paqedashës korean. Amerikanët po zhvillojnë atje një luftë të egër e barbare dhe përdorin ndaj popullsisë paqësore mjete e metoda shfarosëse që ua kalojnë metodave hitleriane. Ata e kanë bërë Korenë heroike shkrumb e hi. Ata vraasin pa mëshirë gra, pleq, kalamanë, ata përdorin në shkallë të gjérë armën e tmerrshme bakteriologjike për të shfarosur popullin korean, ushtrinë heroike të Koresë dhe vullnetarët e lavdishëm të popullit të madh kinez. Këto bisha me fytyrë njeriu, këta kriminelë lufte të përbindshëm, janë armiqtë më të egër të të gjithë njerëzimit përparimtar. Por me gjithë këto tmerre të padëgjuara ndonjëherë në historinë e njerëziunit, imperialistët amerikanë nuk kanë mundur në asnjë mënyrë të përulin vullnetin e popullit korean dhe të ushtrisë së tij heroike. Koreja e lavdishme është e pamposhtur, ajo do të fitojë mbi barbarët imperialistë, kauza e shenjtë e popullit korean do të fitojë, pse ajo është e drejtë dhe se me të janë të gjithë popujt e botës, pse armiqtë e egër të popullit korean janë armiqtë e çdo njeriu të thjeshtë dhe të ndershëm në botë.

Imperialistët amerikanë e anglezë, kur sulmuan Republikën Demokratike Popullore të Koresë, menduan

se, duke e mposhtur shpejt këtë popull heroik, do të mundnin më me lehtësi të vazhdonin agresionin e tyre kundër Kinës. Ata, natyrisht, dështuan dhe jo vetëm që nuk bëjnë dot një hap përpara, por pësojnë disfatë pas disfate. Përdorimi i mjeteve shfarosëse kundër popullit korean nuk tregon veçse dobësinë e madhe të tyre që me siguri do të transformohet në një katastrofë për imperialistët. Duhet ndalur dora e kriminelëve. Populli shqiptar proteston në mënyrën më energjike kundër përdorimit të armëve bakteriologjike në Kore nga ana e gjakatarëve amerikanë dhe i konsideron këta kriminelë si bisha nga më të egrat, mbi të cilët duhet të bjerë e pamëshirshme drejtësia e popujve për t'i shfarosur pa nishan.

Shantazhet dhe kërcënimet e imperialistëve amerikanë kanë për qëllim të përhapin gjenjeshtrën, pasigurinë, frikën, panikun në njerëzit e thjeshtë dhe për t'i bërë këta të besojnë se çdo rezistencë e tyre është e kotë. Me këto metoda luftënxitësit amerikanë dëshirojnë të mbulojnë burimin e vërtetë të këtyre krimeve dhe të këtyre prekatitjeve të ethshme për luftë. Por njerëzit me nerva të fortë, njerëzit e thjeshtë dhe të ndershëm në botë, i shohin dhe i kuptojnë çështjet ndryshe. Ata janë të sigurtë se fitorja është e popujve, se lufta nuk është e paevitueshme.

Çdo njeri i ndershëm në botë, pavarësisht nga pikëpamjet e tija politike ose besimet fetare, e gjykon rrezikun e madh që kërcënon botën nga politika aventuriere dhe luftëdashëse e imperialistëve amerikano-anglezë dhe kjo politikë e revolton, e shqetëson. Asnjeli nuk e nënvleftëson këtë rrezik të madh dhe ky

është shkaku i zgjerimit, i forcimit kurdoherë e më shumë të lëvizjes madhështore të partizanëve të paqes. Kurrë nuk ka ekzistuar një lëvizje e tillë në një shkallë ndërkombejtare. Kjo tregon ndërgjegjen e lartë të njerëzve të thjeshtë e të ndershëm, të influencuar nga politika e lavdishme paqësore staliniane, të cilët e kanë të gjallë kujtimin e tmerreve të luftës së fundit që i shkaktoi botës aq shumë mjerime. Popujt e botës janë kundër luftërave agresive që shpërthejnë imperialistët, pse ato janë një nevojë dhe një shpresë vetëm për imperialistët, për vrasësit, për pasanikët, për tiranët e popujve. Popujt, gjithashtu, e kanë kuptuar se lufta është një provë e pamohueshme e falimentimit dhe e shkatërrimit të regjimit shoqëror kapitalist. Popujt janë të bindur se lufta mund të evitohet.

Në pyetjen, nëse një luftë e re botërore është e paevitueshme, shoku Stalin jep përgjegjen e mëposhtme:

«Jo. Të paktën sot për sot ajo nuk mund të quhet e pashmangshme.

Sigurisht, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Angli, si dhe në Francë, ka forca aggressive të etura për një luftë të re. Atyre u duhet lufta për të nxjerrë superfitime, për të plaçkitur vendet e tjera. Këta janë miliarderët e milionerët që e shikojnë luftën si një kapitull të ardhurash që jep fitime kolosale»¹.

¹ J. V. Stalin. Intervistë dhënë korrespondentit të gazetës «Pravda». «Pravda», Nr. 48 (11885), 17 shkurt 1951.

Fjalët që ka thënë shoku Stalin se

«Paqja do tē ruhet dhe do tē forcohet në qoftë se popujt do ta marrin në duart e veta çështjen e ruajtjes së paqes dhe do ta mbrojnë atë deri në fund»¹,

janë bërë flamur i luftës së popujve për mbrojtjen e paqes.

Eshtë, pra, urgjente për popujt tē mbrojnë me të gjitha forcat e tyre paqen në botë. Eshtë e domosdoshme tē intensifikojmë luftën tonë për paqen dhe tē demaskojmë pa mëshirë q'fshihet prapa fjalëve demagogjike tē lufténxitësve amerikano-anglezë dhe tē satelitëve tē tyre. Propaganda jonë duhet tē mbështetet mbi eksperiencën e masave që kanë vuajtur krimet dhe tmerret e nazistëve, tē fashistëve italianë, tē ballistëve dhe tē zogistëve, me të cilët përsëri amerikanët dhe satelitët e tyre duan tē përsëritin kasaphanën. T'u kujtojmë masave tē popullit 4 shkurtin, Borovën, Përmetin, krahina tē tëra tē Kurveleshit, tē Mallakastrës, tē Pezës, tē djegura e tē përvëluara, t'u kujtojmë pushkatimet e popullit tē pambrojtur, tē pleqve, tē grave, tē kalamanëve nga fashistët gjermanë dhe nga kukslingerët, t'u kujtojmë atyre miliona heronj tē lavdishëm sovjetikë, heronjtë e popullit tonë, tē vendeve tē demokracisë popullore, tē Kinës së Mao Ce Dunit, tē Koresë heroike, tē Spanjës, tē Greqisë, tē popujve

¹ J. V. Stalin. Intervistë dhënë korrespondentit të gazetës «Pravda». «Pravda», Nr. 48 (11885), 17 shkurt 1951.

francez, italian etj. që ranë në fushën e nderit për lirinë e popujve; t'u kujtojmë atyre luftëtarin heroik të popullit grek shokun Nikos Belojanis¹ që xhelatët e Athinës e pushkatuan dje në mëngjes.

Për të nderuar kujtimin e paharrueshmër të shokut tonë të dashur dhe heroik grek, Nikos Belojanis, ftoj kongresin e Partisë, të mbajë një minutë heshtje në shenjë dashurie dhe miqësie të pathyeshme me popullin vëlla grek.

T'u tregojmë masave të gjera të popullit tonë se këto barbarizma kërkojnë t'i vazhdojnë dhe t'i përsëritin në një shkallë akoma më barbare amerikanët dhe shërbëtorët e tyre.

Imperialistët dhe shërbëtorët e tyre propagandojnë se gjoja politika e armatimeve ka për qëllim të sigurojë paqen. Kjo është një hipokrizi e poshtër, pse armatimet nuk mund të çojnë veçse në shpërthimin e luftës.

Bashkimi Sovjetik ka ndjekur dhe ndjek vazhdëmisht një politikë konsekiente paqësore dhe kjo politikë paqësore është bërë drita që ndriçon rrugën dhe udhëheq aksionet e guximshme të qindra e qindra miliona njerëzve që luftojnë të grumbulluar në lëvizjen botërore të partizanëve të paqes.

Që në lindjen e tij Bashkimi Sovjetik u bë kam-

¹ Nikos Belojanis (1915—1952) Hero Kombëtar i popullit grek. Anëtar i KQ të PKG. Në 1943—1944 udhëhoqi në Peloponez luftën e patriotëve grekë kundër pushtuesve fashistë italo-gjermanë dhe më 1946—1949 luftën kundër imperialistëve anglo-amerikanë dhe agjentëve të tyre grekë. Në vitin 1951 u arrestua dhe u dënuar me vdekje. U pushkatua më 30 mars 1952 me urdhër të qeverisë Plastiras-Venizello.

pioni i mbrojtjes së paqes. Një nga parullat e mëdha të Revolucionit të madh të Tectorit ishte lufta për paqen. Lenini dhe Stalini ishin flamurtarët e kësaj politike për paqen dhe këta i treguan klasës punëtore dhe popujve ku qëndrojnë arësyet e luftërave dhe si duhet të luftojnë, t'i pengojnë dhe t'i zhdukin këto. Tridhjet-ekatër vjet me radhë Bashkimi Sovjetik po zbaton me këmbëngulje dhe me sukses këtë politikë paqësore. Në të gjitha konferencat ndërkombëtare, Bashkimi Sovjetik ka mbrojtur kurdoherë tezën e çarmatimit, tezën e bashkëpunimit paqësor në mes të popujve me sisteme shoqërore të ndryshme. Përpjekjet e Bashkimit Sovjetik kanë qenë të mëdha, pas Luftës së dytë botërore, për të vendosur paqen e drejtë dhe demokratike, për të rregulluar çështjen gjermane, duke zbatuar vendimet e Potsdamit dhe për nënshkrimin e një traktati paqeje me Japoninë. Nota e datës 10 mars të këtij viti¹, drejtuar qeverive të Shteteve të Bashkuara, Anglisë dhe Francës, është një akt me shumë rëndësi, është një instrument i madh paqësor, me të cilin qeveria e Bashkimit Sovjetik kërkon që të nënshkruhet sa më parë traktati i paqes me Gjermaninë, traktat i drejtë dhe demokratik që do të largojë kërcënimet e luftës në Evropë dhe në botë.

Kanë qenë dhe janë të mëdha përpjekjet e Bashkimit Sovjetik për të pushuar luftën dhe për vendosjen e paqes në Kore, për çarmatin e përgjithshëm, për ndalimin e menjëhershëm të armës atomike, për demas-

¹ Është fjala për notën e qeverisë sovjetike në lidhje me çështjen e preqatitjes së traktatit të paqes me Gjermaninë.

kimin e Paktit agresiv të Atlantikut Verior dhe të traktateve anekse të hapëta ose të fshehta të tij, për nënshkrimin e një pakti paqeje në mes të pesë fuqive të mëdha.

Por të gjitha këto propozime paqësore të Bashkimit Sovjetik, hasin në kundërshtimin sistematik të imperialistëve amerikano-anglezë e të satelitëve të tyre, të cilët e kanë shndërruar Organizatën e Kombeve të Bashkuara në një instrument lufte dhe në një mjet për të mbrojtur agresorët.

Politika paqësore staliniane ka bërë me vete të gjithë popujt përparimtarë të botës dhe ka demaskuar në sytë e njerëzimit qëllimet e vërteta që fshihen nën fjalët dhe nën aktet e qeveritarëve amerikanë, anglezë dhe të shërbëtorëve të tyre. Por politika paqësore e Bashkimit Sovjetik nuk gjen shprehjen e saj vetëm në qëndrimet e drejta të politikës së jashtme dhe në luftën që zhvillohet në arenën ndërkombëtare për demaskimin e agresorëve imperialistë, ajo shprehet edhe në veprat e ndërtimit të komunizmit, në lulëzimin e jetës në atdheun e socializmit. Realizimet e mëdha në Bashkimin Sovjetik, kanë mbushur me gëzim dhe me besim zemrat e të gjithë njerëzve të ndershëm në botë.

II

LUFTA E POPULLIT SHQIPTAR PËR MBROJTJEN E PAQES, TË INDIPENDENCES SË TIJ DHE PËR NDËRTIMIN E BAZAVE TË SOCIALIZMIT

Populli shqiptar ka vënë të gjitha forcat në shërbim të mbrojtjes së paqes. Fakti që në Republikën tonë Popullore çdo gjë ndërtohet për përmirësimin e jetës së njerëzve, çdo gjë ndërtohet për mbrojtjen e lirisë dhe forcimin e demokracisë, e tregon këtë. Për popullin tonë si dhe për të gjithë popujt e botës, paqja është e shtrenjtë. Nga lufta populli ynë nuk trashëgoi veçse mjerime të panumërtë; atij ju dogj vendi, ju shkatërrua ekonomia, ju vranë njerëzit nga më të mirët.

Lufta' dhe armiqtë e popullit tonë, kanë pasur kurdoherë për qëllim shfarosjen e popullit shqiptar dhe zhdukjen e vendit tonë nga harta e botës. Por agresorët nuk ja kanë arritur kurrë qëllimit. Populli ynë nuk mund të shtypej dhe vendi ynë nuk mund të zhdukej nga harta e Evropës. Populli ynë fitoi lirinë. Këtë liri të shtrenjtë kurrë nuk do ta lërë t'i shkëlet nga agresorët amerikano-anglezë dhe shërbëtorët e tyre. Imperialistët dhe shërbëtorët e tyre predikonin dhe vazhdojnë të predikojnë se për Republikën tonë Popullore ditët janë të shkurtëra, se populli ynë, i rrëthuar

gjeografikisht, do të vuajë nga uria dhe do të detyrohet të bjerë në gjunjë përpëra imperialistëve dhe satelitëve të tyre. Kjo s'ngjau e nuk do të ngjasë kurrë. Faktet tregojnë se populli ynë po forcohet çdo ditë e më tepër dhe u reziston me sukses të gjitha rreziqeve dhe kërcënimeve që i bëhen nga luftënxitësit imperialistë dhe shërbëtorët e tyre.

Imperialistët bëjnë çdo gjë që u është e mundur për të dobësuar pozitat ndërkombëtare të vendit tonë, për të shpifur kundër tij dhe për të lehtësuar e arësyetuar veprimet e dëmshme kundër nesh. Lufta e fashistëve kundër vendit tonë vazhdon, por këtë herë e udhëhequr nga imperialistët amerikano-anglezë, të cilët po përdorin të njëjtët tradhëtarë shqiptarë të «Ballit», të «Legalitetit», të «Blokut Indipendent»¹ etj. që gjatë Luftës së dytë botërore kanë qenë në shërbim direkt të OVRA-s italiane dhe të Gestapos. Nën udhëheqjen e imperialistëve amerikano-anglezë dhe në përputhje me planet e tyre veprojnë dhe agjenturat e imperializmit që sundojnë në Beograd, në Athinë e në Romë. Këto agjentura s'janë veçse thonjtë e gjakosur të dorës kriminale të një shtrige që jep shpirt, të imperializmit amerikan që kërkon të mbytë popullin tonë paqëdashës dhe punëtor.

Imperialistët amerikanë dhe anglezë kanë refuzuar

¹ «Bloku Kombëtar Indipendent» — organizatë tradhëtarë e krijuar në Itali në vitin 1946 nga imperialistët amerikanë dhe neofashistët italianë me mbeturinat e fashizmit të ikur nga Shqipëria (ish-kuadro kryesorë të tyre në kohën e pushtimit). Është vazhdimi i Partisë Fashiste Shqiptare, por organizatorët e saj ja ndryshuan emrin për arësyte taktike.

të njohin Republikën tonë Popullore, ata këtë e bëjnë pér qëllime djallëzore, por kjo nuk e ndaloi karvanin të shkonte përpara në vendin tonë. Populli ynë luftoi me heroizëm kundër fashizmit, fitoi lirinë dhe rregulloi jetën e tij ashtu si e mendonte dhe ashtu si e dëshironte ai vetë. Kujt nuk i interesonte çka ndodhi në vendin tonë? Natyrisht imperialistëve, fashistëve italianë e gjermanë, pasanikëve shqiptarë, interesat e të cilëve ishin në kundërshtim me ato të popullit shqiptar. Për të gjithë këta ujqër populli ynë qenka «i robëruar», pér arësyse se ai e udhëheq vetë fatin e vet dhe nuk pranon të sundohet nga fashistët amerikanë dhe shërbëtorët e tij. Kuptohet lehtë se ç'do të thotë liri dhe demokraci pér imperialistët, se çfarë lirie e demokracie ata predikojnë dhe duan t'i imponojnë popullit tonë! Amerikanët dhe anglezët vazhdimisht kërkojnë që veprat e tyre të fëlliçura t'i mbulojnë me tym dhe me fraza pseudodemokratike, po ato janë qepur me pe të bardhë. Aktet e tyre barbare, agresive, fashiste, të sabotazhit, të diversionit, të skllavërimit, nuk mund të mbulohen as me tym as me fletë hardhie.

Deklaratat e Mollotovit, Idenit e Hullit gjatë kohës së luftës kanë qenë akte me rëndësi historike pér vendin tonë dhe vazhdojnë të qëndrojnë si akte të tilla të cilat u lidhin duart imperialistëve amerikano-anglezë. Amerikanëve dhe anglezëve, sigurisht u pëlqen t'i shkelin aktet ndërkombëtare, por një veprim i tillë, jo vetëm që do t'i dëmtojë rëndë, pse do të demaskojë fytyrën e tyre prej skllavëruesi, por do të ketë edhe konsekuenca të hidhura pér ta. Deklaratat e Hullit dhe të Idenit, i angazhojnë popujt amerikanë dhe

anglezë përpara popullit shqiptar dhe botës përparimtare, por nga ana tjetër qeveritarët e këtyre vendeve përpinqen t'u bëjnë bisht dhe të veprojnë në kundërshtim me këto deklarata.

Deklarata e shokut Mollotov dhe veprat e Bashkimit Sovjetik kanë qenë dëshmia e qartë, se si Bashkimi Sovjetik mbron popujt e vegjël dhe të mëdhënëj, se si ai mbron me konsekuençë liritë dhe të drejtat e tyre. Bashkimi Sovjetik jo vetëm që e njohu me gjithë zemër luftën kreshnike të popullit shqiptar, por respektoi me rigorozitetin më të madh vendimet e popullit shqiptar dhe s'u përzie kurrë në punët e brendshme të tij. Populli ynë u bë zot i fateve të tij, vendosi regjimin e demokracisë popullore, bëri reforma të mëdha ekonomike, shoqërore dhe kulturale. Miqtë e vërtetë dhe besnikë të popullit shqiptar, Bashkimi Sovjetik dhe Stalini, ishin të gjuar për popullin tonë dhe i dhanë të gjithë mbështetjen, ndihmën morale e materiale që vepra e popullit punonjës të Shqipërisë të forcohej, të zhvillohej, të përjetësohej, që jetë e popullit tonë të sigurohej nga armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm.

Si vepruan qeveritarët amerikanë dhe anglezë pas deklaratave të ministrave të tyre të jashtëm? Ata vepruan krejt në kundërshtim me sa thanë. Ata tentuan të kryenin të gjitha aktet kriminale për të ndërhyrë në punët e brendshme të popullit tonë, ata organizuan sabotazhe, ata bënë atentate, ata u përpoqën të grumbullonin reaksionin e brendshëm për ta hedhur në luftë kundër pushtetit popullor, ata preqatitën plane për ndërhyrje të armatosur me qëllim që të rrëzonin

pushtetin e popullit. Imperialistët amerikano-anglezë u përpoqën të pengonin dhe të diskreditonin zgjedhjet e Asamblesë Kushtetuese dhe më në fund, duke parë se të gjitha tentativat e tyre dështuan, u orvatën të diskreditonin regjimin dhe popullin tonë në fushën ndërkombe të, ata shkelën shumë të drejtë të tija, ata kurdisën incidente me karakter ndërkombe të qëllim që të ndërhytin ushtarakisht. Imperialistët amerikano-anglezë, me anën e titistëve të Beogradit, bënë planet e skllavërimit të Shqipërisë dhe u përpoqën t'i zbatonin këto plane. Ata organizonin incidente të vazhdueshme në kufitë tanë, ata vazhdojnë të thurin plane agresive kundër Shqipërisë në bashkëpunim të ngushtë me agjentët titistë, monarko-fashistët grekë, fashistët italianë dhe kriminelët shqiptarë të luftës, të cilët jo vetëm që nuk ja dorëzuan popullit shqiptar në bazë të traktatit të paqes, por i ushqejnë, i stërvitin, i armatosin, i prengatin dhe i hedhin si diversantë për të turbulluar jetën paqësore dhe ndërtimtare të popullit tonë.

Eshtë e qartë si drita e diellit se klika e Beogradit, sunduesit monarko-fashistë të Greqisë dhe qeveritarët e Romës i kanë shndërruar vendet e tyre në një koloni të hapët të imperializmit amerikan dhe i kanë bërë vatra të rrezikshme lufte. Këto klika veprojnë në koordinim të plotë me planet agresive të amerikano-anglezëve dhe haptas ose në mënyrë të fshehtë bëjnë pjesë në kampin agresiv të Paktit të Atlantikut të Veriut. Me gjithë kontradiktat e mëdha që ekzistojnë ndërmjet tyre, nën urdhërat direkte të padronit të madh amerikan, ata i koordinojnë veprimet e tyre

kundër Republikës sonë Popullore dhe Republikës Popullore të Bullgarisë duke menduar se do të kenë disa suksese për të dobësuar fuqinë dhe vrullin ndërtimtar të popujve tanë. Natyrisht ata s'kanë asnje sukses në këtë drejtim dhe as do të kenë kurrë. Kalatë tona janë të forta dhe ata kanë thyer dhe kurdoherë do të thyejnë kokën. Ligji famëkeq amerikan i 100 milion dollarëve¹ për organizimin e akteve të diversionit e të sabotazhit kundër Bashkimit Sovjetik dhe demokrative popullore, ka kohë që vepron kundër Shqipërisë. Kriminelët shqiptarë që gjenden në arrati janë organizuar në grupe spiunazhi dhe diversioni në shërbim të amerikanëve, anglezëve, titistëve, monarko-fashistëve dhe fashistëve italianë. Këta kriminelë shqiptarë prepatiten në shkolla spiunazhi, diversioni dhe sabotazhi në vende të ndryshme si në Amerikë, Jugosllavi, Gjermani Perëndimore, Itali, Greqi e gjetkë. Këta kriminelë shqiptarë i lëshojnë në Shqipëri me parashuta aeroplanët amerikanë ose i futin nga kufitë tanë në formë bandash të armatosura. Qëllimi i të gjithë këtyre hajdutëve është i ditur, po i njojur është edhe përfundimi mizerabël i tyre. Këta janë shfarosur pa nishan nga Arma heroike e Sigurimit të Shtetit tonë dhe nga rojet heroike të kufirit. Për imperialistët amerikano-anglezë s'ka asnje vlerë jeta e këtyre njerëzve të degjeneruar, të cilët vazhdimisht do të përdoren

¹ Në bazë të ligjit «Mbi sigurimin e mbrojtjes reciproke» të aprovuar nga Kongresi i SHBA-së në vitin 1951, presidentit të SHBA-së i viheshin në dispozicion 100 milion dollarë për t'i përdorur për veprimtari subversive kundër vendeve socialiste.

si mish për top. Populli shqiptar do t'ua rregullojë hesapet edhe atyre që do të guxojnë paskëtaj të futen në vendin tonë, ashtu sikurse ua rregulloi edhe shokëve të tyre të mëparshëm. Populli shqiptar do t'i shfarosë pa mëshirë. Imperializmi amerikano-anglez, për të démtuar punën ndërtimtare në vendin tonë, ka vënë në dispozicion të kriminelëve të luftës mjete propagandistike me të cilat vjellin vrer dhe shpifin paturpësisht kundër regjimit popullor të Shqipërisë. Ata kanë vënë në dispozicion të tyre avionë me anën e të cilëve hedhin vazhdimisht fletushka të ndyra duke kujtuar se do të gënjejnë popullin shqiptar me shpifjet e tyre. Kur ndonjë i lexon këto fletushka, mbushet me urrejtje kundër imperialistëve dhe shërbëtorëve të tyre dhc me përbuzje konstaton budallallëqet dhe shpifjet e këtyre tradhëtarëve. Imperialistët dhe spiunët e tyre shqiptarë, lëshojnë me aeroplani ushqime të helmuara, gjoja për popullin, gjoja se populli ynë vuan nga uria. Deri në këtë gradë kanë arritur kotësia, demagogjia dhe shpifjet e agjentëve të imperializmit. Ata kujtojnë se këto bëjnë efekt në vendin tonë, por efekti është i kundërt për ta. Shumë herë imperializmi amerikan s'ka guxuar t'i nxjerrë hapët në drithë këta kriminelë shqiptarë me damkë se do të demaskohet keqas. I tillë është rasti i kriminelit Abaz Kupi, i cili u tërhoq me bisht në shalë nga gjyqi që ata u kanë kurdisur dy shkrimtarëve progresistë francezë, Zhuvanelit për librin e tij «Internacionálja e tradhëtarëve» dhe Vurmserit për parathënjen e këtij libri. Ky gjyq i Parisit, i kurdisur nga imperializmi amerikan dhe shërbëtorët e tij francezë, kishte për qëllim diskreditimin e vendeve të

demokracisë popullore. Por ky gjyq u plasi në duar imperialistëve dhe i demaskoi keqas ata dhe veglat e tyre. Natyrisht, tradhëtari Abaz Kupi u tërroq nga frika, pse ai jo vetëm s'mund të mohonte çka thuhej në librin «Internacionalja e tradhëtarëve», por do të ndodhej përparrë faktëve të krimeve monstruoze që ai ka kryer në bashkëpunim me italo-gjermanët dhe anglo-amerikanët kundër popullit shqiptar. Populli ynë i njeh mirë këta kriminelë dhe s'është nevoja të zgjatem këtu. Fatin e tyre populli e ka vendosur dhe pikërisht pse janë të tillë, prandaj përdoren prej anglo-amerikanëve si spiunë e si banditë për të dëmtuar veprën e popullit shqiptar. Kriminelët shqiptarë në arrati, të drejtuar nga spiunazhi amerikano-anglez, jo vetëm që e kanë shitur veten e tyre te të huajt, por në mes krerëve të tyre dhe sunduesve të Italisë, të Jugosllavisë dhe të Greqisë, janë arritur ujdira dhe marrëveshje për të copëtuar Shqipërinë. Por këto janë si thotë populli hesape pa hanxhinë. Shqipëria rron dhe do të rrojë si një shkëmb i çelniktë.

Klika e Beogradit lufton me egërsi kundër vendit tonë. Është e qartë se në ç'situatë të tmerrshme e ka sjellë Jugosllavinë kjo agjenturë e amerikanëve. Jugosllavia është bërë një vatër mjerimesh për popullin heroik jugosllav dhe një qendër kërcënim i kundër Republikës sonë Popullore. Atje vepron ligji i terrorist, uria, papunësia, burgjet dhe kampet e përqëndrimit, të cilat janë mbushur me patriotë jugosllavë. Lidhjet e klikës së Beogradit me imperialistët amerikanë tanë janë krejtësisht të hapëta. Amerikanët janë bërë zotër të Jugosllavisë. Pasuria e popujve të Jugosllavisë është

bërë pronë e trusteeve amerikane. Amerikanët po armatosen ushtrinë jugosllave për ta pasur këtë një armë në duart e tyre. Populli jugosllav i reziston me heroizëm kësaj klike renegatësh. Populli jugosllav do ta gjejë rrugën e tij të shpëtimit. Tok me popujt e Jugosllavisë lufton edhe populli shqiptar i Kosovës e Metohisë, i Maqedonisë, i Malit të Zi kundër të cilit klika e Beogradit, po ushtron një terror të jashtëzakonshëm, më të egër dhe më shfarosës se terrori i kralëve. Banditët e Rankoviçit, po vrasin, po burgosin, po internojnë me mijëra shqiptarë të Kosovës. Qëllimi i tyre është të zhdukin shqiptarët e Kosovës, t'i shkombëtarizojnë dhe t'u rrëmbejnë tokat, t'u zhdukin gjuhën shqipe, t'i kthejnë në turq, t'u prishin zakonet dhe mbi të gjitha të luftojnë në ta dashurinë për Shqipërinë, për atdheun e tyre. Terrori i klikës së Beogradit mbi kosovaret është një krim genocidi¹. Populli shqiptar ngre zërin për të mbrojtur vëllezërit e tij në Kosovë, Metohi, Maqedoni e Mal të Zi dhe kërkon nga bota përparimtare që të ndalet dora kriminale e klikës së Beogradit që shfaros shqiptarët e Kosovës. Shqiptarët e Kosovës, së bashku e të vëllazëruar me popujt e Jugosllavisë, duhet t'u rezistojnë barbarizmave të xhelatëve të tyre, të luftojnë për lirinë e tyre. Kosovaret të ndjekin rrugën e Asim Vokshit, Bajram Currit, Emin Durakut, Xhevdet Dodës, Miladin Popoviçit etj. kundër klikës së Beogradit, kundër Xhafer Dëvëve, Kryezinjve dhe tradhëtarëve të çdo kallëpi, të cilët vazhdimisht kanë

¹ Genocid (greqisht) — nga genos — racë dhe (lat.) caedo — me vra. Krim, që bëhet me qëllim që të asgjësohet një grup kombëtar, etnik, racial ose fetar.

shkaktuar mjerimin e tyre. Kosovarët shqiptarë të luftojnë dhe të demaskojnë shpifjet që bëjnë këto banda kundër Republikës Popullore të Shqipërisë, të shpartallojnë organizimin e diversantëve që banditi Dushan Mugosha, vrasësi i mijëra shqiptarëve të Kosovës, organizon kundër atdheut të çdo shqiptari patriot, Republikës Popullore të Shqipërisë.

Eshtë i ditur qëllimi djallëzor i titistëve kundër vendit tonë. Zbulimi e demaskimi i kësaj agjenture shumë të rrezikshme të amerikanëve në Ballkan që maskohej me parrulla false marksiste, eshtë një fitore shumë e madhe për socializmin. Partia jonë heroike, e çelnikosur në luftën e përgjakshme kundër okupatorëve, e kalitur me idetë e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, i bëri të dështojnë të gjitha manevrat e planet e titistëve. Ne pamë me sytë tanë poshtërsitë e trockistëve, sabotazhet, provokacionet, dredhitë, metodat e shpifjes e të shantazhit. Për ne eshtë i njojur fakti se si klika e Beogradit pregetiste provokacione në shkallë ndërkombëtare, se si u orvat të okuponte ushtarakisht vendin tonë. Edhe tani këta renegatë përpiken me anën e agjentëve dhe diversantëve të tyre, që i futin fshehurazi në vendin tonë, të krijojnë mosbesim në qëndrueshmërinë e situatës. Ata tentojnë të sabotojnë planet tona ekonomike duke përhapur lloj-lloj shpifjesh. Ata tentojnë të bindin disa fshatarë të thjeshtë se në Jugosllavi gjoja rrohet mirë e të tjera. Me radio, me shtyp, ata përpiken të diskreditojnë Partinë tonë dhe komunistët duke shpifur. Ata kërkojnë të mashtrojnë njerëzit e dobët, qofshin anëtarë partie, qofshin pa parti dhe t'i hedhin këta në akte sabotazhi

dhe terrorizmi, tentojnë të futin përçarjen në njerëzit e organizatave bazë të Partisë në rajonet kufitare, përpiken të ngjallin hasmëritë e vjetra, ligjin barbar të hakmarrjes, përpiken të komprometojnë njerëzit e Partisë duke u dërguar letra nga të arratisur shqiptarë në Jugosllavi, ata përpiken të shfrytëzojnë ndjenjat fetare dhe të ngjallin ndjenjat e shovinizmit. Renegatët e Beogradit përpiken të gënjejnë fshatarë të thjeshtë dhe t'i bëjnë të arratisen në Jugosllavi dhe atje i organizojnë në banda të armatosura e i rekrutojnë në agjenturën e tyre pér t'i hedhur në vendin tonë që të kryejnë krime dhe atentate. Të tilla janë metodat e këtyre agjentëve në shërbim të amerikanëve dhe të anglezëve.

Populli ynë i udhëhequr nga Partia e tij heroike, nuk frikësohet nga këto veprime të ulëta të imperialisteve dhe të shërbëtorëve të tyre, përkundrazi ai u bën ballë me heroizëm dhe me sukses provokacioneve e shantazheve. Populli ynë është i mobilizuar i téri dhe ka shtërnguar radhët e tija rreth Partisë dhe qeverisë dhe do të bëjë të dështojnë të gjitha tentativat e armiqve të jashtëm dhe të brendshëm.

Situata e brendshme e vendit tonë është forcuar shumë. Regjimi i demokracisë popullore është çelnikosur. Populli e do Partinë dhe pushtetin e tij me gjithë zemër, se ai pa konkretisht të zhduket shtypja dhe robëria shekullore. Ai pà të ndërtohetjeta e mirë, të ngrihet standardi i jetesës, të rindërtohet vendi në një kohë jashtëzakonisht të shkurtër, ai pa me sytë e tij se si Partia e pushteti popullor shpronësuan bejlerët dhe aga-

llarët dhe u dhanë fshatarëve tokën, shpronësuan koncessionarët e huaj dhe pasanikët vendës dhe këto prona i bënë të popullit.

Populli pa konkretisht se si në vendin tonë, mendihmën e Bashkimit Sovjetik në radhë të parë dhe të vendeve të demokracisë popullore, u ndërtuan fabrika dhe kombinate të reja madhështore që tani punojnë për të, pa se si bujqësia mori një hov të madh dhe përmirësoi kështu jetën e fshatarëve dhe të gjithë popullit. Populli pa reformat e mëdha financiare që jo vetëm e lehtësuan atë nga taksat e rënda të së kaluarës së zezë, po forcuan buxhetin shtetëror me anën e të cilit u bënë ndërtime kaq të mëdha që nuk i ka parë kurrë Shqipëria. Populli pa zhvillimin e madh të kulturës e të arësimit, pa të hapen kudo nëpër fshatra shkolla fillore e 7-vjeçare, të shumëzohet numri i shkollave të mesme e profesionale, të krijohen institutet e para të larta në vendin tonë, të krijohet një rrjet i madh bibliotekash, kinemash, teatrosh, klubesh, të shtohen spitalet, sanatoriumet, vendet e pushimit e shumë institucione të tjera, të gjitha për popullin dhe në shërbim të popullit. Populli pa se si Partia dhe pushteti popullor ndërtuan me sukses hekurudhat e para, ngritën e vazhdojnë të ngrenë stacione madhështore hidroelektrike që po vënë dhe do të vënë në lëvizje industrinë tonë. Gjithë këto përparime që ka bërë populli ynë e kanë forcuar besimin e tij në të ardhshmen, e kanë forcuar kompaktësinë, kanë ngritur në një shkallë më të lartë gjendjen sociale dhe kulturale, gjendjen ekonomike, ndërgjegjen politike të popullit tonë. Këtë forcim të madh të Republikës sonë Popullore, këtë besim të madh të popullit në forcat e tija, nuk mund

ta errësojnë fletushkat e kriminelit Hasan Dosti me shokë dhe të padronëve të tyre amerikano-anglezë.

Me një besim të patundur në të ardhshmen, populli ynë, i udhëhequr nga Partia e tij, ecën kurdoherë përpara dhe ai vazhdimisht do të forcojë ekonominë e tij dhe fuqinë mbrojtëse të vendit.

Populli ynë e di se këtë lumturi që gjëzon sot dhe sigurinë në të ardhshmen e tij ja detyron Partisë së tij të lavdishme, prandaj ai e do këtë me gjithë shpirt.

Përpara këtyre situatave ndërkombe të dha dhe brendshme, popullit shqiptar dhe Partisë u dalin këto detyra:

1) Të forcojnë dashurinë për Bashkimin Sovjetik dhe Stalinin. Populli dhe Partia jonë të njojin sukseset e mëdha që ka arritur Bashkimi Sovjetik dhe të përfitojnë nga eksperiencia e Partisë së lavdishme Bolshevike dhe e shtetit sovjetik, ta përvetësojnë këtë eksperiencë pse kjo do të na ndihmojë që të arrijmë sukseset dhe fitore të reja.

2) Populli dhe Partia të forcojnë miqësinë me popujt e vendevë të demokracisë popullore, të njihen sa më shumë me jetën, me punën, me sukseset e këtyre popujve vëllezër.

3) Populli dhe Partia të shumëfishojnë luftën e tyre për mbrojtjen e paqes dhe të demaskojnë pa mëshirë propagandën dhe shpifjet e imperializmit dhe të shërbëtorëve të tyre.

4) Populli dhe Partia të jenë kurdoherë vigjilentë për të mbrojtur interesat e Republikës sonë Popullore, për të mbrojtur fitoret e popullit shqiptar që i kërcënojnë imperialistët amerikano-anglezë e agjenturat e tyre. Të

jenë të pamëshirshëm kundër diversantëve dhe sabotatorëve, qoftë të brendshëm qoftë të atyre që vijnë nga jashtë dhe t'i shfarosin këta pa mëshirë. Ushtria jonë heroike, rojet tonë të kufirit dhe Arma e Sigurimit të Shtetit, të mbrojnë sikurdoherë me sukses dhe vigjilencë kufitë e atdheut tonë, interesat e popullit dhe të Republikës dhe të jenë kurdoherë të gatshëm dhe të pamëshirshëm kundër armiqve të jashtëm dhe të brendshëm që do të tentojnë t'i cënojnë këto interesa të shenja.

III

ZHVILLIMI I EKONOMISË SONË DHE PERSPEKTIVAT E SAJA

Që prej Kongresit I e deri sot ne kemi mundur ta zhvillojmë ekonominë tonë në mënyrë të planifikuar socialiste. Kjo u bë e mundshme në radhë të parë për arësyet përqëndrimit në duart e shtetit të industrisë, të tregëtisë së madhe, të tregëtisë së jashtme, të bankës, të mjeteve të transportit etj. Na u bë e mundur pse njerëzit tanë mësuan dhë u zhvilluan në çështjen e planifikimit, e cila koordinon faktorët e jetës sonë ekonomike, mësuan nga eksperiencia sovjetike. Nga ana tjetër ky zhvillim u bë i mundshëm, sepse u likuidua sabotimi nga ana e titistëve që jo vetëm e ndaluan një zhvillim të tillë po njëkohësisht krijuan anarkinë duke grabitur pasurinë tonë.

Në këtë periudhë që bëjmë fjalë, ekonomia kombëtare u forcua në të gjithë sektorët dhe sidomos në lëmin e industrisë që është baza e ndërtimit të socializmit.

Në lëmin e industrisë janë arritur rezultate të kënaqshme. Në fund të vitit 1950, prodhimi global i industrisë bashkë me artizanatin arriti 3 266 000 000 lekë dhe në krahasim me paraluftën (1938), 395 për qind. Politika e Partisë ka qenë të prodhonte sa më tepër që të ishte e mundur sende industriale për nevojat e popullit dhe këtu kemi pasur rezultate të pakraha-

sueshme me paralufstën kur çdo gjë sillej nga jashtë. Njëkohësisht i çshtë vënë rëndësia prodhimit të mjeteve të prodhimit industrial, të cilat natyrisht do të shkojnë duke u shtuar çdo vit për t'u bërë shkak i krijimit të një bollëku më të madh të sendeve të fabrikuara dhe të krijimit të një proporcioni të drejtë në mes mjeteve të prodhimit industrial dhe prodhimeve industriale të konsumit. Me planin dyvjeçar 1949—1950, prodhimi industrial është rritur çdo vit 10,5 për qind.

Gjatë periudhës që ndan dy kongreset, zhvillimi dhe forcimi i ekonomisë sonë ka ecur përpara, në saje të politikës së drejtë të Partisë sonë, të heroizmit të klasës punëtore dhe të gjithë masave punonjëse të vendit, të cilat, duke ditur se punojnë për jetën e tyre më të mirë, për socializmin, s'kanë kursyer asgjë nga vetja e tyre për të realizuar fitoret e konsiderueshme që janë arritur. Në punën për ndërtimin e bazave të socializmit vendi ynë është ndihmuar nga popujt e Bashkimit Sovjetik. Vendi ynë është ndihmuar gjithashtu edhe nga popujt e vendeve të demokracisë popullore. Kjo ndihmë ka konsistuar në kredi të konsiderueshme me anën e të cilave ne kemi rindërtuar industrinë e vjetër ekzistuese, kemi zhvilluar industrinë e naftës dhe atë minerale, kemi fuqizuar industrinë tonë me kombine dhe fabrika të fuqishme siç janë ato të tekstit, sheqerit, pambukut, drurit, kemi ndërtuar centrale hidroelekrike, kemi ndërtuar hekurudha, kemi mekanizuar një pjesë të bujqësisë etj. Këto kredi na kanë ndihmuar gjithashtu për të përballuar nevoja të tjera të importit qoftë në drithëra buke, qoftë në prodhime industriale të shumëllojshme për nevojat e masave punonjëse. Këto kredi na kanë ndihmuar nga ana tjetër që ne të përballojmë me të ardhurat shtetërore ndërtimet e mëdha që janë bërë në këtë periudhë për përmirësimin e je-

tesës së punonjësve, nga ana ekonomike dhe kulturale, duke vënë në dispozicion të punonjësve apartamente të shumta, shkolla, kinema, shtëpi kulture, biblioteka, çerdhe, sanatoriume, shtëpi pushimi, spitale etj.

Zhvillimi i ekonomisë sonë është bërë dhe po bëhet në rrugën e kufizimit sistematik dhe eliminimit të elementeve kapitalistë, në rrugën e shtimit të vazhdueshëm dhe të shpejtë të elementeve socialistë në ekonominë tonë. Një rruge e tillë e drejtë e ka lejuar vendin tonë të ecë më sukses drejt ndërtimit të bazave të socializmit dhe të fuqizojë kështu ekonominë popullore.

Tabloja e nièposhtme na jep një ide të qartë të rritjes së prodhimit industrial në vitin 1950, viti i fundit i dyvjeçarit, dhe në krahasim me paraluftën dhe me planin njëvjeçar 1948.

Rritja e prodhimit industrial sipas degëve
(Në milion lekë, me çmimet e viti 1950)

Nr.	Dega e prodhimit	Prodhimi 1950	Krahasim në përqindje	
			1950	1950
			1938	1948
1)	Industria vajgurore	247	318	113
2)	Industria minerale	205	464	224
3)	Industria elektrike	56	513	112
4)	Industria mekanike	54	—	—
5)	Industria material-ndërtimi	179	852	186
6)	Industria e veshmbathjes	193	547	134
7)	Industria ushqimore	339	175	71
8)	Industria lokale	95	—	272
9)	Artizanati gjithscjt	519	135	110
10)	Të tjera	1374	2521	268
	Shuma	3266	395	155

Kjo është një rritje dhe një zhvillim i mirë. Dihet gjithashtu se plani ynë dyvjeçar 1949—1950 nuk u realizua plotësisht, por rreth 91,4 për qind. Konsekuenca e rënda të sabotazhit jugosllav, veprimitaria armiqësore e disa elementëve antiparti, si dhe dobësitet tona në përgjithësi, kanë qenë shkaku i mosrealizimit të plotë të planit dyvjeçar. Është për t'u theksuar se në mosrealizimin e planit dyvjeçar ka influencuar, sidomos mosrealizimi i planit të nxjerrjes së naftës, i industrisë së vaj-sapunit, të lëkurëve, të këpucëve, të peshkut dhe të drurit. Po të përjashtojmë industrinë e vaj-sapunit, e cila mund të shfajësohet pak për arësyen e prodhimit të keq të ullinjeve, të bimëve që prodhojnë vaj dhe të pambukut, për të tjerat mund të themi se mosrealizimet kanë rrjedhur nga organizimi i dobët i punës, i mungesës së disiplinës së punës dhe i asaj teknike, i mosaplikimit të normave, i mungesës së një kontrolli teknik dhe të shumanshëm, si nga lart ashtu edhe nga baza, nga mungesa e vigjilencës ndaj armikut që është përpjekur të sabotojë dhe nga një fluktuacion shumë i madh nga ana e fuqisë punëtore dhe shfrytëzim i keq i kohës së punës etj. Por është gjithashtu për t'u theksuar se shumë sektoër të industrisë si çimentua, oficinat, tekstilet, makaronat, duhani, elektriku, industria poligrafike etj. e kanë realizuar planin në një përqindje të kënaqshme.

Për t'u vënë në dukje gjithashtu është realizimi shumë i kënaqshëm i planit në sекторin e ndërtimit, i cili e ka realizuar dhe tejkaluar atë, duke i dhënë popullit në një kohë rekord kombinatë, fabrikat, hidrocentralin, ndërtesat e banimit etj.

Edhe në sекторin e bujqësisë janë arritur suksese,

por zhvillimi i bujqësisë nuk mund të quhet kurrsesi i kënaqshëm, sido që kjo e ka tejkaluar nivelin e para-luftës që në vitin 1946. Ndërsa prodhimi industrial është rritur gati tri herë në krahasim me 1938-n, prodhimi bujqësor në vitin 1950 është rritur rrëth 30 për qind kundrejt viti 1938.

Ja se si është rritur prodhimi i drithërave të bukës, një nga problemet kryesore te ne:

Nr.	Emërtimi	Realizimi 1950 (në ton)	Krahasim në përqindje	
			1950	1950
			1938	1948
1)	Misër	109 000	76	68
2)	Grurë	85 000	213	121
3)	Thekër	8 000	267	100
4)	Oriz	3 000	300	100
	Shuma	205 000	110	85

Natyrisht duke parë këtë tabelë ne mund të themi se prodhimi nuk është i bollshëm dhe nevojat e vendit tonë nuk janë plotësuar me bukën e vendit, por kemi qenë të detyruar të importojmë. Nga ana tjetër rritja e sipërfaqeve të kulturave industriale është si më poshtë:

Në hektarë:

Nr.	Emërtimi	Realizimi 1950	Krahasim në përqindje	
			1950	1950
			1938	1948
1)	Pambuk	15 800	5 266	148
2)	Panxhar sheqeri	1 400	—	108
3)	Duhan	4 600	177	124
4)	Lule dielli	6 600	—	108
5)	Lin kërp	1 000	2 500	77
6)	Të tjera	1 600	—	89
	Shuma	31 000	1 065	124

Kjo tabelë na tregon se sipërfaqja e mbjellë me bimë industriale po rritet në mënyrë të kënaqshme. Sipërfaqja e mbjellë me pambuk në vitin 1950 është rritur 52 herë dhe ajo e mbjellë me duhan 77 për qind më shumë në krahasim me vitin 1938 të paraluftës.

Siq e shihni ne kemi një disproporcion mjaft të madh në mes të zhvillimit të industrisë dhe sektorit të bujqësisë. Këtë boshllék ne duhet ta plotësojmë dhe të ndjekim një rrugë të tillë, që duke mos ulur aspak ritmin e zhvillimit të industrisë, të bëjmë që bujqësia jonë të përparojë që t'i afrohet më shumë zhvillimit të industrisë dhe të përballojë nevojat e kësaj të fundit. Ato të plotësojnë njëra-tjetren. Zhvillimi i bujqësisë, me gjithë ndihmën e vazhdueshme që i ka dhënë shteti, nuk mund të rritej proporcionalisht me zhvillimin e industrisë për arësy se në bujqësinë tonë predominon prodhimi i vogël individual, toka është e parceluar në ekonomi shumë të vogla, metodat dhe mjetet e punës në bujqësi janë akoma shumë të prapambetura dhe këto kanë shkaktuar që bujqësia të mos ecë me ritmin e zhvillimit të duhur. Zgjidhja definitive e problemit të bujqësisë, është socializimi i fshatit, domethënë kolektivizimi i tij. Por Lenini e Stalini dhe eksperienca e Bashkimit Sovjetik na mësojnë se në këtë rrugë duhet të ecim me kujdes të madh dhe duhet të krijojmë konditat e përshtatshme për të preqatitur zgjerimin e kolektivizimit. Rruga që duhet të ndjekim në këtë drejtim është përcaktuar nga Kongresi I i Partisë «në kolektivizimin e bujqësisë nuk duhet as të shpejtojmë dhe as të ndalemi në vend»¹, dhe nga Plenumi X i Komitetit Qendror në këtë mënyrë:

¹ «Dokumenta Kryesore të PPSH», Vëll. II, bot. I, f. 97.

«...si detyrë imediate dhe urgjente na vihet jo rritja e numrit të kooperativave bujqësore të prodhimit, por forcimi i gjithanshëm i kooperativave ekzistuese, në mënyrë që këto të bëhen shembull i shkëlqyer për fshatarët e vobektë dhe të mesëm, për t'u tërhequr këta në rrugën e kolektivizimit pa asnje presion, por vullnetarisht dhe në bazë të shembullit praktik të kooperativave ekzistuese. Çfarëdo shpejtimi i pamatur në kolektivizimin e bujqësisë në konditat e sotme do të conte në gabime të rënda që do ta dëmitonin rëndë vetë çështjen e kolektivizimit të bujqësisë»¹.

Ne duhet të ndjekim në situatën e tanishme rrugën e forcimit të kooperativave ekzistuese, e forcimit dhe zgjerimit të SMT-ve dhe mekanizimit të bujqësisë. Për këtë arësy ne duhet të parashikojmë në planin tonë pesëvjeçar një forcë motorike shumë më të madhe për të përballuar mungesën e fuqisë punëtore në fshat, mungesën e kafshëve të punës etj. Nga ana tjeter ne duhet të parashikojmë zhvillimin në një shkallë më të gjerë të bonifikimeve dhe në radhë të parë të kanaleve ujitëse për t'i bërë tokat më prodhuese, të vëmë në dorë të fshatarëve mjete pune më të shumta, farëra të zgjedhura etj. Detyra kryesore, për të dalë nga kjo situatë, është çështja e luftës për shtimin e rendimenteve në të gjitha kulturat, qoftë në ato të drithërave të bukës, qoftë në ato të bimëve industriale. Veçanërisht duhet t'i vëmë rëndësi zhvillimit të bimëve industriale, në radhë të parë pambukut, panxharit, duhanit etj. Lidhur me bujqësinë, rëndësi të madhe duhet t'i vëmë zhvillimit të blegtorisë,

¹ «Dokumenta Kryesore të PPSH», Vëll. II, bot. I, f. 97.

pse gjatë kësaj periudhe, ne konstatojmë jo një ngritje po një ulje në mjaft kategori kafshësh si në qé, buaj e kuaj dhe kjo pér arësyen të mungesës së bazës ushqimore, së cilës duhet t'i vëmë rëndësinë më të madhe.

Duhet theksuar se gjatë dyvjeçarit sukseset nuk kanë qenë proporcionale me rëndësinë jetike që ka pér vendin tonë bujqësia. Megjithkëtë, gjatë këtyre viteve, janë kryer vepra të rëndësishme si bonifikimi i kënetës së Maliqit, kanali ujitës i Myzeqesë dhe kanale të tjera ujitëse dhe kulluese, janë shpërndarë mbi 10 000 ton pleh kimik, mbi 7 000 ton farëra etj. Toka dhe klima e vendit tonë janë të tillë që me një ndihmë dhe me një organizim më të fuqishëm në sektorin e bujqësisë, ne do të arrijmë rezultatet që dëshirojmë. Vetëm se duhet të theksojmë që gjatë dyvjeçarit ka pasur një punë të dobët organizative nga ana e aparatit të Ministrisë së Bujqësisë dhe nga organet e pushtetit lokal përsa i përket detajimit të planeve në ekonominë bujqësore dhe kontrollit të punës. Nuk janë aplikuar si duhet metodat agroteknike, ka pasur pakujdesi dhe vonesa në zhvillimin e fushatave, në shpërndarjen e farërave, të kreditit agrar, të plehrave dhe të veglave bujqësore. Të gjitha këto kanë influencuar në uljen e rendimenteve, pse sukset e arritura në realizimin e rendimenteve shumë të mira, aty-këtu në sektorin socialist dhe në atë privat, tregojnë shumë mirë se në vendin tonë janë të gjitha mundësitë pér të zgjidhur më mirë këtë problem. Duhet gjithashtu të vëmë në dukje se gjatë dyvjeçarit në ndërmarrjet bujqësore dhe blegtorale të shtetit, me gjithë sukseset e arritura në to, ka munguar një organi-

zim i mirë i brendshëm dhe ky u ka lënë shteg shumë dëmtimeve si në prodhimet bujqësore edhe në shtimin dhe përmirësimin e racës së bagëtive. SMT-të gjithashtu nuk i kanë kryer si duhet punimet dhe riparimet e maqinave, nuk janë kryer mirë dhe nuk janë shfrytëzuar ato sipas fuqisë ekzistuese, nuk kanë mbajtur plotësisht angazhimet dhe nuk kanë respektuar kontratat me fshatarët.

Gjatë kësaj periudhe që bëjmë fjalë, transporti në vendin tonë është zgjeruar dhe forcuar, me gjithë sabotimin e jugosllavëve dhe të Niazi Islamit. U ndërtuan hekurudhat tona dhe u fuqizuan me mjete të reja transporti automobilistik dhe detar. Por, si detyrë kryesore në komunikacion duhet të forcohet akoma më shumë organizimi dhe lartësimi i kuadrove.

Gjithashtu është forcuar tregëtia jonë. Në vitin 1950 qarkullimi i mallrave të tregëtisë qe 59 pér qind më tepër se në vitin 1947. Tregëtia socialiste është rritur vazhdimesht dhe tregëtia private është kufizuar.

Gjendja ekonomike e masave punonjëse është ngri-
tur vazhdimesht. Në bazë të të dhënave orientuese, në vitin 1950 të ardhurat kombëtare arrinin mbi 9 miliard lekë (me çmimet e vitit 1947) ose 16,8 pér qind më tepër se në vitin 1948 dhe në vitin 1949 në 121 pér qind kundrejt vitit 1947, kurse në vitin 1951 të ardhurat arritën në 141,5 pér qind në krahasim me 1947-n. Kjo është e qartë dhe tregon se standardi i jetesës së punonjësve është rritur nga viti në vit. Gjatë kësaj periudhe, popullsia është furnizuar vazhdimesht e më shumë me sendet e nevojshme të jetesës, është rritur fuqia blerëse e saj. Zhvillimi i tregëtisë socialiste, shtimi i mall-

rave të konsumit si dhe ndihma e Bashkimit Sovjetik dhe e demokrative popullore kanë shkaktuar uljen e çmimeve në tregjet e Republikës, ulje që në vitin 1950, në disa artikuj si mishi, gjalpi, djathi, qumshti, vezët, fasulet kundrejt vitit 1949 kanë arritur nga 17 për qind në 39 për qind, sipas artikujve. Në 1950 qeveria bëri ulje të pjesshme të çmimeve të artikujve kryesorë dhe popullsia fitoi 300 milion lekë. Në vitin 1951 u bë një ulje tjetër e pjesshme e çmimeve të artikujve kryesorë të tregëtisë socialiste dhe kjo bëri të fitojë populli dhe 148 milion lekë të tjerë.

Numri i punonjësve në aparatet shtetërore, të Partisë dhe të sektorit shtetëror të ekonomisë, është rritur 28 për qind më tepër në krahasim me vitin 1947. Pjesë-marrja e gruas në punë në 1950 ka qenë 18 për qind të numrit të përgjithshëm të punonjësve. Fondi i pagave për punonjësit është rritur 50 për qind më shumë në vitin 1950 kundrejt vitit 1947. Pagat nominale mesatare vjetore për çdo punonjës janë rritur nga 35 000 lekë në 1947, në 39 000 lekë në vitin 1950. Kjo tregon qartë se gjendja ekonomike e masave tona punonjëse është përmirësuar. Klasa punëtore, entuziaste dhe luftarake, ka qenë vazhdimisht e mobilizuar në kulm për ndërtimin e bazave të socializmit. Në sektorët kryesorë të ekonomisë kanë punuar me norma 80,1 për qind e punonjësve.

Një rëndësi shumë të madhe i kanë dhënë Partia dhe qeveria ngritjes kulturale të masave punonjëse në këtë periudhë dhe investimet në sektorët e arësimit, të kulturës e të shëndetësisë, kanë qenë të mëdha. Është shtuar numri i shkollave fillore, i shkollave të mesme,

i shkollave të mësme profesionale. U krijuan institutet e larta në vendin tonë. Është shtuar numri i nxënësve, numri i kopshteve të fëmijëve, i konvikteve, i spitaleve, i sanatoriumeve dhe i vendeve të pushimit për punëtorët dhe për masat punonjëse. Tabela e mëposhtme e vë në dukje këtë përparim në fushën e arësimit e të kulturës:

Nr.	Emërtimi	1950	Krahasin në përqindje	
			1950	1950
			1938	1948
1. Numri i shkollave fillore		2 023	315	106
2. Numri i nxënësve në fillore		150 819	290	93
3. Numri i shkollave 7-vjeçare		193	1 755	132
4. Numri i nxënësve në 7-vjeçare		18 358	397	116
5. Numri i shkollave të mësme		23	209	115
6. Numri i nxënësve në të mesme		5 365	316	168
7. Numri i nxënësve në institutet e larta brenda shtetit		130	—	117
8. Numri i kopshteve të fëmijëve		160	696	112
9. Numri i fëmijëve në kopshte		10 471	430	109
10. Numri i personelit arësimor		5 100	315	114
11. Numri i kinemave e i teatrove		96	600	266
12. Numri i shtëpive të kulturës		11	—	122

Një sërë problemesh të rëndësishme politike, ekonomike e financiare gjetën zgjidhje të drejtë dhe janë realizuar në përgjithësi mirë. U rishqyrtuan ligjet dhe urdhëresat dhe u spastruan nga influenca e trockistëve jugosllavë. U rishqyrtua sistemi i furnizimit të popullsisë duke vendosur një sistem që shpie gjithmonë e më shumë në perfeksionimin e aleancës në mes të qytetit dhe fshatit. U vendos një politikë e drejtë

stimulacionesh në sektorin e bujqësisë me anën e të cilave fshatarit prodhues i sigurohen me shkëmbim mallra konsumi të nevojës së parë dhe nga ana tjetër industrije dhe qytetit prodhime bujqësore më shumë.

Sukseset e arritura i detyrohen udhëheqjes së drejtë të Partisë, Komitetit të saj Qendror, i detyrohen vendosmërisë, heroizmit dhe vetëmohimit të komunistëve, u detyrohen heroizmave të shkëlqyera të klasës sonë punëtore dhe të gjitha masave punonjëse të vendit. Por duhet të theksojmë gjithashtu se të metat dhe gabimet tona kanë qenë gjithashtu të theksuara gjatë kësaj periudhe dhe është e domosdoshme që të mësojmë nga ato për të mos i përsëritur më.

Duhet të forcohet në radhë të parë çështja e drejtimit të Partisë dhe e pushtetit popullor dhc kjo gjë të bëhet që nga kreu e deri poshtë. Partia kërkon nga anëtarët e vet, në radhë të parë, dhe nga të gjithë punonjësit që të zbatojnë në mënyrë rigorozë vendimet e saj dhe të qeverisë, u shtron si detyrë që të punojnë pa u lodhur, kërkon që të zbatojnë në mënyrë të rreptë disiplinën e Partisë dhe të shtetit. Lëshime janë konstatuar në këto drejtime si nga komunistët, ashtu edhe nga njerëzit pa parti që punojnë në aparatet e shtetit dhe të ndërmarrjeve ekonomike. Nga këto qëndrime jo të drejta ndaj detyrave që duhet të kryejnë, i janë shkaktuar dëme ekonomisë sonë kombëtare. Ka pasur thyerje discipline, shpërdorime, abuzime në pasurinë e shtetit, ka pasur indiferentizëm dhe lëshime në kujdesin për jetën e punëtorëve, ka pasur mungesë përgjegjësie kolektive dhe personale.

Në aparatet e ministrive si dhe në udhëheqjen e

tyre ka pasur një burokratizëm të tepruar, një mungesë të theksuar të thellimit në problemet dhe të kontrollimit në zbatimin e vendimeve. Kjo ka shkaktuar që mobilizimi në punë, disa herë, të mos ketë qenë në lartësinë e duhur, të jetë dobësuar vigjilencia. Është për t'u theksuar puna e dobët e drejtimit në Ministrinë e Minierave dhe në Ministrinë e Grumbullimeve. Në këto dikastere, veçanërisht ku fajet kryesore i kanë shokëtit titullarë, pa u hequr dhe përgjegjësinë e tyre vartësve, si lart dhe poshtë në ndërmarrje, ka pasur mungesa të dukshme në organizimin dhe drejtimin e punës, në vendosjen e një discipline të shëndoshë në të gjithë aparatin e ministrive dhe të ndërmarrjeve si dhe në ndjekjen e realizimit të planeve. Veçanërisht në Ministrinë e Grumbullimeve, ka munguar dhe mungon një kontroll rigoroz mbi të plotfuqishmit dhe vartësit e tyre, të cilët, në shumë raste, bëjnë veprime të paligjshme dhe sillen në mënyrë të dënueshme me fshatarësinë. Gjithashtu në këtë ministri ka munguar një bashkëpunim i ngushtë me komitetet ekzekutive dhe me masën e fshatarësisë.

Këshillat popullore dhe komitetet ekzekutive duhet të marrin mirë në dorë çështjen e drejtimit të jetës së vendit dhe të bëhen më të afta për të zgjidhur të gjitha problemet e rrethit. Njerëzit që populli zgjedh në to duhet të mësojnë, të bëjnë përpjekje të mëdha për t'u ngritur në radhën e udhëheqësve dhe jo ta quajnë veten formalë. Të drejtosh nuk është një punë aq e lehtë, por çdo gjë fitohet me energji të pashtershme dhe me këmbëngulje. Sa më të vështira bëhen problemet, aq më të mëdha duhet të bëhen përpjekjet nga të gjithë njerëzit e Partisë dhe të aparateve të saj, të qeve-

risë dhe të aparateve të saj, të pushtetit popullor dhe të aparateve të tij dhe të gjitha ndërmarrjeve ekonomike etj. Problemeve që kërkojnë zgjidhje të drejtë dhe urgjente, nuk mund t'u japid rrugë njerëzit e plogësht, burokratët, njerëzit që s'mësojnë dhe s'edukohen, njerëzit që nuk lidhen ngushtë me masat e gjera të popullit dhe që nuk mbështeten fuqimisht në to.

Në lidhje me drejtimin e punëve të pushtetit, Stalini thotë:

«Të drejtosh mirë, do të thotë:

së pari, të gjesh zgjidhjen e drejtë të çësh-tjes, dhe zgjidhjen e drejtë nuk mund ta gjesh pa u mbështetur në eksperiencën e masave, të cilat i provojnë mbi shpinën e vet rezultatet e drejtimit tonë;

së dyti, të organizosh zbatimin e zgjidhjes së drejtë, gjë që përsëri nuk mund të bëhet pa ndihmën e drejtëpërdrejtë të masave;

së treti, të organizosh kontrollin e zbatimit të kësaj zgjidhjeje të drejtë, gjë që përsëri nuk mund të bëhet pa ndihmën e drejtëpërdrejtë të masave.

Ne, drejtuesit, i shohim gjërat, ngjarjet, njerëzit vetëm nga njëra anë, unë do të thosha — nga lart, prandaj horizonti ynë është pak a shumë i kufizuar. Masat, përkundrazi, i shohin gjërat, ngjarjet, njerëzit nga një anë tjetër, do të thosha — nga poshtë, prandaj edhe horizonti i tyre është deri diku i kufizuar. Për t'i gjetur një zgjidhje të drejtë kësaj çështjeje, duhet të

bashkohen këto dy eksperiencia. Vetëm kështu udhëheqja do të jetë e drejtë»¹.

Komiteti Qendror dhe aparati i tij, duhet të organizojnë dhe të perfekcionojnë më mirë punën e tyre duke u shkundur nga burokratizmi, nga letrat e tepërtë që u kanë zënë këmbët dhe të janë si duhet në krye të kontrollit rigoroz të zbatimit të vendimeve. Po e njëjta gjë është edhe për Këshillin e Ministrave dhe aparatet e tij.

Ne duhet të njohim ndershmërisht këto gabime dhe të meta që janë vërtetuar në punën tonë, pse vetëm kështu do të përparojmë, do të fuqizohet punajonë dhe do t'u bëjmë ballë me sukses detyrave që nadalin përpara në planin pesëvjeçar.

Në rezultatet e arritura me planin dyvjeçar dhe në përgjithësi në sukseset e shumta të korrura në të gjitha fushat e aktivitetit tonë shtetëror, do të zbatohet realizimi me sukses i planit tonë të parë pesëvjeçar. Realizimi me sukses i këtij plani, do të ketë si rezultat përmirësimin akoma më të madh të jetës së masave punonjëse të vendit tonë. Plani ynë pesëvjeçar, do të realizohet me sukses jo vetëm për arësy se ekzistojnë të gjitha konditat në Republikën tonë Popullore, por edhe pse ne ndihmohemi nga Bashkimi i lavdishëm Sovjetik dhe nga shoku Stalin personalisht si dhe nga popujt e vendeve të demokracisë populllore. Nuk do të hyj në detaje dhe në shifra të planit pesëvjeçar, pse ai do të trajtohet në pikën e dytë të rendit të ditës

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 133.

nga shoku Mehmet Shehu, por dua të theksoj, vetëm me disa shifra, rëndësinë e madhe të planit pesëvjeçar.

Në këtë plan parashikohen si investime 21 miliard lekë. Kjo shifër është tri herë më e madhe se të gjitha investimet që janë bërë në vendin tonë që prej vitit 1946 e deri në 1950. Vlera e përgjithshme e prodhimeve të industrisë dhe të bujqësisë në vitin 1955 do të arrijë në më se 19 miliard lekë (me çmimet e vitit 1950) dhe kjo do të thotë se vëllimi i prodhimit industrial e bujqësor në vitin 1955 do të jetë 426 për qind në krahasim me vitin 1938 të paraluftës.

Vëllimi i të ardhurave të popullatës në vitin 1955 do të jetë më se dy herë më i madh në krahasim me vitin 1950.

I tillë do të jetë plani ynë pesëvjeçar, i madh do të jetë suksesi i popullit tonë, e fortë do të bëhet ekonomia jonë, më e mirë do të bëhetjeta e popullit tonë dhe do të forcohet Republika jonë Popullore. Këto suksese duhet t'i arrijmë dhe do t'i arrijmë.

Por që të realizohen këto suksese, neve na vihen detyra shumë të mëdha përpara.

Detyra politike kryesore e planit tonë pesëvjeçar konsiston:

NË FORCIMIN E ALEANCËS MIDIS KLASËS PUNËTORE DHE FSHATARËSISË PUNONJËSE DHE NË FORCIMIN E ROLIT DREJTUES TË KLASËS PUNËTORE NË KËTË ALEANCË; NË KUFIZIMIN E ELEMENTËVE KAPITALISTË DHE SPEKULATORE TË QYTETIT DHE TË FSHATIT; NË RRITJEN E NIVELIT KULTURAL TË MASAVE PUNONJËSE; NË FORCIMIN E NDËRGJEGJES SOCIALISTË TË KLASËS PUNËTORE DHE NË FORCIMIN E VIGJILENCËS REVOLUCIONARE E TË PATRIOTIZMIT TË TË GJITHA MASAVE PUNONJËSE.

“ Përveç këtyre, detyra ekonomike kryesore e planit të parë pesëvjeçar konsiston:

NË VAZHDIMIN ME NJË RITËM MË TË SHPEJTE TË PUNËS PËR NDËRTIMIN E BAZËS EKONOMIKE TË SOCIALIZMIT, PËR TË BËRE QË NË FUND TË PESEVJEÇARIT VENDI YNË TË JETË TRANSFORMUAR NGA NJË VEND AGRAR I PRAPAMBETUR NË NJË VEND AGRARO-INDUSTRIAL.

Nuk do të zgjatem gjithashtu në detyrat që i vë përpara çdo komunisti, çdo qytetari të Republikës Popullore të Shqipërisë, gjithë Partisë dhe organeve shtetërore plani ynë pesëvjeçar, por do të kufizohem vetëm të them, se konditat kryesore, të domosdoshme dhe të nevojshme për zbatimin me sukses të çështjeve ekonomike, arësimore dhe kulturale të planit tonë pesëvjeçar janë:

1) Partia duhet të mobilizohet tërësisht, të sigurojë dhe të organizojë si duhet drejtimin e vet dhe kontrollin e rreptë për kryerjen e detyrave të mëdha. 2) Drejtimi i ekonomisë kërkon një udhëheqje të shëndoshë, të ngritur, operative nga ana e Partisë dhe një kujdes të jashtëzakonshëm për edukimin e kuadrove të saj, të pushtetit dhe të të gjitha degëve të ekonomisë si nga ana ideo-politike, ashtu edhe nga ana tekniko-profesionale.

Realizimi i këtyre detyrave të mëdha lyp:

1) unitetin e çelniktë të të gjithë popullit rrëth politikës shpëtimtare të Partisë së Puñës dhe të qeverisë së Republikës, heroizmin dhe vetëmohimin e të gjitha masave punonjëse të vendit tonë, të klasës punëtore, të fshatarësë, të intelektualëve patriotë, të rinisë, të gruas, të pionierëve.

2) shtimin e madh_{të} produktivitetit në punë nga.

të gjithë punonjësit dhe zhvillimin në shkallë të gjerë të emulacionit socialist, të vënjes në zbatim të metodave të përparuara në punë, në të gjitha degët e prodhimit, të përvetësimit dhe të zbatimit me sukses të eksperiencës së përparuar sovjetike.

3) uljen e kostos në çdo prodhim, duke e administruar çdo gjë në mënyrë më ekonomike, duke e administruar çdo gjë me një dhëmshuri e dashuri të madhe. Ashtu si vepron gjithsecili për sendet e tij personale duhet të veprojë edhe për pasurinë e përgjithshme të popullit, pse interes i seçilit, mirëqenja e tij dhe e familjes së vet është e lidhur dhe kondicionohet nga mbarëvajtja e ekonomisë së përgjithshme dhe begatia e atdheut tonë.

4) një luftë të ashpër dhe energjike, kundër gabimeve, lëshimeve, mungesave në punë dhe në detyrë, kundër vjedhjeve, abuzimeve, prishjeve dhe dëmtimit të pasurisë së shtetit, një goditje të ashpër kundër sabotazheve dhe sabotatorëve.

5) një kontroll të vazhdueshëm, sistematik, rigoroz mbi zbatimin e detyrave të Partisë dhe të shtetit.

Këto janë direktivat më kryesore që ne duhet t'i kemi vazhdimisht dhe çdo orë parasysh, pse vetëm zbatimi i këtyre detyrave me përpikëri, me zemër, me hov revolucionar dhe me patriotizëm, do të na japin fitoren e sigurtë, do të bëjnë që ne të realizojmë me sukses planin tonë të parë pesëvjeçar.

Partia janë heroike, që udhëhiqet në rrugën e lav-dishme të socializmit nga mësimet e të madhit Stalin, angazhohet sot përpara popullit tonë të dashur se do t'i kryejë me nder dhe me sukses këto detyra.

IV

PARTIA JONË NË KRYE TË DETYRËS DHE NË RRUGËN E FORCIMIT TË MËTEJSHËM TË SAJ

Në periudhën që ndan të dy kongreset, në vendin tonë janë realizuar suksese të rëndësishme që i dedikohen faktit se Partia e ka kryer detyrën dhe ka qëndruar si duhet në drejtimin e fateve të popullit. Ajo ka ditur të mobilizojë energjitet e pashtershme të popullit dhe në mënyrë të organizuar t'i hedhë në ndërtimin e bazave të socializmit. Komunistët, të frysmezuar dhe të udhëhequr nga parimet marksiste-leniniste, kanë fituar eksperiencë në drejtimin politik, në organizim dhe janë bërë më të aftë për të kryer detyrat. Lufta e përditshme kundër vështirësive, kundër armiqve të jashtëm dhe të brendshëm, që përpilen të dobësojnë Partinë dhe regjimin e demokracisë popullore, lufta e ashpër kundër titistëve dhe agjentëve të tyre, lufta kundër deviatorëve të rinj, kundër presionit të borgjezisë, e ka çelnikosur Partinë tonë dhe e ka forcuar unitetin e saj. Partia është bërë e aftë të kryejë me sukses detyrat që i vihen përpara dhe të dërmojë tentativat e çdo armiku që do të guxojë ta pengojë në rrugën e saj në interesin e popullit, të paqës dhe të socializmit.

Partia jonë, siç e dimë, shpëtoi nga rreziku i ndërhyrjes së titistëve dhe të agjentëve të tyre Koçi Xoxe me shokë, pse ajo i kuptoi dhe i zbatoi si duhet mësimet e Stalinit. Komiteti Qendror dhe Partia i bënë të tyret mësimet e letrave historike të Partisë Bolshevik drejtuar ish-Partisë Komuniste Jugosllave dhe Rezolucionin e Byrosë Informative «Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave», dërmuan agjentët titistë në Partinë tonë dhe realizuan kthesën historike që e çoi Partinë në rrugë të drejtë marksiste-leniniste. Gjatë gjithë kësaj periudhe, Partia ka qëndruar vigjilente dhe ka goditur ashpërsisht çdo shfaqje të huaj dhe armiqësore. Ajo ka luftuar për mbrojtjen e vijës së saj dhe të parimeve marksiste-leniniste-staliniane, ka luftuar kundër oportunitzmit dhe e ka konsideruar këtë si një shfaqje që çon në zbutjen e luftës së klasave, si një tërheqje nga vija revolucionare e Partisë, që ushtrohet nga ambienti mikroborgjez dhe nga rrethanat e jashtme në përgjithësi.

I) PËRBËRJA DHE SHTRIRJA E PARTISË

Duke zbatuar vijën e Kongresit I Partia ka luftuar për përmirësimin e përbërjes së saj, për forcimin e organizmave drejtuese, për lidhjen e këtyre sa më ngushtë me bazën dhe për përmirësimin e drejtimit të saj. Partia ka arritur rezultate të kënaqshme në këto drejtime:

Efektivi i Partisë në Kongresin I ka qenë 45 382 anëtarë dhe kandidatë. Në këtë kongres përfaqësohen 44 418 anëtarë dhe kandidatë. Siç shihet efektivi i Partisë është pak më i vogël se tre vjet më parë, kjo për arësyte

„se është luftuar më tepër për përmirësimin e cilësisë se sa për shtimin e numrit. Kjo ishte e domosdoshme dhe e drejtë. Partia ka synuar që të vinin në radhët e sajë njerëz të provuar dhe besnikë të komunizmit. Vërtetimi i dokumentave, i cili tani ka marrë fund, ka përjashtuar nga Partia 3 776 vetë. Gjithashtu në këtë periudhë të verifikimit dhe gjatë zhvillimit normal të saj, janë nxjerrë jashtë Partisë dhe 2 220 vetë, të padenjë për të qenë anëtarë të Partisë. Që pas Kongresit I dhe deri në fund të vitit të kaluar janë pranuar në Parti 3 909 anëtarë dhe 7 127 kandidatë partie. Siç shihet numri i kandidatëve në proporcion me anëtarët ka qenë më i madh dhe jo i rregullt. Por kjo gjendje është përmirësuar në përgjithësi, pse ndërsa në prakun e Kongresit I kandidatët përfaqësonin 35,79 për qind të efektivit të Partisë, në prakun e këtij kongresi ata përfaqësojnë vetëm 32,6 për qind. Kjo gjendje do të shkojë duke u përmirësuar.

Shtresat shoqërore në Parti paraqiten në këtë mënyrë: para Kongresit I nuk ka pasur të dhëna ekzakte në lidhje me shtresat, pse konfondohej origjina me gjendjen shoqërore si edhe përcaktimi i vetë origjinës. Tani anëtarë dhe kandidatë me origjinë shoqërore punëtor janë 8,08 për qind dhe me gjendje shoqërore punëtor 11,5 për qind të të gjithë efektivit të Partisë. Në krahasim me numrin e punëtorëve në prodhim, në Parti janë të organizuar vetëm 9,73 për qind. Siç shihet numri i anëtarëve dhe i kandidatëve punëtorë është i vogël. Në këtë çështje influencon fakti që klasa jonë punëtore është e re dhe e vogël dhe tani kjo rritet e forcohet krahas me zhvillimin e industrisë, por megjithatë rritja e

Partisë me elementë të klasës nuk është e kënaqshme. Po ka përmirësimë në këtë drejtim. Pas Kongresit I punëtorët e pranuar në Parti kanë qenë 28,06 për qind dhe kandidatë me origjinë punëtore kanë qenë 21,28 për qind. Kjo rritje në një periudhë të shkurtër, duke marrë parasysh dhe kohën e pezullimit të pranimit në lidhje me verifikimin, nuk paraqitet e keqe, por inkurajuese. Pas vërtetimit të dokumentave u është dhënë prioriteti për pranimet në Parti elementeve të shtresave punëtore. Komiteti Qendror ka ulur stazhin për pranimet në Parti të elementeve punëtorë nga tre vjet në dy vjet për ata të shtresave të varfëra dhe nga katër në tre vjet për ata që vijnë nga shtresat e mesme. Gjithashtu Komiteti Qendror, për ruajtjen e elementit të klasës punëtore ka zbatuar vendimin që çdo përjashtim i një anëtari ose kandidati me origjinë ose me gjendje shoqërore punëtor, të aprovohet prej tij. Vërtetimi i dokumentave të Partisë forcoi gjithashtu përbërjen e saj. Duke bërë krahasim me shtresat shoqërore të vendit tonë, përbërja sociale e Partisë në përgjithësi është e mirë. Nga shtresat e varfëra janë 74,1 për qind, nga shtresat e mesme 22,02 për qind dhe nga shtresat e pasura vetëm 3,7 për qind. Rritja e klasës punëtore dhe kujdesi i vazhdueshëm i Partisë do ta forcojë pa dyshim edhe më tepër përbërjen sociale të saj.

Në lidhje me këtë situatë, Partisë i vihet si detyrë të forcohet me elementë të klasës punëtore dhe të shtrihet sidomos në qendrat industriale, ekonomike të prodhimit si dhe në ato fshatra ku akoma nuk kemi komunistë ose kemi fare pak. Duhet vazhdimesh të luftohet më tepër për cilësinë e mirë se sa për numrin.

Partia duhet të jetë e matur dhe dorështërnguar për pranimin e elementeve që vijnë nga shtresat e pasura dhe të mesme, të ruajë pastërtinë e radhiёve të saja, të ruhet nga demagogët, llafazanët, arrivistët dhe reklamistët, të cilët s'kanë vend në Partinë tonë, të ruajë radhët e saja nga armiqtë e klasës dhe të pushtetit popullor.

Përsa i përket shtrirjes së Partisë, gjatë kësaj periudhe, numri i organizatave bazë ka arritur 130,82 për qind. Në këtë periudhë u ngritën organizatat në bazë prodhimi. Me shtimin e industrisë, janë shtuar edhe organizatat bazë në qendrat industriale, janë shtuar në kooperativat bujqësore, janë krijuar organizata të reja në fshatra. Ky zgierim është normal, i drejtë, i dobishëm, pse Partia krijoi lidhje më të afërta dhe më të shëndosha me popullin. Partia është tani shumë më e lidhur me popullin, ajo drejton më lehtë dhe më mirë se më parë për arësyen se organizatat bazë në fshat nuk u ngritën më në bazë lokaliteti, por në bazë fshati.

Ngritja e komiteteve të Partisë në bazë rrithesh ishte gjithashtu një masë organizative e drejtë për dy arësyen: e 'para, udhëheqja lidhej ngushtë dhe drejtpërdrejt me organizatat e bazës dhe me masën e Partisë dhe e dyta, duke marrë parasysh nivelin e ulët ideologjik e kultural të drejtuesve të Partisë dhe mungesën e eksperiencës në çështjen e drejtimit, format e vjetra organizative të ndarjes administrative në qarqe e prefektura të gjera shkaktonin dobësimin e udhëheqjes. Natyrisht nuk mund të themi se me këtë organizim çdo gjë u ndreq. Ne hasim në vështirësi për arësyen të kërkesës së një numri më të madh kuadrosh me eksperiencë partie dhe drejtimi, të një numri më të madh instruktorësh dhe

organizatorësh partie etj., por me gjithë këto vështirësi janë arritur rezultate të kënaqshme, për arësyen e ekspériencës që na ka dhënë Partia Bolshevikë e Lenin-Stalinit. Parimi i ndërtimit marksist-leninist i Partisë sonë e ka forcuar unitetin e Partisë, lidhjet e bazës me udhëheqjen, éshtë përmirësuar drejtimi, janë edukuar kuadrot. Shoku Stalin na ka mësuar se

«Qëllimi i rajonizimit éshtë të afrojë aparatin e partisë dhe të shtetit, aparatin ekonomik dhe kooperativist, me rajonin dhe fshatin, me qëllim që të krijohet mundësia për të zgjidhur në kohën e duhur çështjet më të ngutshme të bujqësisë, të ngritjes së saj, të rikonstrukzionit të saj»¹.

2) JETA E BRENDSHME E PARTISE DHE ÇËSHTJA E DREJTIMIT TË SAJ

Partia ka luftuar për zbatimin e direktivave që i caktoi Kongresi I. Në Parti u spastruan metodat trockisto-titiste që pengonin vijën politike dhe organizative të saj. Éshtë forcuar disiplina dhe kritika e autokritika, éshtë zhvilluar e forcuar demokracia e brendshme. Zgjedhjet në Parti kanë ndjekur rrugën e drejtë që përcakton Statuti, éshtë braktisur metoda e caktimit nga lart të njerëzve në vende drejtuese, éshtë evituar metoda e kooptimit të njerëzve në forume. Të gjitha këto e kanë

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 12, f. 325-326.

forcuar Partinë, janë forcuar njerëzit, është forcuar "udhëheqja, është forcuar përgjegjësia e njerëzve që bëjnë pjesë në të. Kjo ka sjellë një ndjenjë përgjegjësie më të zhvilluar në komunistët, një qëndrim më të drejtë e konsekuent përparrë detyrave, për ta forcuar dhënjen e llogarisë përparrë masës së Partisë nga ana e udhëheqjes dhe ka forcuar kritikën dhe autokritikën në përgjithësi.

Janë zhvilluar mbledhje të rregullta që pas kongresit e deri sot dhe kjo ka forcuar demokracinë e brendshme. Zgjedhjet e forumeve si dhe të sekretarëve të organizatave bazë janë bërë në fryshtë e një kritike e autokritike të shëndoshë. Kjo fryshtë luftarake, bolshevikë, vërehet veçanërisht në zgjedhjen e sekretarëve të organizatave bazë, të delegatëve për në konferencat e rretheve dhe në zgjedhjen e komiteteve. Këtu duhet kujdesi dhe vigjilanca e anëtarëve të Partisë për të mbrojtur Partinë nga karrieristët, demagogët ose armiqtë.

Por me gjithë këto përparime ne kemi dobësi serioze në kuqtimin dhe në zbatimin si duhet të detyrave dhe në zgjidhjen e problemeve, si nga forumet, ashtu edhe nga komunistët veç e veç. Konferenca II Nacionale e Partisë dhe Plenumi IX i Komitetit Qendror, i kritikoi këto dobësi që konsistonë në zhvillimin jo të rregullt të mbledhjeve të plenumeve dhe të aktiveve të Partisë, në mënyrën e zgjidhjes së problemeve nga drejtuesit, në metodën e punës me plot të meta dhe në moszbativimin si duhet të vendimeve qoftë nga drejtuesit, qoftë nga baza. Kritika e këtyre të metave solli përmirësimë deri në një farë shkalle, pse në zgjedhjet gjatë vitit

1951, komitetet e Partisë dolën me një autokritikë më të mirë dhe me një analizë më të mirë të problemeve dhe aktivitet u thirrën më në rregull. Baza e Partisë jo vetëm i kritikoi më hapët njerëzit që bënin gabime dhe që fshihnin nën autoritetin e Partisë dhe të udhëheqjes të metat e tyre serioze në punë, por studjoi edhe më mirë shumë probleme kapitale për Partinë. Organizatat bazë morën shembull dhe përmirësuan punën, u interesuan më gjallërisht për zgjidhjen e problemeve të tyre. Por prapëseprapë edhe këto rezultate nuk janë të kënaqshme, ne duhet të njohim se dobësítë ekzistojnë dhe t'i kritikojmë ashpër. Komunistët nuk duhet t'i alarmojë qëndrimi kritik përpara gabimeve, por duhet t'u shtojë forcën dhe kurajën për të përmirësuar punën. Vështirësitë dhe pengesat natyrisht janë të mëdha, por shoku Stalin na mëson:

«Eshtë fjala për karakterin e veçantë të vështirësive tona. Fjala është se vështirësitë tona nuk janë vështirësi që vijnë nga dekadanca apo nga të ngecurit në vend, por janë vështirësi që shoqërojnë çdo proces rritjeje, çdo proces zhvillimi, çdo proces përparimi.

...Kjo do të thotë se vështirësitë tona janë vështirësi të tillë, të cilat përbajnë në vetëvëte mundësinë për t'i kapërcyer. Kjo do të thotë se ajo që i dallon vështirësitë tona është se vetë ato na e jasin bazën për t'i kapërcyer»¹.

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 12, f. 295 dhe 296.

„a) Nuk mjafton të kuptohet në teori rëndësia e udhëheqjes kolegiale dhe ajo e dhënjes llogari para masës së Partisë, por këto duhet të vihen në jetë

Dua të theksoj këtu që mbledhjet e plenumeve e të aktiveve të Partisë nuk zhvillohen kurdoherë në rregull. Ato s'janë të preqatitura si duhet, ato shumë herë bëhen formale, vetëm për të qenë në rregull me Statutin dhe me Komitetin Qendror. Faji për këtë u takon më shumë drejtuesve dhe sidomos shokëve të byrove të komitetave të Partisë. Shokët e byrosë mbulohen me punë të madhe praktike, mbulohen me një det shkresash, preokupohen edhe për zgjidhjen e problemeve shumë të vogla që s'janë për ta, ose për probleme që nuk u përkasin drejtpërdrejt atyre, por sektorit shtetëror dhe harrojnë rëndësinë e mbledhjeve të forumeve e të aktiveve që përbëjnë çështjen kryesore të drejtimit të Partisë. Është e dëmshme për një sekretar të parë rrethi të preokupohet edhe për çështjet më të vogla ekonomike dhe të neglizhojë problemin e madh të furnizimit të qytetit dhe të rrethit të tij, të neglizhojë gjendjen shëndetësore dhe arësimore, të neglizhojë ngritjen ideo-politike të masës së Partisë. Kuptohet vetëvetiu se këta drejtues nuk janë në gjendje të preqatin mbledhjet e plenumeve e të aktiveve, pse gjërat e vogla u kanë zënë këmbët, nuk shohin problemet e mëdha dhe nuk kanë idenë e plotë se si mund të zgjidhen këto probleme të mëdha.

Është e vërtetë se baza e Partisë duhet t'i kërkojë vazhdimisht llogari udhëheqjes, të kërkojë zbatimin e Statutit, të kritikojë, të ndihmojë dhe të kontrollojë udhëheqjen e cila është përgjegjëse para saj. Po kjo

nuk bëhet sa duhet, jo pse baza nuk është në gjendje ta bëjë këtë, po në shumë raste drejtuesit e pengojnë dhe një nga format që e pengon bazën të zhvillojë kontrollin e vet, është moszhvillimi i rregullt i mbledhjeve të komiteteve e të aktiveve të Partisë. Komiteti Qendror i Partisë ka faj në këtë drejtim, pse nuk e ka ndjekur në rregull zbatimin e direktivave të tija dhe nuk i ka ndihmuar sa duhet rrethet mbi mënyrën e zhvillimit të këtyre mbledhjeve dhe shtruarjen e problemeve. Nga ana e tyre byrotë e komiteteve të Partisë në rrethe i janë shmangur kësaj detyre kaq të madhe. Kjo tregon se drejtuesit në rreth nuk e kanë kuptuar si duhet ç'do të thotë udhëheqje kolegiale dhe dhënje llogari para Partisë. Nuk mjafton të kuptohen këto gjëra në teori, por duhet të vihen në jetë. Për këtë çështje justifikime nuk mund të ketë. Kur paraqitet rasti udhëheqja duhet të pengohet të shkelë parimet kryesore të demokracisë së brendshme që formojnë një nga kriteret e udhëheqjes së drejtë. Metoda e punës në forumet udhëheqëse të Partisë është akoma e dobët, me të meta serioze, atje ka javashllëk, burokratizëm të madh, prakticizëm dhe preokupim për probleme të dorës së tretë dhe të katërt. Forumet e Partisë mbyten në shkresa, preokupohen shumë për punët shtetërore, i monopolizojnë këto dhe nënveftësojnë natyrisht organet e pushtetit. Një drejtim i tillë na shkakton dëme të rënda, pse jo vetëm dobëson aktivitetin e përgjithshëm të funksionarëve të pushtetit dhe të ekonomisë, por nga ana tjeter, komiteti i Partisë duke u ngarkuar shumë me çështje të karakterit ekonomik, të cilat duhet t'i zgjidhë pushteti, i heq vetes mundësinë që të përqëndrohet në problemet kryesore dhe t'i kush-

tojë kujdesin e duhur punës politike me masat për realizimin e detyrave ekonomike dhe edukimin e gjithanshëm të. masave si dhe të merret pak më tepër e më thellë me problemet e jetës së brendshme të Partisë. Në këtë mënyrë, komiteti i Partisë nuk e luan si duhet rolin udhëheqës, por bëhet sikur është organ ekzekutues i pushtetit dhe i kontrollit të shtetit. Udhëheqjet e Partisë në rrethe bëjnë faj të rëndë në këtë drejtim dhe duhet t'i korrigojnë sa më parë këto të meta. Kompetenca duhet të jenë të qarta, si për forumet e Partisë, ashtu edhe për ato të pushtetit, pse vetëm kështu do të zgjidhen shpejt dhe drejt problemet, do të vihen njerëzit përpara përgjegjësisë, do të kontrollohet zbatimi i vendimeve, qëndrimi i njerëzve përpara detyrës dhe do të luftohet burokratizmi. Vetëm kështu do të arrihet të kuptohet si duhet drejtimi i vërtetë i Partisë.

· Për mjaft njerëz që drejtojnë nuk është i qartë kuptimi i udhëheqjes kolegiale në Parti. Kjo ngjet në mjaft shokë të byrove, të cilët e kanë të errët këtë çështje. Duke ecur nga parimi jo i drejtë që çdo gjë të kryhet vetë, lind puna individuale në preqatjen, në marrjen e masave dhe të vendimeve, problemet nuk thellohen dhe nuk studohen në mënyrë kolegiale. Këndej lind çështja e vendimeve të marrura në mënyrë të përciptë, të shpejtuar, jo të plota. Natyrisht kur punohet në këtë mënyrë, detyra e rëndësishme e punës organizative të Partisë që konsiston në organizimin e zbatimit të një vendimi, nuk bëhet si duhet. Kuadrot duhet të jenë në gatishmëri të luftojnë për zbatimin e vendimeve, pse këta luajnë një rol vendimtar në arritjen e suksesit. Kjo gjë parashikon që të gjithë të kenë të

qartë punën e tyre, jo vetëm se çfarë duhet të bëjnë, por edhe se si duhet të punojnë dhe q'rrugë duhet të ndjekin për të pasur rezultate. Kur një punë e tillë bëhet e çalë që në embrion, natyrisht ky vendim, për ata që do ta zbatojnë, nuk mund të jetë shumë i qartë. Merren vendime, bile shumë, por nuk zbatohen të gjitha. Atëherë merren gati po aq vendime për të zbatuar vendimet që janë marrë më parë. Merren gjithashtu vendime të reja për çështje që janë vendosur, por janë harruar. Kësaj i thonë të tallesh me punën dhe me vendimet, të hiqesh sikur punon duke pjellë vendime, por në realitet s'bën gjë, qëndron në vend dhe pengon punën.

Shumë herë në byrotë e komiteteve të Partisë të rretheve, disa shokë nuk interesohen gjallërisht për të gjitha problemet që i përkasin udhëheqjes, por kufizohen për sektorin e tyre të caktuar. Kjo është një e metë e madhe që duhet zhdukur. Edhe kur përgjigjen për sektorin e tyre të caktuar, ata s'janë pozitivë në dhënjen e llogarisë për kryerjen e detyrave, por sjellin njëmijë arësy e shfajësimë dhe dalin me konkluzione se detyra nuk u realizua për arësy se «ka faj ai ose ky, pse ra shi, ose fryu erë». Dhe çështja është se krijohet në udhëheqje një situatë e tillë, plot justifikime dhe familjaritet saqë bëhet një sëmundje e përgjithshme. Dobësohet, pra, kritika dhe autokritika, të gjithë janë të komprometuar, kush më shumë e kush më pak, dhe ai shok që nuk e ka kryer detyrën, nuk qortohet si duhet, as skuqet dhe as tronditet.

Në shumë raste organet e Partisë nuk punojnë sa duhet me operativitet dhe prediminon metoda e punës deklarative dhe konferenciale. Kjo metodë pune i çon

drejtuesit në rrugën e përciptë, të mos thelohen dhe vendimet të merren keq. Nuk veprohet shpejt për të zgjidhur çështjet, për të zhdukur të metat dhe kjo bëhet gjoja për t'u qëndruar besnikë rregullave të procedurës. Bëhen mbledhje mbi mbledhje që zgjatin me orë dhe me ditë të tëra dhe shumë pak gjë mbelet mbi shoshë. Ne nuk jemi kundër mbledhjeve, as edhe kundër shkresave të nevojshme, pse një shtet nuk mund të ecë pa to, por ka mbledhje e mbledhje dhe shkresa e shkresa. Unë mund të marr shembuj plot për këtë çështje, por do të jap dy shembuj tipikë:

Për të transferuar një peshore nga një ndërmarrje në një tjeter, i është dashur njërit nga shokët nënkyryeministra të organizojë dy mbledhje ku merrnin pjesë qdo herë ai vetë dhe katër-pesë ministra dhe nënministra, i është dashur të krijojë një komision me inxhinierë dhe ekspertë, të cilët u dërguan në vend ta këqyrnin këtë peshore, i është dashur të shkruajë gati 10 shkresa zyrtare dhe nja 10 të tjera anekse. Dhe këtë problem «kaq të madh» dhe «kaq të koklavitur», që mund të zgjidhej, sikundër u zgjidh në pesë minuta, e sollën deri në mbledhjen e Kryesisë së Këshillit të Ministrave. Kësaj i thonë kulmi i burokracisë. Ne jemi kundër këtyre mbledhjeve dhe këtyre shkresave. Një shembull tjeter:

Një bimsë e errët e një shtëpie në Fier, e cila duhej për depo ullinjsh, u bë një problem i dorës së parë. Njëri e kërkonte, tjetri s'e jepte. Atë s'e zgjidhi dot komiteti i Fierit, atë s'e zgjidhën dot dy ministritë, por çështja u shtrua para dy nënkyryeministrave, derisa u arrit të shtrohej dhe në mbledhjen e qeverisë. Natyrisht, në rast se ministrat dhe nënkyryministrat që u morën me këto

probleme, do t'i kishin kushtuar jo një orë, jo një ditë, por edhe një javë mbledhje çështjes së fabrikës së marmallatave, veglat e së cilës prej katër vjetësh me radhë po kalben e prishen në rrugën e madhe dhe të mos e vinin qeverinë në gjumë, po të kishin ngritur fabrikën në këmbë dhe ta bënин të prodhonte, ne nuk do të ishim aspak kundër këtyre mbledhjeve dhe atë kohë prej një javë, nuk do ta quanim aspak kohë të humbur, por të frutshme. Por kështu, popullit jo vetëm që marmallatë s'i zuri dhëmbi, por edhe maqineria po i prishet.

Tipik është gjithashtu shembulli i Komitetit të Partisë të rrethit të Krujës, i cili gjatë vitit 1951 ka marrë 23 herë në studim çështjen e grumbullimit, domethënë ka bërë 23 mbledhje për këtë gjë. Për fat të keq asnjëherë nuk i ka dhënë rrugë këtij problemi kaq të rëndësishëm. Por edhe problemet e tjera që janë po aq të rëndësishme kanë mbetur pa zgjidhje të kënaqshme, pse kohën ua kanë ngrënë mbledhjet për çështjen e grumbullimeve.

Në rrethet ku puna bëhet në mënyrë të tillë, kriohen në njerëzit e byrove të komiteteve të Partisë një kënaqësi në vetëvete dhe për të fshehur gabimet, ose shkohet vazhdimi shë duke bërë kritika formale, ose përdoret autoriteti i Partisë për të goditur kuadrot poshtë, pse gjoja ata e kanë të gjithë fajin që problemet nuk zgjidhen. Kalohet atëhere në arrogancë, merren masa të tepruara, shtypen kuadrot, mbytet kritika nga poshtë-lart dhe procedohet nga pushimet dhe transferimet. Disa udhëheqës mendojnë se pa ata nuk mund të ecë puna, se ata duhet të gjenden kudo. Këta mbivlerësojnë veten dhe nënvleftësojnë kuadrot e tjerë, mbytin hovin

krijues dhe frenojnë iniciativën. Por ata krijojnë fryshtësimin e sëmurë në byro dhe pikëpamjen e dëmshme se ky forum mund t'i zgjidhë të gjitha problemet dhe se ka kapacitetin dhe rolin të vendosë dhe të veprojë pa komitetin e Partisë për rrithin. Këtej rrjedh nënveftësimi i udhëheqjes kryesore të Partisë. Këtu është burimi që mbledhjet e komiteteve nuk bëhen në rregull, që problemet atje nuk shtrohen të studjuara, që problemet atje nuk rrihen dhe nuk merren vendime dhe direktiva që t'u shërbejnë si drejtim pune byrosë dhe gjithë Partisë në rrith. Roli drejtues, edukues dhe kontrollues i komitetit të Partisë në rrith dobësohet. Byroja e komitetit të Partisë e ndjen veten si e vëtmja udhëheqëse në rrith dhe sikur është përgjegjëse vetëm përparrë Komitetit Qendror. Pak e ndjen veten përgjegjëse përparrë komitetit të saj dhe Partisë në rrith që e kanë caktuar dhe zgjedhur dhe që duhet vazhdimiشت t'u japë llogari. Në këtë çështje këta shokë që mendojnë kështu, dashur padashur deformativë parimin e centralizmit demokratik dhe të demokracisë së brendshme të Partisë. Pikëpamje të tillë, jo vetëm të çojnë në nënveftësimin e punës kolegiale në byro dhe në komitet, po të bëjnë të nënveftësosh udhëheqjen kryesore të Partisë në rrith dhe të mos ndjesh nevojën e ndihmës dhe të kontrollit të saj. Bile kontrollin e saj disa herë përpigjen ta evitojnë. Natyrisht pikëpamje të tillë antimarksiste të drejtimit të Partisë e dobësojnë shumë udhëheqjen dhe Partinë dhe duhen luftuar pa mëshirë këto tendencia, pse po të ecet në këtë rrugë, krijojen tarafe shokësh të lidhur me simpati të sëmura, krejtësisht të huaja për Partinë. Të tillë gjëra na ngjanë në byronë e Komitetit të

Partisë të Qytetit «Stalin» me ish-sekretar Pajo Islamin, në Komitetin e Partisë të Lushnjës me tarafin e Hasan Ginës, në byronë e Komitetit të Partisë të Shkodrës, na ngjanë në byronë e Komitetit të Partisë të Pukës me ish-sekretarin e dytë të komitetit të Partisë, Z. G. Drejtues të tillë me pikëpamje të sëmura, krijojnë mendimin se byroja është çdo gjë, vetë zot vetë shkop, se njerëzit që e formojnë janë të pagabueshëm dhe të pëkritikueshëm. Këta duke punuar dhe menduar keq, nënveftësojnë gjithashtu anëtarët e plenumeve të komiteteve të Partisë, të cilët konsiderohen si pa rëndësi dhe mjaft të kryejnë detyrën që u është caktuar në pushtet ose në aparatet e Partisë. Në praktikë të gjérave, një frymë e tillë vërehet jo vetëm nga ana e disa drejtuesve të byrosë, por fillohet të bëhet një jetë dhe në vetë anëtarët e plenumeve. Këta shokë harrojnë detyrën kryesore që u ka ngarkuar Partia duke i caktuar në udhëheqje, harrojnë se ata janë udhëheqës të Partisë mi parë se të janë kryetarë dege osc drejtorë fabrike. Kjo pikëpamje vërehet dhe në disa anëtarë të Komitetit Qendror. Në praktikë fusha e aktivitetit të këtyre shokëve kufizohet në punën që u është caktuar si kryetar dege apo drejtor fabrike osc ministër. Më larg ata nuk shohin, nuk marrin mundimin të shohin, nuk marrin kurajën të ndërhyjnë, të këshillojnë, të kërkojnë të merren masa urgjente, të vënë përpara përgjegjësisë njerëzit e byrosë që janë të ngarkuar të ekzekutojnë vendimet e Komitetit Qendror dhe të plenimit të komitetit të rrethit. Jo, këta shokë janë indiferentë për çështjet e udhëheqjes. Ata nuk interesohen si vend grumbullimet, si shkon edukimi në Parti, si zhvillohet

industria, si shkon arësimi dhe kultura e shumë probleme të tjera. Pak i shkon ndërmend p.sh. një anëtarë të komitetit të Partisë të vejë të bisedojë me përgjegjësin e arësimit për çështjen e arësimit dhe të kulturës në rrëth, të vejë të vizitojë shkollat e qytetit dhe të fshatit dhe të bindet ai vetë nëse zbatohen ose jo vendimet e Partisë dhe të qeverisë dhe bisedat që mbajti përgjegjësi i arësimit janë të vërteta apo janë përralla. Kuptohet, pra, se në këtë mënyrë plenumi si udhëheqje nuk do ta ngrëjë kurrë këtë problem në rast se nuk e ngrë byroja. Në rast se byrosë nuk i bëhet vonë, asnjeriu s'i bie ndërmend, pse ky problem as që e ka preokupuar. Por edhe kur e shtron byroja, diskuton vetëm përgjegjësi i arësimit dhe i kulturës e ndonjë intelektual dhe puna mbaron me kaq. Të tjerët s'kanë ç'thonë, pse as që i ka preokupuar ky problem. «S'ka diskutime — thuhet — s'ka kritikë dhe autokritikë». Por si mund të ketë diskutime, si mund të ketë kritikë dhe si mund të bëhet autokritikë në këto situata? Atëherë arrihet në konkluzione të gabuara që Partia është e ulët. Partia është me të vërtetë e ulët nga ana ideologjike dhe kulturale, por jo në atë shkallë siç mendojnë disa drejtues. Pra udhëheqësit e organizatave të Partisë duhet të janë të gjallë, aktivë, punëtorë, vigjilentë për punët e drejtimit, të preokupohen vazhdimisht për të gjitha problemet, se përgjegjësi s'ka vetëm një në këto çështje, ka përgjegjësi personale në udhëheqje, ka dhe përgjegjësi kolektive. Këto janë ngushtësisht të lidhura dhe duhet të ecin së bashku.

**b) Në qoftë se nënvleftësohet aktivi i Partisë,
atëhere nënvleftësohet roli i Partisë**

Kur drejtuesit e Partisë nuk e kanë kuptuar drejt këtë problem të rëndësishëm, kuptohet që çështja e aktiveve të Partisë është akoma e dobët. Duhet të pranojmë se udhëheqja e Partisë në rreth nuk i përdor aktivitet si duhet në rrugën e drejtë që i ka caktuar Statuti, nuk i konsideron ata si ndihmës të dorës së parë të saj dhe këshillues, drejtues, orientues të të gjithë punës së Partisë dhe të udhëheqjes. Udhëheqjet e Partisë duhet të mos harrojnë se në këto aktive përfaqësohen e gjithë organizata e Partisë e rrethit, atje vijnë delegatë njerëzit më të zgjedhur të Partisë, të bazës, për të studjuar probleme të rëndësishme, për të marrë vendime me rëndësi, për të korrigjuar gabimet e shfaqura në punë, për të ndrequr gjërat dhe njerëzit që gabojnë dhe për të propozuar masa për njerëzit që s'janë për udhëheqje. Në qoftë se nënvleftësohet aktivi i Partisë, atëhere nënvleftësohet roli i Partisë dhe puna drejtuese merr një formë burokratike, shkelet gjithashtu parimi i centralizmit dhe i demokracisë së brendshme të Partisë. Drejtuesit atëhere nuk mbështeten sa duhet dhe si duhet te Partia, ata janë shkëputur në praktikë nga baza dhe lidhjet më bazën, me gjithë frazat e shumta, nuk janë të forta dhe reale. Në rast se kjo çështje nuk kuptohet drejt, atëhere vendimet e marrura nga udhëheqja nuk mund të bëhen si duhet probleme të organizatës bazë, këto nuk mund të mobilizohen si duhet për problemet që

u shtrohen nga lart. Pastaj është edhe ana tjetër e rëndësishme e çështjes. Këto vendime që çohen nga lart, duhet të zbatohen patjetër nga organet vartëse dhe nga baza. Ky është parimi i centralizmit demokratik. Por të mos harrojmë nga ana tjetër që tok me zbatimin e domosdoshëm të vendimeve e të direktivave vepron edhe demokracia e brendshme, vepron dinamizmi i Partisë, vërtetimi i saktësisë së vendimit, anët e mira dhe të metat e tija, të cilat rëndojnë në kurrizin e bazës së Partisë dhe të masave të popullit. Partia ka objektione, vërejtje, korrigjime, sugjerime për vendimet e marrura dhe që ekzekutohen prej saj. Ajo bën propozime për korrigjime, ndryshime, përmirësimë. Këto duhet t'i dëgjojë udhëheqja, t'i studjojë, t'i marrë parasysh gjërat e mira dhe të skartojë propozimet e gabuara. Por kur do t'i marrë në shqyrtim udhëheqja këto gjëra, në rast se vazhdon të punojë në këto forma burokratike, të mos u japë rëndësinë e duhur mbledhjeve të plenumeve, të neglizhojë mbledhjet e aktiveve, të mos lexojë dhe studjojë si duhet dhe shumë herë raportet dhe protokollet e organizatave bazë ose raportet e instruktorëve dhe organizatorëve të Partisë, ose të mos bëjë në rregull seminaret me sekretarët e organizatave bazë? Kur veprohet kështu udhëheqja qëndron si peshku pa ujë, dhe atëhere ajo vepron nga lart, ajo s'e zotëron situatën. Rëndësia e aktiveve qëndron në mobilizimin e organizatave të Partisë, në shtimin e aktivitetit të të gjithë masës së Partisë. Aktivet duhet të mblidhen vazhdimisht për të diskutuar vendimet më të rëndësishme të Partisë dhe të qeverisë dhe realizimi i këtyre vendimeve, që duhet të kuptohej

një herë e përgjithmonë, varet prej aktiveve, sepse këto ua shpjegojnë masave vendimet në fjalë, mobilizojnë për zbatimin e tyre gjithë komunistot dhe me anën e tyre gjithë masat punonjëse. Aktivi, mos harrojmë, grumbullon kuadrot më të mirë të Partisë dhe të shtetit dhe kjo do të thotë shprehja më e gjallë e opinionit të të gjithë Partisë. Nga Lenini, Stalini e Partia Bolshevike mësojmë se kompaktësia bolshevike e aktivit të partisë është kusht i domosdoshëm për një punë me sukses të çdo organizate të partisë. Aktivet, në asnjë mënyrë nuk duhet të thirren me qëllim formal dhe aprovimi solemn dhe të kotë të vendimeve të partisë, por me qëllim që të diskutohen me të vërtetë këto vendime. Të nënçmuarit e aktivit të partisë, mospërfillja e aktivit, është e papajtueshme me politikën organizonte leniniste-staliniane, kjo cënon demokracinë e brendshme të partisë dhe ka si pasojë të paevitueshme dobësimin e punës së partisë.

c) Kritika dhe autokritika bolshevike në Partinë tonë nuk mund të njohin as kondita as kufi

Mësimet e shokut Stalin dhe të Partisë Bolshevike, t'i ketë orë e çast parasysh Partia jonë dhe asnjë grimë nuk duhet t'u shmanget këtyre mësimeve jetike. Ne mund të flasim shumë pér demokracinë e brendshme, të kërkojmë të forcohet kritika dhe autokritika, vetinisiativa e anëtarëve të Partisë, por do të kemi pak rezultate, në rast se këto nuk zbatohen konkretisht në jetë dhe në praktikë nëpërmjet formave organiza-

tive që ka përcaktuar Partia. Vetëm demokracia e brendshme i jep mundësitë masës së Partisë të kritikojë, të kontrollojë udhëheqjen dhe të zgjedhë në organet drejtuese njerëzit më të denjë. Kritika bolshevike duhet të fôrcohet në radhët e Partisë dhe krahas me të edhe autokritika. Kritika bolshevike duhet të forcohet dhe sidomos nga poshtë-lart, pa marrë parasysh se i kritikuari qenka personalitet me rëndësi i Partisë ose i pushtetit. Kritika dhe autokritika bolshevike në Partinë tonë nuk mund të njohin as kondita as kufi. Kritika duhet të drejtohet e ashpër kundër cilitdo që gabon, qoftë i madh ose i vogël, i vjetër ose i ri në Parti dhe sidomos të jetë e ashpër kundër atij që është me funksione të larta dhe i vjetër në Parti, por që vazhdon të bëjë gabime. Autokritika gjithashtu duhet të bëhet e hapët, e singertë nga cilido dhe të mos harrojmë se autokritika është vetëm fillimi i çështjes,jeta dhe praktika duhet të tregojnë se vallë me të vërtetë ajo autokritikë ka qenë e singertë, apo i përngjiste rrëfimit te prifti. Nuk përdoret si duhet dhe sa duhet kritika nga poshtë-lart. Pse druhën vallë njerëzit që nuk kanë guximin ta përdorin këtë armë dhe këtë të drejtë të madhe që u jep Partia, armë të cilën ajo u thotë ta përdorin pa hezitim, pa drojtje, kundër kujtdo qoftë, pa marrë parasysh personin dhe pozitën e tij? Kritika dhe autokritika e çon punën tonë përpara, e kundërtë e kalb punën tonë. Po të kihet frikë nga një person me pozita të larta, atëhere ne s'jemi në rrugën e Partisë, atëhere te ne kanë bërë fole pikëpamjet mikroborgjeze, oportunizmi, servilizmi, hatërlëku, ambicia, familjari-teti, frika etj. të këqia, të huaja për komunistët. Mos

vallë nuk e kritikojmë një më të madh se mendojmë se «ai gjen shpejt rastin dhe na e bën të keqen»? Edhe ata që mendojnë kështu, s'janë në rrugën e Partisë, s'e kanë kuptuar se ç'është Partia jonë, bile kanë një kuptim të shtrembër.

Një bandë hajdutësh është zbuluar kohët e fundit duke vjedhur në kurri zbuluar nga Librarisë qendrore. Në krye të kësaj bande ka qenë edhe një që fshihej nën teserën e anëtarit të Partisë. Ky ishte një farë Rexhep Luga. Në organizatën bazë ku gjendej ky njeri, disa anëtarë shfaqën dyshime ndaj shoferit të kësaj ndërmarrjeje, i cili brenda një kohe të shkurtër na u bë i pasur, na harxhonte të holla pa kursyer dhe mbi të gjitha na bleu dhe një shtëpi. Ata e shtruan çështjen në organizatë, po nuk e vazhduan në mënyrë bolshevike, pse ky hajdut i maskuar u imponua në organizatë me demagogjinë e tij, me pozitën e tij dhe me fjalë bombastike. Ai u kthye dhe akuzonte shokët e Partisë se gjoja e akuzonin pa të drejtë shoferin në fjalë, se Partia nuk lejon një gjë të tillë e të tjera përralla. Dhe shokët përpara këtij demagogu dhe kusari të maskuar u tërroqën. Këtu është gabimi i shokëve, pse jo vetëm që shoferi ishte hajdut, por vetë ai që mbronte shoferin ishte kryehajduti. Ai mbronte veten dhe shokët e tij në mënyrë konsekiente, kurse shokët e mirë të Partisë nuk i mbrojtën si duhet me vigjilencë dhe me kurajë bolshevike Partinë dhe interesat e popullit.

Kritika dhe autokritika shumë herë mbyten nga njerëzit lart, por edhe nga disa njerëz poshtë në të cilët mbizotërojnë pikëpamjet e huaja mikroborgjeze. Shihet shumë herë nëpër mbledhje, kur guxohet të

kritikohet hapët ndonjë drejtues ose jodrejtues, të ngrihet qoftë i kritikuari, qoftë miku i tij dhe t'i presë fjalën atij që bën kritikën duke thënë: «Pa të na thotë pakëz shoku për veten e tij, pse e bëri këtë ose atë gjë dhe pastaj të kritikojë të tjerët». Një ndërprerje e tillë e palejueshme dhe e dënueshme, është një nga format mbytëse të kritikës. Jo vetëm kritikuësi e humbet pusullën, por edhe të tjerë shokë që dëshirojnë të thellojnë edhe më mirë kritikën ngurrojnë. Po pse, ngurrojnë? Natyrisht se dhe ata do të kenë bërë disa gabime në punën e tyre. Këtu përfitojnë njerëzit që nuk e durojnë kritikën. Mbledhja ose konferanca që bëhet ka qëllim, atje shtrohen një ose dy probleme, merren vendime dhe kritikohen njerëzit që, të ngarkuar për ta zbatuar këtë detyrë, kanë bërë gabime. Kritika duhet të drejtohet vetëm kundër gabimeve kryesore dhe shokëve që i kanë bërë këto gabime. Shokët duhet të kritikojnë pa frikë autorët e këtyre gabimeve qoftë edhe sikur këta kritikues komunistë të kenë bërë dhe ata gabime në punë në të kaluarën ose në të tashmen, por gabimet e tyre ose i kanë njojur më parë dhe i kanë ndrequar dhe atëhere s'bëhet më fjalë, ose ato janë të vogla ndaj gabimeve që kritikohen në atë moment. Dhë s'është aspak komuniste që fajtorët kryesorë të kërkojnë të zvogëlojnë gabimin dhe të tërheqin vëmendjen e mbledhjes duke kërkuar nga njëri e tjetri që edhe ata të bëjnë autokritikë. Këto janë hile për t'i hedhur ujë verës. Ata kërkojnë në këtë mënyrë të transformojnë mbledhjen në një vend ku të gjithë të fillojnë çdo herë të bëjnë rrëfime dhe, ku ishe, hiç gjëkundi, pra, «puna nuk u bë, pse të tërë kemi bërë

nga një çikë faj, kush më shumë e kush më pak dhe hyra mish e dola peshk». S'është aspak e nevojshme që nё çdo mbledhje çdo anëtar i Partisë duhet të jetë i predispozuar të bëjë autokritikë kur ai ka bërë një faj të vogël dhe s'ka lidhje gjékundi me problemin që diskutohet. Atëherë flasim nё teori që kritika duhet të jetë e drejtë, e matur, e ashpër kundër gabimeve të rënda etj., po kur vjen puna për zbatim nё jetë i futim të gjitha nё një thes dhe ngatërrojmë gjithë dynjanë. Të mos harrojmë shokë se, kur arma e kritikës dhe e autokritikës zhvillohet drejt, koncentrohet nё pikat e dobëta dhe të rëndësishme, ajo është një armë e madhe edukative. Shumë shokë gabojnë nё punë, këta duhet t'i njojin gabimet, t'i kritikojnë dhe të bëjnë autokritikë. Kjo ka shumë efekt nё komunistët dhe nё ata që nё disa momente nuk janë predispozuar të bëjnë autokritikë. Zhvillimi i drejtë i kritikës dhe i autokritikës, i edukon ata nё rrugën e drejtë të Partisë të realizojnë nё brendinë e tyre gabimet dhe, duke marrë shembull nga shokët e mirë, nga komunistët e shëndoshë, që s'kanë aspak frikë të kritikojnë nё rrugën e drejtë cilindo qoftë dhe s'turpërohen po e kanë për ndër të njojin ndershmërisht, hapët, nё mënyrë bolshevike, gabimet dhe fajet e tyre dhe t'i japid prova konkrete Partisë se ata me punë, me luftë i kanë korrigjuar, të gjithë të tjerët do të përfitojnë dhe do të përmirësojnë kritikën dhe autokritikën e tyre. Duhet të goditen pa mëshirë ata që mbytin kritikën me lloj-lloj mënyrash. Komunistët duhet të janë vigjilentë për këto hile mikroborgjeze të veshura me petka markiste. Lenini dhe Stalini na mësojnë se autokritika,

zbulimi i gabimeve të partisë, studimi i shkaqeve që kanë çuar në ato gabime dhe caktimi i udhëve të nevojshme për ndreqjen e atyre gabimeve, janë një prej mjetave më të sigurta për edukimin e drejtë të partisë dhe të klasës punëtore. Lenini ka pasë vënë në dukje se krenaria, frika nga autokritika, fshehin në veten e tyre rreziqe të mëdha për partinë, pse partia që vuan prej krenarisë bie në një pozitë të marrë; të turpshme dhe qesharake.

T'i kemi parasysh në çdo çast mësimet e Leninit dhe të Stalinit dhe t'i zbatojmë me përpikëri këto në jetën e përditshme të Partisë, pse vetëm kështu do të forcohet akoma më shumë Partia jonë, do të dalë me sukses lufta e klasës punëtore kundër armiqve të saj, vetëm kështu do të luftojmë me sukses burokratizmin, tendencat e vetëkënaqësisë, të mbivlerësimit të vetëvetes, të qetësimit të vetëvetes që krijojnë dobësi të mëdha politike dhe organizative.

Marrja e masave për përmirësimin e punës në drejtimin e çështjeve që përmenda më lart, sigurisht do të ketë si rezultat forcimin akoma më të madh të rolit drejtues të Partisë, do të forcojë udhëheqjen dhe do ta lidhë atë akoma më ngushtë me bazën e Partisë dhe këtë me masat e gjera të popullit. Byrotë dhe komitetet e Partisë duhet t'u vënë rëndësi të jasht-zakonshme lidhjeve me bazën e Partisë, me organizatat e bazës, pse në këtë drejtim kemi mjaft dobësi. Lidhjet e udhëheqjes me bazën bëhen nëpërmjet jetës së gjallë, kontakteve të përhershme dhe jo vetëm nëpërmjet formave organizative që përmendëm më lart, por nëpërmjet kontaktit të gjallë dhe në vend, të drejtuesve

me organizatën bazë, me komunistët veç e veç, me sekretarët e organizatave bazë veç e veç dhe pastaj nëpërmjet protokolleve të organizatave bazë. Këto mjete kontakti dhe marrëdhënjeje duhet të gjallërohen dhe të forcohen te ne. Disa udhëheqës më të shumtata e rasteve mbyllen në zyra e në letra, por çka është e dënueshme, ata nuk interesohen të studjojnë protokolllet e organizatave, të japid me shpejtësi ndihmën që kërkon baza. Ka shembuj në këtë drejtim që vënë në dukje mungesën e kësaj detyre kryesore. Mjafton të përmendim çështjen e organizatës së Partisë të Dukagjinit në protokollet e së cilës sekretari i organizatës bazë me të drejtë i shkruan Komitetit të Partisë të Shkodrës që të aprovojë përjashtimin nga Partia të një personi pse është spiun i titistëve. Komiteti i Partisë i Shkodrës as e vë këtë ujë në zjarr. Me muaj të tërë as i lexon protokollet e kësaj organizate bazë dhe të organizatave të tjera derisa sekretari i kësaj organizate bazë me plot të drejtë preferon dhe vendos të mos bëjë mbledhje të organizatës përderisa të mos jetë aprovuar përjashtimi i agjentit titist.

Puna e instruktorëve të Partisë dhe e organizatave nuk kontrollohet si duhet nga komiteti i Partisë e sidomos nga byroja. Ata në shumë raste janë bërë postë, transmetues automatë të vendimeve të komitetit të Partisë dhe të byrosë, ata janë kthyer në urdhërdhënës dhe s'kryejnë me të vërtetë funksionet e rëndësishme që u janë ngarkuar. Në këtë drejtim kanë faj drejtuesit pse nuk i ndihmojnë si duhet, nuk i kushtojnë kujdes më të madh edukimit të tyre, nuk analizojnë me një sy kritik e bolshevik punën e tyre

dhe në gabimet e tyre dhe të shokëve të Partisë, t'i mësojnë ata të përmirësojnë punën. Puna e këtyre instruktorëve që janë hallka e rëndësishme e lidhjes së udhëheqjes me bazën është bërë e pakritikueshme, jo pse s'ka në punën e tyre gabime, atje ka plot, por që të dalin gabimet e tyre, duhet të analizohet mirë nga udhëheqja dhe aparatet e komitetave të Partisë puna e tyre, në lidhje me raportet që ata japid, në lidhje me protokollet e organizatave bazë, në lidhje me kontaktet e gjalla dhe operative të drejtuesve me bazën, në lidhje me mbledhjet e aktiveve dhe të konferencave të Partisë. Instruktorët e Partisë në rrethe janë shndërruar në të plotfuqishëm për fushatat ekonomike, për hetime ankesash etj., nuk e kryejnë detyrën e plotë të tyre, për të gjitha problemet që u ka ngarkuar Partia. Edukimi profesional i tyre është shumë i ulët dhe përpjekjet nga ana e tyre dhe nga ana e komitetit për t'i ngritur këta, nuk janë shumë të kënaqshme. Këta instruktorë shkojnë poshtë më shumë të hetojnë, këshillojnë pak, pse kapaciteti i tyre është i ulët. Ata poshtë punojnë vendimet, po nuk janë në gjendje të lidhin ngushtë zbatimin e këtyre vendimeve me masën e Partisë.

Është, pra, e domosdoshme që Partia dhe udhëheqja qoftë lart, qoftë poshtë të marrë të gjitha masat për përmirësimin e metodës së punës dhe atë të drejtimit. T'u vihet rëndësi e madhe mbledhjeve të plenumeve, të aktiveve, të konferencave dhe të seminareve. Të përmirësohen në to puna, të studjohen thellë problemet dhe të merren vendime të sakta. Këto ven-

dime të lidhen mirë me bazën e Partisë dhe me masat e gjera punonjëse dhe të kontrollohet zbatimi rigoroz. Duhet të forcohet kritika dhe autokritika dhe sidomos nga poshtë-lart, pa marrë parasysh aspak personat, të forcohet disiplina dhe konspiracioni i Partisë.

Të ngrihet niveli i drejtuesve si lart edhe poshtë, duke likuiduar metodat e punës deklarative dhe konferenciale dhe me fut në praktikën e punës drejtuese metodën operative me anën e së cilës çështjet zgjidhen shpejt, me kohë dhe nuk lejon të humbet koha në mbledhje të tepërtë, të mërzitshme e të pafrutshme. Drejtuesit e Partisë të kujdesen veçanërisht për ngritjen e nivelit teorik dhe politik të funksionarëve të aparateve të saj, të instruktorëve, të organizatorëve dhe të sekretarëve të organizatave bazë të cilët do të ndihmojnë ngritjen e gjithë elementëve të bazës në një nivel më të lartë. Të studohen vazhdimishit faktet më të rëndësishme nga jeta e organizatës dhe menjëherë të veprohet. Puna e sotme të mos lihet për nesër. S'duhet kurrsesi të lihen në harresë raportet e sekretarëve, të instruktorëve dhe të mos humbet koha me fjalë dhe muhabete të gjata, por të veprohet menjëherë. Të luntohet burokratizmi në të gjithë aparatin e Partisë dhe të shtetit, pse ai është një nga sëmundjet më të rrezikshme që shkatërron punën tonë. Burokratizmi, duhet të dimë, ndalon përdorimin e forcave kolosale rezervë që janë të gatshme të hidhen në luftë për ndërtimin e bazave të socializmit, pengon iniciativën krijuese dhe ndërtuesë të masave. Burokratizmi është armiku më

i rreptë i kontrollit të ekzekutimit të vendimeve. Shoku Stalin na mëson se

«burokratizmi... orvatet t'i shndërrojë udhëzimet kryesore të organizatave udhëheqëse në shkresa boshe, të shkëputura ngajeta reale»¹.

Duhet, pra, t'i shpallet një luftë e rreptë burokratizmit dhe burokratëve dhe jo vetëm kundër burokratëve të vjetër të regjimeve të kaluara, që punojnë në aparatet tona, por edhe kundër burokratëve të rinj dhe «komunistëve» burokratë sidomos, që përpilen të zë-vendësojnë punën e gjallë operative me regjinin e kartave dhe të «dekreteve» e projektvendimeve, pa të cilat mendojnë ata asgjë s'mund të zgjidhet. Shoku Stalin na mëson:

«Detyra jonë është që ta dërmojmë burokratizmin në institucionet dhe organizatat tona, të likuidojmë «zakonet» dhe «doket» burokratike dhe të spastrojmë rrugën për të shfrytëzuar rezervat e rendit tonë, për të zhvilluar iniciativën krijuese dhe veprimtarinë e masave.

Kjo detyrë nuk është e lehtë — vazhdon shoku Stalin — ajo nuk mund të zgjidhet «fët e fët». Por ajo duhet zgjidhur me çdo kusht, në goftë se duam me të vërtetë ta transformojmë vendin tonë mbi baza socialiste»².

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 12. f. 318.

² Po aty, f. 318-319.

Shoku Stalin na jep mënyrën e luftimit të kësaj murtaje. Ai na këshillon të veprojmë kështu:

«Në luftën kundër burokratizmit puna e partisë bëhet në katër drejtime: duke zhvilluar autokritikën, duke organizuar kontrollin e zbatimit, duke spastruar aparatin dhe, më në fund, duke ngritur në aparat njerëz besnikë të dalë nga radhët e klasës punëtore»¹.

3) VERIFIKIMI I DOKUMENTAVE TË ANËTAREVE TË PARTISË

Eksperiencia e Partisë Bolshevikë na mëson se «partia e Leninit dhe e Stalinit e ka shqyrtuar përbërjen e partisë, në një formë ose në një tjetër, në çdo kongres, në çdo konferencë të partisë». Partia Bolshevikë, ka ndjekur me kujdes ndryshimet në efektivin e saj «duke u përpjekur që përbërja e partisë t'i përgjigjet rolit të saj si detashment i organizuar i klasës punëtore, si prijës dhe udhëheqës i shtetit socialist». Duke i ndjekur me besnikëri këto mësime të Stalinit dhe të Partisë Bolshevikë, Komiteti Qendror me vendimin e tij të datës 21 janar 1950, në lidhje me ndërrimin e dokumentave të Partisë, e konsideroi të domosdoshme që të bëhej në të gjithë Partinë vërtetimi i dokumentave të të gjithë anëtarëve dhe kandidatëve të Partisë. Një veprim i tillë i rëndësishëm kishte për qëllim të spastronte radhët e Partisë nga elementët e huaj e të padëshirueshëm që nuk e meritonin të ishin në radhët e

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 12, f. 319.

Partisë, të siguroheshin të dhëna të sakta për çdo komunist, të vendosej rregulli bolshevik në çështjet e administratorit të Partisë dhe, krahas me këto, vërtetimi i dokumentave të vlente për forcimin e jetës së brendshme të Partisë, për edukimin e komunistëve, për forcimin e kritikës dhe të autokritikës, të vigjilencës, të disiplinës. Vërtetimi i dokumentave të Partisë filloi rregullisht më 1 prill 1950 dhe mbaroi në fund të shtatorit 1951. Ky veprim ishte një sukses i madh për Partinë tonë.

Vërtetimi i dokumentave tregoi luftën e gjallë dhe vigjilencën e Partisë për ta kryer me sukses këtë detyrë të madhe. Organizatat bazë kanë marrë pjesë gjallërisht dhe çdo komunist veç e veç. Një preokupacion i madh dhe një dëshirë e zjarrtë ka mbizotëruar në të gjithë komunistët për ta spastruar Partinë nga elementët e futur kontrabandë dhe për t'i mbajtur radhët e Partisë të pastra.

Vërtetimi i dokumentave tregoi se në radhët e Partisë kishin mundur të hynin njerëz të dyshimtë, të padenjë, deri edhe armiq. Në këta të përjashtuar, që përbëjnë gati 8 për qind të efektivit të të gjitha dokumentave të vërtetuara, një pjesë kanë qenë për punë armiqësore në të kaluarën, kanë qenë në radhët e armikut dhe në luftë kundër Partisë; një pjesë janë përjashtuar për aktivitet armiqësor të tanishëm. Kjo pjesë përbën 47,85 për qind të totalit të të përjashtuarve. Një pjesë tjeter që përbën 13,24 për qind të totalit të të përjashtuarve, përbëhet prej elementësh të dobët dezerterë nga fronti i luftës që zhvillon Partia për ndërtimin e bazave të socializmit, që kanë lëshuar deklarata në kohën e okupacionit dhe që mbajnë qëndrime të lëkundshme ndaj armikut të brendshëm dhe të jashtëm dhe

të tjerët, 39 për qind të totalit të të përjashtuarve, përbëhet prej elementësh të pasinqertë, të pavlefshëm, të futur para kohe në Parti që ja kanë fshehur të kaluarën e tyre të dyshimtë Partisë.

Stazhi i këtyre njerëzve në Parti ka qenë: të viteve 1941, 1942, 1943 janë vetëm 19 anëtarë partie të përjashtuar d.m.th. 0,86 për qind të të përjashtuarve; të viti 1944 janë 9,74 për qind të totalit të të përjashtuarve; të viteve 1945 dhe 1946 janë 21,8 për qind dhe të viteve 1947 dhe 1948 janë 55 për qind të totalit të të përjashtuarve. Ç'na tregojnë shifrat e mësipërme? Ato na tregojnë se një numër i konsiderueshëm elementësh të padëshirueshëm, kanë hyrë kontrabandë në Parti në periudhën më kritike që ka kaluar Partia jonë, në periudhën e punës armiqësore të trockistëve jugosllavë dhe të tradhëtarit Koçi Xoxe me shokë. Është e qartë se metodat trockiste, të huajtura nga trockistët jugosllavë, presioni i tyre agjentural brenda në Parti, i kishin çelur dyert elementit ballist, milic, xendar dhe agjent të maskuar për t'i pasur si trupa të sulmit, për të marrë kalanë nga brenda. Pastrimi i radhëve të Partisë nga këta elementë ka qenë një grusht i rëndë për armikun e brendshëm dhe të jashtëm që kishte në ta një mbështetje. Shumë nga këta elementë, në dukje, për të maskuar veprimtarinë e tyre, janë përpjekur të tregohen aktive, të zellshëm, por lufta e shëndoshë që është zhvilluar në organizatat bazë dhe vigjilencia e Partisë i ka zbuluar krejtësisht dhe i ka hedhur jashtë saj.

Gjatë verifikimit është përjashtuar edhe një numër elementësh të pavlefshëm, të degjeneruar, dembelë, që nuk zbatonin vijën e Partisë dhe thyenin rëndë disipli-

nën. Këta elementë, më të shumtët, kanë hyrë në Parti para kohe, në momentin e famshëm «të pranimeve më plan», sipas metodave trockiste jugosllave.

Ka dhe një numër të konsiderueshëm elementësh të përjashtuar nga shtresa të varfëra dhe kryesisht fshatarë të varfër. Këta elementë janë pranuar në Parti vetëm duke u bazuar në shtresën e tyre, pa studjuar të kaluarën, aktivitetin, qëndrimin dhe vendosmërinë e tyre për Partinë. Por kjo tregon edhe se puna edukative më këta ka qenë shumë e dobët dhe në rast se do të ishtë punuar më mirë, një pjesë e tyre do të shpëtohej nga përjashtimi.

Vërtetimi i dokumentave goditi dobësitë dhe të metat në lidhje me qëndrimin dhe aktivitetin e sotëm të komunistëve, si mungesë sinqeriteti në dokumentat e Partisë, thyerje të disiplinës, qëndrime oportuniste, dobësi të ndryshme si fanatizëm, karrierizëm etj. Për këta elementë Partia ka marrë masa edukative të vlefshme për forcimin e disiplinës së Partisë.

Vërtetimi i dokumentave i ka edukuar komunistët dhe ka influencuar shumë në jetën e brendshme të organizatave të Partisë, të cilat tani janë më vigjilente. Vërtetimi ka forcuar shpirtin luftarak të Partisë dhe ka bërë që elementët e dobët dhe të padenjë të mos i rezistojnë dot gjallërisë së Partisë.

Vërtetimi i dokumentave lejoi që të studjohet më mirë jeta e çdo komunisti, e kaluara, e tashmja, zotësia e tyre.

Shtruarja e dokumentave në organizatat bazë për diskutim luajti një rol të dorës së parë. Eksperienca e vërtetimit të dokumentave u ka dhënë komunistëve

një armë për të parë çdo punë të shokëve më thellë dhe sidomos ata janë bërë vigjilentë për shfaqjet e huaja në Parti. Kombativiteti revolucionar në radhët e Partisë është shtuar.

Vërtetimi i dokumentave bëri që organizatat e Partisë të fitojnë një eksperiencë më të mirë në drejtim të çështjeve organizative të Partisë dhe veçanërisht për punën e përbërjes së Partisë.

Rezultatet që dha vërtetimi i dokumentave të Partisë, treguan se organizatat e Partisë e kanë çmuar në përgjithësi drejt rëndësinë e këtij problemi. Kanë punuar më mirë në këtë drejtim organizatat e Partisë të Tiranës, Korçës, Peshkopisë, Gjirokastrës. Në përgjithësi organizatat bazë të Partisë që kanë pasur përbërje më të shëndoshë, kanë luftuar më mirë gjatë verifikimit si organizata e Partisë e Kurveleshit, e Mesaplikut dhe organizatat e Partisë në qendrat e prodhimit në Tiranë etj. Por gjatë verifikimit janë vërtetuar edhe dobësi. Vigjilanca për të ruajtur pastërtinë e radhëve të Partisë nuk ka qenë gjithnjë në lartësinë e duhur. Disa komitete partie në rrethe nuk kanë pasur parasysh disa çështje karakteristike të rrethit të tyre gjatë vërtetimit të dokumentave. Mungesë vigjilence është konstatuar nga komitetet e Partisë të Pukës, Burrelit, Beratit, të cilët janë treguar zemërgjerë dhe të butë ndaj elementeve të padenjë për të qenë në Parti. Dhe pikërisht në këto organizata ku lufta për vërtetimin e dokumentave nuk ka qenë e gjallë, ekzistojnë akoma mjaft të meta në mjaft komunistë, të cilët akoma vazhdojnë t'i përsëritin gabimet që u janë vërtetuar me rastin e verifikimit. Qëndrime oportuniste janë shfaqur gjatë

vërtetimit të dokumentave dhe veçanërisht në Shkodër, Fier, Përmet, Elbasan, Sarandë etj. Në përgjithësi këto të meta janë ndrequr pastaj me ndërhyrjen e vazhdueshme të Komitetit Qendror. Gjatë vërtetimit të dokumentave nuk është pasur parasysh sa duhet puna e armikut, i cili është përpjekur t'i shpëtojë kësaj pune. Ai e paraqiste qenjen e tij në radhët e armikut dhe aktivitetin e tij në të kaluarën si krejtësisht formale. Këta elementë të dyshimtë janë përpjekur të mbrojnë njëri-tjetrin, nuk kanë folur. Të tjerë, si Rahman Uruçi, u lëshonin deklarata dezertorëve gjatë luftës që të forconin pozitat e tyre në Parti. Gjatë vërtetimit elementi armik është përpjekur të shpifë kundër elementit të shëndoshë të Partisë. Ai ka kërcënuar gjithashtu elementë të shëndoshë që të tërhojnë deklaratat e tyre të cilat demaskonin veprimtarinë armike të këtyre njerëzve. Elementi armik ka qenë në veprim dhe merrte kontakte menjëherë me elementët e përjashtuar për t'i tërhequr në punën e tij armiqësore.

Vërtetimi i dokumentave na mëson të përmirësojmë me çdo kusht përbërjen sociale të Partisë me elementë të klasës punëtore dhe me elementë besnikë. T'u vëmë kujdesin më të madh pranimeve të reja në Parti, të ruajmë si sytë e ballit Partinë nga përpjekjet e armikut që kërkon të hyjë në radhët e saja, të forcojmë vigjilencën revolucionare. Në Parti të pranohen njerëz të provuar, pse Partia duhet të jetë si na mëson Stalini:

«një kështjellë, dyert e së cilës hapen vetëm për të sprovuarit»¹.

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 1, f. 69.

Duhet t'i kushtohet një kujdes i veçantë edukimit të anëtarëve dhc të kandidatëve të Partisë dhe të pranojmë në Parti, jo vetëm ata që e meritojnë, por edhe t'i preqatit, pse ndryshe biem në pozitat e oportinizmit organizativ. Këta duhet të edukohen, të lartësohen në një platformë udhëheqësi, pse ndryshe dobësohet roli i Partisë si pararojë c klasës punëtore, dobësohet vigjilanca dhe kapaciteti luftarak i organizatave të Partisë. Të respektohet Statuti i Partisë, të zhvillohet kritika dhe autokritika dhe sidomos nga poshtë-lart. Të forcohen vazhdimisht organizatat bazë të Partisë dhe të bëhen qendra të vërteta të edukimit bolshevik të komunistëve. Këta të jenë në ballë të luftës për problemet ekonomike dhe politike të Partisë dhe të punohet me këmbëngulje për edukimin ideologjik, politik dhe kultural të komunistëve.

Në lidhje me vërtetimin e dokumentave, organizatat e Partisë duhet të tregohen më të kujdeshme kundrejt elementit të përjashtuar nga Partia, pse ekziston rreziku të futen të gjithë në një thes dhe të konsiderohen të gjithë armiq. Po të veprohet kështu do të jetë gabim dhe e dëmshme. Partia duhet të interesohet vazhdimisht për ta, t'i ndihmojë, t'i edukojë, t'i bëjë të vlefshëm.

4) LUFTA KUNDËR TITIZMIT DHE DEVIACIONET NGA VIJA E PARTISE

Trockistët e Beogradit me renegatin Tito në krye janë armiq dinakë që kanë komplotuar e komplotojnë kundër Partisë sonë dhe pavarësisë së atdheut. Dihen metodat që ata përdorën tok me agjentët e tyre tradhë-

tarë Koçi Xoxe, Pandi Kristo e të tjerë për t'ua arritur qëllimeve të tyre, por Partia jonë luftoi me heroizëm, i theu pengesat, i dërmoi tentativat e klikës së Beogradit në saje të mësimeve të Stalinit të madh. Pas disfatës që pësuan agjentët titistë në Partinë tonë, për të lindi një jetë e re dhe Partia korri suksese të rëndësishme. Vetëjeta që ndërtohet në vendin tonë, kombinatet dhe fabrikat madhështore që prodhojnë për popullin tonë, traktoret që çajnë tokat e atdheut, hidrocentralet madhështore që u ngritën dhe po ngrihen, si dhe të gjitha veprat monumentale që ndërton populli shqiptar, i udhëhequr nga Partia e tij heroike, tregojnë vlerën e madhe të letrave të Partisë Bolshevikë dhe të Stalinit që u çorën maskën tradhëtarëve të Beogradit dhe ndihmuani Partinë tonë për të shpëtuar popullin dhe demokracinë popullore në vendin tonë.

Qëllimet e klikës së Beogradit qëndrojnë po ato të përhershmet: të zaptojnë Shqipërinë dhe të shtypin popullin shqiptar. Kuptohet se titistët janë bërë tani më të egër dhe më të tërbuar kundër Partisë dhe popullit tonë, por janë shumë më të dobët, njëkohësisht, sepse forcat e Partisë dhe të popullit tonë janë çelnikosur. Si të gjithë trockistët dhe ata të Beogradit nuk janë veçse agjentë të imperializmit, që kurdisin plane sabotazhesh e diversioni. Por qëllimet dhe metodat e tyre ndaj vendit tonë kanë dështuar dhe do të dështojnë, pse Partia dhe populli ynë qëndrojnë vazhdimisht vigjilentë dhe i shkatërrojnë planet e tyre pa mëshirë.

Me gjithë sukseset që ka korrur Partia në luftën kundër bandave të spiunëve e të diversantëve jugosllavë, vigjilanca duhet të dhjetëfishohet, pse titistët dhe agjen-

tët e tyre, do të përpiken të depërtojnë në Parti nëpërmjet elementëve të dobët që do t'i shpëtojnë vigjilencës së Partisë. Trockistët e Beogradit do të përpiken të bëjnë me vete ata elementë që nuk do t'i durojnë dot hovit revolucionar të Partisë dhe kritikës dhe autokritikës bolshevik, ata që do të gabojnë në rrugën e Partisë dhe që nuk do të duan t'i njohin ndershëmërisht dhe t'i năreqin gabimet e tyre. Njerëzit që dobët, që nuk e durojnë dot diktaturën e proletariatit, që ëndërrojnë dhe punojnë për ardhjen në fuqi të borgjezisë dhe të fashizmit, janë elementët e përshtatshëm të agjenturës titiste dhe imperialiste, janë avangarda e tyre kundër popullit dhe Partisë sonë. Titistët dhe agjentët e tyre do të grumbullojnë rrëth vetes gjithë elementin antiparti, kulak, borgjez, ambicioz dhe megaloman. Prandaj detyra e Partisë është të shtojë vigjilencën, të ruajë pastërtinë e radhëve të saja nga elementë të dobët, karrieristë, megalomanë, oportunistë që kanë krimbin e atyre sëmundjeve që çojnë ujë në rrugën e agjenturave titiste dhe imperialiste.

Të kemi parasysh se titizmi i drejton goditjet kundër njerëzve të shëndoshë të Partisë, kundër unitetit bolshhevik të saj, kundër principeve dhe rregullave organizative të Partisë dhe kundër vijës politike dhe ideologjike të saj. Titistët dhe agjentët e tyre do të përpiken të prishin disiplinën e hekurt të Partisë dhe vigjilencën revolucionare të saj. Propaganda e tyre konsiston në përhapjen e antisovjetizmit, e shfaqjeve kundër Bashkimit Sovjetik dhe politikës paqësore të tij. Titizmi s'është një ideologji, por një agjenturë e imperializmit, një grupim banditësh të hurit dhe të litarit në shërbim

të kapitalit. Titistët përpiqen të maskohen me parulla të majta dhe të fshehin nënshtrimin e tyre të plotë përpëra amerikanëve, por fshati që digjet s'do kallauz, demagogjia e tyre është e qepur me pe të bardhë dhe s'mund të gënjejë aasnë njeri të ndershëm. Ata që shkojnë në rrugën e titiznit, që simpatizojnë me ta, ose hyjnë në shërbimin e tyre në mënyrë agjenturale, nuk na lejohet t'i konsiderojmë më si mendjelehtë, si u treguan disa gjatë ditëve të para kur u zbulua tradhëtia e titistëve. Jo, shumë ujë ka kaluar nën urë dhe çdo gjë tanë është e qartë për këta banditë.

Shumë njerëz gabojnë në rrugën e Partisë, por në rast se këta i njohin ndershmërisht gabimet dhe japid prova se i ndreqin këto gabime dhe s'i përsëritin më, ata janë të shpëtuar nga rreziku i titizmit. Por ata që nuk i pranojnë këto gabime rrëshqasin në rrugën e titistëve dhe një ditë ose tjetrën do të lidhen me ta. Këta duhen spastruar pa hezitim nga Partia. Ka të tjerë që kanë bërë gabime dhe i kanë njohur për sy e për faqe, po në brendi ata janë në kundërshtim me Partinë, këta janë më të rrezikshmit, pse janë të maskuar dhe ndodhen brenda në Parti; këta janë elementë të «kalit të Trojës». Prandaj Partia duhet të jetë shumë vigjilente kundër tyre. Duhet vazhdimisht të verifikohen qëndrimet e tyre ndaj vijës së Partisë dhe në rast se personi që ka gabuar dhe ka bërë autokritikë, jep prova të gjalla të përditshme se e ka kuptuar gabimin e tij dhe e ndreq, atëherë Partia ka bërë një punë të mirë, ka shëruar një njeri dhe e ka bërë të vlefshëm. Në rast se ngjet e kundërtat, atëherë pa hezitim duhet hedhur jashtë Partisë. Elementët që shkelin disiplinën e hekurt të Partisë, që

godasin centralizmin demokratik, që dobësojnë kritikën dhe autokritikën, që zhvillojnë pakënaqësitë, kritikat e sëmura e nëpër qoshe, në rast se nuk spastrohen nga këto të meta, ata shpejt ose vonë do të bien në kundërshtim me vijën e Partisë. Partia duhet të përpinqet t'i ndreqë këta clementë, t'i edukojë dhe të pandreqshmit t'i flakë pa hezitim, pse ata janë krimbi i së keqes që kërkon të thyejë unitetin ideologjik dhe organizativ të Partisë. Duhet të mos harrojmë kurrë se pa unitet ideologjik dhe organizativ, nuk mund të ekzistojë partia e klasës punëtore. Vetëm në unitet dhe në kompaktësi Partia jonë ka siguruar fitoren mbi armiqtë e klasës punëtore dhe vetëm duke luftuar pa hezitim, pa kompromis kundër këtyre shkatërruesve të unititetit të Partisë, në Partinë tonë nuk do të ketë kurrë grupe dhe tarase antiparti, që s'janë veçse grupe trockiste ose titiste apo agjentura të imperialistëve, armiq të klasës punëtore dhe të socializmit. Lenini i madh na mëson:

«Kush e dobëson qoftë edhe pak disiplinën e hekurt të partisë së proletariatit (sidomos në kohën e diktaturës së tij), ai në të vërtetë ndihmon borgjezinë kundër proletariatit»¹.

Të mos jemi, pra, zemërbutë dhe zemërgjerë kundër atyre që i shkelin parimet e Partisë sonë. Partia jonë është e fortë për arësyen e kompaktësisë së saj, e bashkimit të vullnetit, të aksionit, të papajtueshmërisë me

¹ V. I. Lenin. Veprat. vëll. 31, f. 33.

shmangjet nga Statuti dhe nga programi, me prishjen e disiplinës së Partisë, me grupet fraksioniste, me oportunitizmin, sektarizmin, hipokrizinë etj.

Partia jonë ka treguar dhe tregon vigjilencë dhe kjo e ka çelnikosur Partinë tonë. Ishte një mësim i madh për Partinë tonë lufta dhe fitorja kundër grupeve trockiste të Anastas Lulës, Aristidh Qendros dhe Niko Xoxit, ishte një mësim i madh lufta dhe fitorja mbi trockistët e Beogradit dhe agjentët e tyre Koçi Xoxe me shokë. Këto pësime e forcuan shumë Partinë tonë dhe elementë të tjerë që më vonë tentuan të dëmtonin Partinë u zbuluan, u demaskuan, u hodhën pa hezitim jashië Partisë.

Por nuk mund të flemë mendjen dhe të themi se u zhdukën me kaq armiqtë e Partisë, të hapët ose të fshehtë. Rreziku qëndron kurdoherë i madh, derisa qëndron rrëthimi kapitalist, derisa vendi ynë është i rrëthuar qark e qark gjeografikisht nga fashistë, të cilët hedhin spiunë dhe diversantë në vendin tonë, që orë e çast përgjojnë dhe tërheqin në shërbim të tyre elementët e reaksiونit të brendshëm dhe elementë të dobët që nuk i rezistojnë dot hovit revolucionar të Partisë sonë dhe ligjeve të diktaturës së proletariatit. Ne nuk mund të mos jemi vigjilentë derisa ekzistojnë kontradiktat dhe lufta midis klasës punëtore në aleancë me fshatarësinë e varfër dhe të mesme dhe borgjezisë së qytetit dhe të fshatit, derisa presioni i borgjezisë është i madh dhe i vazhdueshëm mbi Partinë dhe mbi popullin dhe manifestohet në lloj-lloj mënyrash, në lloj-lloj vesesh mikroborgjeze që sillen në Parti nga elementët e këtyre shtresave, të cilët, në rast se nuk edukohen, nuk spastrohen, në rast se nuk vigjilohet nga ana e Partisë,

me një edukatë të shëndoshë ideo-politike, me një aktivitet intensiv revolucionar, ata do të dobësojnë situatën e brendshme të Partisë dhe do të preqatitin terrenin për shfaqjen e elementëve antiparti dhe fraksionistë. Këto rreziqe ekzistojnë, duhet të mos i harrojmë dhe duhet t'i luftojmë pa pushim në rrugën e drejtë të Partisë.

Devijimet dhe gabimet e shfaqura në Partinë tonë na tregojnë se rreziku i djathtë, rreziku i oportunizmit, është më i madh dhe kjo ka arësyet e veta.

Shoku Stalin në fjalimin e tij të mbajtur në Komisionin çekoslovak të komitetit ekzekutiv të Internacionales Komuniste më 27 mars 1925, ka thënë në mes të tjerave:

«Në vetëvete kalimi nga një periudhë ngritjeje në një periudhë qetësie, nga vetë natyra e tij, i shton mundësitë e rrezikut të së djathtës. Në qoftë se periudha e ngritjes pjell iluzione revolucionare, duke krijuar rrezikun e majtë si rrezikun kryesor, periudha e qetësisë, përkundrazi, pjell iluzione reformiste, socialdemokrate, duke krijuar rrezikun e djathtë si rrezikun kryesor. Në vitin 1920, kur lëvizja punëtore ishte në ngjitje, Lenini shkroi broshurën mbi «Sëmundjen foshnjore të «majtizmit». Pse Lenini shkroi pikërisht këtë broshurë? Sepse rreziku i majtë aso kohe ishte rreziku më serioz. Unë mendoj se po të kishte qenë gjallë Lenini, tanj ai do të kishte shkruar një broshurë të re mbi «Sëmundjen pleqërore të djathtizmit», sepse tanj, në periudhën e qetësisë, kur iluzionet e kompro-

misit duhet të shtohen, rreziku i djathtë është rreziku më serioz»¹.

Në periudhën e luftës, kur hovi revolucionar ishte në ngritje, Partia nuk gaboi kurrë djathtas. Fraksioni i Anastas Lulës me shokë, që ishte një fraksion trockist u likuidua pa mëshirë. Partia nuk i bëri as më të voglin koncesion borgjezisë reaksionare të grumbulluar në organizatat tradhëtare «Balli Kombëtar», «Legaliteti» etj. Partia nuk e ndau kurrë pushtetin me borgjezinë. Titistët dhe agjentët e tyre të maskuar si Koçi Xoxe e Pandi Kristo, shërbëtorët e borgjezisë si Sejfulla Malëshova e Ymer Dishnica, nuk mundën dot të vepronin dhe ta pengonin Partinë tonë në zhvillimin e saj dhe në korrjen e fitores. Në Frontin Nacional-Çlirimtar, në kohën e luftës, u futën mjaft elementë të borgjezisë me qëllim që të frenonin luftën dhe të kapnin pozita në udhëheqje. Të tillë ishin Shefqet Beja, Riza Dani, Gjergj Kokoshi etj. Këta s'mundën dot të realizonin qëllimet e tyre, pse Partia ndiqte rrugën revolucionare me vendosmëri, hovi revolucionar ishte i madh dhe rreziku i djathtë, megjithëse farën e kishte brenda, qëndronte i mbuluar si thëngjilli nën hi. Por a ka gabuar Partia nga e majta në këtë periudhë? Jo, s'ka gabuar.

Kur u çlirua Shqipëria, rreziku i djathtë polli iluzionet reformiste, socialdemokrate dhe trockiste të hapëta. U aktivizuan trockistët jugosllavë, Koçi Xoxe, Sejfulla Malëshova, Ymer Dishnica; u aktivizuan Shefqet Beja, Riza Dani e të tjerë. Rreziku i djathtë në Parti dhe

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 7, f. 61.

jashtë Partisë, ngriti krye dhe filloi luftën. Në Parti trockistët jugosllavë, Sejfulla Malëshova, Koçi Xoxe, Pandi Kristo etj. fituan pozita për të degjeneruar Partinë tonë Komuniste në një parti socialdemokrate. Këta filluan kritikën e poshtër kundër vijës së Partisë gjatë kohës së luftës, duke e akuzuar si sektare. Sejfulla Malëshova u përpoq të sillte në udhëheqje oportunistin Ymer Dishnica, përgjegjësin e kompromisit në Mukje me borgjezinë reaksionare. Qëllimi i tyre ishte të shkattërronin fitoret e popullit, të ndanin pushtetin me borgjezinë, ta transformonin këtë në një pushtet të borgjezisë dhe Partinë tonë në një parti borgjeze. Qëlli-mi i tyre ishte të mposhtnin vijën marksiste-leniniste të Partisë, ta shkëputnin Shqipërinë nga miqësia me Bashkimin Sovjetik dhe ta bënin vendin tonë një koloni të jugosllavëve ose të anglo-amerikanëve. Rreziku i djathjtë, pra, ishte kërcënues për Partinë tonë në këtë periudhë të pasluftës. Por Partia jonë marksiste-leniniste ishte e fortë. Merrni shkrimet e Sejfulla Malëshovës, të këtij oportunisti të pashërueshëm, në to nuk do të gjeni të flitet për Partinë tonë si dhe për Bashkimin Sovjetik, faktorë vendimtarë të fitoreve historike të popullit tonë. Për Sejfulla Malëshovën këta dy faktorë nuk duhesin zënë shumë në gojë. Sipas tij vetëm Fronti Nacional-Çlirimtar, «e ka udhëhequr» luftën e popullit, dhe ky «do ta udhëheqë» ndërtimin e socializmit. Sejfulla Malëshova e likuidonte Partinë, ai ishte për krijimin e partive të tjera socialdemokrate në Front, ai ishte për ndarjen e pushtetit me borgjezinë. Sejfulla Malëshova ishte kundër reformave revolucionare ekonomike dhe sociale, ishte për një bashkëpunim të hapët dhe të

sinqertë me borgjezinë e pasur tregëtare dhe industriale, ai ishte për moskonfiskimin e pasurive dhe të fabrikave të tyre, ai ishte për shuarjen e luftës së klasave dhe për integrimin paqësor të elementit kapitalist në socializëm. Të tilla pikëpamje Sejfulla Malëshova ka pasur gjithashtu për Bashkimin Sovjetik, të cilin e vinte kurdoherë në një radhë me imperialistët anglo-amerikanë, ai ishte për kulturën perëndimore, borgjeze dhe imperialiste.

Por pikëpamjet e djathta, likuidatore të Sejfulla Malëshovës, nuk fituan se i shqelmoi Partia, sidomë që në shpinë të saj ishte ngulur thika titiste. Kjo tregon akoma më me forcë vitalitetin e Partisë dhe vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste. Partia jonë në këto rrëthana shumë të vështira luftonte pareshtur. Ajo i dërmoi Shefqet Bejën me shokë, elementë të borgjezisë dhe agjentë të imperialistëve, bashkë me oportunizmin e Sejfulla Malëshovës. Më në fund Partia e mposhti edhe titizmin.

a) Partia të jetë gjithnjë vigjilente

Por a u zhduk kërcënim i rreziku i djathtë për Partinë tonë me zhdukjen e titizmit nga radhët e Partisë sonë? Jo, ky rrezik nuk është zhdukur. Lufta kundër titizmit arriti kulmin në Kongresin I të Partisë. Në ato momente kishte me të vërtetë një hov të madh revolucionar në Partinë tonë, saqë ishte rrezik të kalohej majtas në disa veprime, sidomos në goditjen¹. Kjo nuk

¹ Është fjala për goditjen kundër një numri komunistësh që kishin gabuar pa qenë të ndërgjegjshëm se qëndrimet e tyre i shërbenin revizionizmit jugosllav.

ngjau. Partia me të drejtë gjithë peshën e vigjilencës e drejtoi në këto momente kundër rrezikut kryesor të titistëve dhe të agjentëve të tyre dhe njerëzit i peshoi me këtë kandar. Në të vërtetë Partia i kaloi përciptas qëndrimet e disa shokëve të lëkundshëm në të kaluarën, me plot të meta të theksuara mikroborgjeze. Këta elementë, filluan të bërtisin më tepër se të tjerët kundër Koçi Xoxes dhe trockistëve jugosllavë, këta hiqeshin si të parët që qenë persekutuar. Të tillë ishin Abedin Shehu, Niazi Islami e të tjerë. Këta ishin rreziku i djathtë që do të shfaqej përsëri më vonë në Partinë tonë. Këta elementë s'ishin dakord me vijën e Partisë që caktoi kongresi, por përpara hovit revolucionar të Partisë ata u strukën, bënë «korus»¹ me Partinë dhe me kongresin, u zgjodhën në udhëheqje dhe për një periudhë qëndruan në qetësi, dhe kur filloi të stabili zohej «qetësia» për të cilën flet shoku Stalin, këta elementë antiparti filluan të vaprojnë, por llogaritë s'i bënë mirë, se Partia nuk flinte. Manifestime oportuniste, rreziqe të djathta u shfaqën edhe më vonë në Parti, në periudha të ndryshme si gabimet e rënda oportuniste të shokut Tuk Jakova, kapitullimi dhe dezertimi nga lufta e Partisë i shokëve Manol Konomi dhe Theodor Heba. Këtë karakter oportunist, rrezik i djathtë, ka pasur grupi i Hasan Ginës në Lushnjë, qëndrimet e gabuara të Nexhip Vinçanit dhe të Gjin Markut, puna e sëmurë e Pajo Islamit në Komitetin e Partisë në Kombinatin e naftës dhe dredhia e kurdisur kundër organizatës së Partisë dhe udhëheqjes së Komitetit të Partisë të

¹ Bashkuan zërin.

Pukës nga sekretari i dytë i këtij komiteti. Për këto devijime nga vija e Partisë do të flas më poshtë, por i numërova këto për të vënë në dukje dy gjëra. E para, që ireziku më i madh te ne është oportunizmi, është rreziku i djathtë dhe, e dyta, ky shfaqet dhe bëhet i rrezikshëm në momentet e uljes së hovit revolucionar, të qetësisë. Prandaj hovi revolucionar i Partisë duhet vazhdimisht të ecë përpara, prandaj vigjilencia revolucionare e Partisë të shtohet çdo ditë, prandaj lufta kundër oportunizmit të jetë e ashpër dhe pa kompromis.

Përsa i përket punës së grupit antiparti të Abedin Shehut dhe të shokëve të tij nuk do të zgjatem shumë se Partia është në dijeni, por do të numëroj disa karakteristika të kësaj pune antiparti. Elementët e këtij grupei me Abedin Shehun, Niazi Islamin, Shyqri Këllezin, tre anëtarë dhe kandidatë të Komitetit Qendror, vinin nga ish-grupet e vjetra komuniste dhe ruanin gjërat e këqia që ekzistonin në ato grupe. Ata kishin një lustër prej komunisti, nën të cilën fshihnin pikëpamjet e tyre të shtrembra. Ata ishin mikroborgjezë, llafazanë, megalomanë, ambiciozë. Ata nuk u shëruan kurrë nga këto të meta dhe i quan këto shumë larg. Me të meta të tilla kaluan nga lidhjet miqësore, në grup të organizuar e në një punë fraksionale. Mbledhjet e tyre të fshehta kishin karakter politik dhe politika që zhvillohej në mes tyre ishte në kundërshtim me politikën e Partisë dhe të qeverisë. Te ata kishte mbaruar disiplina e Partisë, konspiracioni dhe vigjilencia. Veprimet e tyre nuk mund të zienin në vazo të myllur, ato u manifestuan jashtë, në punë. Ata shkelën në mënyrë flagrante disiplinën në punët e Partisë dhe të

qeverisë, thyen urdhërat dhe vendimet, dekonspiran e sekretet shtetërore dhe ushtarake, përhapën fryshtë e demobilizimit dhe filluan sabotazhet e hapëta. Natyrish kjo rrugë atje do t'i conte. Ky grup fraksionistësh s'kishte besim as te klasa punëtore as te Partia e saj as te udhëheqja e Partisë. Karakteristika e punës së tyre fraksionale nuk ishte si ajo e gabimeve të disa shokëve të tjerë që gabojnë në mënyrë të izoluar në një drejtë ose në një tjetër. Ata ishin për ndërrimin e situatës në vendin tonë. S'mund ta quash një gabim të lehtë, të rastit, kur një grup shokësh që janë në udhëheqje të Partisë dhe të shtetit, në mënyrë të organizuar atakojnë frontalist Partinë, duke thyer disiplinën, centralizmin demokratik, konspiracionin, dobësojnë kritikën dhe autokritikën. Një veprimi të tillë i thonë t'i futesh një pune për të degjeneruar Partinë dhe regjimin e demokracisë populllore. Lufta kundër principave mbi të cilat është ndërtuar Partia jonë, ishte një pjesë kryesore e përpjekjeve të këtij grupei fraksional. Ata, nga ana tjetër, atakuan planin e shtetit, e frenuan, e sabotuan, e diskredituan. Domethënë ata minonin ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë.

Ata minonin udhëheqjen e Partisë dhe të shtetit, ata shpifnin dhe diskreditonin, ata provokonin për të krijuar në Parti dhe në popull mosbesim, dyshime kundër udhëheqjes. S'ka dyshim se kjo të conte në rrugën e titizmit.

Kjo punë armiqësore u likuidua dhe sigurisht tradhëtari Niazi Islami, duke pasur frikë se do të zbuloheshin dhe të tjera fakte që do të provonin lidhjet

e ngushta të tradhëtisë së tij me trockistët e Beogradit, vrau veten. Abedin Shehu, Niazi Islami dhe Shyqri Këllezi u përjashtuan nga Komiteti Qendror dhe nga Partia¹.

Mësimë të vlefshme nxori Partia nga kjo punë armiqësore që kurdisej në errësirë dhe këto mësimë i shërbyen për të shtërnguar radhët e saja dhe për të shtuar vigjilencën.

Gjithashtu Plenumi V i Komitetit Qendror, përjashtoi nga radhët e tija Nexhip Vinçanin, për gabimet e tij në kundërshtim me parimet themelore të Partisë. Pikëpamjet e theksuara mikroborgjeze e çuan këtë në rrugën e gabuar.

Presionin e borgjezisë mbi Partinë duhet ta konsiderojmë si një rrezik shumë serioz dhe duhet ta luftojmë seriozisht dhe vazhdimesh. Kur ky rrezik paraqitet i hapët, është kollaj të demaskohet dhe të shkatërrohet, por më të shumtata e rasteve ky është si vëmja e butë që sillet nga jashtë në Parti, nëpërmjet elementit mikroborgjez dhe kjo sëmundje në trajta të ndryshme zhvillohet atje ku ngritja ideologjike dhe kulturale e anëtarëve të Partisë është e ulët, në ato organizata ku nuk ka kritikë dhe autokritikë bolshevikë, atje ku disiplina e Partisë paraqitet e dobët, atje ku elementi i

¹ Abedin Shehu duke pasur parasysh këshillat që i dha shoku Enver Hoxha në Plenumin V të KQ të PPSH në shkurt 1950 dhe duke u mbështetur në ndihmën që i dha Partia, u bind për gabimet e tij dhe punoi për t'i ndrequr ato. Më 1965 u ripranua në radhët e Partisë. Gjithashtu dhe Shyqri Këllezi u ripranua në Parti më 1966.

klasës punëtore është më i paktë, atje ku kombativiteti revolucionar i Partisë është më i ulët.

Simpatia dhe dashuria për Partinë tonë të Punës është shumë e madhe në masat e gjera të popullit. Njerëzit dëshirojnë dhe e kanë për ndër të jenë anëtarë të Partisë heroike të Punës. Por pranimi në Parti është dhe duhet të jetë kurdoherë një çështje shumë e rëndësishme, delikate dhe me plot përgjegjësi. Ka pasur momente që ky pranim nuk ka ecur drejt dhe sikundër e pamë më lart kanë pasë hyrë në Parti njerëz me qëndrime të lëkundshme, me origjinë agai, intelektualë të sëmurë, llafazanë, pretenciozë, mendjemëdhenj, kritizerë të pashërueshëm, të cilët janë përpjekur të nxjerrin përfitime personale nga qenja e tyre në Parti dhe të dëmtojnë Partinë. Të tillë elementë ishin futur sidomos në organizatën e Lushnjës dhe ishin bërë një pengesë serioze për zhvillimin e Partisë në rrugën normale. Instruktive është për Partinë të dijë si vepronte elementi kulak dhe mikroborgjez mbi njerëzit e Partisë. E dimë që rrathi i Lushnjës është një vend bujqësor. Fshatarët e këtij rrathi kanë qenë të shtypur nga bejlerët, agallarët, qehajallarët dhe pasanikët e qytetit. Reforma agrare u dha fshatarëve tokën. Organizata e Partisë në këtë rrath nuk ishte zhvilluar në rrugë të drejtë. Fshatarë, dhe sidomos fshatarë të varfër në Parti kishte pak në periudhën për të cilën bëjmë fjalë. Në Parti dhe në udhëheqje të këtij rrathi shumica ishin qytetarë, elementë mikroborgjezë, nëpunës të vegjël, cirakë, berberë, intelektualë të vegjël, djem agallarësh dhe elementë të tjerë të ardhur nga rrethet e tjera të Shqipërisë dhe të fiksuar në rrethin e Lush-

njës. Disa nga këta, si në Parti, si në udhëheqje të saj, kishin bërë gabime në të kaluarën, dezertuan në një moment nga lufta, lëshuan deklarata, ju shmanqën autokritikës dhe, duke mos i njojur këto gabime, mbronin shoku-shokun, krijuan grupe dhe zhvilluan një luftë kundër elementit të ri në Parti. Një nga këto grupe ishte ai i Hasan Ginës, i cili nën presionin e kulakëve dhe të borgjezisë së vogël të qytetit, përpinqej të eliminonte elementin e ri dhe të fitonte pozitat kyçë në udhëheqjen e Partisë dhe të pushtetit. Një punë e tillë e kishte molepsur organizatën e Lushnjës. Kulakët e fshatit dhe të qytetit ishin mjaft të interesuar që një situatë e tillë të thellohej edhe më tepër dhe mbështetnin grupin e Hasan Ginës dhe të Halit Ahmetit, pse u shërbente pikëpamjeve të tyre. Në këta shokë gjithashtu mbizotëronte ambicia, megalomania, karrierizmi, oportunizmi i theksuar ndaj elementit borgjez. Kështu që lufta e klasës në këtë rreth ku kishte dominuar feudalizmi, ku kishte lëvuar kamxhiku i beut dhe i kulakut, në vend që të shkonte duke u shtuar, nuk ekzistonte gati fare. Liberalizmi ishte në rendin e ditës ndaj elementeve të dobët në Parti dhe elementit kulak. Në praktikë, presioni i borgjezisë dhe i kulakëve u reflektua në zbatimin me gabime të reformës agrare. Kulakët mbajtën tokat më të mira, fshatarët e varfër nuk u përkrahën si duhet, shumë fshatarë të varfër u lanë pa mbrojtje përpara kërcënimeve të kulakëve dhe të fajdexhinjve. Zhvilloheshin hatëre, nxiteshin intrigat dhe politika e fshatit zhvillohej në pozitat e këtyre intrigave të kulakëve. Kulakët dhe borgjezia merrnin frymë lirisht. U dobësuan konspira-

cioni dhe disiplina e Partisë. Çështjet e brendshme u bënë çështje kafeneje, goditeshin komunistët e shëndoshë dhe u arrit deri në atë shkallë që kulaku dhe njerëz që dilnin nga burgjet për faje politike inkurajoheshin të kërkonin gjykimin e komunistëve për veprimet e tyre të drejta ndaj kulakëve. Natyrisht kësaj situate Komiteti Qendror i dha fund menjëherë dhe mori masa kundër fajtorëve, forcoi përbërjen e organizatës së Partisë të Lushnjës dhe udhëheqjen e saj.

Por një punë e tillë oportuniste, e dëmtoi Partinë dhe pati rrjedhime të hidhura. Atje elementi kulak është akoma në aktivitet dhe para ca kohe ai u hodh edhe në akte terrorizmi, ai lufton kundër forcimit të kooperativave bujqësore dhe kundër futjes së metodave të reja agroteknike në bujqësi. Eksperienca e hidhur e organizatës së Lushnjës duhet të jetë një mësim i madh për të gjitha organizatat e tjera të Partisë në Republikë, për të qenë vigjilente dhe rigozoze në zbatimin e vijës së drejtë politike dhe organizative të Partisë, për të ashpërsuar luftën e klasës në fshat dhe për të goditur pa mëshirë manevrat e shumëllojshme të kulakëve.

b) Konkluzionet e Plenumit IX kanë qenë një mësim dhe një eksperiencë e vlefshme për gjithë Partinë

Plenumi IX i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë ka një rëndësi të madhe për Partinë tonë, pse zbuloi gabime të rënda në punën e Tuk Jakon-

vës, Manol Konomit dhe Theodhor Hebës. Gabimet e këtyre shokëve kanë qenë gabime të së djathtës. U konstatua se veprimtaria e Tuk Jakovës, karakterizohej nga një oportunizëm dhe liberalizëm i madh, nga një mungesë vigjilence revolucionare e theksuar dhe nga një neglizhencë serioze në zbatimin e detyrave. Këto gabime e kishin çuar Tuk Jakovën në praktikë të vepronte e të mendonte në kundërshtim me vijën politike dhe organizative të Partisë. Kështu ngjau që kapitullimin e Ymer Dishnicës në Mukje, pikëpamjet oportuniste të Sejfulla Malëshovës, punën antiparti të grüpuit të Niazi Islamit me shokë, jo vetëm t'i nënvlef-tësonte por t'i kuptonte me vonesë. Tuk Jakova vijën politike të Partisë dhe të shtetit në lidhje me fenë dhe me klerin katolik, veçanërisht, nuk e kishte kuptuar drejt dhe vepronte në kundërshtim, duke mos e parë rrezikun e elementëve klerikë reaksionarë. Tuk Jakova nuk e urrente në shkallën e duhur armikun e klasës dhe kjo e bënte atë të binte shumë herë në pozita oportuniste.

Si sekretar i Komitetit Qendror për kuadrot, Tuk Jakova nuk e kishte kryer detyrën si duhet dhe kishte bërë lëshime serioze. Te Tuk Jakova mungonte vigjilenca dhe ekzistonte një kënaqësi e tepruar në vetë-vete. Ngaqë ai kishte të tilla pikëpamje, lufta për forcimin e Partisë, të kritikës e të autokritikës, të demokracisë së brendshme, ishte dobësuar. Të gjitha këto tregonin qartë se Tuk Jakova për një kohe të gjatë ishte në opozion me vijën e Partisë dhe në rast se Partia do të ishte vënë në rrugën oportuniste të Tuk Jakovës, kjo patjetër do të conte në likuidimin e

saj, dhe të pushtetit popullor. Në Rezolucionin e Plenumit IX të Komitetit Qendror theksohet me të drejtë se

«Kjo punë oportuniste e shokut Tuk Jakova nuk ka qenë dënuar më parë siç dënohet sot, jo vetëm për faktin se sot kjo punë e dëmshme e shokut Tuk është bërë shumë e qartë prej vetë fakteve konkrete, por nga shkaku se në Byronë Politike ka munguar kritika dhe autokritika bolshevike. Vendosja e kritikës dhe e autokritikës bolshevike në Byronë Politike, bëri që këto veprime të dëmshme të shokut Tuk Jakova të sqaroheshin, të dënoheshin dhe t'i paraqiteshin Plenumit të Komitetit Qendror, i cili i aprovoi plotësisht dhe i zhvilloi edhe më tej konkluzionet e Byrosë Politike mbi veprimtarinë e shokut Tuk Jakova»¹.

Konkluzionet e Plenumit IX kanë qenë një mësim dhe një eksperiencë e vlefshme për udhëheqjen e Partisë, për gjithë Partinë. Duke marrë parasysh, gabimet e tij si dhe duke pasur parasysh të kaluarën e tij, dhe premtimin se do të ndreqë gabimet e tij, Komiteti Qendror e shkarkoi shokun Tuk Jakova nga funksionet e tij si sekretar i Komitetit Qendror, e përjashtoi nga Byroja Politike, por e la si anëtar të Komitetit Qendror. Përsa u përket shokëve Theodhor Heba dhe Manol Konomi ata u përjashtuan nga Komiteti Qendror për arësyte të pikëpamjeve të tyre thellësisht oportuniste, të

¹ «Dokumenta Kryesore të PPSH». Vëll. II, Bot. I, f. 65.

influencuara nga presioni i borgjezisë së brendshme dhe nga imperializmi i jashtëm në përgjithësi. Këta dy shokë janë treguar frikacakë dhe kapitullantë përpara vështirësive dhe përpara detyrave që u ka pasë besuar Partia.

Janë përjashtuar gjithashtu nga Komiteti Qendror dhe nga Partia Sali Ormeni dhe Beqir Ndou për këtë arësy:

Sali Ormeni disa javë para Plenomit IX manifestoi kriza nervozizmi, duke thënë se ka bërë gabime të rënda ndaj Partisë. Ju kërkua t'i pohonte këto gabime dhe ai tha se ka pasë marrëdhënje me disa persona, të cilët kanë tentuar t'i vjedhin sekrete shtetërore, porse, s'kanë mundur dot t'ja vidhnin, sipas thënjes së tij. U këshillua që të ketë shumë kujdes herë tjetër dhe meqë kishte rënë mjaft fizikisht dhe moralisht u këshillua të merrte pushim. Për këtë arësy ai nuk u ndodh në mbledhjen e Plenomit IX, po kur ju komunikuan vendimet ai nuk ka qenë dakord dhe disa ditë më vonë shkoi në Elbasan, ku ndodhej dhe Beqir Ndou. Pasi ndenji disa orë me të, ai u nda nga Beqir Ndou dhe duke kërcënuar shoferin me kobure i tha këtij të largohej dhe të shkonte të lajmëronte se Sali Ormeni u arratis. Të nesërmen, forcat që shkuan në ndjekje e gjetën që kishte vrarë veten në një pyll afér Elbasanit. S'ka asnë dyshim se ai ishte një armik i fshehtë i popullit dhe i Partisë.

Beqir Ndou u pyet për çështjen e Sali Ormenit. Ai pretendoi se s'kishte asnë dijeni. Në mbledhjen e Plenomit IX të Komitetit Qendror dhe gjatë gjithë periudhës që ju kërkuan sqarime Beqir Ndout mbi

çështjen e Sali Ormenit, ai ka treguar një mosbesim të madh ndaj Partisë dhe udhëheqjes së saj, ai është sjellë si një njeri krejt i huaj për Partinë, si një njeri antiparti. Ai ka pasur frikë të jashtzakonshme sikur të kishte bërë faje të rënda. Vetëm se Komiteti Qendror nuk kishte prova kundër tij, kishte vetëm faktin se Beqir Ndou kishte thyer ligjet ushtarake dhe kishte zbuluar sekretet ushtarake përpara një elementi si Sali Ormeni, i cili tentoi të arratisej dhe vrau veten. Për qëndrimin e tij antimarksist përpara Komitetit Qendror dhe për mosbesim ndaj Partisë, Komiteti Qendror e përjashtoi atë nga radhët e tija dhe nga radhët e Partisë.

Do ta mbaroj këtë kapitull duke i vënë në dukje kongresit gjithashtu, metodat direkte ose indirekte që përdor armiku i jashtëm ose i brendshëm, që përdor agjentura titiste dhe imperialiste për të goditur Partinë tonë dhe ndërtimin e socializmit. Kjo ka lidhje me punën e Komitetit të Partisë në Pukë. Në këtë komitet ishte krijuar një situatë e rëndë, ku fajtor kryesor ka qenë ish-sekretari i dytë i këtij komiteti, Z.G. Ja si vepronte ky njeri: Z.G., element ambicioz, mendjemadh, karrierist, nuk i kryente mirë detyrat që i kishte ngarkuar Partia dhe ishin konstatuar shumë lëshime dhe dobësi në punën e tij. Përveç kësaj Z.G. duke kërkuar të ngjitej më lart, pa e merituar, organizoi një intrigë shumë të rrezikshme me metoda tipike trockiste-titiste. Kjo intrigë kishte për qëllim dobësimin dhe likuidimin e organizatës së Partisë të rrethit të Pukës, krijimin në këtë organizatë të dy tarafeve, komunistë të rinj dhe të vjetër, krijimin e pikëpamjes

se komunistët e vjetër janë më të besueshëm dhe të pagabueshëm dhe të rintjtë më pak besnikë, bile dhe të dyshimtë. Për t'ja arritur kësaj, Z.G., i mbështetur në të dhëna jo të besueshme, por të grumbulluara prej tij nga elementë armiq dhe spiunë në shërbim të okupatorëve, akuzonte padrejtësisht, sekretarin e parë të Komitetit të Partisë të rrëthit të Pukës dhe disa shokë të tjerë si spiunë të okupatorëve dhe të kuislingëve në kohën e okupacionit. Z.G. në kurdisjen e kësaj intrige kishte krijuar një rrëth të tjin në byronë e komitetit të Partisë dhe jashtë Partisë. Duke shkelur çdo rregull organizativ të Partisë dhe pa vënë në dijeni Komitetin Qendror të Partisë, kishte filluar përpunimin e sekretarit të parë dhe të shokëve të tjerë. Z.G., të gjitha këto veprime i bënte prapa krahëve të Komitetit të Partisë të rrëthit të Pukës dhe të Komitetit Qendror të Partisë, të cilin e vuri në korrent vetëm kur u zbulua një situatë e tillë e rëndë dhe e sëmurë. Kjo natyrisht kishte tronditur udhëheqjen e Partisë në Pukë dhe organizatën e këtij rrathi. Komiteti Qendror mori masa të shpejta dhe e shëndoshi atë situatë.

Të tilla kanë qenë devijimet kryesore nga vija e Partisë gjatë kësaj periudhe, të kësaj natyre kanë qenë tentativat e armikut të brendshëm dhe të jashtëm për të dobësuar Partinë tonë, të tilla kanë qenë gabimet dhe pikëpamjet e sëmura që janë vërtetuar në shokët. Këto gabime Partia s'ka pasur frikë t'i zbulojë, t'i kritikojë ashpër dhe t'i spastrojë në bazë të kritikës dhe të autokritikës dhe bash pse ka vepruar në këtë mënyrë, Partia jonë nuk është dobësuar, por është çelnikosur edhe më tepër. Arniqtë e Partisë, të brend-

shëm dhe të jashtëm, llomotitin se gjoja Partia jonë me këto masa që merr po shkatërrohet, po dobësohet etj. Ata s'i qajnë hallin kësaj gjëje, pse për këtë gjë ata punojnë, por qajnë pse njerëzit e tyre të hapët dhe të fshehtë demaskohen, pse mbështetja e tyre dërmohet, pse metodat e tyre zbulohen dhe se pikëpamjet e sëmura që shfaqen në njerëzit e Partisë sonë, shfaqje që përbëjnë një burim dhe një mbështetje për titizmin, goditen, korrigjohen, spastrohen. Le të qajnë dhe le të bërtasin titistët, pse në këtë kohë populli ynë gëzohet, kënaqet, pse shikon Partinë e Punës të Shqipërisë të çelnikosur, të bolshevizohet dhe ndërtimin e socializmit të ecë përpara. Partia jonë heroike bëhet çdo ditë e më shumë një udhëheqje e çelniktë e popullit tonë, një kala e pamposhtur që mbron me heroizëm dhe me sukses interesat e larta të popullit dhe të atdheut. Partia jonë ndjek me besnikëri të madhe mësimet dhe rrugën e lavdishme të mësuesit dhe të udhëheqësit tonë të madh, Josif Stalinit.

5) EDUKIMI MARKSIST-LENINIST I ANËTARËVE DHE I KUADROVE TË PARTISË. PROPAGANDA E PARTISË

«Për të zhdukur prapambetjen politike dhe ideologjike të Partisë sonë, të bëhet — thuhet në Rezolucionin e Kongresit I — një punë sistematike nga të gjitha organet dhe organizatat e Partisë për përvetësimin e bazave të marksizëm-leninizmit, për përforcimin e ndërgjegjes komuniste të anëtarëve të Partisë, për njojjen e ligjeve

·të zhvillimit ekonomiko-shoqëror. Partia duhet ta konsiderojë problemin e ngritjes politike dhe ideologjike të anëtarëvë të saj si një nga problemet më me rëndësi dhe që duhet të marrë një zgjidhje të drejtë dhe urgjente»¹

Në bazë të vendimeve të Kongresit I të Partisë Komiteti Qendror studjoi dhe mori vendime për edukimin marksist-leninist në Parti, përcaktoi format e arësimit dhe pregetiti programet për secilën formë. U hap shkolla njëvjeçare e Partisë për anëtarët e komiteteve të Partisë dhe të komiteteve ekzekutive të rretheve si dhe për kuadrot që punojnë në qendër. U organizua pranë saj kursi dyvjeçar me korrespondencë dhe kursi i gazetarisë. U organizuan në pesë qendra rrethesh kurset tremujore (tani pesëmujore), kryesisht për kuadrot e aparateve të komiteteve të Partisë dhe të komiteteve ekzekutive të rretheve. Gjithashtu u organizuan në 10 qendra (tani 20 qendra) kurset njëmujore (tani dy mujore) pranë komiteteve të Partisë në rrethe, kryesisht për sekretarët e organizatave bazë të fshatit e të qendrave të punës. Arësimi marksist-leninist në masat e Partisë zhvillohet në shkollat politike, në rrethet e studimit (në dy kategori) dhe me anën e studimit individual. Në bazën e programeve është studimi i kursit të shkurtër të «Historisë së Partisë Komuniste (bolshevikë) të Bashkimit Sovjetik», i historisë së Partisë sonë, i Statutit të Partisë së Punës të

¹ «Dokumenta Kryesore të PPSH». Vëll. I, Bot. I, f. 463.

Shqipërisë dhe i Kushtetutës së Republikës sonë Populllore.

Për të ndihmuar zhvillimin e arësimit në Parti, u ngritën pranë të gjitha komitetave të Partisë në rrethe kabinetet e Partisë (16 kabinet) edhe bibliotekat (5 biblioteka). U përkthyen dhe janë botuar 128 libra me karakter ideologjik me një tirazh total prej 2 084 000. Ka filluar përkthimi e botimi i veprave të shokut Stalin, është botuar vëllimi i parë e i gjashtë dhe gjatë këtij viti do të botohen dhe vëllimi i shtatë e i tetë.

Shtypi dhe botimet tona janë përmirësuar dhe kanë marrë përpjesëtime të gjera.

Për përhapjen e eksperiencës së punës së Partisë, btohet një herë në muaj revista «Punëtori i Partisë», u organizua për herë të parë puna me leksione, mbi 200 leksione janë dërguar nga Komiteti Qendror për të ndihmuar në radhë të parë propagandën e Partisë, janë marrë masa për shtimin e numrit të propagandistëve dhe për kualifikimin e tyre (1 000 vetë kaluan në seminaret e propagandistëve gjatë verës së kaluar).

Janë marrë vendime për edukimin marksist-leninist të klasës punëtore, rinisë, intelektualëve dhe janë ngritur format e nevojshme.

Lënda e marksizëm-leninizmit u fut edhe në programet e shkollave të mesme (në klasën III e IV) dhe në shkollat e larta.

Pjesëmarrja e komunistëve në format e arësimit të Partisë ka ardhur çdo vit duke u shtuar. Gjithsejt kaluan në format e arësimit të Partisë: gjatë vittit 1949—1950, 6 246 dhe gjatë vittit 1950—1951, 12 264 vetë.

Gjatë vitit 1951 — 1952 ndjekin format 18 568 vetë. Domethënë pas kongresit kanë kaluar në format e edukimit marksist-leninist 14 herë më shumë se në vitet 1944 — 1948.

Shtrirja e rrjetit të arësimit në Parti është më e mirë në qytet. Në fshat kjo shtrirje është shumë më e kufizuar e sidomos në rrethet e Veriut. Nga 13 420 komunistë që ka fshati, 6 326 nuk marrin pjesë në forma arësimi. Nga 2 877 komunistë që kanë 8 rrethet e Veriut (Shkodër, Lezhë, Rrëshen, Burrel, Peshkopi, Kukës, Tropojë e Pukë), 1 032 nuk marrin pjesë në format e arësimit të Partisë.

Niveli i ulët i propagandistëve ka penguar një zgjerim më të madh të rrjetit arësimor të Partisë. P.sh. në një grup prej 1 000 propagandistësh 551 ishin me shkollë fillore, 176 me shkollë unike, 267 me disa klasë të mesme ose të plotë dhe 6 me arësim të lartë.

Pas Kongresit I doli edhe vendimi «Mbi punën politike me masat», i cili konkretizoj format e organizimit, përmirësoi dhe forcoi punën e agitacionit në cilësi dhe në shtrirjen e tij.

Gjatë kësaj periudhe janë arritur suksese të mëdha në mobilizimin e masave për problemet politike dhe ekonomike. Entuziazmi dhe mobilizimi i masave gjatë fushatës për ndër të 10-vjetorit të themelimit të Partisë, fushatave për ndër të 7 Nëntorit, ditëlindjes së shokut Stalin, fushatave për zgjedhjet, fushatave të solidaritetit me luftën e popujve për paqen si me atë të Koresë, nënshkrimet për paqen etj., kanë treguar se orientimi i Kongresit I që të forcohet miqësia dhe dashuria për Bashkimin Sovjetik e shokun Stalin, të forcohet lufta

për paqen e të demaskohet veprimitaria armiqësore e imperialistëve luftënxitës amerikano-anglezë e shërbëtorëve të tyre titistë, monarko-fashistëve etj. si dhe të forcohet vigjilencia e luftës për ruajtjen dhe forcimin e Republikës Popullore, ka përfshirë masat e gjera të vendit. Kjo është arritur në saje të punës politike të organizatave të Partisë.

Kolektivet e agitatorëve që përmbledhin sot 31 799 agitatorë kanë shkuar vazhdimiشت duke u zgjeruar, ato janë ngritur kudo dhe kanë tërhequr një masë të madhe njerëzish të ndershëm dhe patriotë pa parti në punën politike me masat.

Por në punën e propagandës e të agitacionit ka të meta dhe dobësi:

Ngritura politike dhe ideologjike e Partisë nuk konsiderohet akoma si një nga problemet më me rëndësi, ajo nuk udhëhiqet si duhet nga komitetet e Partisë e nga organizatat bazë. Deri disa kohë më parë edukimi marksist-leninist i anëtarëve e i kandidatëve të Partisë ishte jashtë kujdesit të duhur dhe kontrollit të organizatës bazë dhe komitetet e Partisë kanë ngarkuar vretena ndjekin këtë vetëm me anën e propagandistëve. Kjo praktikë e gabuar, ka bërë që komitetet e Partisë të kufizojnë detyrat e tyre në ngritjen e formave të arësimit në Parti dhe të angazhojnë sektionet e agit-propit e kabinetet edhe në ndjekjen e frekuentimit nga ana e dëgjuesve, në marrjen e masave disiplinore etj. Dhe nga kjo praktikë jo e drejtë, është dobësuar udhëheqja e tyre në problemet më të rëndësishme të punës ideologjike në Parti, si në ngritjen e kualitetit e të metodës së propagandës, në lënjen krejt pasdore të punës për edu-

kimin marksist-leninist të të rinxje dhe në zhvillimin e një punc shumë të dobët me masat e Partisë që kanë mbetur jashtë këtyre formave, në punonjësit pa parti, punëtorë, fshatarë dhe me inteligjencien.

Është shumë e dëmshme për Partinë në qoftë se nuk luftohet me vendosmëri kundër indiferentizmit ose nënveftësimit të studimit të teorisë marksiste-leniniste që ekziston në mjaft kuadro udhëheqës të Partisë e të shtetit, në rrethe e në qendër. Tamam, studimi individual, ku janë përfshirë shokët që kanë një preqatitje më të mirë ideologjike, shkon më keq dhe ka rezultate më të dobëta. Ku është e keqja? Mos është metoda e papërshtatshme? Përkundrazi. Në vendimet e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste (bolshevik) të Bashkimit Sovjetik thuhet: «Metoda kryesore ku të mësojnë kuadrot marksizëm-leninizmin, duhet të jetë metoda e studimit individual». Por e keqja, shokë, është në nënveftësimin e studimit të marksizëm-leninizmit. Deri një vit më parë, kjo gjendje, me pak përjashtime, ka qenë edhe në anëtarët e Komitetit Qendror.

Ky nënveftësim shihet në tendencën e komiteteve të Partisë që janë gati për të dobësuar format e arësimit të Partisë duke dërguar me javë në fshatra, propagandistët për grumbullimet e çfarëdo fushate. Kjo shihet në tendencën e disa kuadrove të Partisë e të shtetit, në ndërmarrjet ekonomike e në institucionet e tjera si dhe në vetë aparatet e komiteteve të Partisë për të dërguar në shkollat e në kurset e Partisë jo kuadrot më me përgjegjësi, më të shëndoshë e me perspektivë, por ata që ndodhen më «të ngeshëm» e që «s'prishin punë». Kjo politikë kuadri dritëshkurtër duhet të marrë fund.

Të meta e dobësi të theksuara ka në cilësinë e propagandës së Partisë. Pas kongresit kujdesi i Komitetit Qendror u përqëndrua në ngritjen e sistemit arësimor në Parti dhe puna për prebatitjen e propagandistëve që krejt e pamjaftueshme. Natyrisht menjëherë u ndie nevoja e madhe e prebatitjes dhe e ngritjes së propagandistëve, për këtë u zhvilluan shumë seminare gjatë verës dhe u vendos një sistem edukimi i propagandistëve gjatë vitit arësimor. Por puna e seksioneve të agjitet-propit dhe e kabineteve të Partisë në rrethe, kujdesi i komiteteve të Partisë si dhe ndihma e Drejtorisë së agjencionit e të propagandës të Komitetit Qendror dhe e shtypit ka qenë e dobët dhe me të meta.

Partia ndodhet përpëra një problemi të rëndësishëm: nga njëra anë duhet të shtojë numrin e propagandistëve për t'ju përgjegjur shtrirjes së arësimit ideo-politik në Parti e në masa dhe nga ana tjetër, njëkohësisht, duhet të ketë shumë kujdes e të marrë masa që cilësia e propagandës të mos ulet.

Në vendimet e Partisë Komuniste (bolshevike) të Bashkimit Sovjetik, konsiderohet si një praktikë e parregullt përpjekja për të përfshirë sa më tepër komunistë në rrethet e rrjetit të arësimit të Partisë në dëm të cilësisë të propagandës praktike. Ta rindërtojmë organizimin e propagandës së partisë në mënyrë të tillë — thuhet në këto vendime — që të sigurojmë ngritjen e cilësisë së saj dhe të nivelistës saj ideologjik.

Duke pasur këto mësime të Partisë Bolshevikë dhe duke treguar shumë kujdes në zgjedhjen, prebatitjen e ngritjen e propagandistëve, puna politike e ideolo-

gjike do të forcohet e niveli i propagandës së Partisë do të ngrihet.

Në punën e propagandës ka formalizëm e një ndarje të teorisë nga praktika, ngajeta e problemet praktike të Partisë. Formalizmi në punën politike e ideologjike shihet që në mënyrën se si bëhet agjitacioni e propaganda në masa: me fjalë të mëdha e të pakuptueshme, e pali-dhur mirë me nevojat e popullit, jo bindëse dhe luftara-ke. Kjo shihet që në kabinetet të cilat ashtu si janë sot, s'janë akoma vatra të fuqishme për përhapjen e ideve të marksizëm-leninizmit e të vijës së Partisë sonë, por ekspozita të bukura, pa jetë e aktivitet.

Gjithashtu në propagandën me shtyp e leksione, vihet re një trajtim historik i çështjeve, një demaskim i botëkuptimeve të vjetra, i shfaqjeve të huaja, por nuk ka një analizë marksiste, nuk vihet përballë së vjetërës botëkuptimi ynë i ri komunist që të shërbejë si orientim për veprim.

Roli i shtypit për të ndihmuar masat e Partisë në studimin e marksizëm-leninizmit, në sqarimin e shumë problemeve e në shkëmbimin e eksperiencës së punës politike e ideologjike, ka qenë krejt i pamjaftueshëm. Në këtë punë kanë ndihmuar shumë pak kuadrot udhëhe-qës të Partisë, anëtarët e Komitetit Qendror, sekretarët e Partisë të rretheve etj.

I duhet dhënë fund një herë e përgjithmonë indife-rentizmit e qëndrimit aspak komunist që mbajnë shumë anëtarë partie e kuadro me përgjegjësi kundrejt shpër-ndarjes dhe aq më shumë leximit të shtypit e të librit. Është krejt e pakuptueshme se si mund të drejtojë punën një organizatë partie që nuk lexon shtypin.

Shoku Stalin ka thënë:

«*Shtypi është arma më e fuqishme, me anën e së cilës partia flet çdo ditë dhe çdo orë me klasën punëtore në gjuhën e saj»¹.*

«Puna është se s'ka asnje mundësi që sot të udhëheqësh pa «andralla», dhe jo më pa gazeta»².

Për të ngritur në një nivel më të lartë propagandën e Partisë (punën politike e ideologjike të saj), për të armatosur sa më parë e sa më mirë anëtarët e Partisë e kuadrot udhëheqës, duhen luftuar të gjitha këto të meta e dobësi, duhen zbatuar me këmbëngulje vendimet e Komitetit Qendror dhe duhen mbajtur gjithmonë parasysh mësimet e mëdha e të ndritura të Partisë Bolshevikë e të Lenin-Stalinit.

Komiteti Qendror ka marrë këto kohë vendime të rëndësishme për ngritjen e nivelit arësimor e ideo-politik të kuadrove të Partisë e të shtetit ku parashikohet që Shkolla e Partisë të bëhet në dy vjet, rrëth saj të ngrihen kurse të ndryshme me programe e afate të ndryshme, të bëhet e detyrueshme ndjekja e arësimit më të lartë për aparatet e Partisë dhe kuadrot e shtypit, është vendosur një sistem seminaresh për ngritjen ideologjike e profesionale të kuadrove të Partisë etj.

Shokë, Partia dhe qeveria kanë krijuar kondita të tillë që masat e gjera punonjëse, të dalin nga errësira

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 5, f. 198.

² J. V. Stalin. Veprat, vëll. 7, f. 128.

e prapambetja e së kaluarës. Me një zell të madh e me entuziazëm, masat e qytetit e të fshatit, po ndjekin kurset kundër analfabetizmit dhe shkollat e ndryshme. Bjtë e bijat e punëtorëve e të fshatarëve mund t'i gjesh kudo në shkollat pedagogjike, profesionale, artistike e deri në shkollat e Bashkimit Sovjetik e të demokratike popullore. Pa këtë zhvillim kultural e arësimor të masave nuk mund të kuptohet e të arrihet edhe zhvillimi ekonomik. Por aq më shumë pa zhvillimin kultural e arësimor të pararojës së këtyre masave të Partisë sonë nuk mund të ecet përpara. Masave të Partisë u duhet të jenë në çdo gjë, kudo e kurdo, në krye. Gjendja arësimore e Partisë nuk është shumë e kënaqshme dhe ngrihet me ngadalë. Në fund të vitit 1951 gjendja arësimore paraqitet si më poshtë:

Lloji i arësimit	Anëtarë partie	Përqindja	Kandida- të partie	Përqindja	Gjith- sejt	Përqindja
Analfabetë	289	0,96	723	4,9	1 012	2,2
Me fillore të pambrau .	7 543	25,2	5 847	40,3	13 390	30,1
Me fillore	15 356	51,3	6 464	44,6	21 820	49,1
Me 7-vjeçare	3 992	13,3	921	6,3	4 913	11
Me profesionale të ulët	312	1,04	52	0,3	364	0,8
Me të mesme	2 045	6,8	399	2,7	2 444	5,5
Me të mesme pro- fesionale	299	0,9	57	0,3	356	0,8
Me universitet	96	0,2	23	0,1	119	0,2
Shuma	29 932		14 486		44 418	

Ky kongres duhet të shënojë një kthesë të rëndësishme për ngritjen e nivelit politiko-ideologjik e

arësimor-kultural të Partisë. Duhet, pra, t'i vihemë më këmbëngulje studimit, duhet jo vetëm që disa, por masat e gjera të Partisë të ngrenë nivelin e tyre arësimor-kultural, të mësojnë pa pushim teorinë marksiste-leniniste dhe ta zbatojnë këtë në praktikë.

a) Të forcojmë punën e Partisë në fushën ideo-politike dhe kulturale

Në konditat e ndërtimit të socializmit, të ndërtimit të shoqërisë së re dhe veçanërisht në konditat e rrëthimit ku gjendet vendi ynë, forcimi i punës politike dhe ideologjike në Parti, merr një rëndësi çdo ditë e më të madhe. Aq më shumë kjo merr një rëndësi të madhe po të mbajmë parasysh se Partia jonë pës çlirimit është rritur nga 5 266 në 44 418 anëtarë e kandidatë. E vërteta është se këta mijëra anëtarë e kandidatë partie karakterizohen nga një dashuri e besnikëri e thellë për Partinë, nga një entuziazëm e shpirt luftarak për ndërtimin e shoqërisë së re. Por duhet të mos harrojmë se ata sjellin me vete në Parti dhe gjithë prapambetjen kulturale e arësimore të trashëguar nga e kaluara, gjithë influencat e ideologjisë feudobor-gjeze, me të cilat i ka ushqyer shoqëria e vjetër.

A mund të mendojmë se sot për sot kemi shumë punë, prandaj me t'i vënë ca në udhë këto punë, atëherë do të fillojmë të mësojmë, atëherë do të merremi me ngritjen tonë kulturalo-arësimore dhe ideo-politike?

Jo, shokë, neve nuk na lejohet të mendojmë në këtë mënyrë. Ata shokë që mendojnë kështu, ata duhet

t'i paralajmërojmë se shpejt do të mbeten në mes të udhës, pse zhvillimi i vrullshëm i shoqërisë sonë të re kërkon rritjen e pararojës së saj, e kuadrove për ta udhëhequr. Kush nuk rritet bashkë me këto, do të zvarritet për ca kohë pas karros që ecën revan dhe më në fund do të mbetet prapa. Ky është një ligj dialektik që duhet njobur thellë. Kështu na mësojnë i madhi Lenin dhe i madhi Stalin.

«Pa njobjen e teorisë marksiste-leniniste — thuhet në vendimet e Partisë Komuniste (bolshevike) të Bashkimit Sovjetik, — pa përvetësimin e bolshevizmit dhe pa kapërcimin e prapambetjes së tyre teorike, kuadrot tanë do të çalojnë me të dy këmbët, sepse detyra e udhëheqjes së drejtë e të gjitha degëve të ndërtimit socialist, kërkon përvetësimin e bazave të teorisë marksiste-leniniste nga ana e praktikëve, kërkon dijeninë përt'u udhëhequr nga teoria në zgjidhjen e çështjeve të veprimtarisë praktike». Po atëhere që të mësojmë — mund të mendojnë disa shokë — duhet të shkarkohemi nga punët e shumta, nga telashet e grumbullimit, e çështjeve ekonomike etj. A na lejohet kjo? Në asnjë mënyrë. Partia është në krye të pushtetit populor dhe mbi të bie përgjegjësia e madhe dhe e rëndë e udhëheqjes së transformimeve të mëdha e të shpejta që bëhen në vendintonë në fushën ekonomike, kulturale e sociale.

Atëhere cila është rruga e daljes? Ne komunistët e sotshëm, shokë, jemi të lumtur, pse të gjitha rrugët e daljes na i kanë ndriçuar Marksit, Engelsin, Leninit e Stalinit.

«Natyrisht teoria bëhet një gjë pa objekt — thotë shoku Stalin — po qe se ajo nuk lidhet me

praktikën revolucionare, po ashtu sikurse edhe praktika bëhet e verbër, po qe se nuk e ndriçon rrugën e saj me teorinë revolucionare»¹.

Sa më shumë të kemi parasysh këtë mësim, aq më mirë e drejt do t'u përgjigjemi detyrave që na vë përpara ndërtimi i socializmit.

Është për t'u theksuar se shumë kuadro kanë punë mjaft, lodhen shumë, pikërisht pse studjojnë pak. Ka shumë shokë të tjerë që nën pretekstin e punëve të shumta fshehin mungesën e kurajës e të vullnetit për të mësuar me vendosmëri, për t'u futur në kalanë e diturisë e të shkencave, për t'ju futur njohjes së shkencës marksiste-leniniste. Ka edhe mjaft komunistë, sidomos anëtarë partie të thjeshtë e të rinj, që qëndrojnë larg nga lufta e botëkuptimeve të tyre të vjetra dhe, jo për faj të tyre, por nga mungesa e një pune të gjerë e sistematike ideologjike, këta shokë nuk njojin botëkuptimin marksist mbi gjérat që i rrethojnë dhe ndërgjegjja e tyre marksiste është e ulët. Të gjithë këta shokë, në qoftë se duan të ecin përpara, duhet të kenë gjithmonë parasysh mësimin e shokut Stalin:

«Duhet pranuar, si një aksiomë, se sa më të lartë të janë niveli politik dhe vetëdija marksiste-leniniste e kuadrove të çdo sektori të punës së shtetit dhe të partisë, aq më e mirë dhe më frutdhënëse është vetë puna, aq më të efektshme janë rezultatet e punës, dhe anasjelltas.

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 6, f. 92.

sa më të ulët që të janë niveli politik dhe vetë-dija marksiste-leniniste e kuadrove, aq më të mundshme janë gabimet dhe dështimet në punë...¹.

Pa një punë të thellë për edukimin marksist-leninist të masës së Partisë, vazhdimisht do të bëhen shtrembërime e do të ketë lëkundje në vijën e Partisë, vazhdimisht do të hasen vështirësi në zgjidhjen e problemeve ekonomike, vazhdimisht komunistët nuk do të janë në gjendje të luftojnë si duhet kundër ideologjisë borgjeze për të siguruar një ideologji më të lartë në arësim, kulturë, art e letërsi, vazhdimisht do të manifestohen në Parti influencat e ideologjisë feudoborgjeze e reaksionare e do të dobësojnë kështu shpirtin luftarak e revolucionar në Parti.

b) Për një lidhje të ngushtë të teorisë me praktikën

Kjo është urgjente, e domosdoshme, pse jemi shumë prapa, e përsërit edhe një herë, jemi prapa të gjithë, pa përjashtim. Duhet të mësojmë filozofinë marksiste-leniniste, të mësojmë metodën e saj që është materializmi dialektik. Është e domosdoshme ta studojmë këtë filozofi dhe këtë metodë, pse vetëm kështu do të kuptojmë marksizëm-leninizmin, i cili do të na armatosë për të shqelmuar dhe flakur tej teoritë borgjeze dhe do të na lejojë të zhvillojmë një luftë politike të përgjithshme. Lenini na mëson:

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 247.

«Pa teori revolucionare nuk mund të ketë as lëvizje revolucionare»¹.

Kjo do të thotë pikësëpari, që duhet me e lidhë teorinë me praktikën. Praktika do të thotë të vësh teorinë në jetë. Industria, bujqësia, realizojnë, domethënë kthejnë në realitet njojuritë kimike, fizike, biologjike. Mund të jesh praktik, por atëhere realizon në mënyrë mekanike; mund të jesh vetëm teorik dhe atëhere bën projekte të gjërave që s'realizohen. Duhet, pra, të ketë lidhje të ngushtë në mes të praktikës dhe të teorisë. I duhet, pra, klasës punëtore dhe avangardës së saj, partisë komuniste ose punëtore një metodë analize e drejtë për të realizuar vepra revolucionare të drejta, i duhet një metodë që të mos jetë një dogmë, domethënë që të japë zgjidhje të gatshme, por një metodë që të llogaritë fakte dhe rrrethana që s'janë ngahera të njëjta, një metodë që nuk e ndan teorinë nga praktika. Dhe këtë metodë na e mëson filozofia marksiste-leniniste, materializmi dialektik.

Historia e Partisë Bolshevikë na mëson se vetëm ajo parti që ka zotëruar teorinë marksiste-leniniste mund të shkojë përpara e sigurtë dhe të shpjerë përpara klasën punëtore.

Historia e Partisë Bolshevikë na mëson se të zotërosh teorinë marksiste-leniniste, nuk do të thotë të mësosh përmendësh formulat e konkluzionet, por do të thotë ta bësh për vete këtë teori dhe të mësosh ta

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 5, f. 434.

përdorësh për zgjidhjen e problemeve praktike të lëvizjes revolucionare në konditat e ndryshme të luftës së klasës së proletariatit. Prandaj të gjithë ne duhet të studjojmë kursin e shkurtër të «Historisë së Partisë Komuniste (bolshevike) të Bashkimit Sovjetik» dhe ta bëjmë tonën këtë armë të fuqishme të bolshevizmit, ku është përbledhur eksperiencia e Partisë Bolshevikke. Çdo komunist atë duhet ta konsiderojë si mjetin më të rëndësishëm në zgjidhjen e detyrës së përvetësimit të bolshevizmit dhe të pajisjes së anëtarëve të Partisë me teorinë marksiste-leniniste, domethënë me dijeninë e ligjeve të zhvillimit shoqëror dhe të luftës politike. Historia e PK të BS është mjeti përritjen e vigjilencës politike të bolshevikëve të partisë dhe të atyre pa parti, është mjeti përritjen e propagandës së marksizëm-leninizmit në lartësinë teorike përkatëse.

Të bëhet kursi i shkurtër i «Historisë së Partisë Komuniste (bolshevike) të Bashkimit Sovjetik», arma e pandarë e çdo komunisti që ta ndriçojë rrugën e tij për veprim. Sa më shumë e sa më mirë ta zotërojë atë Partia dhe gjithë njerëzit që drejtojnë jetën politike, ekonomike, kulturale e shoqërore, aq më shpejt dhe aq më me siguri do të ecë përpara Partia jonë e Punës dhe gjithë populli ynë.

Të forcojmë drejtimin e Partisë në fushën e punës ideo-politike e kulturale, të luftojmë kundër çdo tendencë përtacie ose nënçmimi të punës përvetësimin e bazave të marksizëm-leninizmit dhe kundër çdo nën-vleftësimi të kulturës së përgjithshme, pse kështu do të eliminojmë të metat në punë dhe do ta çojmë vazhdimisht përpara revolucionin kultural në vendin tonë.

V

MBI DISA DETYRA URGJENTE NË LIDHJE ME FSHATIN

Këtu nuk do të bëj fjalë mbi problemet dhe detyrat ekonomike në fshat, pse shoku Mehmet Shehu do të flasë në raportin e tij. S'ka dyshim se fshatarësia jonë punonjëse është lidhur ngushtë me Partinë, kjo do të thotë se aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse është një realitet. Fshatarësia i qëndron besnikë Partisë së Punës që e çlroi nga zgjedha e robërisë dhe që e udhëheq drejt socializmit. S'ka dyshim se ajo, jo vetëm që e ka pranuar, por e konsideron të domosdoshme dhe shpëtimtare udhëheqjen e klasës punëtore. Kjo është garancia themelore e shkuarjes në socializëm. Këtë aleancë ne duhet ta forcojmë çdo ditë, pse në rrugën tonë për ndërtimin e bazave të socializmit kemi dhe armiq të cilët luftojnë me rreptësi për ta dobësuar këtë aleancë.

Gjatë kësaj periudhe të shkurtër, që prej çlirimt dhe deri sot, janë bërë përparime kolosale në fshat: është përmirësuarjeta dhe ekonomia, është përhapur arësimi fillor dhe i mesëm me një shpejtësi të madhe, po luftohen me sukses analfabetizmi dhe sëmundjet, po hyjnë me ngadalë, po me siguri metodat e reja të

punës dhe të prodhimit. Por fshati ynë është mjaft prapa qytetit. Fshatari ynë është patriot, përparimtar, dëshiron që sa më shpejt të fitojë kohën e humbur dhe të zhdukë prapambetjen e së kaluarës, por natyrisht çdo gjë nuk mund të ndryshojë përnjëherë. Duhet luftë dhe përpjekje. S'ka dyshim që ne hasim pengesa në fshat, në vendosjen e formave të reja të punës dhe të prodhimit dhe kjo e ka burimin në prapambetjen e fshatit, gjithashtu në pamundësinë e pushtetit tonë për t'u bërë ballë përnjëherë të gjitha nevojave që lyp një punë kaq e gjerë ndërtimtare e vendit, në mungesën e kuadrove të ngritur dhe të aftë të zgjidhin si duhet problemet e fshatit dhe në tendencat mikroborgjeze të prodhimit të vogël që manifestohen çdo ditë e çdo orë në fshat. I bie, pra, barra e madhe Partisë t'i kapërcejë këto vështirësi. Fshatarësia është aleati kryesor dhe besnik i Partisë sonë. Ajo i jep popullit bukën, bimët industriale, nga radhët e saja shtohet numri i punëtorëve që vënë në lëvizje industrinë dhe minierat, ajo i jep në pjesën më të madhe ushtarët që mbrojnë atdheun dhe fitoret e popullit. Në aleancë me fshatarësinë ne ndërtojmë bazat e socializmit. Partia jonë ndjek me besnikëri mësimet e Stalinit që thotë:

«Gjëja kryesore tani nuk është aspak ndezja e luftës së klasave në fshat. Gjëja kryesore tani është t'i bashkojmë fshatarët e mesëm rreth proletariatit, t'i tërheqim ata përsëri në anën tonë. Gjëja më me rëndësi tani është që të lidhemi ngushtë me masën kryesore të fshatarësise, të ngremë nivelin e saj material e kultural

dhe të ecim përpara bashkë me këtë masë kryesore në rrugën e socializmit»¹.

Duhet kurdoherë të kemi parasysh se Partia është shumë e interesuar për zhvillimin e industrisë, pse ajo është baza kryesore për ndërtimin e socializmit dhe mbështetje e pushtetit popullor. Në këtë drejtim ritmi i zhvillimit të industrisë sonë, brenda kësaj periudhe të shkurtër, është shumë i kënaqshëm dhe do të bëhet edhe më i madh me planin tonë të parë pesëvjeçar. Por të mos harrojmë, nga ana tjetër, se Partia është po aq e interesuar për zhvillimin e bujqësisë, pse pa një zhvillim të bujqësisë industria mbetet si peshku pa ujë. Industria jonë duhet të mbështetet në tregun e brendshëm domethënë në tregun fshatar dhe kooperativist. Ne jemi shumë të interesuar që të përmirësohet gjendja ekonomike e fshatarësisë, të ngrihet në nivel shumë më të lartë gjendja ekonomike dhe kulturale e fshatarëve tanë, të ngrihet fuqia prodhuese e fshatarit, të rritet fuqia blerëse e tij dhe kështu të forcohet aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë.

Ekonomia jonë në fshat në pjesën dërmuese është një ekonomi e shpërndarë individuale ku sundon sistemi i ekonomisë së vogël individuale me të metat e sajë dhe me pengesa të çdo lloji. Prandaj edhe lufta për t'i kapërcyer këto pengesa është e vështirë, pra, përpjekjet dhe vëmendja duhet të jenë më të mëdha, ndihmat më të koncentruara dhe drejtimi më i përsosur nga ana e komunistëve. Reforma agrare, zbatimi i metodave të

1 J. V. Stalin. Veprat, vëll. 7, f. 125.

reja agroteknike, ndihmat e vazhdueshme fshatarësisë nga ana e pushtetit, kanë sjellë përmirësimë të dukshme në ekonominë fshatare, por kjo mbetet akoma një fushë ku Partia duhet të zhvillojë beteja të mëdha për të korru fitore të reja. Kemi fituar betejën e parë mund të themi në fshat, por tani Partisë i vihet si detyrë që ekonominë fshatare aktuale ta ndryshojë dhe ta futë gradualisht, pa u shpejtar, por pa u ndalur, gjatë procesit, në rrugën e sistemit të përgjithshëm të zhvillimit ekonomik që na çon në socializëm. Një proces i tillë i zhvillimit të ekonomisë fshatare ka për qëllim të krijojë kushtet që ta çojë përparrë ekonominë kombëtare duke ngritur në mënyrë graduale dhe pareshtur mirëqenjen e masës së madhe të fshatarëve punonjës, dhe bashkë me të mirëqenjen e të gjithë popullit punonjës të vendit tonë. Në këtë zhvillim të ekonomisë fshatare, ne kuptojmë që fshatarësia jonë dhe ekonomia e saj të kalojë nga faza primitive ose tranzitore, ku gjendet, në një fazë më të përparuar dhe të bëjmë kësisoj që bujqësia të ecë krah për krah me zhvillimin e industrijeve sonë. Njëra të ndihmojë tjetrën dhe të dyja të ecin krahas, të bashkohet fshatarësia në rrugën e klasës punëtore që e udhëheq dhe të çelnikoset në këtë mënyrë aleanca e të dyja këtyre klasave që përbëjnë faktorët determinues të shoqërisë sonë.

Shoku Stalin na mëson se si ta ndjekim këtë rrugë dhe të korrim fitoren. Shoku Stalin thotë:

„Është i nevojshëm para së gjithash, likuidimi i mbeturinave të komunizmit të luftës në fshat. Pastaj është e nevojshme një politikë e

drejtë e çmimeve të prodhimeve të fabrikuara dhe prodhimeve bujqësore, një politikë që të sigurojë zhvillimin e shpejtë të industrisë dhe të bujqësisë dhe likuidimin e «gërshërëve». Përveç kësaj, është i nevojshëm pakësimi i shumës së përgjithshme të tatimit bujqësor dhe kalimi i tij gradual nga binarët e buxhetit të përgjithshëm shtetëror në binarët e buxhetit lokal. Është i nevojshëm kooperimi i masave milionëshe të fshatarësise, në radhë të parë në fushën e kooperativave bujqësore dhe të kreditit, si mjet përfutjen e ekonomisë fshatare në sistemin e përgjithshëm të ndërtimit socialist. Është i nevojshëm furnizimi maksimal i fshatit me traktorë, si mjet për revolucionizimin teknik të bujqësisë dhe si rrugë për krijimin e vatrave kulturale-teknike në fshat. Është i nevojshëm, më në fund, zbatimi i planit të elektrifikimit, si mjet për afrimin e fshatit me qytetin dhe për zhduket e kontrastit midis tyre»¹.

Ky është program pune për ne për një periudhë mjaft të gjatë, ky është objekti i planit tonë të parë pesë-vjeçar dhe i planeve të ardhshme, të cilat do të na sjellin rezultate shumë të kënaqshme në rrugën për ndërtimin e socializmit ku na udhëheq Partia jonë dhe i madhi Stalin.

Partisë sonë i bie, pra, barra e rëndë ta udhëheqë popullin në këtë rrugë të lavdishme. Partisë sonë i bie

¹. J. V. Stalin. Veprat, vëll. 7, f. 159.

barra të drejtojë fshatarësinë tonë për të kryer këto detyra të mëdha. S'ka dyshim pra se duhet përmirësuar puna e Partisë në fshat, të forcohet drejtimi i saj, puna organizative dhe politike. Duhet t'u kushtohet një kujdes i veçantë nga drejtuesit organizatave bazë në fshat dhe komunistëve të fshatit. Në këtë drejtim kërkohet një punë më e rregullt, një kujdes më i madh, këmbëngulje dhe durim, pse komitetet e Partisë të rretheve, në përgjithësi, fshatit i kushtojnë një kujdes të përciptë dhe vetëm në drejtimin e kërkesave për plotësimin e detyrimeve. Këto kërkesa nuk shoqërohen me një edukim të shëndoshë politik, ideologjik dhe kultural. Komitetet e Partisë nuk i edukojnë sa duhet shokët e fshatit si t'i organizojnë punët më mirë. Fshatit dhe komunistëve u jepen shumë urdhëra dhe më pak sqarime si të zbatohen këto urdhëra. Në fshat punohen direktivat në një mënyrë të përciptë dhe formale, pa i lidhur këto si duhet me gjendjen konkrete të fshatit. Mjaft herë njerëzit që venë e i punojnë këto direktiva, jo vetëm që s'i njojin si duhet gjendjen e fshatit dhe problemet e ekonomisë, por edhe nuk preqatiten mirë. Punimi i direktivave është me shumë rëndësi dhe kurrsesi nuk duhet të lejohet të punohet në mënyrë të përciptë. Instruktorët që merren me çështjen e Partisë në fshat, duhet patjetër t'i mësojnë dhe t'i dinë mirë problemet e bujqësisë, të agronomisë, të blegtorisë, të frutikulturës, ashtu sikundër instruktorët dhe komunistët në përgjithësi që punojnë në qytete, nuk mund të drejtojnë pa njojur industrinë, tregëtinë, çështjet financiare e të tjera. Pa i mësuar këto nuk mund të drejtohet. Fjalët boshe, frazat e mëdha, konferencat me karakter të përgjith-

shëm mbi situatën ndërkombejtare nuk të çojnë shumë larg, s'i dëgjon njeri me vërejtje, pse i ka dëgjuar njëmijë herë dhe me këto e mërzit tjetrin e i humbet kohën. Fshatarin duhet ta mësojmë konkretisht për çështjet e bujqësisë, ta këshillojmë konkretisht të përdorë metodat e reja agroteknike, këto t'ja tregojmë në fushë, në jetën eksperimentale. Atëherë fshatari do të na dëgjojë me shumë vërejtje, do të na jetë mirënjohës dhe do të na ndjekë deri në fund. Në këtë rrugë Partia duhet të vërë të gjitha forcat për t'i edukuar komunistët e fshatit që kështu të udhëhiqet fshati në rrugën e ndërtimit të bazave të socializmit.

Disa drejtues të Partisë në rrethe duhet menjëherë të braktisin frymën e neglizhencës së punëve të Partisë në fshat, të mosstudimit të protokolleve të organizatave bazë ku pasqyrohet e gjithëjeta e Partisë, të mospraktikimit si duhet të seminareve me sekretarët e organizatave bazë. Këto detyra kryesore kanë lidhje të ngushtë me detyrat e Partisë në fshat, të cilat duhet të studohen, të analizohen me kujdesin më të madh, të merren masa të shpejta operative dhe t'u jepet ndihma e menjëershme komunistëve për të përmbushur nevojat dhe për të zgjidhur sa më mirë nevojat e fshatarëve.

Disa drejtues mendojnë të jenë në rregull me qeverinë ose me Komitetin Qendror dhe më pak me fshatarësinë. Këta të mos harrojnë se po nuk qenë në rregull me popullin, me punëtorët, me fshatarësinë, ata do ta kenë keq me udhëheqjen e Partisë dhe të shtetit. Drejtuesit e Partisë në rrethe duhet medoemos të heqin dorë nga metodat e shëmtuara të administrimit, pse nuk mund të ecet përpara vetëm me urdhëra në çdo gjë

dhe veçanërisht në lidhje me fshatarësinë. Me fshatarësinë duhet sqarim, edukim, interesim i gjallë për nevojat dhe problemet e saj. Shoku Stalin thotë:

«...të jesh i zoti të drejtosh ekonominë, duhet ta njohësh dhe ta kuptosh ekonominë... Prandaj mund të udhëheqë vetëm ai që kuption nga ekonomia, që di t'i japë muzhikut këshilla të dobishme përsa i përket zhvillimit të ekonomisë, që di t'i vijë në ndihmë muzhikut në ndërtimin ekonomik. Të studjojnë ekonominë, të lidhen me ekonominë, të futen në të gjitha hollësirat e ndërtimit ekonomik — kjo është sot detyra e komunistëve në fshat»¹.

Në rrethet ku puna e Partisë shkon mirë, ne shohim të kemi rezultate të kënaqshme në zhvillimin e ekonomisë bujqësore. Duke u drejtuar mirë dhe këshilluar si duhet, fshatarët kanë pasur të korra të bollshme, janë realizuar mirë grumbullimet, shembulli personal i komunistëve ka qenë i lartë, është realizuar qind për qind arësimi i detyruar fillor, shtypi ka shkuar, është shpërndarë dhe lexuar në rregull, janë luftuar shfaqjet e dëmshme në Parti, është luftuar me sukses fanatizmi, gratë kanë dalë në prodhim, janë ngritur politikisht, kanë shkuar në shkolla, kanë shkuar në fabrika e në punë të ndryshme. Ne kemi shembuj të lavdërueshëm në këtë drejtim në rrethin e Peshkopisë, ku sekretar

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 7, f. 129.

i parë është shoku Jashar Menzelxhiu, në rrethin e Tiranës ku sekretare e parë është shoqja Fiqret Shehu, në Tepelenë, në Sarandë, në Korçë etj. Këtu komunistët janë mobilizuar, kanë qenë shembull, kanë mobilizuar masat e fshatarësisë dhe kanë korrur rezultate të kënaqshme. Këto rezultate janë arritur se komitetet e Partisë në këto rrethe janë interesuar shumë për çështjet e fshatarësisë, kanë qenë vazhdimisht në kontakt me bazën e Partisë, kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm me popullin, u kanë mësuar fshatarëve metodat e reja agroteknike sovjetike, janë interesuar për zhvillimin e arësimit e të kulturës, kanë organizuar klubet. Në rrethin e Korçës, bujqësia ecën më mirë se në çdo vend tjetër. Komunistët e Korçës janë në pararojë dhe fshatarët e atij rrethi janë nga më përparimtarët. Atje kooperativat bujqësore forcohen çdo ditë, përmirësojnë organizimin e tyre, ato pásurohen dhe bëhen shembull i mirë për bujqit me ekonomi individuale. Kultura e rëndësishme e panxharit të sheqerit në Korçë ka gjetur zgjidhje të kënaqshme dhe bujqë përparimtarë kanë arritur rendimente të larta. Kështu ngjet për pambukun në shumë lokalitete të Fierit dhe të Lushnjës, kështu ngjet për prodhimin e ullirit dhe të agrumeve në Vlorë e në Bregdet, për prodhimin e misrit në Peshkopi, për prodhimin e orizit në rrethin e Sarandës e të Elbasanit. Ky është fruti i punës së palodhur të fshatarësisë sonë përparimtare dhe i udhëheqjes së drejtë të Partisë dhe të pushtetit në këto rrethe. Kudo në vendin tonë janë të gjitha mundësitë që puna në fshat të marrë një hov përpara dhe Partia duhet të shkundet nga të metat e t'i përvi-

shet punës në mënyrë më të organizuar që të korrim kudo suksese.

Drejtuesit e Partisë në rreth dhe Partia në fshat duhet t'i vënë rëndësinë më të madhe këshillit popullor të fshatit, i cili është organi me rëndësi i pushtetit në bazë. Kjo duhet të kuptohet mirë dhe drejt dhe t'u jepen këshillave të gjitha kompetencat dhe të drejtat e drejtimit të pushtetit në fshat. Është urgjente dhe e domosdoshme të forcohen këshillat e fshatrave me njerëz të zgjedhur nga populli dhe të rrënjoset në to demokracia. Duhet të likuidohen metodat e komandimit, të jashtëligjshme. Këshilltarët e fshatrave duhet të edukohen me njohjen e përpiktë të ligjeve, të urdhëresave dhe sidomos me ato që kanë lidhje të ngushtë me ekonominë. Aparati i këshillit në fshat duhet të jetë i thjeshtë dhe jo i kushtueshëm dhe të luftohen ato tendenca që në fshat të kemi sa më tepër njerëz me rrogë, pse të tilla rroga rëndojnë në kurriz të fshatarësisë. Këshilltarët e fshatrave e kanë për nder të zgjidhen dhe të administrojnë fshatin e tyre. Partia duhet të luftojë për fuqizimin e këshillave, për edukimin e këshilltarëve. Të zhduket monopolizimi i punëve nga komunistët dhe të kihet besim i plotë në njerëzit e popullit. Të mos merret shembull nga organizata e Partisë e fshatit Brezhdan të Peshkopisë e cila i ka ngarkuar një komunisti gjashtë përgjegjësi ose shembulli i organizatës bazë të fshatit Vergo të Sarandës ku sekretari i saj mban tetë përgjegjësi në kurriz, kurse ka me dhjetëra e me dhjetëra patriotë e patriote që janë në gjendje të kryejnë me nder detyrat që u ngarkohen. T'i luftojmë këto tendenca sektare, pse e dëmtojnë

Partinë, e shkëputin atë nga masat, e' ndërrojnë në një kastë të ndrydhur në vetëvete që kurrë nuk mund t'i zgjidhë problemet pa masën, që kurrë nuk mund t'i zbatojë vendimet, qofshin këto shumë të mira, pa ndihmën e masës, pa aprovimin e masës dhe pa kontrollin e saj. Një parti si e jona, kaq popullore, kaq e dashur nga masat punonjëse të vendit, nuk mund të lejojë disa elementë burokratë e sektarë të komprometojnë prestigjin e madh të Partisë, të dobësojnë lidhjet e shëndosha që ajo ka me masat dhe të dobësojnë drejtimin e Partisë.

Çështja e edukimit politik dhe kultural të komunistëve në fshat dhe të fshatarësisë në përgjithësi është një nga detyrat kryesore të Partisë. Duhet ta kemi të qartë se pa i vënë kujdesin më të madh këtij problemi, fshati do të ngelet prapa nga çdo pikëpamje. Në asnje mënyrë kjo gjë nuk duhet të ngjasë. Por me një të goditur nuk zhduket prapambetja, padituria, fanatizmi etj. Për t'i zhdukur këto, miliona e miliona harxhon shteti në këtë drejtim. Një nga detyrat kryesore të Partisë është që detyrimin e arësimit fillor ta realizojë qind për qind. Kalamanët, djem dhe vajza, pa përjashtim, duhet të mbarojnë shkollat fillore. Për zbatimin e këtij ligji Partia duhet të zhvillojë një propagandë të madhe bindëse, duhet të jetë shumë e ashpër dhe të mos bëjë asnje lëshim. Masat duhet të janë të rrepta kundër atyre prindërve që për një arësy ose një tjetër i pengojnë fëmijët e tyre të venë në shkollë. Shpejt do ta kuptojë prindi se një masë e tillë i ka bërë shumë mirë dhe jo keq. Po e fituam këtë betejë, ne kemi arritur një nga sukseset më të

mëdha. Por me kaq Partia s'duhet të kënaqet. Partia duhet të ngulë këmbë që shumica dërmuese e djemve dhe e vajzave që mbarojnë shkollën fillore, sidomos në fshat, pse atje paraqitet problemi i vështirë, të ndjekin shkollat 7-vjeçare, kurset teknike, bujqësore, shkollat e mesme dhe universitetet. Por edhe kjo s'është e mjaftueshme. Duhet të luftohet me këmbëngulje për zhdukjen e analfabetizmit në masat e gjera të fshatit. Ne kemi korrur suksese në këtë drejtim, por lufta duhet të vazhdohet këmbëngulëse dhe me durim të madh. Çdo njeri që di të shkruajë dhe të lexojë në Republikën tonë Popullore, ta ketë për nder dhe për detyrë të bëhet një mësues për ata që akoma nuk dinë të shkruajnë dhe të lexojnë. Le të mendojmë sa shërbime të mëdha i kanë sjellë këta mësues atdheut të tyre dhe ndërtimit të socializmit duke u mësuar atyre që s'dinë, shkrimin dhe lexicin. Në Mirditë rronte dhe luftonte një komunist i quajtur Ndrec Ndue Gjoka. Ai ishte mësues, ai s'mund të duronte as shtypjen as errësirën që ushtronte në Mirditë fashizmi dhe Gjon Marka Gjoni. Fill pas çlirimt i ndihmuar nga Bardhok Biba ai, duke zbatuar direktivën e Partisë, me iniciativën e tij, që në dhjetor të vitit 1944, hapi në Mirditë 50 shkolla. Por a hapen 50 shkolla pa lokale, pa lapsa, pa fletore dhe sidomos pa mësues? Po, hapen. S'ka kala që nuk e marrin komunistët. Ndrec Ndue Gjoka, fshatar i varfër, lokalet e shkollave i krijoj në shtëpitë e fshatarëve, fletoret dhe lapsat, çau e ndau andej-këlej i mblođhi vetë, mësuesit, gjoja kryesorë, ai i grumbulloi nga ish-nxënësit e «konviktit të Oroshit», që përpëra ai u foli për hapjen e shkollave, dhe vetë u bëri

atyre një kurs të shkurtër pedagogjik. Dhe shkollat u çelën, 50 shkolla, shokë, dhe këto funksionuan kështu për mrekulli derisa i aprovoi Ministrja e Arësimit në vitin 1945. Me krenari, nxënësit e vjetër të «konviktit të Oroshit» që tani janë bërë mësues me eksperiencë, thonë «na jena nga mësuesit e parë të preqitur prej Ndrec Ndure Gjokës». Dhe shokun tonë, Ndrec Ndure Gjokën, na e vranë tradhëtarët e Gjon Marka Gjonit në Qafën e Vorres më 1946 pikërisht për këtë vepër të madhe patriotike të tij. Unë e ftoj kongresin që të nderojmë kujtimin e këtij pionieri të shquar komunist të dritës dhe të arësimit. Po të mendojë dhe të veprojë çdo njeri kështu, dhe kështu duhet të mendojë dhe të veprojë, çështja e analfabetizmit do të hyjë shpejt në arkivin e historisë së Republikës Popullore të Shqipërisë.

Partia duhet t'i vërë kujdesin më të madh shpërndarjes së shtypit e të literaturës dhe të organizojë leximin e tyre, pse në këtë drejtim kemi dobësi të mëdha. E hidhur është, por duhet thënë se ka edhe drejtues partie dhe të organeve shtetërore që nuk e lexojnë shtypin dhe literaturën. Merre me mend pastaj si mund ta çojnë punën përpëra këta «katranë». Kjo duhet të marrë fund. Por problemin e leximit të shtypit dhe të literaturës në fshat Partia duhet ta ngrejë me forcë të madhe dhe ta kontrollojë vazhdimisht. Konferencat e tjera edukative, teknike, për problemet e fshatit, duhet të zhvillohen më në rregull dhe qyleti duhet ta ndihmojë vazhdimisht fshatin në këtë drejtim. Inteligjencia jonë duhet të shkojë në fshat, të edukojë fshatarët tanë. Shumë preferojnë të hartojnë urdhëra

mbi urdhëra, vendime mbi vendime, por pak mendojnë se këto vendime duhet të zbatohen nga njerëz që kërkojnë ndihmë të sqarohen, të edukohen, t'u hapen perspektiva të gjera në punë. Vetëm puna e zyrës nuk e zgjidh problemin. Të ndjekim shembullin sovjetik, se si shkenca lidhet ngushtë me praktikën, se si profesorë dhe akademikë sovjetikë shkojnë e punojnë bashkë me punëtorin në fabrikë dhe me fshatarin në ara, provojnë me ta shpikjet e tyre, mësojnë ata, njerëz aq të ditur, nga punëtorët dhe fshatarët e thjeshtë dhe përmirësojnë shpikjet e tyre. Kurse te ne ka mjaft njerëz që s'tunden nga vendi ta provojnë punën e tyre në jetë, të mësojnë masat dhe të edukohen nga masat. Njerëzit e Partisë, njerëzit e mësuar, duhet ta vënë diturinë e tyre në shërbim të masave, jo me fjalë, jo vetëm me shkresa dhe me urdhëra, por në mënyrë të gjallë, në kontakte të vazhdueshme me masat e popullit.

Shpesh ne themi se në fshat ka prapambetje, ka fanatizëm, ka influencë të klerikëve antipopullorë. Drejt i bëjmë këto konstatime. Po si punojmë për t'i shëruar këto plagë? Me urdhëra dhe me dekrete këto nuk shërohen. Këto shërohen me një edukatë të shëndoshë politike dhe ideologjike, me një punë të pareshtur revolucionare, me anë konferencash, me propagandë individuale bindëse, kurdoherë bindëse dhe jo të godasë brutalisht ndjenjat e njerëzve që kanë mbi supe një të kaluar shekullore plot paragjykime.

Organizata e Frontit Demokratik e udhëhequr nga Partia, është ajo që duhet të ndihmojë shumë në edukimin politik të masave të gjera të popullit dhe sidomos

të fshatit. Por kjo organizatë shumë e vlefshme, nën-vleftësohet dhe konsiderohet formale. Këto pikëpamje janë shumë të gabuara. Fronti Demokratik duhet të gjallërohet, të bëhet i fuqishëm siç ka qenë në kohën e Luftës nacional-çlirimtare, të mobilizojë masat e gjera të popullit, t'i edukojë politikisht, të frymëzojë një patriotizëm të flaktë dhe dashuri të madhe ndaj atdheut, t'u sqarojë çdo problem, të ngjallë entuziazmin dhe besimin në forcën e Republikës sonë Popullore. Fronti duhet të konsiderohet si një aktiv i madh që e drejton Partia. Në fshat, punët nuk mund të drejtohen, në rast se Partia nuk krijon një aktiv të gjerë të fshatit rrëth saj dhe rrëth këshillit. A mund të drejtojë Partia në fshat pa krijuar një aktiv të shëndoshë fshatar? A mund t'i kryejë Partia detyrat e saja si duhet, në rast se nuk kujdeset veçanërisht për organizatën e rinisë, për forcimin e saj? A mund të drejtojë dhe t'i kryejë punët Partia pa u kujdesur veçanërisht për organizatën e gruas? Në asnjë mënyrë jo. Të lidhesh me masat do të thotë të lidhesh me masat e organizuara dhe në rast se këto organizata me rëndësi nënveftësohen nga Partia, atëhere s'je i lidhur me masat. Masën duhet ta sqarosh për çdo gjë, të marrësh aprovin e saj, ta lësh të të kritikojë gabimet, t'i presësh me këpaqësi këshillat e saja dhe të përfitosh nga ajo. Po ku ta gjesh zërin e masës në rast se braktisen këto organizata? Natyrisht, kjo nuk është rruga e drejtë, por e gabuar dhe duhet braktisur shpejt kjo rrugë. Duhet me luftue sektarizmin që shfaqet në lidhje me dhënjen e kártërave të Frontit, ku në shumë rrethe janë lënë jashtë njerëz që e meritojnë të janë në Front. Por është shkuan

edhe më tej. Ata që s'marrin kartën e Frontit, i cilësojnë armiq të popullit pa prova, pa fakte dhe shkojnë deri në atë pikë sa të mos u flitet as me gojë. Vepime të tilla s'janë në vijën e Partisë, po në kundërshtim. Ku veprohet kështu, çohet ujë në mullirin e armikut. Partia ka thënë se vetëm ata që me prova dhe me fakte, në të kaluarën dhe në të tashmen, janë kundër regjimit të demokracisë popullore, s'duhet të kenë vend në Front. Partia në rreth duhet ta kontrollojë mirë këtë çështje se në dhënjen e kartërave të Frontit ka padrejtësi, ka intriga të vogla, ka inate personale të maskuara që njerëzit e dobët i shfryjnë në rrugën e pushtetit dhe në vijën e Partisë. Vija e Partisë duhet të ruhet dhe të mbrohet.

Të mos harrojmë se Partia ka në fshat një forcë të madhe në organizatën e rinisë popullore, ka brezin e ri heroik të vendit tonë që ka bërë dhe bën mrekullira, që është pjesa më përparimtare në fshat dhe në qytet, që është burimi më i madh e i pashtetur i kuadrove të Partisë dhe të pushtetit. Ka raste që organizata e rinisë konsiderohet në disa fshatra si një organizatë e shkëputur nga Partia. Ka fshatra ku kemi të rinj, por s'kemi komunistë. Ka fshatra ku kemi dy komunistë dhe një numër të mirë të rinjsh. Por këta dy «qyqarë» komunistë, as që e shkojnë në mendje, të mblidhen së toku me rininë dhe të forcohet kështu udhëheqja në fshat, por ndjekin një rrugë sektare, rrugën e vetmisë. Disa rrethe nuk interesohen sa duhet për drejtimin dhe edukimin e rinisë në fshat, disa të tjera e konsiderojnë organizatën e rinisë burim që i jep pushtetit forca për kryerjen e aksioneve. Këto

s'janë pikëpamje të drejta. Organizata e rinisë është ajo që grumbullon forcën më të mirë të atdheut tonë, shtyllë e çelniktë e socializmit, pranvera e Shqipërisë. Prandaj si të tillë duhet ta konsiderojë Partia dhe t'i kushtojë kujdesin më të madh. Drejtuesit e rinisë duhet gjithashtu të përmirësojnë punën e tyre organizative dhe politiko-kulturale në organizatë. Duhet të shkunden nga burokratizmi, nga sektarizmi i dëmshëm dhe i theksuar që ka tendenca t'i zvogëlojë radhët e rinisë. Drejtuesit e rinisë duhet të mos braktisin shpirtin rino, të gëzuar, dinamik që karakterizon rininë tonë. Partia, duhet t'i vërë kujdesin më të madh edukimit të brezit të ri në qytet e në fshat, në fabrikë dhe në ara. Rinia e vendit tonë është si një vullkan i madh që shfryn nga të katër anët e vendit, një forcë e pamposhtur revolucionare që thyen çdo gjë të vjetër që gjen përrapa dhe ndërton të renë, të ardhshmen e saj të lumtur. Partia jonë pra, partia e së resë, e asaj që lind dhe zhvillohet, duhet t'i përgjigjet rinisë sonë heroike, t'ja përmbushë nevojat e saja, ta edukojë atë dhe ta udhëheqë.

Udhëheqja e Partisë dhe drejtuesit e rinisë, duhet të vënë forcat që organizata e rinisë të shtrihet në të gjithë vendin, në të gjitha fshatrat. Drejtuesit e rinisë duhet të kenë kujdes që t'i shpérndajnë kuadrot e saj më të mirë në çdo pikë, në mënyrë që të sigurohet si duhet udhëheqja e rinisë. Rinia duhet të ketë kujdes dhe të braktisë formën sektare të punës në fshat e kudo gjetkë, e cila konsiston në moskrijimin e një aktivi të gjerë rrëth vetes, të ruhet duke zbatuar formën e organizimit të Partisë në jetën e organizatës

së saj, pse organizimi i Partisë ndryshon nga ai i rinisë. Kjo metodë pune në rini ka shkaktuar sektarizmin dhe moskrijimin e aktivit të gjerë të rinisë, qoftë në qendra pune, qoftë në fshat. Dhe mbi të gjitha rinia duhet të edukohet dhe të arrijë të bëhet, si na mëson shoku Stalin, përques i politikës proletare në fshat. Mësimet që na jep Stalini në këtë drejtim, janë jo vetëm për rininë, por edhe për anëtarët e partisë. Duhet, si na mëson Stalini, që aktivi fshatar i rinisë, të furnizohet me broshura dhe manuale popullore që të sqarojnë dekretet e pushtetit në dobi të fshatarëve. Dhe rinia këto duhet t'i dijë përmendësh dhe të sqarojë fshatarësinë në çdo moment. Rinia në fshat duhet të bëhet roja e ligjshmërisë revolucionare, duhet të qëndrojë si një shkëmb graniti për mbrojtjen e fshatarësisë nga kulakët dhe nga të gjithë ata që kërkojnë të shkelin ligjet. Aktivi i rinisë në fshat duhet të lexojë broshurat mbi bazat elementare të agronomisë, të ekonomisë bujqësore, të mësojë metodat që e përmirësojnë këtë dhe këto t'ua mësojë fshatarëve. Fshatari, si thotë shoku Stalin, shpeshherë nuk e sheh komsomolin me një sy serioz, tallet me të, e konsideron si kalama etj. Për të zhdukur këtë duhet që të rinjtë të lidhen ngushtë me ekonominë, me prodhimin në fshat dhe t'i japin këshilla të dobishme fshatarit mbi agroteknikën etj. Të rinjtë në fshat duhet të lexojnë broshurat që flasin mbi ligjet, mbi tatimet bujqësore, mbi buxhetin lokal, mbi çështjet e ndërtimit të këshillave popullore, mbi pjesëmarrjen e fshatarësisë në çështjet e pushtetit, duhet të studjojnë broshurat mbi kooperativat bujqësore, statutin e kooperativave bujqësore, ato të shit-

blerjes, duhet të mësojnë broshurat që flasin për ndërtimin kultural në fshat, për zhvillimin e shtë-pive të leximit, për likuidimin e analfabetizmit etj. Duhet që rinia në fshat të studjojë broshura që flasin mbi aleancën e punëtorëve me fshatarësinë, mbi kuptimin dhe aleancën, rëndësinë e kësaj aleance etj. Siç shihet, këto detyra kaq të mëdha, që shoku Stailn i vë.përpara komsomolit dhe që unë i përmblodha shkurtimisht; janë kurdoherë në rendin e ditës, jo vetëm për rininë tonë, por duhet t'i zbatojnë edhe anëtarët e Partisë sonë. Kështu ne do të gjallërojmë jetën e fshatit tonë, ky do të përparojë, kooperativat tona bujqësore do të forcohen, do të ecin përpara dhe do të bëhen një shembull i shkëlqyer për t'u ndjekur në të ardhshmen e afërt nga e gjithë fshatarësia jonë punonjëse.

Detyrë nga më të rëndësishmet për Partinë është çështja e zbatimit me rigorozitet të direktivës që i kanë vënë Kongresi I dhe Plenumi X i Komitetit Qendror në lidhje me kooperativat bujqësore. Kooperativat bujqësore janë e ardhshmja e ndritur e socializmit të fshatit dhe, pra, të mos ngadalësohet propaganda për ngritjen e kooperativave bujqësore. Por në këtë çështje kaq të rëndësishme dhe delikate duhet të ecim me hapa të matur, nuk duhet të shpejtohem derisa të krijojmë konditat e domosdoshme ekonomike dhe politike për të ecur më përpara. Nuk duhet të lakmojmë shumë për shtimin e numrit të tyre se sa për cilësinë dhe forcimin e tyre, pse ka rrezik që, në konditat aktuale të dëmtohet çështja e këtij problemi kaq të madh. Partisë i vihet detyrë të luftojë për forcimin e

kooperativave ekzistuese që këto të përparojnë, të pasurohen dhe të bëhen shembull për të gjithë fshatarësinë individuale rrëth e rrotull tyre. Shumë kooperativa në vendin tonë kanë marrë një rrugë të mirë, janë forcuar dhe përmirësuar, por ka të tjera që numërojnë në vend dhe disa që nuk shkojnë mirë. Në kooperativat bujqësore duhet forcuar puna e organizimit, të luftohet për të kuptuar dhe për të zbatuar me përpikëri statutin, t'i vihet një kujdes i madh mbajtjes së llogarive, të zhvillohet puna me norma, të shtohet emulacioni socialist dhe pjesëmarrja e gjerë e gruas në prodhim. Duhet veçanërisht të edukohen në shkolla e kurse kuadro drejtues për kooperativat. Që të kemi suksese në këto drejtime të domosdoshme, duhet të forcojmë sidomos organizatat e Partisë në to, pse ato në disa raste kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të dobëta. Shembulli i organizatave të Partisë në rrethet e Fierit dhe të Lushnjës nuk është i kënaqshëm përsë i përket drejtimit të organizatave bazë në kooperativat bujqësore. Ndryshe është çështja në Korçë, ku drejtimi i Partisë në kooperativa ka qenë më i mirë dhe këto kanë përparuar, kanë pasur fitime dhe janë forcuar si ekonomikisht dhe politikisht.

Çështja e fundit ka lidhje me luftën e klasave. Lufta e klasave nuk është shuar dhe as që do të shuhet derisa do të ekzistojnë klasat në vendin tonë, deri në triumfin e plotë të socializmit. Është për këtë shkak që Lenini dhe Stalini na mësojnë se në këtë fazë ajo nuk shuhet, por vazhdon deri në zhdukjen e plotë të klasave.

Komiteti Qendror e ka shtruar vazhdimesht këtë problem, ka shpjeguar si duhet të zhvillohet lufta e klasave, ka treguar rreziqet dhe gabimet që mund të bëjnë shokët në zgjidhjen e këtij problemi. Por ka komunistë që e kuptojnë përciptas këtë çështje të rëndësishme dhe nuk e kanë kuptuar si duhet që problemi i luftës së klasës, përmban në vetëvete luftën ekonomike, luftën politike dhe luftën ideologjike dhe mbi këto tri fusha ajo duhet të zhvillohet njëkohësisht. Disa kënaqen duke e likuiduar kulakun dhe kujtojnë se mbaroi puna dhe s'ka nevojë më të zgjatesh. Këta as mendojnë se çështja nuk është aq e thjeshtë dhe kot nuk e ka shtruar Komiteti Qendror që kulakët në këtë fazë nuk duhet t'i likuidojmë. Duhet të kuptohet se të luftosh për bukën, për prodhime të bollshme, për transformimin socialist të bujqësisë dhe zhvillimin e blektorisë (luftë ekonomike), nuk mund të neglizhosh luftën për paqen, si dhe të mos mbrosh liritë e fituara, (luftë politike), të mos luftosh prapambetjen, paragjykimet borgjeze dhe idealiste (luftë ideologjike). Për të bërë një luftë politike, duhet të llogaritësh situatën ekonomike dhe korrentet ideologjike. Nga ana tjetër, për të bërë një luftë ideologjike, të drejtë dhe me sukses, duhet të llogaritësh situatën ekonomike dhe atë politike. Të gjitha këto të dhëna të një problemi, duhet të shtrohen dhe të zgjidhen njëkohësisht, që të zgjidhet vetë problemi i luftës së klasës. Kot nuk e ka thënë Komiteti Qendror që në këtë situatë duhet të kufizohet ekonomikisht kulaku dhe jo të likuidohet. Komiteti Qendror, i bazuar në mësimet e Stalinit, nuk e ka thënë kot që duhet treguar kujdes i madh, të mos

përzihet katundari i mesëm me kulakun. Ç'ngjet në realitet? Mjaft komunistë drejtues kanë gjetur rrugën më të shkurtër, por të gabuar, likuidimin total ekonomik të kulakut si dhe izolimin total politik të tij dhe kjo kuptohet «të mos i flasë njeri as me gojë kulakut». Përsa i përket luftës ideologjike, për atë pak vihet ujë në zjarr. Shumë herë sëpata e tyre ka goditur dhe katundarë të mesëm. Ka disa komunistë të tjerë që kalojnë nga ana tjetër. Ata e zbutin luftën kundër kulakëve dhe as kufizimin ekonomik nuk e bëjnë. Sa për luftën politike dhe ideologjike, kuptohet lehtë sa dobët e bëjnë këta njerëz. Një palë nuk u flet me gojë kulakëve, pala tjetër ha e pi me kulakët.

Por lufta e klasës, sikundër e kam theksuar edhe herë tjetër, s'mund dhe s'duhet të zhvillohet vetëm në fshat dhe kundër kulakëve dhe në asnjë mënyrë në këto forma të gabuara, sektare dhe oportuniste, siç përmenda më lart. Lufta e klasës duhet të zhvillohet e ashpër, e drejtë, e gjithanshme, në fshat dhe në qytet, në zyrë e në fabrikë, në kooperativë e në ndërmarrje, kundër kulakëve, kundër borgjezisë së madhe, kundër spekulatorëve, kusarëve, sabotatorëve, kundër pikëpamjeve mikroborgjeze që ekzistojnë në njerëzit dhe në komunistët vetë, qofshin këta edhe nga shtresa punëtore, kundër presionit të borgjezisë, kundër burokratizmit, kundër korrenteve ideologjike të huaja përne, kundër korrenteve idealistë, mistike, fetare, fashiste, imperialiste, kundër injorancës, prapambetjes në çdofushë, kundër sektarizmit, oportinizmit, egoizmit, pendantizmit, individualizmit. Lufta e klasës duhet të kuptohet dhe të zhvillohet, si thashë edhe më lari, në

të tri të dhënat e këtij problemi, luftë ekonomike, luftë politike, luftë ideologjike. Duhet të zhvillohet lufta në të tria këto fusha njëkohësisht që të mund të zgjidhet me sukses problemi i rëndësishëm i luftës së klasës. Dhe që të zgjidhet ky problem drejt si dhe gjithë problemet e tjera jetike që i shtrohen Partisë dhe popullit, duhet në radhë të parë komunistët, pa asnje përjashtim, të pajisen me armën e marksizëm-lenismit dhe ta lidhin këtë ngushtësisht me praktikën.

Këto janë në përgjithësi detyrat që i dalin përpara Partisë në lidhje me forcimin e punës së saj dhe, në përgjithësi, të punës me fshatin. Partia jonë do t'i kryejë me nder këto detyra dhe do të korrë rezultate në këtë drejtim. Kjo do të sjellë si rezultat realizimin me sukses të planit pesëvjeçar të ekonomisë sonë kombëtare.

VI

TE FORCOJMË DHE TE DEMOKRATIZOJMË PUSHTETIN POPULLOR

Detyrë e madhe e Partisë dhe e masave punonjëse është të gjallërojnë, të forcojnë, ta bëjnë sa më tepër revolucionar dhe demokratik pushtetin popullor. Push-teti i këshillave është krejtësisht i ri, i dalë nga Lufta nacional-çlirimtare, i krijuar me luftë kundër pushtetit të vjetër të borgjezisë. Këtë fitore të madhe ja dety-rojmë Partisë sonë dhe Bashkimit Sovjetik që na dha dhe formën dhe eksperiencën e tij të ndërtimit të pushtetit popullor. Partia i ka ndjekur me kujdes mësimet e Leninit e të Stalinit, qoftë në anën teorike, qoftë në zbatimin praktik të formave të pushtetit popu-llor. Pushteti popullor në vendin tonë ka shkuar në rrugën e forcimit dhe masat e kanë ndjerë dhe e kanë kuptuar që ai është i tyre, është afër tyre. Këtë e kanë treguar çdo herë votimet e ndryshme që janë zhvilluar në vendin tonë për Kuvendin Popullor dhe për këshillat popullore, rezultatet e të cilave nuk kanë qenë kurrrë më pak se 97 për qind e votave për Frontin. Ndarja e re administrative në rrethe, lokalitete dhe këshilla fshatash ka qenë një masë e rëndësishme për

forcimin e pushtetit, për afrimin dhe lidhjen e tij sa më ngushtë me masat e gjera punonjëse.

Të gjitha këto janë anë pozitive të fituara dhe baza të shëndosha që na lejojnë të ecim përpara. Po kjo situatë nuk mund të jetë e mjaftueshme dhe mund të keqësohet në rast se Partia nuk i drejton forcat e veta për konsolidimin e pushtetit, për demokratizimin e tij të mëtejshëm duke luftuar me ashpërsinë më të madhe elementët e burokratizmit dhe tendencat e vjetra reaksionare në kuptimin e pushtetit dhe në zbatimin në praktikë të metodës së punës. Një rrezik i tillë nuk është aspak për t'u neglizhuar. Vetëm pjesë-marrja e gjerë e masave punonjëse, në mënyrë aktive, në të gjithë hierarkinë e pushtetit, lufta e drejtë për zbatimin e Statutit Themeltar të Republikës dhe të ligjeve të shtetit janë mjetet që mposhtin rreziqet që mund të dobësojnë dhe të shkatërrojnë pushtetin popullor. Kjo gjë duket e lehtë në të kuptuar, por zbatimi në praktikë nuk është një punë aq e lehtë.

Ka disa komunistë që nuk e kuptojnë si duhet ku konsiston esenca demokratike dhe popullore e pushtetit tonë. Këta mendojnë se kjo demokraci konsiston vetëm në mënyrën e zgjedhjeve që zhvillohen në bazë të ligjeve të Kuvendit Popullor. Ata kujtojnë se këto zgjedhje dhe këto votime mjaftojnë për të treguar popullaritetin e pushtetit tonë. Këta komunistë gabojnë jo pse vënë në dukje lidhjet e ngushta të popullit me Partinë dhe me pushtetin, pse ky është një realitet i padiskuteshëm, por se suksesi në votime nuk mjafton dhe nuk duhet të na rritet mendja se gjithshka ka mbaruar për këtë punë, se pushteti ka arritur përsos-

mërinë dhe është bërë sa më demokratik dhe popullor. Jo, ne kemi akoma shumë për të bërë në këtë drejtim.

S'ka dyshim se Partia preokupohet shumë për çështjen e pushtetit, për funksionimin e tij në mënyrë sa më të përsosur. Partia i mëson anëtarët e saj dhe gjithë popullin të zgjedhin në pushtët njerëzit më të mirë, më aktivë dhe më besnikë të kauzës së popullit. U rekomandon veçanërisht të respektohen në mënyrë absolute liria e fjalës, e kritikës në zgjedhjet. Në këtë drejtim ka disa komunistë që e shtrembërojnë vijën e Partisë. Këta gabojnë rëndë dhe duhen ndëshkuar rëndë. Ka ngjarë që listat e kandidatëve që propozohen për t'u zgjedhur në pushtet nuk diskutohen gjallërisht nga zgjedhësit dhe ka qëlluar disa herë që disa komunistë drejtues, kanë imponuar njerëz jo të dëshirueshëm nga masa. Provat në jetë kanë treguar se në këto raste populli ka pasur të drejtë dhe ata komunistë që kanë guxuar të bëjnë një vepër të tillë të shëmtuar s'kanë qenë të mirë; ata kanë mbështetur njerëz të dobët, me vese të këqia dhe me një të kaluar të keqe. Të tilla qëndrime të dënueshme nga Statuti dhe nga ligjet kanë bërë që të vijnë disa herë në këshillat popullore si dhe në gjykatat njerëz të padëshirueshëm. Më lejoni të përmend vetëm shembullin e fshatit Tërbaç. Disa drejtues të Partisë në Vlorë propozuan si ndihmësgjyqtar në këtë fshat një person jo të mirë, zgjedhësit e Tërbaçit nuk e pranuan. Këta komunistë vazhduan përsëri t'ua impononin me zor. Fshati i Tërbaçit me plot të drejtë e refuzoi. Këta komunistë përsëri insistuan, atëherë zgjedhësit nuk deshën të votonin dhe ngjau gjëja më e shëmtuar që këtë gjykatës më në fund ua im-

ponuan. Shumica e zgjedhësvé abstenuan. Por çka është akoma më e dënueshme, drejtuesit e Partisë dhe organet shtetërore e fshehën këtë veprim për gati një vit e gjysmë. S'ka dyshim se ai që veproi në këtë mënyrë s'e kishte vendin në Parti as në funksione shtetërore, por në burg ku edhe shkoi. Të tilla veprime të dënueshme nga ligjet dhe nga Partia janë vepra armiqësore që kanë për qëllim të vetëm të diskreditojnë Partinë në sytë e masave dhe të krijojnë në popull mendimin se «ligjet dhe direktivat e Partisë për zgjedhje të lira s'janë veçse demagogji». Qëllimi tjetër është të sjellin në pushtet njerëz antipopullorë dhe armiq për të sabotuar nga brenda, për të sjellë krimbin e sabotimit dhe të burokratizmit në gjirin e pushtetit popullor. Natyrisht, ku vijnë këta njerëz pushteti dobësohet, s'ja mbaron punën popullit, nuk ja zgjidh problemet dhe s'ja shëron plagët.

Disa herë ka njerëz që shkelin ligjet e shtetit duke emëruar dhe shkarkuar njerëz të zgjedhur në këshillat, që nga lart, në vend që të veprojnë në bazë të Kushtetutës së Republikës dhe ligjit të këshillave; kjo duhet të bëhet nga vetë këshillat popullore dhe nga zgjedhësit. Këto veprime të dënueshme, jo vetëm që nuk ndihmojnë për ta bërë pushtetin sa më popullore dhe demokratik, por krijojnë gjithashtu në njerëzit e këshillave një pikëpamje të gabuar në çështjen e drejtimit dhe i bën këta të mendojnë se janë përgjegjës, jo më përpara popullit që i ka zgjedhur dhe që duhet t'i japid llogari, por përpara aparatit shtetëror. Vetëvetiu shkohet pastaj në rrugën që, me të mbaruar zgjedhjet, mbaron dhe përgjegjësia ndaj zgjedhësve. Llogari

i jepet vetëm aparatit. Krijohet pikëpamja «ta kemi mirë me njerëzit e Partisë, ta kemi mirë me kryetarin e komitetit ekzekutiv» dhe sa për përgjegjësinë ndaj zgjedhësve ajo harrohet. Ky është shtrembërim flagrant i kuptimit të vijës së drejtë të pushtetit popullor dhe të demokracisë. Ka mjaft raste që këshilltarët shkarkohen si pa gjë të keqe nga lart pa e shtruar çështjen për diskutim dhe vendim në këshillin popullor, u hiqet imuniteti nga lart si pa gjë të keqe, «për arësy se s'kanë dhënë shembull personal në kryerjen e asaj ose të kësaj pune». Kështu ndodh që ish-kryetari i lokalitetit të Ishmit, bënte aq poshtërsi në kurriz të fshatarëve saqë këshilli i lokalitetit s'guxonte të merrte masa, po priste të vinin urdhërat nga lart, nga Komiteti ekzekutiv i rrethit të Durrësit, të cilin e kishte zënë gjumi i rëndë tok me komitetin e Partisë të rrethit.

Të gjitha të metat e mësipërme, të cilat duhet të luftohen dhe të zhduken nuk mund të shërbejnë për forcimin dhe demokratizimin e pushtetit tonë popullor.

Të kalojmë tash më tej. Pasi zgjidhen këshillat dhe anëtarët e këshillave, si veprohet dhe si konsiderohen këto këshilla? Unë mund të them se në ato rrëthe ku Partia dhe udhëheqja e kanë kuptuar drejt çështjen e centralizmit demokratik, të demokracisë së brendshme të Partisë dhe rolin drejtues të Partisë, atje është kuptuar mirë dhe çështja e pushtetit. Pa dyshim ka mjaft gabime dhe të meta, po puna shkon më mirë në Tiranë, Peshkopi, Korçë, Gjirokastër etj. rasti nuk është njëloj për Shkodrën, Fierin, Elbasanin etj.

Në përgjithësi ngjet kjo: pasi këshilli popullor zgjedh komitetin ekzekutiv, roli drejtues i këshillit

harrohet, këshilli bëhet në praktikë formal dhe komiteti ekzekutiv, i plotfuqishëm. Komiteti ekzekutiv shikon vetëm nga kryeqyteti dhe ta ketë mirë me qeverinë e me komitetin e Partisë të rrethit dhe e harron këshillin popullor nga gjiri i të cilit ka dalë dhe që duhet të japë llogari. Njerëzit e komitetit ekzekutiv e konfondojnë veten e tyre me aparatin administrativ që varet nga pushteti qendror, por që edhe ky është nën kontrollin e vazhdueshëm të masave punonjëse.

Derisa nuk kuptohet si duhet se pushteti buron nga populli dhe i përket popullit dhe ky parim themelor të zbatohet si duhet në jetë, nëpërmjet formave të ndryshme, ne do të bëjmë gabime. Esenca demokratike e pushtetit tonë mbetet në letër, pushteti transformohet në një trup të vdekur, ku mbizotëron burokratizmi brenda në format e përparuara që janë të destinuara të fishken. Ç'i mbetet pushtetit tonë popullor në rast se ai nuk bëhet i masave, në rast se këto nuk marrin pjesë gjallërisht në të, në rast se nuk e kanë nën kontrollin e tyre të vazhdueshëm, në rast se masat punonjëse nuk drejtojnë fatet e tyre nëpërmjet këshillave popullore, komisioneve, komiteteve, organeve administrative, ekonomike, institucioneve kulturale, bashkimeve profesionale, organeve të Frontit, të rinisë, të gruas, të bashkimeve të kooperativave të shitblerjes etj.? Natyrisht nuk i mbeten përveçse format, të cilat do të shkojnë duke u degjeneruar në forma burokratike dhe kështu do të ndërrohet vetëvetiu dhe esenca e pushteti popullor. Të kemi vazhdimisht parasysh dhe të udhëhiqemi nga mësimet e shokut Stalin i cili na mëson:

«Nga se ndryshon aparati shtetëror sovjetik prej aparatit shtetëror borgjez?

Para së gjithash, nga fakti se aparati shtetëror borgjez qëndron përmbi masat, arësyse për të cilën ai është i veçuar nga popullsia me një barrierë të pakapërcyeshme, dhe, nga vetë fryma e tij, është i huaj për masat e popullit. Kurse aparati shtetëror sovjetik shkrihet me masat, sepse ai nuk mund të qëndrojë dhe nuk duhet të qëndrojë përmbi masat, në qoftë se ai do që të mbetet pikërisht si aparat shtetëror sovjetik, sepse ai nuk mund të jetë i huaj për këto masa, në qoftë se me të vërtetë do që të përfshijë në gjirin e tij masat milionëshe të punonjësve. Ky është një nga dallimet parimore të aparatit shtetëror sovjetik prej aparatit shtetëror borgjez»¹.

Nuk janë, pra, format që na mungojnë, por këto forma duhet t'i gjallërojmë. Drejtuesit e Partisë dhe lë pushtetit duhet të kuptojnë mirë rolin e rëndësishëm të këshillave popullore dhe duhet të luftojnë rreptësisht të gjithë ata që pengojnë aktivitetin e vërtetë të tyre. Këshillat duhet të aktivizohen, të marrin të gjitha kompetencat dhe të drejtat. Komunistët në radhë të parë duhet t'i aktivizojnë këshillat dhe të ruajnë me vigjilencë kompetencat e tyre, të mbrojnë ligjet dhe të drejtat e këshillave dhe të këshilltarëve kundër çdo shkelësi dhe abuzuesi.

Këto janë përsëritur vazhdimisht nga Komiteti

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 7, f. 162

Qendror, por për fat të keq ka akoma disa komitete të Partisë dhe komitete ekzekutive rrëtresh, ka akoma disa komunistë që kënaqen me deklarata, por në praktikë vazhdojnë të bëjnë gabime. Këta nuk bëjnë përpjekjet e duhura të aktivizojnë këshillat popullore, komisionet e tyre, deputetët e Kuvendit Popullor dhe anëtarët e këshillave. Për disa komunistë deputeti i popullit, qoftë ai i Kuvendit Popullor, qoftë i këshillit popullor, ka më tepër vlerë formale. Në rast se deputeti është anëtar i Komitetit Qendror ose ministër atëhere ndryshon puna. Për të ka sjellje të mira, fjalë të bukura, oportunizëm sa të duash, për të tjerët mbyllët dera dhe vrënjen fytyrat. Sjellje të tilla ndaj përfaqësuesve të popullit janë të dënueshme dhe antimarksiste. Kjo lë të kuptosh gjithashtu se nuk është kuptuar esenca e pushtetit tonë popullor. Deputeti dhe anëtarë i këshillit popullor janë njerëz të nderuar, njerëz nga më të mirët dhe kanë shumë të drejta dhe kompetenca që ua ka ngarkuar populli. Kush nënveftëson përfaqësuesit e popullit dhe funksionet e tij, ai jo që s'mund ta quajë veten e tij marksist, por është një burokrat i pandreqshëm. Deputetët dhe anëtarët e këshillave popullore kanë të drejtë të kërkojnë llogari, qoftë në forume ku bëjnë pjesë, qoftë jashtë këtyre forumeve gjatë periudhave që ndajnë dy sesionet. Këta duhet të kontrollojnë në jetë zbatimin e ligjeve dhe të vendimeve që merren. Ata duhet të mbajnë kontakt me zgjedhësit e tyre, duhet të ndërhynë, të këshillojnë, të kontrollojnë, të kërkojnë të zbatohen ligjet dhe vendimet dhe për ta jo vetëm portat duhet të jenë të hapëta, por që nga Kryeministri dhe deri te kryetari i këshillit të fshatit, duhet t'u përgji-

gjen menjëherë kërkesave të deputetëve dhc të anëtarëve të këshillave popullore.

Dhe vetë deputetët dhe anëtarët e këshillave popullore duhet të bëhen të ndërgjegjshëm për funksionet dhe detyrat e larta që u ka besuar populli. Çdo nën-shtetasi të Republikës, me funksione ose pa funksione zyrtare, me anën e ligjit i janë siguruar të drejtat, por njëkohësisht ka edhe detyra. Me përfaqësue popullin është nderi më i lartë, por me votën e tij populli nuk të jep vetëm një titull nderi, po të ngarkon edhe me detyra me përgjegjësi. Nuk mund të pranojë populli që përfaqësuesi i tij të mos vizitojë zgjedhësit, të mos bisedojë me ta, të mos marrë prej tyre këshilla, të mos dëgjojë ankesat e tyre dhe të mos ndërhyjë kur shkëlet ligji. Një qëndrim të tillë indiferent nuk duhet dhe nuk e lejon populli. Në rast se ka njerëz që pengojnë aktivitetin e deputetit ose të këshilltarit në funksionet e tij që i ka ngarkuar populli, Kushtetuta e Republikës, ligjet e shtetit, Partia e Punës, janë kurdoherë me deputetin dhe këshilltarin për të goditur të gjithë ata, cilëtdo qofshin pa përjashtim, që shkelin ligjin dhe vijën e Partisë.

Përveç kësaj, në çështjen e marrëdhënjeve të Partisë me pushtetin vërehet një dobësi që duhet zhdukur sa më parë: nënvleftësohet roli i pushtetit dhe monopolizohet ky rol nga aparatet e Partisë. Kjo çështje duhet kuptuar drejtë. Partia iudhëheq gjithë jetën, pra dhe pushtetin. Ajo këshillon, ndihmon, kontrollon, kurse pushteti drejton drejtpërdrejt çështjet ekonomike etj. Partia nuk duhet që të konfondojë rolin e saj iudhëheqës me detyrat që i ngarkohen pushtetit. Duke i konfonduar kë-

to role disa komunistë arrijnë në konkluzione të gabuara duke e lënë mënjanë pushtetin, duke mos e aktivizuar dhe shumë herë edhe duke e paralizuar. Ka komunistë dhe komitete që mendojnë se vetëm me anëtarët e Partisë do t'i zgjidhin të gjitha punët dhe këtej lind mosbesimi ndaj elementit të ndershëm patriot dhe me eksperiencë. Këtej disa herë lind ideja e gabuar që njerëzit e pushtetit, qofshin këta komunistë ose jo, janë më pak të zot se ata që punojnë në aparatet e Partisë. Kjo është një tendencë e parë jo në forma të hapëta, por që vërehet disa herë në praktikë të punës dhe të çon në likuidimin e pushtetit. Kështu nënvleftësohet pushteti dhe komiteti i Partisë e monopolizon punën e pushtetit, merr kompetencat e tija duke menduar se ai do t'i zgjidhë çështjet më mirë. Në fakt ai ngarkohet me punë që nuk i përkasin dhe s'bën mirë as njérën as tjetrën. Nga ana e tyre komitetet ekzekutive u shmangen detyrave, u pritet iniciativa, heqin nga vetja e tyre përgjegjësinë. Disa komitete partie janë shndërruar në komitete të pushtetit, ato dhe aparatet e tyre interesohen më shumë për problemet ekonomike deri në detajen më të vogël. Ato ushtrojnë një kontroll të atillë saqë konfondohen me funksionet e kontrollit të shtetit. Ky monopolizim i punëve të pushtetit vërehet sidomos në çështjet ekonomike siç është shembulli i Fierit. Ndërsa byroja e komitetit të Partisë e merr në studim problemin e grumbullimeve 7-8 herë, komiteti ekzekutiv vepron sikur s'ka të bëjë aspak me këtë problem të rëndësishëm. Komiteti i Partisë i rrëthit të Korçës, gjatë vitit 1951, analizon 27 probleme ekonomike, ndërsa komiteti ekzekutiv vetëm 3 probleme.

Duke spostuar rolin e pushtetit dhe monopolizimin e punëve të tij, kjo natyrisht e çon komitetin e Partisë në rrugën e natyrshme të mos e analizojë vetë asnjëherë problemin e pushtetit, të forcimit, të demokratizimit të tij. I tillë është rasti i Shkodrës, i Durrësit, i Përmetit. Përse ta analizojnë, kurse këta e konsiderojnë pushtetin si një apendiks?

Në rast se çështjet që u shtruan më lart nuk kuptohen dhe nuk zbatohen drejt, atëhere pushteti ynë nuk mund të forcohet dhe të demokratizohet, pse nga moskuptimi i drejtë i këtyre çështjeve themelore, rrjedhin pastaj gabime të tjera. Ata drejtues që nuk i kanë të qarta këto, natyrisht nuk i kanë të qarta detyrat e tyre ndaj popullit, nuk pranojnë kontrollin e masave, nuk mësojnë nga masat. Ka disa njerëz që nuk sillen mirë me popullin dhe krijojnë në aparatet e pushtetit një frymë të sëmurë dhe burokratike. Në disa rrethe populli nuk pritet mirë në zyra, lutjet e tija nuk gjejnë zgjidhje të drejtë dhe të shpejtë. Dëgjohet në popull të thuhet në lidhje me këto gjëra: «Ujët del i pastër nga burimi, po turbullohet poshtë». Populli është realist, populli tregon se sa besim ka te Partia, por edhe e paralajmëron atë të marrë masa kundrejt atyre që e shtrembërojnë vijën e drejtë të saj. Kjo shtrembërohet nga njerëz të pandërgjegjshëm dhe të dobët, të cilët bëjnë padrejtësi flagrante, vjedhin, shkatërrojnë pasurinë e shtetit dhe të popullit dhe i shpëtojnë syrit vigjilent të Partisë dhe të organeve të kontrollit të shtetit. Këta, natyrisht, zbulohen dhe goditen, por në rast se udhëheqja do të vërrë të gjitha forcat që çdo gjë ta mbështetë në popull, çdo gjë ta bëjë me popullin, shumë prej këtyre padrejtësive

dhe të metave do të evitohen me kohë. Armiku maskohet. Një parti vigjilente që forcon lidhjet me masat, që i mbështet veprimet e saj në masat, që s'ka frikë t'i njo-hë gabimet e saj, që e lejon popullin të flasë lirisht, të kritikojë gabimet, ajo parti kurrë nuk humbet, ajo ecën përpara, bolshevizohet dhe armiqtë e sabotatorët s'mund të jetojnë gjatë nën maskat e tyre të shumë-llojta. Ka komunistë që, kur dalin përpara popullit, ja presin hovin kritikës që u bëhet njerëzve që s'punojnë mirë dhe këtë e arësyetojnë se gjoja kritikohet Partia. Por le të kritikohet Partia kur s'ka punuar mirë, kritika do t'i shërbejë të forcohet dhe të mos gabojë më. Por më të shumtat e herës nuk është Partia që kritikohet, por janë disa njerëz të Partisë që punojnë shtrembër dhe këta njerëz për të fshehur të palarat e tyre mybyn kritikën, gjoja se mos dëmtohet Partia. Kjo është djallëzore dhe duhet ta godasim rëndë.

Kam parasysh disa raporte ku thuhet se «Partia s'i përdor si duhet levat e saja, si organizatën e gruas ose atë të rinisë» etj. Por a është e drejtë kjo thënje? Le ta shohim ca këtë çështje. Këto organizata masash luajnë një rol të madh në lidhje me forcimin dhe demokratizimin e pushtetit, në lidhje me ndërtimin e bazave të socializmit, në lidhje me edukimin e brezit të ri dhe të masave punonjëse me fryshtë e re. Këto organizata nën drejtimin e Partisë, kanë bërë heroizma dhe mrekulli. Të mëdha dhe heroike janë veprat e klasës punëtore, të rinisë, të gruas, të grumbulluara në organizatat e veta. I madh është roli i Frontit Demokratik që nën udhëheqjen e Partisë edukon masat me fryshtë e lartë patriotike. Por ka komunistë që s'kanë besim aq sa

duhet në këto organizata dhe e nënveftësojnë rolin e tyre. Ata mendojnë në mënyrë sektare se çdo gjë do ta bëjnë vetëm komunistët dhe se puna burokratike e zyrës është çdo gjë. Këta burokratë të mbushin me raporte false dhe ta fshehin ku qëndron c'keqja dhe e keqja qëndron te ata dhe jo te Partia, se Partia e ka kuptuar me kohë rolin e madh të këtyre organizatave dhe kujdesi i saj ndaj tyre është i jashtëzakonshëm.

Ç'faj ka Partia kur ajo punon ditë e natë dhe mobilizon me qindra gra në Tiranë, gra të popullit, patriote, që me thirrjen e Partisë ecin pesë orë në këmbë për të hapur gropa dhe për të pyllëzuar vendin dhe kur venë në vend s'gjejnë as kazma as lopata? Ku janë kazmat dhe lopatat pyetet shoqja përgjegjëse për këtë punë? Asaj s'i bëhet vonë dhe me lehtësi përgjigjet, i telefonova këtij, i telefonova atij e të tjera përralla. E keqja u bë. Gratë patriote të Tiranës u kthyen të lodhura, pa bërë asnjë punë, kurse shoqja përgjegjëse e gruas s'i ngjeshi këpucët me baltë.

Një grua tiranase, pa parti, mëmë dëshmori dhe aktiviste e shquar, më qahej një ditë për disa shokë dhe shoqe partie që nuk interesohen aspak për organizatat e masave. «Bëhen disa padrejtësi, shoku Enver, — më thoshte kjo grua — shkelen disa të drejta të njerëzve si pa të keq. Jam deputete e mëhallës, jam prokurore dhe gjej nganjëherë vështirësi në kryerjen e detyrës. Ndërhyj ku duhet që të merren masa dhe të ndreqet puna. Vete në shoqet dhe në shokët më lart dhe më përgjigjen: «Po, po, si urdhëron, do ta shohim, do ta shqyrtojmë» dhe me të kthyer krahët,

i futin letrat në dosje dhe i zë gjumi. Jo, shoku Enver — më thoshte kjo grua — më janë vrarë djemtë e mi për këtë popull, për këtë pushtet, janë vrarë me mijëra djem të nënave për Partinë, ne nuk duhet t'i lejojmë në asnjë mënyrë këta njerëz të pandërgjegjshëm të vazhdojnë kështu». Po vazhdoj me fjalët e nënës patriote: «Mbledh gratë dhe burrat për konferencë për t'u.sqaruar shumë probleme, qdo gjë e bëj gati. Kërkoj andej-këtej ndonjë shok o shoqe, shumë më të ngritur se unë dhe i lut të vijnë të flasin të paktën dhjetë minuta. Kemi punë në zyrë, më përgjigjen dhe unë detyrohem të shpërndaj popullin». Të tillë komunistë duhen kritikuar ashpër dhe duhen marrë masa kundër të pandërgjegjshmëve. Të tillë komunistë, që s'marrin mundimin të kryejnë këto detyra të rëndësishme të Partisë, janë gati të ngrihen në organizatën bazë dhe të flasin me orë se për shembull «shitëset e dyqaneve nuk sillen mirë me popullin, nuk shërbejnë pastër, s'kanë disiplinë etj.». Po pastaj, t'i pyesësh, ç'duhet të bëjmë? Përgjigjen e kanë në majë të gjuhës: të merren masa, dhe jo të thonë se duhen edukuar më parë se të shkojnë në masat. Dhe komunistit i bie detyra në radhë të parë të bëhet edukator i masave, të japë shembullin dhe të vejë të mësojë njerëzit. Por a mund të forcohet pushteti ynë dhe të demokratizohet në rast se njerëzit e Partisë nuk i aktivizojnë organizatat e masave dhe atje t'i edukojnë masat e t'i ngrenë detyrat në shkallën politike? Jo. Nuk mundet. Partia duhet të zbatojë në jetë mësimet e Stalinit dhe eksperiencën e Sovjetëve në forcimin e pushtetit popullor. Ja ç'na thotë Stalini:

«Shokët tanë nganjëherë nuk e shohin se rrëth organizatave tona bazë të partisë, të Sovjetëve, organizatave kulturale, profesionale, arësimore, të komsomolit, të ushtrisë, të grave dhe gjithë organizatave të tjera të ndryshme, janë grumbulluar si mizat e dheut gjithfarë organizatash, komisionesh dhe mbledhjesh të iniciativës së masave, të cilat përfshijnë masat milionëshe të punëtorëve dhe të fshatarëve pa parti dhe që me punën e tyre të përditshme, të kujdeshme dhe pa bujë, krijojnë bazën dhe jetën e Sovjetëve, burimin e fuqisë së Shtetit Sovjetik. Pa këto organizata milionëshe, që rrëthojnë organet tona sovjetike dhe të partisë, ekzistenca dhe zhvillimi i Pushtetit Sovjetik, udhëheqja dhe qeverisja e këtij vendi të madh do të ishte krejt e pamundur. Aparati shtetëror sovjetik nuk përbëhet vetëm nga Sovjetët. Aparati shtetëror sovjetik, në kuptimin e thellë të kësaj fjale, përbëhet nga Sovjetët plus organizatat milionëshe të të gjitha bashkimeve të ndryshme pa parti e të partisë, që lidhin Sovjetët me «fundërinat» më të thella, që shkrijnë aparatin shtetëror me masat milionëshe dhe asgjësojnë hap pas hapi çdo lloj barriere midis aparatit shtetëror dhe popullsisë.

Ja se si ne duhet të përpiqemi ta «dhjetëfishojmë» aparatin tonë shtetëror, duke e bërë atë të afërt dhe të dashur për masat milionëshe të punonjësve, duke shporrur prej tij mbeturinat e burokratizmit, duke e shkrirë atë me masat

dhe duke pregatitur kështu kalimin prej shoqërisë me diktaturën e proletariatit në shoqërinë komuniste»¹.

Partia duhet të luftojë pareshtur që t'i mësojë njerrëzit të udhëhiqen kurdoherë nga interesat e popullit dhe të pushtetit, të jenë të drejtë, të shërbyeshëm, të thjeshtë, të dashur me popullin dhe t'u thyejnë brinjët pa mëshirë dhe pa nishan armiqve të popullit, sabotatorëve, konspiratorëve, kusarëve etj. Partia duhet të ngrejë lart dhe t'i shtyjë përpara kuadrot e rinj, të godasë pa hezitim dembelët dhe burokratët.

Partisë i bie barra të ngrejë klasën punëtore në shpirtin luftarak të pushtetit dhe populli të ndjejë nevojën urgjente të forcimit të pushtetit për mirëqenjen e tij dhe për zhdukjen e mbeturinave të klasave shfrytëzuese dhe për ndërtimin me sukses të bazave të socializmit.

Në qoftë se duam me të vërtetë të ndërtojmë bazat e socializmit, duhet me të gjitha forcat të forcjmë e të demokratizojmë pushtetin tonë popullor.

Idetë socialiste mbi shtetin nuk mundet të rrënjosn në njerëzit vetëm me anën e agjizacionit, por, sidomos, me punën praktike. Mjeti më i sigurtë për të forcuar ndërgjegjen e njerëzve është zbatimi i përpiktë i ligjeve dhe i vendimeve në të gjitha fushat e jetës. Kryesorja në punën organizative është zgjedhja e njerëzve dhe kontrolli i zbatimit të vendimeve.

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 7, f. 163-164.

Shoku Stalin na mëson:

«Të drejtosh mirë, do të thotë:

së pari, të gjesh zgjidhjen e drejtë të çësh-tjes, dhe zgjidhjen e drejtë nuk mund ta gjesh pa u mbështetur në eksperiencën e masave, të cilat i provojnë mbi shpinën e vet rezultatet e drejtimit tonë;

së dyti, të organizosh zbatimin e zgjidhjes së drejtë, gjë që përsëri nuk mund të bëhet pa ndihmën e drejtëpërdrejtë të masave;

së treti, të organizosh kontrollin e zbatimit të kësaj zgjidhjeje të drejtë, gjë që përsëri nuk mund të bëhet pa ndihmën e drejtëpërdrejtë të masave»¹.

Nga ana tjeter pa njohjen e thellë të ligjeve, pa u mbështetur dhe pa u drejtar nga këto ligje, nuk mund të ecet në rrugën e forcimit të drejtësisë socialiste dhe nuk mund të forcojmë pushtetin tonë popullor. Të njohësh masat me ligjet e pushtetit dhe të jesh rigoroz në zbatimin e drejtë të tyre, është mjet i rëndësishëm të térheqësh për vete masat e gjera të popullit dhe t'i lidhësh këto ngushtë me pushtetin popullor. Patjetër nuk mund të flitet për respektim ligjesh në ato organizata shtetërore, kooperativiste dhe ekonomike, ku shkelet disiplina shtetërore, ku ka shthurje në realizimin e planeve ekonomike dhe në ruajtjen e pasurisë së shtetit. Partia të jetë e pamëshirshme ndaj këtyre

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 133.

shfaqjeve të këqia, të spastrojë me energji aparatet shtetërore nga këta njerëz që thyen disiplinën, shkelin ligjet dhe abuzojnë. Vjedhësi duhet të konsiderohet si spiuni më i rrezikshëm, se ai është aq i gatshëm sa dhe spiuni të shitet te i huaji. Një rëndësi të jashtzakonshme Partia duhet t'i vërë kontrollit të shtetit dhe ai të bëhet një armë e fuqishme në duart e pushtetit popullor. Të bëhet një vegël për përmirësimin e aparatit tonë, një institucion me të vërtetë shëmbullor — thotë Lenini. Për këtë duhet që elementët më të mirë që ekzistojnë në rendin tonë shoqëror dhe pikërisht:

«...punëtorët e përparuar, së pari, dhe së dyti, elementët me të vërtetë të mësuar, për të cilët mund të jemi të sigurtë se ata nuk do të besojnë asgjë vetëm në bazë të fjalëve dhe se nuk do të thonë asnjë fjalë në kundërshtim me ndërgjegjen e tyre, — të mos kenë frikë të pranojnë çdo lloj vështirësie dhe të mos kenë frikë nga asnjë lufte për të arritur qëllimin, që ata do t'ja shtrojnë vetes seriozisht»¹.

«Punëtorët që ne caktojmë si anëtarë të Komisionit Qendror të Kontrollit duhet të janë komunistë të përsosur dhe mendoj se me ta duhet të bëjmë një punë akoma të gjatë për t'u mësuar atyre metodat dhe detyrat e punës së tyre»².

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 33, f. 551.

² Po aty, f. 553.

Një rëndësi të madhe, një kujdes të veçantë, një kontroll të imtë dhe rigoroz duhet t'i kushtojë Partia edukimit ideo-politik dhe profesional të kuadrove të pushtetit. Detyra jonë është të ngremë kuadro të rinj, besnikë për Partinë, për pushtetin dhe çështjen e popullit, kuadro të gjallë, dinamikë, të ndershëm dhe që e duan punën. Kurset, shkollat e ndryshme politike dhe profesionale jo vetëm që duhet të funksionojnë në rregull, por duhen zgjeruar dhe shtuar. Niveli kultural i kuadrove tanë është mjaft i ulët dhe s'u përgjigjet nevojave të mëdha të kohës. Duhet të kemi parasysh se s'janë më kohët e luftës partizane dhe periudhat e para të që kur çështjet zgjidheshin në mënyrë ushtarake. Tash është periudha e ndërtimit të bazave të socializmit dhe socializmi për t'u ndërtuar kërkon njerëz të mësuar. Kuadrot tanë duhet të pajisen me kulturë të përgjithshme, por njëkohësisht edhe të specializohen për t'u bërë zot të punës në një degë të caktuar, pse:

„Për të udhëhequr ashtu si duhet — thotë Stalini — duhet ta njoħeš punën, duhet ta studjosh punën me ndërgjegje, me durim dhe këmbëngulje. Nuk mund të udhëheqësh në fshat, pa njobur bujqësinë, pa njobur kooperativat, pa pasur njoburi nga politika e çmimeve, pa studjuar ligjet që kanë lidhje direkte me fshatin. Nuk mund të udhëheqësh në qytet, pa njobur industrinë, pa studjuar jetën e punëtorëve, pa ua vënë veshin kérkesave dhe nevojave të punëtorëve, pa njobur kooperativat, bashkinjet

profesionale dhe punën e klubeve. Por a mund të arrihen të gjitha këto me një të goditur? — thekson shoku Stalin. Mjerisht, jo. Për të ngritur udhëheqjen e partisë në lartësinë e duhur, duhet ngritur, para së gjithash, kualifikimi i funksionarëve të partisë. Tani kualiteti i funksionarit duhet të zërë vendin e parë»¹.

Duke u bazuar në mësimet e shokut Stalin neve na dalin detyra kolosale në këtë drejtim, pse kuadri ynë është shumë i ulët dhe në të shumtata e rasteve shkon në fshat o në fabrikë dhe mban konferenca me karakter të përgjithshëm dhe s'është në gjendje të japë një ndihmë konkrete të lidhur me problemet e bujqësisë ose të industrisë. Këtej, na mëson Stalini, mund të lindin arësyet e dobësimit të udhëheqjes që konsistonjë në mospërputhjen midis kërkesave që shtron Partia dhe mundësive që ka ajo në këto momente. Duhet, pra, një kujdes i madh për të térhequr në Parti dhe në pushtet njerëzit më të mirë nga punëtorët dhe fshatarët, që kanë ecur përpara në saje të zhvillimit të aktivitetit politik të këtyre klasave. Kështu Partia do të mund t'u përgjigjet më me lehtësi nevojave të mëdha të zhvillimit, t'u përgjigjet kërkesave dhe nevojave të punonjësve që kurdoherë shtohen, përparojnë, zhvillohen.

Shoku Stalin na mëson se mund të lindë dhe një rrrezik tjetër:

«Këto kohët e fundit, gjatë periudhës së zhvillimit të ekonomisë, u rrit dhe u forcua mjaft

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 7, f. 173.

aparati i organizatave shtetërore dhe shoqërore. Trustet dhe sindikatat, institucionet tregëtare dhe të kreditit, organizatat administrative-politike dhe kulturale-arësimore, më në fund kooperativat e të gjitha llojeve — u rritën dhe u zgjerruan mjaft, duke futur në gjirin e tyre qindra mijëra njerëz të rinj, kryesisht pa parti... Po rritet gjithashtu edhe forca dhe pesha e tyre specifike. Dhe sa më tepër të shtohet rëndësia e tyre, aq më i ndjeshëm bëhet presioni i tyre mbi partinë, aq më shumë sjellin ato dobësimin e udhëheqjes së partisë, aq më e fortë bëhet rezistenca e tyre kundër partisë. Prandaj, duhet bërë një rigrupim i tillë forcash edhe një shpërndarje e tillë e njerëzve drejtues brenda këtyre aparateve, të cilat të mund të sigurojnë udhëheqjen e partisë në situatën e re. Por, siç dihet, është e pamundur që të gjitha këto të arrihen me një të goditur. Së këtejmi lind rreziku i shkëputjes së aparatit shtetëror nga partia»¹.

Është, pra, e domosdoshme që Partia t'i vërë një rëndësi të madhe forcimit të pushtetit. Organizatat bazë të Partisë në të gjitha institucionet shtetërore ekonomike, kooperativiste, duhet të luajnë rolin e tyre drejtues. Këto duhet të zbulojnë të metat, t'i korrigojnë dhe të vënë në korrent udhëheqjen e Partisë, organet më të larta të Partisë. Detyra e organizatave bazë duhet të përqëndrohet në përmirësimin e ve-

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 7, f. 172.

primtarisë së aparatit të pushtetit, domethënë që aparatit të punojë mirë, në mënyrë të organizuar, të përpiktë, operativisht dhe pa burokratizëm. E domosdoshme është për Partinë të bashkojë punën politike me drejtimin ekonomik, pse ka shokë, sikundër përmenda më lart, që anojnë nga një prirje e tepruar për punët ekonomike dhe harrojnë detyrat politike të Partisë, ose i braktisin krejt punët ekonomike dhe interesohen me hope për të plotësuar boshllëqet. Shoku Stalin na mëson se

«Nuk bën ta ndajmë politikën nga ekonomia. Ne nuk mund t'i shpëtojmë ekonomisë, po ashtu sikundër nuk mund t'i shpëtojmë politikës»¹.

Eksperiencia e Partisë Bolshevikë na mëson se asnjë fushë pune politike, ekonomike dhe shoqërore nuk duhet t'i shpëtojë udhëheqjes dhe kontrollit të organizatave të Partisë. Por të ruhem i nga gabimet që përmenda më lart, pse disa shokë kërkojnë ta bëjnë çdo gjë vetë, ngarkohen me shumë gjëra dhe i raportojnë Partisë dhe organizatës hollësitë më të vogla të ekonomisë dhe të drejtimit shtetëror dhe shoqëror. Në qoftë se veprojmë kështu, rezultati do të jetë që atë nuk do t'i kryejnë dot të gjitha detyrat që kanë marrë përsipër dhe kështu zhdukjet personaliteti i organizatave shoqërore dhe ekonomike.

Detyra tjetër e organizatave të Partisë në aparatin shtetëror dhe në ndërmarrjet është të edukojë puno-

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 121.

njësit me frymën e përgjegjësisë, të patriotizmit, të respektit rigoroz të ligjeve, të disiplinës shtetërore. Organizatat bazë duhet të zhvillojnë kritikën dhe autokritikën për të korrigjuar të metat e aparatit. Vetëm në këtë mënyrë aparati i shtetit do të forcohet, do të rritet influenca e komunistëve dhe do të realizohet me sukses plani pesëvjeçar i shtetit.

Shokë,

Po e mbaroj raportin tim. Siç e shihni u përpoqa të vë në dukje në vija të përgjithshme sukseset dhe të metat në punën tonë. As Komiteti Qendror as e gjithë Partia, nuk kanë pasur dhe as do të kenë kurrë frikë t'i vënë në dukje të metat e veta, pse kështu ne i kemi korrigjuar këto dhe kemi arritur rezultate të mëdha në punën tonë për të mirën e popullit.

Partia jonë heroike është forcuar dhe çelnikosur dhe në saje të saj janë arritur këto rezultate të mrekullueshme në lëmin ekonomik, social dhe kultural. Në saje të Partisë sonë të lavdishme është forcuar Republika jonë Popullore, është forcuar dhe çelnikosur mbrojtja e atdheut dhe Shqipëria është bërë një shkëmb graniti që u reziston dhe do t'u rezistojë kurdoherë me sukses kërcënimeve të imperialistëve dhe të shërbëtorëve të tyre, renegatëve titistë e të çdo kallëpi tjetër.

Demagogjia dhe shpifjet e armiqve të jashtëm dhe të brendshëm, kundër vendit tonë, janë gjellë e qelbur e pa kripë. Ndërkohë që ata lehin,jeta e popullit shqiptar lulëzon, mbushet vendi me kombinate, fabrika, hidrocentrale e miniera, në ara fshatarët punojnë të

gëzuar e të lirë, në fushat tona punojnë traktorë e kombajna moderne sovjetike që paralajmërojnë produhime të begatshme për popullin tonë, në shkolla, kurse, teknikuqe, universitete edukohen me mijëra e me mijëra të rinj. Po rritet e çelnikoset klasa jonë punëtore e inteligjencia e re, po ngrihen njerëzit e së resë, njerëzit e së ardhshmes, njerëzit e socializmit.

Këto janë veprat madhështore të Partisë, të rrugës së saj, të drejtësisë së saj. A mund të rezistojnë përpara këtij realiteti të madh pallavrat e armiqve të jashtëm dhe të brendshëm? Kurrsesi jo. Ato bëhen pluhur para jetës së ndritur që po ngrihet e lulëzon në vendin tonë.

Armiqtë imperialistë dhe shërbëtorët e tyre e kanë halë në sy Partinë dhe popullin tonë dhe kërkojnë të na pengojnë në rrugën tonë me çdo mjet.

Por të gjitha tentativat e tyre kanë dështuar me turp dhe kurdoherë do të dështojnë, pse populli ynë udhëhiqet nga Partia e tij besnike, Partia e Punës. Kur armiqtë e jashtëm ulërijnë si çakej dhe predikojnë për ne disfata — ja, Partia jonë e dashur del përpara popullit me planin e parë pesëvjeçar, një plan madhështor, që do ta bëjë vendin tonë më të begatshëm, jetën e njerëzve më të bukur, atdheun tonë më të fortë. Qentë le të lehin në hënëz, ne të vazhdojmë punën tonë të lirë, paqësore dhe ndërtimtare.

Partia jonë heroike, si kurdoherë do t'i kryejë me sukses të gjitha detyrat që i dalin përpara, pse ajo ka besimin dhe dashurinë e pakufishme të popullit.

Shokë, ta mbajmë lart e të papërkulur flamurin e internacionalizmit proletar dhe me flamurin e Leninit e të Stalinit, përpara për fitore të reja!

Rroftë populli heroik shqiptar!

Rroftë Partia jonë e dashur dhe heroike, Partia e Punës!

Rroftë Bashkimi Sovjetik, atdheu i lavdishëm i socializmit dhe i komunizmit, kështjellë e pamposhtur e paqes dhe e lirisë!

Lavdi Partisë mëmë Bolshevikë të Lenin-Stalinit!

Lavdi Stalinit të madh, udhëheqësit dhe edukatorit tonë të lavdishëm!

Rroftë dhe u forcoftë paqja në botë!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 79 (1087), 1 prill 1952*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**FJALA E MBAJTUR NË SEANCËN E MBYLLJES
SË KONGRESIT II TË PARTISË SË PUNËS
TË SHQIPÉRISË**

6 prill 1952

Shokë delegatë,

Gjithë Partia jonë u mobilizua e luftoi që të vinte në këtë kongres me duar plot e më e pregetitur, më e armatosur dhe më e gatshme për frontin e detyrate që do të shënonte ky kongres.

Masat punonjëse, gjithashtu, u mobilizuan me një entuziazëm të tillë në të gjitha frontet e ndërtimit socialist të vendit e shoqërisë sonë dhe si kurdoherë i thonë Partisë: Të gjithë jemi në këmbë, udhëhiqna përpara, Partia jonë e dashur, parti çlirimtare, parti e punës.

Shokë, po mbyllim punimet e këtij kongresi. Mund të themi se ky kongres ka treguar në një mënyrë të shkëlqyer hovin revolucionar të Partisë sonë, unitetin e saj të çelniktë rreth Komitetit Qendror.

Kongresi ka qenë një manifestim i zjarrtë i besnikërisë së Partisë sonë ndaj marksizëm-leninizmit.

Kongresi u zhvillua në një frymë të tillë luftarake,

revolucionare, që provon me siguri se Partia jonë, me këtë gjallëri, me këtë përkrahje të nxeh të masave punonjëse, e ndihmuar dhe e ndriçuar nga Partia e lavdishme Bolshevikë dhe i madhi Stalin, me siguri do të bëjë që plani pesëvjeçar të realizohet plotësisht.

Këtë detyrë të madhe e shumë të rëndësishme që ka të bëjë me jetën, lumturinë e të ardhshmen e popullit e të Republikës sonë, Partia do ta përbushë me nder, sepse, shokë, kongresi tregoi që Partia jonë është forcuar dhe ka ecur përparrë, që anëtarët e kuadrot e saj janë rritur, janë pajisur me një eksperiencë të madhe në luftën e re për ndërtimin e socializmit. Kongresi tregoi se uniteti i radhëve të Partisë rreth Komitetit Qendror është çelnikosur, se ky unitet është me rrënje të shëndosha, sepse ai nuk është arritur me frymën e pajtimit, të mbulimit të të metave dhe të dobësive në dëm të Partisë, por është arritur me metodën bolshevike të kritikës e të autokritikës, në interes të Partisë e të socializmit. Kongresi tregoi se komunistët dhe Partia jonë po mësohen ta përdorin gjithmonë më mirë e më drejt armën e shkëlqyer e shpëtimtare të Lenin-Stalinit, kritikën e autokritikën.

Kongresi për të gjithë ne ka qenë një shkollë e madhe, një shkollë e vërtetë.

Ai tregoi se Partia dhe komunistët janë rritur e kanë fituar një eksperiencë e pjekuri të madhe që do të na ndihmojë të ecim përparrë me hapa më të shpejtë.

Ne dalim nga ky kongres me bindjen e patundur se Partia jonë e dashur do të forcohet e do të ecë përparrë, se ajo frymëzohet nga një kurajë e vendosmëri

bolshevikë për të kritikuar çdo punë jo të mirë, me të meta, dobësi e gabime. Një parti ku komunistë të thjeshtë, kritikuan me kurajë, pa rezerva njërin a tjetrin udhëheqës, një parti ku udhëheqësit i presin me respekt këto, kritika e janë të vendosur t'i ndreqin menjëherë, me siguri, shokë, ajo parti nuk mund të ndryshket, por do të mbetet e gjallë e revolucionare dhe e tillë do të rritet e do të ecë përpara.

Një parti që s'i duron dot njerëzit që ja fshehin asaj të vërtetën mbi dobësitë e tyre, puna e të cilëve udhëhiqet jo nga dashuria për popullin, për partinë, por për «poste», e «tituj», një parti që është e pamëshirshme kundër atyre që s'ja kanë me të drejtë, një parti e tillë, kurrë nuk mund të mposhtet e nuk do të mposhtet nga armiqtë e jashtëm ose të brendshëm.

Shokë delegatë, është detyrë e madhe për çdonjërin nga ne që këtë frysme të kongresit ta shpiem poshtë, në organizatat bazë, në qendra pune e fshatra.

Është detyrë e madhe që puna e Partisë të frysme zohet çdo ditë nga ajo dashuri e zjarrtë e mirënjoyje e thellë për Partinë Bolshevikë, për Bashkimin Sovjetik e Stalinin e madh, ashtu siç e shprehu kongresi ynë.

Është detyrë për gjithë Partinë që të shtojë solidaritetin me gjithë popujt e vendeve të demokracisë popullore e kampin e paqes, të forcojë luftën për mbrojtjen e paqes. Të shtojë vigjilencën për të ruajtur radhët e saja dhe popullin e të jetë e pamëshirshme kundër armiqve të Partisë e të popullit ashtu siç u shpreh kongresi.

Organizatat e Partisë e komunistët, të forcojnë ato lidhje të shëndosha e dashuri të masave për Partinë.

ashtu siç u shpreh në këtë kongres, të dëgjojnë zërin e tyre, të mësojnë nga to gjithmonë, ashtu siç mësuam ne në këtë kongres. Të jemi të thjeshtë e të mos harrojmë që masat punonjëse na lindën e na rritën, pa to nuk ecim dot përpara dhe se qëllimi ynë është që t'u shërbejmë atyre deri në fund me besnikëri e vetëmohim.

Është e domosdoshme për forcimin e mëtejshëm të Partisë që ta bëjmë tonën, të masave, të Partisë eksperiencën e madhe e shumë të vlefshme që u ngrit në këtë kongres, të na bëhet ajo një mbështetje për ta armatosur më mirë Partinë e për t'i dhënë një hov të ri zhvillimit të ndërtimit ekonomik e kultural të vendit tonë.

Fryma e kritikës dhe e autokritikës, e papajtueshmërisë me të metat, me dobësitë e me armikun e klasës, siç u ndie në këtë kongres, të vejë deri poshtë se në këtë rrugë do të forcohet Partia, do të ecë përpara shoqëria jonë e do të ndërtojmë socializmin.

Shokë, ne gjithë këto ditë folëm si të forcojmë Partinë tonë, si ta prepatitim atë që të jetë në krye të luftës së madhe për realizimin e tejkalimin e planit të parë pesëvjeçar, për forcimin e Republikës sonë Popullore dhe për mbrojtjen e paqes në botë.

Këto mësime, shokë, t'i bëjmë tonat, të na udhëheqin në punën tonë të përditshme, që të shkojmë në Kongresin III ballëhapët para popullit e Partisë dhe të themi: «Detyrat që na ngarkuat i plotësuam me nder, planin pesëvjeçar e realizuam plotësisht. Jemi gati të ecim përpara».

Kongresi zgjodhi më unanimitet udhëheqjen e re

të Partisë, Komitetin e saj Qendror. Ne Komitetin Qendror e zgjodhëm nga njerëzit e luftëtarët më të mirë të Partisë që kanë dhënë prova të një dashurie e vendosmërie të pakufishme për kauzën e çlirimtë të popullit dhe për t'i sigruar atij një jetë të re e më të mirë. Në Komitetin Qendror u fut gjak i ri që do ta ndihmojë Partinë dhe udhëheqjen e saj në punën e madhe për ndërtimin e bazave të socializmit.

Më lejoni shokë që në emër të Komitetit të ri Qendror, të siguroj kongresin dhe nëpërmjet tij gjithë Partinë, se do të shkrijmë gjithë energjitet tona dhe, kur ta lypë nevoja e Partisë dhe e popullit, edhe jetën tonë, që këtë besim ta meritojmë plotësisht; se do të mbajmë lart flamurin e lavdishëm të Partisë sonë e do të shënojmë në të fitore të reja të Partisë e të masave punonjëse.

Me besim të patundur në forcën e vendosmërinë e Partisë, në shpirtin patriotik e revolucionar të masave tona punonjëse, ne do t'ja arrijmë patjetër, që në flamurin e Partisë të shënojmë dhe fitoren e realizimit të plotë të planit pesëvjeçar.

Shokë, ne nuk mund të harrojmë kurrë se ajo që na nxori nga errësira, ajo që na tregoi rrugën e së ardhshmes, që drita e Revolucionit të madh të Totorit.

Prandaj, shokë, ne deklarojmë përparrë këtij kongresi se çdo hap e veprim yni, do të ndriçohet nga drita e mësimave të Partisë Bolshevik, e të madhit Lenin e Stalin. Ne do të vazhdojmë të forcojmë e të çelnikosim përditë e më tepër miqësinë me popujt e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore. Ne do të gjallërojmë ekonominë dhe gjithë

jetën e vendit duke futur në damarët e saj eksperiençen sovjetike. Ne do të luftojmë për të realizuar planin pesëvjeçar, ashtu siç kanë bërë popujt sovjetikë nën udhëheqjen e Partisë Bolshevikë.

Shokë, ne sigurojmë kongresin se do të jemi të pamëshirshëm kundër armiqve të klasës e të vendit, imperialistëve amerikanë, anglezë, agjenturave të tyre, titistëve të Beogradit, monarko-fashistëve të Athinës, neofashistëve të Romës e këlyshëve të tyre në vendin tonë. Ne do të shtojmë vigjilencën dhe do të forcojmë fuqinë mbrojtëse të vendit, që populli ynë të rrojë i lirë dhe të ndërtojë në paqe.

Komiteti i ri Qendror në fryshtësinë e këtij kongresi, do të luftojë për të ruajtur unitetin e Partisë, për të ngritur lart nivelin e saj ideologjik e politik, për të mbajtur të pastra radhët e Partisë dhe për ta ruajtur nga çdo armik që kërkon ta dëmtojë atë nga brenda ose nga jashtë.

Shokë, ne nuk do të harrojmë se nëna jonë është populli e ne jemi bijtë e tij. Ne betohemi para Partisë dhe popullit se do t'i shërbejmë atij me vetëmohim si bij të denjë dhe do ta ruajmë atë nga çdo e keqë.

Partia jonë, çdo komunist, nuk mund të harrojë se qëllimi për të cilin lufton është ta bëjë jetën e masave të lumtur e të begatshme. Partia jonë ka ecur e do të ecë gjithmonë në këtë rrugë.

S'ka gjë më të shenjtë për ne e për çdo komunist se sa t'i shërbesh kauzës së popullit, ndërtimit të socializmit, paqes e miqësisë me popujt e Bashkimit Sovjetik, e gjithë popujt e kampit të paqes e të socializmit.

Për këtë çdonjeri nga ne do të luftojë deri në

frymën e fundit, për këtë Partia jonë heroike do të luftojë deri në fund për fitoren e socializmit e të komunizmit.

Rroftë populli ynë heroik!

Rroftë Kongresi II i Partisë!

Lavdi organizatores të të gjitha fitoreve të popullit tonë, Partisë heroike të Punës!

Lavdi Partisë Bolshevikë të Lenin-Stalinit!

Lavdi mësuesit të madh të Partisë e të popullit tonë, edukatorit të punonjësve të të gjithë botës, mbrojtësit më të madh të paqes, mikut më të shtrenjtë të popullit tonë, J.V. Stalinit!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 85 (1093), 7 prill 1952*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**TELEGRAM Urimi DËRGUAR SHOKUT
BOLESLAV BJERUT ME RASTIN E 60-VJETORIT
TË DITËLINDJES**

18 prill 1952

**PRESIDENTIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË
PUNËTORE TË BASHKUAR TË POLONISË
SHOKUT BOLESLAV BJERUT**

V a r s h a v ē

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe në emrin tim personal, më lejoni t'Ju dërgoj urimet dhe përshëndetjet më të përzemërtat me rastin e 60-vjetorit të ditëlindjes Suaj. Partia dhe populli ynë Ju çmojnë Ju, shoku Bjerut, si një luftëtar të shquar të paqes dhe të socializmit dhe si një mik të ngushtë e të sinqertë, që keni punuar e punoni pa u kursyer, për forcimin e miqësisë ndërmjet popujve tanë vëllezër.

Me rastin e 60-vjetorit të ditëlindjes Suaj, Ju urojmë nga zemra shëndet dhe jetë të gjatë për të mirën e popullit vëlla polak, për sukseset e mëtejshme në ndërtimin e Polonisë së re dhe në luftën për mbrojtje

tjen e paqes, e cila është e pandarë nga lufta që bën gjithë kampi i paqes e i demokracisë nën udhëheqjen e lavdishme të çliruesit dhe mikut tonë të përbashkët, Bashkimit Sovjetik dhe të Stalinit të madh.

Sekretari i Përgjithshëm i Partisë së
Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 95 (1103), 18 prill 1952*

*Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 95 (1103),
18 prill 1952*

**LETËR DËRGUAR KOMITETEVE TË PARTISË DHE
KOMITETEVE EKZEKUTIVE TË RRETHEVE
LUSHNJE, FIER, BERAT DHE PËR NJOFTIM GJITHË
KOMITETEVE TË PARTISË DHE KOMITETEVE
EKZEKUTIVE NË RRETHE NË LIDHJE ME
FUSHATËN E MBJELLJEVE**

5 maj 1952

KOMITETIT TË PARTISË TË RRETHIT
KOMITETIT EKZEKUTIV TË KP TË RRETHIT
Lushnjë — Fier — Berat

Për njoftim:

KOMITETEVE TË PARTISË TË RRETHEVE
KOMITETEVE EKZEKUTIVE TË KP TË RRETHEVE

Nga kontrolli mbi fushatën e mbjelljeve, në rrethet Lushnjë, Fier dhe Berat, u konstatua se komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive nuk kanë treguar kujdesin e duhur në punimet që bëhen për mbjelljet në fermat shtetërore, kooperativat bujqësore dhe ekonomitë bujqësore individuale. Ka munguar një drejtim i organizuar dhe operativ në mbjelljet si për SMT-të ashtu dhe për sektionet e bujqësisë të rrëthit. Këto rre-

the janë prapa si me preqatitjen e tokës ashtu edhe me mbjelljet, kualiteti i punës është bërë dhe po bëhet i dobët. Komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të rretheve Lushnjë, Fier e Berat nuk i ka preokupuar sa duhet kjo gjendje dhe nuk marrin masa efektive për të ngritur në këmbë mbarë organizatat e Partisë, organizatat e masave dhe këshillat popullore, për të likuiduar të metat dhe plogështinë në drejtimin e fushatës.

Kuadrot drejtues të këtyre rretheve, vendimit të Këshillit të Ministrave dhe të KQ të PPSH mbi mbjelljet pranverore, nuk i kanë kushtuar kujdesin e duhur për t'u kuptuar dhe për t'u zbatuar mirë e me kohë nga të gjithë punonjësit e bujqësisë. Drejtuesit nuk e kanë analizuar seriozisht gjendjen e mbjelljeve që është problemi më me rëndësi, megjithëse në këtë kohë bëhen mbledhje të gjata dhe të njëpasnjëshme për çështje të tjera më pak të rëndësishme dhe më pak urgjente. Në këtë mënyrë ata gjejnë plot justifikime për interesimin e paktë dhe për drejtimin burokratik të fushatës.

Komititetet ekzekutive në këto rrethe më tepër marrin dijeni për gjendjen e mbjelljeve, përmes evidencave me shifra të thata që flasin vetëm për realizimin e planit duke mos bërë fjalë mbi cilësinë e punimeve që është faktori më me rëndësi për realizimin e prodhimit. Një pjesë e mirë e lëvrimeve është bërë e vazhdon të bëhet si nga ekonomitë bujqësore ashtu edhe nga SMT-të pa përdorur asnjëherë lesën, gjë që shkakton humbjen e vlagës së tokës dhe puna mbetet të bëhet vetëm kur të bjerë shi. SMT-të në disa raste bëjnë punë me cilësi të dobët e megjithkëtë kjo punë merret në do-

rëzim pa asnje vërejtje nga kooperativat bujqësore dhe ekonomitë bujqësore individuale.

Mbjellja e pambukut është shumë prapa, por ka edhe raste që ai mbillet keq: hidhet fara thellë ose shumë cekët dhe mbjellja nuk bëhet me vija të drejta, gjë që do të vështirësojë prashitjen e mekanizuar të kësaj kulture.

Këto dobësi në punën agroteknike vërtetohen sepse kuadri agroteknik nuk i ndihmon praktikisht fshatarët në arë, në skuadrën kooperativiste ose në parcelën ku punon traktori, apo atje ku shkelet agrorregullorja.

Komiteti Qendror i PPSH e dënon këtë drejtim burokratik nga rrëthet e sipërpërmendura dhe, duke pasur parasysh se të njëjtat dobësi, ku më shumë e ku më pak, ekzistojnë edhe në rrëthet Krujë, Vlorë, Lezhë e të tjera, porosit të gjithë komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive që të marrin këto masa:

1. — Byrotë e komiteteve të Partisë të shqyrtojnë menjëherë dhe me kujdes punën e mbjelljeve të pranverës. T'i vihet rëndësi cilësisë së punimeve dhe të merren masa konkrete që të sigurohet kryerja e punimeve për mbjelljet brenda afateve të caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave dhe të KQ të PPSH.

2. — Sekretarët e komiteteve të Partisë dhe kryetarët e komiteteve ekzekutive, çdo mbrëmje, në bazë të evidencave të rregullta dhe reale, të analizojnë punën, të marrin masa konkrete për ditën e nesërme duke u kushtuar kujdes të veçantë kooperativave bujqësore dhe fshatrave që janë më prapa. Nga komitetet e Partisë dhe nga komitetet ekzekutive të rretheve, veçanërisht drejtuesit kryesorë gjatë kësaj periudhe duhet të shkoj-

në dëndur në terren, aty ku mbillet, bashkë me teknikët bujqësorë, për të ndihmuar konkretisht, në vend, fshatarët.

3. — Të evitohet praktika e mbledhjeve gjatë ditës dhe thirrja në qytet e në mbledhje e punonjësve nga fermat, kooperativat bujqësore ahe fshatrat, sidomos gjatë mbjelljeve.

4. — Të praktikohet nga anëtarët e byrove të komitetave të Partisë dhe komitetet ekzekutive marrja në patronazh e lokaliteteve, kooperativave bujqësore dhe fshatrave të mëdha që janë prapa me mbjelljet.

5. — Të kërcohët llogari dhe të ngrihet përgjegjësia në të gjitha organizatat e Partisë dhe organet e push-tetit për realizimin e planit të shtetit në afatet e caktuara dhe të ndiqen me kujdes punimet bujqësore që të kryhen me cilësi të lartë.

Komiteti Qendror i PPSH u thekson edhe një herë sekretarëve të komitetave të Partisë dhe kryetarëve të komitetave ekzekutive në rrethe, se puna e tyre do të çmohet nga fakti se sa ata kanë ditur ta organizojnë punën për realizimin e planit të shtetit dhe sa kanë luftuar për të siguruar rendimente të larta nga çdo kulturë bujqësore.

Sekretari i Përgjithshëm i KQ të PPSH

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

MBI FORCIMIN E PUNËS ME LEKTORËT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

9 maj 1952

Eksperiencia që kemi marrë nga Partia Bolshevikë për punën e lektorëve nuk po vihet si duhet në zbatim. Ndoshta kjo çështje është parë vetëm nga ana financiare, por mua më duket se duhet të shohim në radhë të parë përfitimet.

Unë bisedova pak me drejtuesit e Komitetit të Partisë të Tiranës, të cilët e paraqitin të nevojshëm forcimin e punës me lektorët. Ata propozojnë se është e nevojshme që pranë çdo organizate bazë të Partisë të ketë një lektor, ndërsa në komitetin e Partisë të ketë lektorë profesionistë. Me sa di unë, pranë çdo komiteti partie në Bashkimin Sovjetik ka nga një grup lektorësh, të cilët preqatitin leksione për nevojat e organizatës. Ky grup lektorësh atje varet nga komiteti i

¹ Në këtë mbledhje, Byroja Politike po shqyrtonte propozimin e Komitetit të Partisë të Tiranës për të emëruar lektorë profesionistë. Duke marrë shkas nga kjo, shoku Enver foli për nevojën e organizimit të punës me lektorët pranë komiteve dhe organizatave bazë të Partisë.

partisë, punon pranë kabinetit të partisë dhe preqatit leksione për masat e gjera të popullit dhe të partisë.

Ne kemi nevojë që njerëzit dhe shokët tanë të mësojnë, të ngrihen ideologjikisht dhe politikisht, prandaj jam i mendimit që këtë punë ta organizojmë, së pari, këtu në kryeqytet. Ta autorizojmë Komitetin e Partisë të Tiranës që të fillojë nga puna duke marrë dy lektorë profesionistë, me pagesë, por pranë kabinetit të tij ai mund të ngarkojë edhe shokë të tjera të ngritur të organizatës për të preqatitur leksione pa u shkëputur nga puna e tyre. Të hartosh një leksion, kjo është një punë më e madhe se sa të shkruash një artikull, pse kërkon më shumë punë, prandaj mendoj se duhet të ketë edhe stimul, pse kështu lektorët do të interesohen më shumë të punojnë, do të zhvillohen, do të forcohen dhe do të bëjnë përpjekje të studjojnë. Nga kjo punë ne do të kemi përfitime shumë të mëdha.

Përsa u përket lektorëve të organizatave bazë të Partisë, ata duhet të zgjidhen dhe të nisin nga puna për të preqatitur leksione. Këta lektorë mendoj të mos paguhën për punën që do të bëjnë, po ta konsiderojnë këtë një detyrë partie, pse çdo shok e ka për detyrë që të punojë për të ngritur shokët e tij të organizatës bazë ku bën pjesë.

Pasi ta organizojmë këtë punë në Tiranë, pastaj të shikojmë nëse mund ta bëjmë në të gjitha rrethet e e vendit tonë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

MBI DËRGIMIN E KOMUNISTËVE NË OBJEKTET E MËDHA TË NDËRTIMIT

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH*

16 maj 1952

Nëse nisemi nga parimi që komunistët të venë në prodhim, duhet që shumica e tyre të jenë nga administratat dhe sektori i tregëtisë shtetërore e kooperativiste dhe puna e tyre të zëvendësohet me gra. Le të marrim si shembull një dyqan ku ta zëmë se punojnë 8 komunistë, aty të hiqen katër nga këta dhe të zëvendësohen me gra, të cilat mund të mos jenë komuniste.

Qëllimi kryesor i Partisë është që komunistët të shkojnë në prodhim, të punojnë atje ku ndërtohet, ku prodhohet, pse atje është fronti i nderit për ta. Edhe unë mendoj si shokët, që të mos heqim komunistë nga fshatrat e fushës, pse edhe atje kemi nevojë, por nga zona malore. Për shembull, nga Kuçi i Kurveleshit ne mund të tërheqim deri gjysmën e komunistëve, po jo nga rrithi i Lushnjës ose nga zona fushore e Vlorës. Të kihet kujdes që për të dërguar fuqi punëtore në

këto objekte¹ të mos tërhiqet asnjë nga komunistët që punojnë në prodhim.

Shpërndarja e komunistëve duhet të bëhet sipas rëndësisë dhe madhësisë së objekteve që po ndërtohen, por të tregohet kujdes që ata të mos futen në letra, dua të them në administratë, po në prodhim, ku të kaliten e të aftësohen që nesër të bëhen drejtues e kuadro ndërtimi të zot si kryeminatorë, kryebrigadierë etj. Të gjitha këto varen nga kuptimi i detyrave, nga niveli i punës ideologjike e politike të domosdoshme që do të bëjnë organizatat e Partisë në rrethe, se të jemi të sigurtë që do të gjejmë edhe rezistencë.

Shkaku i parë i kësaj rezistence ështëjeta dhenjë farë komoditeti që ka krijuar secili në qytet dhe që nuk dëshiron ta trazojë, prandaj, për t'i larguar ata nga qyteti duhet bërë një punë e madhe ideologjike dhe politike, kjo është kryesorja. Ka pastaj dhe njerëz që janë mësuar të punojnë në administratë dhe nuk e kanë lehtë të largohen prej saj. Detyra e Partisë është ta thyejë këtë rezistencë dhe komunistët të shkojnë atje ku u bën thirrje ajo. Në përgjithësi, ata që do të dërgohen në gjithë këto qendra pune të mëdha duhet të janë komunistë të rinj.

Çështja e rrogës që tha Gogo [Nushi] duhet t'u

¹ Në këtë mbledhje Byroja Politike shqyrtoi edhe problemin e plotësimit me fuqi punëtore e sidomos dërgimin e komunistëve për të punuar në objektet e mëdha të ndërtimit si në Hidrocentralin mbi lumin e Matit, Rafinerinë e naftës në Cërrrik, Fabrikën e cimentos në Vlorë, rrugën Gramsh-Lozhan, punimet e Urës vajgurore, në hekurudhën Papër-Cërrrik etj.

shpjegohet mirë të gjithë këtyre komunistëve, pse edhe kjo ka rëndësi. Shokët e Partisë që do të punojnë me ta, pasi të informohen më parë mbi gjendjen e tyre ekonomike, familjare, dhe kjo nuk është një punë e lehtë, duhet t'i thërrasin ata një e nga një, të shohin bashkërisht nëse ka mundësi që në vendin e komunistit që largohet, të punojë gruaja e tij, t'i llogaritet secilit sa rrogë do të marrë atje ku do të dërgohet dhe sa do t'i taprojë për jetesën e familjes. E gjithë kjo të bëhet me një punë partie të gjithanshme e bindëse, me takt dhe në asnje mënyrë me imponim, me qëllim që secili ta ndjejë ngrohtësinë dhe urtësinë e Partisë. Ne po bëjmë luftë për t'i shtyrë shokët e Partisë që të punojnë me masat dhe prapë gjejmë mjaft vështirësi dhe jo më t'i thuash tjetrit: ngrehu tani nga familja dhe shko në Mat! Kjo mund të arrihet kur me komunistin të bëhet ajo punë bindëse e me durim që thashë.

Kriteri për zgjedhjen e elementëve mund të jetë, pra, ky: të studjohet më parë cilët komunistë mund të tërhiqen për këtë qëllim, duke pasur parasysh në radhë të parë ata që janë në administratë. Sigurisht këtu është fjala për ata që mund të zëvendësohen me njerëz pa parti. Të shihet gjithashtu që të tërhiqen në këto vepra të mëdha ndërtimi sa më shumë komunistë edhe nga sektori i tregëtisë, nga malësitë dhe jo nga fushat e qendrat e prodhimit. Pasi të jetë bërë kjo punë pregitore, të thërriten një e nga një ata që mendohet se mund të shkojnë dhe, në rrugën që përmenda, të gjithë ata që do të janë dakord, të dërgohen në objektet e mëdha të ndërtimit, në bazë të numrit të caktuar për çdo rreth. Duhet pasur parasysh se do

të ketë edhe komunistë që do të dërgohen larg rrethit. Ndarja e tyre për në objektet e punës do të bëhet këtu, në qendër.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
‘ që gjendet në AQP*

MBI PUNËN E PARTISË NË USHTRI

*Nga fjala në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH*

23 maj 1952

Edhe unë në përgjithësi jam dakord me raportin¹ dhe diskutimet e shokëve. Në ushtri ka përparime si në fushën e edukimit politik, ashtu dhe në atë të stërvitjes ushtarake. Është e drejtë të thuhet se ushtria po forcohet dita-ditës dhe kjo i detyrohet Partisë. Puna atje ka pasur suksese dhe kjo është inkurajuese.

Nga pikëpamja kulturale besoj se ushtria ka më shumë përparime nga sektorët civilë, pse atje ky problem është ndjekur me më tepër kujdes. Megjithkëtë nuk duhet të kënaqemi me kaq. Shkollat dhe kurset shkojnë mirë dhe numri i oficerëve e i nënoficerëve që kanë mbaruar 7-vjeçaren është i kënaqshëm. Por, më të shumtët e nënoficerëve janë në lëvizje, prandaj me ta të zhvillohet një punë politike më e madhe.

¹ Në këtë mbledhje Byroja Politike diskutoi rreth raportit që kishte paraqitur Drejtoria politike mbi forcimin e mëtejshëm të punës së Partisë në ushtri.

Përbërja e oficerëve tanë është e mirë, gati të tërë janë anëtarë dhe kandidatë për anëtarë partie. Vetëm kam një vërejtje përsa i përket punës politike: të përpinqemi të luftojmë më mirë kundër formalizmit.

Është e vërtetë se format dhe metodat e vendosura në ushtri për edukimin ideo-politik të kuadrove tanë janë model për të tjerët, pse ato bazohen edhe në eksperiencën dhe ndihmën sovjetike, por duhet parë se mos temat janë pak të përgjithshme. Duhet që edukimin ta lidhim edhe me jetën, pse ndryshe oficerët do të mësojnë sa për të marrë notën dhe pas provimeve do të harrojnë ato që kanë mësuar.

E tërë puna ideo-politike edukative e Partisë në ushtri duhet t'i shërbejë më mirë forcimit të disiplinës, pse ka disa thyerje të saja nga ndonjë oficer, nënoficer dhe ushtar. Kjo duhet të na tërheqë vëmendjen jo vetëm nga ana ushtarake, po edhe nga ana e Partisë, pse jeta dhe puna e Partisë luajnë një rol të madh në ngritjen e nivelit të ndërgjegjes së njerëzve përzbatimin e rregullave ushtarake në çdo repart. Në rast se anëtarët e Partisë dhe oficerët nuk e kuptojnë mirë disiplinën në ushtri, natyrisht në masën e ushtarëve kjo do të jetë akoma më e dobët. Duhet pasur parasysh se zbatimi i urdhërave në ushtri është ligj. Edhe kur një urdhër nuk është i drejtë, ai duhet zbatuar patjetër dhe, pas kësaj, të gjendet forma më e përshtatshme për ta kritikuar komandantin. Kur ky e përsërit një gabim, prapë ka forma dhe mënyra se si të kritikohet, prandaj nuk duhet menduar se komandanti s'mund të kritikohet.

Dëshiroj të them pak fjalë edhe për forcimin e

punës së Drejtorisë politike. Kjo është një drejtori speciale, që varet nga Komiteti Qendror dhe zhvillon punën politike dhe organizative të Partisë në ushtri, po ajo bën edhe punë nga ana shtetërore nën kontrollin e KQ të Partisë. Drejtoria politike ka për detyrë të zbatojë vijën e Partisë në të gjitha drejtimet dhe Komiteti Qendror ta kontrollojë këtë zbatim. Por që të mund të kontrollohet zbatimi i kësaj vije, Komiteti Qendror duhet të jetë në kontakt me ata që e zbatojnë këtë vijë dhe një nga këto organe është edhe Drejtoria politike, siç janë organe zbatuese edhe komitetet e Partisë në rrethe.

Shokët e aparatit të Komitetit Qendror shkojnë poshtë në komitetet e Partisë në rrethe për të kontrolluar zbatimin e vijës, po ata nuk shkojnë celulë më celulë. Njerëzit e Drejtorisë së organizimit mund të shkojnë edhe në një celulë ose edhe në aktive të Partisë, po nuk venë me radhë në të tëra organizatat e rrethit, ashtu sikurse bën komiteti i Partisë. Që të kontrollojë zbatimin e vijës së Partisë, Drejtoria e organizimit duhet të ketë medoemos kontakte dhe të shohë se çfarë bën në këtë drejtim Drejtoria politike, pa hyrë në kompetencat e saja, por të shohë si zbatohet vija, si ecën përpara Partia, si ecin njerëzit. Kështu, si njerëzit e Drejtorisë së organizimit, edhe ata të agjitet-propit duhet të shkojnë në Drejtorinë politike për të parë se si zbatohen vendimet e Partisë për sektorin e tyre. Vijat dhe metodat se si duhet bërë ky kontroll janë caktuar dhe, në bazë të punës që bëhet, t'i jepet raport udhëheqjes së Komitetit Qendror. Në këtë mënyrë nuk ja marrim kompetencat Drejtorisë politike,

po organet e aparatit të Komitetit Qendror duhet ta ndihmojnë dhe ta kontrollojnë atë, pse kështu kontrollohet zbatimi i vendimeve të Partisë.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Pyrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP

MBI FORCIMIN E UDHEHEQJES SË PARTISE NË BASHKIMET PROFESIONALE¹

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH*

30 maj 1952

Eshtë e vërtetë që ne kemi pasur suksese në punën e bashkimeve profesionale. Çështja e emulacionit ka marrë hov, në këtë drejtim në qendra pune ka përparrime. Por në lidhje me udhëheqjen e Partisë në bashkimet profesionale, ka edhe të meta, që nuk janë vetëm në Durrës.

Unë mendoj se drejtuesit e Partisë dhe Partia në përgjithësi, nuk e kanë kuptuar si duhet rëndësinë e bashkimeve profesionale. Kjo duket si nga raporti që na u paraqit ashtu edhe nga bisedimet që unë kam pasur me shumë shokë të tjerë. Disa shokë të Partisë mbledhjet e bashkimeve profesionale i quajnë si pengesë; kjo do të thotë se ata nuk kanë konsideratën e duhur për këtë organizatë.

¹ Në këtë mbledhje të Sekretariatit të KQ u thirr në raport Komiteti i Partisë i rrethit të Durrësit lidhur me punën që bën për të sigruar udhëheqjen e Partisë në bashkimet profesionale.

Siq e dimë, bashkimet profesionale janë shkollë e komunizmit dhe udhëhiqen nga Partia. Nëpërmjet tyre Partia edukon klasën punëtore me ndërgjegjen socialiste ndaj punës. Si detyrë të rëndësishme bashkimet profesionale kanë mobilizimin e klasës punëtore në realizimin e planit të shtetit, prandaj, të mos i vësh rëndësi kësaj, do të thotë të mos i vësh rëndësi realizimit të planit të shtetit.

Partia e di që bashkimet profesionale janë rripa transmisioni që e lidhjn atë me klasën punëtore. Në qoftë se ne kemi një motor të ri dhe të mirë, të cilin e lidh me maqinerinë një rrip i dobët (që në këtë rast janë bashkimet profesionale), atëherë kjo maqineri nuk do të vihet në lëvizje si duhet, sepse megjithëqë motori është i mirë rripi nuk do ta kryejë mirë punën. Prandaj, bashkimet profesionale duhet të bëhen me të vërtetë një rrip transmisioni i tillë, që të realizojnë me sukses të gjitha detyrat.

Bashkimet profesionale te ne kanë disa detyra dhe të drejta. Në vendet kapitaliste klasa punëtore organizon greva kundër shfrytëzimit dhe ka si qëllim të rrëzojë pushtetin e borgjezisë e të vendosë pushtetin e proletariatit, kurse te ne është krejt ndryshe: këtu klasa punëtore ka për detyrë të forcojë diktaturën e proletariatit. Bashkimet profesionale kanë detyrë gjithashtu që të ngrenë punëtorët kundër shfaqjeve të burokratizmit që ekzistojnë në aparatin tonë shtetëror, kundër pronës private që lind kapitalizmin. Derisa ekzistojnë klasat dhe lufta e klasave, do të ekzistojnë edhe kontradikta në mes të të ndërmarrjeve tona dhe punëtorëve, por këto kontradikta nuk janë si në kapi-

talizëm. Për t'i zgjidhur këto kontradikta një rol me rëndësi luajnë bashkimet profesionale.

Sindikatat, siç ka thënë shoku Stalin, janë një organizatë e punëtorëve pa parti, në to ka edhe njerëz që besojnë te zoti dhe që nuk besojnë. Po çfarë janë atëhere sindikatat? Ato janë një bashkim vullnetar i klasës punëtore për të mbrojtur pushtetin e tyre, diktaturën e proletariatit.

Diktatura e proletariatit forcohet në luftë të ashpër kundër armiqve të klasës. Partisë dhe bashkimeve profesionale u bie detyra që në këtë rrugë të bëjnë edukimin e klasës punëtore. Por, në bashkimet profesionale nuk mund të kërkosh një disiplinë aq të fortë sikurse në parti; në radhë të parë këtu duhet të veprohet në bazë të bindjes.

Lidhur me mbrojtjen e interesave të punëtorëve, ne kemi kontratat kolektive, të cilat janë një marrëveshje midis drejtorisë së ndërmarrjes dhe punëtorëve. Kur bëhet mbledhja e bashkimeve profesionale dhe del se punëtorët i kanë kryer detyrat e tyre, ndërsa ndërmarrja nuk i ka zbatuar detyrimet e saj ndaj punëtorëve, atëherë bashkimet profesionale shkojnë dhe merren vesh me drejtorin, të cilin e vënë përparrë përgjegjësisë.

Lenini thotë që të interesohemi në maksimum për të plotësuar kërkeshat e punëtorëve, por këtu duhet të kihet parasysh që këto kërkesa të mos jenë në bazë të nevojave të një grupei punëtorësh, por në bazë të interesave të përgjithshme të punëtorëve. Kur një çështje nuk ka mundësi të kryhet, bashkimet profesionale ua shpjegojnë këtë punëtorëve, ndërsa kur është

puna që një çështje nuk është kryer nga mosinteresimi i drejtorive, për shkak të burokratizmit të tyre, bashkimet profesionale e ngrenë këtë problem në Parti, me qëllim që Partia t'i vërë shkaktarët përpara përgjegjësisë.

Kështu duhet t'i shikojmë punët dhe jo të mos ketë kritikë e autokritikë në mbledhjet që zhvillohen. Nga ana e Partisë duhet një interesim më i madh për këto gjëra dhe nuk ka pse organizatat e saj bazë të marrin kompetencat e bashkimeve profesionale. Detyra e tyre është të punojnë që të realizohet plani dhe këtë ato do ta kryejnë vetëm me punën e punëtorëve, kur puna nuk shkon mirë, të thirren bashkimet profesionale dhe bashkë me to të luftojë edhe Partia. Në rast se Partia nuk i kryen këto detyra, puna nuk mund të ecë mirë.

Megjithëse Partia e di që bashkimet profesionale janë shkollë e komunizmit, në këtë drejtim ka shumë sektarizëm. Këtu doli se në Durrës për të dërguar punëtorë në kursin e bashkimeve profesionale duhet që më përpara kandidaturat t'i shikojë byroja e komitetit të Partisë. Në rast se nomenklatura është kështu, nuk është e drejtë, ne nuk mund t'ja dalim kësaj pune vetëm me një grusht njerëzish që njohim duke u vërtitur rrëth tyre. Bashkimet profesionale dhe Partia duhet t'i njojin më mirë njerëzit dhe kështu do të gjejnë me qindra e qindra luftëtarë të mirë për komunizmin, nga të cilët vetë organizata profesionale do të zgjedhë për të dërguar në kurse.

Partia gjithashtu ka ngritur çështjen e përhapjes së novatorizmit dhe të metodave të reja të punës, për

të cilat duhet të bëhen mbledhje të gjera të punëtorëve dhe të flasin vetë punëtorët, papritur që më parë të bëhet mbledhja e organizatës bazë të Partisë.

Për forcimin e punës në bashkimet profesionale duhet të kujdesemi të tërë. Si është e mundur për shembull që seksioni i industrisë në pushtet të mos interesohet për çështjen e punëtorëve, të cilët punojnë për realizimin e planit? Të gjithë sektorët janë të lidhur me punën e bashkimeve profesionale, bile edhe bujqësia ka lidhje pune me to, për arësyen se në ferma punojnë punëtorë dhe ka një organizatë profesionale që vepron për edukimin dhe mobilizimin e tyre.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQF

KOOPERATIVAT E SHITBLERJES TË KRYEJNE SI DUHET FUNKSIONET EKONOMIKE DHE POLITIKE QË U KA NGARKUAR PARTIA

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

6 qershor 1952

Furnizimi i popullit nga tregëtia shtetërore dhe kooperativat e shitblerjes ka një rëndësi të madhe dhe këta dy sektorë për këtë janë përgjegjës. Natyrisht, grumbullimet luajnë një rol mjaft të madh, po sot nuk e kemi në shqyrtim këtë sektor. Vetëm se mendoj t'u themi shokëve të Ministrisë së Grumbullimeve² që të marrin masa më të mira për të ndryshuar sa më parë gjendjen në sektorin e tyre, ku ka pasur e ka vështirësi e të meta të mëdha, ndryshe kompromise-

¹ Në këtë mbledhje të Byrosë Politike u diskutua rreth raportit të paraqitur nga Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit «Mbi blerjen në tregun reciprok për vitin 1951 dhe tremujorin e parë të vitit 1952».

² Ministria e Grumbullimeve u krijua në 5.7.1950 dhe u suprimua më 1.8.1953; funksionet e saj i kaluan Ministrisë së Bujqësisë.

tohet politika e Partisë dhe e shtetit. Tregëtia varet, sigurisht, edhe nga puna që do të bëjë grumbullimi, po nuk duhet harruar edhe organizimi i mirë i punës nga vetë organet e tregëtisë.

Po të shohim punën e kooperativave të shitblerjes në fshat, duhet thënë se ato kanë dobësi serioze. Kjo doli e qartë dhe nga të gjithë shokët që diskutuan. Roli i këtyre kooperativave ka rëndësi të madhe jo vetëm nga ana thjesht tregëtarë, po sidomos nga ana politike. Por nga të dyja këto parime të mëdha në kooperativat e shitblerjes ka devijime nga vija e Partisë. Nuk mund të lejohen devijime nga vija e Partisë në një mënyrë ose në një tjetër dhe sidomos kur Komiteti Qendror i ka parë këto gabime, i ka sinjalizuar, ka dhënë ndihmën e tij, dhe në vend që gjendja të përmirësohet, ajo është rënduar akoma më shumë. Prandaj shokët që drejtojnë këtë sektor duhet të kuptojnë thellë përgjegjësinë e tyre. E them këtë, sepse edhe në raportin që na është paraqitur nga ana e Bashkimit Qendror të Kooperativave të Konsumit duket tendenca që tri të katërtat e fajeve i kanë «të tjerët». Fajet i hidhen artizanatit ose ndonjë sektori tjetër. Natyrisht, ata kanë fajet e tyre dhe këto t'uа themi, por nuk është në rrugën e Partisë që të mos shohim se ku është shkelur vija e Partisë në punën e kooperativave të shitblerjes.

Ku vërtetohen këto shkelje të vijës së Partisë në punën e kooperativave të shitblerjes?

Pikësëpari ato duken në atë që kooperativat e shitblerjes nuk janë bërë organizata masash. Ky është një parim me rëndësi. Të mos luftosh që këtë parim ta zbatosh në jetë, do të thotë të devijosh nga vija e Partisë,

ta shtrembërosh këtë vijë në praktikë. Këtë e ka sinjalizuar Komiteti Qendror, është bërë vazhdimi i autokritikës dhe mund të bëhet autokritikë me vite. Mirëpo kooperativat e shitblerjes dhe të konsumit në vend që të funksionojnë si organizata ekonomike masash, janë kthyer në dyqane të këqia, duke mos u shërbyer mirë masave punonjëse të fshatit e të qytetit. Dyqanet e kooperativave të shitblerjes nuk janë thjesht dyqane, ato janë organizata mësash që i shërbejnë forcimit të lidhjeve ekonomike dhe të aleancës midis punonjësve të qytetit e të fshatit. Duke mos kuptuar rolin e rëndësishëm dhe funksionet e tyre ekonomike e politike për forcimin e marrëdhënjeve fshat-qytet nëpërmjet shkëmbimit të mallrave, është shtrembëruar vija e Partisë, duke devijuar nga e djathta si nga ana politike, ashtu dhe nga ana tregëtare. Është braktisur tregëtia reciproke duke u drejtuar nga tregëtia e lirë¹. Në këtë mënyrë kooperativat kanë spikuluar duke nxjerrë fitime të mëdha në kurriz të klasës punëtore, e cila është furnizuar me çmime të larta.

Duke i shitur klasës punëtore mallra me çmime të larta, fshatarësia jo vetëm nuk i jepet asnjë ndihmë, por pengohet edhe furnizimi i kooperativave bujqësore, ku ne mbështetemi për të ndërtuar socializmin në fshat. Si rrjedhim punonjësit e kooperativave bujqësore detyrohen të blejnë në tregun e lirë. Po ç'do të thotë kjo? Kjo do të thotë të pasurohen disa elementë, të favorizohet tregu privat. Po edhe sikur me këto fitime të

¹ Tregu reciprok furnizonte fshatarësinë nëpërmjet shkëmbimit të tepricave të prodhimeve të veta me prodhime industriale. Në tregun e lirë çmimet ishin më të larta.

pasurohet shteti, prapë edhe kjo nuk është e lejueshme, pse shteti ka një fitim të caktuar dhe mbi këtë bazë hartohet buxheti i tij. Pra shteti nuk duhet të fitojë në kurriz të masave. Nuk duhet lejuar gjithashtu që edhe artizanati të shesë artikuj me çmime që lëvizin çdo javë, pse ka matrapazë që për mungesë të organizimit tonë i shfrytëzojnë këto raste, blejnë artikuj me çmime të lira dhe ua shesin fshatarëve kur ata mungojnë në treg; në këtë mënyrë ne, në vend që të ecim duke luftuar spekulatorët dhe tendencat mikroborgjeze të fshatarëve, u hapim atyre rrugë. Të gjitha këto çojnë në deviacion dhe në fakt na kanë çuar përsa u përket kooperativave të shitblerjes.

Unë nuk do të them ndonjë gjë të re se si do ta ndreqim këtë situatë. Puna është a mundet që kooperativat e shitblerjes të kryejnë funksionet ekonomike dhe politike që u ka caktuar Partia? Po, mundet. Po në rast se lëmë pasdore çështjen e organizimit të mirë të këtyre kooperativave, të edukimit të kuadrit të tyre, të metodave të ndryshme të grumbullimit, atëhere nuk mund ta ndreqim situatën. Duhet të fillojmë nga zbatimi i këtyre detyrave që të forcohet gjendja e kooperativave dhe të zbatohet drejt viaj e Partisë në këtë sektor. Këto janë të domosdoshme, po nuk janë masa që duhen marrë në rrugë administrative; në radhë të parë detyrat që diskutojmë duhen kuptuar thellë nga ana politike dhe ideologjike.

Furnizimi në rregull i punonjësve është një problem me shumë rëndësi, por edhe i vështirë. Thatësira është thatësirë, por edhe deviacionet janë deviacione. Siç luftojmë kundër thatësirës për t'i marrë tokës prodhime e

për të furnizuar popullin, po me atë vendosmëri duhet të luftojmë edhe kundër shtrembërimeve e shkeljeve të vijës së Partisë në praktikën e kooperativave të shitblerjes. Këtë duhet ta kuptojë mirë Partia dhe gjithë organet shtetërore.

Tregëtia kooperativiste furnizohet nga industria dhe njëkohësisht nga artizanati, importi dhe grumbullimi. Përsa i përket importit edhe unë jam i mendimit me Hysniun, që, përfshatin, mallrat e importit të tregëtohen vetëm nga kooperativat e shitblerjes. Prandaj ç'janë përfshatin duhet t'i shkojnë fshatit nëpërmjet kooperativave të shitblerjes. Në rast se nuk bëjmë këtë, por mallrat i shesim në qytet, atëherë do të kemi disa lekë më shumë e më shpejt në arkat e shtetit, por do lëmë pasdore fshatin e kështu nuk do nxitim prodhimin e as do kënaqim fshatarët, nuk do të plotësojmë nevojat e tyre.

Të gjitha raportet që kemi nga qendrat e punës na thonë se njerëzit qahen në lidhje me furnizimin. Se sa janë të mëdha këto çrregullime duhet me i pa mirë, po gjërat nuk duhet të bëhen tërkuzë. Edhe industria duhet të ndjekë mirë planet dhe ato që ka për t'ua dhënë kooperativave t'ua japë. Ministria e Industrisë të marrë masa përfshatin e rregullt të organizatave kooperativiste sipas planeve dhe kontratave në sasi, cilësi, assortiment dhe kohë. Siç dihet, furnizimi bëhet në bazë të planit. Përsa u përket marrëdhënjeve ekonomike midis organizatave ekonomike, furnizimi detajohet dhe rregullohet nëpërmjet kontratave që kanë rëndësi të madhe. Për të forcuar disiplinën kontraktuale, veç masave të tjera, duhet patjetër të parashikojmë edhe sanksione për moszbatimin e përpiktë dhe me kohë të detyrimeve. Po

të mos respektohen kontratat, nuk mund të ketë disiplinë dhe, për pasojë, do të shkelet plani i shtetit. Ana që dëmtohet nga shkelja e kontratës duhet të ngrerë zërin deri në qeveri me qëllim që njerëzit të korrigohen me kohë dhe plani i shtetit, që është ligj, të mos mbetet pa u zbatuar për shkak të zvarritjeve të kota. Prandaj me përjashtim të forcës madhore që justifikon mospërmbushjen e detyrimeve të shprehura në kontratat, përrastet e tjera, përveç përgjegjësisë civile, kur ka pakujdesi kriminale, shpërdorim të pozitës zyrtare etj., personat duhet t'i kalojnë gjyqit për t'u përgjegjur penalisht.

Përsa u përket kooperativave të artizanatit edhe këto nuk janë si duhet në rregull, siç nuk janë në rregull kooperativat e shitblerjes dhe vetë Komisioni i Planit. Artizanati nuk duhet të tregëtojë vetë mallrat përfshatin, pse ai është prodhues, ashtu si dhe industria. Detyra e artizanatit është që të prodhojë përfshatarësinë artikuj të ndryshëm sipas kërkesave të Bashkimit Qendror të Kooperativave të Konsumit. Artizanati është ndihmës i industrisë dhe duhet të jetë furnizuesi kryesor i kooperativave të shitblerjes. Këto parime duhen kuptuar drejt dhe të zbatohen në praktikë pa gabime. Po të tregëtojë vetë artizanati, kjo mund t'u sigurojë artizanëve disa të holla më tepër, por nuk mund të quhet fitim kur anëtarët e kooperativës së artizanatit nuk gjejnë në treg pemë dhe zarzavate. Është në interes të tyre që të kenë më pak fitime, por tregu t'u sigurojë patate, djathë, vezë, fruta, zarzavate etj. Kështu si është tani në treg krijohen turbullira dhe ka rrezik që të ketë konkurencë, gjë që është e huaj për tregëtinë tonë socialistë. Prandaj njerëzit në kooperativat e artizanatit

të fitojnë më pak lekë dhe të arrihet që vlefta e lekut të jetë më e madhe e populli të ketë mundësi të blejë më shumë. Tregëtinë në fshat ne e bëjmë me anë të kooperativave të shitblerjes, të cilat duhet të luftojnë kundër spekulatorëve, ndërsa me një organizim më të shëndoshë të zhvillohet tregu fshatar në rrugën e drejtë të Partisë. Prandaj shokët që drejtojnë artizanatin të bashkëpunojnë më mirë me kooperativat e shitblerjes dhe ju, drejtuesit e Bashkimit Qendror të Kooperativave të Konsumit, të jeni në dijeni të planit të artizanatit për të gjithë Republikën. Në të njëjtën kohë të shikohet edhe cilësia e mallrave të produara nga artizanati, i cili duhet të ketë parasysh porositë e tregëtisë që nisen nga kërkesat e popullit. Ndryshe artizanati ynë nuk mund të ketë kuptim.

Për lidhjen e kontratave me fshatarët, të tregohet shumë kujdes, të mos neglizhohet, kooperativat e shitblerjes t'u përgjigjen atyre si duhet, pse ka rrezik që të mos zbatohen dhe kështu të komprometohet furnizimi i popullit. Kontratat janë zinxhir dhe lidhen me shumë gjëra të tjera. Kështu ky problem duhet të kuptohet mirë si nga industria, ashtu dhe nga artizanati e nga vetë fshatarët. Industria duhet të jetë përgjegjëse për ato që ka kontraktuar me kooperativat e shitblerjes, kështu edhe artizanati, edhe fshatarët. Po të çalojë një nga këto, puna nuk ecën. Po të mbahet ndonjë qëndrim oportunist ndaj shokëve të industrisë duke mos kërkuar me forcë zbatimin e kontratës, atëherë do të pengohet furnizimi i popullit dhe do të shkelet vija e Partisë. Plani nuk zbatohet vetë, atë duhet ta zbatojmë ne deri në fund. Në rast se ndonjëri nuk është i zotit të drejtojë

mirë punën, t'ja lërë vendin një tjetri pse këtu kemi të bëjmë me jetën e popullit.

Çështjet e tjera që u thanë duhet të studjohen sa më parë dhe të vihen në zbatim pa u zvarritur me muaj e vite të tëra. E theksoj këtë se shumë nga këto detyra kanë dy vjet dhe nuk janë vënë në zbatim. Po i themi përsëri edhe sot, prandaj ju duhet t'i merrni seriozisht e t'i zbatoni.¹

Problemi tjetër është ai i transportit shtetëror me automjete dhe i transportit me kafshë. Përsa i përket transportit shtetëror me automjete duhet medoemos të ketë një kuotë të caktuar. Shteti ka vënë në dispozicion automjete edhe për tregëtinë kooperativiste, megjithkëtë këto nuk janë shfrytëzuar si duhet. Ky është një tjetër gabim nga ana e drejtuesve të Bashkimit Qendror të Kooperativave të Konsumit. Unë do t'ju pyesja për një gjë: Shqipëria ka plot pemë, po nuk di nëse ju keni bërë ndonjë plan për grumbullimin e tyre? A e di çdo kooperativë shitblerjeje në fshat se sa fruta duhet të grumbullojë dhe për këtë të marrë masa me kohë? Po për kafshët që do t'i transportojnë ato, a është menduar? A i bëjnë këto hesape shokët tanë drejtues të kooperativave të shitblerjes? Vetëm pema përbën një prodhim shumë të rëndësishëm të vendit tonë. Pema që nuk duron të dërgohet menjëherë në qytetin më të afërt dhe ajo që duron mundet edhe të mbahet derisa të sigurohet transporti. Në rast se nuk ka mundësi transportimi për pemët që nuk durojnë, kooperativat e shitblerjes të

¹ Është fjala për çështje të tillë siç janë: forcimi i tregëtisë ambulante, grumbullimi me grumbullues jashtë organikës, shpërblimi i punonjësve të kooperativave në fshat në bazë të xhiros etj.

organizojnë punishte dhe në rast se sasia e tyre në një zonë të caktuar është shumë e madhe, duhet t'i bëhet propozim qeverisë për krijimin e një industrie lokale. Ç'do t'i bëjë, për shembull, gjithë ato fruta krahina e Përmetit? Prandaj kur është koha, t'i dilet qeverisë me propozim se në këtë rreth do të grumbullojmë kaq kuin-talë qershi dhe për këtë na duhet kaq transport. Po kështu të veprohet edhe për patatet etj. Por shokët që drejtojnë kooperativat e shitblerjes nuk i kanë menduar këto gjëra dhe presin ç't'u sjellë fshatari dhe kur të dojë ai. Vetëm këto masa do t'i aktivizojnë e gjallë-rojnë kooperativat e shitblerjes, do t'i zgjidhin më drejt problemet e tyre. Po të jenë të qarta këto çështje dhe po të zbatohen si duhet në jetë, punët do të shkojnë më mirë.

Përveç këtyre, drejtuesit e Bashkimit Qendror të Kooperativave të Konsumit duhet të bëjnë më mirë edhe politikën e çmimeve, të mos mbetemi me të njëjtat çmime edhe kur konditat klimatike ndryshojnë. Kur ka thatësirë duhet që çmimet e blerjes patjetër të ngrihen, le të ketë humbje shteti. Punëtori në këto raste do të paguajë pak më shtrenjtë, po ai do ta kuptojë dhe me këtë nuk do të spekulohet. Në rast se nuk merret para-sysh thatësira ose breshëri që ra në këtë ose në atë krahinë, atëhere prodhimet do të humbasin, pse fshatari do t'i shesë ato në tregun privat dhe jo në kooperativat e shitblerjes. Prandaj në raste të tilla duhet të grumbullohen prodhimet me një çmim më të shtrenjtë. Ne këtu po bisedojmë për çmime sezionale dhe zonale, po nuk dimë se kur do të zbatohen këto çështje, koha ikën dhe, në materialin që na është paraqitur nuk caktohet asnjë datë për kryerjen e këtyre detyrave, gjë që du-

het bërë sa më parë. Edhe unë jam i mendimit që të ketë çmime zonale, pse te ne ka vende, për shembull, ku qershia zhvillohet më shumë dhe prandaj atje duhet të jetë edhe më e lirë se në një zonë tjetër ku mungojnë kushtet klimatike për zhvillimin e saj.

Pastaj në këtë situatë nuk flitet fare për rezerva, pa të cilat nuk mund të ecet, sidomos në dimër. Si do të bëhet, për shembull, për prodhimin e reçelit dhe të turshive nga zarzavatet qysh në stinën e verës? Kjo është një detyrë që duhet kryer, me qëllim që edhe në dimër të kemi rezerva për t'i dhënë popullit kur ka mungesë zarzavatesh.

Për të gjitha çështjet që u ngritën këtu, duhet të mendohet e të reflektohet nga shokët drejtues të industrisë, të tregëtisë, të grumbullimit, por veçanërisht nga vetë shokët e Bashkimit Qendror të Kooperativave të Konsumit. Ti, shoku Sulë¹, megjithëse je i ri në krye të këtij sektori, duhet t'u futesh më thellë çështjeve.

Të mos mbetemi me gjëra të përgjithshme, por të përcaktohen konkretisht detyrat që dalin për të ndryshuar medoemos gjendjen në kooperativat e shitblerjes dhe kryesorja është organizimi i mirë i punës për zbatimin e tyre.

*Botohet për herë të parë
sipas tekstit të nxjerrë nga
procesverbal i mbledhjes
së Byrosë Politike të KQ
të PPSH që gjendet në
AQP*

¹ Sulë Baholli, në atë kohë President i Bashkimit Qendror të Kooperativave të Konsumit.

NGA BISEDA E ZHVILLUAR ME KRYETARIN E KOMITETIT EKZEKUTIV TË KP TË RRETHIT TË TIRANËS NË LIDHJE ME PROBLEMET E FSHATIT

17 qershor 1952

Mbasi u informua nga kryetari i Komitetit ekzekutiv të Këshillit popullor të rrethit të Tiranës mbi gjendjen e të lashtave në përgjithësi, mbi punën e bërë për korjet dhe shirjet, si zgjidhen ankesat e fshatarëve, si punon pushteti në lokalitete si dhe për problemet e planit të shtetit në bujqësi, shoku Enver tha:

«Ju e keni marrë projektplanin e viti 1953 dhe keni afat ta studjoni e ta përfundoni mirë deri në vjeshtë, d.m.th. kohë keni mjaft. Kur të vjen plani ti duhet ta marrësh atë dhe t'i hedhësh një sy. Si kryetar i komitetit ekzekutiv që je do të thérresësh shefin e seksionit të bujqësisë, të grumbullimit, të planit, përgjegjësin e zyrës së kadastrës e të gjithë njerëzit e tjerë të interesuar dhe t'i vësh në korrent të çështjes. Pastaj thérret mbledhjen e komitetit ekzekutiv dhe i thuhet që na ka ardhur ky projektplan i mbjelljeve, të cilin duhet ta marrim në studim në këtë kohë, prandaj duhet t'ua japim aparatëve ta studjojnë. Çfarë duhet të studjojë aparat? Përgjegjësi i zyrës së kadas-

trës duhet të verifikojë nëse janë toka të punueshme ato që ka vënë në plan Ministria e Bujqësisë. Tokat arë ose do të janë ato të vjetmet, ose më shumë apo më pak, kadastra duhet t'i vërtetojë më mirë se deri tani. Shefi i bujqësisë duhet të punojë më shumë në drejtim të problemeve që ka fshati. Ai duhet të jetë vazhdimisht në punë, në kontroll, të shohë lutjet e fshatarëve, pse ata bëjnë kërkesa të ndryshme, se njërit i mbytet toka, tjetrit i mbetet batall, një tjetër e ka bërë livadh etj. Dhe këto ndryshime ndodhin çdo ditë. Mirëpo këtë punë shefi i bujqësisë nuk e bën si duhet, po rri shumë në qendër duke parë në mënyrë të sipërfashme ndonjë lutje të veçuar. Po kështu edhe kur shihet plani i mbjelljeve ai nuk bën sa duhet, kurse në fakt ai duhet të luajë një rol me rëndësi në pregatitjen e tij. Po edhe vetëm në kadastra nuk mund të bazohemi kur hartojmë planin se nuk është pasqyruar drejt gjendja e tokës arë dhe nuk mund të jetë pasqyruar drejt dhe sikur përgjegjësi i saj t'i ndjekë ndryshimet e tokës këmba-këmbës, pse kjo është një punë e zorshme. Po sidoqoftë puna e tij është diçka. Nëpunësi i kadastrës gjatë gjithë vitit duhet ta ndjekë çështjen e tokës, prandaj në mbledhjen e komitetit ekzekutiv duhet të vejë edhe ai e të japë llogari. Ai duhet të vërtetojë nëse është apo jo kjo tokë e punueshme dhe t'i argumentojë mendimet e tij, të faktojë se kaq tokë është këtu, kaq atje dhe më në fund të thotë se e gjithë toka e pënueshme nuk është kaq sa thuhet nga Ministria e Bujqësisë, po p.sh. 100 ha. më pak ose më shumë. Pastaj shefi i bujqësisë duhet të argumentojë se sasia e pambukut që na ka vënë në

plan Ministria e Bujqësisë është e realizueshme, bille mund të shtojmë edhe diçka p.sh. 100 hektarë. Ai bën propozime dhe ato duhet t'i justifikojë, pastaj vendos komiteti ekzekutiv. Përgjegjësi i bujqësisë do të thotë p.sh. se vitin e kaluar në rrethin tonë pambuku u bë më mirë nga ç'parashikohej, fshatarët kanë dëshirë dhe prirje ta shtojnë sipërfaqen e mbjellë me pambuk, prandaj ne mund ta shtojmë sipërfaqen e pambukut, natyrisht, në rast se i intereson shtetit një gjë e tillë për të mbjellë pambuk dhe jo misër etj. Ky i argumenton komitetit ekzekutiv se sa mund të realizohet plani, nëse janë apo nuk janë sipërfaqet që shënohen në projektin e ministritës së pambukut, dhe të gjitha këto i arësyeton. Ai mund të thotë që misër mund të bëhet më shumë në rrethin tonë, ndërsa grurë më pak për këto e këto arësy.

Për çështjen e farës duhet të japë llogari shefi i bujqësisë. Ai duhet të thotë që ne duhet të mbjellim kaq ha. me pambuk dhe na duhet kaq kv. farë, për këtë sipërfaqe grurë na duhet të kemi kaq kv. farë, ne në depot e shtetit disponojmë kaq kv., pastaj mund të kenë edhe fshatarët kaq kv. farë tjetër, pra, duke bërë llogaritë neve na duhet të kemi edhe kaq kv. farë plus, nga e cila do të jepet kaq kv. këtu dhe kaq kv. këtu. Ai do të raportojë nëse fshatarët kanë kafshë për të punuar tokën apo jo, pse edhe ky është një problem i madh. Prandaj ai duhet të jetë në gjendje të thotë se sa që kemi në rreth, sa na mungojnë dhe sa na duhen. Kaq sipërfaqe do të na e punojë SMT-ja dhe kaq që ose kafshë të tjera do të na duhen për të siguruar mbjelljen e kësaj sipërfaqeje toke. Të gjitha këto

gjëra ai i thotë me llogari e një për një dhe jo me mend. Kështu me radhë do të paraqesë situatën për të gjitha problemet e tjera. Si të bëhen këto veprime arrihet te rezultatet dhe do të dalë p.sh. që sipërfaqja që do të mbillet me pambuk është më e madhe nga ajo që është parashikuar në projektplanin e Ministrisë së Bujqësisë, për grurin ju del aq sa ka thënë ministria, ndërsa çështjen e misrit e lini për më vonë. Në lidhje me këtë studim i njoftohet ministrisë se, përsa i përket pambukut, na intereson që ky plan të qëndrojë sa e keni llogaritur ju, dhe ministria duhet t'ju përgjigjet për këtë brenda dy-tri ditëve, kohë gjatë së cilës ju duhet të bëni preqatitjet për të mbledhur këshillin popullor të rrethit, mbasi të keni bërë të gjitha këto preqatitje. Komitetit ekzekutiv kjo mbledhje duhet t'i jetë njoftuar një javë ose dhjetë ditë më parë bashkë me rendin e ditës. Ky veprim duhet të bëhet patjetër, pse ata janë anëtarë të këshillit popullor dhe duhet të vijnë të preqatitur në mbledhje që të mbrojnë interesat e shtetit dhe të fshatarëve. Por përpara se të vijnë këtu, ata duhet të vihen në korrent për rendin e ditës, të kenë kohë të mbledhin zgjedhësit e tyre, t'u komunikojnë atyre se në këto ditë do të bëhet mbledhja e këshillit popullor për çështjen e mbjelljeve dhe fton zgjedhësit të bëjnë vërejtjet e tyre, propozimet dhe kundërshtimet e tyre që anëtarë i këshillit popullor t'i marrë me vete dhe të diskutojë rreth tyre kur të vejë në mbledhje të këshillit të rrethit. Në këto takime me fshatarët e tij këta i bëjnë atij plot pyetje, i thonë mendimet e tyre. Ky mban shënimë për këto gjëra dhe vjen në mbledhjen e këshillit popullor i preqatitur për

të mbrojtur interesat e planit dhe të fshatarëve që përfaqëson. Kështu bëhet kjo mbledhje që ka një rëndësi të madhe dhe duke u bërë kështu, do të të vijnë të gjithë anëtarët e këshillit në mbledhje. Në mbledhjen e këshillit populor të rrëthit duhet të vijnë edhe të gjithë nepunësit e aparatit të komitetit ekzekutiv që kanë të bëjnë me bujqësinë, kadastrën, grumbullimin, mund të vijë sekretari i Partisë në qoftë se nuk është anëtar i këshillit populor, pse sekretari i Partisë duhet të shohë si punon Partia, si punojnë njerëzit, si kontrollohen dhe si ndihmohen ata. Pastaj kur të jetë pre-gatitur mbledhja dhe të kenë ardhur të gjithë, ti, si kryetar i komitetit ekzekutiv, hap mbledhjen dhe i vë në korrent të të gjithë punës që ka pre-gatitur aparatit dhe komitetit ekzekutiv në lidhje me planin e rrëthit që ka dërguar qeveria për çështjen e mbjelljeve. U thuhet atyre se sa parashikohet të mbillet pambuk, sa misër, sa grurë etj. etj. U thuhet se komiteti ekzekutiv e ka studjuar këtë plan dhe ka arritur në këto konkluzione p.sh. sipërfaqja e tokës nuk na rezulton aq sa ka planifikuar Ministria e Bujqësisë, po kaq. Në këtë rast i sinjalizohet shokut të kadastrës të flasë dhe të thotë arësyet e tija për ndryshimet që i duhen bërë planit të Ministrisë së Bujqësisë. Ai thotë se sipërfaqen e tokës së punueshme e kemi të vogël, p.sh. kaq është bërë kanal, kaq e ka marrë lumi, kaq është e papunuar për arësyen ushtarake, prandaj duhet të na zbritet nga plani i mbjelljeve kjo sipërfaqe. Në këto fjalë e sipër mund të ngrihet një tjetër dhe të thotë pse nuk përmendet edhe toka e filanit, pse edhe atij i është mbytur nga lumi. Në bazë të kësaj vërejtjeje i thuhet atij të ka-

dastrës të shohë librin dhe nëse kjo nuk figuron, i kërkohet pse nuk e ka shënuar atë tokë. Pastaj mund të ngrihet një tjetër dhe të thotë që filan fshatar ka bërë lutje për tokë, por kérkesat e tija në fshat nuk janë marrë para-sysh. Kështu këtu diskutohet çështja e tokës. Në mble-dhje të tërë pjesëmarrësit kanë të drejtë të thonë atë që mendojnë. Ti u shfaq atyre mendimet e tua dhe mbas këtyre diskutimeve vendoset dhe luftohet për të realizuar planin e mbjelljeve me kaq sipërfaqe pambuk, kaq grurë etj. Mirëpo mund të ngrihet një anëtar këshi-lli dhe të thotë që unë nuk jam dakord për atë sipër-faqe të planifikuar, por për më pak. Atëherë shefi i seksionit të bujqësisë duhet të argumentojë mirë pse është caktuar kjo sipërfaqe duke pasur parasysh interesat e planit.

Kështu veprohet edhe për problemet e tjera. Diskutohet pastaj për çështjen e farës, pse këto probleme janë të lidhura të gjitha me njëra-tjetren. Ti i thua këshillit se fshatarët kanë kaq farë. Ky problem duhet të diskutohet dhe të verifikohet edhe më vonë dhe po të mos jenë të drejta ato që thotë përgjegjësi i bujqësisë, ai ka përgjegjësi. Po kështu kanë përgjegjësi edhe ata këshilltarë që kundërshtojnë planin megjithëse e dinë se ato që thonë nuk janë reale, pse ata janë anëtarë të këshillit popullor dhe duhet të mbrojnë edhe interesat e planit dhe të fshatarit. Në këshillin popullor ju e bëni ndarjen e sipërfaqes së planifikuar për lokalitetet sipas projektit që keni bërë në komitetin ekzekutiv. Kështu mbasi diskutohet për planin, vendoset dhe kërkohet për ta realizuar. Mundësish të vendoset afërsisht plani i Ministrisë së Bujqësisë, po nga rezis-

tenca e këshillit popullor mund të bëhet ndonjë ndryshim në plan dhe vërejtjet e diskutimet e këshilltarëve ju duhet t'i merrni parasysh. Kështu ky plan i komitetit ekzekutiv fillon të ndahet nëpër lokalitete. Lokaliteti duhet të luajë rolin e vet, të bëjë detyrën si pushtet. Në lokalitet do të merret plani dhe do të shihet pikësëpari nga ana e komitetit ekzekutiv, ashtu siç bëri komiteti ekzekutiv i rrethit. Lokaliteti ka lidhje me fshatarët e territorit të vet. Plani që i dërgon komiteti ekzekutiv i rrethit do t'i mbetet në arkiv dhe kur të vijë plani i mbjelljeve të vitit 1954, lokaliteti do të mbështetet në planin e vitit 1953. Komiteti ekzekutiv i lokalitetit do të thérresë këshillin popullor të lokalitetit. Edhe kjo mbledhje duhet të lajmërohet më parë që këshilltarët të kenë kohë të bëjnë takime me zgjedhësit e tyre e të jenë të preqatitur për të folur. Mbledhjet e lokaliteteve të një rrethi të mos bëhen të tëra në një ditë, menjëherë, po nga një mbledhje në ditë të mënyrë që shefi i bujqësisë me njerëzit e vet të mund të shkojë në të gjitha mbledhjet. Kështu duhet të veprojë edhe shefi i kadastrës. Edhe në lokalitet duhet të luftohet për të aprovar planin e komitetit ekzekutiv të rrethit. Në mbledhjen e këshillit popullor të lokalitetit mund të njoftohen të vijnë edhe fshatarë që dëshirojnë të dëgjojnë, dhe ata që kanë ankesa do të vijnë patjetër të dëgjojnë, prandaj t'u jepet e drejta e fjalës. Pas kundërshtimeve që mund të bëjë një fshatar, të diskutohet mbi çështjene gabimeve në kadastër, për kërkësat e fshatarëve dhe të gjitha këto të lidhura kurdoherë me planin. Si të pranohet plani në lokalitet detajohet fshat më fshat. Kjo është, pra, një detyrë e lokalitetit, i cili duhet të

ndihmohet në fillim derisa të marrë veten. Si të detajohet plani për çdo fshat, dërgohet, shtrohet në këshillin e fshatit ku duhet të mblidhet edhe i gjithë populli i fshatit. Këtu fillojnë edhe angazhimet që duhet të merrin drejtpërdrejt dhe të mos mjaftohet duke i marrë gishtin fshatarit. Bisedohet me filan fshatar dhe i thuhet që do të marrësh kaq pambuk, kaq grurë etj. «Jo, përgjigjet ai, pambukun e marr, po grurin jo, se nuk e bëj dot, nuk kam krahë pune». Mirëpo këshilli e di gjendjen e tij dhe këtu fillon lufta. Përsëri ai kundërshton për grurin. Atëhere lihet aq sa thotë ai, i vihet pambuku aq sa pranoi, kaq grurë e kaq misër dhe ftohet të vëré firmën. Kështu bëhet me radhë për të gjithë fshatarët. Mundet në këtë punë e sipër të dalë një fshatar tjetër dhe të thotë se nuk ka aq tokë sa i është shënuar, se ja ka mbytur lumi. Pyeten fshatarët nëse është e vërtetë. Jo, thonë ata që e njohin, ose mund të thonë se është e vërtetë që i është mbytur një pjesë e tokës dhe nuk i është zbritur. Kjo duhet pasur parasysh, prandaj t'i thuhet që do të mbjellë këtë dhe këtë, minus tokën që i është mbytur. Më në fund bëhet llogaria. Pambuku p.sh. del në rregull, misri po ashtu, kurse gruri del më pak nga plani i lokalitetit. Atëhere punohet nga ana e Partisë për të bindur fshatarët individualisht. Kështu arrin Partia t'i bindë. Pra, kur bëhen këto gjëra, kur bëhet detajimi i planit merr pjesë i gjithë populli. Me këtë mënyrë fshatari merr pjesë vetë në pushtet, ai vetë kontrolloi planin dhe angazhimet u morën drejtpërdrejt, një pjesë e pakënaqësive u zgjidhën në këtë mbledhje gjatë procesit të punës dhe përpara gjithë popullit; disa që kishin gënjer u demaskuan për gë-

njeshtren, kurse disa te tjerë, ankesat e te cileve ishin me vend, fituan te drejtën e tyre. Shefi i kadastrës shkundet duke ju thënë pse nuk e ka bërë këtë dhe këtë. Këto plane i merr lokaliteti nga fshatrat, i verifikon dhe ja dërgon rrethit. Ju i mbledhni te gjitha këto dhe ja jepni aparatit, i cili njihet me to dhe pastaj i sjell komplet. Pas këtij veprimi ju bëni mbledhjen e komitetit ekzekutiv dhe shihni se pambuku ju doli kaq, misri kaq etj. toka e papunueshme kaq, se në filan lokalitet kanë dalë edhe këto gjëra që kadastra nuk i ka bërë. Me këtë rast merren edhe masa kundër atij te kadastrës nëse nuk ka punuar mirë, se nuk i ka bërë këto veprime, se nuk i ka parë lutjet e fshatarëve. Në fund planin me te gjitha këto ndryshime ja dërgoni Ministri-së së Bujqësisë duke i thënë se na vjen mirë që rezultatet kanë qenë te kënaqshme ose na vjen keq, nëse rezultatet nuk janë te mira. Ministria e kontrollon planin dhe pastaj ua kthen me vërejtjet e saja, p.sh. që filan tokë në këtë lokalitet duhet rishikuar edhe një herë, pse kemi informata që nuk është parë drejt. Kështu ju bëni rishikimin me anën e aparatit dhe ja dërgoni definitivisht ministrisë, e cila rregullon këto gjëra dhe pastaj ja çon qeverisë. Si te aprovohet ky projekt atëhere bëhet plani. Qeverisë i thuhet nga ministria se si është vepruar, i arësyetohet pse del mangut toka dhe se nuk mund te bëhet më tepër, prandaj del detyrë që te bëhen përpjekje për ngritjen e rendimenteve. Si dëgjon këto qeveria, merr vendim dhe pranon planin.

C'bën Partia në këtë mes? Ajo për çështjen e planit te mbjelljeve dhe te realizimit te tij mobilizon komunistët e pushtetit, te komitetit te Partisë, te këshillave

popullore dhe gjithë komunistët që merren me bujqësi në rreth. Të gjithë këta duhet të vënë të gjitha forcat që të zbatohet ky plan. Kjo është direktiva që duhet të japë komiteti i Partisë për këtë fushatë. Pastaj të gjithë ju të komitetit ekzekutiv të rrethit duhet të veni në komitetin e Partisë, të merrni udhëzimet e tij, të luftoni për të realizuar planin e qeverisë dhe të jeni të kujdesshëm që aparati i pushtetit të kryejë detyrën si duhet.

Ti, si kryetar i komitetit ekzekutiv, duhet të vësh përpara përgjegjësisë të gjithë shefat e seksioneve, të cilët duhet të punojnë intensivisht dhe drejt. Si të bëhet kjo, të zhvilloni mbledhjen e komitetit ekzekutiv ku të diskutohet, të mbrohet interesi i shtetit dhe interesi i fshatarëve. Pas kësaj pune duhet vajtur në lokalitet, të kontrollohet e gjithë puna e lokalitetit, të vihet në lëvizje i gjithë aparati dhe të kontrollohet e të ndihmohet në punë e sipër. Kjo punë të bëhet çdo vit. Pastaj ti duhet të instruktosh në vend si të punojë kryetari i lokalitetit, nëpunësi i gjendjes civile dhe të vihen kështu të gjithë në lëvizje. Pastaj bën mbledhjen në lokalitet dhe përpara saj shtron dhe shpjegon këto detyra, p.sh. atij të gjendjes civile i thua se çfarë duhet të ketë gati. Pastaj Partia duhet të veprojë, të kontrollojë e të ndihmojë duke ardhur në mbledhje. Kur ti e sheh se aparati i komitetit ekzekutiv nuk ka gjallëri dhe punët nuk ecin, me gjithë masat që janë marrë nga ana shtetërore, kërkon edhe ndihmën e Partisë. I thuhet komitetit të Partisë se komunistët nuk po mobilizohen si duhet. Atëhere në mbledhjet e organizatave bazë bëhen vërejtje për ata që nuk janë aktivizuar dhe kjo bëhet që të mobilizohet Partia në lokalitet. Përveç

punës që bën ti nga ana shtetërore, bën edhe Partia punën e saj si mbledhjet e organizatave bazë, aktivizimin e organizatave të Partisë, punë kjo që kryhet menjëherë pas asaj që bëjnë organet e pushtetit. Prandaj duhet të mblidhet organizata bazë e Partisë dhe t'u shpjegohet komunistëve se q'pretendime mund të nxjerrë fshatari gjatë fushatës së mbjelljeve me qëllim që Partia ta ketë këtë gjë të qartë për të bërë që të zbatohen këto direktiva në terren. Kjo është detyra e Partisë. Po të veprohet kështu, ne i kemi bërë një shërbim të madh kësaj çështjeje dhe kemi bërë një plan real, jo një plan nga lart.

Vitin tjetër ne ju themi që të bëhet plani nga poshtë. Në bazë të kësaj procedure bëhet plani, duke filluar në fshat, në bazë të planit vjetor. Shihen ç'ndryshime do t'i bëhen planit, nëse do të shtohet p.sh. plani i mbjelljes së pambukut në fshat. Për këtë fillohet në fshat një për një dhe emër për emër për çdo fshatar, kjo punë do të bëhet për të gjitha kulturat bujqësore dhe plani i dërgohet lokalitetit; ky është plan i bërë me vullnetin e popullit. Lokaliteti e merr, e sheh, e studjon dhe vë re se pambuk ka më shumë nga plani i vjetëm, megjithatë duke njojur terrenin mund ta nxitë fshatin për ta shtuar edhe pak më tepër planin. Po të shtohet edhe diçka mirë është. Pastaj i çohet rrethit dhe ky e dërgon në ministri. Dikasteri sheh se nga ky rreth ka dalë një plan shumë i mirë dhe shumë më i lartë nga viti i kaluar. Bën edhe ministria llogaritë e saja se ku ka mundësi të bëhet më shumë, p.sh. në Lushnjë, prandaj i dërgon atje vërejtjet dhe njerëzit kur shtrohet plani. Mbas këtyre shtesave bëhet plani definitiv, plan nga poshtë, të cilin ministria e paraqet në qeveri. Në

përgjithësi ne e themi këtë gjë, po në praktikë nuk bëhet; pastaj themi se nuk vijnë në mbledhje këshilltarët. Po pse të vijnë kur nuk i pyet njeri? Edhe duke ardhur në mbledhje, këshilltarit nuk i jepet mundësia ta thotë fjalën e tij. Çështja është se në këtë veprim të parë ne shohim realitetin dhe zgjidhim shumë pakënaqësi. Sigurisht të tëra pakënaqësitet nuk janë zgjidhur, po një pjesë e tyre janë parë e janë zgjidhur. Pastaj gjatë gjithë këtij veprimi zgjidhet se kush ka e kush nuk ka qé, kush e ka tokën dhe kush e ka lënë. Ti ke të qartë situatën në rreth dhe në ankesat që të vijnë, ka të vërteta po ka edhe të rrema. Komiteti ekzekutiv ka listën se sa qé ka në rreth, por ndodh që nuk janë kaq qé, pse ka edhe ndonjë të dhënë që s'është e saktë, megjithëse në fshat bëhet punë nga Partia. Për të pasur një evidencë të saktë për çështjen e qeve, bëhen korrigjimet dhe dihet se ku janë mungesat. Pastaj ti ke në plan kush e ka dhe kush e ka lënë tokën, sepse kjo gjë është bërë në mbledhjen e fshatarëve, prandaj është më e saktë gjendja nga ç'mund ta kiske ti nga lart. Ti tani duhet të mendosh vetëm se kujt do t'ja japësh atë tokë. Këtë ja vë dëtyrë komitetit të lokalitetit. Për ta realizuar shpërndarjen vë në korrent Partinë që të punojë dhe të ndihmojë në fshat për të ndarë tokën e tepërt në fshatarët. Partia lufton në këtë drejtim dhe këto ndryshime vijnë e shtrohen në komitetin ekzekutiv në mënyrë që të nxirren konkluzione dhe komiteti ekzekutiv vendos. Mbas vendoset, bëhen propozime për Partinë, për qeverinë dhe ju duhet të informoni mbi dobësitë; Ministria e Bujqësisë ka kështu diçka konkrete për ta studjuar më mirë.

Tani vjen puna te grumbullimet. Te plotfuqishmit e grumbullimit e kanë më te lehtë punën. Ata kanë bazë kadastrën ku figurojnë ndryshimet që janë bërë gjatë vitit dhe që janë verifikuar në mbledhjet e fshatrave dhe lokaliteteve gjatë veprimeve që thamë. Një pjesë e tyre janë të verifikuara, janë të shkruara në kadastër, po kjo nuk është e mjaftë. I plotfuqishmi ka edhe angazhime që janë marrë nga fshatarët dhe janë të drejta. Tani ju i keni në rreth; po ç'do rrethi që t'i mbajë këtu ato? Sipas mendimit tim fletëdetyrimet duhet të plotësohen në lokalitet. Sidoqoftë këtë gjë duhet ta shohim. I plotfuqishmi vete në lokalitet bën këtë veprim dhe pastaj vete drejt e në fshat, mbledh ose jo fshatin, u jep fletëdetyrimet të gjithë fshatarëve dhe ikën. Mirëpo fshatarët kanë edhe ankime dhe këto ju vijnë të tëra këtu në rreth. Kjo praktikë është e gabuar, pse rrethi nuk i njeh fshatarët, dhe komisioni, që përbëhet nga ti, i plotfuqishmi etj., nuk e kryen si duhet punën dhe ndodh si në Durrës që lutjet shikohen përciptazi. Kjo është e padrejtë. Prandaj këto ankime duhet të mblidhen të tëra në lokalitet. Komiteti ekzekutiv i lokalitetit për shqyrtimin e lutjeve të fshatarëve duhet të mbledhë këshillin e lokalitetit dhe t'u thotë të gjithë fshatarëve që kanë bërë lutje, të vijnë në këtë mbledhje. Këtu duhet të jenë medoemos i plotfuqishmi i grumbullimit, nëpunësi përgjegjës i kadastrës si dhe të gjithë nëpunësit e këtyre sektorëve. Pastaj duhet të jetë edhe ai i gjendjes civile. Këta njerëz të aparatit të komitetit ekzekutiv kur të shqyrtohen lutjet, duhet t'u përgjigjen ankesave të fshatarëve. Në lutjet e tyre fshatarët duhet të vënë vetëm dëshminë e këshillit po-

pullor të fshatit dhe të gjitha të tjerat të shikohen në mbledhje të këshillit të lokalitetit. Thërriten një e nga një fshatarët se ç'anxesa kanë. Ngrihet njëri dhe thotë se detyrat që i janë vënë atij nuk janë të drejta se nuk ka krahë pune. Atëhere urdhërrohet nëpunësi i gjendjes civile të bëjë verifikimet dhe nëse rezulton që është e vërtetë si thotë ankuesi, lutja e tij pranohet. Kështu veprohet me radhë për të gjithë të tjerët. Të gjitha këto anxesa verifikohen në një ditë. Nëse mbeten disa gjëra të paverifikuara, ngarkohen edhe njerëz të tjerë, ndoshta nga organizatat e masave t'i shikojnë dhe t'i verifikojnë. Nëse fshatari nuk është i kënaqur edhe nga kjo, atëhere kërkon të bëhet mbledhja e fshatit, kërkon të ngrihet një komision nga fshati që të shikohet edhe më mirë çështja e ankesës së tij në lidhje me tokën. Më në fund, pas kësaj pune, si të dalë e vërteta vendoset çështja. Raste të tilla mund të ndodhin për një ose dy fshatarë se të tjerët verifikohen në mbledhjet e përparshme. Në këtë mënyrë me këto dy veprime edhe plani u bë real edhe pakënaqësitë e fshatarëve u zgjidhën edhe mbledhjet e tepërtë evitohen. Ju mund të raportoni që plani mbërriti kaq dhe shifrat janë të verifikuara, prandaj edhe ne deri në qeveri jemi dakord, pse ky është një plan i drejtë, real, se për hartimin e tij kanë punuar të gjithë, se ka marrë pjesë vetë populli. Kurse po të punohej si deri tani, as ti në rreth nuk je i sigurtë as ne në qeveri, pse për hartimin e planit nuk je mbështetur në baza të shëndosha, po në disa letra. Për problemet e fshatit duhet të kihen parasysh këto që thamë, sepse sjellin me vete lehtësira të mëdha në çështje të grumbullimit; fsha-

tari e sheh se ka drejtësi për çështjen e tokës që ka punuar dhe ka mbjellë, shtetit ai do t'ja japë atë që i takon dhe është i qetë se për tokën që nuk punohet nga ai, shteti nuk do t'i kërkojë gjë. Prandaj në këtë rast, nuk ka përse të mos ja japë detyrimin shtetit, nuk ka pse të ketë veprime arbitrale nga nëpunësit e grumbullimeve, nuk ka pse të ketë urrejtje kundër nëpunësve të grumbullimit që sot nuk po ua zgjidhin drejt kérkesat fshatarëve.

Ne u themi fshatarëve se ata duhet të qeverisin, po derisa plani që vjen nga lart u thuhet se është i padiskutueshëm, le të flasin sa të duan ata, kjo tregon se asgjë nuk bëhet siç thuhet. Nga këto veprime mbeten mjaft çështje të pazgjidhura, mbjelljet nuk bëhen sipas planit, grumbullimet nuk realizohen dhe nëpunësit e grumbullimit armiqësohen me fshatarët. Tani pse të mos realizohet plani, kur problemet do të vihen më në rregull, kur punon mirë komiteti ekzekutiv i rrethit, ai i lokalitetit, këshilli popullor i rrethit si dhe këshillat popullore të fshatrave? Pse të dërgosh ekipe në fshat, kurse ke njerëz në terren që e njohin fshatin dhe fshatarëve ua dinë mirë hallet? Atëherë kur ke këto leva, përse nuk i vë në lëvizje, pse nuk e organizon punën, se kjo nuk do ndonjë punë të madhe, vetëm rregull e disciplinë. Me kërkue nga secili të bëjë detyrën e vet, kjo është pozitive dhe do të ketë përparime në këtë drejtim, pastaj me kontrollue si duhet zbatimin e vendimeve. Deri tani këshilltarët nuk vinin rregullisht në mbledhjet e këshillit popullor, po nesër do të vijnë rregullisht; me këtë mënyrë tërhoqen, se janë të interesuar e secili do të shohë sa i është caktuar plani. Kur të

vijë për vëten e tij, ai do të interesohet edhe për planin e fqinjëve që përfaqëson. Ndërsa tani atyre u thuhet se janë pas me grumbullimet, se duhet të ecin shpejt etj. Duke u interesuar sa më shumë për problemet e fshatit, fshatari nga ana e tij nuk do të thotë se është ankuar dhe nuk ja ka vënë njeri veshin.

Ne kemi 6 muaj që kemi vendosur që fshatarëve të katundit Ball të Ballabanit t'u zbriten detyrimet për tokën nga kategoria e tretë në të katërtën, kurse kjo në praktikë nuk është bërë. Po pse ndodh një gjë e tillë? Pse të krijojë fshatari një mendim të keq për Partinë dhe shtetin, pse të lihen gjithë këto çështje me kaq rëndësi vetëm në dorën e atij nëpunësit të grumbullimit? Po nëpunësi i grumbullimit, edhe njeri shumë i ndershëm të jetë, nuk ka ç'të bëjë. Si mund të kontrollojë ai vetëm me dy-tre vetë 2-3 mijë fletë-detyrime, që i vijnë? Natyrisht, ai do t'i shohë kur urdhërohet, po do t'i shohë vetëm në mënyrë mekanike, përciptas. Kurse e irregullt është që lutjet të venë në lokalitet, atje të thërriten fshatarët e interesuar dhe njerëzit e aparatit të lokalitetit që të shikohet se kur e ka drejtuar ky apo ai fshatar lutjen. Shihet në mbledhje p.sh. lutja e filan fshatarit, kur e ka pësuar këtë dëm për të cilin ankohet. Kur të shihen lutjet e fshatarëve në lokalitet, shoku i lokalitetit që e njeh, ngrihet dhe i thotë se nuk është e vërtetë ajo që ngrë ai në lutje në rast se fshatari nuk ka të drejtë. Kështu përzgjidhjen e problemeve luftojnë shumë njerëz e jo vetëm një dhe kështu do të zgjidhen çështjet më me drejtësi. Kjo metodë pune duhet ndjekur për tërë problemet jo

vetëm për ato të bujqësisë, kështu për arësimin, për sigurimin e fuqisë punëtore etj.

Problemin e nxjerrjes së fuqisë punëtore tani në lokalitet nuk kemi njeri që ta ndjekë. Këtë punë e bën vetë fshati. Po lokalitetit ju duhet t'i dërgoni planin, të cilin duhet ta studjojë në bazë të gjendjes civile, duke parë sa njerëz p.sh. janë në filan fshat, së janë nga 17-18 vjeç, sa gra janë, sa tokë të punueshme ka fshati, sa që, sa njerëz duhen për të gjitha këto punë dhe për të tjerat. Në bazë të këtyre të dhënavë bëhet llogaria dhe del se në këtë fshat taprojnë 30 vetë. Studjohet sa bukë bën fshati dhe çdo familje veç e veç dhe për sa muaj. Kihet parasysh që të shkojnë punëtorë, në radhë të parë ata që mbarojnë më shpejt bukën dhe bëhet plani në fshat se këta njerëz do të shkojnë në këtë muaj, këta të tjerët një muaj më vonë e kështu me radhë. Pas këtij studimi mblidhet fshati dhe i paraqitet plani që ka studjuar këshilli. U thuhet fshatarëve se shtetit ne mund t'i japim kaq njerëz, prandaj duhet të vendoset në këtë mbledhje se kush do të vejë. Këshilli del me propozime dhe thotë që ne mendojmë që të vejë filani dhe filani. Pas kësaj diskutohen propozimet e këshillit dhe më në fund arrihet në një konkluzion. Në fund firmoset një lloj kontrate dhe vendoset të shkojnë në radhë të parë ata që nuk kanë bukë. Lokaliteti ngarkon një njeri të merret me këtë çështje dhe ai e ndjek. Kur përfundon ky problem në të gjitha fshatrat, rezultatet ua dërgon juve në rreth dhe ju pastaj dikastereve duke u thënë që në këtë muaj do t'u dërgojmë kaq punëtorë dhe muajin tjetër aq, prandaj nuk duhet të kërkonit më përpara. Ministria e Ndërtimit dhe

dikasteret e tjera duhet t'u japin një avancë prej 5 ose 7 ditësh për arësyen se nuk ka mjete transporti. Prandaj ministria e interesuar duhet t'i bëjë llogaritë në këtë drejtim për të gjitha rrethet dhe t'u vihet pastaj detyrë të gjitha këshillave të lokaliteteve që ta ndjekin çështjen fshat më fshat dhe shtëpi më shtëpi. Tani ka një farë forme pune për këtë çështje, po duhet të bëhet në mënyrë më të organizuar, nuk duhet të kufizohet puna vetëm me propagandë.

Pastaj e rëndësishme është edhe çështja e përdorimit të flamujve dhe e garave socialiste që mbeten në kartë. Në lokalitetet në çdo mbrëmje duhet të vijnë korrierë nga të gjitha fshatrat me informata, sa është korruar në këtë fshat dhe sa në atë tjetrin. Me një fjalë, në kohën e fushatave në lokalitetet duhet të zhvillohet një jetë e gjallë duke ardhur aty çdo mbrëmje korrierrë të fshatrave, vullnetarë nga rinia për të sjellë informata dhe të shihet se kujt i takon të marrë flamurin. Sot atë e mori ky fshat, po nesër e merr ai tjetri. Tani nuk bëhen kështu këto gjëra, kështu që nuk dihet se kush ecën më mirë e kush më ngadalë. I është dhënë njërit para katër muajsh flamuri i ministrisë. Ka kaq kohë e flamuri rri në zyrë, nuk i është dërguar të interesuarit. Kjo është serioze. Prandaj komiteti ekzekutiv i lokalitetit duhet t'i vërë rëndësi edhe metodës së punës, pse, po të çalojë kjo gjë në një hallkë, të tëra do të çalojnë. Në rast se ti, si kryetar i komitetit ekzekutiv, nuk i vë njerëzit përpara përgjegjësisë, nuk kërkon që njerëzit të kryejnë detyrat që kanë lidhje me këto probleme, edhe sikur ta bësh mirë mbledhjen e komitetit ekzekutiv, të këshillit popullor të lokalitetit, puna

prapë është e çalë. Çështja e tokës, e rendimenteve, e kulturave bujqësore, po të mos studjohet drejt, do të mbetet në hava, po kur të jenë në rregull këto, kur të luftohet si duhet, edhe diskutimet në mbledhje do të jenë të rregullta. Rrethet deri sot nuk i japid as ndihmë as rëndësi lokalitetit. Të gjitha problemet sot janë përqëndruar për t'u zgjidhur në rreth dhe lokaliteti ka mbetur pa asnje kompetencë. Me këtë metodë edhe sikur të tërë punonjësit të jenë të mirë në rreth, një pune të tillë nuk mund t'i dilet. Kësaj i thonë burokraci, kësaj i thonë të largohesh nga kontrolli, nga pushteti i popullit, pse pushteti në bazë ka dobësi, kurse ti çdo gjë e bën drejtpërdrejt me të. Po të zgjidhen problemet në lokalitet ty do të të mbetet kohë të zgjidhësh ato probleme që të takojnë, pse do të lehtësohesh, mbasi shumë çështje do t'i zgjidhin edhe të tjerët, pse duhet edhe ata të punojnë dhe ti të ndihmosh e të kontrollosh zbatimin e vendimeve. Ka disa gjëra që duhet t'i bësh vetëm ti, po punët e tjera duhet t'i bëjnë vartësit e tu dhe ti të kontrollosh. Po t'i kesh kuptuar mirë problemet, do të jesh në gjendje t'i ndihmosh si duhet vartësit e tu. Kështu ti do të mund të shkosh edhe në lokalitet dhe të shohësh p.sh. çështjen e lutjeve që u drejtojnë fshatarët, ose vjen çështja e hapjes së shkollave ose për kooperativat e shitblerjes. Dhe jo të shkosh sa për të thënë vajta, por për të ndihmuar, për të kontrolluar dhe për të vënë punën në vijë. Nga ana tjetër njerëzit duhet t'i shpiem më mirë në lokalitet se sa të mbeten këtu. Në rreth të qëndrojnë kuadrot kryesorë për të zgjidhur fillimin e çështjeve kryesore. Aty duhet të rrijë agronomi, pse tanë për tanë nuk

kemi shumë dhe do të ishte ideale për ne po të kishim një agronom në çdo lokalitet. Në rreth duhet të rrijë shefi i seksionit të bujqësisë, veterineri, pastaj gjithë teknikët e tjerë të venë në lokalitet. Edhe një pjesë e mirë e buxhetit duhet të vejë në lokalitet. Shumë njerëz do të zgresin poshtë e pastaj do të shohësh ti që nuk do të kesh nevojë as për nënkyetar të komitetit ekzekutiv, pse baza do të punojë si duhet. Sikur të pyesim Partinë dhe t'i themi: duke u forcuar lokaliteti do të lehtësohet puna, po na jepni tani 10 vetë për t'i bërë kryetarë lokaliteti, Partia në minutë do të na i sigurojë këta duke zgjedhur shokë energjikë dhe që të kuptojnë mirë situatën. Po kështu edhe për të tjerët më poshtë. Pastaj duhet të caktohet edhe nga një organizator partie në çdo lokalitet. Kështu në lokalitet do të ketë 7-8 vetë të fortë, do të janë atje edhe nja dhjetë komunistë nga fshati dhe do të kemi me këtë mënyrë një organizatë bazë me 20-25 vetë me në krye një kryetar lokaliteti dhe një organizator partie. Kur të shtrohet çështja e grumbullimit në lokalitet nga ana e pushtetit, organizatori i Partisë do të shkojë menjëherë në organizatën bazë, t'ua shtrojë këtë problem komunistëve nga ana e Partisë. Kështu fillohet nga puna dhe zgjidhen këto gjëra, por kështu si bëhet tani, nuk mund të gjejnë zgjidhjen e duhur. Ju keni instruktorë në rrethe që kontrollojnë pushtetin, po për këta do të janë më të qarta detyrat me këtë organizim, kurse tani pse të vejë poshtë, për të ndenjur kot. Ti vetë i bën atij në fshat konferencë për forcimin e pushtetit dhe për probleme konkrete dhe nuk bëhen mbledhje e nuk orientohen njerëzit se si të punojnë. Kjo ka rëndësi të madhe.

Përsa i përket çështjes nëse del nevoja në lokalitet të ketë ndonjë instruktor për çështje pushteti, këtë do ta studjojmë, po e rëndësishme është që të spostojmë pak drejtimin në lokalitet, se atje është baza dhe këto probleme duhet të zgjidhen në lokalitet dhe me popullin, kurse tani bëhen të tëra nga rrethi e drejt me këshillin e fshatit dhe është e natyrshme që nuk mund të zgjidhen drejt. Prandaj duhet të përpinqemi se si e si t'i vëmë në jetë këto rregulla.

Ne nuk duhet të shtojmë njerëz me rrogë në fshat, mund t'i japim pak më shumë kryetarit, por po të bëhet kështu si thamë, mobilizohet më shumë fshati vullnetarisht, se çështja e bujqësisë është atje, vetëm se kjo duhet të bëhet në këtë formë.

Ju nuk do të merreni me të gjitha dhe kjo do t'ju lehtësojë mjaft që të kontrolloni më shumë dhe të ndihmoni për zbatimin e vendimeve. Ju tani çdo gjë e zgjidhni me fshatin, kurse atje nuk kemi veçse një njeri me 400-500 lekë në muaj. Puna edhe atje mund të bëhet mirë, po jo si tani që lihen kaq njerëz pa aktivizuar. Prandaj i shihni këto çështje në këtë drejtim.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbajtur në këtë takim, që gjendet në AQP

MBI PUNIMIN E REZOLUCIONEVE TË KONGRESIT II TË PPSH NË AKTIVET DHE ORGANIZATAT BAZË TË PARTISË NË TERREN DHE NË USHTRI

Nga diskutimi në Plenumin II të KQ të PPSH

27 qershor 1952

Natyrisht punimet e rezolucioneve të Kongresit II të Partisë kanë pasur një rëndësi jashtëzakonisht të madhe dhe i kanë sinjalizuar udhëheqjes shumë dobësi që ekzistojnë në Parti. Gjithashtu udhëheqja ka një ide të qartë të forcës së Partisë, të anëve të mira të punës së Partisë, të sukseseve etj. Ato që u thanë këtu janë shumë instruktive dhe duhet të na shërbejnë për të ardhshmen dhe të gjitha janë të drejta. Vetëm një gjë dua të theksoj që është karakteristike dhe e drejtë. Partia në bazë ka kritikuar udhëheqjen, Komitetin Qendror, aparatet e tij dhe të qeverisë, komitetet ekzekutive, ato të Partisë etj. Këto kritika janë me bazë dhe këto dobësi në udhëheqje duhet të na preokupojnë jashtëzakonisht. Këto dobësi i kemi konstatuar, por masat që kemi aplikuar në praktikë për t'i ndrequr ato nuk kanë qenë në lartësinë e duhur dhe vazhdimisht ka pasur lëshime të rëndësishme në këtë drejtim. Të

marrim një çështje që duhet të na preokupojë, atë të udhëheqjes së Partisë. Partia duhet të udhëheqë gjithë jetën e vendit tonë, por kjo gjë bëhet me ngritjen ideologjike dhe teknike të drejtuesve të aparati të KQ dhe të komiteteve të Partisë, ashtu edhe të atyre të bazës, po në radhë të parë më shumë të udhëheqjes kryesore. Natyrish të çdo muaj e vit punët tona bëhen më të mëdha, më të gjera, më specifike, më të komplikuara dhe ne nuk i përgjigjemi dot si duhet kësaj situate dhe disa herë në mënyrë të përciptë, megjithëse ka përparime. P.sh. nevojat e mëdha të ndërtimit të ekonomisë, të bujqësisë, na kanë shtyrë të përqafojmë metodat e reja shkencore, si ato sovjetike, në çdo sektor të punës, të cilat nuk i kemi përtypur mirë në udhëheqje dhe kemi kujtar se jemi në gjendje që vetëm me një të hedhur të një parulle ose me futjen e një forme organizative ose metode të re të kryejmë deri në fund punën tonë. Faktet na tregojnë se kjo është shumë pak dhe ngjet që futen forma organizative, hidhen parulla, futen forma pune, metoda të reja etj. Të gjitha këto venë në bazë dhe nuk gjejnë aplikimin e vërtetë. Po pse? Sepse ato nuk shoqërohen këmba-këmbës me një shpjegim të qartë duke marrë parasysh se sa të dobët e kemi bazën dhe barrën e madhe që ka ajo për realizimin e këtyre punëve të rënda, të gjera dhe specifike. Ne vetë nuk jemi të armatosur për të kuptuar në gjerësinë e tyre këto forma që të mundim së bashku me shokët e bazës t'ua shpjegojmë mirë çështjen nga të katër anët, t'i zbatojmë dhe të kontrollojmë zbatimin e tyre. Kjo nuk bëhet dhe do të vazhdojë kështu, në rast se udhëheqja nuk do ta

marrë seriozisht këtë çështje. Tani mund të themi se nuk kemi specialistë, agronomë, inxhinierë aq sa duhet. Po a ka mundësi dhe a do të bëhet me këta kuadro që kemi e me një edukim më sistematik të tyre të ecim më përpara? Po, ka mundësi, po t'i racionallizojmë forcat e specialistëve, sepse ne i jemi qepur një pune rutine, burokratike. Kështu p.sh. kur një shok shkon të kontrollojë çështjet financiare ose ato të ndërtimit etj. këtë e bën në bazë të disa rregullave dhe formave që janë caktuar, të disa udhëzimeve tip që janë dhënë dhe ai ato ka në kokë. Shumë herë edhe kuptimi i tyre politik dhe teorik nuk dihet fare. Kështu është e natyrshme që kur ky të vejë poshtë, udhëzimet do t'i transmetojë në mënyrë automatike, pse horizonti i tij është i ngushtë dhe pasurohet vetëm me disa gjëra praktike. Që t'i studjojë këto nga ana financiare dhe teorike, ai nuk bën përpjekje dhe ne vetë nuk e bëjmë një gjë të tillë, po përqëndrohem i një prakticizëm shumë të dëmshëm. Shumë herë instruktorët e Partisë marrin rolin e një instruktori të pushtetit dhe, po ta shohim mirë çështjen, do të gjejmë një paralellizëm shumë të madh, pse del si ajo që thotë Josifi¹, që i vijnë Komitetit Qendror gjëra shumë të vogla. Për instruktorët është shtruar që ata nuk duhet të interesohen për çështje pa rëndësi, pse ata janë instruktorë të Komitetit Qendror që e dinë thelbin e çështjes jo vetëm nga ana praktike, por edhe teorike e shkencore dhe janë caktuar të shkojnë për të ndihmuar Partinë se si t'i zgjidhë problemet që i paraqiten, si nga ana

¹ Josif Pashko, në këtë kohë ishte sekretar i KQ të PPSH.

politike, ashtu edhe organizative. Për çështjet e tjera duhet të luftojnë njerëzit nga ana e pushtetit me drejtoren e ndërmarrjeve. Shoku instruktor i Komitetit Qendror duhet të vijë këtu dhe të na thotë thelbin e problemeve që i dalin bazës, prandaj po të orientohet mirë instruktori i KQ, gjërat nuk do të na vijnë kështu në aparatin e KQ për disa çështje të thjeshta administrative se duhen kaq e aq kv. fasule ose një kamion, pse nuk është KQ i Partisë ai që do të zgjidhë çështje të tilla, por organet e pushtetit.

Pastaj është edhe çështja tjetër që duhet të na preokupojë, ajo e kompetencave të organeve të bazës, komiteteve të Partisë, komiteteve ekzekutive të k.p. që kemi shpjeguar disa herë dhe që duhet të jetë e qartë për të gjithë. Mirëpo provat na tregojnë se çështjet nuk janë kuptuar drejt se përndryshe do t'u ishin hapur horizonte të gjithë shokëve, kurse kjo nuk bëhet, të tërë presin të flasë sekretari i parë ose i dytë dhe ne jemi të kënaqur me një gjë të tillë. Ne kemi marrë shumë vendime që janë të drejta. P.sh. themi të forcohen kooperativat fshatare dhe ne këtu do të qëndrojmë, nuk do të shpejtohemi në ngritjen e kooperativave të reja, këtë e përsëritim vazhdimisht, por konkretisht, për ta detauar, për të marrë vendime, për të përcaktuar si do të bëhet forcimi i kooperativave ekzistuese, për këtë duhet të ketë një plan të veçantë. Duhet vajtur në organizatat bazë të kooperativave dhe kjo direktivë e Partisë të shpjegohet nga ana politike dhe ekonomike dhe e gjithë Partia, në radhë të parë të kuptojë rëndësinë që ka forcimi i kooperativave ekzistuese, për nxjerrjen e bujqësisë nga prapambetja. Kjo

gjë të bëhet në mënyrë të detajuar, d.m.th. të armatosim organizatën bazë jo vetëm me një formulë që është e drejtë, por edhe me zgjidhjen e drejtë të problemit. Ne kujtojmë se këto çështje i kuptojnë të gjithë, kurse nuk është kështu, prandaj duhet medoemos t'i ndihmojmë shokët poshtë, t'ua zbërthejmë problemet shokëve, t'u hapim atyre perspektiva dhe t'i ndihmojmë konkretisht. Por këtë gjë ne nuk e bëjmë.

Vjen çështja e forcimit të lokalitetit që është një hallkë me rëndësi e pushtetit, por që e kemi të dobët, prandaj duhet ta forcojmë dhe për këtë është dakord i gjithë Komiteti Qendror. Por para se të zgjidhet ky problem duhen marrë masat. Për këtë Komiteti Qendror duhet të ngarkojë Byronë Politike që të punohet seriozisht qysh tanë nga ana e Drejtorisë së organizimit dhe e komiteteve të Partisë që në lokalitetet të zgjidhen kryetarë të mirë, shokë me perspektivë e me shkollë. Për ta të caktohet një shkollë të paktën për 4-5 muaj deri në fillim të vitit të ri dhe pastaj të venë të zënë vendet. Kjo është një anë, po jo e gjitha. Unë këtë e shtroj në Komitetin Qendror që shokët në të gjithë sektorët të mendojnë mirë në mënyrë që çdo sektor ta detajojë mirë e me perspektivë të gjithë punën që nga ministria e deri në bazë dhe ta lidhë këtë punë konkretisht me kompetencat e rretheve dhe të lokaliteteve e fshatrave; për bujqësinë p.sh. duke filluar që nga shtruarja e planeve e deri në korrje, shirje etj. Se ne mund të dërgojmë njerëz të mirë, po duhen ndryshuar shumë gjëra, duhen transferuar shumë njerëz, duhet çdo dikaster ta shohë me shumë kujdes çështjen e kompetencave që do t'i lihen lokalitetit. Ne ja kemi

përcaktuar kompetencat lokalitetit, po asnjë njeri nuk është përkujdesur për zbatimin e tyre të drejtë. Ne nuk mund të kënaqemi me këto forma organizative, po duhet të insistojmë që këtë punë që ja lëmë ta drejtojë lokaliteti duhet t'ua ripërsëritim, t'ua bëjmë të qartë nga të tëra anët dhe t'i ndihmojmë e t'i kontrollojmë njerëzit atje vazhdimisht. Prandaj shokët duhet të mendojnë dhe duhet t'u caktojmë edhe detyra që në një kohë këtë çështje ta kemi të mbaruar, pse të tëra këto na sjellin vështirësi në punë. Ka padrejtësi që u bëhen fshatarëve ca nga njerëzit e pandërgjegjshëm, ca nga padituria dhe ca nga rregullat që kemi ne tani. Po të zhvillojmë një punë të shumanshme, padrejtësitë, pakënaqësitë, lutjet dhe kërkesat do t'u zgjidhen më mirë popullit. Sigurisht gjërat nuk mund të ndreqen në një vit, po duhet të punohet që këto të ndreqen sa më parë dhe për këtë janë të gjitha mundësitë.

Çështjes së bujqësisë duhet t'i vihet rëndësi e posaçme. Aparatet e bujqësisë, sidomos seksionet e bujqësisë në aparatet e Partisë dhe në ato të komiteteve ekzekutive, ashtu edhe Drejtorinë e bujqësisë në aparatin e KQ duhet t'i forcojmë. Po si? Të heqim ata që janë sot unë nuk jam i mendimit, po edhe një agronom që kemi në aparatin e KQ të mos e dërgojmë për çështje grumbullimi. Pastaj ashtu sikurse thashë edhe më lart shokët e Drejtorisë së bujqësisë duhet të mësojnë shkencën dhe teknikën dhe të mos bëjnë punën e njerëzve të thjeshtë të bujqësisë. Shokët që punojnë në aparatet e Partisë duhet t'i drejtojnë ata të pushtetit, t'u hapin perspektiva etj. etj. Një përmirësim i tillë i metodës së punës duhet të na preokupojë dhe të ndiqet

me kujdes të madh kjo çështje. Po kështu edhe në rrëthe ka njerëz me eksperiencë, po që janë mjaft të dobët nga ana teorike, prandaj ata duhet t'i forcojmë nga kjo anë.

Një gjë tjetër që duhet të kemi parasysh është që mbledhjet t'i shkurtojmë se bëhen mjaft të gjata. Kur nuk zgjidhen problemet, kur nuk realizohen planet, atëhere vetëvetiu edhe mbledhjet vijnë duke u shtuar, po derisa një sektor shkon mirë nuk ka nevojë të bëhen mbledhje. Për shkak të mosrealizimit të planeve bëhen shumë mbledhje. Natyrisht, kur drejtuesit nuk marrin masa brenda kompetencave, bëhen mbledhje pas mbledhjesh dhe humbet shumë kohë e vlefshme, të cilën sikur t'ja kushtojmë çështjes së edukimit dhe ngritjes së kuadrit si dhe kontrollit në bazë të vendimeve, ne do të kemi më shumë suksese në realizimin e detyrave, pse këto janë gjëra më të frutshme se mbledhje të zvarura dhe pa asnje rezultat.

Përsa u përket çështjeve organizative të Partisë përsëri dolën shumë gjëra dhe Drejtoria e organizimit në Komitetin Qendror duhet të punojë më mirë dhe më me sistem, d.m.th. jo në mënyrë të shkëputur, duke dërguar ndonjë telegram ose me ndonjë vërejtje, por t'i studjojë mirë të dhënat nga ana e organizatave bazë dhe komiteteve të Partisë. Atyre duhet t'u bëhet një analizë marksiste-leniniste dhe shkencore dhe të edukohen instruktorët e kësaj drejtorie që lidhin qendrën me komitetet, pse janë instruktorët e Komitetit Qendror ata që udhëzojnë e ndihmojnë instruktorët e komiteteve të Partisë, të cilët pastaj mbajnë lidhje më të afërta me bazën. Edhe problemet e tjera si ato që kanë të

bëjnë me shkeljen e Statutit të Partisë, me forcimin e disiplinës etj. t'ua shtrojnë njerëzve poshtë jo në një mënyrë të thatë, po në formë të qartë, që të krijojmë me të vërtetë punëtorë partie. Përsa u përket çështjes së organizatave të Partisë dhe çështjeve politike, ashtu si thamë edhe për Drejtoren e bujqësisë, kuadrot që drejtojnë këta sektorë duhet të mësojnë shkencën, të dinë të zgjidhin problemet mbasi të kenë studjuar anën teorike. Thyerja e disiplinës duhet të luftohet. Kur merren masa disiplinore ndaj një kuadri që thyen disiplinem, kjo i duhet shpjeguar mirë gjithë Partisë nga ana teorike dhe praktike se çfarë dëmi i shkaktohet Partisë, pushtetit dhe planit të shtetit. Një rast i tillë duhet të shërbejë si një shkollë e madhe edukimi dhe jo vetëm të informohet Partia në mënyrë të thatë. Partia ka mjaft probleme, prandaj duhet të studjohen dhe duhet medoemos të studjohen imtësisht raportet e komiteteve të Partisë dhe ato të instruktorëve të Komitetit Qendror. Pastaj duhet të mblidhet medoemos kolektivi i instruktorëve, të shpjegohen këto probleme edhe nga ana teorike dhe masat që duhen marrë, në mënyrë që të zgjidhen drejt, kështu lartësohen shokët dhe nuk mbeten prakticienë të thjeshtë. Prandaj kjo çështje që ngrihet për anën organizative të Partisë, më duket se në këtë mënyrë duhet të studjohet dhe të shtrohet nga ana e Drejtorisë së organizimit.

Çështjen e kuadrit do ta shtrojmë në mbledhjen e ardhshme të Komitetit Qendror, po vihet re se nuk ka interesimin e duhur nga shokët e Komitetit Qendror që drejtojnë dikasteret dhe nuk mund të ecet në këtë mënyrë. Ushtria e ka zgjidhur drejt çështjen e preqatitjes

së kuadrit, ajo i ka në rregull kurset e shkollat, prandaj ajo nxjerr dhe mëson kuadro në mënyrë sistematike. Po tē mos bëhej kjo gjë nuk do tē kishte ushtria kuadro. Neve na raportojnë se ministrat nuk shkojnë tē shohin si funksionojnë teknikumet e dikastereve tē tyre, andej nga do tē dalin kuadrot e tyre, kurse nga tē katër anët po bërtasin pér mungesa në organikë ngaqë nuk kanë kuadro. Ata nuk iñteresohen se ç'po bëjnë degët e kuadrove tē dikastereve tē tyre tani në kohën e provimeve në teknikumet. Kush eshtë kujdesur pér këtë problem? Asnjë. Atëherë çfarë interesimi mund tē tregohet pér kuadrin? Më duket se ne duhet t'i kush-tojmë një kujdes shumë tē madh këtij problemi. Edhe Komisioni i Planit duhet tē tregojë më shumë interesim dhe t'i vërë, si Byronë ashtu edhe qeverinë, më mirë në korrent tē këtij problemi kryesor që po na bën tē na dhëmbë koka. Prandaj plani duhet tē shkarkohet nga gjërat e vogla dhe tē ndiqen më mirë nga ana e Komisionit tē Planit problemet më tē rëndësishme dhe tē mos ecet në mënyrën si eshtë ecur deri më sot.

Çështja e ndërtimit do tē analizohet. Po fakti eshtë se ndërtimet janë shumë prapa. Shumë arësyte nxirren pér çështjen e mosrealizimit tē planit tē ndërtimeve. Disa prej tyre janë me baza, disa tē tjera natyrisht nuk kanë asnjë bazë. Puna në sektorin e ndërtimit eshtë e rëndë, por organizimi nuk eshtë i shëndoshë, kontrolli eshtë i dobët, ana financiare nuk eshtë në rregull, po kështu edhe çështja e mungesës së projekteve.

Edhe çështja e administrimit tē mjeteve financiare eshtë një gjë shumë serioze, pse janë me të vërtetë miliarda lekë që shpenzon shteti dhe duhet tē dihet

se ku shkojnë këto para të popullit. Prandaj Ministria e Financave ka shumë të drejtë të vërë rregull dhe bile në mënyrë absolute. Duhet me qenë shumë të rreptë në këtë çështje. Në asnje objekt që mbarohet të mos bëhen shpenzime të tepërtë për zbulime të panevojshme etj. Të tregohet kujdes në caktimin e preventiveve për objektet që ndërtohen se ndodh që caktohet një shumë prej 2 milion lekësh për ndërtimin e një objekti dhe na del më vonë se u dashkan 30 milion lekë që ai të përfundojë. Këtu më duket se nuk jemi në rregull. Mund të ndodhë që të kërkohet një milion lekë më shumë ose të të taprojnë një milion lekë nga shuma e parashikuar, po jo të kërkohet plus një shumë e tillë kolosale. Ne do të bëjmë për ndërtimet e objekteve industriale aq sa janë mundësitë tona, shpenzime të tjera jashtë mundësive tona nuk lejojmë.

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

FJALA E MBAJTUR NË KONGRESIN E DYTE TË BRPSH

29 qershor 1952

Shokë dhe shoqe të rinisë,

Komiteti Qendror i Partisë së Punës në mbledhjen e tij plenare që mbajti në datën 27 të këtij muaji, më ngarkoi t'i sjell kongresit tuaj dhe nëpërmjet tij të gjithë të rinxve, të reja ve dhe pionicerëve të vendit tonë përshëndetjet më të nxehta e më të përzemërtë dhe t'ju uroj suksese të mëdha në punimet tuaja.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë konstaton me gëzim të madh, se rinia heroike e vendit tonë, ka përshkuar një rrugë të lavdishme, plot luftëra heroike për çlirimin e popullit dhe për ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë. Ajo ka korru fitore të panumërtë në çdo lëmë, sepse ajo ka ndjekur orë e çast me besnikërinë më të madhe mësimet dhe direktivat e Partisë, ajo ka përvetësuar me etje të madhe eksperiencën e komsomolit të lavdishëm të Lenin-Stalinit. Rinia jonë e mrekullueshme është treguar e zonja në çdo gjë, e guximshme, patriote, realiste, e pamposhtur përpara vështirësive, të cilat kurdoherë

i ka kapërcyer me sukses dhe ka korrur kurdoherë fitore në interesin e saj dhe të popullit të vet.

Shokë dhe shoqë të rinisë,

Në epokën e lavdishme që ne jetojmë dhe luftojmë për socializmin dhe për një paqe të qëndrueshme, një rol madhështor dhe vendimtar luan rinia. Vetëm në ato vende ku është vendosur diktatura e proletariatit dhe regjimi i demokracisë popullore, që është një formë e kësaj diktature, ekziston liria, demokracia dhe popujt janë sovranë, vetëm në këto vende rinia ka gjetur të gjitha mundësitë dhe ndihmën e pakufishme për të realizuar ëndrrat e saja të bukura. Provat e kësaj gjëje janë të gjalla dhe bindëse edhe te nc.

Çdo gjë është e re dhe e fortë në vendin tonë, që nga kombinatet madhështore, që nga traktoret dhe kombajnat, që nga institutet e larta, që nga kopshtet e çerdhet ku luajnë dhe rriten të gëzuar fëmijët e punëtorëve dhe deri te garda e vjetër e çelnikët e Partisë sonë.

Ne i jetojmë ndryshimet e mëdha që bëhen në vendin tonë dhe jemi ndërtuesit e rindës së Shqipërisë së re socialiste. Është titull i lartë për çdo qytetar të Republikës së Popullore të jesh ndërtues, krijues, të transformosh natyrën, t'i bësh fushat të bukura, t'i ujitësh, të prodhosh sa më shumë grurë, pambuk, misër, të veshësh malet dhe kodrat me drurë të rindës, të ndërrrosh shtratet e lumenjve dhe t'i vësh këta në shërbim të ekonomisë popullore, të ngresh hidrocentrale; të ndërtosh hekurudha, të transformosh mentalitetin

e vjetër të njerëzve dhe t'i bësh këta të rrojnë të gjëzuar e të lumtur. Të gjitha këto i bëjnë njerëzit me vullnet të mirë, njerëzit e tipit të ri, që të edukuar dhe të udhëhequr nga mësimet e Leninit dhe të Stalinit, punojnë dhe luftojnë me vetëmohim për çështjen e përgjithshme të popullit. E tillë është rinia jonë heroike e kalitur dhe e udhëhequr nga Partia jonë e lavdishme. S'ka ndryshim, s'ka përparim, s'ka realizim në vendin tonë që të mos ketë markën e rinisë, që të mos ketë kulluar në të djersa e rinisë, që të mos jetë shkrirë në të dituria, guximi, sakrifica, patriotizmi i shkëlqyer i rinisë sonë. E reja ndërton të renë, ështëjeta e re që ngrihet për të rintjtë, vrulli dhe entuziazmi i të cilëve i bën pleqtë të rinj.

Të gjitha këto realizime madhështore që janë arritur në interesin e popullit tonë në një kohë kaq të shkurtër i detyrohen udhëheqjes së drejtë të Partisë sonë që me besnikëri ndjek rrugën e Stalinit dhe të Partisë Bolshevikë dhe u siguron kështu masave të gjera punonjëse të vendit tonë një jetë çdo ditë e më të begatshme, i siguron Shqipërisë indipendencën, sovranitetin dhe paqen.

Por Partia, populli dhe rinia jonë nuk dehen nga sukseset e arritura. Ne e dimë se kemi akoma shumë e shumë për të bërë dhe Partia është e sigurtë se rinia do të ecë e guximshme në rrugën e fitoreve të reja.

Të mbështetur në realizimet e arritura deri sot dhe me ndihmën e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore, ne po punojmë për realizimin me sukses të planit të parë pesëvjeçar të vendit tonë.

Kjo është një ndërmarrje kolosale për ne, është një hap i madh, i guximshëm, por i mundshëm, drejt zhvillimit dhe forcimit të ekonomisë populllore. Këtë vepër të madhe të Partisë dhe të pushtetit e priti me entuziazëm të madh klasa jonë heroike punëtore, rinia dhe mbarë populli. Të gjithë janë të ndërgjegjshëm për të mirat që do t'i sjellë popullit realizimi me sukses i planit pesëvjeçar, të gjithë janë të ndërgjegjshëm se për realizimin e këtij plani duhet të mobilizohen totalisht të gjitha energjitet e popullit. Asgjë nuk fitohet me duar lidhur, çdo gjë fitohet me luftë, me përpjekje, me sakrifica, me heroizma.

Të mos kujtojmë se plani ynë pesëvjeçar do të mund të realizohet pa një luftë të pamëshirshme kundër mbeturinave të klasave sunduese, të cilat do të aktivizohen dhe ato për të na dëmtuar në mënyrë të hapët ose të fshehtë. Duhet të mprehet vigjilencia në kulm dhe të goditen këta armiq pa asnje pikë mëshire. Të mos kujtojmë se nuk do të ndeshemi dhe nuk do të luftojmë kundër vështirësive, kundër mungesave, kundër burokratizmit etj. Jo, këto do t'i hasim në rrugë, do t'i luftojmë dhe do t'i kapërcejmë. Vështirësitë, pengesat dhe lufta kundër armiqve të hapur ose të maskuar, të cilët na njohin mirë se ç'kokë kemi, kurrë s'na kanë trembur dhe kurrë nuk do të na frikësojnë, kurrë nuk jemi gjendur dhe as do të gjendemi ndonjëherë të çarmatosur, armiqtë i pret varri dhe ne, si kurdoherë, na pret fitorja.

Rinia jonë heroike e ka kuptuar më së miri rëndësinë e madhe të planit të parë pesëvjeçar, e ka kuptuar se ky plan përfaqëson të ardhshmen edhe më të lumtur

të saj dhe të popullit të vet. Fakti është se ajo ka thirrur Kongresin e saj të dytë që mbahet sot, posaçërisht për të shtruar detyrat që i ngarkohen rinasë në këtë plan madhështor që me të drejtë ajo e quan planin e ndërtimit të jetës së saj.

Drejt i ka shtruar rinia në këtë kongres detyrat dhe aktivitetin e saj. Paraqitje e shëndoshë ashtu siç është realiteti, me suksese dhe me të meta, me frymë të kritikës dhe të autokritikës, me siguri të plotë në forcat madhështore të saja, me siguri të patundur në fitoret e ardhshme dhe me dashuri e besnikëri të pafund për popullin e vet, për Partinë e vet, për Stalinin dhe për komsomolin. Sigurisht se kongresi i juaj do të jetë në lartësinë e duhur dhe diskutimet që do të zhvillohen këtu do të tregojnë edhe një herë tjetër pjekurinë tuaj, vendosmërinë tuaj për ta bërë organizatën e Bashkimit të Rinisë një nga levat më luftarake të Partisë.

Më lejoni të theksoj disa çështje që ju duhet t'i keni parasysh edhe në punimet tuaja.

Ju e dini nevojën e madhe për kuadro të mësuar dhe të edukuar që lypin momentet e ndërtimit të bazave të socializmit. Organizatës së rinisë i vihet si detyrë të mobilizojë të gjitha forcat e saja në këtë drejtim. Detyra e juaj kryesore, pra, është të mësoni. Të gjitha mundësitë janë krijuar për ju nga shteti dhe Partia. Një rrjet i gjerë shkollash, kursesh, teknikumesh, institush të larta, është ngritur në vendin tonë. Të rintjtë dhe të rejat duhet t'i ndjekin me kujdesin më të madh mësimet, të mbarojnë me sukses dhe të jenë shembull në detyrë dhe në punë, të çojnë në fshat, në fabrika, në miniera diturinë e fituar, ta vënë atë në

shërbim të kolektivitetit. Shteti ynë, ekonomia jonë, kanë nevojë si për kuadro të lartë edhe për kuadro të mesëm dhe punëtorë të kualifikuar. Ekonomia jonë pret çdo ditë me padurim kontingjente të rinjsh dhe të rejas që mbarojnë shkollat e mesme të bujqësisë, teknikumet e ndryshme, kurset e kualifikimit.

Organizata e rinisë duhet të ketë kurdoherë para-sysh që me punën e saj organizative dhe politike të ndihmojë Partinë dhe shtetin në këtë drejtim; vlerat e rinisë të mos rrinë të fjetura, ose të shpërndara në punë jo shumë prodhimtare. Organizata e rinisë duhet të ketë shumë kujdes veçanërisht për rinninë fshatare; të mos lërë asnjë të ri fshatar që ka kryer një shkollë, qoftë fillore, të mbetet me kaq, në një kohë që kurse e shkolla të panumërt presin kontingjente të rinjsh për të plotësuar numrin e nxënësve. Ministria e Arësimit jo vetëm që duhet të ndjekë me kujdes jetën arësimore të çdo nxënësi, por e ka për detyrë ta ndihmojë shumë në këtë drejtim organizatën e rinisë, pse këtu është çështja në interesin e vetë të riut ose të resë lidhur ngushtë me interesin e kolektivit. Në këtë drejtim ka dikastere që kanë nën drejtimin e tyre shkolla, teknikume dhe kurse, por nuk tregojnë interesimin e duhur për edukimin e elementeve të rinj të klasës punëtore. «Mendojmë më shumë të realizojmë planin», thonë shumë drejtorë e nëndrejtorë ndërmarrjesh, por s'mendojnë se kush do ta realizojë këtë plan, s'mendojnë sa duhet se janë kuadrot që do ta bëjnë këtë, se është klasa jonë punëtore heroike që në numrin e saj dërmues përbëhet nga punëtorë dhe punëtore të rinj. Ka interesim të dukshëm për nevojat e klasës punëtore, konditat e punonjësve janë

përmirësuar shumë, po ka edhe shumë neglizhenca të dënueshme, nga dikasteret dhe nga ndërmarrjet, që duhen goditur pa mëshirë. Klasa jonë punëtore nuk kërkon krevat me pupla, por ajo që i është caktuar nga shteti duhet t'i jepet pa u vonuar. Është e dënueshme të mos tregohet një kujdes jashtëzakonisht i veçantë prej të gjithëve, për punëtorët e rinj që deri dje s'dinin të shkruanin e të lexonin, kurse sot ata kanë marrë në duart e tyre dhe drejtojnë e vënë në lëvizje me aq sukses, me aq heroizëm, me aq pjekuri maqineritë moderne që kemi, siç janë sondat sovjetike të naftës, Kombinati i tekstileve «Stalin», kombinati i sheqerit, kombinati i drurit, fabrika e pambukut, kinostudioja etj. etj. A është e lejueshme të mendojmë vetëm për realizimin e planit dhe të mos mendojmë njëkohësisht për edukimin sa më të plotë të punëtorëve, për kualifikimin e tyre teknik, për edukimin politik, për mënyrën e jetesës dhe të nevojave të tyre? Kurrsesi s'është e lejueshme. Ne, tok me bazat e socializmit, ndërtojmë dhe kalitim njëkohësisht klasën tonë të re punëtore, pa të cilën s'mund të ketë pushtet popullor, s'mund të ndërtohet socializmi. Prandaj rinia duhet të jetë mbështetja luftarake e Partisë dhe e klasës punëtore për edukimin e kuadrove, kualifikimin e tyre dhe të jetë e pamëshirshme kundër atyre që pengojnë, ose neglizhojnë në këtë drejtim.

Rinia të bëhet një mbështetje luftarake e Partisë dhe e klasës punëtore në forcimin e aparatit shtetëror dhe të këshillave populllore.

Të rinxjtë dhe të rejat duhet të janë armiqtë më të tmerrshëm të burokratizmit, të javashllékut, të punës

pa perspektivë, të vjedhësve dhe të sabotatorëve. Këto janë nga sëmundjet më të rrezikshme që mund të rrezikojnë pushtetin tonë, për të cilin u derdh gjaku i shenjtë i rinisë dhe i popullit. A do t'i lejojë Partia, klasa punëtore dhe rinia jonë këto të zënë vend në jetën tonë të re? Sigurisht jo, dhe sigurisht do t'i luftojmë pa mëshirë kudo dhe kurdoherë që të shfaqen.

Organizata e rinisë duhet të ketë parasysh detyrën e madhe, të forcojë në rini ndjenjën e mbrojtjes së pushtetit popullor, të modernizimit dhe të demokratizimit sa më të madh të tij, të rrënjosë disiplinën në punë, ndjenjën e përgjegjësisë dhe të organizimit, shpirtin metodik në mësim dhe në punë, të ngjallë urejtjen më të madhe kundër armiqve të popullit tonë dhe të kampit të socializmit e të paqes, kundër bishave imperialiste amerikane etj., kundër banditëve të Beogradit e shokëve të tyre.

Organizata e rinisë ta edukojë vazhdimisht rininë me patriotizmin e flaktë për popullin dhc Republikën tonë Popullore, ta rritë dhe ta ushqejë me besnikëri të pafund për Partinë e Punës, për Partinë Bolshevikë, për Bashkimin Sovjetik, për Stalinin.

Organizata e rinisë t'i rritë dhe t'i edukojë të rintjtë me mësimet e Partisë dhe me frymën e internacionallizmit proletar, dhe ta bëjë rininë luftëtare të pampa-shtur të paqes, të fitoreve të popullit, të mbrojtjes së atdheut tonë të lirë dhe sovran.

Në raportin e Komitetit Qendror të Rinisë u vunë në dukje sukseset politike dhe organizative të organizatës suaj, u vunë gjithashtu në dukje dhe gabimet. Më

lejoni të theksoj dhe t'ju këshilloj që çështjen e sektarizmit që shfaqet në punën tuaj, në lidhje me organizimin dhe forcimin e organizatës suaj duhet ta luftoni.

Fakti është se në këtë drejtim nuk e keni pasur sa duhej vëmendjen tuaj.

Është gabim të përpinqesh të aplikosh në organizatën e rinisë po ato forma organizimi, atë disiplinë të hekurt që kërkohet në Parti. Shokët komunistë që punojnë me rininë nuk kanë pasur shumë kujdes për të ruajtur karakterin special të punës me rininë, për zbatimin e rregullave që ndryshojnë nga ato të Partisë. Është e domosdoshme që të ketë organizatë bazë te ju, por organizata juaj bazë nuk mund dhe nuk duhet të jetë e njëllojtë me atë të Partisë. Këtë duhet ta kenë parasysh shokët e Partisë që punojnë me rininë dhe jo ta ndërtojnë dhe t'i japid organizatës suaj bazë po ato tipare, po ato rregulla, po atë disiplinë të hekurt, po atë konspiracion që duhet medoemos të ekzistojë në organizatën e Partisë. Organizata juaj bazë duhet të jetë më elastike, shumë më e hapur, drejtuese dhe nxitëse për organizimin e aktiveve të gjera të rinisë ku të marrin pjesë me shumicë të rinj e të reja, të organizuar dhe të pa organizuar, të aktivizohen këta në detyrat që u cakton organizata e rinisë, të diskutojnë, të kritikojnë e të marrin vendime bashkërisht. Me një metodë pune të tillë këto aktive të gjera, të drejtuara nga organizata juaj bazë do të grumbullojnë gjithë rininë patriote të vendit, do ta bëjnë çdo të ri e të re një luftëtare të vërtetë. Kështu do të shtohen radhët e organizatës suaj, në luftë, në punë dhe jo me dekrete, me fushata; kështu në çdo fshat do të kemi organizata bazë, do të kemi aktiv të

gjerë të rinisë dhe jo me vendime e me dekrete nga lart. Për ju kanë pasur shumë rëndësi aktiv i sekretarët e organizatave bazë, por aktivin e gjerë ju e keni nënvlefësuar. Tamam për ta bërë të gjallë këtë aktiv të gjerë mblidhet dhe punon organizata juaj bazë. Edhe mbledhjen e organizatës bazë ju zakonisht e bëni shumë të myllur. Në shumë raste edhe organizata bazë e Partisë bën mbledhje të hapura, thérret aktivistë pa parti të qendrës së saj të punës, të dëgjojnë, të sugjerojnë, të kritikojnë pa të drejtë vote.

Ju sa më shumë duhet ta praktikoni këtë gjë. Në interpretimin e rregullave të statutit tuaj përsëri keni shfaqje sektarizmi dhe çoni në organizatën e rinisë rigorozitetin e Partisë, si për shembull në çështjen e pranimit të anëtarëve të rinj. Komiteti Qendror i Partisë është informuar se ka mjaft raste që mbahen të rinj të thjeshtë, patriotë, fshatarë e punëtorë, përparrë komisionit të pranimit, me orë të tëra në pyetje, i bëni të dërsijnë, të hutohen dhe kur dalin nga dera thonë «uf, shpëtova!». Të veprosh kështu në rini nuk është e drejtë. Rinia nuk është Parti, por është organizatë e masave të rinisë, me rregullat, me statutin, me disiplinën e saj, por që s'janë njëlloj me rregullat, me Statutin dhe me disiplinën e Partisë.

Besoj se e keni të qartë këtë çështje. Sigurisht pas analizës që i bëri Komiteti Qendror i Partisë kësaj çështjeje dhe pasi ja vuri në dukje Komitetit Qendror të Rinisë këtë sektarizëm që është shfaqur, janë bërë përmirësimë dhe janë ndrequr mjaft gjëra, por aty akoma duhet të keni kujdes. Zhdukja e sektarizmit do ta gjallërojë organizatën tuaj, do të mobilizojë masën dër-

muese të rinisë, do të rritet organizata juaj me elementë të rinj, të shëndoshë e të pastër. Shokë të Komitetit Qendror të Rinisë, më kanë thënë se gjoja është problem te ju çështja e fëmijëve të kulakëve: «T'i futim apo jo në organizatë». Unë nuk kuptoj pse të jetë ky një problem i pazgjidhshëm. Sigurisht rinia ka për detyrë t'i ndreqë këta, t'i edukojë, t'i bëjë të vlefshëm dhe jo t'ja japë armikut. Kjo s'është në interesin tonë. Baballarët e tyre kulakë, janë njerëz të këqinj, armiq të pushtetit dhe të popullit tonë. Ata s'janë në rrugën tonë dhe s'mund të vijnë në këtë rrugë, ata janë kundër saj. Por fëmijët e tyre që janë të rinj mund të ndreqen, për këtë duhet të bëjmë përpjekje. Po a mund të flitet për djem të kulakëve, kur ju harroni ose neglizhoni të futni me mijëra të tjerë të rinj fshatarë të varfër dhe të mesëm, t'i mobilizoni dhe t'i aktivizoni në aktive të gjera? Në luftë e në punë njihen njerëzit, atje njihet besnikëria e tyre. Në qoftë se veprohet kështu, atëhere është fare e lehtë të vendosësh a e meriton apo jo një djalë kulaku nderin e madh të jetë anëtar i organizatës suaj. Kështu është drejt të vihen dhe të zgjidhen çështjet, mendoj unë.

Jua bëra këto vërejtje si shok më i madh juaji, natyrisht për të mirë dhe këtë jam i sigurtë se ju e kuptoni drejt, por ju kritikoj aq sa keni faj, pse në këtë çështje faji s'është vetëm juaji. Kanë faj edhe organizatat bazë të Partisë edhe komitetet e Partisë në rrethe. Interesimi i tyre për punën e rinisë nuk ka qenë aq i madh dhe i vazhdueshëm. Disa drejtues të Partisë në rrethe mendojnë se rinia ka forumet e saj dhe s'duhet të preokupohemi shumë. Janë gati t'i kërkojnë rinisë

në çdo çast, por, t'i japin rinisë, pak i luajnë këmbët dhe pak lodhin trutë. Ata që mendojnë dhe veprojnë kështu, s'janë në rregull, s'janë në rrugën e drejtë të Partisë. Rinia është gjëja më e çmueshme për jetën e Partisë, ajo është e ardhshmja e saj. Të rintjtë janë anëtarët e ardhshëm të Partisë, janë garda e re, janë gjaku i ri dhe i kulluar që gjallëron Partinë, që çelnikos Partinë. Unë jam i bindur se ju dhe ne, duke i njobur haptas këto të meta, do t'i korrigojmë shpejt dhe do të korrim suksese edhe më të mëdha në rrugën tonë të lavdishme ku na udhëheq Partia.

Kam edhe një çështje të fundit: Kam parasysh një letër që i ka ardhur Partisë nga disa të reja korçare të cilat i luten Partisë t'i ndihmojë ato të vijnë të punojnë në Kombinatin e tekstileve «Stalin». Kjo është dëshira e zjarrtë e këtyre vashave të reja, por për fat të keq ato pengohen nga paragjykimet e dëmshme dhe nga mbeturinat e fanatizmit të prindërve të tyre. Ato kërkojnë nga Partia që të ndërhyjë. Unë i falenderoj këto të reja për besimin e madh që ato kanë te Partia jonë dhe sigurisht që Partia do t'i ndihmojë, sigurisht që prindërit e tyre do ta dëgjojnë fjalën e Partisë.

Nga kjo tribunë e kongresit të rinisë unë u lutem si shok, si vëlla, këtyre prindërve, t'i dëgjojnë me vëmendje dëshirat dhe aspiratat e drejta dhe të lavdërueshme të vajzave të tyre. Unë mendoj se dëshirat e këtyre të rejave korçare janë të drejta, janë legjitime dhe të natyrshme. Është një gjë shumë e dëmshme dhe e shëmtuar t'i pengosh ato në rrugën e tyre të jetës, të punës, të nderit. Shpejt ose vonë këta prindër, sigurisht, do ta kuptojnë se kanë bërë një padrejtësi, kanë bërë një

gabim të madh ndaj fëmijëve të tyre, të cilët duan të ndërtojnë jetën e tyre, të gëzojnë jetën e tyre të re. Unë jam i bindur se këtë gjë këta prindër do ta kuptojnë. Dikush mund të thotë, më mirë vonë se kurrë. Unë s'jam i atij mendimi, por jam i mendimit më mirë shpejt se vonë, pse këtu është çështja për lumtérinë e fëmijëve. Këta prindër e duan lumtérinë e fëmijëve të tyre, por mendojnë se vetëm duke i ndrydhur brenda mund t'u sigurojnë këtë lumturi. Natyrisht ata gabohen rëndë, por fajin, e drejta është të mos ua hedhim të gjithë atyre. Të mendojmë errësirën, fanatizmin e regjimeve të kaluara, që mbyste popullin dhe i zinte frymën. Ako- ma dhe akoma duhet të luftojmë kundër këtyre tme- rreve të së kaluarës që rëndojnë në shpirtin dhe në supet e njerëzve. Detyra jonë është të çajmë errësirën dhe mjegullën. Detyra e Partisë, e organizatës së rinisë, e organizatës së gruas është me i sqarue këta njerëz të thjeshtë të popullit, që kështu ta shohin qartë ku është e mira dhe e keqja dhe të zgjedhin rrugën e mirë. Unë u them këtyre prindërve se është fare e kotë me u përpjekë me e mbajtë rininë të ndrydhur nën prangat e paragjykimeve dhe të fanatizmit; i riu s'mund t'i durojë këto, ai do të rrojë i lirë, ai është me të renë që ngrihet dhe ndërtohet. Çdo gjë, të riun dhe të renë, e thërret në punë, në shkollë e kudo. Me dhjetëra mijëra gra e vajza, kudo në fabrika, në kombinate, në shkolla, punojnë të lumtura për jetën e tyre, të familjeve e të kalamanëve. I riu dhe e reja është si ajo kokrra e vogël e grurit që në vjeshtë hidhet në tokë, mbulohet nga toka e rëndë, por toka atë s'e mposht. Kjo kokërr gruri për muaj të tërë të vjeshtës dhe të dimrit lufton me

errësirën e tokës, me elementët e natyrës dhe ja, kur vjen pranvera, ajo e çan tokën, i thyen prangat dhe vështirësitë dhe hidhet përpjetë, rritet, zbuluron natyrën, formon kallinë dhe grurin e florinjtë që kënaqë mban gjallë njerëzit. Kështu është edhe me të rinjtë e me të rejat. Në atdheun tonë ndërtohet socializmi, lulëzon pranvera. A është e drejtë dhe a ka mundësi që t'ua vonosh sado pak pranverën të rinjve? Jo, kjo s'duhet dhe është e pamundur, aq sa është e pamundur që një fshatar që quhet fshatar, të mos dojë, ose të mund të pengojë farën e grurit të mbijë, të rritet dhe të piqet.

Mbeturinat e bejlerëve dhe të agallarëve në vendin tonë përpinqen të mbajnë gjallë fanatizmin dhe t'u pësshpëritin disa njerëzve të thjeshtë se gjoja s'e ka dhënë zoti që gruaja, o e reja të vejë në punë, s'e ka dhënë zoti që gruaja të dalë e lirë dhe pa perçë, pse i prishet nderi, kurse këta banditë dhe vajzat e tyre s'lënë derë pa trokitur për të fituar një copë bukë. Feja, perçja, u shërbejnë këtyre për të mbajtur të tjerët në errësirë, në injorancë për të livadhisur lirisht në kurrizin e të tjerëve. Këta mendojnë të nxjerrin kështu disa fitime: të pengojnë ndërtimin e bazave të socializmit, të pengojnë përparimin, të mund të futen vetë në fabrika dhe në aparatet shtetërore, për të mbajtur frymën gjallë dhe për të sabotuar nga brenda, për të vjedhur, për të grabitur pasurinë dhe djersën e popullit. Ka pasur raste që disa të reja të cilat kanë mbaruar kurset për financë, të qëndrojnë me muaj pa punë dhe të frikësohen të punojnë në degën e financës. Pse ngjet kjo? Pse shumë elementë të klasave borgjeze, që punojnë në aparatet e financës dhe të tregëtisë, zhvillojnë një propagandë të

stërholluar dhe djallëzore jo vetëm duke i përcmuar këto kuadro të rinj, por edhe i frikësojnë duke u thënë «ju nuk dini dhe do të humbisni në llogari, pastaj ju pret burgu, pse shteti nuk bën shaka ndaj atyre që dëmtojnë pasurinë e shtetit». Në këtë mënyrë ata përpiken të skartojnë nga drejtimi dhe kontrolli njerëzit e popullit, të bëhen të pazëvendësueshëm, të krijojnë një terren më të lehtë për vjedhje dhe abuzime në kurriz të popullit. Çupat e bezlerëve dhe të agallarëve janë gati të nxjerrin një sy, për t'u futur si endëse në Kombinatin e tekstileve «Stalin», por nga ana tjetër s'përtojnë t'u pëshpëritin në vesh disa njerëzve të thjeshtë, që të mos i dërgojnë vajzat e tyre në punë, pse atje do të prishen, do të shkatërrohet familja e të tjera përralla. I pyes ata prindër për të cilët bëhet fjalë: a do t'i lejojnë këta matrapazë të fesë dhe të interesave të popullit, të dëmtojnë interesat e popullit dhe të familjes së tyre vëçanërisht? Sigurisht që jo. Ka ardhur koha, pra, të sqarohen edhe ata pak njerëz që mendojnë gabim në lidhje me lirinë dhe të ardhshmen e vashave dhe të grave të tyre dhe t'i zhdukin këto pengesa pa kuptim dhe të dëmshme.

Shokë dhe shoqe të rinisë,

Ju i kuptioni mirë momentet e rënda ndërkombëtare. Imperialistët amerikanë dhe satelitetët e tyre, kërkojnë t'i vënë përsëri zjarrin botës, të përsëritin në një shkallë edhe më të tmerrshme tmerret e fashistëve hitlerianë. Ata duan të gjakosin popujt dhe rininë e botës. Po të

ishte çdo gjë në duart e kanibalëve amerikanë, dhe të shërbëtorëve të tyre titistë e monarko-fashistë; gjithë bota do të ishte ndezur si Koreja e lavdishme që u bën ballë me heroizëm barbarëve të luftës bakteriologjike dhe të bombave me napalm, vrasësve dhe torturuesve të të rinjve dhe të të rejaqe të Koresë e të Kinës. Por fati i paqes është në duart e popujve dhe popujt do ta mbrojnë atë me të gjitha forcat. Kampi ynë i paqes dhe i socializmit është më i fortë se kurrë, pse ai ka në krye Bashkimin Sovjetik dhe udhëhiqet nga Stalini. Ne jemi kundër luftërave. Neve na dhimbsetjeta e njerëzve, për ne njeriu është thesari më i çmuar, ne nuk duam të na digjet dhe të na përvëlohet atdheu ynë që e çliruam me gjak dhe e ndërtuam me gjak e me djersë, ne nuk duam që bombat e armët bakteriologjike të na shfarosin rininë tonë të mrekullueshme, ne nuk duam që mëmat tona të vishen në zi. Por në rast nevoje ne do të luftojmë me të gjitha forcat, për të mbrojtur vendin tonë. Në do të ndërtojmë, vazhdimisht dhe me sukses, atdheun tonë për lumturinë e njerëzve tanë, për lumturinë e rinisë sonë.

Ne do ta mbrojmë dhe do ta ruajmë me vigilencën më të madhe lirinë, indipendencën dhe sovranitetin e atdheut tonë, që është më i fortë se kurrë, për lumturinë e popullit dhe të rinisë sonë.

Ne iurrejmë me të gjitha forcat e shpirtit tonë, imperialistët amerikanë dhe satelitët e tyre, titistët, monarko-fashistët grekë, fashistët italianë dhe të çdo ngjyre qofshin dhe u themi atyre, poshtë duart e gjakosura, poshtë luftërat agresive, mos i prekni vendet dhe popujt tanë, pse do të thyeni kokën.

Rinia jonë trime të qëndrojë si kurdoherë vigjilente dhe e papërkulur në ballë të luftës për mbrojtjen e paqes, për mbrojtjen e popullit dhe të atdheut nga çdo rrezik, për ndërtimin e socializmit. Partia jonë heroike, që udhëheq popullin dhe rininë në rrugën e ndritur të socializmit, do ta ndihmojë me të gjitha forcat e saja rininë e vendit tonë, të edukohet dhe të rrojë në lumturi, do ta bëjë Republikën tonë akoma më të bukur, më të begatshme dhe më të fortë.

Komiteti Qendror i Partisë më ka ngarkuar t'i dorëzoj kongresit tuaj një flamur të Partisë sonë, në shenjë dashurie të pakufishme që Partia ushqen për brezin e ri të vendit tonë, në shenjë merite dhe lavdërimi për patriotizmin tuaj të flaktë, për heroizmat dhe sakrificat tuaja në interes të popullit, në interes të ideve të pavdekshme të leninizmit dhe të paqes. Le t'ju prijë si kurdoherë përpara flamuri i Partisë sonë në rrugën e ndritur të socializmit dhe të paqes, ku na udhëheq mësuesi ynë i lavdishëm, Josif Visarionoviç Stalin.

Rroftë rinia jonë heroike!

Rrofshin pionierët dhe pionieret e vendit tonë!

Lavdi Partisë sonë heroike!

Lavdi dhe jetë të gjatë Stalinit të madh!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i Popullit»
Nr. 158 (1166), 30 qershori 1952*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

MBI KATEGORIZIMIN E PUNËTORËVE DHE TË NËPUNËSVE

Nga diskutimi në Byronë Politike të KQ të PPSH¹

4 korrik 1952

Çështja e pagave në vendin tonë është një rregulator i madh, që ka të bëjë me politikën e Partisë, me ekonominë dhe punën e njerëzve. Me të vërtetë ne bëmë një hap përpara me zbatimin e kategorizimit të ri që tani është në fuqi, vendosja e të cilit në bazë të eksperiencës sovjetike ka treguar se është i drejtë. Po edhe në këtë kategorizim ka të meta, sidomos në koeficientet²

¹ Në këtë mbledhje të Byrosë Politike u diskutoa mbi kategorizimin në fuqi dhe nevojën e rishqyrtimit të tij. Kategorizimi i ri i punëtorëve dhe i pagave të nëpunësve, kishte hyrë në fuqi më 17 dhjetor 1949. Ai likuidoi mjaft shrrregullime që ekzistonin në kategorizimin e vjetër dhe çështjen e pagave e vuri në baza më të drejta. Megjithkëtë jetë nxirrte probleme të tillë, për zgjidhjen e drejtë të të cilave patën rëndësi të madhe orientimet që dha në diskutimin e tij shoku Enver Hoxha.

² Është fjala për koeficientët e pagës orare, që u vendosën për punëtorët sipas kategorisë së punës të secilit, ndërsa për nëpunësit u caktua rroga mujore fikse.

dhe në disproporcjonin e pagave të punonjësve të administratës në krahasim me ata të prodhimit.

Unë jam dakord që të kemi 7 kategori, por kam një vërejtje: në përgjithësi kategoritë e para i kemi djegur. Mua më duket se kjo s'është e drejtë. Pse të hiqen nga libri i kategorizimit kategoritë e para? Atij që porsa fillon punën i jepet kategoria më e ulët me më pak lekë në orë. Po aq le të marrë edhe për 3-4 vjet më radhë, në qoftë se nuk do të bëjë përpjekje për të mësuar. Po nuk u fillua kategorizimi i punëtorëve nga më i ulëti te më i larti, do të vazhdojë të ndodhë që të mos kemi njerëz për në kurset e kualifikimit, pse të gjithë duan të punojnë menjëherë në kategorinë IV ose V. Sigurisht, duke nisur paga nga kategoria e I, vetëvetiu e ardhura do të ulet për një pjesë të punëtorëve. Këtë ta respektojmë me rigorozitet të madh, pse ndryshe, duke u paguar punëtori menjëherë për kategorinë III, ne vetë sanksionojmë që të gjithë të marrin mbi tremijë lekë e lart. Atëhere, ku do të shkojë ai punëtor pas 40 vjetëve, sa rrogë do të marrë? Në këtë rast vetë norma këtu është një rregulator. Po të thyhen ato gjithnjë, prodhimi do të shtohet dhe ne do të kemi ulje çmimesh në artikujt industrialë dhe bujqësorë. Ne duhet të bëjmë një politikë të tillë që të ecim duke ulur çmimet shtetërore dhe të bujqësisë dhe kjo do të bëjë që rrogat të mjaftojnë. Sigurisht, ai që është në kategorinë II, do ta shtërngojë më shumë rripin, do të jetë pak më ngushtë ekonomikisht, po që të marrë më shumë, duhet të punojë, të studjojë dhe të specializohet, pse kështu do të ngrihet në kategori. Lidhur me këtë dua të theksoj edhe një çështje tjetër: kur njerëzit ngrihen në

kategori, duhet të kontrollohen nëse u përgjigjen kërkesave përkatëse të kategorisë që do të marrin.

Në kategorizimin që kemi, jemi bazuar në parimet e BS, të cilat janë të drejta, por koeficientet ne duhet t'i zbatojmë në konditat tona dhe duke pasur parasysh sakrificat që duhet të bëjnë punëtorët dhe nëpunësit tanë. Kur ne vendosëm këtë kategorizim nuk kishte fare norma që është stimuli kryesor. Ne kemi shkuar nga parimi që t'u japim punonjësve rroga të tillë me të cilat ata të rrojnë mirë dhe kemi krijuar kështu gjithë këto çrregullime. Këtë ne duhet ta ndryshojmë patjetër, jo duke i marrë në provime punëtorët nëse e meritojnë ose jo kategorinë që kanë sot¹, por duke e vendosur këtë disiplinë tanë e tutje.

Jam dakord t'i favorizojmë njerëzit e prodhimit, por mendoj që kjo të bëhet më shumë me anën e tejkalimit të normës se sa me anë të pagesës bazë. Ai që prodhon më shumë, lodhet më shumë, prandaj edhe duhet të shpërblehet më shumë edhe kjo na intereson se kështu shtohet prodhimi. Po të bëhet kjo, ai që është në administratë e ka të mjaftueshme rrogën se do të ulen çmimet nga puna më e mirë e punëtorëve, të cilët duhet të marrin edhe më shumë. Me një fjalë norma këtu duhet të jetë kryesorja, ai që nuk realizon dhe nuk e tejkalon normën, le të mbetet me tremijë lekë në muaj. Ata që punojnë në administratë duhet ta kenë

¹ Kishte mendime që të gjithë punëtorët të kalonin në provim për kategorinë që kishin, gjë për të cilën s'kishte akoma ndonjë studim. Në të njëjtën kohë duhej organizuar më mirë puna për edukimin tekniko-profesional të punëtorëve.

të qartë se puna e tyre nuk krijon të mira materiale, kurse puna e punëtorëve është ai faktor, që do të përmirësojë edhe jetesën e nëpunësve. Megjithkëtë punonjësit e administratës duhet t'i favorizojmë pak më tepër se sot në rrogën bazë, se ajo është fikse, por kjo të jetë një gjë e vogël. Kur një punëtor kalon në administratë, të ketë një farë shtese. Sidoqoftë ne nuk duhet të ecim nga parimi që teknikun e kualifikuar ta bëjmë nëpunës, ai të mbetet në prodhim, të ngrihet, të bëhet inxhinier, drejtues i prodhimit. Duke u bërë inxhinier ai do të marrë një pagë të caktuar në muaj, veç asaj po të tejkalohet plani do t'i takojë të marrë edhe disa shpërblime të tjera dhe në këtë mënyrë ai do ta përballojë më mirë jetesën. Pra punëtorët e kualifikuar të ngrihen në prodhim dhe jo në administratë, por edhe po të vijë në administratë punëtori duhet ta kuptojë që këtu puna e tij do të jetë më e lehtë, prandaj edhe rrogën do ta ketë më të vogël¹. Pakënaqësitet që janë tanë për kategorizimin na vijnë nga punonjësit e administratës dhe jo nga punëtorët ose teknikët e mesëm.

Kryesorja për ne është të shtohet prodhimi dhe të ulen çmimet, nga kjo duhet të orientohemi dhe jo duke ngritur pagën bazë. Kush kërkon më shumë të ardhura, këtë duhet ta fitojë me punë, me djersë. Ai që tejkalon normat, meriton të hajë më mirë. Pagën bazë ne duhet ta rishikojmë dhe nga ana ligjore të bëjmë zbritje në ndonjë kategori pune, po kjo të stu-

¹ Shoku Enver kritikoi propozimin e gabuar që bënte komisioni i ngritur për këtë qëllim sipas të cilit «po të ngrihen punëtorët në vende drejtuese, rroga e tyre duhet shtuar».

djohet mirë. Meqenëse themi që normat kanë rëndësi, atëherë duhet bërë një studim aktual i tyre dhe i pagesave përkatëse, të cilat duhet të janë progresive.

Edhe në administratë duhet të ketë stimul për arësimin dhe vjetërsinë. Rroga bazë mund të jetë më e ulët se tani, po duhet të merret parasysh edhe shkolla e secilit. Tani ne kemi teknikume dhe institute të larta dhe kemi mundësi që njerëzit t'i nxitim t'i vazhdojnë ato e të paguhën sipas arësimit. Në aparatet e Partisë ne e kemi vënë si ligj që shokët duhet të mbarojnë shkollën e mesme, kjo mund të bëhet edhe për administratën shtetërore dhe të arrihet që një kryetar dege me shkollë dhe vjetërsi të marrë 2 000 lekë më shumë nga ai që është i ri dhe që ka edhe më pak shkollë. Por sa të mbarojë njeriu universitetin do shumë kohë, ai do të hajë sot, prandaj koeficienti i vjetërsisë të jetë pak më i madh dhe kjo të kihet parasysh që nga viti 1944.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

FRONTIN DUHET TA BËJMË NJË ARMË AKTIVE QË TË MBËSHTETË VIJËN E PARTISË

*Fjala e mbylljes në mbledhjen e Këshillit
të Përgjithshëm të Frontit Demokratik
të Shqipërisë*

8 korrik 1952

Eshtë e kuptueshme rëndësia e madhe që ka kjo mbledhje për vetë faktin se kemi përpara një problem të madh siç është çështja e zgjedhjeve për pushtetin lokal. Në këtë mbledhje u dha edhe raporti mbi aktivitetin e Frontit dhe u pa se organizata jonë ka korrur suksese të shumta, të cilat dihen dhe u vunë në dukje nga shokët. Por nuk përjashtohet fakti se në punën e organizatës dhe të forumeve të saj ka të meta, formalizëm dhe neglizhenca. Këto duhet të kemi kujdes të gjithë, t'i zhdukim.

Frontin duhet ta bëjmë një armë aktive dhe jo të ndryshket e të mbetet formale, ta bëjmë të mbështetë vijën, direktivat e Partisë dhe të qeverisë, ta bëjmë të tillë që të aktivizojë masat për realizimin e planit pesëvjeçar të shtetit, të ngrejë nivelin kultural dhe politik të popullit, të edukojë masat, të luftojë fanati-

zmin, paragjykimet e dëmshme, të luftojë armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm. Fronti të armatosë popullin tonë me urrejtjen kundër imperializmit dhe ta demaskojetë këtë në çdo orvatje të tijën.

Fronti disa herë mbetet formal dhe mbledhjet e tija bëhen të pa pregititura dhe pra, disa herë të mëritshme, pse dilet me fjalime tipc dhe nuk shtrohen e nuk rriven probleme konkrete që janë të shumta në jetën e popullit tonë. Në rrugën tonë ka vështirësi. Si mund të kapërcehen këto vështirësi? Natyrisht, duke marrë pjesë i gjithë populli, duke i shtruar përpara masës këto probleme dhe tok me të të zgjidhen. Kështu nuk praktikohet sa duhet, pse po të ngjiste kështu, Fronti do të bëhej akoma më i gjallë, më aktiv, sidomos në fshat ku s'ka organizata profesionale. Njerëzit e Partisë dhe ata pa parti duhet ta kuptojnë se, po të mos e gjallërojmë Frontin dhe ta bëjmë luftarak, domethënë të shtrojmë atje problemet, të ketë atje kritikë ndaj të metave, ndaj atyre që s'kryejnë detyrat, të ketë atje luftë të ashpër kundër armiqve, spekulatorëve, dëmtuesve të pasurisë së shtetit e të tjera, atëhere ai do të mbetet formal. Ne nuk duam një Front formal.

Në Front kanë vend të gjithë patriotët dhe njerëzit e ndershëm. Në Front armiqtë s'kanë vend. Po sikundër u theksua edhe në raport, në organizatën tonë ka pasur sektarizëm dhe nuk u janë dhënë kartat e Frontit disa njerëzve që mbajnë qëndrim jo të keq, të cilët kanë qëndruar të ftohtë dhe indiferentë gjatë luftës, që mund të kishin rezerva kundër luftës sonë, po s'kanë luftuar aktivisht kundër popullit. Kësaj kategorie nje-

rëzish jo vetëm nuk u kanë dhënë kartën e Frontit, por u kanë ngjitur edhe etiketën e «armikut të popullit». Por çështjet duhet t'i shikojmë në dinamizmin e tyre. Pas çlirimit, me shkatërrimin e klasave sunduese, me ndryshimin e situatës, me përparimet që po bëhen në atdheun tonë, kjo kategori njerëzish pa qartë poshtërsinë dhe kalbësinë e regjimeve të kaluara e të plehrave të tyre dhe ata njerëz kanë bërë një farë ndryshimi në kokën e tyre, pse ekziston në ta një fije dashurie për atdheun, për të cilin ata fundi i fundit nuk duan që të pushtohet nga i huaji, nga imperialistët amerikano-anglezë, nga titistët jugosllavë, monarko-fashistët grekë dhe fashistët italianë. Detyra e Frontit është, pra, t'ua shtojë këtë dashuri për atdheun dhe t'i bindë edhe këta në rrugën e drejtë të pushtetit popullor. Pra, lidhur me këtë çështje, s'duhet të jemi shumë të ngurtë dhe t'i afrojmë ata që kërkojnë të punojnë për ndërtimin e vendit dhe për mbrojtjen e paqes që kërcenohet nga imperialistët amerikano-anglezë, titistë e të tjera. Por përveç sektarizmit nga ana tjetër ka pasur edhe lëshime. Kanë hyrë në Front edhe disa armiq, arrivistë dhe sharlatanë, që përpinqen të ngatërhojnë punë dhe të gënjejnë me fjalë bombastike që në brendinë e tyre fshehin qëllime armiqësore. Ndaj këtyre duhet të kemi kujdes të madh. Sidoqoftë populli ynë është shumë vigjilent, i ngritur politikisht, i zgjuar dhe e kupton shpejt se cila kambanë bie drejt dhe cila bie fals. Një Front aktiv dhe luftarak i zgjdh drejt këto të meta: ata që ndodhen jashtë dhe që paraqiten të mirë i ndjell, i afron dhe i fut brenda dhe ata që janë të këqinj, por që janë brenda, i flak jashtë.

Në Front të flasim hapur, të diskutojmë lirisht, të kritikojmë të gjithë ata që s'veprojnë drejt dhe ta vëmë çdo gjë drejt në rrugën që na mëson Partia. Në vendin tonë Fronti është i tillë, atje ka liri fjale dhe veprimi. Një fenomen i tillë nuk mund të ngjasë kurrë në vendet ku sundon borgjezia, pse regjimet kapitaliste janë kundër lirisë së fjalës dhe të veprimit të masave të gjera të popullit. Ngjet ndonjëherë që edhe në këto vende, ku partitë komuniste janë të forta dhe presioni i masave të popullit për të fituar të drejtat politike dhe ekonomike është i madh, të krijohet front kundër fashizmit dhe luftënxitësve. I tillë ka qenë Fronti Popullor në Francë¹, por borgjezia dhe partitë e saja nuk e lejuan atë të merrte frymë, por e shkatërruan, pse bëhej një rrezik i madh për ta. Fronti te ne nuk është një grumbullim partish dhe një shesh intrigash në dëm të popullit. Këtë të mirë populli ynë ja detyron vigjilencës dhe udhëheqjes së drejtë të Partisë. Disa elementë armiq të maskuar thonë: «Kush ja vë veshin Frontit, atje të gjitha punët i bën Partia». Kjo propagandë e tyre, natyrisht, ka për qëllim të dëmtojë punën e masave dhe s'është veçse një punë e tërthortë armiqësore. As është mbajtur kurrë e fshehtë se Partia që udhëheq fatin e popullit, udhëheq edhe politikën e Frontit dhe po të mos ishte Partia, s'do të kishte liri dhe demokraci në vendin tonë, por do të ishte fashizmi i gjallë dhe populli i zhytur në robëri të rëndë. Mbeturinat e reaksionit do të dëshironin të paktën të kishin një të

¹ Fronti Popullor në Francë u kriua dhe veproi në vitet 1935-1938.

ashtuquajtur parti të tyren që me ndonjë etiketë «ultra-demokratike» të fshihnin fashizmin e tyre. Por davanë e kanë humbur përgjithmonë dhe kurrë nuk do të mundin të gënjejnë popullin. Partia na mëson të forcojmë organizatën e Frontit, të lidhemi ngushtë me popullin, ta dëgjojmë popullin me kujdes, të luftojmë për popullin dhe tok me popullin.

Fronti, si gjatë Luftës nacional-çlirimtare ashtu edhe tash, luan një rol të madh për mobilizimin e masave punonjëse. E madhe dhe e shumanshme duhet të jetë puna e Frontit me rastin e fushatës së madhe të zgjedhjeve të reja të këshillave popullore. Forumet e organizatës sonë të madhe duhet të aktivizohen në këtë drejtim për t'ja bërë të qartë popullit rëndësinë politike të zgjedhjeve, forcimin dhe demokratizimin e pushtetit popullor, rëndësinë e madhe të votës që sjell me vete demaskimin dhe likuidimin e atyre elementeve që kontrabandë kanë hyrë në pushtet, e burokratëve, e dembelëve e të tjérë dhe që nxjerr përpara njerëzit e zot, besnikë të popullit, luftëtarë të pamposhtur dhe patriotë të vërtetë. Populli duhet të luftojë që në pushtet të vijnë njerëzit më të mirë të tij. Të zhdukjet mentaliteti që ekziston nganjëherë që të dërgohen në këshillat e fshatit dhe të lokalitetit njerëz që nuk prishin shumë punë, njerëz që nuk i prishin qejfin njeriut. Të kemi kujdes këtu pse lëmë njerëzit më aktivë e më besnikë jashtë pushtetit dhe ka rrezik të na futen njerëz dembelë që s'kanë mundur dot të rregullojnë shtëpinë e tyre dhe jo të rregullojnë punët e shtetit. Të zqidhesh në pushtet do të thotë të meritosh nderin më të madh, pse të besohet rregullimi i jetës së vendit, i mirëqenjes

së popullit, i zhvillimit të industrisë dhe të bujqësisë, i zhvillimit të arësimit populor. Me një pushtet të fortë shpejt do të zhduken të metat dhe gabimet që konstatohen në lidhje me problemet e fshatit, me grumbullimet, me kullotat, me shkëmbimet tregëtare e të tjera. A dëshiron populli që këto të zgjidhen drejt dhe shpejt? Sigurisht që po. Këto i zgjidh vetëm një pushtet i fortë. Prandaj në këshillat popullore duhet të venë njerëzit më të mirë, njerëzit e sakrificës, njerëzit e ndershëm, ata që duan Partinë, Bashkimin Sovjetik dhe Stalinin, ata që janë për socializmin.

Duhet një punë e madhe politike dhe organizative përfushatën e zgjedhjeve. Në të gjitha zgjedhjet e deritanishme ne kemi pasur suksese shumë të mëdha, por ne nuk duhet as të dehem, as të kënaqemi me kaq. Të kemi parasysh se këshillat e fshatit, të lokalitetit dhe të rrëthit i kemi akoma të dobëta, atje kamjaft të meta dhe mjaft burokraci. Prandaj të çojmë. atje njerëzit e shkathët që t'i zhdukin shpejt këto të meta. Duhet të kuptojmë mirë një gjë, se pushteti ynë nuk mund të jetë i fortë kur atje janë vetëm një ose dy njerëz të zot. Pushteti ynë është pushtet i masave dhe këtu qëndron forca e tij. Nuk është çështja t'i japësh një rrogë kryetarit të këshillit të fshatit dhe të mendohet se puna u zgjidh. Jo, çështja është që në këshillin e fshatit të 6-7 vetët që do të zgjidhen, të janë njerëz të zot, të punojnë të gjithë së toku dhe të vënë në lëvizje të gjitha energjitetë e fshatit. As kemi në mend dhe as që do të krijojmë kurrë një aparat burokratik në fshat, pse kjo është në dëm të popullit dhe të fshatarit vetë, por një këshill fshati i gjallë dhe

aktiv do të bëjë që fshati të përparojë. Ç'mund të bëjë vetëm një kryetar këshilli, kur s'është i rrrethuar me shokë të zot? Me një lule s'vjen behari, por behari në vendin tonë ka bërë të mbijnë shumë lule.

Partia dhe qeveria na kanë ngarkuar që ta studjojmë çështjen e pushtetit në lokalitet dhe ta forcojmë atë, pse e kemi të dobët, pse mjaft kompetenca i janë marrë atij nga rrethi, pse shumë gjëra bëhen përmbi kokën e lokalitetit, i cili është kompetent t'i zgjidhë më shpejt dhe më mirë se rrethi, pse është më afër fshatit. Shumë vështirësi që ne hasim sot në lidhje me tokat, me grumbullimet, vijnë nga kjo mungesë organizative. Në lokalitet do të dërgojmë njerëz të zot, njerëz të popullit dhe njëkohësisht të mësuar. Njerëz të tillë ka me mijëra në vendin tonë dhe po edukojmë me mijëra të tjera. Problemet që i vihen pushtetit përpëra s'janë aq të thjeshta dhe nuk mund të kryhen aq kollaj nga njerëz që nuk mësojnë dhe që nuk përparojnë, kurse ndërkohë industria përparon; bujqësia përparon me agroteknikën e re, me traktorë dhe me kombajna. Për këtë arësyte duhen njerëz të aftë dhe në rast se ne e zgjidhim mirë problemin e kuadrit do ta forcojmë edhe më shumë pushtetin tonë dhe do ta realizojmë me sukses planin pesëvjeçar.

Thirrjen e Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik për zgjedhjet e reja ta punojmë në bazë menjëherë. Të mblidhen kudo organizatat e Frontit dhe të shtrohet problemi i madh i zgjedhjeve. Çështja e zgjedhjeve të mos kuptohet e shkëputur nga të gjitha problemet e tjera me të cilat janë të okupuara masat. Pra, në këtë rast me punimin e thirrjes dhe me zhvi-

llimin e fushatës, të zhdukim të metat në punë, të plotësojmë planin e grumbullimeve, të prodhimeve bujqësore e blegtorale, të realizojmë planin në fabrika e miniera, të pregetitim mirë vitin e ri shkollor dhe më në fund detyrën kryesore, të forcojmë pushtetin me anën e zgjedhjeve të reja.

Jemi të bindur se kësaj fushate të madhe si anëtarët e Partisë edhe ata pa parti, të gjithë anëtarët e Frontit Demokratik, do t'i vënë kujdesin më të madh dhe do të korrin suksese. Në rrugën e Partisë, populli kurdoherë do të korrë suksese dhe populli e di se Partia siguroi jetën e tij dhe të brezave të ardhshëm, siguroi përjetë regjimin e demokracisë popullore dhe e mbron këtë nga armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm. Partia i ka siguruar popullit miq besnikë, Bashkimin Sovjetik dhe Stalinin e madh, i ka siguruar miqësinë me vendet e demokracisë popullore dhe me gjithë popujt e botës. Populli e ka në zemër Partinë dhe ai do t'u përgjigjet me patriotizëm të lartë detyrave që i ka vënë përpara. Unë mendoj se fitorja e Frontit do të jetë e plotë.

Ekonomia e vendit tonë dita-ditës po forcohet. Bujqësia sivjet është mirë, gruri u bë mirë, shpresojmë edhe për misrin me rënjen e shiut të fundit. Pambuku dhe panxhari paraqiten mirë. Përsa i përket planit në industri e miniera ai është gati i realizuar si gjashtë-mujor. Kjo gjë u detyrohet mobilizimit dhe heroizmave të klasës punëtore dhe të fshatarësisë punonjëse. Kjo tregon se çdo gjë rritet dhe përparon në vendin tonë, kjo tregon vijën e drejtë të Partisë. Armiqtë na kanë halë në sy, por s'kanë ç'na bëjnë kurse ne i likuidojmë

ata kudo që shfaqen. Ne do të vazhdojmë kësisoj të jemi vazhdimisht të pamëshirshëm kundër tyre. Kriminelët, parashutistët, që hedhin amerikanët dhe agjentët e tyre në kufitë tanë, ne i kemi zhdukur të gjithë si në Veri ashtu edhe në Jug. Ata s'i nxë vendi. Jo vetëm Arma e Sigurimit, por edhe populli vetë po bën mrekullira në shtypjen dhe kapjen e kriminelëve. Populli patriot e ka pushkën në dorë dhe tok me forcat e mbrojtjes së shtetit ai i zë për fytin banditët. Kjo i tërbon armiqtë, pse ata shohin sa ngushtë është lidhur populli me Partinë dhe qeveria e Partia me popullin.

Shokë, detyrën e lartë patriotike që na ka vënë Presidiumi i Kuvendit Popullor për zgjedhjet e push-tetit, ne do ta kryejmë me nder. Partia jonë e dashur që udhëheq popullin, që udhëheq Frontin, do të na çojë në fitore të plotë. Ne, anëtarët e Frontit, të punojmë intensivisht për të sigruar qind për qind pjesë-marrjen e popullit në votime dhe të votohet qind për qind për kandidatët e Frontit Demokratik.

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i Popullit»
Nr. 166 (1174), 9 korrik 1952*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**TELEGRAM URIMI DËRGUAR J. V. STALINIT MË
RASTIN E INAUGURIMIT TË KANALIT LUNDRUES
VOLLGA-DON «LENIN»**

26 korrik 1952

**KRYETARIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË BASHKIMIT SOVJETIK
SHOKUT J. V. STALIN**

Kremlin-Moskë

Në emër të popullit shqiptar, të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe timin personal, Ju lutem të pranoni urimet më të zjarrta me rastin e inaugurimit të kanalit Vollga-Don «Lenin».

Ndërtimi i kësaj vepre kolosale, të pashoqe në botë, tregon fuqinë e pakufishme të atdheut të madh të socializmit, forcën krijuese të shkencës dhe të teknikës së lartë, e pararojës sovjetike në shërbim të paqes dhe të lumturisë së popullit, hovin dhe shpirtin e lartë ndërtues dhe heroik të popullit sovjetik. Kanali «Lenin» është dëshmia e gjallë dhe madhështore e politikës leniniste-staliniane të Partisë Bolshevikë dhe të qeverisë sovjetike për paqen dhe lumturinë e popullit sovjetik. Ai është një monument i shkëlqyer i fitoreve

të ideve të pavdekshme të marksizëm-leninizmit dhc të popullit sovjetik, i cili me siguri dhe me vullnet të pathyeshëm ecën drejt komunizmit dhe lufton për të mbrojtur dhe forcuar kauzën e shenjtë të paqes në botë.

Dita e inaugurimit të kanalit madhështor «Lenin» është një ditë feste e madhe dhe fitoresh të shkëlqyera për kampin e paqes, të demokracisë dhe të socializmit.

Populli shqiptar, që sheh te Bashkimi Sovjetik dhe te Ju, shoku Stalin, miqtë dhe mbrojtësit më të mëdhenj të tij, e feston plot gëzim këtë fitore, sepse çdo fitore të popullit sovjetik ai e quan si fitore të tijën dhe si faktor me rëndësi për ndërtimin e bazave të socializmit në atdheun e tij.

Me rastin e kësaj dite historike populli ynë shpreh dashurinë dhe besnikërinë e tij të madhe ndaj Jush, mësues dhe udhëheqës i shquar i mbarë njerëzimit përparimtar.

Ju lutem, shoku Stalin, pranoni edhe një herë urimet e popullit shqiptar, të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të mijat për fitore të reja në ndërtimin e komunizmit, për mirëqenjen dhe lumbturinë e popullit sovjetik, për mbrojtjen dhe forcimin e paqes në botë.

Kryetari i Këshillit të Ministrave të RPSH

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 181 (1189), 26 korrik 1952

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 181 (1189), 26 korrik 1952

FJALA PARA OFICEREVE QË MORËN PJESE NË LOJËN OPERATIVE TË ARMATËS

30 korrik 1952

Shokë oficerë,

Ju falenderoj për përpjekjet e mëdha që keni bërë në përvetësimin e diturive ushtarake dhe për sukseset që keni arritur. Populli ynë krenohet me Partinë e tij heroike të Punës që diti të organizojë në momentet më të rënda të historisë së vendit, Ushtrinë e tij Popullore, ta edukojë atë me fryshtësinë e besnikërisë ndaj popullit dhe atdheut, ta pajisë atë me artin e lavdishëm ushtarak stalinian, ta transformojë atë nga një ushtri partizane në një ushtri të tipit të ri, në një ushtri moderne. Juve ju takon merita e madhe, shokë oficerë dhe gjeneralë, bij nga më besnikë të popullit dhe të Partisë, përkëto përparime që ka bërë Ushtria jonë Popullore, arma më e fuqishme e diktaturës së proletariatit, arma që siguroi fitoren e revolucionit popullor, arma që mbron me vigjilencë fitoret e popullit dhe kufitë e shenjtë të atdheut tonë.

Ju jeni plotësisht të ndërgjegjshëm, shokë oficerë, përrrezikun e madh që kërcënons vatrat tona, kampin

tonë të paqes dhe të socializmit. Rreziku i një lufte të re botërore, e prebatiturg nga imperializmi amerikano-anglez dhe satelitët e tij, kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore, duhet të mos nënveftësohet për asnjë minutë.

Zjarrin e luftës që kanë çuar në Korenë heroike fashistët amerikanë dhe shërbëtorët e tyre kërkojnë ta përhapin në Lindjen e Largme dhe në Evropë. Për këtë arësyje ata po prebatiten në ethe, kanë krijuar pakte agresive, kanë krijuar ushtrinë e Gjermanisë Perëndimore dhe me terror të papërshkrueshëm përpiken të shtypin lëvizjet revolucionare të popujve, që ata mbajnë nën thundër dhe që i shqetësojnë jashtëzakonisht prebatitjet e imperialistëve gjakatarë. Imperialistët amerikano-anglezë dhe agjenturat e tyre, nuk mund t'i zhvillojnë aq lehtë veprimitaritë e tyre dhe ata do të falimentojnë, pse përballë tyre gjendet i fuqishëm, i pamposhtur dhe kurdoherë triumfues kampi i madh i paqes dhe i socializmit që udhëhiqet nga Bashkimi Sovjetik dhe nga shoku Stalin. Lufta për mbrojtjen e paqes ka marrë proporcione të mëdha. Një gjë e tillë, nuk mund të ngjiste veçse në epokën staliniane dhe përfaktin e ekzistencës së kampit të socializmit me Bashkimin Sovjetik në krye. Fjalët e shokut Stalin se paqja do të triumfojë mbi luftën, në rast se popujt e mbrojnë atë deri në fund, janë bërë flamuri që udhëheq njerëzit me vullnet të mirë të të gjithë botës, në luftën përmes mbrojtjen e paqes. Populli ynë heroik lufton i pamposhtur, i patrembur përf këtë kauzë të shenjtë të njerëzimit.

Ushtria jonë heroike luan një rol të madh dhe ven-

dimitar në këto momente kaq kritike. Ushtria jonë duhet të jetë kurdoherë e gatshme dhe e pregetitur mirë ushtarakisht dhe politikisht për të përballuar çdo rrezik që mund të kërcënojë popullin, atdheun tonë dhe kampin tonë të pages e të socializmit. Gatishmëria luftarake duhet të jetë detyra kryesore e ushtrisë sonë. Populli e do ushtrinë e tij dhe ka besim të plotë te ajo. Ta meritojmë plotësisht këtë dashuri dhe këtë besim. Përgjegjësia jonë është e madhe dhe e rëndë, shokë oficerë, por ne nuk u trembemi përgjegjësive dhe punëve të rënda, ne nuk i trembemi asnjë rreziku, për mbrojtjen e popullit dhe të atdheut ne jemi kurdoherë gati për të bërë sakrificën supreme, për mbrojtjen e popullit tonë, pse kështu na ka mësuar dhe edukuar Partia jonë e shtrenjtë, që na udhëheq nga fitore.

Ushtarët dhe oficerët tanë që kanë dhënë prova të shkëlqyera të besnikërisë ndaj Partisë, popullit dhe atdheut, nuk mjafton vetëm të jenë trima, por duhet të zoterojnë si duhet edhe artin modern ushtarak. Ushtria jonë Popullore edukohet me artin e lavdishëm stalinian të luftës dhe është kjo një nga arësyet më kryesore që e çelnikos atë përditë e më shumë. Arti luftarak stalinian na bën të njohim fenomenet e zhvillimit të ligjshmërisë së luftës si fenomen shoqëror, të njohim konkretisht mënyrat e zhvillimit të luftërave, të organizimit të ushtrisë, të teknikës etj. të gjitha këto të lidhura dhe të kondicionuara me konditat materiale të jetës dhe me strukturën e klasave të shoqërisë. Mësimet e Stalinit mbi luftën dhe forcat e armatosura e kanë armatosur shkencën ushtarakë me metodën e materializmit dialektik dhe kjo është ajo forcë e madhe që e

bën shkencën ushtarake sovjetike, që ne e përvetësojmë me etje dhe me sukses, të ndërmarrë studime të shumta dhe të thella shkencore dhe të ketë një veprimitari shumë të madhe.

Shkenca ushtarake staliniane i ka hedhur poshtë dhe i ka bërë të falimentojnë kryekëput metodat e artit ushtarak borgjez, tezat metafizike të quajtura «principet e pandryshuara të artit ushtarak», si recepte «të vërteta të fitores në çfarëdo kondita të situatës». Në fushat e betejave legjendare të Ushtrisë famëmadhe Sovjetike, shkëlqyen tezat gjeniale staliniane të luftës, të zbatuara me përpikëri nga ushtarët, oficerët dhe gjeneralët e lavdishëm sovjetikë, që dërmuan ushtritë e okupatorëve nazistë dhe bënë të falimentojnë në turp metodat ushtarake borgjeze. Arti ushtarak stalinian puthitet në mënyrë të mrekullueshme me gjithë organizimin dhe veprimtarinë e pushtetit sovjetik, me sistemin ushtarak të shtetit të Sovjetëve, me bazën ekonomike të shtetit, me gjendjen social-politike, me rolin vendimtar të Partisë Bolshevikë në veprën për ndërtimin e forcateve të armatosura të shtetit sovjetik, si dhe ka kurdoherë parasysh, e pa i nënveftësuar, luftën dhe forcat e imperializmit. Ky art i mrekullueshëm luftarak, triumfues mbi forcat dhe metodat e luftës të imperialiste u arrit pse Lenini dhe Stalini zbuluan thelbin social-politik të luftërave imperialiste, zbuluan lidhjet e politikës dhe të luftës në konditat e reja të luftërave imperialiste dhe në konditat e revolucioneve proletare, pse Lenini dhe Stalini përpunuuan dhe perfeksionuan mësimet mbi luftërat e drejta dhe të padrejta, dhe marrëdhënjet në luftë, të klasës punëtore dhe të partisë së saj. Kështu që Lenini

dhe Stalini armatosën klasën punëtore dhe partinë e saj për të demaskuar me sukses ideologjinë e gjenjeshtër të kapitalizmit, të socialshovinizmit, politikën tradhëtare të socialistëve të djaftë, këtyre shërbëtorëve të ndyrë të imperialistëve që përpiken të tërheqin masat e popullit në luftërat e tyre grabitqare dhe t'i shtyjnë popujt të luftojnë e të derdhin gjak për një kauzë që s'është e tyre, por që është në kundërshtim flagrant me interesat jetike të masave punonjëse.

Arti luftarak stalinian na jep të gjitha mundësitë të përcaktojmë drejt drejtimet kryesore të preqatitjes së vendit për mbrojtjen aktive dhe për zhvillimin e luftës në fitore. Ky art luftarak na mëson rrugët dhe metodat për të njojur mundësitë e veta dhe ato të armikut, anët e forta dhe të dobëta të tija. Tezat staliniane mbi faktorët që veprojnë vazhdimesh në luftë dhe që zgjidhin fatin e luftës, karakterizojnë thelbin e shkencës ushtarake sovjetike e cila përbledh jo vetëm elementët ushtarake, por edhe faktorët social-ekonomikë dhe moral-politikë.

Në vendin tonë dhe në Ushtrinë tonë Popullore mund të gjejnë zbatim të plotë këto teza staliniane për arësy se te ne është vendosur regjimi i demokracisë popullore, një nga format e diktaturës së proletariatit, pse ekonomia jonë zhvillohet në mënyrë të planifikuar, pse shteti ynë udhëhiqet nga një Parti leniniste-staliniane që udhëheq dhe ndërton çdo gjë në bazë dhe në shembullin e Partisë së lavdishme Bolshevikë dhe pse vendi ynë dhe ushtria jonë kanë ndihmën e Bashkimit Sovjetik dhe të Ushtrisë famëmadhe Sovjetike.

Ju e dini, shokë oficerë, rëndësinë e madhe që i

vë shoku Stalin në këto teza forcës së prapavijës sovjetike për çështjen e fitores. Me forcën e prapavijës sovjetike, shoku Stalin, kupton gjithë veprimtarinë e shtetit, rendin shoqëror, politikën, ekonominë, aparatin prodhues, ideologjinë, shkencën, artin, gjendjen morale të popullit e të tjera. Duke ndjekur me besnikëri të madhe këto mësime të shokut Stalin, Partia jonë po punon me të gjitha forcat për t'i forcuar çdo ditë e më shumë prapavijat e vendit tonë. Politika e drejtë marksiste-leniniste e Partisë sonë ka bërë që të çel-nikoset uniteti moralo-politik i popullit shqiptar, të forcohet patriotizmi i flaktë dhe krijues në masat e gjera të popullit, të luftohen me sukses ideologjitet armike dhe të edukohen masat me ideologjinë e parojës marksiste-leniniste. Gjithashtu ekonomia jonë zhvillohet me të shpejtë në rrugën e socializmit, zhvillohet arësimi në popull, arti, kultura etj. Faktori i forcës së prapavijës për artin ushtarak është jashtëzakonisht i madh, pse në themelin e kësaj pasqyrohet forca dhe mundësitetë e artit ushtarak. Në këtë kompleks janë të ndërlidhura sasia dhe cilësia e reparteve, armatimi dhe furnizimi i ushtrisë, mundësitetë tekniko-ekonomike, fryma e lartë morale dhe politike e ushtrisë. Në eksperiencën e vendit tonë, u vërtetuan dhe vërtetohen në jetë tezat gjeniale të Stalinit mbi luftën. Lufta jonë nacional-çlirimtare kundër okupatorëve fashistë dhe tradhëtarëve, ishte lufta e gjithë popullit, ku u vërtetua uniteti moralo-politik dhe patriotizmi i flaktë i popullit tonë, u vërtetua morali i lartë i shqiptarit që nuk vuri gjë tjetër përmbi interesat e popullit dhe të shtetit të tij të ri që po ndërtonte. Partia jonë e laydishme i për-

forcon vazhdimisht këto me drejtësinë e vijës së saj politike dhe organizative dhe një nga shembujt më të qartë është se ajo i ka siguruar Ushtrisë sonë Popullore një prapavijë të shëndoshë në bazë të së cilës ajo mund të zhvillohet në rrugën dhe në shembullin e Ushtrisë së lavdishme Sovjetike dhe njëkohësisht i ka siguruar regjimit tonë, demokracisë popullore, një armë të fuqishme dhe besnike për sigurimin e fitoreve të arritura dhe ato të ardhshme.

Të keni kurdoherë parasysh, shokë oficerë, mësimet e Stalinit që na mëson se nuk mund të ketë mundësi për suksese të forta luftarake dhe aq më tepër për fitore të plota në qoftë se ushtria nuk do të zotërojë frymën e lartë luftarake. Për këtë gjë ne duhet të punojmë intensivisht për ta ngritur këtë në një shkallë të lartë. Fryma e lartë luftarake është një fenomen që e ka burimin nga rendi shoqëror dhe politik i shtetit, nga natyra politiko-shoqërore e forcave të tij të armatosura, nga karakteri politiko-shoqëror dhe i qëllimeve të luftës. Vetëm rendi ekonomiko-shoqëror socialist mund ta krijojë dhe e ka krijuar këtë frymë të lartë luftarake për arësyte të konditave të mësipërmë, kurse shtetet imperialiste nuk e kanë zgjidhur dhe nuk do ta zgjidhin kurrë këtë problem, për natyrën e rendit të tyre shoqëror shfrytëzues.

Rëndësi të madhe duhet t'i vini, shokë oficerë, pre-gatitjes moralo-politike të trupave dhe këtej del roli i madh i masave të marrura në punën e Partisë dhe në punën politike. Kjo punë duhet të shërbejë për ta bërë sa më të ndërgjegjshëm luftëtarin, t'i konkretizojë detyrën e tij luftarake, t'ja bëjë të qartë ushtarit se veprimitaria

e drejtë e kryer me heroizëm dhe me vetëmohim nga ana e tij, kontribuon në çështjen e përgjithshme të fitores. Duhet të forcohet çdo ditë e më shumë puna edukative e komandantëve dhe e punëtorëve politikë, të përhapet gjërësisht dhe rrënjosht puna e Partisë dhe puna politike në trupa dhe komunistët të jenë në ballë dhe shembull vetëmohues për të gjithë të tjerët. Rëndësi të madhe dhe të veçantë duhet t'i vini stërvitjes luftarake të trupave, ngritjes së mjeshtërisë luftarake, zgjidhjes së detyrave të ndryshme luftarake. Ju duhet të dini se sukseset në këtë drejtim varen nga aftësitë organizative të kuadrit komandues. Nga aftësia organizative e kuadrit varet niveli i stërvitjes së trupave, zgjidhja me sukses e të gjitha detyrave, gjendja disiplinore në trupa, cilësia e edukimit të trupave, rregulli i mirë i brendshëm dhejeta e trupës, zotërimi i teknikës luftarake dhe i ruajtjes së saj. Shoku Stalin na mëson se arti luftarak pa aftësitë organizative të kuadrore, është i pafrutshëm, por edhe aftësitë organizative nuk do të jepin rezultatin e duhur në qoftë se nuk bazohen në diturinë e fortë të artit ushtarake dhe të teorisë marksiste-leniniste.

Për t'i fituar këto aftësi organizative, për kuadrot komandues të ushtrisë në vendin tonë janë krijuar shkolla të ndryshme ushtarake. Bashkimi Sovjetik ka vënë në dispozicion të ushtrisë sonë materialin e çmuar dhe eksperiencën e pakufishme të Ushtrisë së lavdishme Sovjetike. Shkollat e ndryshme, akademitë e Bashkimit Sovjetik kanë qenë dhe janë kurdoherë të hapura për kuadrin oficer të Ushtrisë sonë Popullore. Në këto akademi dhe shkolla ushtarake sovjetike kanë mësuar

në mënyrë të shkëlqyer, me qindra e me qindra oficerë, tanët, të cilët i kanë dhënë një hov të jashtëzakonshëm punës për forcimin dhe modernizimin e ushtrisë sonë. Ne kemi në ushtrinë tonë këshilltarë sovjetikë, oficerë të larë të të Ushtrisë Sovjetike, të pajisur me dituri e eksperiençë të madhe. Këta shokë sovjetikë, me të gjitha forcat dhe me një dashuri të madhe për ushtrinë tonë, po ndihmojnë në edukimin e kuadrove tanë. Unë i falenderoj nga zemra shokët sovjetikë, për ndihmën që po na japid.

Pra, shokë oficerë, fushat e diturisë për ne i ka çelur Partia jonë heroike, i ka çelur i madhi Stalin. Detyra juaj është të mësoni sa më shumë për ta bërë ushtrinë të çelniktë dhe moderne në shembullin e shkëlqyer të Ushtrisë së lavdishme Sovjetike. Të përvetësoni me etje të madhe artin luftarak stalinian, pse vetëm ai është kyçi i fitores, pse vetëm ai do t'i zhdukë rrënjesisht të metat dhe gabimet që për fat të keq ekzistojnë akoma në ushtrinë tonë.

Shokë oficerë dhe gjeneralë, loja operative, me temën «Armata në operacionin ofensiv në tokën malore» që u zhvillua këtë vit, gjatë dhjetë ditësh, në terren, ka qenë loja më e rëndësishme nga të gjitha lojnat dhe mësimet e tjera që janë bërë në të kaluarën. Në këtë lojë operative morën pjesë për herë të parë dy shtabe korpusi, të cilët nuk kanë pasë qenë të pajisur qysh më parë me praktikën e nevojshme për drejtimin e njësive luftarake. Gjithashtu në këtë lojë operative morën pjesë të gjitha shtabet e kohës së paqes të ushtrisë sonë. Të gjitha shtabet kanë qenë të kompletuara plotësisht sipas organikës si me njerëz ashtu edhe me mjete transporti, me materialet e nevojshme të shtabeve, me mjetet e

ndërlidhjes dhe me materialin xhenier. Para se të filloonte kjo lojë, u bë një preqatitje serioze e gjithanshme dhe e gjatë e Shtabit të Armatës, gjithashtu edhe e shtabeve të njësive. Si rezultat i gjithë kësaj preqatitjeje u bë e mundur që shtabet tona të jenë në gjendje të kryejnë veprime ofensive të rëndësishme.

Sikurse e dini të gjithë, luftimi ofensiv kundër një armiku në mbrojtje është lloji i koklavitur i luftimit dhe sidomos në konditat malore, luftim i cili mund të shkaktojë shpartallimin e plotë të armikut dhe të sjellë fitoren përfundimtare.

Ushtria jonë e mbështetur në doktrinën e saj përmbrojtjen e atdheut, duhet të përdorë të gjitha llojet e luftimit: mbrojtjen në vijat më të përshtatshme, luftimin në ndeshje, luftimin ofensiv mbi armikun që mbrohet etj. Njëkohësisht, ne nuk duhet të harrojmë dhe eksperiencën e çmueshme të Luftës nacional-çlirimtare, të veprimeve luftarake partizane. Vetëm duke përvetësuar plotësisht të gjitha llojet e luftimit, duke praktikuar gjerësisht veprimet luftarake të reparteve partizane në prapavijat armike dhe duke organizuar me aftësi të plotë bashkëveprimin e përsosur midis të gjitha llojeve të armëve — vetëm kështu ne do të mundim të sigurojmë sukseset e rëndësishme në luftë.

Terreni i Republikës sonë është një terren malor, me një rrjet rrugësh automobilistike të kufizuar, me një rrjet hekurudhor shumë të kufizuar e të porsalindur dhe me një bregdet relativisht të gjatë dhe të ekspozuar nga perëndimi. Të gjithë këta faktorë influencojnë negativisht dhe na krijojnë vështirësi të konsiderueshme në lidhje me luftimet difensive ose ofensive eventuale.

Porse nga ana tjetër, reliivi malor i terrenit të Republikës sonë, paraqit edhe shumë faktorë pozitivë përsa u përket veprimeve luftarake në përgjithësi:

Së pari, reliivi malor i terrenit tonë na lejon që me forca më të pakta se armiku, duke u mbështetur në vija malore të përshtatshme, të mbrohemë me këmbëngulje, të thyejmë me sukses ofensivën e armikut, sikur edhe të jetë ky superior mbi ne në njerëz dhe në mjete, dhe t'i shkaktojmë armikut humbje shumë të rënda vdekjeprurëse për atë.

Së dyti, në të shumtata e rasteve armiku është i detyruar që të përqëndrojë grupimet e tij kryesore në drejtimet e rrugëve dhe veprimet e tij ofensive kundër nesh t'i zhvillojë gjatë këtyre rrugëve. Kjo na lejon ne që të manevrojmë gjatë të gjithë frontit të mbrojtjes si këmbësorinë ashtu edhe llojet e tjera të armëve, duke bërë kështu të mundur përqendrimin e forcave tona kryesore atje ku duam ne, ku mund t'i shkaktojmë armikut humbjet më të mëdha në drejtimet e goditjes kryesore të tij.

Së treti, stërvitja e ushtrisë sonë në terrenin malor, preqatitja intensive dhe e gjithanshme e saj në konditata malore, bën të mundur që, duke përdorur manevrën e shpejtë të trupave, ta godasim armikun në befasi, qoftë frontalishët ashtu edhe në krahë dhe në shpinë të tij, me goditje të befasishme me forca më të vogla, ta shpartallojmë armikun si në mbrojtje ashtu edhe në mësymje.

Së katërti, reliivi malor i vendit tonë, ekzistanca e pyjeve të shumta dhe patriotizmi i shkëlqyer i popullit tonë, forcat drejtuese të Partisë sonë që ka eksperiencën e madhe të Luftës nacional-çlirimtare, të gjitha këto,

bëjnë të mundur formimin e reparteve partizane në prapavijat e armikut në zonat e okupuara. Në këto rrethana, repartet partizane në prapavijat armike, në bashkëveprim të ngushtë me ushtrinë e rregullt, duke vepruar me iniciativë të guximshme, me vendosmëri, me shpejtësi dhe pa ndërprerje, do të mund t'i japin armikut goditje mbi komunikacionet, mbi shtabet dhe objektet e rëndësishme, do të mund t'i shkaktojnë armikut humbje në forcat e gjalla dhe në mjetet teknike, do të pengojnë lëvizjen e rezervave të armikut, etj., do të mundin në këtë mënyrë të ndihmojnë efektivisht ushtrinë e rregullt në kryerjen e detyrës së shenjtë përpara popullit, në mbrojtjen e atdheut tonë të dashur dhe të kampit të socializmit.

Çfarë na tregon, shokë oficerë dhe gjeneralë, kjo lojë operative? Çfarë rezultatesh kemi pasur nga mësimet e rëndësishme të këtyre dhjetë ditëve të fundit? Rezultatet pozitive të kësaj loje operative na tregojnë se oficerët dhe gjeneralët e ushtrisë sonë janë futur seriozisht në rrugën e përvetësimit të artit ushtarake modern, të artit ushtarake sovjetik, se ata janë të ndërgjegjshëm në shërbimin e tyre kundrejt atdheut dhe Partisë, se ata janë në gjendje të drejtojnë njësitë dhe repartet ushtarake në konditat e luftës dhe se bëjnë përpjekje serioze për t'u perfeksionuar në këtë drejtim. Ushtria jonë është duke u pajisur me shpejtësi me shkencën ushtarake staliniane dhe, duke u bazuar në rezultatet e deritanishme, mund të themi se brenda një kohe relativisht të shkurtër ajo do të mbërrijë nivelin e një ushtrie të përparuar në të gjitha pikëpamjet.

Kjo lojë luftarake na tregon ngritjen e konsideru-

eshme të oficerëve tanë në zbatimin e funksioneve të tyre. Të gjitha organet dhe shërbimet që morën pjesë në këtë lojë luftarake kanë ditur si të organizojnë punën e tyre dhe të organizojnë koordinimin dhe bashkëveprimin e nevojshëm. Të gjitha shtabet, organet e shërbimet, i gjithë personeli që mori pjesë në këtë lojë, janë treguar në lartësinë e detyrës së tyre, si një tërësi, pjesët e së cilës veprojnë në harmoni të plotë në bazë të një planit të caktuar, si një kolektiv plotësisht i ndërgjegjshëm për detyrën e caktuar, si një forcë e madhe në duart e Partisë, nga e cila shpreson populli dhe atdheu. Ushtria jonë që po ecën me hapa të shpejtë drejt modernizimit të saj, është mburrja e popullit tonë dhe e Partisë sonë.

Rezultatet e kësaj loje operative tregojnë se si shtabi i armatës, ashtu dhe shtabet e njësive kanë bërë hapa të mëdhenj përpëra në organizimin e preqatitjes së operacionit, në organizimin e drejtimit të operacionit, të vendkomandave, të vendvroatimeve etj. Shtabet tona kanë treguar se janë në gjendje të organizojnë dhe ta drejtojnë operacionin në të gjitha fazat, si në atë preqatitore ashtu edhe gjatë dinamikës. Është për t'u theksuar se shtabet tona kanë përvetësuar në mënyrë të dukshme kulturën e përpunimit dhe të formulimit të dokumentave luftarake dhe të dokumentave të shtabeve. Rezultatet e lojës tregojnë se horizonti taktik dhe operativ i oficerëve tanë është zgjeruar mjaft dhe do të zgjerohet edhe më tepër në të ardhshmen. Të gjitha dokumentat e planifikimit të operacionit ofensiv janë formuluar prej shtabeve siç e kërkojnë rregulloret, kanë qenë të plota dhe në përgjithësi janë mbaruar në kohën e duhur.

Drejtimi i njësive dhe i reparteve, si në periudhën preqatitore ashtu edhe në periudhën e dinamikës së luftës, në këtë lojë ka qenë më i përsosur se sa në lojnat luftarake dhe stërvitjet e viteve të kaluara. Sigurimi i ndërlidhjes së shtabeve, që është konditë e domosdoshme për drejtimin e njësive dhe të reparteve në luftë, ndërlidhja me mjete teknike dhe me mjete të lëvizshme, ka funksionuar mjaft mirë gjatë të gjithë procesit të operacionit. Ndërlidhja ka punuar mirë dhe ka siguruar në mënyrë plotësisht të kënaqshme drejtimin e njësive dhe reparteve prej shtabeve dhe komandave.

Repartet xheniere, ushtarët, nënoficerët dhe oficerët e xhenios, e kanë kryer në mënyrë të kënaqshme detyrën e tyre, kanë punuar pa u lodhur, kanë kryer me sukses ndërtimin e plotë dhe në kohën e duhur të vendkomandave dhe vendvroatimeve në bazë të rregullloreve dhe plotësisht si në konditat e luftës së vërtetë, ata kanë punuar ditë dhe natë, pa ndërprerje, pa kursyer energjitë e tyre.

Gjithashtu kanë punuar mirë të gjithë ushtarët dhe një pjesë e oficerëve të reparteve të shërbimit të shtabeve, duke u shërbyer vendkomandave dhe vendvroatimeve.

Disiplina gjatë lojës operative ka qenë plotësisht e kënaqshme, gjë e cila tregon ndërgjegjen e plotë të ushtarakëve kundrejt detyrës së tyre.

Shokë oficerë, unë vura në dukje para jush vetëm pjesën më kryesore të anës pozitive të kësaj loje. Porse ne kemi edhe një sërë të metash dhe gabimesh të rëndësishme që janë vërtetuar gjatë lojës. Ato më kryesoret ndër to janë:

1. — Shumica e oficerëve është e vërtetë se kanë përvetësuar metodën e planifikimit dhe të formës së dokumentave luftarake dhe të dokumentave të punës, porse ata akoma nuk kanë mësuar sa duhet rëndësinë e përbajtjes, të esencës së këtyre dokumentave, shumë herë i japid më tepër rëndësi formës se sa përbajtjes, shumë herë nuk kontrollojnë sa duhet përbajtjen e dokumentave, por shikojnë formën e tyre dhe kjo e ul në mënyrë të konsiderueshme vlerën reale të dokumentave.

2. — Gjatë dinamikës së luftimeve, shumica e oficerëve nuk kanë ditur si të përdorin metodën e drejtimit sekret, duke shkelur rregullat e drejtimit sekret, duke shkelur konspiracionin në bisedimet telefonike ose në transmetimet me radio, ose duke humbur shumë kohë në kodifikimin e bisedimeve ose transmetimeve, sado që kodi në fuqi është mjaft i thjeshtë dhe lehtë mund të përvetësohet nga çdo oficer.

3. — Komandantët dhe oficerët e shtabeve nuk kanë mësuar akoma sa duhet si ta çojnë deri në fund punën, nuk e çojnë vendimin e tyre deri në zbatim të plotë, nuk kontrollojnë sa duhet zbatimin e vendimit të tyre, marrin vendim për të marrë vendim, pa u interesuar mbi fatin e zbatimit të këtij vendimi. Aja nuk kanë kuptuar sa duhet se vendimi sado i drejtë që të jetë, nuk ka asnjë vlerë në rast se nuk organizohet zbatimi i plotë i tij, në rast se nuk kontrollohet në kohën e duhur zbatimi i tij.

4. — Komandantët e njësive akoma nuk janë mësuar që të sigurojnë vendimin që kanë marrë me anën e urdhërave që duhet të japid dhe detyrave që duhet t'u caktojnë vartësve për zbatimin e vendimit të tyre. Shumë

herë merret vendim, por nuk jepen urdhërat e rastit në kohën e duhur për zbatimin e këtij vendimi. Në këtë mënyrë vendimi mbetet formal dhe nuk bëhet vendim për veprim. Të vendosësh dhe të mos sigurosh zbatimin e vendimit tënd, është njëlloj sikurse të mos marrësh asnë vendim.

5. — Shumica e oficerëve nuk mbajnë rregullin e vazhdueshëm dhe të nevojshëm në kërkimin e llogarisë nga vartësit. Ata nuk kërkojnë sa duhet nga vartësit dhe nga kjo, gjatë procesit të lojës, është vënë re lënja mënjanë e formulimit të dokumentave të nevojshme; dokumentat luftarake janë formuluar vetëm gjatë fazës preqatitore të operacionit, ndërsa gjatë dinamikës nuk janë bërë në rregull. Nga kjo ka ndodhur që s'ka pasur përpikëri në punë, në zbatimin e vendimeve, dhe rregulli në vendkomandat dhe vendvroatimet nuk është mbajtur ashtu si e kërkon rregullorja, ashtu si e kërkon lufta. Nuk është kuptuar akoma sa duhet nga të gjithë se rregulli, përpikëria, organizimi — janë kondita të domosdoshme për suksesin në luftë.

6. — Oficerët akoma nuk kanë përvetësuar të gjitha cilësitë e një organizatori të mirë. Nga kjo, gjatë punës janë vërtetuar mjaft të meta. Si rezultat i organizimit jo të mirë, kanë ndodhur avari të jashtzakonshme të maqinave që kanë shkaktuar edhe përmbyssje të këtyre, duke sakrifikuar ose duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe duke nxjerrë jashtë përdorimit mjete teknike të vlefshme.

7. — Shumë oficerë madhorë akoma edhe sot e kësaj dite nuk përkujdesen sa duhet përfshirë ushtarët dhe nën oficerët, duke mos u sigruuar atyre në kohën e

duhur ushqimin që u takon. Nuk kanë rrënjosur sa duhet në mendjen e tyre mësimin e Partisë se përgjegjësit për vartësit duhet të kujdesen më përpara se sa për veten e tyre, se ushtari kurrë nuk duhet ta ndjejë veten jashtë kujdesit atëror të komandantit.

8. — Disa oficerë që kanë mbaruar akademinë ose ndonjë shkollë ushtarake, duke harruar thelbin kryesor të parimeve që kanë mësuar në akademi ose në shkollë, d.m.th. duke harruar se mësimi s'ka fund, se duhet mësuar dhe kurdoherë duhet mësuar, tregohen kryelartë duke pretenduar se ata i dinë të gjitha dhe s'ka se ç'u duhet që ta zhvillojnë më tej ose ta pasurojnë atë që kanë mësuar.

9. — Një nga shkaqet e të metave që u thanë më sipër është disiplina e dobët personale në disa oficerë, si edhe moskërkimi i llogarisë sa duhet nga vartësit.

Punëtorët politikë dhe organizatat e Partisë akoma nuk kanë mësuar si të reagojnë shpejt dhe drejt mbi të gjitha të metat që vërtetohen gjatë procesit të operacionit, ata nuk veprojnë menjëherë kundrejt atyre që thyejnë disiplinën luftarake dhe ka të atillë që qëndrojnë indiferentë kundrejt detyrës që u është caktuar.

Çfarë detyrash shtrohen para nesh?

1. — Të përforcojmë dhe të perfektionojmë rezultatet e arritura deri më sot.

2. — Të mësojmë, pa ndërprerje të mësojmë artin ushtarak, të zgjerojmë horizontin taktik dhe operativ, të studjojmë literaturën ushtarake dhe rregulloret.

3. — Komandantët, komisarët dhe shefat e shtabeve të preqatitin dhe të perfektionojnë oficerët e shtabeve, të mësojnë aparatet, shërbimet dhe shtabet në

tërësi si të drejtojnë njësitë dhe repartet. Oficerët e rinj me perspektivë, të stërviten, të preqatiten, të perfeksionohen me kujdesin më të madh nga udhëheqësit e tyre dhe të krijohen të gjitha mundësitë që ata të ngrihen, të çohen përpara.

4. — Oficerët të mësojnë drejtimin sekret të njësive dhe të reparteve, të kërkohet prej tyre përvetësimi i metodës së drejimit sekret. Gjatë inspektimit të vjetës të provohen të gjithë oficerët për drejtimin sekret të njësive dhe të reparteve, deri atëherë ata të gjithë duhet të kenë përvetësuar në mënyrë të kënaqshme metodën e drejimit sekret, me anën e tabelave të bisedimit dhe të kodit të komandimit.

5. — T'u hiqet frika oficerëve për të drejtuar njësitë dhe repartet me anën e radios. Në kohën më të shkurtër të përvetësohet metoda e transmetimit dhe e marrjes me anën e radios, në bazë të rregullave të caktuara, duke arritur që me anën e radios të transmetohen dhe të merren edhe urdhërat luftarake, duke kuptuar mirë se gjatë veprimeve luftarake radio-rrjeti është mjeti kryesor i ndërlidhjes që siguron drejtimin e njësive dhe të reparteve. Komandantët duhet të mësojnë ta përdorin vetë personalisht radion dhe jo me ndërmjetësinë e të tjerëve, jo të flasin në radio me anën e oficerëve të ndërlidhjes.

6. — Në stërvitjet e ardhshme të shtabeve të bëhen preqatitje më serioze dhe të zgjidhen të gjitha problemet organizative dhe, para se të dilet në terren, të provohet gatishmëria e shtabeve, e shërbimeve dhe e aparateve të prapavijës.

7. — Të tregohet kujdes më i madh për teknikën

luftarake, të ruhen mjetet teknike si sytë e ballit (makinat, radio-stacionet etj.). Të merren masa preventive për të mos ndodhur avari dhe ngjarje të jashtzakonshme gjatë stërvitjeve dhe lojnave luftarake. Të dënohen rëndë ata që neglizhojnë në ruajtjen e teknikës luftarake, të pasurisë ushtarake, shtetërore, sidomos shkaktarët e ngjarjeve të jashtzakonshme me teknikën luftarake.

8. — Të aktivizohen të gjithë oficerët e shtabeve; ndër shtabet të mos mbetet askush me duar kryq, por secilit t'i caktohet puna konkretisht, të ndihmohet për kryerjen e detyrës dhe t'i kërkohet llogari.

9. — Të gjithë oficerët duhet të tregojnë një kujdes atëror kundrejt trupës dhe të konsiderohet si ngjarje e jashtzakonshme mbetja pa ushqim e oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve gjatë stërvitjes, çështja të hetohet menjëherë dhe deri në fund për të përcaktuar përgjegjësinë. Shkaktari të dënohet rëndë.

10. — Të marrë fund një herë e përgjithmonë neglizhenca e patolerueshme që ekziston në shkallë të gjerë në lidhje me ruajtjen e sekretit ushtarak. Në rast se këtej e tutje do të humbasë ndonjë dokument sekret, qoftë gjatë punës së përditshme, ndër shtabet dhe komandat, ashtu edhe gjatë lojnave luftarake, çështja duhet të ndiqet deri në fund, të formulohet akti i hetuesisë rregullisht dhe rezultatet e hetuesisë të më paraqiten personalisht për të vendosur marrjen e masave të rastit kundrejt fajtorit.

11. — Të mësohen të gjithë oficerët që e gjithë puna e tyre gjatë stërvitjes në terren të bëhet njëloj sikurse në rr Ethanat e luftës.

12. — Aparatet politike dhe organizatat e Partisë të forcojnë punën individuale për edukimin e oficerëve duke rritur te ata ndjenjën e përgjegjësisë personale për zbatimin e detyrave të ngarkuara.

Konsideroj se loja operative luftarake që u zhvillua gjatë këtyre dhjetë ditëve të fundit në terren, trigradshe, njëanshe, me mjetet e ndërlidhjes, në të cilën morën pjesë të gjitha shtabet e sotshme të ushtrisë, u krye në mënyrë plotësisht të kënaqshme, ka zgjeruar horizontin taktilo-operativ dhe ka rritur aftësitë organizative të personelit udhëheqës të ushtrisë.

Shokë gjeneralë dhe oficerë, ju uroj suksese të mëtejshme në prepatitjen e trupës dhe në perfektionimin tuaj, në ngritjen politiko-morale të ushtrisë dhe në prepatitjen e saj luftarake për të qenë ajo e gatshme në çdo orë për të mbrojtur atdheun!

*Botohet për herë të parë sipas
kopjes së daktilografuar që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

MBI ZGJERIMIN E INDUSTRISE LOKALE DHE TË ARTIZANATIT

*Nga diskutimi në mbleedhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH*

4 gusht 1952

Siç u tha edhe nga shokët e tjerë të Byrosë, studimi¹ nuk është edhe aq i plotë e konkret dhe është rrezik të mbetet në kartë e detyrat të zvarriten. Sidomos çështjet e industrisë duhet të ishin më të qarta, pse Partia i ka ngritur vazhdimisht dhe ka thënë se industria jonë është e re dhe ekonomia jonë ka nevojë të domosdoshme e urgjente për ndihmën e industrisë lokale.

¹ Studimi mbi zgjerimin e industrisë lokale dhe të artizanatit ju paraqit Byrosë Politike të KQ të PPSH nga Ministria e Industrisë, Bashkimi Qendror i Artizanatit dhe drejtoria përkatëse pranë KQ të PPSH. Zgjerimi i industrisë lokale dhe i artizanatit në atë kohë ishte një problem i madh partie. Kishte rrethe si në Lezhë, Përmet, Pukë, Sarandë, Skrapar, Tepelenë, Burrel, Rrëshen e Tropojë, ku nuk ekzistonte fare industria lokale. Në tri rrethet e fundit nuk kishte as kooperativa artizanati.

Nga kërkesat e rretheve del se industria lokale duhet të zgjerohet. Lëndën e parë për këtë industri Ministrja e Industrisë ka mundësi ta sigurojë. Ajo këtë e di dhe duhet të kishte bërë përpjekje e të na dilte këtu me propozime konkrete. Nevojë ka edhe për gjërat e tjera si materialet e ndërtimit, që kanë një rëndësi të madhe, duke filluar që nga tullat, gëlqerja, lënda e drurit etj. Në çdo rreth ka nevoja të mëdha se atje po bëhen ndërtime lokale të rëndësishme, prandaj disa ndërmarrje të industrisë lokale janë të nevojshme për të gjitha rrethet dhe ato duhet të ngrihen. E vlen barra qiranë të mendohet dhe të veprohet për zgjerimin e Industrisë lokale. Ka mundësi të çojmë poshtë një sërë maqinash të tjera për të bërë, për shembull, këpucë. Ka mundësi që atje të bëhen banka dhe orendi shkollore, kurse sot këta artikuj venë nga Puka në Gjirokastër. Edhe për prodhimin e artikujve ushqimorë shokët e industrisë duhet të na dalin me propozime më konkrete dhe për këtë mund të bëjmë edhe investime. Tani i pranojmë këto që themi, por të kemi kujdes që të mos na mbeten studime në letër dhe të mos zvarriten.

Gjithashtu, për zhvillimin e mëtejshëm të artizanatit, shokët shfaqën mendime të drejta. Çështja është që t'i vëmë rëndësi më të madhe zgjerimit të artizanatit në fshat dhe në këtë drejtim të bëjmë kthesë, të prodrojmë mallra sipas nevojave e kërkesave të fshatarëve dhe t'u shërbejmë më mirë atyre. Këtu duhet parë interes i fshatarëve. Artizanati duhet të lidhë kontrata të rregullta, prodhimet e tij të jenë të një cilësie të mirë, sepse p.sh. këpucët që bëhen nuk mbajnë shumë, por grisen shpejt. Pra, kërkohet një kthesë në drejtim

të cilësisë së prodhimeve të artizanatit. Pse mbeten pa u shitur prodhimet e artizanatit? Se fshatari nuk i merr mallrat e cilësisë së dobët dhe këtu mungon bashkëpunimi në mes prodhuesve dhe konsumatorëve. Artizanati nuk duhet të niset nga fitimet, të cilat duhen parë mirë; kur mallrat janë të cilësisë së dobët, çmimet e tyre të jenë më të ulëta. Për këtë të respektohen ligjet dhe urdhëresat në fuqi. Gjithashtu çështja e prodhimeve të reja në artizanat ka një rëndësi të madhe për ne dhe nuk është mirë që Komisioni i Planit dhe Ministria e Industrisë s'ndihmojnë në këtë drejtim.

Unë dyshoj se pushteti nuk është interesuar sa duhet për artizanatin dhe kjo do të thotë që edhe Partia nuk ka dhënë ndihmën e duhur. Kooperativat e shitbierjes qahen pse mallrat u mbeten në depo pa u shitur, prandaj këto çështje t'i sinjalizohen pushtetit, kryetari i të cilit të thérresë përgjegjësin e artizanatit dhe ta vëré përparrë përgjegjësisë që ta bëjë punën si duhet. Po kështu të interesohet më shumë edhe Partia, pse mbarëvajtja e këtij sektori ka të bëjë me zbatimin e vijës së saj në fshat.

Bashkimin Qendror të Kooperativave të Artizanatit këtu në Tiranë, duhet ta kemi më tepër në lidhje; kur shtrohen çështjet ekonomike në mbledhjet e qeverisë, të thirret edhe kryetari i Bashkimit Qendror të Kooperativave të Artizanatit me qëllim që të jetë në korrent të problemive që ngrihen dhe të përmirësojë punën në këtë sektor. Edhe për klubet duhet të shtohen fondet dhe të ketë një interesim më të madh nga vetë Partia në bazë. Shtypi duhet të shkruajë më shumë për artizanatin dhe të vëré në dukje si anët e mira, ashtu

dhe ato të dobëta, bile edhe gazeta «Puna» duhet të flasë për artizanatin.

Tani aktiviteti i artizanatit është zgjeruar, prandaj në lokalitete duhet të bëhet decentralizimi, po kjo kërkon një studim. Qëllimi i Partisë është që të plotësohen nevojat e popullit në bazë lokalitetesh. Pastaj duhet t'u krijojmë disa kondita njerëzve të artizanatit. Për ata artizanë që do të venë në lokalitete ne mund të parashikojmë që të kenë një shpërblim më të madh, sigurisht kjo do të lejohet vetëm në fillim, derisa të krijojmë kuadro vendës. Përsa i përket çështjes së mekanizimit në artizanat, të ngarkohet Komisioni i Planit. Më duket se është e drejtë që artizanati lokal më parë të prodrojë nga të gjitha për nevojat e rrethit të vet dhe pastaj për nevojat e rretheve të tjera.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**LETËR UDHËZUESE DËRGUAR KOMITETEVE TË
PARTISE NË RRETHE MBI PROCEDURËN QË DUHET
NDJEKUR NË CAKTIMIN E KANDIDATËVE PËR
ANËTARE TË KËSHILLAVE POPULLORE**

12 gusht 1952

GJITHË KOMITETEVE TË PARTISE

Anulohen udhëzimet që janë dhënë më parë në lindhje me procedurën e propozimeve për zgjedhjet. Veproni si më poshtë:

Zgjedhjet e kandidatëve të këshillave popullore duhet të zhvillohen në mënyrë plotësisht demokratike dhe të lira. Në to duhet të marrë pjesë masa e gjërë e zgjedhësve me propozime e diskutime të lira. Duhet të zhvillohen dhe të inkurajohen kritika dhe propozimet nga poshtë.

Çdo zgjedhës ka plotësisht të drejtë që të propozojë kandidatin që do, ose të rrëzojë kandidatin e propozuar. Qëndrimi i vetë komunistëve, qoftë kur diskutohet kandidatura e tyre ose e të tjerëve, duhet të jetë i tillë që të inkurajojë kritikën dhe shfaqjen e mendimeve të çdo zgjedhësi lirisht.

Procedura duhet të jetë si më poshtë:

Për fshatin. — Organizata bazë e Partisë për fshatin duhet të zgjedhë anëtarët e Partisë që mendon t'i paraqesë si kandidatë për anëtarë të këshillit të fshatit, të mendojë sa gra, sa të rinj, dhe cilët mund të propozohen për kandidatë. Por, veç anëtarëve të Partisë që i cakton për t'i paraqitur si kandidatë vetë organizata bazë, për të tjerët ajo bën vetëm parashikimet. Mbas kësaj pune të organizatës bazë mblidhet kryesia e Frontit të fshatit. Kandidatët, anëtarë partie, që ka vendosur organizata bazë, propozohen në kryesinë e Frontit tok me propozimet e tjera që bëhen nga kjo kryesi dhe diskutohen këtu gjallërisht të gjitha propozimet. Numri që do të caktojë kryesia e Frontit duhet të jetë dy-tri herë më i madh nga numri i kandidatëve për anëtarë të këshillit që do të zgjedhë fshati për listën e Frontit.

Për të caktuar kandidatët definitivë të Frontit duhet të mbledhen të gjithë anëtarët e Frontit në fshat. Në mbledhjen e organizatës së Frontit në fshat kryesia e Frontit bën propozimet e saj. Propozimet nuk duhet të mbarojnë me kaq. Kryesia mbasi ka bërë propozimet e saj fton fshatarët të bëjnë propozime të tjera në qoftë se kanë. Të gjitha propozimet duhet të regjistrohen. Mbasi janë mbaruar të gjitha propozimet fillon diskutimi për çdo të propozuar. Këtu duhet të inkurajohet kritika dhe mbas diskutimit vihet në votë të hapët çdo i propozuar dhe mbahen në shënim votat. Mbeten kandidatë të Frontit për t'u caktuar në listën e Frontit të fshatit ata, që mbas diskutimeve kanë fituar shumicën e votave të hapëta të mbledhjes së organizatës së Frontit të fshatit.

Është e qartë se nuk është organizata e Partisë ajo që cakton kandidatët as kryesia e Frontit, por

organizata e Frontit në fshat. Por kryesia e Frontit, e frysmezuar dhe është udhëhequr nga Partia, i sugjeron masës njerëzit më të mirë dhe kjo nuk përjashton propozimet e tjera nga masat. Në qoftë se masa nuk do dëshiron një kandidat të propozuar nga kryesia e Frontit, qoftë ky komunist ose jo, ajo ka plotësisht të drejtë ta bëjë dëshiron një kandidat duhet të mbajnë qëndrim të drejtë ndaj kritikës dhe autokritikës dhe, duke ua vënë veshin me kujdes thënjeve të masave, të luftojnë gjallërisht për caktimin e njerëzve më të mirë, të luftojnë kundër shtypjes së kritikës dhe tendencave armike dhe të mos qëndrojnë në bisht të situatës. Kështu që duhet të luftohet kundër infiltrimit të elementeve armiq, por nuk duhet, nga ana tjetër, t'i imponohen masës pa të drejtë ata që ajo nuk i do dëshiron një nuk e meritojnë qofshin këta edhe kandidatët që ka menduar organizata e Partisë ose kryesia e Frontit. Për kryetarët e këshillave popullore të fshatit nuk është nevoja të preokupohet komiteti i Partisë mbasi këta do të zgjidhen nga mbledhja e këshillit popullor.

Për lokalitetet. — Mblidhen së bashku sekretarët e organizatave bazë të fshatrave të zonës elektorale, kur në një zonë ka më shumë se një organizatë, ose mblidhet organizata kur në zonë është vetëm një dëshiron caktuar që do të propozohen. Parashikojnë sa gra, sa të rinj dhe cilët do të propozojnë si kandidatë. Në këtë mbledhje të sekretarëve ose të organizatës bazë duhet të asistojë një instruktor i komitetit të Partisë. Mbësajt mblidhen së bashku kryesitë e Frontit të fshatrave që përmbledh zona elektorale. Këtu propozojnë komunistët dhe të tjerët. Edhe këtu procedura është njëlloj si

për fshatin; d.m.th. kandidatët propozohen dhe diskutohen nga kryesitë e Frontit. Numri i kandidatëve tëzonës duhet të jetë dy-tri herë më i madh nga sa ka për të zgjedhur zona.

Për të caktuar kandidatin definitiv që do të zgjedhë zona mblidhen të gjithë zgjedhësit e zonës elektorale, ku ndiqet e njëjta procedurë si për fshatin.

Për rrethin. — Byroja e komitetit të Partisë parashikon komunistët që do të dalin në këshillin popullor të rrethit si dhe numrin e të rinxve, punëtorëve, grave e të tjerëve. Më vonë mblidhet kryesia e Frontit të rrethit ku diskutohen dhe zgjidhen dy ose tre kandidatë për çdo zonë elektorale. Diskutimi dhe zgjedhja në zona duhet të bëhet si për lokalitetet.

Komititetet e Partisë me të marrë këtë letër duhet të instruktojnë dhe të nisin nga një të deleguar për çdo organizatë bazë për t'i udhëzuar që të veprojnë si më sipër. Atje ku janë bërë propozimet në popull sipas udhëzimeve të mëparshme të mos përsëriten. Merrni masa dhe veproni sipas këtij udhëzimi atje ku nuk janë bërë propozimet.

Sekretari i Përgjithshëm i PPSH

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë si-
pas originalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

• MBI REALIZIMIN E PLANIT TË SHTETIT PËR
GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 1952

*Nga fjala e mbylljes në Plenumin III
të KQ të PPSH*

12 gusht 1952

Sipas mendimit tim në këtë plenum doli e qartë gjendja e realizimit të planit. Problemet u rrahën mirë dhe me siguri ky plenum do të ndihmojë Partinë, qeverinë dhe gjithë organet shtetërore që të marrin masat e duhura në mënyrë që të përmirësohet akoma më shumë gjendja. Siç e kam theksuar edhe herë të tjera, konstatohet, se çdo ditë e më tepër, shokët drejtues përparojnë në punën e tyre, ata i kuuptojnë më drejt problemet. Ata bëjnë përpjekje të mëdha, mund të themi, dhe të lavdérueshme për t'i zgjidhur problemet që u janë ngarkuar dhe luftojnë e kapércejnë vështirësi të mëdha. Një situatë e tillë do të na inkurajojë patjetër, por udhëheqja nuk është e tillë që nga këto suksese t'i rritet mendja. Një dobësi e tillë nuk duket në shokët tanë dhe kjo është një anë shumë pozitive, d.m.th. e shohim drejt realitetin, kemi përparime, por edhe të meta serioze në punën tonë. Kjo do të na bëjë

që ne të kemi akoma suksese të mëtejshme në realizimin e planit.

Cështja tjetër është që udhëheqja, gjithë Partia dhe punonjësit e kanë kuptuar që problemet ekonomike në këtë situatë, me gjithë gjendjen e rëndë ndërkombltare dhe me situatën e vendit tonë, qëndrojnë në radhën e parë, pse nga rezultatet ekonomike rrjedh dhe forcimi i mëtejshëm i situatës politike të vendit tonë, të mbrojtjes së tij; këto përpjekje, këto rezultate e kanë forcuar situatën politike të jashtme dhe të brendshme të vendit tonë, se është forcuar shumë besimi i masave të popullit te Partia dhe në regjimin e demokracisë sonë popullore, në forcimin e sigurimit dhe të ushtrisë sonë. Ky besim është në një shkallë shumë të lartë. Gjithashtu Partia e ka kuptuar mirë që problemet ekonomike janë një kyç i rëndësishëm i politikës së saj dhe nuk ka harruar njëkohësisht çështjen e sigurimit të mbrojtjes së atdheut. Këto gjëra janë kuptuar mirë dhe po ecet në rrugë të shëndoshë në këtë drejtim.

Natyrisht përsa i përket situatës së brendshme politike kemi korrur dhe korrim suksese dhe kjo duhet të na inkurajojë akoma më shumë që të përpinqemi më tepër për realizimin e planeve ekonomike, pse kështu do të forcohet më tej gjendja e brendshme e vendit tonë.

Ky plenum është një shkollë e madhe për ne. Këtu ne mësuam shumë dhe duhet të konsiderojmë se Plenumi III i KQ nuk gjykoi vetëm punën e çdo shoku individualisht, por duke bërë këtë analizë gjykoi në përgjithësi edhe punën e qeverisë. Komiteti Qendror

është forumi më i lartë i Partisë pas kongresit dhe më duket se punën e qeverisë sonë e gjykoj drejt në lidhje me rezultatet e arritura. Por duhet ta konsiderojmë se me kritikat që ju bënë punës së secilit u kritikua dhe qeveria, të tërë së bashku, që nga unë si Kryeministër e deri te shokët ministra dhe nga ky plenum na u vunë detyra të rëndësishme. Kritikat që na u bënë këtu për organizimin e punës, për disiplinën dhe për të gjitha çështjet e tjera që u ngritën drejt, duhet t'i marrim seriozisht dhe të ecim në rrugën e zgjidhjeve që u dha plenumi problemeve, të kryhen gjithashtu detyrat që ju vunë çdo dikasteri e që janë detyra të qeverisë dhe të jemi përgjegjës, të tërë si qeveri, përpara Komitetit Qendror. Prandaj e mira e Partisë e do që ne të vijmë me plan të realizuar, d.m.th. udhëzimet, vërejtjet dhe kritikat që na bëri plenumi nuk duhet t'i marrim vetëm në mënyrë individuale, por t'i kemi parasysh edhe si kolektiv. Komiteti Qendror na ka kritikuar për punën tonë të dobët dhë për të metat që vazhdojnë të duken në punën tonë që ne kemi akoma si qeveri. Ne mund t'i kritikojmë shokët një nga një, por ata duhet t'i kritikojmë si tërësi për metodën e tyre të punës. Kryeministri dhe zëvëndëskryeministrat duhet më tepër t'i ndihmojnë shokët dhe të janë rigorozë në zbatimin e vendimeve që merr qeveria, t'u hapin më shumë perspektiva shokëve ministra, t'i ndihmojnë dhe t'i kontrollojnë më shumë pse nga metoda e punës sonë varen shumë operativiteti, mënyra e studimit të problemeve, të zbatimit me rigorozitet të vendimeve nga ana e shokëve ministra. Udhëheqësit, si Kryeministri ashtu dhe zëvendëskrye-

ministrat, duhet të mos harrojnë se kemi shumë. të meta dhe në rast se biem në rrugën ku kërkon të na tërheqë një ministër për të zgjidhur problemet që janë në mundësitë e tija, ne kemi dhënë një shembull të këq. Unë e kuptoj se duhet t'u japim ndihmë ministrave dhe bile të vazhdueshme, por këtu duhet të jemi të qartë çfarë ndihme duhet t'u japim.

Ne si udhëheqje kolektive, unë si Kryeministër dhe zëvendëskryeministrat, të gjitha këto probleme që na vë përpara Komiteti Qendror për t'i zgjidhur, duhet t'i kemi parasysh dhe të mos zvarritemi në studime dhe stërstudime, po të caktojmë afatet e kryerjes së detyrave dhe t'i ndjekim që të kryhen punët. Shokët drejtues duhet të kenë të qartë që punët duhet të zgjidhen brenda afateve duke marrë parasysh të gjitha rrëthanat dhe të bëhen propozime konkrete, të caktohet koha dhe të zbatohen ato detyra për të cilat jemi përgjegjës. Por nuk bëhet kështu dhe këtë e shohim me projektvendimet që na paraqiten ku me zor caktohen afatet, të cilat i caktojmë ose të shkurtëra ose shumë të largëta, gjë që dëmon tonë shumë kryerjen e detyrave.

Po të marrim realizimin e planit të gjashtëmuajorit të parë, shihet se kemi rezultate më të kënaqshme nga përrapa dhe po ta krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, me disa ndryshime të vogla në disa prodhime, ne kemi një tejkalim shumë të madh. Pastaj po të marrim realizimin e gjashtëmuajorit, shihet me kënaqësi se minierat, në radhë të parë, e kanë realizuar dhe tejkaluar planin. Kjo natyrisht ka arësyet e saja që i thanë shokët. Rezultatet e këtij gjashtëmuajori në mimiera janë një fakt pozitiv për shtetin dhe Partinë tonë.

Edhe në industri, po të shohim, janë bërë mjaft përparime. Edhe në këtë sektor ka realizime. Nuk jemi më në situatën e parë, por edhe atje ka mjaft sektorë që nuk kanë realizuar planin dhe që janë mjaft mbrapa. Për disa nga këta do të flas më vonë.

Po kështu edhe në bujqësi, financë dhe në sektorë të tjerë. Vetëm në sektorin e ndërtimit, sikundër u analizua edhe në mbledhjen e Plenumit të mëparshëm të Komitetit Qendror, jemi mbrapa me realizimin e planit.

Një problem tjetër për ndërtimet është që të zgjidhet çështja e projekteve d.m.th. ndërtimet të bëhen me projekte. Kjo nuk do të thotë që tani të fillojmë e të filozofojmë, po kështu si kemi ecur të mos ecim më. Ne kemi caktuar se si duhet të ndërtojmë dhe të ndihmojmë ndërmarrjen e projekteve. Kjo do të caktohet edhe më mirë nga qeveria se mungesa e projekteve ka qenë një çështje me rëndësi për sektorin e ndërtimeve. Tani nuk duhet të bëhen më muhabete; për këtë çështje dhe për këtë problem Komiteti Qendror ngarkon qeverinë ta zgjidhë dhe vitin tjetër kjo punë të jetë vënë në rregull e po të mos jetë zgjidhur Komiteti Qendror të marrë masa pse kemi të gjithë përgjegjësi si qeveri. Kur një dikasteri i sinjalizohet se ka dobësi, i jepet dhe ndihma dhe nuk e kryen punën, sigurisht është përgjegjës. Prandaj të mos i marrim në mënyrë të lehtë këto çështje dhe ne nuk i kemi vënë njerëzit sa duhet përpara përgjegjësisë. Këtu ne kemi faj dhe në të ardhshmen Komiteti Qendror të marrë masa.

Në lidhje me ndërtimet, jemi në gjendje që të caktojmë çmimet e materialeve të ndërtimit gjë që deri

tashti nuk e kemi bërë dhe na ka penguar në çështjet e parashikimeve. Për këto ka disa përcaktime, por vihen vazhdimisht në diskutime dhe sillen arësyetime të përgjithshme. Për ndërtimet ka një eksperiencë dhe ne tani jemi në gjendje të përcaktojmë çmimet e materialeve gjë që duhet bërë mirë dhe i bie detyra qeverisë që të ngarkojë organet kompetente për zgjidhjen e këtij problemi.

Sektorin e ndërtimeve ne duhet ta ndihmojmë në lidhje me çështjen e preqatitjes së kuadrit, pse ky sektor lidhur me kualifikimin e kuadrit në shkollat dhe kurset është shumë pas, jashtëzakonisht pas, dhe nuk mund të ecet më me këtë ritëm që po vazhdohet, prandaj duhet të mendojmë seriozisht për çështjen e preqatitjes së kuadrit të ndërtimeve. Këtë nevojë ta shohim sa më shpejt, bile me të dalë nga kjo mbledhje. Partia të marrë masa pa u vonuar dhe të interesohet në mënyrë të veçantë për çështjen e edukimit të kuadrit, jo vetëm për ndërtimet që duhet të interesohet në radhë të parë, por për të gjithë sektorët e tjera shtetërorë. Për këtë çështje komitetet e Partisë dhe drejtoritë e Komitetit Qendror nuk janë interesuar, kurse ky është një problem shumë i rëndësishëm dhe Partia duhet ta ketë kurdoherë në qendër të vëmendjes. Të marrim parasysh se sektorët e ndërtimeve janë shumë të përhapur, prandaj kanë nevojë për kuadro që këtë çështje ta vënë në rrugë.

Duhet të shihet pikëpamja që ekziston se në tremujorin e parë dhe të katërt d.m.th. në periudhën vjeshtë-dimër planifikimi në sektorin e ndërtimit duhet të jetë më i vogël. Po të qëndrojmë në këtë pikëpamje

do të kemi vështirësi jashtëzakonisht të mëdha për realizimin e planit të ndërtimeve. Në planin pesëvjeçar, plani i vitit 1952 është më i ngarkuar nga të gjithë dhe Byroja Politike e ka parashikuar një gjë të tillë, prandaj neve na bie faji që duke e ditur këtë gjë duhet të kishim marrë masa shumë më serioze. Prandaj mendoj se për ndërtimet duhet të zgjidhim disa probleme përveç ndihmës në përgjithësi që duhet të jepet.

Problem kryesor për sektorin e ndërtimeve është mungesa e fuqisë punëtore dhe siç rezulton kjo është arësyjea kryesore që ndërtimet nuk shkojnë mirë. Ky është një problem i vështirë që duhet ta zgjidhim. Po si duhet ta zgjidhim? Duke marrë parasysh se sektori i ndërtimeve është më i dobët nga çdo sektor tjetër, dikasteret e tjera duhet të marrin masa në lidhje me racionalizimet, me futjen e maqinerive në punë, d.m.th. me mekanizimin dhe çdo sektor të ristudjojë mirë çështjen e fuqisë punëtore dhe të zvogëlojë kësh-tu kërkesat dhe presionet që bëhen për këtë çështje. Dikasteret e tjera të përpilen dhe të manevrojnë gjith-ashtu me ndërmarrjet e ndryshme të tyre. Kjo nuk do të thotë që këtyre të mos u jepet fare fuqi punëtore, po me to të jemi më të shtërnguar dhë t'i jepen më shumë forca ndërtimit. Por edhe ndërtimi duhet të bëjë sforca më të mëdha që të përmirësojë mekanizimin, racionalizimin, të shtohet rendimenti në punë e të forcojë organizimin dhe disiplinën në qendrat e ndërtimit. Metodat e reja në punë, Ministria e Ndërtimit jo vetëm duhet t'i përhapë, por duhet t'i marrë në dorë konkretisht, të organizojë në shkallë të gjerë aplikimin e tyre dhe pas një muaji të shohim konkre-

tisht rezultatet në këtë drejtim. Të kemi si preokupacion kryesor që ta ndihmojmë me fuqi punëtore këtë sektor. Këto përpjekje që janë bërë nga Partia dhe pushteti mendoj se duhet të vazhdohen dhe, megjithëse është mjaft e vështirë, diçka më shumë mund të bëhet për të ndihmuar ndërtimin. Në përgjithësi çështja e fuqisë punëtore, siç thanë edhe shokët, është një problem shumë i madh. Duhet ta kemi mirë të qartë se fuqia punëtore del kryesisht nga fshati. Mirëpo përsa i përket këtij problemi tani situata nuk është e njëllojtë në demokracinë tonë popullore me atë që ndodh në vendet kapitaliste. Ne e dimë se në vendet kapitaliste, kapitalizmi e varfëron fshatarësinë, e detyron këtë të zgresë në qytet, krijon kështu proletariatin dhe në këtë mënyrë siguron krahun e lirë të punës. Kurse te ne ndodh krejt ndryshe. Ne nuk e varfërojmë fshatarin, përkundrazi ja përmirësojmë vazhdimisht konditat e jetesës. Kështu ndodh që konditat e fshatarësisë çdo vit bëhen më të mira dhe jo vetëm të fshatarësisë në fusha, po dhe të asaj të malësive. Edhe për malësitë mund të themi se konditat janë më të mira. Kjo gjendje është shumë e mirë, po e keqja është se fshatarësia jonë, duke qenë se ka parë shumë të zeza në të kaluarën dhe lehtësitet që i ka bërë qeveria ja kanë përmirësuar jetën, të cilën ajo e konsideron shumë të mirë në krahasim me të kaluarën, kënaqet me pak. Prandaj në këtë situatë me zor mund të shkëputet fshatari nga malësia. Fshatarësisë në malësi ne duhet t'i hapim perspektiva, jeta e saj është përmirësuar, po kjo nuk është e mjaftueshme, ajo duhet ta kuptojë që jeta e saj duhet të bëhet akoma më e mirë dhe për këtë ka shumë rrugë. Prandaj

në këtë drejtim duhet të bëhet një punë më e madhe nga Partia që fshatarët të luftojnë prapambetjen e tyre, fanatizmin, analfabetizmin dhe t'i hapet perspektiva fshatarësisë për punën në qytete, në industri e miniera. Por edhe kjo nuk është e mjaftueshme në qoftë se nuk krijojmë në industri, në miniera e në qendrat e punës kondita të favorshme për një jetë më të mirë nga ajo e malësive. Këtu ne çalojmë shumë dhe kjo u vu mirë në dukje, prandaj duhet të marrim masa që ta vëmë në rrugë, ndryshe do ta kemi shumë vësh-tirë nxjerrjen e fuqisë punëtore. Ne mund të tërheqim edhe nga fusha krahë pune, po këtu duhet të kemi kuj-des që të mos na braktisen fushat, pse ka shumë raste të tilla dhe arësyet nuk janë detyrimet e rënda, por janë arësyet të tjera, si p.sh. mungesa e krahut të punës, e kafshëve të punës etj. Është vënë re se ato ekonomi fshatare në zonat fushore që kanë krahë pune dhe kafshë i përballojnë mirë detyrimet ndaj shtetit. Megjithatë në fusha detyrimet mundet të jenë edhe pak më të mëdha. Sidoqoftë ne duhet të tërheqim sa më pak fuqi punëtore nga fshatrat e fushës. Sa për malësitë të mos ua ngremë detyrimet, të qëndrojmë në ato që kemi caktuar, pse vendet malore meritojnë të lehtësohen nga tatimet dhe të përmirësohet gjendi-a e tyre.

Në organizimin e punës për tërheqjen e fuqisë punëtore nga fshati më duket se nuk jemi mirë dhe këtë barrë të rëndë ja kemi ngarkuar Partisë edhe pushtetit lokal. Disa shokë nuk mendojnë aq drejt kur thonë se për këtë çështje të gjithë fajin e kanë komitetet ekzekutive dhe komitetet e Partisë. Ata mund

të kenë gabime të tjera, por në këtë çështje fajti qëndron shumë edhe këtu lart, pse fuqia punëtore nuk mund të nxirret me fushata propagandistike, duhet të vendosen disa rregulla të mira dhe të studjohen këto gjëra në mënyrë shkencore. Por Komisioni i Planit një gjë të tillë nuk e ka bërë deri më sot. Ky është një problem qeveritar, të cilin duhet t'ja paraqesë qeverisë. Një nga aparatet kryesore të qeverisë është Komisioni i Planit, i cili planifikon fuqinë punëtore në bazë të kërkesave të dikastereve të cilët mund të kenë dhe gabime. Mirëpo nuk është vetëm kjo. Komisioni i Planit ka në dispozicionin e vet Drejtorinë e Statistikave dhe të orientojë atje njerëzit të bëjnë studime për këtë problem veçanërisht. Komisioni i Planit duhet të nxjerrë nga gjithë kjo eksperiencë, në sigurimin e fuqisë punëtore konkluzionin për gjithë punën e komiteteve ekzekutive dhe të dikastereve dhe t'i japë qeverisë disa të dhëna konkrete dhe sugjerime për zgjidhjen e këtij problemi në bazë të studimeve vjetore, gjashtëmuore dhe mujore të lëvizjes së fuqisë punëtore. Por Komisioni i Planit as që i ka menduar këto gjëra. Të marrim çështjen e regjistrimit të popullatës. Kjo ka një qëllim që bëhet po nuk është shfrytëzuar fare, por dhe sikur të jetë bërë për disa probleme, ne nuk shohim asgjë konkrete. Në lidhje me fuqinë punëtore regjistrimi i popullatës ka rëndësi të madhe dhe këtë ja kemi sinjalizuar shokëve të Komisionit të Planit. Kur ja kërkua më herën e parë përpunimin e këtij problemi kaq të madh na u tha se nuk i takon. Më në fund u zgjidh, por u desh përsëri që t'ja themi të na tregonë se sa njerëz ka vendi ynë, as këtë nuk ja ka sjellë qeverisë. Në

lidhje me fuqinë punëtore ne kemi Drejtorinë e Rezervave së cilës qeveria duhet t'i japë disa orientime, të paktën statistikat në bazë të të dhënavë të regjistrimit të popullsisë. Kështu Komisioni i Planit t'i thoshte Drejtorisë së Rezervave që kemi kaq krahë pune të kësaj dhe asaj moshe, kaq gra, të rinj nga kjo moshë deri në këtë moshë dhe ku i kemi këto forca. Pastaj duhej bërë llogari me kalem në dorë se sa krahë i nevojiten bujqësisë, sa ju duhen aparateve shtetërore etj. T'i jepet Drejtorisë së Rezervave orientim dhe kjo të ketë një bazë konkrete për të ditur se cilat janë nevojat e një rrethi dhe sa forca disponibël ka. Këto të dhëna Drejtoria e Rezervave ua dërgon komiteteteve ekzekutive. Në këtë mënyrë Partia ta zgjidhë më mirë çështjen e fuqisë punëtore, pse do të ketë përpara shifra konkrete për çdo fshat ku mund të nxirren kaq ose aq punëtorë. Sigurisht këto janë orientime. Pastaj po të vendoset rregulli Drejtoria e Rezervave mund të mbajë evidencën e lëvizjes së fuqisë punëtore. Kështu lehtësohet shumë puna e Partisë dhe e komiteteteve ekzekutive dhe plani i sigurimit të fuqisë punëtore bëhet real. Por Komisioni i Planit për këtë punë nuk e vë ujin në zjarr dhe të pranojë që kjo është një punë e tij.

Ne flasim shumë për futjen e gruas në prodhim, por për këtë problem nuk kemi të dhëna. Nuk është e vërtetë që gruaja nuk futet në punë pse faktet tre-gjnjë që në shumë rrethe gruaja punon në punë bujqësore. Mirëpo ne si qeveri duhet ta dimë se në cilat zona punojnë gratë dhe në cilat nuk punojnë dhe nga një gjë e tillë mund të nxirren detyra edhe për Partinë, për të luftuar fanatzimin dhe për të térhequr gruan

në punë. Me një fjalë, të bëhen studime shkencore dhe të orientohen drejt Partia dhe pushteti në cilat rrethe çalon nxjerrja e fuqisë punëtore ose për cilat arësyen çalon. Po këtu ne nuk jemi të rregullt, prandaj çështja e sigurimit të fuqisë punëtore duhet të bëhet objekt i një studimi shkencor; të dhënët i kemi, prandaj të bëhet shpejt, të mos na ndalojnë format burokratike, pse ky është një problem urgjent që duhet ta zgjidhim sa më parë. Por ky problem nuk mund të zgjidhet, po të mos zhvillojmë mekanizimin e punimeve në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Masat ne duhet t'i marrim, pse pa organizim ne përsëri do të gjejmë vështirësi, por mekanizimi do të na shpëtojë e sidomos mekanizmi i bujqësisë për të cilin kongresi dhe Plenumi X i Komitetit Qendror¹ kanë vendosur drejt, se duhet t'i vihet rëndësi e madhe mekanizmit të bujqësisë. Për këtë duhet të kërkojmë ndihmë nga Bashkimi Sovjetik dhe kjo do të na jepet. Ndihma sovjetike do ta zgjidhë drejt çështjen e mekanizmit të bujqësisë. Por mekanizmi në këtë sektor të mos na gjejë të papregatitur. Këtë gjë Byroja Politike ja ka vënë në dukje shokut Hysni në mënyrë që për traktoret që do të vijnë të ketë njerëz që t'i drejtojnë dhe këta njerëz do të dalin nga shkollat. Shoku Hysni ka marrë angazhim për këtë çështje, ka bërë prepatitje, pse, sigurisht, qeveria sovjetike përpara se të na i dërgojë traktoret dhe maqinat e tjera do të na pyesë nëse kemi njerëz t'i drejtojmë.

Prandaj për të sigruuar fuqinë punëtore duhen bërë

¹ Kongresi II i PPSH. dhe Plenumi X (i korrigjuar) i KQ të PPSH që u mblohdh më 14 maj 1951.

sforca imediate dhe pastaj menjëherë të bëhen studime, të konkretizohen dhe të kemi rezultate në këtë drejtim.

Përsa i përket çështjes së kuadrove, edukimit të tyre, shkollave, kurseve, teknikumeve të ndryshme, duhet të kemi parasysh kritikën që u bëri Komiteti Qendror dikastereve veç e veç dhe qeverisë lidhur me këtë problem, i cili duhet të na preokupojë seriozisht dhe t'i japim fund kësaj situate. Të marrim shembull nga ushtria dhe Ministria e Brendshme që e kanë zgjidhur dhe vazhdimisht e zgjidhin me sukses çështjen e edukimit të kuadrit; pavarësisht nga fakti se atje kemi kuadro më të preqatitur, në sektorë të tjerë shohim që shkollat dhe kurset neglizhohen edhe kur mundësitetë e dikastereve janë. Ka një mosinteresim të çuditshëm në këtë drejtim. Problemi i mungesës së kuadrove po u lidh duart dikastereve e megjithatë nuk i vihen ta zgjidhin, nuk interesohen si duhet. Mua më duket se nuk duhet të vazhdohet në këtë mënyrë që dhe për gjëra të paarësyeshme nuk hapen shkollat, siç ndodh në Ministrinë e Ndërtimit e cila nga 7 shkolla të parashikuara në plan nuk hapi 5, dhe kjo ministri është nga ato që ka nevojë më shumë për kuadro. Kështu ndodh edhe me Ministrinë e Komunikacionit edhe me të tjera që qahen shumë për mungesë kuadri, por nuk bëjnë gjë në këtë drejtim. Ky problem është analizuar, shokët kanë shkuar poshtë dhe ne kemi mundësi të gjejmë njerëz sa të duam për të plotësuar këto kurse. Është e pakuptueshme të mos dihen arësyet pse nuk vijnë njerëz në kurse. Kur rastis të takohemi shumë të rinj na thonë se duan të shkojnë në kurse e shkolla. Por për këtë çështje komitetet e Partisë nuk punojnë si

duhet, kanë një dobësi të madhe, prandaj duhet që aparati i Komitetit Qendror t'ua shtrojë me forcë këtë problem komiteteve të Partisë pse ka me qindra të rinj që duan të shkojnë në kurse e shkolla. Kam takuar një plakë, nënë dëshmori, që ka dy djem të cilët kanë mbaruar uniken dhe kanë kërkuar bursë për të ndjekur shkollën, por komiteti i Partisë u thotë se bursat janë mbaruar. Për këtë çështje i bie një barrë e madhe Partisë dhe faji është në komitetet e Partisë poshtë. Prandaj duhet ta ndryshojmë këtë situatë.

Shumë propozime të mira u bënë për shfrytëzimin e maqinerive që për ne akoma është një plagë e madhe. Këto propozime dhe vendime duhet t'i marrim ne të qeverisë dhe t'i konkretizojmë. Jo vetëm ministrat që duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet në sektorin e tyre për shfrytëzimin e maqinerive, po këtu u bënë disa propozime për qeverinë që ta marrë në shqyrtim këtë problem. Këtu u thanë shumë gjëra për maqineritë që nuk shfrytëzohen, për veglat e këmbimit që mungojnë etj. Të gjitha këto qeveria duhet t'i konkretizojë dhe të veprohet në këtë drejtim. Këto propozime janë bërë me kohë, po rezultate të dukshme nuk kemi. Në qeveri kemi marrë vendim që të bëhet inventari i të gjitha maqinerive të tepërtë që nuk shfrytëzohen dhe t'i dërgohet Komisionit të Planit, i cili deri më sot nuk i ka dhënë asgjë qeverisë se ç'duhet të bëhet me to. Këtë gjë ne e bëmë për të pasur të qartë situatën mbi këto gjëra, të shohim sa janë në të vërtetë dhe këto që kemi t'i përdorim si duhet. Këtë punë Komisioni i Planit nuk e ka bërë si duhet, prandaj të bëhet sa më parë me propozime të qarta dhe, po të kemi mundësi, të krijojmë

brenda një kohe sa më të shkurtër një uzinë ose të ndreqim ato që janë për t'u ndrequar.

Në lidhje me kursimet të gjithë sektorët duhet të bëjnë përpjekje akoma më të mëdha, pse kemi mjaft humbje nga projektet e fryra, nga shpenzimet e paparashikuara dhe vjedhjet e dëmtimet e armikut, të gjitha këto influencojnë jashtëzakonisht në buxhetin tonë. Ne mund të shpëtojmë nga një situatë e tillë vetëm me një disiplinë të rreptë, me një goditje të ashpër kundër atyre që shpërdorojnë, me një presion të fortë moral kundër të gjithë vjedhësve dhe abuzuesve duke i demaskuar publikisht në të gjitha qendrat e punës dhe ndërmarrjet ekonomike për ta diskredituar hajdutin moralisht. Këtu u bënë propozime konkrete përsa i përket hartimit të projekteve sa më pak të kushtueshme. Edhe projektet që vijnë nga BS duhet të shikohen, anekset e tyre të bëhen në fund fare dhe vetëm po të jetë e nevojshme të bëhen.

Përsa u përket industrive të reja, duhet të tregojmë kujdes shumë të madh në lidhje me kuadrin dhe me prodhimin. Prodhimi nuk duhet të realizohet në kurriz të sforcave të jashtzakonshme të klasës punëtore dhe të kuadrove. Prandaj kemi përgjegjësi të madhe për të realizuar planin qoftë si qeveri ashtu edhe si Komision i Planit si edhe dikasteret e tjera ekonomike. Nuk është e lejueshme të diskutohet këtu jo më the ti, jo e pranoi ai, por këtu duhet të përcaktohen mirë përgjegjësitë e shokëve dhe të mos kërkojnë t'u shpëtojnë këtyre përgjegjësive, të thonë më mirë haptas që e bëmë këtë gabim, se sa e bëri ai ose e bëri ky pse një qëndrim i tillë nuk është komunist. Mbi këto studime dhe plane ne

mbështetim planin e tregëtisë, të financës etj., prandaj duhet të realizohen dhe të merren masa për realizimin e tij se p.sh. në Kombinatin e tekstileve një vidë të na këputet dhe na pakësohen 10 000 metra pëlhirë në ditë gjë që shkakton konsekuencia të rënda për sektorin e tregëtisë, të financave, për furnizimin etj. Prandaj kur bëhet plani të mendohet mirë nga dikasteret dhe nga zëvëndëskryeministrat, se te ne ka pasur tendenca që të predominojë dëshira. Ne themi se duhet të bëjmë sakrifika, por këto nuk duhet të rëndojnë mbi kurrisin e punëtoreve të reja të tekstit, të dobësoshet rritja e tyre, t'i sëmurim dhe si rrjedhim të largohen nga puna. E përse? Për fajet e mungesat tona. S'është hera e parë që theksohet se duhet të përmirësohen konditat e punëtorëve, po punëtorët e Bizës ishin lënë si mos më keq, edhe barrakat ju dogjën dhe nuk kishin vend as ku të flinin. Po ta merr mendja, që në një qendër të tillë pune nuk të vjen njeri. Po të tregohet kujdesi i duhur, atje edhe në dimër mund të punohet, vetëm se duhet të përmirësohen konditat, të jepen sharra për të prerë, të ngrihen shtëpi prej druri, të sigurohet zjarr për ngrohje, veshimbathje etj. Nuk lejojmë që rruga e Bizës të mylljet në dimër, se i kemi të gjitha mjetet që mund ta pastrojmë borën. Ka shumë gjëra që dikasteret tona mund dhe duhet t'i ndreqin. Mënyrat u thanë dhe nuk është nevoja të zgjatem.

Përsa i përket furnizimit dhe ushqimit të popullit ky është një problem që duhet të na preokupojë jashtëzakonisht, sepse ka pasur dobësi të mëdha dhe propozimet që bëri Kiçua [Ngjela] më duket se ishin shumë konstruktive dhe e ndihmuani Komitetin Qendror.

Komiteti Qendror duhet të nxjerrë një rezolucion të veçantë për këtë problem ose të vihet një paragraf i veçantë në rezolucionin e plenumit dhe kryesia e qeverisë të bëjë një urdhèresë ku të përcaktohen detyrat për të gjitha organet përkatëse shtetërore dhe ato të zbatohen. Unë besoj se Komiteti Qendror është dakord për këtë dhe në këtë mënyrë të përmirësohet situata, të parashikojmë nevojat e dimrit dhe t'u dalim përparravështirësive. Një situatë e tillë duhet të na preokupojë sidomos për vitin e ardhshëm dhe propozimet që u bënë këtu për qytetin duhet të studjohen më konkretisht nga Ministria e Bujqësisë. Preokupante për ne është çështja e mishit. Këtë problem, ne mund ta zgjidhim tanë ashtu siç tha Kiçua d.m.th. është më mirë që të mos nxjerrim shumë mish tanë në treg, kur ka më shumë zarzavate po t'ja sigurojmë këtë për dimër. Ministria e Bujqësisë bashkë me atë të grumbullimit ta studjojnë mirë këtë çështje se në fakt blegtoria, sidomos kafshët e trasha, po pakësohen, natyrisht nga therjet. Por edhe bagëtitë e imta nuk rriten me ritmin e duhur. Për këtë ne nuk kemi akoma një studim konkret, të cilin duhet të na e bëjë Ministria e Bujqësisë. Në rast se ne shkojmë duke u dobësuar në çështje të blegtorisë, duhet të mendojmë për furnizimin e popullit. Çështja është që duhet të mendojmë për shtimin e blegtorisë, të vëmë pak dhjamë pastaj ta shtojmë gradualisht racionin e mishit. Lidhur me këtë problem duhet të na preokupojë çështja e zëvendësimit të mishit. Çfarë do t'i japim popullit në rast se realizimi i planit të zënjes së peshkut shkon sikurse ka shkuar deri më sot? Edhe për shtimin e shpendëve nuk vihet ujët në zjarr; ishte caktuar edhe

ferma e Dukatit për rritjen e tyre, por puna s'po ecën mirë. Çfarë do t'i japim popullit në rast se gjahu nuk vihet në rrugë, në rast se konservimi i zarzavateve lihet pasdore? Harrova të thosha pastaj për çështjen e derrit. Të gjitha propozimet që u bënë për shtimin e tij duhet t'i zbatojmë. Vetëm me këto masa dhe me një kontroll të rreptë për disa vjet, pa therur bagëti si sot, ne do ta përmirësojmë gradualisht furnizimin me mish dhe do të mbrojmë blektorinë.

Partia duhet të mobilizohet edhe për problemet e kooperativave të shitblerjes që të zhduken anomalitë që ngjasin në këtë sektor. Këtyre çështjeve nga ana shtetërore dhe administrative duhet t'u kushtohet një vëmendje e jashtzakonshme, por duhet që Partia ta kuptojë mirë këtë gjë më konkretisht; atje ku ka kooperativa shitblerjeje dyqanet duhet të gjallërohen, të funksionojnë në rregull asambletë e kooperativave dhe anëtarët ta ndjejnë se këto punë u takojnë edhe atyre. Prandaj për këtë nuk duhet të punojë vetëm kryetari i kooperativës, por të gjithë komunistët e fshatit dhe këto detyra të kryhen në rregull. Të forcohet kontrolli nga masat dhe nga lart në kooperativat, të zbatohet statuti. Kooperativat e shitblerjes duhet të jenë shumë ekzigjente ndaj kooperativave të artizanatit dhe industrisë. Duhet të punojë dhe Partia për forcimin e gjendjes në kooperativa, të cilat mund të luajnë një rol mjaft më rëndësi për lidhjen e fshatit me qytetin. Këto çështje ne i kemi parë dhe një situatë të tillë duhet ta ndryshojmë. Për këtë i vihet detyrë Partisë.

Sikundër u tha, si në Byronë Politike ashtu dhe në qeveri, ne kemi marrë vendim për forcimin e industrisë

lokale dhe të artizanatit dhe besojmë që të kemi rezultate në këtë drejtim. Zhvillimi i këtij sektori do të shtojë mjaft prodhimin, do të ndihmojë shumë në furnizimin e masave të popullit me prodhime të fabrikuara dhe si industria lokale ashtu dhe artizanati do të bëhen një ndihmë e madhe për industrinë nacionale. Në këtë drejtim ka mjaft mundësi, vetëm se duhet një punë më e organizuar, të edukohen njerëzit e artizanatit me frymën e Partisë. Vërejtjet e kërkesat që bëri Kristua¹ dhe disa shokë të tjerë, për ndihmën që duhet t'i japë Partia artizanatit, janë të drejta dhe aparatit i Komitetit Qendror me drejtoritë e tija duhet të punojnë që puna aty të përmirësohet dhe do të përmirësohet. Drejtoritë e aparatit të Komitetit Qendror duhet të interesohen më gjallërisht nga kjo anë. Punonjësit e aparatit të Komitetit Qendror duhet të mësojnë në profesionin e tyre, të studjojnë dhe ne të gjejmë kështu një rrugëdalje.

Çështja e kulturës së përgjithshme të punonjësve të aparatit të KQ është vënë në rrugë të drejtë në bazë të vendimit që ka marrë Byroja Politike dhe ata po ndjekin sot shkollat. Përsa i përket anës profesionale duhet t'u bëhen favore për të ndjekur teknikumet ekonomike sipas sektorit ku punon secili dhe shokëve, që kanë mbaruar shkollat e mesme, qoftë edhe jo të plota, t'u jepet mundësi që të ndjekin shkollat e larta dhe në një të ardhshme të afërt të jenë në gjendje të kuptojnë mirë nga zanati që të mund të japid ndihmën e tyre, kur të venë poshtë, në nivelin që kërkohet prej tyre.

¹ Kristo Themelko — kryetar i Bashkimit Qendror të Koperativave të Artizanatit.

Në përgjithësi këto kisha për të thënë. Përpara kësaj barre që na ngarkohet duhet të mobilizohemi të tërë, ta organizojmë më mirë punën qoftë nga ana shtetërore ose nga ajo e Partisë. Rezolucioni që do të nxjerrim duhet të punohet mirë në të gjithë Partinë, veçanërisht në qendrat ekonomike, sepse ka një rëndësi të madhe për këto t'i analizojnë mirë dobësitë e tyre dhe të kuptojnë si duhet detyrat që u vë përpara Komiteti Qendror për realizimin e gjashtëmujorit të dytë dhe këto detyra të shoqërohen me një kontroll dhe masa të rrepta shtetërore e të mos mbeten vetëm të thëna të drejta. Prandaj në aplikimin e këtyre vendimeve nga ana shtetërore duhet të jemi rigorozë e të mos bëjmë lëshime, d.m.th. të arrijmë të zhdukim të metat edhe në aparatet e Partisë dhe të shtetit. Është me rëndësi çështja që në Parti i vëmë mirë në dukje të metat, të cilat edhe këtu u vunë në dukje mjaft gjerë. Megjithatë në shumë raste shokët e Partisë nuk kanë qenë mjaft vigjilentë përsa i përket pastrimit të radhëve të Partisë nga elementët e pandërgjegjshëm. Çështja e disiplinës dhe e ndërgjegjes proleta e duhet të ngrihet me forcë në Parti dhe të jepen dënlime të ashpra, shembullore, të rrepta kundër komunistëve që vjedhin dhe të luftohen qëndrimet librale në këtë drejtim, kur fajtori është komunist. Përkundrazi anëtarët e Partisë që vjedhin duhet të dënohen më rreptë që të shohin të tjerët se sa rigoroze është Partia për njerëzit e vet. Çështja e edukimit të njerëzve për një qëndrim komunist ndaj pronës shoqërore duhet të jetë në qendër të vëmendjes. Po të shihen disa të dhëna janë mjaft alarmante si p.sh. në Fabrikën e zhveshjes së pambukut në Fier, ku janë depozituar nga

Ministria e Industrisë 19 000 kv. farë pambuku që është kalbur e tëra bashkë me 1 000 thasë duke i shkaktuar kështu shtetit një humbje prej më se 1 000 000 lekë. Prandaj ky problem duhet ta preokupojë shumë Partinë dhe shtetin se njerëz të tillë siç janë vjedhësit e dëmtuesit e pasurisë së shtetit jo vetëm na shkatërrojnë, ekonominë, po ky ves i bën të rrëshqasin edhe në punë të tjera armiqësore si spiunazh, diversion etj. Prandaj kundër të tillë elementëve duhet të luftohet energjikisht dhe çështja e vigjilencës revolucionare duhet të jetë në rendin e ditës. Shumë herë lihen dhe humbasin gjëra të rëndësishme dhe nuk mbahet gjallë dhe vazhdimisht porosia e vazhdueshme e Partisë në lidhje me mbrojtjen e sektorëve të shtetit. Shokët ministra dhe të gjithë funksionarët e Partisë dhe të shtetit në këtë drejtim duhet të hapin sytë se armiku përdor shumë metoda të rafinuara. Nga të dhënat që kemi del se armiku nuk punon me forma të trasha, por me forma jashtëzakonisht të rafinuara që njerëzit në sigurim, në saje të përpjekjeve të tyre për t'u perfektuar, kanë arritur t'i zbulojnë. Pra armiku përpinqet të zbulojë ato që ne i ruajmë me kujdes, pastaj merre me mend ç'bëhet kur funksionarët tanë i lënë hapur dyert, ose lëshojnë shifra andej-këtej pa asnjë përgjegjësi apo u thonë personave të tjerë gjëra që nuk u përkasin. Armiku i hap veshët dhe sytë të marrë gjëra që janë më të vështira të gjenden, jo më këto që njerëzit tanë ua servirin vetë padashur. Prandaj Partia duhet të mobilizohet në këtë drejtim.

Një detyrë preokupante për komunistët dhe për të gjithë Partinë është zbatimi i ligjeve. Komunistët duhet t'i respektojnë dhe t'i zbatojnë ligjet dhe Partia të inten-

resohet jashtëzakonisht për t'u dhënë vijën aparateve të drejtësisë dhe të prokurorisë. Në përgjithësi jam dakord me sa tha shoku Siri¹, vetëm dua të shtoj se më duket sikur ai diskutoi pak me një frymë pesimiste për gjendjen në këtë drejtim. Mua më duket se një frymë e tillë «e dëshpëruar», nëse është kështu, duhet të zhduket; sigurisht që ka gabime nga ana e shokëve edhe në çështjen e ligjshmërisë dhe për këto duhet të luftohet që të mos bëhen gabime të tillë dhe jo të shkelen ligjet e të mos merren masa. Mundet që ekziston kjo gjë dhe shumë komitete partie nuk interesohen sa duhet jo vetëm të nxjerrin konkluzione nga të dhënat e prokurorisë, por edhe t'i japin orientimin asaj. Këtu është e meta e madhe që Partia, duke mos u interesuar si duhet për çështjen e vjedhjeve, abuzimeve e krimeve të tjera, nuk e orienton drejt prokurorinë. Në raportet tuaja Partia duhet të shohë se si i zgjidh këto çështje prokuroria dhe njëkohësisht ta mësojë atë dhe vetë të kontrollojë vjedhjet, të shohë si është situata. Është e drejtë që Partia duhet të interesohet për çështjen e organeve që zbatojnë ligjshmërinë dhe ka raste që as thirren prokurorët nga komitetet e Partisë, as nuk merren prej tyre në shqyrtim çështjet e drejtësisë. Edhe nga Drejtoria administrative e Komitetit Qendror, siç tha Siri, mund t'u jepet një ndihmë konkrete organeve të drejtësisë, prandaj një situatë e tillë duhet të marrë fund. Duke u interesuar për këto probleme të rëndësishme, Partia i shtron çështjet në mënyrë parimore

¹ Siri Çarçani — në këtë kohë Prokuror i Përgjithshëm i Shtetit.

dhe përpinqet t'i zhdukë fajet dhe gabimet në praktikë, si me anë të propagandës dhe mjeteve të tjera; një nga pasqyrat që ka Partia dhe që sheh dhe rezultatin e punës së saj është lidhja e ngushtë me studimin e punës që bën prokuroria. Kështu do t'i ndihmojë Partia organet e drejtësisë dhe prokurorisë.

Përsa i përket rezolucionit propozoj të përpunohet më mirë, sepse Komiteti Qendror na dha shumë ndihmë për ta bërë akoma më të gjallë këtë dhe me detyra akoma më të rëndësishme që dolën këtu. Prandaj të na jepet një afat prej 5-6 ditësh që ta përpunojmë mirë dhe ta paraqesim për aprovim në një mbledhje të veçantë të Komitetit Qendror.

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

FJALA NË KONGRESIN E TRETE TË BASHKIMEVE PROFESIONALE TË SHQIPËRISË

20 gusht 1952

Të dashur shokë dhe shoqe,

Më lejoni t'ju falenderoj për pritjen që më bëtë dhe t'i sjell kongresit tuaj, dhe nëpërmjet jush, klasës punëtore të vendit dhe gjithë punonjësve të Shqipërisë, përshëndetjet më të nxehta revolucionare nga ana e Komitetit Qendror të Partisë së Punës dhe nga ana ime.

Kongresi që mbani sot është një ngjarje shumë e rëndësishme në jetën politike dhe ekonomike të vendit, duke marrë parasysh qëllimet e këtij kongresi, momentet nga ku kalojmë, dhe se në këtë kongres janë dërguar njërejt nga më të mirët e klasës punëtore që është baza sociale e shtetit tonë të demokracisë populllore.

Sigurisht, punimet e këtij kongresi do të kenë konsekuencia të shkëlqyera në realizimin e detyrave historike që u vuri gjithë punonjësve të vendit Kongresi II i Partisë së Punës. Detyrat konkrete që ju do të përcaktoni për klasën punëtore dhe punonjësit në përgjithësi, do të forcojnë akoma më shumë hovin revolucionar dhe entuziazmin në punë, për realizimin me sukses të planit

pesëvjeçar ekonomik të shtetit, do të çelnikosin ndërgjegjen e klasës në punonjësit, disiplinën në punë dhe këto do të sjellin me vete përmirësimin akoma më të madh të jetës së punonjësve, forcimin e mbrojtjes së atdheut tonë dhe do të jepin njëkohësisht një kontribut të çmuëshiën përmes mbrojtjen e paqes në Ballkan dhe në botë.

Ndryshime kolosale janë bërë në jetën e punonjësve të vendit tonë në këtë periudhë relativisht të shkurtër, që kur ne fituam me armë në dorë, dhe në saje të përkrahësve tanë të lavdishëm, Bashkimit Sovjetik dhe Stalinit të madh, lirinë dhe sovranitetin e atdheut tonë. Shqipëria e vogël, e prapambetur, e shtypur vazhdimisht nga imperialistët dhe nga klasat sunduese feudalo-borjeze, mundi më në fund të këputë përgjithmonë prangat e robërisë dhe të ecë në rrugën e përparimit, në rrugën e ndritur të socializmit. Po të mendojmë pak të kaluarën e zezë të popullit tonë, mizerjen, urinë, vuajtjet, okupacionin, djegjet, gjakosjet, torturat dhe shndrimet që i bëheshin popullit tonë, po të mendojmë prapambetjen e tmerrshme të bujqësisë dhe mjerimin e madh të fshatarësë, mungesen gati të plotë të industrisë dhe mizerjen e punëtorëve, gjendjen kulturale dhe arësimore shumë të vajtueshme, dhe ta bërazojmë këtë të kaluar me realitetin e sotshëm të atdheut tonë, me plot bindje mund të krenohet populli shqiptar me klasën e tij punëtore dhe me pararojën e lavdishme të saj, Partinë e Punës të Shqipërisë që e udhëhoqën atë në rrugën e të gjitha këtyre fitoreve.

Populli shqiptar ka sot një industri të tijën që përbëhet prej kombinateve madhështore nga më modernet,

të sjella nga Bashkimi Sovjetik, ka fabrika, uzina, oficina, të ndërtuara në një kohë kaq të shkurtër. Të gjitha këto prodhojnë me materialin e parë të vendit për popullin. E merrni me mend ç'kusëri e tmerrshme i bëhej popullit tonë nga imperialistët e huaj dhe nga tregëtarët matrapazë të vendit, duke i shitur popullit tonë rreckat e tyre me çmime aq të shtrenjta saqë e detyronin popullin punonjës të rrinte zhveshur e zbatthur, ose për të blerë një këmishë trupi duhej të jepte dhe kilen e fundit të prodhimit të tij, që i shërbente për të mbajtur gjallë frymën e kalamaneve të uritur. Sot populli shqiptar, ka bezen e tij, ka sheqerin, makaronat, vajin, djathin, çimenton, lëndën e drurit, par mendat e qindra e qindra prodhime të tjera që fabrikohen në vend nga fabrikat dhe nga duart e arta të klasës së tij punëtore. Fshatari ynë që s'kishte as tokë as par mendë as shtëpi as katandi, sot i ka të gjitha të mirat. Toka është e tij, shtëpia dhe prodhimet janë të tijat. Por s'mjafton kaq. Pushteti i tij popullor, që ai luftoi për ta ndërtuar, e ndihmon vazhdimesht të përmirësojë jetën dhe punën e tij, të prodhojë më shumë dhe të lodhet më pak, të rrojë më mirë dhe të zhvillohet më shpejt. Fshatarit i vjen në ndihmë shteti me kredi, me mekanizime e me kanalizime, me bonifikime, me kuadro të mësuar bujqësorë, me metoda agroteknike të përparuara. Ashtu si ka ndryshuarjeta e punëtorëve tanë, ashtu si ka ndryshuarjeta e fshatarësise sonë, ashtu ka ndryshuar dhe faqja e vendit tonë. Në Shqipëri nuk të zë më syri gjermadha, rrënimë ose vende të shkreta. Nga të katër anët të zë syri kombinate dhe fabrika që punojnë, të tjera që po ndër-

tohen, me qindra banesa të reja për punonjësit. Janë ndërtuar dhe po ndërtohen hidrocentrale madhështore që do të elektrifikojnë industrinë dhe gjithë vendin tonë, janë ndërtuar dhe po ndërtohen vija hekurudhore të reja, janë ndërtuar dhe po ndërtohen rrugë të reja automobilistike. Industria jonë minerale po zgjerohet dhe modernizohet. Ekipë gjeologjike po studjojnë tokën tonë për t'i dhënë popullit akoma më shumë, naftë, qymyr, bakër, krom, bitum, hekur etj. Fushat tona nuk janë më të shkretuara, në to lulëzon pambuku, gruri, misri, lule dielli etj.; ato çahen nga qindra traktorë të fuqishëm sovjetikë dhe përshkohen nga kanale të panumërtë ujitëse dhe kulluese, që janë vepra mëdha mështore të regjimit tonë popullor. Me mijëra hektarë moçalishte janë kthyer në tokë prodhuese dhe atyre që akoma ekzistojnë po u afrohet fundi. Këneta e Tërbufit dhe ajo e Karavastasë do të pësojnë fatin e Maliqit. Lumi i Drinit, i Matit dhe Vjosë plakë nuk do të lëvrijnë më lirisht dhe të mbytin sipas qejfit të tyre fushat e atdheut tonë. S'është e largët koha kur këta lumenj do të kalojnë medoemos atje ku do t'u caktojë vendin vullneti i çelniktë i popullit dhe i Partisë dhe ujët e këtyre lumenjve do të shërbejë jo më për të përmbytur dhe shkatterruar, por për të vaditur dhe për të sjellë jetë, në fushat e Shkodrës, të Zadrimës, të Lezhës, të Fierit, të Lushnjës.

Tok me mirëqenjen ekonomike të masave të gjera punonjëse të vendit, shkon dhe zhvillimi i tyre politik, arësimor dhe kultural. Po zbukurohet shpirti i njerëzve, po ngrihet ndërgjegjja politike e njerëzve dhe zhvillohet truri dhe intelekti i tyre me dituri e me shkencë.

Po farkëtohet nga Partia një patriotizëm i flaktë në popull, krijohet dhe çelnikoset një besim i patundur në popull për forcën e tij të madhe krijuese, një vendosmëri e papërkulur për të mbrojtur me sukses fitoret e mëdha që ai ka korrur me luftë, me gjak e me djersë. Kaloi dhe s'kthehet më koha për mbeturinat e klasave të shtypura sunduese dhe të padronëve të tyre imperialistë që të gënjejnë dhe të shfrytëzojnë popullin tonë. Ata kanë të bëjnë me një popull trim e të vendosur në rrugën e ndritur të socializmit, me një popull që u dha mësimin e merituar gjatë Luftës së dytë botërore dhe vazhdon gjithmonë, me vepra dhe me rezultate të provojë forcën e pamposhtur të ideve gjeniale të Leninit dhe të Stalinit, forcën dhe superioritetin e regjimit socialist mbi atë kapitalist. Imperialistët dhe shërbëtorët e tyre duhet ta dinë mirë, se populli ynë nuk fle mbi fitoret që ka korrur, por është shumë vigjilent ndaj manevrave dhe kërcënimive të tyre kriminale. Populli ynë e di mirë, se ç'pregatitje të tmerrshme për luftë bëjnë imperialistët amerikanë, anglezë dhe satellitët e tyre kundër njerëzimit dhe veçanërisht kundër popullit tonë. Pregatitjet e tyre për luftë do të dështojnë, pse forca e madhe e kampit të paqes, që udhëheq Bashkimi Sovjetik dhe Stalini do t'uua prishë planet e tyre kriminale. Popujt janë kundër luftës agresive dhe luftojnë me vetëmohim për paqen, popujt janë kundër skllavërimit, urisë, mizerjes, të shkaktuara nga kapitali dhe luftojnë me vetëmohim dhe me sukses kundër zgjedhës kapitaliste. Populli shqiptar që shekuj me radhë i ka vuajtur në kurriz tmerret e imperializmit dhe të klasave feudalo-borgjeze, lufton me vendosmëri

për paqen dhe njëkohësisht është shumë vigjilent. Koburen pas brezi dhe pushkën në sup shqipua i mban edhe tash që ndërton kombinatet madhështore, edhe kur lëron tokën, edhe kur pajiset me dituri e me shkencë. Hallet dhe vuajtjet na kanë bërë të tillë, bishat imperialiste dhe shërbëtorët e tyre na e imponojnë këtë gjendje. Kurrë këta gjakatarë nuk do ta gjejnë popullin tonë në befasi, por në rast se luajnë me zjarrin do të gjejnë përpara një kala të çelniktë, një popull trim dhe të vendosur për të mbrojtur jetën, kulturën dhe pasurinë e tij, një popull të bashkuar si një trup i vetëm rrëth Partisë së tij heroike dhe qeverisë së Republikës. «Të dy duart për një kokë» thotë shqiptari, dhe imperialistët, titistët dhe fashistët e tjerë e dinë se shqiptarët edhe kokën, edhe duart, edhe zemrën i kanë të forta.

Kundërshtarët e regjimit tonë, armiqtë e klasës punëtore dhe të popullit shqiptar, feudalët dhe borgjezët që ne i dërmuam ushtarakisht, politikisht dhe ekonomikisht, mendonin, me gjithë disfatat e tmerrshme të tyre, se regjimi i demokracisë popullore në vendin tonë do t'i kishte ditët e shkurtëra dhe se nc do të pësonim disfata të njëpasnjëshme politike, ekonomike, kulturale etj. Natyrisht, ngjau e kundërtë e asaj që ëndërronin dhe predikonin elementët e klasave feudalo-borgjeze. Ç'ka ngjarë në Shqipëri? Përparimet dhe fitoret e mëdha që ka korrur dhe po korr vazhdimeshit populli shqiptar, nën udhëheqjen e Partisë dhe të qeverisë së tij janë sheshit. Çdo njeri i sheh dhe të gjithë punonjësit e vendit tonë gjëzojnë frutet e këtyre fitoreve. Përpara realitetit të prekshëm të vendit tonë, sa

qesharake dhe sa të ndyra bëhen shpifjet dhe të lehurat histerike të tradhëtarëve shqiptarë në emigracion, këto pllaka gramafoni të imperialistëve amerikano-anglezë, të titistëve e të tjerë. Sigurisht, tradhëtarët e vendit tonë, nga grazhdi i dollarit dhe i dinarit, mund të përpiqen ta bëjnë të bardhën të zezë, por çështja është se duhet të gjejnë klientë syleshë që t'u besojnë. Këtu është e keqja për ta, se jo vetëm që populli shqiptar është kundërshtari i rreptë i tyre dhe nuk çan kokën për këto të lehura në hënëz, por edhe miqtë e tyre, reaksionarë brenda në Shqipëri, të struktur nëpër vrima, kur mundin të dëgjojnë ngandonjëherë «vazin pa qitap» të këtyre tradhëtarëve, sigurisht thonë mie vete: «Vaj ne ç'njerez u kemi pasë besuar dhe në çfarë njerez ne kishim varur shpresat e shpëtimit tonë!». Të tillë fat ka propaganda shpifëse dhe e ndyrë e radiove: Zëri i Amerikës, Londrës, Beogradit dhe e pllakave të gramafonit të tyre. Por a ka tjetër rrugë veprimi për tradhëtarët? Jo, s'ka. Atyre u ka mbetur vetëm arma e shpifjes, e spiunazhit dhe e diversionit në favor të padronëve të tyre, imperialistëve amerikano-anglezë dhe satelitëve të tyre të Beogradit, Athinës dhe Romës. Ata janë njerez pa atdhe, njerez të shitur shpirtërisht dhe trupërisht te armiku i atdheut dhe i popullit. Imperialistët dhe krerët e tradhëtarëve shqiptarë jashtë gënjejnë tradhëtarë më të vegjël dhe i futin në vendin tonë si diversantë dhe spiunë. Sigurisht, ata hidh diversantë dhe ne vra, ata hidh parashutistë dhe ne shfaros, ata shpif e gënje me radio e ne ec përpara nga fitorja në fitore. S'ka forcë që mund të ndalojë hovin madhështor të leninizmit, s'ka forcë në botë që

mund të ndalojë hovin ngadhnjimtar të socializmit. Përpara kësaj force të madhe, që është shpresa e njerëzimit, s'ka maskë që të mbulojë tradhëtinë e socialistëve të djathtë tradhëtarë të klasës punëtore dhe spiunë të imperialistëve dhe të kapitalit, s'ka maskë që të qëndrojë në ftyrën e tradhëtarit Tito dhe klikës së tij, këtyre shërbëtorëve të imperialistëve, që shtypin me terror popullin jugosllav, popullin shqiptar të Kosovës, dhe që janë bërë arma më e rrezikshme e imperialistëve amerikanon-anglezë në Ballkan. Nën urdhërat e amerikanëve ata po preqatitin nënshkrimin e aleancës agresive në mes të Jugosllavisë, Greqisë dhe Turqisë, kundër kampit të socializmit dhe të paqes¹. Çka ekzistonte që prej kohësh në mes të këtyre tri shteteve në mënyrë të fshehtë, tash legalizohet në mënyrë të hapët. Ky pakt rrezikon paqen në Ballkan, prandaj dhe vigjilanca jonë duhet të mprehet në kulm, për të bërë të dështojnë këto plane djallëzore. Titistët e Beogradit dhe monarko-fashistët e Athinës gabohen kur besojnë se vendi ynë është i izoluar ekonomikisht dhe ushtarakisht, ata gabohen në rast se mendojnë se vendi ynë është një thelë e vogël që mund të gjellitet lehtë në gërmazin e tyre të gjerë. Mos harrojnë se ka gjemba rreth e rrötull kufirit tonë, por ka edhe miq dhe aleatë besnikë populli ynë i vogël, ka miq dhe aleatë gjithashtu popujt vëllezër të Jugosllavisë dhe të Greqisë dhe klasën punëtore heroin-

¹ Është fjala për Paktin e miqësisë dhe të bashkëpunimit në mes të Jugosllavisë, Greqisë dhe Turqisë, që u nënshkrua në Athinë më 28 shkurt 1953 dhe që më 9 gusht 1954 u plotësua me marrëveshjen mbi aleancën, bashkëpunimin politik dhe ndihmën reciproke në mes të Jugosllavisë, Greqisë dhe Turqisë.

ke të këtyre vendeve, të cilët nuk do të lejojnë kurrë që të preken pavarësia dhe liria e popullit tonë. Agjenturat e imperialistëve në kufitë tanë mund të nënshkruajnë traktate zyrtare etj., por fjalën e fundit e kanë popujt e këtyre vendeve, që janë armiqtë e tërbuar të klikave që i sundojnë dhe që do të bëjnë të dështojnë planet kriminale të xhelatëve amerikanë dhe të shërbëtorëve të tyre. T'i ruajmë me vigjilencën më të madhe fitoret e popullit, lirinë dhe pavarësinë e atdheut tonë, pse s'ka gjë më të shtrenjtë në botë dhe s'mund të vihet asgjë mbi interesat e shenja të popullit. Të shtojmë vigjilencën revolucionare në çdo qytetar të Republikës sonë, për t'i bërë ballë me sukses çdo tentative të armikut të jashtëm dhe të brendshëm, dhe t'i godasim pa mëshirë të gjithë armiqtë e popullit, t'i demaskojmë ata në sytë e popullit dhe t'i vëmë ata në pamundësi të dëmtojnë veprën ndërtimitare të popullit. Diktatura e proletariatit është lufta më e ashpër e klasës, lufta më e pamëshirshme kundër klasave shfrytëzuese, kundër kapitalit dhe imperializmit. Të mos e dobësojmë për asnjë moment luftën e klasave dhe ta udhëheqë atë me ashpërsinë më të madhe klasa jonë punëtore dhe pararoja e saj dhe e gjithë masave punonjëse, Partia e Punës e Shqipërisë. Mos harrojmë se jemi në luftë të përditshme me armikun e klasës, që dhe ai vepron në forma të ndryshme për të na penguar, sabotuar dhe ngadalësuar në veprat tona; mos harrojmë se momentet janë të vështira e të rënda dhe s'lejohen lëshimet, liberalizmat dhe zemërbutësia.

Një qëndrim i tillë i patundur i Partisë sonë të Punës, besnikë e marksizëm-leninizmit, besnikë deri

në fund e mësimeve të Partisë Bolshevikë dhe të Stalinit, kanë bërë që populli shqiptar të korrë kaq suksese dhe të jetë i bindur e i sigurtë për suksese edhe shumë më të mëdha në të ardhshmen...

Shokë,

Partia na mëson se fitoret nuk bien nga qiejt, por fitohen me luftë dhe me përpjekje. Për sukseset që ne kemi arritur, klasa jonë punëtore dhe gjithë masat punonjëse të vendit kanë bërë heroizma të papërshkruara, kanë bërë sakrifica të mëdha, por në luftë me vësh-tirësitë dhe me mungesat, ato janë çelnikosur dhe kanë mësuar shumë. Ne mund të themi se jemi shumë më të armatosur se më parë, nga çdo pikëpamje, për të përbushur me ndër detyrat e mëdha dhe të rënda që na vihen përpara për realizimin e planit tonë pesë-vjeçar ekonomik të shtetit. Asgjë s'trashëguam nga regjimet e errëta të së kaluarës përvèç mjerimit dhe urisë, por çdo gjë që kemi sot e ndërtuam siç thotë populli «me thonj e me dhëmbë». Ne ndërtuam pushtetin tonë popullor që nga themelat, ne ndërtuam një organizim të përshtatshëm, ne krijuam një numër të konsiderueshëm kuadrosh të ndryshëm, ne nga punëtorë të thjeshtë, mësuam me mijëra specialistë, punëtorë të kualifikuar, inxhinierë, mjekë, agronomë, veterinerë, financierë, planovikë, mësues, profesorë e shumë e shumë kuadro të tjera të vlefshëm, bij besnikë të popullit, të cilët kanë marrë në duar drejtimin e ekonomisë së vendit, drejtimin e ndërtimeve industriale

dhe bujqësore, zhvillimin e arësimit, kulturës etj. Sigurisht, ju jeni të ndërgjegjshëm se plani ynë pesëvjeçar s'është një ndërmarrje e vogël dhe as e lehtë, por një punë shumë serioze dhe e vështirë. Në rrugë do të hasim shumë vështirësi, do të kemi edhe mungesa, prandaj këto lypset të kapërcehen me një organizim më të madh, me një disiplinë të çelniktë në punë, me një luftë të pamëshirshme kundër burokratizmit, lëshimeve, gabimeve. Mos kujtojmë se çdo gjë është shesh me lule dhe kur thashë se jemi nië të armatosur se më përpara, kjo nuk duhet të kuptohet se ne i kemi zgjidhur të gjitha problemet, se organizimi ynë është i përsosur, se nuk ekzistojnë te ne gabime dhe lëshime të dënueshme, se ne jemi të plotësuar me kuadrot e nevojshëm për këtë ndërmarrje kaq kolosalë siç është plani ynë pesëvjeçar. Jo, ne jemi akoma shumë mbrapa, ne kemi akoma gabime në punën tonë, në organizimin tonë, ne jemi akoma shumë mangut me kuadrot tanë. Në analizën e fundit që Komiteti Qendror dhe qeveria i bënë realizimit të planit gjashtëmuajor të këtij viti, u konstatua me kënaqësi se plani në miniera, në industri, në komunikacion, në bujqësi, në artizanat e në mjaft sektorë të tjerë, është realizuar në përgjithësi dhe disa herë tejkaluar; por ka sektorë, siç është ai i ndërtimeve sidomos, ku plani nuk është realizuar, dhe kjo për arësyte të organizimit të dobët, të mungesës së disiplinës në punë, të mosshfrytëzimit sa duhet të mekanizimit disponibël, të mungesës në racionalismin e fuqisë punëtore ku janë lejuar fluktuatione të mëdha kuadri të thjeshtë dhe kuadri specialist. Por me gjithë sukseset edhe në sektorët ku është realizuar plani, prapë

ka dobësi të theksuara në organizimin e punës, në disiplinën në punë, në zbatimin e metodave të përparuara në shkallë të gjërë. Atje nuk ekziston ai emulacion socialist i dëshiruar, nuk tregohet interesimi i duhur për edukimin dhe specializimin e kuadrove në shkolla e në kurse, të krijuara për këtë qëllim nën drejtimin e dikastereve për ngritjen e kuadrove të kualifikuar për sektorët respektivë, nuk tregohet interesimi i duhur për jetën e punëtorëve etj. Të gjitha këto të meta dhe gabime shumë serioze, kanë bërë që të mos kemi realizim të planit në disa sektorë siç është ai i ndërtimit, por njëkohësisht jemi vënë përparrë realitetit se, po të organizojmë më mirë punën, ne i kemi mundësitet jo vetëm ta realizojmë planin, por edhe ta tejkalojmë. Pra, detyra jonë kryesore qëndron në atë që t'i bëjmë të ndërgjegjshëm të gjithë punonjësit për detyrat e mëdha që kanë për të kryer, të zhdukim medoemos gabimet dhe lëshimet tonë që janë vërtetuar në punë dhe të jemi të sigurtë se planin do ta realizojmë me sukses.

Si në të gjithë sektorët e tjera, ashtu edhe në lëmin e punës të bashkimeve profesionale, janë arritur sukseset të mëdha. Bashkimet profesionale në vendin tonë janë bërë një levë e fuqishme e Partisë në edukimin dhe forcimin e klasës punëtore dhe të masave punonjëse, në mbarëvajtjen e punës në fabrika, në miniera, në zyra, në shkolla e kudo që ato zhvillojnë aktivitetin e tyre. Por edhe në bashkimet profesionale janë vërtetuar dobësi të theksuara dhe të meta serioze, që presidenti i Bashkimeve Profesionale, shoku Pilo Peristeri, i vuri shumë qartë në dukje dhe mbi të cilat unë

nuk do të zgjatem, por, po të më lejoni, do të shtoj diçka që anëtarët e bashkimeve profesionale le ta kenë parasysh në punën e tyre.

Eshtë e vërtetë se nga gjiri i klasës sonë punëtore kanë dalë me qindra dhe me mijëra kuadro të rinj, të cilët janë kualifikuar dhe specializuar në kurse dhe në punë, dhe këta kuadro, që janë mburrja dhe thesari ynë i çmuar, kanë bërë mrekulli në punën e tyre. Mjeshtër të mrekullueshëm kanë dalë, si Veli Allajbej, Negri Nikolla, Xhevdet Laze, Koço Çaci, Sali Vata, Nashe Badihavaj, Sadije Rexhepi e qindra të tjerë. Por ritmi i madh i zhvillimit të ekonomisë sonë, dhe, nga ana tjetër prapambetja e së kaluarës, na vënë përpara detyra shumë të rëndësishme në lidhje me ngritjen teknike dhe profesionale të klasës punëtore. Dihet se klasa jonë punëtore shtohet dhe forcohet çdo vit me elementë të rinj të ardhur nga fshati, që për herë të parë vihen përpara një teknike shumë moderne, e cila, për t'u vënë në lëvizje në fillim, lyp një minimum perfeksionimi. Një avantazh i madh për ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë është çështja, që klasa jonë punëtore është e pastër nga tendencat shkatteredimtare, reformiste, nga dallaveret kapitaliste dhe socialdemokrate e oportuniste dhe klasa jonë punëtore, revolucionare, dinamike dhe plot heroizëm e vetëmohim në punë edukohet nga Partia të luftojë për t'i mbajtur kurdoherë radhët e saja të pastra. Nga ana tjetër, klasa jonë punëtore ka avantazhin e madh të mësohet, duke marrë në duar teknikën më moderne. Fabrikat, uzinat, minierat, oficinat, traktorët, centralet elektrike etj. janë gati të gjitha moderne. Kësaj teknike moderne duhet

t'i përgjigjet edhe një ngritje tekniko-profesionale e përparuar nga ana e punëtorëve. Faktet tregojnë zotësinë e punëtorëve shqiptarë, të cilët, për një kohë të shkurtër, duke mësuar në shkollat sovjetike, duke mësuar në shkollat profesionale dhe në kurset e specializimit në vendin tonë, duke mësuar nga ndihma e çmuar e inxhinierëve dhe e specialistëve sovjetikë, duke ndjekur shembullin e stakanovistëve sovjetikë, kanë arritur të vënë vetë në lëvizje kombinatet moderne, siç janë ai i tekstileve, i sheqerit, i drurit, kinostudion, Hidrocentralin «Lenin», traktorët, maqinerinë e Uzinës «Enver», sondat moderne të shpimit etj. etj. Megjithatë duhet ta kemi të qartë se jo vetëm që ekziston një disproporcione madh në mes nivelist profesional të ulët të kuadrove tanë dhe teknikës moderne, por edhe numri i këtyre kuadrove, përpala nevojave të planit, është shumë i vogël. Prandaj, si detyrë urgjente dhe nga më kryesoret është kualifikimi sa më i madh i kuadrove ekzistues dhe edukimi me urgjencë i kuadrove të tjera të rindërtimit. Vetëm kujdesi i veçantë i Partisë, i qeverisë, i të gjitha ndërmarrjeve shtetërore dhe i bashkimeve profesionale mund ta zgjidhë drejt dhe shpejt këtë problem kapital. Pushteti ka krijuar të gjitha mundësitë materiale, si shkolla profesionale, teknikume të ndryshme, kurse kualifikimi nga të katër anët; ka krijuar gjithashtu të gjitha mundësitë dhe leverdinë ekonomike për punëtorët që të punojnë dhe njëkohësisht të perfektionohen. Zelli dhe vullneti i punëtorëve tanë për të mësuar është jashtëzakonisht i madh. Kudo që të hedhësh sytë do të shohësh punëtore dhe punëtorë të rindërtimit që deri dje ishin fshatarë të thjeshtë, që s'dinin

gati të shkruanin dhe të lexonin, por që, me vullnet të madh, ata kanë përparuar dhe nga ana kulturale dhe nga ana profesionale. Por këtij entuziazmi të madh të klasës punëtore për t'u perfekcionuar duhet t'i përgjigjen po me atë vrull, po me atë kujdes të madh, edhe ndërmarrjet shtetërore, edhe bashkimet profesionale. Disa ministri dhe ndërmarrje, në mënyrë të dënueshme, kanë neglizhuar në lidhje me shkollat dhe kurset për edukimin e punëtorëve; ato nuk dinë ku i kanë kuadrot, që me aq zor ne po i ngremë dhe i mësojmë. Shumë prej tyre dinë vetëm të qahen duke thënë se s'kemi kuadro, kurse kuadro kanë sa të duash, shkolla dhe kurse ku t'i mësojnë kanë, por kujdes për ngritjen e kuadrit nuk tregojnë sa duhet. Kjo praktikë e dënueshme duhet të marrë fund. Gjithashtu edhe bashkimet profesionale duhet të zhdukin me urgjencë shkujdesjen e tyre ndaj problemit të edukimit të kuadrove dhe të përqëndrojnë seriozisht vëmendjen dhe kujdesin më të madh për plotësimin dhe zbatimin sa më të përsosur të programeve për realizimin e plotë të planit të kurseve, të shkollave të rezervave të punës etj., si në kualitet edhe në kuantitetin e nxënësve. Pa punëtorë të specializuar dhe të kualifikuar, pa teknikë të mesëm dhe pa kuadro të lartë, nuk mund të ecet përpëra me ritmin e dëshiruar. Inxhinierët tanë të vjetër dhe të rinj të bëjnë të gjitha përpjekjet jo vetëm për të vënë në praktikë dituritë e tyre të vlefshme, jo vetëm t'i shtojnë dhe t'i perfektionojnë çdo ditë e më shumë njohuritë e tyre shkencore dhe teknike, por të kenë gjithashtu një preokupacion të madh edukimin e kuadrove të rinj të dálë nga radhët e klasës punëtore

dhe t'i bëjnë këta të aftë. Kjo do të jetë një meritë shumë e madhe e tyre, për të cilën populli dhe Partia jonë do t'u jenë shumë mirënjohës. Duhet t'i njojin, t'i duan dhe t'i nderojnë populli dhe Partia të gjithë ata inxhinierë, agronomë, pedagogë që veçanërisht kujdesen dhe dallohen në edukimin dhe në kualifikimin e elementeve të klasës punëtore.

Emulacioni socialist, ky faktor vendimtar për realizimin e planit pesëvjeçar dhe lëvizja sulmuese një karakteristikë e lartë dalluese e emulacionit socialist, që janë zhvilluar në vandin tonë, janë probleme shumë serioze, janë përpjekje shumë serioze dhe jetike për ndërtimin e socializmit në vandin tonë. Shoku president i Bashkimeve Profesionale e vuri qartë në dukje, në raportin që mbajti, këtë lëvizje të madhe që ka shpërthyer në gjirin e klasës sonë punëtore, vuri në dukje përparimet dhe gabimet që vërtetohen në këtë çështje. Unë nuk do të hyj në hollësi për të mos u zgjatur, vetëm dua të shtoj se mjetet e teknikës moderne që ne kemi në duar lypin dhe metoda të përparuara në punë, që të mundim kësosoj t'i shfrytëzojmë plotësisht këto mjete dhe t'i shërbejmë interesit të përgjithshëm sa më mirë. Përcaktimi i formave dhe zbatimi me kujdes i këtyre formave të ndryshme që janë në bazë të zhvilimit me sukses të emulacionit socialist, kanë një rëndësi të madhe. Natyrisht, emulacioni socialist nuk mund të pajtohet me një formalizëm të kalbur, me një pakujdesi dhe shthurje nga drejtuesit e ndërmarrjeve, nga bashkimet profesionale dhe sidomos nga drejtimi i gjithanshëm dhe i kujdeshëm i Partisë si në udhëheqje dhe në bazë. Atje ku këto forma zbatohen me

kujdes, ku drejtuesit qofshin këta të Partisë, të bëashkimeve profesionale, ose shtetërorë, e kanë kuptuar rëndësinë e madhe të emulacionit, ne kemi suksese të mëdha. Kështu ngjet në fabrikën e çimentos që me vjete e vazhdimisht tejkalon planin; kështu ngjet në Uzinën «Enver», në SMT-në e Korçës etj. Lëvizja sulmuese dhe emulacioni socialist janë një hov i madh patriotik i masave punonjëse të vendit tonë, janë metodat komuniste të ndërtimit të socializmit, siç ka thënë shoku Stalin. Duhet, pra, ta kuptojnë një herë e përgjithmonë drejtorët e ndërmarrjeve shtetërore dhe drejtuesit e bashkimeve profesionale se pa ndihmën e emulacionit socialist, pa ndihmën e lëvizjes sulmuese, pa përhapjen në shkallë të gjërë të metodave të përparruara sovjetike si ato të stakanovistëve që janë verifikuar në praktikë në vandin tonë, nuk mund të realizojnë me nder detyrat e tyre, nuk mund të realizojnë e të tejkalojnë planin e shtetit. Masat punonjëse luftojnë për të rrojtur më mirë dhe për këtë gjë duhet të prodhojmë më shumë. Natyrisht, nevojat e mëdha nuk mund t'i përballojmë duke vazduar të punojmë me metodat e vjetra, nuk mund të ecim përpara dhe të sigurojmë mirëqenjen dhe të ardhshmen e lumtur për të gjithë. Lenini ka thënë se

«Rendimenti i punës është, në fund të fundit, gjëja më e rëndësishme, gjëja kryesore për fitoren e rendit të ri shoqëror»¹.

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 29, f. 474.

Ne po e ndërtojmë këtë rend të ri shoqëror dhe ndërtimi i bazave të socializmit në vendin tonë ka hapur mundësitë e mëdha të emulacionit i cili të përdoret në një shkallë të gjerë masive dhe t'u japë mundësinë punonjësve të zhvillojnë kapacitetet e tyre të mrekullueshme, të tregojnë zotësitë krijuese, talentet e tyre. Dhe talente të mrekullueshme ka sa të duash në gjirin e popullit tonë. Këtë e dëshmojnë rezultatet në punë, e dëshmon lëvizja sulmuese, e dëshmojnë novacionet dhe shpikjet e punonjësve tanë në të gjitha fushat e ekonomisë. Ne duhet t'i thyejmë dhe t'i zhdukim të gjitha pengesat dhe gabimet në drejtimin e zhvillimit me sukses të emulacionit socialist dhe të lëvizjes sulmuese...

Vullneti i madh i punonjësve tanë për të mësuar sa më shumë nga eksperiencia e stakanovistëve sovjetikë, është një garanci e madhe për realizimin e planit tonë pesëvjeçar. Punonjësit e vendit tonë ecin me vendosmëri në rrugën e kësaj shkolle të lartë dhe sulmuesit e vendit tonë e të gjithë punonjësit që marrin pjesë në emulacionin socialist, duhet ta kuptojnë se me marrë pjesë në këtë lëvizje të madhe nuk do të thotë vetëm të përmirësosh rrogën personale, plotësisht të merituar, se qëllimi i lëvizjes nuk është vetëm rroga, por është motori kryesor i përpjekjes së madhe socialiste për të ndihmuar të gjithë dhe njëkohësisht të ndihmosh veten. Ky është qëndrimi i drejtë i njerëzve të rinj ndaj punës socialiste. Sulmuesit nuk duhet në asnje mënyrë të qëndrojnë si figura, të izoluar në ndërmarrjet e tyre. Përkundrazi, ata duhet të përhapin me të shpejtë metodën e tyre të punës dhe duhet vazhdimisht të udhëhiqen nga ideja që duhet të krijojnë rreth tyre kolektiva

të gjera punëtorësh sulmi, t'i mësojnë dhe t'i edukojnë ata me eksperiencën e vet. Nga ana tjetër, ndërmarrjet, ministritë dhe bashkimet profesionale nuk duhet të rrinë të shkujdesura në këtë drejtim dhe të kënaqen me pak, sikundër ka ngjarë me shumë sulmues në vendin tonë që kanë aplikuar me sukses të madh metodat e përparuara sovjetike, por përfat të keq ata kanë ngelur vetëm, pse konditat përfat zgjerimin e këtyre metodave nuk janë krijuar. Duhet të kemi parasysh gjithashtu se lëvizjen sulmuese nuk mund ta bazojmë mbi kapacitetet fizike të njerëzve, mbi përpjekjet e tepruara në forcën e punës, mbi lodhjen dhe zgjatjen e orarit të punës. Pikërisht metodat e përparuara në punë, lëvizja sulmuese dhe emulacioni socialist janë ato që bëjnë të punojë truri tok me forcën fizike dhe punëtori ta ndjejë punën më të lehtë, të jetë më i sigurtë dhe të lodhet më pak. Mosvënya në zbatim e këtyre metodave, natyrisht, sjell vështirësi të mëdha në zbatimin e planit dhe atëhere fillojnë garat me hope dhe orët suplementare që shkatërrojnë shëndetin e punëtorëve dhe interesat shtetërore. Ndërmarrjet, ministritë dhe bashkimet profesionale duhet ta bazojnë emulacionin socialist dhe lëvizjen sulmuese mbi një organizim më të mirë të punës, mbi përdorimin në shkallë më të gjerë të mekanizmit, mbi shpikjet e reja, mbi racionalizimet, mbi ekonomizimet në prodhim, mbi furnizimin me kohë dhe me kualitet të mirë të lëndës së parë dhe të mos qëndrojnë vetëm në propagandë dhe në fjalë. Emulacioni socialist duhet të përfshijë masën e gjerë të punonjësve tanë, lëvizja sulmuese duhet të ecë me hapa të mëdhenj përpara, pse ju,

punëtorë heroikë të vendit tonë, ju sulmues të shquar, jeni njerëzit nga më të dashurit dhe më të nderuarit e popullit dhe të Partisë sonë, jeni garancia e madhe e realizimit me sukses të planit pesëvjeçar. Bashkimet profesionale janë organet më të rëndësishme për organizimin e mirë të kësaj lëvizjeje të madhe dhe në rast se bashkimet profesionale qëndrojnë në bisht të situatës, në bisht të hovit revolucionar të masave, në rast se mbyten në shkresa dhe në burokraci, atëherë kjo lëvizje do të frenohet dhe do të dëmtohet. Ky është dëmi më i madh që mund t'i shkaktohet realizimi të planit pesëvjeçar, këtë ta kenë parasysh Partia, udhëheqja e bashkimeve profesionale dhe e gjithë klasa punëtore, e cila nuk duhet të lejojë që të pengohet hovi i saj i madh ndërtimtar nga disa njerëz të pazot ose burokratë të pakorrigjueshëm.

Dëshiroj të them dhe pak fjalë në lidhje me realizimin e kontratave kolektive. Lidhja e kontratave kolektive çdo vit ka mobilizuar më shumë punëtorët dhe ka shtuar përgjegjësinë e drejtuesve të ndërmarrjeve për realizimin e planit dhe përmirësimin e jetesës së punëtorëve. Por megjithatë kontratat kolektive nën vlef-tësohen dhe, shumë herë, shkelen. Shkelja vjen zakonisht nga ana e ndërmarrjeve dhe jo nga punëtorët, të cilët kurdoherë kanë qenë të përpiktë në mbajtjen e angazhimeve të kontratës. Ministritë përkatëse gjithashtu i kanë neglizhuar këto dhe bashkimet profesionale në mjaft raste kanë fjetur, ose udhëheqësit e bashkimeve profesionale në ndërmarrje kanë rënë në kompromis me drejtoren e ndërmarrjeve, nuk kanë ngulur këmbë për të mbrojtur të drejtat e punëtorëve dhe

punëtorët janë dëmtuar. Kjo është shumë e keqe dhe duhet të marrë fund. Do të jetë gabim të mendohet që në regjimin e demokracisë popullore, në kohën kur bëhet tranzicioni nga kapitalizmi në socializëm, të mos ekzistojnë fërkime ndërmjet klasës punëtore dhe ndërmarrjeve shtetërore të socializuara dhe ca më shumë me ndërmarrjet me karakter privat. Këto fërkime ekzistojnë dhe ne i konstatojmë nga eksperienca në punë, nga fakti që ndërmarrjet shtetërore nuk i mbajnë angazhimet e kontratave kolektive. A duhet të rrimë me duar kryq përpara kësaj situate? A duhet klasa punëtore dhe bashkimet profesionale të mos luftojnë kundër këtyre deformimeve dhe padrejtësive duke thënë se «kundër kujt ne duhet të mbrohem, kundër ndërmarrjeve që janë të shtetit tonë, që janë tonat, të klasës punëtore?» Këtë dua ta shpjegoj pak. Lenini me Stalinin na mësojnë se derisa ekzistojnë klasat, lufta e klasave është e paevitueshme dhe në periudhën e tranzacionit nga kapitalizmi në socializëm, ekzistenca e klasave është e paevitueshme, e tillë pra, është edhe lufta ekonomike derisa nuk janë zhdukur nga rrënjët tendencat e prodhimit të vogël dhe dominimi i tregut. Ndodh që në regjimin tonë të demokracisë popullore, në ndërmarrjet shtetërore, duke u vënë përpara detyrës të shtojnë rendimentin në punë dhe të punojnë jo me humbje, por me fitime, shumë herë drejtuesit e taprojnë zellin e tyre administrativ dhe, duke i shtuar këtij zelli administrativ dhe deformimet burokratike, neglizhencat, gaçimct, shkaktohet medoemos një kundërshtim interesash në mes ndërmarrjes dhe punëtorëve. Kundër këtij zelli administrativ të tepruar të drejtuesve të

ndërmarrjeve, kundër këtyre deformimeve burokratike, kundër lëshimeve dhe gabimeve, që janë shkaku i mosrespektimit të kontratave kolektive nga ana e ndërmarrjeve dhe nga pakujdesia e ministrive duhet të luftojnë klasa jonë punëtore, Partia dhe bashkimet profesionale. Qëllimi i fundit i çdo veprimi të klasës punëtore në këtë drejtim është forcimi i shtetit proletar, i shtetit të demokracisë populllore. Duhet të jetë klasa punëtore ajo që të luftojë me ashpërsinë më të madhe kundër shtrembërimeve burokratike dhe gabimeve c lëshimeve. Këtu del qartë roli i bashkimeve profesionale, të cilat jo t'i zërë gjumi dhe jo të bien në formalizëm, por kurdoherë që nuk zbatohen kontratat ose ligjet e mbrojtjes së punës nga ndërmarrjet ose nga kushdo qoftë, të paraqesin menjëherë kërkesat e tyre dhe të zgjidhin fërkimet në interesin e punëtorëve. Kërkesat të formulohen qartë dhe në mënyrë serioze nga të dyja palët dhe në rast se nuk zgjidhen poshtë, të mos lihen në heshtje nga të dyja palët, por të bëjnë apel dhe të kërkohet zgjidhja nga instancat më të larta shtetërore. Kështu do të evitohen çrrregullimet, gabimet, fërkimet. Por zotësia e bashkimeve profesionale duhet të jetë në atë që këto fërkime t'i parashikojë më parë dhe të marrë masa që të evitohen.

Udhëheqja e Partisë në bashkimet profesionale duhet të jetë vendimtare dhe nga më aktivet, pse atje është grumbulluar klasa jonë punëtore, njerëzit më të mirë të vendit tonë.

«Një nga rreziqet më të mëdha dhe më të tmerrshme për një parti komuniste... — ka thënë

Lenini — është rreziku i shkëputjes nga masat, rreziku se mos pararoja shkon tepër përpara, pa e «drejtuar frontin», pa mbajtur lidhje të shëndosha me gjithë ushtrinë e punës, d.m.th. me shumicën dërmuese të masës punëtore dhe fshatare. Sikundër fabrika më e mirë me motor të mrekullueshëm dhe maqina të dorës së parë do të mbetet e paralizuar, po të prishet mekanizmi i transmisionit, që lidh motorin me maqinën, ashtu është e pashmangshme katastrofa e ndërtimit tonë socialist, po të mos jetë ndërtuar mirë dhe po të mos punojë mirë mekanizmi i transmisionit, që lidh partinë komuniste me masat — bashkimet profesionale. Nuk mjafton që kjo e vërtetë të shpjegohet, të kujtohet, të provohet, ajo duhet të përforcohet në mënyrë organizative në gjithë strukturën e bashkimeve profesionale dhe në punën e tyre të përditshme»¹.

Udhëheqjen e Partisë në qendër dhe në rrethe duhet ta preokupojë seriozisht forcimi i bashkimeve profesionale dhe t'i kushtojë vëmendjen e veçantë, në mënyrë që të ngrihet niveli kultural, ekonomik dhe politik i masave punonjëse. Duhet të shkunden mjaft komitetet e Partisë në rrethe dhe mund të themi se problemet e bashkimeve profesionale janë të huaja për to; gjithashtu duhet luftuar, nga ana tjetër, interesimi for-

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 33, f. 206.

mal i disa komitetetë të tjera, të cilat bëjnë mbledhje dhe marrin në shqyrtim punën e organizatave profesionale, por pak realizime ka dhe pak ndihmë konkrete u jepet. Por sikur edhe vendimet në udhëheqjen e Partisë të janë të drejta në këtë drejtim, nuk mund të janë të mjaftueshme, në rast se ato mbeten letër e vdekur dhe nuk zbatohen me rigorozitet nga organizatat bazë dhe nga masa e madhe e Partisë që punon në ndërmarrje të ndryshme dhe në entet e ndryshme shtetërore. Është një detyrë urgjente e dorës së parë për udhëheqjen e Partisë në rrith, të bëjë të ndërgjegjshme masën e Partisë për detyrat e rënda dhe të rëndësishme që duhet të kryejë në organizatat e bashkimeve profesionale dhe në të gjitha masat punonjëse. Analizat, vendimet, që bëhen dhe merren në komitetet e Partisë dhe në organizatat bazë, duhet të transmetohen e të gjejnë zgjidhjen konkrete në praktikë dhe të luftohet prej komunistëve me këmbëngulje për zbatimin e tyre. Komunistët duhet të janë shembull për të gjithë të tjerët, në punë e në detyrë, në emulacionin socialist, në lëvizjen stakanoviste, shembull për disiplinën, për sakrifica, për zbatimin e ligjeve dhe të rregulloreve të punës, të janë ata më të ashprit për të mbrojtur të drejtat e punëtorëve nga deformimet burokratike të aparateve, nga lëshimet dhe gabimet. Po të kuptohet drejt kjo çështje mbledhjet e ndryshme të bashkimeve profesionale do të gjallërohen dhe nuk do të bëhen të mërzitshme, siç ngjet në shumë raste. Komunistët dhe punëtorët duhet të bëjnë shumë kujdes në këtë drejtim. Këto mbledhje të bëhen luftarake, të inkurajohet kritika nga punëtorët, pa të ci-

lën asgjë s'mund të ecë përpara dhe të goditen ashpër ata drejtorë ndërmarrjesh ose zyrtarë të tjerë, siç është rasti, në mes të të tjerave, i drejtorit të NISH prodhimeve të ndryshme në Shkodër, të cilat i djeg kritika dhe arrin t'i thotë një sulmuesi novator që e kritikon me të drejtë: «Ki mendjen, se unë të kam në dorë dhe të pushoj nga puna». Në raste të tilla nuk është aspak rrezik të pushohet punëtori novator, por është rrezik të pushohet drejtori. Të dëgjohen në këto mbledhje me kujdesin më të madh sugjerimet e propozimet e punëtorëve dhe të merren masat menjëherë për t'i zbatuar. Komunistët duhet të jenë në ballë të kësaj lufte dhe jo të mbledhin supet e të thonë se kjo është vetëm punë e drejtorit. Jo, s'është vetëm punë e drejtorit, por i intereson gjithë kolektivit, kur është çështja për përmirësimin e prodhimit, për gjetjen dhe zbatimin e metodave për të realizuar planin më shpejt, si në cilësi ashtu edhe në sasi, kur është çështja për uljen e kostos ose për përmirësimin e jetesës të punonjësve. Në bashkimet tona profesionale shfaqet gjithashtu një sektarizëm shumë i dëmshëm në lidhje me mosaktivizimin sa duhet, si në bazë edhe në udhëheqje, të njerëzve të sindikuar, pa parti. Çdo gjë kërkojnë ta bëjnë me komunistët, gjë që s'është e drejtë. Lenini na mëson:

«Që poshtë deri në krye të organizatave të bashkimeve profesionale dhe në aparatet e tyre duhet të krijohet dhe të verifikohet praktikisht, në bazë të eksperiencës së një vargu të tërë vjetësh, një sistem i tërë shokësh me për-

gjegjësi, medoemos, jo vetëm nga radhët e komunistëve, të cilët duhet të jetojnë midis punëtorëve, ta njohin jetën e tyre dhe çdo anë, dhe të njohin problemet e tyre deri në fund»¹.

Mësuesi ynë i madh Lenini na këshillon se

«Nga anëtarët e bashkimeve profesionale në shtetin proletar duhet kërkuar vetëm që ata të kuptojnë disiplinën shoqërore dhe nevojën e bashkimit të forcave të punëtorëve për të mbrojtur interesat e punonjësve dhe të ndihmojnë pushtetin e punonjësve d.m.th. Pushtetin Sovjetik»².

Dhe më tutje Lenini vazhdon:

«Bashkimet profesionale duhet të janë bashkëpunëtorët më të afërt dhe të domosdoshëm të pushtetit shtetëror, i cili drejtohet në gjithë punën e tij politike dhe ekonomike nga pararoja e ndërgjegjshme e klasës punëtore — Partia Komuniste»³.

T'i kemi kurdoherë parasysh mësimet e Leninit dhe të Stalinit, t'i studjojmë dhe vazhdimisht t'i studjojmë me kujdesin më të madh dhe neve do të na hapen horizonte të mrekullueshme në punë, ne do të armatosemi për të kryer çdo detyrë, për të kapërcyer çdo vështirësi dhe për të korrur kurdoherë fitore.

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 33, f. 205.

² Po aty, f. 201.

³ Po aty, f. 202-203.

Shokë e shoqe, unë ju uroj nga zemra suksese në punimet tuaja. Kongresi juaj do të jetë një shkollë e madhe për të gjithë punonjësit e vendit tonë, për bazën dhe për udhëheqjen, qoftë ajo e Partisë qoftë ajo shtetërore. Ne do të mësojmë shumë këtej nga eksperiencia e klasës sonë punëtore, nga njerëzit e dalluar të saj, nga sulmuesit tanë. Nga diskutimet dhe propozimet e punëtorëve ne do të nxjerrim mësime të vlefshme, ne do të gjejmë me siguri zgjidhjen e shumë problemeve që na preokupojnë dhe kjo do t'i japë një hov të ri gjithë zhvillimit të punës sonë dhe do të bëjë që plani i vitit 1952, viti i dytë i planit tonë pesëvjeçar, të realizohet me sukses dhe të tejkalohet në mënyrë që viti i tretë i planit tonë pesëvjeçar të na gjejë akoma më të armatosur, më të mësuar dhe të korrim suksese akoma më të mëdha në interesin e masave tona punonjëse, në interesin e mbrojtjes së atdheut dhe të paqes në botë.

Rroftë klasa jonë punëtore heroike!

Rrofshin Bashkimet Profesionale të Shqipërisë!

Rroftë Partia jonë heroike e Punës, organizatorja e lavdishme e të gjitha fitoreve të popullit tonë që na udhëheq në rrugën e ndritur të socializmit!

Lavdi dhe jetë të gjatë mësuesit dhe edukatorit të lavdishëm, njeriut më të dashur të klasës punëtore dhe të gjithë popullit shqiptar, Josif Stalinit!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zeri i Popullit»,
Nr. 203 (1211), 21 gusht 1952*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

MBI DISA ÇËSHTJE TË ARËSIMIT SHTETËROR

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH*

22 gusht 1952

Ministria e Arësimit duhet të bëjë më shumë përpjekje që të përmirësohet puna metodike e saj, me qëllim që kalimi i nxënësve të jetë më i lartë e të mos na mbeten kaq shumë në klasë¹. Plani i preqatitjes të kuadrove të arësimit ka rëndësi të madhe, prandaj ai duhet realizuar patjetër. Për këtë duhet të forcohet bashkëpunimi edhe me organizatën e rinisë e me familjet e nxënësve dhe këto lidhje, ky bashkëpunim, të mos jetë formal.

Në radhë të parë duhet të punohet për arësimin fillor të detyruar, jo vetëm nga Partia, por edhe nga ana shtetërore. Me rëndësi është që të gjithë djemtë dhe vajzat të mbarojnë medoemos katër klasë të shkollës

¹ Sipas raportit që ju paraqit Byrosë Politike nga Ministria e Arësimit, atë vit plani i edukimit në shkollat e ditës u realizua 97,8 për qind ose i vazhduan të gjitha kategoritë e shkolave të ditës 3798 nxënës më pak.

fillore. Nuk është e drejtë siç ndodh te ne, që mjaft prej tyre, si në Tepelenë e në rrethe të tjera, të na mbeten pa mësuar, me pretekstin se shkollat i kanë larg. Derisa shteti ka një ligj, ndjekja e shkollës fillore është e detyruar për të gjithë dhe ne nuk duhet të lëmë asnjë pa e kryer atë, prandaj të merren masa të tilla që çështja të zgjidhet, pse nuk mund të lejojmë më të na mbeten të rinj në injorancë.

Kështu shtrohet çështja edhe për arësimin 7-vjeçar. Ne e bëmë të detyruar me ligj ndjekjen e shkollës 7-vjeçare atje ku ka shkolla të tilla, prandaj përveç propagandës që është kryesorja, duhet të kërkojmë edhe zbatimin e ligjit; komitetet ekzekutive duhet të janë rigorozë në këtë drejtim dhe të mos bëjnë lëshime.

Një çështje me rëndësi të madhe është ndjekja e shkollës së natës dhe me korrespondencë nga punonjësit, të cilave duhet t'u vëmë rëndësi aq sa edhe shkollave të ditës. Në situatën tonë ka të rinj që lënë shkollat e ditës dhe hyjnë në punë. Derisa nuk kemi ligj që ta detyrojmë tjetrin të ndjekë shkollën e mesme, atëhere duhet të merren masa që të çelen shkolla të mbrëmjes dhe me korrespondencë. Këto shkolla duhet të grumbullojnë ata elementë, të cilët i ndërpresin mësimet për arësyen ekonomike. Ne duhet të arrijmë që këta të ndjekin shkollat e mbrëmjes, pse janë një numër jashtëzakonisht i madh. Pra, nuk duhet të bazohemi vetëm në shkollat e ditës, po edhe në shkollat me korrespondencë apo të mbrëmjes, për ata që janë në marrëdhënje pune, të cilave t'u vëmë rëndësi të madhe si nga ana materiale (libra, fletore etj.), ashtu dhe për çështje të tjera. Një nga këto çështje është faktori

kohë. Në rast se një mjeri që ndjek shkollën e mbrëmjes pengohet nga qendra e punës, si do të mund ta ndjekë shkollën? Prandaj, të gjithë ata që janë në punë interes i Partisë është që të vazhdojnë edhe shkollën, pse situata nuk na lejon që të mbarojnë të gjithë shkollën e pastaj të futen në punë, po të punojnë dhe njëko-hësisht të mësojnë; të arrijmë që këta njerëz që futen në shkollat e mbrëmjes dhe me korrespondencë të mbarojnë qind për qind shkollat. Për një kontingjent të madh nxënësish që futen në punë, ndërmarrjet duhet të kujdesen që të ndjekin edhe shkollat e mbrëmjes dhe ato me korrespondencë. Për këtë, ne duhet të vendosim edhe për kohën e tyre të punës. Për ata që ndjekin shkollat e mbrëmjes të respektohet koha e punës prej 7 orësh dhe veç kësaj Partia të mos i bëjë mbledhjet në kohën e mësimeve. Këtë gjë ta kenë parasysh dhe ta studjojnë komitetet e Partisë se është një problem i madh. Nga ana ekonomike neve na leverdis të nxitim që të mësojnë edhe një kategori njerëzish drejtues në ekonomi, pse kështu ata do të drejtojnë më mirë. Të bëjmë që ata, të cilët janë me fillore, të vazhdojnë 7-vjeçaren.

Botohet për herë të virë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP

**LETËR DËRGUAR REDAKSISË SË GAZETËS
«ZËRI I POPULLIT» ME RASTIN E 10-VJETORIT TË
THEMELIMIT TË KËTIJ ORGANI**

24 gusht 1952

REDAKSISË SË GAZETËS «ZËRI I POPULLIT»

Komiteti Qendror i Partisë përshëndet dhe përgëzon gazeten «Zëri i Popullit», organin luftarak të Partisë sonë, me rastin e 10-vjetorit të themelimit të saj.

Rruja e kaluar nga «Zëri i Popullit» është rrugë e lavdishme, sepse e tillë është historia e Partisë sonë që e krijoj dhe e udhëheq atë. Në çastet më të vësh-tira të jetës së popullit tonë, kur pushtuesit fashistë dhe tradhëtarët e vendit donin ta kthenin Shqipërinë në një koloni të imperializmit, Partia jonë, nëpërmjet gazetës «Zëri i Popullit», lëshoi kushtrimin e luftës përliri. Gazeta u bë një mjet i fuqishëm në duart e Partisë dhe të popullit tonë, në luftën e shenjtë për një Shqipëri të lirë, demokratike, popullore, në dërmimin e gjithë armiqve të Parisë dhe të popullit dhe në triumfin e plotë të vijës leniniste-staliniane të Partisë sonë.

Gazeta «Zëri i Popullit» edhe sot po i kryen mëdhyrat e saja në luftën për mbrojtjen e paqes

dhe ndërtimin e themeleve të socializmit. Ajo e edukon popullin me fryshtën e patriotizmit dhe të vigjilencës revolucionare, me fryshtën e dashurisë e të besnikërisë së pakufishme ndaj atdheut të madh të socializmit dhe të Partisë së Lenin-Stalinit, me idetë e internacionalizmit proletar. Gazeta lufton për interesat e klasës punëtore, të fshatarësisë punonjëse dhe të inteligjencies popullore, i mobilizon këto në luftë për realizimin e planit, pasqyron punën e tyre krijuese dhe është bërë një faktor me rëndësi për zhvillimin e emulacionit dhe të garave socialistë.

Por përballë detyrave të mëdha e të rëndësishme që ka populli ynë në realizimin e planit të parë pesëvjeçar, roli dhe përgjegjësitë e gazetës rriten dita-ditës më shumë. Gazeta duhet të bëhet gjithmonë një agjитator më i fuqishëm, një propagandist më i flaktë dhe një organizator kolektiv më i mirë i masave tona punonjëse.

«Zëri i Popullit» duhet të forcojë më tepër propagandën për mbrojtjen e paqes, për forcimin e miqësisë dhe të dashurisë së popullit tonë për Bashkimin Sovjetik dhe Stalinin e madh dhe për demaskimin e imperializmit amerikano-anglez dhe të shërbëtorëve të tij.

Organzi i Komitetit Qendror të Partisë duhet të bëjë një propagandë më të gjerë dhe me një cilësi më të lartë për përhapjen e ideve të marksizëm-leninizmit e për të ndihmuar anëtarët e Partisë dhe masat punonjëse në përvetësimin e kësaj teorie.

Gazeta duhet të organizojë në një shkallë më të gjerë përhapjen e eksperiencës së më të mirëve, të nxiti më tepër zhvillimin e emulacionit socialist dhe të lëvizjes sulmuese në vendin tonë, të trajtojë më shumë dhe më mirë problemet e fshatit. Gazeta duhet

të forcojë kritikën parimore dhe instruktive kundrejt të metave, lëshimeve, gabimeve dhe shtrembërimeve në zbatimin e vijës së Partisë.

Komiteti Qendror i Partisë i tërheq vëmendjen redaksisë për punën e pamjaftueshme që është bërë me korrespondentët punëtorë e fshatarë dhe porosit që në bazë të vendimeve të Partisë sonë të merren masa urgjente për zhdukjen e kësaj të mete. Lidhja sa më e ngushtë me masat, puna e vazhdueshme dhe sistematike për zgjerimin e forcimin e rrjetit të korrespondentëve punëtorë e fshatarë duhet të jetë një nga detyrat më të rëndësishme të gjithë redaksive.

Komiteti Qendror i Partisë porosit gjithë punonjësit e gazetës që të shtojnë përpjekjet për ngritjen e tyre politike, ideologjike e profesionale dhe për përvetësimin e vazhdueshëm të eksperiencës së lavdishme të shtypit bolshevik.

Komiteti Qendror i uron redaksisë suksese të reja në punën e mëtejshme të gazetës dhe ka besim se në të ardhshmen gazeta «Zeri i Popullit» do t'i kryejë akoma më mirë detyrat e ngarkuara nga Komiteti Qendror i Partisë.

Për Komitetin Qendror të PPSH

Sekretari i Përgjithshëm

Enver Hoxha

Boruar për herë të parë në
gazetën «Zeri i Popullit»,
Nr. 206 (1214), 24 gusht 1952

Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zeri i Popullit», Nr. 206 (1214),
24 gusht 1952

FJALA PARA DISA OFICERËVE QË U GRADUAN GJENERAL-MAJORE

30 gusht 1952

Shokë oficerë dhe gjeneralë,

Ju kám ftuar pér t'ju komunikuar se Presidiumi i Kuvendit Popullor, me propozimin tim, dekretoi dje gradimin në gjeneral-majorë të shokëve kolonela Kadri Hazbiu, Petrit Dume, Sadik Bekteshi, Rahman Perlaku dhe Mihallaq Ziçishti.

Ju uroj pérzemërsisht shokë gjeneral-majorë pér gradimin tuaj.

Kjo është një ngjarje e rëndësishme dhe e gjueleshme, jo vetëm pér shokët gjeneral-majorë të rinj, por pér gjithë ushtrinë dhe popullin tonë, pse ushtria dhe populli shohin se si bijtë e tyre, të edukuar nga Partia jonë heroike dhe nga mësimet e Stalinit të madh, nëpërmjet Luftës heroike nacional-çlirimtare dhe luftës pér ndërtimin e bazave të socializmit, luftës pér edukimin dhe modernizimin e Ushtrisë sonë Popullore, nga ushtarë të thjeshtë të popullit arritën në gradat më të larta që i ngarkojnë ata me përgjegjësi më të rënda dhe me detyra të shenja. Gradimi i merituar i shokëve

tanë të lartpërmendur është rrjedhim logjik i besnikërisë së tyre të madhe dhe i dashurisë së pakufishme ndaj popullit dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, ndaj leninizmit, është rrjedhimi logjik gjithashtu i përpjekjeve të tyre për t'u pajisur me artin luftarak stalinian dhe e vënjes së këtij arti në jetë, duke edukuar ushtrinë dhe kuadrot tanë në rrujan e lavdishme të Ushtrisë Sovjetike dhe për ta bërë ushtrinë tonë dhe Armën e Sigurimit, armët më të fuqishme dhe më besnikë të Partisë, të popullit, të diktaturës së proletariatit.

Ushtria jonë do të gëzohet shumë kur të mësojë se ajo ka sot edhe pesë gjeneralë të rinj, ajo do të forcohet më shumë dhe më shumë do të forcohet besimi ndaj saj.

E njëjtë gjë do të ngjasë edhe te ju shokë gjeneral-majorë. Gradimi juaj i merituar të mos jetë një shenjë krenarie e kotë, por një nxitje dhe një inkurajim për të punuar edhe më tepër, për të shtuar edhe më tepër rendimentin në punë, për t'u edukuar akoma më shumë në të gjitha fushat që kështu të bëheni akoma më të aftë për t'i shërbyer ushtrisë sonë të shtrenjtë ashtu si na mëson Partia dhe udhëheqësi ynë i madh, Stalin.

Ta doni ushtrinë dhe ushtarit si sytë e ballit, të preokupoheni për ushtrinë dhe ushtarit më mirë se për veten tuaj, të jeni nga më të afërtit dhe më të dashurit me kuadrot dhe me ushtarit, të jeni të thjeshtë dhe të rreptë për zbatimin e urdhërave dhe të rregulloreve ushtarake, të jeni të pamëshirshëm kundër armiqve të popullit e të Partisë.

Unë jam i bindur se ju jeni shumë të ndërgjegjshëm për detyrat dhe përgjegjësitë tuaja të rënda, unë

jam i bindur se do t'i kryeni me nder detyrat tuaja si oficerë të denjë të ushtrisë sonë heroike dhe luftëtarë të pamposhtur të popullit e të Partisë.

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

. L E N D A

PARATHËNJE PËR VËLLIMIN 9 V—VII

1 9 5 2

MBI VËRTETIMIN E DOKUMENTAVE — Konkluzione në Plenumin XII të KQ të PPSH (8 janar 1952)	1—9
FJALIM I MBAJTUR ME RASTIN E INAUGURIMIT TË PUNIMEVE TË HIDROCENTRALIT MBI LUMIN E MATIT (11 janar 1952)	10—22
TË FORCOJMË VAZHDIMISHT PARTINË NË PROCESIN E LUFTËS PËR NDËRTIMIN E SOCIALIZMIT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (15 janar 1952)	23—36
TË PËRMIRËSOJMË MË TEJ DREJTIMIN E PROPAGANDËS DHE TË AGJITACIONIT TË PARTISË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (15 janar 1952)	37—49
TË PËRMIRËSOJMË ORGANIZIMIN DHE DREJTIMIN E PUNËS PËR REALIZIMIN E DETYRAVE EKONOMIKE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (16 janar 1952)	50—63
TË ZBATOJMË DREJT POLITIKËN E PARTISË NË CILËSIMIN E KULAKËVE NË FSHAT — Letër dërguar Komitetit të Partisë të rrëthit Durrës (21 janar 1952).	64—70

SI TË PARAQITEN MATERIALET PËR MBLEDHJET E BYROSE POLITIKE E TË SEKRETARIATIT TË KQ TË PPSH — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (25 janar 1952)	71—74
SHTYPI NUK MUND TË JETË I PAVARUR NGA PARTIA — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (25 janar 1952)	75—80
TË GJALLEROHEN MË SHUMË ASAMBLETË E KOOPERATIVAVE TË SHITBLERJES DHE TË KONSUMIT — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (25 janar 1952)	81—84
MBI DISA GABIME NË PUNËN E KOMITETIT TË PARTISË TË RRETHIT TË PUKËS — Letër udhëzuese dërguar komiteteve të Partisë në rrethe (26 janar 1952)	85—92
TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR KQ TË PPB TË POLONISË ME RASTIN E 10-VJETORIT TË THEMELIMIT TË SAJ (29 janar 1952)	93—94
TELEGRAM NGUSHULLIMI DËRGUAR QEVERISË SË RP TË MONGOLISË ME RASTIN E VDEKJES SË MARESHALIT ÇOJBALSAN (29 janar 1952)	95—96
MË SHUMË INTERESIM PËR PROBLEMET JETIKE TË POPULLIT — Takim me sekretarin e parë të Komitetit të Partisë të rrethit të Durrësit (2 shkurt 1952)	97—118
LETËR FALENDERIMI DËRGUAR PIONIERËVE TË SHKOLLËS SË LUKOVËS (17 shkurt 1952)	119—120
TELEGRAM URIMI DËRGUAR SHOKUT MATIAS RAKOSHI ME RASTIN E 60-VJETORIT TË DITËLINDJES (9 mars 1952)	121—122
RAPORT NË KONGRESIN II TË PPSH «MBI AKTIVITETIN E KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË» (31 mars 1952)	123—293

I

SITUATA NDËRKOMBËTARE.	124—140
-----------------------------	---------

II

LUFTA E POPULLIT SHQIPTAR PËR MBROJTJEN E PAQES, TË INDIPENDENCËS SË TIJ DHE PËR NDËRTIMIN E BAZAVE TË SOCIALIZMIT	141—154
--	---------

III

ZHVILLIMI I EKONOMISË SONË DHE PER-SPEKTIVAT E SAJA	155—172
---	---------

IV

PARTIA JONË NË KRYE TË DETYRËS DHE NË RRUGËN E FORCIMIT TË MËTEJSHËM TË SAJ	173—245
---	---------

1) PËRBERJA DHE SHTRIRJA E PARTISË ..	174
---------------------------------------	-----

2) JETA E BRENDSHME E PARTISË DHE ÇËSHTJA E DREJTIMIT TË SAJ	178
--	-----

a) Nuk mjafton të kuptohet në teori rëndësia e udhëheqjes kolegjiale dhe ajo e dhënjes llogari para masës së Partisë, por këto duhet të vihen në jetë	181
---	-----

b) Në qoftë se nënveftësohet aktivi i Partisë, atëherë nënveftësohet roli i Partisë	190
---	-----

c) Kritika dhe autokritika bolshevike në Partinë tonë nuk mund të njohin as kondita as kuqi.	192
--	-----

3) VERIFIKIMI I DOKUMENTAVE TË ANETARËVE TË PARTISË	202
---	-----

4) LUFTA KUNDER TITIZMIT DHE DEVIA- CIONET NGA VIJA E PARTISE	208
a) Partia të jetë gjithnjë vigjilente	217
b) Konkluzionet e Plenomit IX kanë qonë një mësim dhe një eksperiencë e vlefshme për gjithë Partinë	221
5) EDUKIMI MARKSIST-LENINIST I ANE- TAREVE DHE I KUADROVE TË PARTISE. PROPAGANDA E PARTISE	230
a) Të forcojmë punën e Partisë në fushën idco-politike dhe kulturale	240
b) Për një lidhje të ngushtë të teorisë me praktikën	243

V

MBI DISA DETYRA URGJENTE NË LIDHJE ME FSHATIN.	246
--	-----

VI

TË FORCOJMË DHE TË DEMOKRATIZOJMË PUSHTETIN POPULLOR	269
---	-----

FJALA E MBAJTUR NË SEANCËN E MBYLLJES SË KONGRESIT II TË PARTISE SË PUNËS TË SHQIPÉRISE (6 prill 1952)	294—300
--	---------

TELEGRAM URIMI DËRGUAR SHOKUT BOLESLAV BJERUT ME RASTIN E 60-VJETORIT TË DITE- -LINDJES (18 prill 1952)	301—302
---	---------

LETËR DËRGUAR KOMITETEVE TË PARTISE DHE KOMITETEVE EKZEKUTIVE TË RRETHEREVE LUSH- NJË, FIER, BERAT DHE PËR NJOFTIM GJITHË KOMITETEVE TË PARTISE DHE KOMITETEVE	
---	--

EKZEKUTIVE NË RRETHE NË LIDHJE ME FUSIAT TËN E MBJELLJEVE (5 maj 1952)	303—306
MBI FORCIMIN E PUNËS ME LEKTORËT — Dis- kutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (9 maj 1952).	307—308
MBI DËRGIMIN E KOMUNISTËVE NË OBJEK- TET E MËDHA TË NDËRTIMIT — Nga diskuti- mi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (16 maj 1952)	309—312
MBI PUNËN E PARTISË NË USHTRI — Nga fjala në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (23 maj 1952).	313—316
MBI FORCIMIN E UDHEHEQJES SË PARTISË NË BASHKIMET PROFESIONALE — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (30 maj 1952)	317—321
KOOPERATIVAT E SHITBLERJES TË KRYEJNË SI DUHET FUNKSIONET EKONOMIKE DHE POLITIKE QË U KA NGARKUAR PARTIA — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (6 qershor 1952)	322—331
NGA BISEDA E ZHVILLUAR ME KRYETARIN E KOMITETIT EKZEKUTIV TË KP TË RRETHIT TË TIRANËS NË LIDHJE ME PROBLEMET E FSHATIT (17 qershor 1952)	332—352
MBI PUNIMIN E REZOLUCIONEVE TË KONGRESIT II TË PPSH NË AKTIVET DHE ORGANIZATAT BAZË TË PARTISË NË TERREN DHE NË USHTRI — Nga diskutimi në Plenumin II të KQ të PPSH (27 qershor 1952)	353—362
FJALA E MBAJTUR NË KONGRESIN E DYTË TË BRPSH (29 qershor 1952)	363—379
MBI KATEGORIZIMIN E PUNËTORËVE DHE TË NËPUNËSVE — Nga diskutimi në Byronë Politike të KQ të PPSH (4 korrik 1952).	380—384

FRONTIN DUHET TA BËJMË NJË ARMË AKTIVE QË TË MBËSHTETË VIJËN E PARTISË — Fjala e mbylljes në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë (8 korrik 1952)	385—393
TELEGRAM URIMI DËRGUAR J. V. STALINIT ME RASTIN E INAUGURIMIT TË KANALIT LUNDRU-ES VOLLGA-DON «LENIN» (26 korrik 1952)	394—395
FJALA PARA OFICERËVE QË MOREN PJESË NË LOJËN OPERATIVE TË ARMATËS (30 korrik 1952).	396—415
MBI ZGJERIMIN E INDUSTRISË LOKALE DHE TË ARTIZANATIT — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (4 gusht 1952).	416—419
LETËR UDHEZUESE DËRGUAR KOMITETEVE TË PARTISË NË RRETHE MBI PROCEDURËN QË DUHET NDJEKUR NË CAKTIMIN E KANDIDATËVE PËR ANËTARE TË KËSHILLAVE POPULLORE (12 gusht 1952).	420—423
MBI REALIZIMIN E PLANIT TË SHTETIT PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 1952 — Nga fjala e mbylljes në Plenumin III të KQ të PPSH (12 gusht 1952).	424—440
FJALA NË KONGRESIN E TRETE TË BASHKIME-VE PROFESIONALE TË SHQIPËRISË (20 gusht 1952)	447—473
MBI DISA ÇËSHTJE TË ARËSIMIT SHTETËROR — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (22 gusht 1952)	474—476
LETËR DËRGUAR REDAKSISE SË GAZETËS «ZËRI I POPULLIT» ME RASTIN E 10-VJETORIT TË THEMELIMIT TË KËTIJ ORGANI (24 gusht 1952).	477—479
FJALA PARA DISA OFICERËVE QË U GRADUAN GJENERAL-MAJORE (30 gusht 1952)	480—482

Shtypur NISH Shtyp. «M. DURI», Stab. «8 NËNTORI» — Tiranë